MARIO VARGAS LLOSA
FESTA
E
CJAPIT
ROMAN
Një kryevepër mbi pushtetin,
diktaturën dhe natyrën e njeriut.

MARIO VARGAS LLOSA

FESTA E CJAPIT

Roman

“Populli feston
me gëzim të madh
Festën e Cjapit
më tridhjetë maj.”

Kanë vrarë Cjapin
Merenga domenikane

I

Urani. Prindërit nuk i kishin bërë ndonjë favor. Ky emër të jepte idenë e një planeti, të një minerali, të gjithçkaje, përveç gruas shtathedhur me tipara fine, me një lëkurë të lëmuar e të ndritshme, me sy të mëdhenj e të errët, diçka e trishtuar, siç ia tregonte pasqyra. Urani! Ç'gjetje! Fatmirësisht, tani, askush s'e thërriste ashtu, po Uri, Miss Kabral, Mrs. Kabral ose Dr. Kabral. Me sa kujtonte, qysh kur doli nga Santo Domingo (më mirë të themi Qyteti Truhijo, kur iku ende nuk ia kishin ndërruar emrin kryeqytetit), as në Adrian, as në Boston, as në Uashington D.C., as në Nju Jork, askush nuk do ta quante më Urani, si më përpara në shtëpinë e vet dhe në Kolegjin Santo Domingo, ku motrat dhe shoqet e saj e shqiptonin saktësisht atë emër të çuditshëm që ia kishin ngjitur kur lindi. Do t'i shkonte më mendja për atë emër? Tepër vonë për ta ndryshuar, moj vajzë; jot ëmë është në qiell dhe yt atë i vdekur së gjalli. Kurrë nuk do ta kujtosh. Urani! Aq i pakuptim, si të fyesh Santo Domingon e vjetër të Gusmanit, duke e quajtur Qyteti Truhijo. A do të mendonte kështu dhe yt atë?

Po pret të duket deti nga dritarja e dhomës së vet, në katin e nëntë të Hotel Haragua. Më në fund e sheh. Errësira hapet për pak sekonda dhe shkëlqimi kaltëror i horizontit që zgjerohet me shpejtësi, i jep pamjen që priste qysh kur u zgjua në katër të mëngjesit, megjithëse e kishte gëlltitur hapjen, duke thyer rregullin e vet kundër barit për gjumë. Sipërfaqja blu e errët e detit, e njollosur befas me të bardha shkume, vinte e takohej me një qiell të plumbtë, tej te vija e largët e horizontit, ndërsa këtu, në breg, deti thërrmohej në valë të zhurmshme e të shkumbta duke u përplasur buzë Malekonit*, ku duken copëza rruge midis palmave dhe bajameve që e rrethojnë. Dikur, Hotel Haragua e shikonte Malekonin përballë. Tani e sheh brinjas. Kujtesa i sjell imazhin – të ç'dite vallë? – e vajzës së vogël, të kapur për dore nga babai, duke hyrë në restorantin e hotelit për të drekuar të dy vetëm. Të ulur në një tavolinë

pranë dritares nga ku, përmes perdes së hollë, Urania e vogël shihte kopshtin e gjerë dhe pishinën me trampolinat dhe notuesit. Një orkestër i binte merengas në Platenë Spanjolle, rrethuar me pllaka qelqi e saksi me karafilë. A thua të jetë njësoj si atëherë? "Jo", thotë me zë të lartë. Hotel Haraguan e asaj kohe e kishin shembur dhe e kishin zëvendësuar me këtë ndërtesë të madhe në ngjyrën e panxharisë së kuqe, që e habiti me të mbërritur në Santo Domingo, para tri ditësh.

A bëre mirë që u ktheve? Do të pendohesh, Urani. Të shpërndash një javë nga pushimet tua, ti që kurrë s'pate kohë për të njohur as qytete, as krahina apo vende që kishe dashur t'i shikoje – vargmalet dhe liqenet e ngrirë të Alaskës, për shembull – dhe u ktheve në këtë ishull të vogël, për të cilin ishe betuar se nuk do ta shkelje më kurrë. Shenjë dobësie? Sentimentalizëm vjeshtor? Jo. Kureshtje, asgjë më shumë. Do të provosh se mund të ecësh nëpër rrugët e këtij qyteti që tashmë nuk është i yti, të shëtitësh në këtë vend të huaj pa të mbytur trishtimi, nostalgia, urrejtja, hidhërimi, zemërimi. Apo ke ardhur të përplasesh me tët atë, i cili tani është një rrënojë? Mos do të dish se ç'ndjenja do të provosh pa ta shohësh pas kaq vjetësh? Një rrëqethje e përmendshme që i përshkon nga koka te këmbët. Urani! Urani! E sheh pra, që pas shumë vitesh zbulon se përtej sjelljeve të tua kapriçoze, të rregullta, të padepërtueshme prej njeriu të fortë, se pas asaj fortese që ta admirojnë e ta kanë zili të gjithë, ke një zemër të butë, të drithëruar, të vuajtur, sentimentale? Nis e qesh. Mjaft me këto marrëzira, moj vajzë!

Vesh atletet, pantallonat, bluzën sportive dhe mbledh flokët me një rrjetëz. Pi një gotë ujë të ftohtë dhe është gati të ndezë televizorin për të parë CNN, por pendohet. Rri pranë dritares, duke parë detin, Malekonin, pastaj kthen kokën e sheh pyllin e çative, kullat, kupolat, kambanat dhe kurorat e pemëve të qytetit. Sa është zgjeruar! Kur e la, në vitin 1961, kishte treqind mijë banorë. Tani, më shumë se një milion. Është mbushur me lagje, bulevarde, parqe e hotele. Një natë më parë ishte ndier e huaj, duke kaluar me një autoveturë me qira nëpër lagjen elegante Bela Vista dhe nëpër parkun e madh Mirador, ku kishte plot joggers, njësoj si në Parkun Qendror. Në fëmijërinë e saj, qyteti mbaronte te Hotel Ambasadori. Prej aty fillonin kopshtet dhe arat e mbjella. "Country Club", ku i ati e çonte të dielave në pishinë, atëherë kishte përreth vetëm fusha, në

vend të asfaltit, shtëpive dhe shtyllave elektrike që ka tani.

Po qyteti kolonial nuk është modernizuar, as lagja e saj Gaske. Urania është e sigurt se edhe shtëpia e saj nuk ka ndryshuar shumë. Do të jetë po ajo, me kopshtin e vogël, me mangon e hershme dhe flambojanin me lule të kuqe, të shtrirë mbi tarracën ku zakonisht drekonin në ajrin e pastër çdo fundjavë; me çatinë e saj me kulm dhe ballkonin e vogël të dhomës së saj, ku priste kushërirat, Lusindën dhe Manolitën, dhe nga ku, atë vit të fundit të 1961-it, përgjonte atë djaloshin që kalonte me biçikletë, duke e ndjekur me bisht të syrit, pa guxuar t'i fliste. Po brenda, a do të jetë si më parë? Kujtonte orën e madhe austriake të murit me numra gotikë dhe një skenë gjahu në fushë. Po i ati, a do të ishte siç e kishte lënë? Jo. E ka parë të rënë në fotografitë që të dërgonin herë pas here hallë Adelina dhe kushërinj të tjerë të largët, të cilët vazhdonin të të shkruanin edhe pse ti kurrë nuk u ktheve përgjigje.

U lëshua mbi një kolltuk. Dielli i mëngjesit shigjetonte qendrën e qytetit; kupola e Pallatit Kombëtar dhe orka e zbehtë e mureve të saj vezullonin butësisht nën qiellin blu. Hajde pra, dil tani, së shpejti vapa do të jetë e padurueshme. Mbyll sytë e pushtuar nga një plagosje e rrallë (ajo është mësuar të jetë kurdoherë në aktivitet). Qysh kur shkeli përsëri në tokën domenikane, nuk do që të humbasë aspak kohë dhe ajo që e shqetëson është: të kujtojë. "Kjo është bija ime, gjithmonë duke punuar. Edhe kur fle, përsërit mësimin". Kështu thoshte për ty senatori Agustin Kabral, ministri Kabral, Inteligjenti Kabral, dhe u mburrej miqve të vet për vajzën që mori tërë ato çmime, për nxënësen që motrat e merrnin si shembull. A do të guxonte t'i mburrej Shefit për bëmat shkollore të Uranitkës? "Do të më pëlqente shumë që Ju ta njihnit vajzën time, e cila ka marrë çdo vit Çmimin e Lartë, që kur ka hyrë në Kolegjin Santo Domingo. Për time bijë, t'Ju njohë, t'Ju japë dorën, do të ishte vetë lumturia. Uranitka lutet çdo natë që Zoti t'Ju ruajë shëndetin e hekurt që keni. Po ashtu lutet për donja Hulian dhe donja Marien. Plotësonani këtë dëshirë. Jua kërkon Ju let, Ju përgjërohet me besniku i qenve Tuaj. Ju do të ma pranoni lutjen: Priteni time bijë! Shkëlqesia Jonë! Udhëheqësi ynë!"

E urren? E ke inat? Ende? "Tani, jo", thotë me zë të lartë. Nuk do të kishe ardhur në qoftë se inati do të vazhdonte të të gërryente, nëse plaga do të ishte akoma e përgjakur, apo

zhgënjimi do të ishte duke të dërrmuar e helmuar, si në kohën e rinisë, kur të studiuarit, të punuarit të qenë kthyer në ilaçe të fuqishëm për të mos kujtuar asgjë. Atëherë, po, e urreje. Me tërë forcën tënde, me tërë mendimet dhe ndjenjat që përbënin qenien tënde. I kishe dëshiruar fatkeqësinë, sëmundjet, aksidentet. Zoti ta plotësoi dëshirën, Urani. Djalli, më mirë. Nuk të mjaftoka që hemorragjia cerebrale e ka vrarë së gjalli? A s'është kjo një hakmarrje e ëmbël që e ka mbërthyer për karroce qysh prej dhjetë vjetësh, pa lëvizur, pa folur, veç me një infermiere që e ushqen, e shtrin për të fjetur, e vesh, e zhvesh, i pret thonjtë, e rruan, e vë të bëjë ujët e hollë dhe ujët e trashë? Hë, ndjehesh e kënaqur tani? "Jo."

Pi gotën e dytë me ujë e del. Është shtatë e mëngjesit. Në katin përdhes të Haraguas e mësyn zhurma, ajo atmosfera familjare tashmë, me zëra njerëzish, motorrësh, radiosh në tërë volumin, merengash, salsash, dansonesh e bolerosh, apo rock e rap, të gjitha të përziera, duke u sulur e duke e sulmuar me ulërimat e tyre. Një kaos i zjarrtë, një nevojë e thellë për t'u trullosur, për të mos menduar e pothuajse për të mos vuajtur për atë që pësoi vendi yt, Urani. Po është dhe shpërthimi i një jete të egër, të padëmtuar nga dallgët e modernizimit. Pas kësaj forme pararacionale, magjike, kapet diçka pastërtisht domenikane: Etja për zhurmën. ("Për zhurmë, jo për muzikë.")

Nga fëmijëria s'i kujtohej, kur Santo Domingo quhej Qyteti Truhijo, të kishte një gjallëri të tillë në rrugë. Ndoshta s'kishte. Ndoshta tridhjetë e pesë vjet më parë, kur qyteti ishte tri a katër herë më i vogël, provincial, i izoluar dhe i përgjumur nga frika e paniku e me shpirt të tkurrur nga përulja dhe servilizmi ndaj Udhëheqësit, Gjeneralisimit, Bamirësit, Babait të Atdheut të Ri, Shkëlqesisë së Tij, Doktor Rafael Leonidas Truhijo Molina, ishte më i heshtur, më pak i furishëm. Sot, të gjithë tingujt e jetës, motorrët e makinave, kasetat, disqet, radiot, boritë, lehjet, hungërimat, zërat njerëzorë, dalin me tërë forcën e shfaqin nga kjo aftësinë, me tingujt e zhurmshëm mekanikë, dixhitalë a shtazorë (qentë lehin më fort dhe zogjtë cicërijnë me më shumë qejf). Pse Nju Jorku ka aq famë zhurme?! Kurrë gjatë dhjetë vjetëve të jetës së saj në Manhattan, veshët s'i kishin regjistruar gjë që t'i ngjante kësaj sinfonie të tmerrshme, të çakorduar, ku është zhytur këto tri ditë.

Dielli përvëlon palmat e thinjura me kurora të larta, tro-

tuarët e prishur dhe si të bombarduar, gropat dhe grumbujt e plehrave, që disa gra me shami në kokë, i fshijnë dhe i hedhin në qeska që nuk mjaftojnë. “Haitjanet”. Tani rrinë të heshtura, po dje çuqusnin midis tyre në gjuhën kreole*. Pak më tej shikon dy haitjanë të zbathur dhe gjysmëzhveshur, të ulur mbi ca arka, pranë dhjetëra pikturave me ngjyra të ndezura, të hapura mbi një mur. Është e vërtetë se qyteti, pothuajse i gjithë vendi, është mbushur me haitjanë. Më përpara nuk kishte. A nuk thoshte senatori Agustin Kabral: “Për Udhëheqësin le të thonë ç’të duan, por historia do t’i njohë, të paktën, që ka bërë një vend modern dhe që i shporri në vendin e tyre haitjanët. Ilaçe të fortë për sëmundje të rënda!” Udhëheqësi gjeti një vend të shkatërruar nga luftërat midis kapove, pa ligje dhe pa rregulla, një vend të varfër që ishte duke humbur identitetin, një vend ku dyndeshin fqinjtë e egër dhe të uritur. Ata kapërcenin lumin Masakre dhe vidhnin pasurinë tonë, kafshët tona, shtëpitë tona. Na rrëmbenin punën punëtorëve tanë të bujqësisë, e prishnin fenë tonë katolike me shtrigëritë e tyre prej djalli, përdhunonin gratë tona, shkatërronin kulturën, gjuhën e zakonet tona perëndimore e hispanike, duke na imponuar tyret, afrikane dhe barbare. Udhëheqësi ynë preu nyjen gordiane: “Ilaçe të fortë për sëmundje të rënda!” Inteligjenti, jo vetëm përligjte masakrën bërë haitjanëve në vitin tridhjetë e shtatë, po e quante edhe si një bëmë të dytë në histori prej këtij fqinji grabitqar? Ç’rëndësi kanë pesë, dhjetë, njëzet mijë haitjanë, kur bëhet fjalë për të shpëtuar një popull?

Ecën nxituar, duke njohur vendet: Kazino Guibia e kthyer në klub dhe qendra e banjave, e qelbur tani nga ujërat e zeza. Ja, mbërrin te kryeqëzimi i Malekonit me bulevardin Maksimo Gomes, itinerari i Udhëheqësit gjatë shëtitjeve të tij të mbrëmjes. Që kur mjekët e këshilluan se i bënte mirë për zemrën, shkonte nga Vila Radames deri te Maksimo Gomes, me një pikë qëndrimi në shtëpinë e donja Hulias, Zonjës Madhështore, aty ku Uranitka kishte hyrë një herë për të recituar diçka, por që për dreq, qe ngatërruar; pastaj zbriste deri te Malekoni Xhorxh Uashington, këtu kthehej dhe vazhdonte deri tek Obelisku (që shërbente atë të Uashingtonit), me hap të shpejtë, i rrethuar nga ministra, këshilltarë, gjeneralë, adjutantë, oborrtarë, të cilët rrinini në një largësi të respektueshme,

me sytë katër e zemrën plot shpresë, duke pritur një gjest, një shenjë për t'i lejuar t'i afroheshin sadopak Udhëheqësit, ta dëgjonin, të meritonin një bisedë me të, qoftë edhe një qortim po të ishte. Çdo gjë le të ndodhte, veç të mos qëndroje larg në ferrin e të harruarve. "Sa herë shëtitje midis tyre, baba? Sa herë pate fati e madh të të fliste? Dhe sa herë u ktheve i dëshpëruar, sepse nuk të foli, i tmerruar që nuk ndodheshe në rrethin e të zgjedhurve dhe që kishe rënë me të mallkuarit. Gjithkohët jetove me llahtarin se mos përsëritej historia e Anselmo Paulinos edhe me ty. Por ajo u përsërit, baba."

Urania qeshi, dhe një çift me pantallona të shkurtra që ecte në të kundërt, mendoi se qeshi me ta. "Mirëdita", i thanë ata. Por ajo qeshi me imazhin e senatorit Agustin Kabral, i cili rrethe çdo mbasdite këtu te Malekoni, mes shërbëtorëve të luksit, i vëmendshëm jo për flladin e nxehtë, zhurmat e detit, vërtimën e pulëbardhave, as për yjet e ndritur të Karaibeve, po për duart, sytë, lëvizjet e Udhëheqësit, që mbase i jepnin ndonjë sinjal, duke e preferuar ndaj të tjerëve. Mbërriti te Banka Bujqësore. Pastaj mbërrin te Vila Ramfis e më pas te Ministria e Punëve të Jashtme dhe Hotel Hispanjola. U kthye.

Ja rruga Qezar Nikolas Penson, ja cepi Galvan. Do të shkosh apo do të kthehesh në Nju Jork, pa i hedhur një sy shtëpisë? Do të hysh dhe do të pyesësh infermieren për invalidin dhe do të ngjitesh në dhomën e gjumit e në tarracë, ku e nxjerrin për të bërë gjumin e mbasdites. Ajo tarracë që bëhej e kuqe nga lulet e flambojanit. "Mirë se të gjej, baba. Si je, baba? Nuk më njeh? Jam Urania. Patjetër që do të më njohësh. Kur më ke parë herën e fundit, isha katërmbëdhjetëvjeçe, tani jam dyzet e nëntë. Njeriu ndryshon. Nuk është ashtu po ajo moshë që kishe ti, baba, kur ika në Adrian? Po, dyzet e tetë ose dyzet e nëntë. Një burrë në kulmin e pjekurisë. Tani po mbush tetëdhjetë e katër. Të ka mbërthyer pleqëria, baba." Nëse është në gjendje të mendojë, ka pasur shumë kohë gjatë këtyre viteve për të bërë një bilanc të jetës së tij të gjatë. Kush e di ç'do të kesh menduar për vajzën tënde bukëshkalë, e cila për tridhjetë e pesë vjet nuk t'u përgjigj në një letër, nuk të dërgoi një fotografi, as një urim për ditëlindje, për Krishtlindje a për Vit të Ri. As kur pësove hemorragjinë (ndërsa hallat, dajat, kushërinjtë, menduan se do të vdisje), ajo as erdhi, as pyeti për shëndetin tënd. Ç'bijë shpirtligë, baba.

Shtëpia në Qezar Nikolas Penson, te cepi Galvan. Tani nuk presin më vizitorë, në hollin e hyrjes ku zakonisht vendosej portreti i Virgjëreshës së Altagrasias. Shtëpia me atë pllakën e bronxtë përunjëse: "Në këtë shtëpi, Truhijo është Zot". A është ende si provë besnikërie, të cilët i blenë dhe i bënë mijëra domenikanë, të cilët i blenë ato pllaka dhe i vendosën në vendin më të dukshëm të shtëpisë që askush të mos dyshonte për besnikërinë e tyre ndaj Udhëheqësit, por kur u prish magjia, donin t'i zhduknin gjurmët, sepse ajo pllakë turpi përfaqësonte burracakërinë e tyre. Edhe ti me siguri do ta kesh zhdukur, baba.

Mbërrin në Hispanjola. Ka djersitur dhe zemra i rreh me shpejtësi. Përgjatë bulevardit Xhorxh Uashington kalon një lumë i madh me autovetura, kamionçina e kamionë dhe i duket se të gjithë i kanë hapur radiot në kupë të qiellit dhe nga zhurma e madhe do t'i shpërthenin veshët. Herë-herë, nga dritaret e autoveturave del ndonjë kokë burri dhe sytë e saj kryqëzohen për një çast me ndonjë sy mashkullor që i vështron gjoksin, këmbët apo vithet. Ç'vështrime! Ndërkohë që pret dhe i lë të kalojnë, mendon, sikurse bëri dje e pardje, se është në tokën domenikane. Në Nju Jork askush nuk i shikon femrat me kaq ngulm e epsh. Këtu të masin, të peshojnë, llogarisin sa mish ke në një gji dhe në një kofshë, sa qime ke në pubis, llogarisin me saktësi burrat e mollaqeve të tua. Mbyll sytë nga një marramendje e lehtë. Në Nju Jork tani as latinët, pra, domenikanët, kolombianët, guatemalasit etj., nuk të shohin më kështu. Kanë mësuar t'i mposhtin pasionet, duke kuptuar se nuk duhen parë gratë siç vështrojnë qentë bushtrat, kuajt pelat, apo derrat dosat.

Kur makinat ndalojnë, përshkon rrugën. Në vend që të bëjë një gjysmëkthesë e të drejtohet për nga Hotel Haragua, jashtë vullnetit të saj këmbët e çojnë drejt Hispanjolas dhe pastaj e kthejnë nga Indipendenca, një bulevard që, po të mos e tradhtojë kujtesa, duke filluar që këtu, është i mbytur dyfish me pemë të dendura dafinash, majat e të cilave mpleksen mbi xhade, duke e freskuar, derisa ajo degëzohet e humbet tej midis qytetit kolonial. Sa herë ke shëtitur me babain për dore, nën hijen freskuese të dafinave të Indipendecës. Zbrisnit nga Qezar Nikolas Penson te ky bulevard dhe shkonit deri te parku Indipendenca. Pastaj te akullorja italiane në krahun e

djathtë ku fillonte El Konde, merrnit një akullore me koko, mango apo guajava. Sa krenare ndihej kapur te dora e atij zotërie: Senatori Agustin Kabral, ministri Kabral. Të gjithë e njihnin. I afroheshin, i jepnin dorën, i hiqnin kapelen, e përshëndesnin, ndërsa rojat dhe ushtarakët kërcisnin takat me ta parë që afrohej. Sa do të të ketë marrë malli baba për ato vite, kur ishe aq i rëndësishëm. Tani je kthyer në një mjeran i rëndomtë. Me ty u kënaqën, duke të sharë në Forumin Publik, por nuk të futën në burg si Anselmo Paulinon. Burgut i trembeshe më shumë, apo jo? Se kushedi një ditë të bukur Shefi do të urdhëronte: Inteligjent, në burg! Pate fat, baba.

Po bëhen tre çerek ore dhe ka ende mjaft rrugë deri te hoteli. Po të kishte para me vete, do të ishte futur në ndonjë kafene për ndonjë kafe të nxehtë e të shpëlarë. Herë pas here fshin djersën nga fytyra. Vitet bëjnë punën e vet, Urani. Tani, me dyzet e nëntë vite në shpinë, s'je më e re. Veç nuk je ende për ta lënë veten pas dore si një rraqe e vjetër, po të gjykosh se si hidhnin vështrime djathtas e majtas mbi fytyrën dhe trupin tënd, vështrime mikluese, lakmitare, dëshiruese, nga meshkujt që janë mësuar t'i zhveshin me sy e me mendje tërë femrat që kalojnë në rrugë. "Dyzet e nëntë vjet të kaluara mrekullisht mirë, Uri", tha Dik Litnej, miku yt, kolegu yt i zyrës së punës, atë natë në ditëlindjen tënde, pasi hodhi dy-tri gota uiski si Diku. I shkreti Dik, u skuq dhe u hutua, kur Urania e ngriti me një nga ato vështrimet e ngadalta, me të cilat, për gati tridhjetë e pesë vjet, po përballon komplimentet, shakatë dhe falënderimet e tepruara, aluzionet apo budallallëqet e burrave, po shpesh edhe të grave.

Ndalet për të marrë veten. Ndien zemrën e çakorduar dhe gjoksin t'i ulet e t'i ngrihet me forcë. Ndodhet ku kryeqëzohet Indipendenca me Maksimo Gomes, midis një grupi burrash e grash, duke pritur të kalojë në anën tjetër. Hunda e saj ndien një larmi aq të madhe aromash, sa edhe pafundësia e zhurmave që po i çokanisin veshët: era e vajit që djegin motorrët e autobusëve dhe që e lëshojnë pastaj jashtë nga tubat e daljes si gjuhëza të tymta që shpërhapen apo pluskojnë mbi këmbësorët; erëza dhjami të fërgurar, të ardhura nga ndonjë cep ku kërkasin tiganët dhe ku ofrojnë për të ngrënë e për të pirë; ajo era e rëndë, mbytëse, e pambarimtë, tropikale, prej rrëshi-

rash dhe shkurresh në kalbje, prej trupash të djersitur; një ajër i ngopur me esenca kafshësh, bimësh e njerëzish, të cilët dielli i mbron, duke ua vonuar përhapjen e davaritjen. Është një aromë e ngrohtë që i prek ndonjë fije intime të kujtesës dhe e shpie në fëmijërinë e saj, te trinitariat shumëngjyrëshe të varura nëpër ballkone, te ky bulevard me emrin Maksimo Gomes. Dita e Nënave! Sigurisht. Maji me diell rrezatues, me shira përmbytës, vapë. Vajza të zgjedhura të Kolegjit Santo Domingo për t'i çuar lule Mama Hulias, Zonjës Madhështore, nënës së Bamirësit, pajtore dhe simboli i nënës kishëtare. I sollën me një autobus të kolegjit, me uniformat e tyre të bardha e të pastra, të shoqëruara nga drejtuesja e kuvendit dhe nga motër Maria. Të nxitura nga kureshtja, krenaria, dashuria dhe respekti. Ishe në grupin përfaqësues të kolegjit te shtëpia e Mama Hulias. Do të recitoje poemën "Nënë dhe mësuese, Zonja Madhështore", që e kishe shkruar vetë dhe që e kishe recituar dhjetëra herë përpara pasqyras, përpara shoqeve të tua, përpara Lusindës dhe Manolitës, përpara babait, përpara motrës dhe që e kishe përsëritur me vete për t'u siguruar se mos harroje ndonjë rrokje. Po kur mbërriti çasti fatlum, në shtëpinë e madhe rozë të Mama Hulias, Uranitka, e hutuar nga ushtarakët, zonjat, adjutantët dhe delegacionet që mbushnin kopshtet, dhomat, korridoret, e shastisur nga emocionet, eci, me dashuriësi nga karrigia lëkundëse, me tufën e trëndafilave që sapo ia kishte dorëzuar drejtuesja e kuvendit, pikërisht aty, të ëmblës çupkë, iu mbyll goja e nga mendja iu fshinë të gjitha. Ia dha të qarit. Dëgjoje të qeshura, fjalë kurajoje, nga zonja dhe zotërinj që rrethonin Mama Hulian. Zonja Madhështore, duke buzëqeshur, kërkoi t'i afroheshe. Atëherë, Uranitka u rregullua, fshiu lotët, mori qëndrim gatitu dhe, e vendosur, e shpejtë, po jo me intonacionin e duhur, recitoi "Nënë dhe mësuese, Zonja Madhështore". E recitoi rrëmbimthi. E duartrokitën. Mama Hulia i përkëdheli flokët dhe, me buzët e saj të mbledhura e plot rrudha, e puthi.

Më në fund, u hap e gjelbra. Urania vazhdon rrugën, e mbrojtur nga dielli prej hijes së pemëve të Maksimo Gomesit. Ka gati një orë që ecën. Është kënaqësi të ecësh poshtë dafinave, të kundrosh ato pemë me lule të kuqe dhe pistil të praruar dhe kajenan, që ndryshe quhet gjak Krishti, e zhytur

në mendimet e veta, e shushatur nga rrëmuja e zërave dhe muzikës, megjithatë e kujdesshme ndaj disniveleve të rrugës, gropave, pellgjeve, prishjeve të trotuarëve, ku herë pas here është gati të pengohet ose të fusë këmbën në plehrat që rremihin qentë e rrugëve. Ishe e lumtur, atëherë? Kur vajte me grupin e nxënëseve të Santo Domingos për t'i çuar lule për t'i recituar poemën në Ditën e Nënave Zonjës Madhështore, vërtet ishe e lumtur. Tek Urania, që kur e ëma, ajo figurë mbrojtëse, e bukur, e fëmijërisë së saj, ndoshta u largua edhe kuptimi i lumturisë për jetën. Por yt atë, ungjërit – mbi të gjithë hallë Adelina dhe xhaxha Anibali, po ashtu kushërirat e para, Lusinda dhe Manolita – dhe miqtë e vjetër bënë ç'ishte e mundur për të mbushur mungesën e nënës tënde me përkëdhelje dhe lastime që të mos ndiheshe e vetmuar, e humbur. Babai t'u bë edhe baba, edhe nënë ato vite. Prandaj e doje aq shumë. Prandaj të dhembi shumë, Urani.

Kur mbërrin te porta e pasme e Haraguas, ku dikur ishte një portë hekuri e gjerë nga hynin automobilat, kryeshërbëtorët, kuzhinierët, kamerierët, pastruesit, nuk ndalet. Ku shkon? Nuk ka marrë ndonjë vendim. Por mendja e saj, e përqendruar në fëmijërinë e vet, në kolegjin e vet, në të dielat kur shkonte me hallë Adelinën dhe kushërirat te lojërat feminore, në kinemanë Elite, ende nuk ka mendimin të hyjë në hotel që të bëjë një dush e të hajë mëngjes. Këmbët kanë vendosur të ecin. Ecën pa mëdyshje, e sigurt për atë. Vërtet do të shkosh për atje ku ke nisur, Urani? Tani e di që do të shkosh, edhe pse nuk do.

Kthehet nga e majta te Servantesi dhe ecën përpara drejt Belivarit, duke i rënë në ëndërr shtëpisë një apo dykatëshe, me oborre dhe kopshte, me tarraca të zbuluara dhe garazhe. Të gjitha i zgjojnë ndjenja familjare. Janë pamje shtëpish të ruajtura, por edhe të dëmtuara, lehtësisht të çngjyrosura, të ciflosura, të shëmtuara me shtesa dhe ngjitje, dhomëza të ngritura mbi tarraca, të ngjitura anash shtëpive, në mes të kopshteve, për të strehuar pinjollët e sapomartuar, që s'mund të jetojnë vetëm dhe vijnë pranë familjeve, duke u kërkuar më shumë hapësirë. Kalon lavanteri, farmaci, dyqane lulesh, kafene, tabela shenjuese mjekësh, dentistësh, llogaritarësh

dhe avokatësh. Gjatë bulevardit Bolivar ecën sikur përpiqet të arrijë dikë, gati të vrapojë. Zemra është gati t'i dalë nga kraharori. Në çdo çast mund të rrëzohet. Në lartësinë e Roza Duartes kthehet majtas dhe fillon të vrapojë. Për fatin e nuk i mjaftojnë dhe përsëri ecën me hap, madje tani më ngadalë, shumë afër murit të bardhëlluar të shtëpisë, që po t'i përsëritet marramendja, duhet të mbështetet diku për të marrë veten. Me përjashtim të një ndërtese të shëmtuar, tepër të ngushtë, me katër kate, ku kishte qenë shtëpia e vogël e doktor Estanislasit, i cili e kishte oborrin nga bajamet, asgjë nuk kishte ndryshuar. Që gati të betohej se ata shërbëtorët që po pastronin kopshtet dhe fasadat, do ta përshëndesnin: "Tungjatjeta, Uranitka. Si je, moj vajzë? Sa qënke rritur, moj çupë! Për ku nxiton kaq, moj?"

Edhe shtëpia s'ka ndryshuar shumë, megjithëse gria e mureve, dikur aq e fortë, tani është e zbardhëllyer, me njolla, e zhvoshkur. Kopshti është kthyer në shkurret barërash të këqija, plot gjethe të thata e të kalbura. Askush nuk e ka ujitur dhe krasitur për vite të tëra. Ja ku është mangoja. Ky është flambojani? Po ku i ka gjethet dhe lulet? Tani është një trung me degë të zhveshura dhe të thata.

U mbështet te porta e hekurt tërë të çara që sheh nga kopshti. Udha e ngushtë, e mbushur me bar midis pllakave, që prishur. Në tarracë dhe në treme ka karrige të vjetra, këmbëthyera. Janë zhdukur orenditë me krep të verdhë. Po ashtu edhe mbajtësja e llambave te cepi, me ato kristalet e smerilara, nga ku ndriçohej tarraca e rreth së cilës grumbulloheshin fluturat e ditës e guximtarin insektet e natës. Ballkoni i vogël i dhomës së saj të gjumit, tani s'ka më trinitarian e harlisur që e mbulonte. Në çimento duket një e çarë me njolla ndryshku.

Në fund të tarracës hapet një derë me një gërvimë të gjatë. Një figurë femre, e mbështjellë me një uniformë të bardhë po e shikon me kureshtje:

-Kërkon njeri?
Urania nuk flet dot. Është e turbulluar, e emocionuar, e trembur. Rri si vuve, duke vështruar të panjohurën.
-Keni nevojë për gjë? - pyet gruaja.
-Unë jam Urania, - thotë më në fund. - E bija e Agustin Kabralit.

II

U zgjua i paralizuar nga një ndjenjë katastrofe. Përpëlitjet që pallat pa lëvizur, i mbërthyer në një rrjetë merimage, gati të gëlltitej nga një përbindësh leshtor gjithë sy. Pas një mundimi të madh, arriti të shtrijë dorën drejt komodinës, ku ruante një pistoletë automatike me karikatorin plot. Po në vend të armës, kapi orën e tavolinës: Katër pa dhjetë. Atëherë gjumi i doli plotësisht. "Përsëri ëndërr e keqe?" Kishte akoma disa minuta. Me maninë për të qenë i përpiktë, nuk çohej nga shtrati para katrës. Asnjë minutë përpara, asnjë minutë pas.
"Çfarë kam arritur, ia detyroj disiplinës" i shkoi në mendje. Dhe disiplinën madje, këtë busull jete, ia detyronte marinsave. Mbylli sytë. Provat në San Pedro de Makoris për t'u pranuar në Policinë Kombëtare Domenikane, që jankit kishin vendosur ta krijonin vitin e tretë të pushtimit, kishin qenë tepër të rënda. Por i kishte kaluar pa vështirësi. Në stërvitje, gjysma e kandidatëve qenë eleminuar. Ai kishte shkëlqyer në të gjitha ushtrimet, në ato shpejtësie, vetmohimi, guximi apo qëndrese, edhe në ato më të rëndat për vullnetin dhe bindjen ndaj eprorëve. Qe zhytur në baltra me gjithë pajimet ushtarake dhe kishte mbijetuar më shumë me mal duke pirë urinën e tij apo duke ngrënë kërcenj, barëra dhe karkalecë. Rreshteri Gitleman i kishte dhënë notën më të lartë: "Do të ecësh përpara shumë, Truhijo". Qe vërtet falë asaj discipline të hekurt heronjsh dhe të përkushtuarish që i patën edukuar marinsat. Mendoi plot mirënjohje për rreshterin Simon Gitleman. Një gringo besnik dhe pa interes, në atë vend meshkinësh, vampirësh dhe burracakësh. A kishin pasur Shtetet e Bashkuara ndonjë mik më të sinqertë se ai këto tridhjetë e një vjet? Cila qeveri i kishte mbështetur më shumë në OKB? Kush qe ai i shpalli luftë Gjermanisë dhe Japonisë? Kush i mbushi me dollarë deputetët, senatorët, guvernatorët, bashkiakët, avokatët dhe gazetarët e SHBA-së? Ai i pagoi sanksionet ekonomike OEA-s, për të kënaqur zezakun Romulo Betankur dhe për të vazhduar thithë

naftë venezuelane. Në qoftë se Xhoni Abesi do t'i kishte bërë saktë gjërat dhe bomba do t'ia kishte këputur kokën pederastit Romulo, nuk do të kishte sanksione dhe gringot burracakë nuk do t'i çanin kokën me sovranitetin, demokracinë dhe të drejtat e njeriut. Po deri atëherë ai nuk e dinte se në atë vend me dy qind milionë budallenj, kishte një mik si Simon Gitlemani. I zoti të fillonte një fushatë personale në mbrojtje të Republikës Domenikane që nga Feniksi, Arizona, ku jetonte duke iu përkushtuar tregtisë qysh kur mori pensionin e marinsave. Dhe pa kërkuar asnjë qindarkë! Falas! Kishte ende burra midis marinsave. Ç'mësim për ato shushunjat e Senatit dhe Dhomën e Përfaqësuesve, të cilët po i majmte për vite të tëra dhe që nuk kishin të ngopur me çeqe, koncesione, dekrete e lehtësira taksash. Dhe tani që ua kishte nevojën, ruanin kokën e tyre. Pa orën, duhen akoma edhe katër minuta. Një gringo madhështor Simon Gitlemani! Një marins i vërtetë. Braktisi tregtinë e vet në Arizona, i indinjuar nga sulmet e Shtëpisë së Bardhë, Venezuelës dhe OEA-s kundër Truhijos dhe bomardoi shtypin amerikan me letra, duke u kujtuar atyre se Republika Domenikane gjatë tërë periudhës së Truhijos, qe një kështjellë e antikomunizmit dhe aleati më i mirë i Shteteve të Bashkuara në tërë Hemisferën perëndimore. Po nuk u kënaq me kaq: erdhi me familjen e tij në Qytetin Truhijo, ku mori me qira një shtëpi në Malekon. Këtë mbasdite Simoni dhe Dorotea do të hanin me të në Pallat dhe ish-marinsi do të merrte Urdhërin "Merito Huan Pablo Duarte", dekorata më e lartë domenikane. Po zotëri, një marins i vërtetë!

Katër fiks. Tani po. Ndezi abazhurin, veshi pantoflat dhe u ngrit, por pa shkathtësinë e dikurshme. Eshtrat i dhimbnin dhe muskujt e këmbëve e të shpatullave i ndiente të dobësuar, si para ca ditësh në Shtëpinë me Mogan, atë natë të mallkuar me atë çupkën pa shije. Nga inati kërcëlliti dhëmbët. U nis drejt karriges, ku Sinforosoja i kishte vënë kostumin e gjimnastikës, por një dyshim e ndali në vend. I shqetësuar, nguli sytë mbi çarçafë: Ja, njolla e përhimtë dhe e paformë shquhej në bardhësinë e linosë. Prapë i kishte shpëtuar. Zemërimi ia fshiu kujtimin e mërzitshëm të Shtëpisë me Mogan. Në djall vaftë! Ky nuk ishte një armik që mund ta shkatërronte si qin-

dra, mijëra, të cilët i kishte përballuar dhe i kishte mundur gjatë viteve duke i blerë, duke i trembur apo duke i vrarë. Ky jetonte brenda tij, qe mishi i mishit të tij, gjaku i gjakut të tij. Dhe po e shkatërronte pikërisht kur kishte nevojë më shumë se kurrë për tëpër forca dhe shëndet. Ajo çupka, ajo ngordhësira, ia solli këtë të keqe.

I gjeti përsosmërisht të lara dhe të hekurosura tirandat, pantallonat e shkurtra, këmishën dhe atletet. Kurrë s'kishte pasur nevojë për shumë orë gjumë. Qysh i ri, në San Kristobal ose kur ishte komandant i rojave fshatare në fabrikën Boka Çika, katër a pesë orë i mjaftonin, edhe po të kishte pirë e të kishte harbuar deri në mëngjes. Aftësia për t'u ripërtërirë fizikisht vetëm me një pushim të shkurtër, e ndihmoi atë për të qenë mbi të tjerët. Po ajo kohë, iku. Tani zgjohej i lodhur dhe nuk mund të flinte më shumë se katër orë. Pothuajse pas dy-tri orësh gjumë hidhej përpjetë nga ëndrrat e liga.

Natën që shkoi ndenji zgjuar në errësirë. Nga dritarja shikonte kurorat e pemëve dhe një copë qielli plot me yje. Në natën e zbrazët, herë pas here, mbërrinte deri tek ai, dërdëllitjen e atyre plakave të pagjuma, që recitonin poezi të Huan de Dios Peza, Amado Nervos, Ruben Darios (kjo e bëri të dyshojë se midis tyre ndodhej edhe Lyrashi, që e dinte përmendsh Darion), "Njëzet poemat e dashurisë" të Pablo Nerudës dhe poezi tërëse të Huan Antonio Aliksit. Sigurisht, edhe vargjet e donja Maries, dëshmitare dhe moraliste domenikane. I erdhi për të qeshur, ndërsa po hypte në biçikletën statike. E shoqja kishte filluar ta merrte seriozisht atë punë dhe, herë pas here organizonte në sallën e patinazhit të Vilës Radames, mbrëmje letrare ku sillte recitues për të lexuar vargje pa vlerë. Senatori Henri Çirinos, i cili hiqej si poet, zakonisht merrte pjesë në ato rrethe, falë të cilave ushqente cirrozën e vet për llogari të buxhetit shtetëror. Për të fituar simpatinë e Marie Martinesit, ato plaka tuhafe, sikurse edhe vetë Çirinosi, kishin mësuar përmendsh faqe të tëra nga "Meditime morale" të saj ose fjalime nga "vepra" e saj teatrale "Miqësia e rreme". Si papagallë i recitonin dhe i duartrokisnin. Edhe e shoqja - ajo tyryfyçka plakë e dhjamur, Dama e Hijshme, mbi të gjitha ishte gruaja e tij - e kishte marrë seriozisht atë punën e shkrimtares moraliste. Pse jo?! A nuk e thoshin një zë të tillë gazetat, radiot, televizionit? A nuk ishte libër leximi i detyruar në shkolla "Me-

ditime morale", me një prolog të meksikanit Hose Vaskonselos, libër që shtypej çdo dy muaj? A nuk kishte qenë "Miqësia e rreme" suksesi më i madh teatral në tridhjetë e një vitet e Epokës së Truhijos? A nuk e kishin ngritur në qiell kritikët, profesorët universitarë, priftërinjtë, intelektualët? A nuk i kushtuan një seminar në Institutin Truhijonian? A nuk i kishin mburrur konceptet e saj veladonmëdhenjtë, peshkopët, korbat tradhtarë, ata judët, të cilët, pasi jetuan me paratë e tij, u kthyen tani, njësoj si jankitë, të flasin për të drejtat e njeriut? Dama e Hijshme, ishte shkrimtare dhe moraliste jo për meritë të saj, po falë atij, sikurse çdo gjë tjetër që ndodhte në këtë vend, këto tri dekada. Truhijo mund të bënte që ujët të kthehej në verë dhe buka të shumëfishohej, sa herë t'i donte trapi. Ia tha Maries në grindjen e fundit: "Harron se ato budallallëqe nuk i ke shkruar ti, që nuk di të shkruash as emrin tënd pa bërë gabime gramatikore, i shkroi ai galiciani tradhtar, Hose Almoina i paguar nga unë? Nuk e di çfarë thonë njerëzit? Që inicialet e "Miqësisë së rreme", M dhe R do të thonë: Marie Rrenacake. Pati një shpërthim tjetër të qeshure të gëzuar e të vërtetë. I qe larguar hidhësia. Maria kishte nisur të qante: "Pse, më poshtëron?!", dhe e kishte kërcënuar se do të ankohej te Mama Hulia. Sikur e mjerë e tij, me nëntëdhjetë e gjashtë vite në shpinë s'kishte punë tjetër, vetëm të merrej me grindjet familjare. Njësoj si vëllezërit e tij, edhe e shoqja i drejtohej Zonjës Madhështore me një shami lotësh në dorë. Për t'u pajtuar, iu desh t'i jepte përsëri ndonjë dhuratë. Ishin të vërteta ato që thoshnin nën zë domenikanët: Shkrimtarja dhe moralistja është fyçkë nga mendja dhe koprace nga shpirti. Ashtu kishte qenë edhe kur kishin qenë të dashur. Kur kishte qenë ende e re, ajo kishte bërë atë proçkën e lavanterisë së uniformave të Policisë Kombëtare Domenikane, me çka vuri paratë e para. Pedalimi ia nxehu trupin. Ndihej në formë tani. Pesëmbëdhjetë minuta. Mjafton. Edhe pesëmbëdhjetë të tjerë me rremat para se të fillonte beteja e ditës.

Aparati i rremave ishte në dhomën ngjitur, mbushur me makineri ushtrimesh. Filloi t'u jepte rremave, kur një hingëllimë e gjatë melodioze kali, si një himn gazmor për jetën, ia prishi qetësinë mëngjesore. Sa kohë kishte që nuk kishte hipur mbi kalë? Muaj. Kurrë nuk i ishte mërzitur. Edhe pas pesëdhjetë vjetëve, të kalëruarit, vazhdonte ta kënaqte një-

soj si gjerbja e një gote me konjak spanjoll “Karli I”, apo si vështrimi i parë mbi një trup femre të dëshiruar, e zhveshur, e bardhë, me forma të përsosura. Po ia helmoi atë ide kujtimi i vajzës hollake, të cilën, ai bir kurve, ia futi në shtrat. A thua e kishte bërë enkas, duke ditur ç’poshtërim do t’i ndodhte? Më vonë dhe ai të jetë shkulur së qeshuri! Mbase tani kjo gjë do të ketë marrë dhenë përmes gojëve të thashethemexhinjve nëpër kafenetë e El Kondes. U drodh nga turpi e tërbimi dhe u dha rremave me inat. Po djersinte. Pa mendo ta shihnin të djersitur! Një mit tjetër që përsëritnin për të ishte: “Udhëheqësi ynë Truhijo s’djersin kurrë. Në pisk të vapës mund të vishet me uniformën prej stofi, me kapelen trekëndëshe dhe me dorashka e të mos i shikosh pikë djersë në ballë”. S’djersinte po të mos donte. Por në intimitet, për shembull, kur bënte ushtrime, i jepte leje trupit të tij të djersinte. Këto kohët e fundit, të vështira, të ngarkuara me probleme, e kishte privuar veten nga kalërimi. Do të përpiqej nëse këtë javë do të mund të shkonte në San Kristobal. Do të kalëronte i vetmuar, poshtë pemëve, buzë lumit, si dikur, që të ndihej i rinuar. “As gjiri i bukur i një femre, s’është aq i ëmbël sa shpina e një dori.”
Ndjeu një ngrëç në krahun e majtë dhe i la rremat. Pasi u fshi, këqyri me kujdes veten tek e çara e pantallonave. Nuk kishte gjë. Vazhdonte errësira. Pemët e shkurrëzat e kopshteve të Vila Radames njanin si cajolla të errëta nën qiellin e pastër mbushur me dritëza përpëlitëse. Si ishte ai vargu i Nerudës që u pëlqente shumë mikeve papagalle të moralistes? Dhe dridhen, të bruztë, yjet së largu. Kurse ato plakushe dridheshin, duke ëndërruar ndonjë poet që u vinte pas oreksit. Po pranë kishin vetëm Çirinosin, atë biçim Frankeshtajni. Përsëri e mori një gaz i shtrirë, një kukurisje e hapur, gjë që rrallë i ndodhte kohët e fundit.
U zhvesh dhe me pandofla e rrobëdheshambër, u fut në banjë të rruhej. Ndezi radion. Tek “Zëri Domenikan” dhe “Radio Karaibe” lexonin gazetat. Para ca vitesh lajmet fillonin në pesë të mëngjesit. Por kur vëllai i tij, Petani, pronari i “Zërit Domenikan”, mësoi se ai ngrihej qysh në katër të mëngjesit, i filloi ato një orë më parë. Transmetuesit e tjerë bënë sikurse ai. E dinin që ai dëgjonte lajmet ndërsa rruhej, lahej dhe vishej, prandaj ishin të kujdesshëm.

"Zëri domenikan", pas një muzike reklame të Hotel Restorantit "El Conde", duke njoftuar për një mbrëmje vallëzimi me Kolosët e Ritmit, nën drejtimin e profesor Gatonit dhe këngëtarit Xhoni Ventura, shpalli se çmimin Hulia Molina-Vejusha Truhijo për nënën më pjellore, e kishte fituar donja Alejandrina Francisko, me njëzet e një fëmijë të gjallë. Ajo, me të marrë medaljen me portretin e Zonjës Madhështore kishte deklaruar: "Të njëzet e një fëmijët e mi do ta japin jetën për Bamirësin, po t'ua kërkojë". Nuk të besoj, moj dosë, tha nëpër dhëmbë.

Kishte larë dhëmbët dhe po rruhej me një makinë rroje vjetësirë, të cilën e kishte që kur ishte qenë një djalë tepër i varfër në San Kristobal. Në atë kohë nuk dinte nëse nëna e mjerë, së cilës tani i tërë vendi i bënte homazhe për Ditën e Nënave ("Burim ndjenjash bamirësie dhe nëna e burrit hero që po na qeveris", tha spikeri), do të kishte një dorë fasule apo oriz që t'u jepte për darkë tetë gojëve të familjes. Pastrimi, kujdesi për trupin dhe veshja, kishin qenë për të e vetmja fe që praktikonte me ndërgjegje.

Pas listës tjetër të vizitorëve në shtëpinë e Mama Hulias për t'i uruar Ditën e Nënave (e shkreta plakë, duke i pritur pa e dhënë veten tërë atë karvan shkollarësh, shoqërish, institutesh, sindikatash dhe duke i falënderuar me zërin e saj të humbur për lulet dhe urimet), filluan sulmet kundër peshkopëve Reji dhe Panal, "të cilët nuk kanë lindur nën diellin tonë, as kanë vuajtur nën hënën tonë ("Bukur", mendoi) dhe fusin hundët në jetën tonë shoqërore dhe politike, duke shkelur hapësirat ligjore". Xhoni Abesi donte të hynte në Kolegjin Santo Domingo dhe t'i nxirrte nga strehimi peshkopët janki. "Ç'mund të ndodhë, Shef? Gringot, sigurisht, do të protestojnë. Ka kohë që po protestojnë për çdo gjë. Për Galindesin, për pilotin Murfi, për Mirabalet, për atentatin e Betankurit e një mijë gjëra të tjera. Ç'rëndësi ka që lehin në Karakas, Porto Riko, Uashington, Nju Jork e Havana. E rëndësishme është çfarë ndodh këtu. Vetëm kur të tremben, veladonët do të pushojnë së kompllotuari." Jo. Ende s'ka ardhur çasti për t'u marrë me Rejin apo me atë tjetrin bir kurve, atë peshkopin spanjollush, Panalin. Do të vinte koha. Do t'ia paguanin. Atë nuk e gënjen te instinkti. Nuk do t'u prekim asnjë qime tani për tani, edhe pse vazhdojnë të më bezdisin, gjoja që e kanë filluar qysh të

dielën e 25 janar të vitit 1960 – po mbushet një vit e gjysmë – kur Karta Pastorale e Peshkopatës u lexua në tërë meshat, duke inauguruar fushatën e Kishës Katolike kundër regjimit. Të mallkuarit! Korbat! Eunukët! T'ia bënin këtë atij që ishte dekoruar në Vatikan, nga Papa Pio XII, me Kryqin e Madh të Urdhrit Papal të San Gregorios?! Te "Zëri domenikan", Paino Piçardo kujtonte me një fjalim të mbajtur flakë për flakë, me cilësinë e sekretarit të Shtetit të Punëve të Brendshme dhe Kulteve, se shteti kishte harxhuar gjashtëdhjetë milionë peso për atë Kishë, "peshkopët e së cilës i bëjnë tani aq dëm grigjës katolike domenikane". Ndërroi stacionin. Te "Radio Karaibet" lexonin një letër proteste të qindra punëtorëve, sepse nuk i kishin përfshirë firmat e tyre në Manifestin e Madh Kombëtar "kundër makinacioneve turbulluese të peshkopit Tomas Reji, tradhtar i Zotit dhe i Truhijos, peshkop, i cili duke qenë edhe prift edhe burrë, në vend që të qëndronte në dioqezën e tij në San Huan de la Maguana, ia kishte mbathur si një mi i trembur për t'u fshehur në Qytetin Truhijo, nën fustanit e murgeshave amerikane të Kolegjit Santo Domingo, folie terrorizmi dhe konspiracioni". Kur dëgjoi se Ministria e Edukimit ia kishte mohuar karakterin zyrtar Kolegjit Santo Domingo, për "komplotin e atyre murgeshave të huaja me intrigat terroriste të kardinalëve të San Huan de la Maguanas dhe atë të La Vegas kundër shtetit", u kthye përsëri te "Zëri domenikan". Folësi njoftonte për një tjetër fitore të ekipit domenikan të polos në Paris, ku "në kampin e bukur të Bagatejës, pasi kishte mundur Leopardët pesë me katër, kishte siguruar Kupën e Hapjes duke shkëlqyer në garën e përmendur". Ramfisi dhe Radamesi ishin lojtarët më të duartrokitur. Një gënjeshtër me bisht për t'i bërë qejfin domenikanët. Edhe atë vetë. Ndjeu në stomak athtësinë që i shkaktohej sa herë që i vinin në mendje të bijtë, më mirë dështimet e mëdha, zhgënjimet. Hëm, ngelën duke luajtur polo në Paris dhe duke harbuar me francezet, ndërsa babai i tyre po përjetonte betejat më të ashpra të jetës së tij.

Shpëlau fytyrën. I helmohej gjaku kur mendonte të bijtë. Zot i madh, po ç'faj kishte ai?! Raca e tij ishte e shëndoshë. Ai qe një hamshor riprodhues i fuqishëm. Ja ku ishin provat: Bij të tjerë, të ngjizur nga fara e tij në barqe të tjerë, ai i Lina Lovatoni, për të mos shkuar më larg, janë të fortë, energjikë, të cilët meritojnë një mijë herë të zënë vendin e këtyre dy bjerra-

ditësve, të këtyre hiçërve me emra personazhesh operash. Pse kishte pranuar që Dama e Hijshme t'u vinte bijve të tij emra nga "Aida", nga ajo opera që pa në një orë të keqe në Nju Jork? Prej atyre emrave u gatuan ashtu, si ata palaçot e operetave, në vend që të bëheshin burra gjoksleshë. Zuzarë, dembelë, pa karakter dhe pa ambicie, të zotët vetëm për zdërhallje. U ngjanë vëllezërve të tij, jo atij. Janë njerëz të kotë, njësoj si vëllezërit e tij: Negroja, Petani, Pipi, Anibali; një kategori kopukësh, parazitësh, përtacësh dhe horrash. Si nuk mori njëri prej tyre një të mijtën e energjisë, vullnetit dhe largpamësisë së tij?! Çfarë do të ndodhte me këtë vend kur ai të vdiste? Sigurisht që Ramfisi, ne si shtrat me femrat nuk ishte aq i zoti, sa i kishte dalë nami prej lajkatarëve. Kishte fjetur me Kim Novakun! Kishte vënë në shtrat Ca Ca Gaborën! Kishte vënë rëposh Debra Pagetin dhe gjysmën e Hollivudit! Eh, ç'meritë! Duke u dhuruar Mercedes-Benzed, Kadillakë e pellush kunadheje edhe i marri Valeriano do t'i shtinte në dorë Miss Universin dhe Elisabet Teilorin. Lumëmadhi Ramfis! Truhijo dyshonte se as gratë nuk e pëlqenin atë. Vetëm donte të dukej, të thonin për të se është ndërhyrësi më i mirë i këtij vendi, më i mirë edhe se Porfirio Rubirosa, domenikani i famshëm në botë për madhësinë e penit dhe për bëmat e tij prej kodoshi ndërkombëtar. Edhe ai, Përçitësi i Madh, luante polo me djemtë e tij atje në Bagatejë? Ama për Porfirion kishte simpati të madhe, që kur ky bënte pjesë në trupën e gardës së tij ushtarake. E ruajti atë ndjenjë edhe kur ai i ndau të bijën, Flor de Oro. Porfirio qe mashkull me shumë ambicie dhe kishte shtrirë në dorë femra të mëdha, që nga francezja Danielë Darië e deri te multimilionaria Barbara Huton, pa u dhuruar as një tufë lulesh, përkundrazi, duke i shtrydhur e duke u pasuruar në kurriz të tyre.

Mbushi vaskën me kripë aromatike dhe shkumë, pastaj u fundos në të me kënaqësi të madhe, siç bënte çdo mëngjes. Porfirio ia kishte kaluar gjithmonë mirë. Martesa e tij me Barbara Hutonin kishte zgjatur vetëm një muaj, sa për t'i zhvatur asaj një milion dollarë para të thata dhe pasuri të tjera. Ah, sikur të ishin edhe djemtë e mi si ai! Ishte një zog kurve që nuk i shterte kurrë ambicia. Dhe, si gjithë ngadhjimtarët, kishte armiq. Gjithnjë i kishin fryrë në vesh, duke e këshilluar që ta nxirrte Rubirosën nga karriera diplomatike, sepse skandalet e tij njollosnin imazhin e vendit. Ziliqarë. Kush më mirë

se një kopil si ai do të propagandonte për Republikën Domenikane? Kur ai ishte i martuar me Flor de Oro, e shtynin t'ia këpuste kokën pushtit mulat që i vinte rrotull së bijës duke e joshur. Po nuk e bëri. Ai i njihte mirë tradhtarët, i nuhaste para se ata ta tradhtonin. Prandaj ishte i gjallë ende, ndërsa tërë judëria kalbej në burgjet Kuarenta, Viktoria, në ishullin Beata, në stomakët e peshkaqenve ose majmnin krimbat e tokës domenikane. Eh, horrat Ramfis e Radames! Shyqyr që Angjelita, vajza e vogël, kishte diçka nga karakteri i tij dhe i qëndronte pranë.

Doli nga vaska dhe bëri një dush. Ndryshimi i ujit të ngrohtë me të ftohtin e gjallëroi. Tani po, ishte në formë. Ndërkohë që hidhte deodorant dhe pudrosej, i tërhoqi vëmendjen "Radio Karaibet", që po jepte idetë dhe udhëzimet e "agjentit të mallkuar", siç e quante ai Xhoni Abesin kur ishte në humor të mirë.

Folësi s'la gjë pa thënë kundër "miut të Mirafloresit", "plehut venezuelan", dhe, duke bërë zërin që duhej kur flitet për një homoseksual, theksonte se Presidenti Romulo Betankur, veç urisë, i kishte sjellë Venezuelës edhe fatkeqësi. A nuk shpërtheu një avion tjetër i Linjës Aeropostale Venezuelane që i kushtoi atij vendi gjashtëdhjetë e dy të vdekur? Po atij të krekosuri kësaj here nuk do t'i shkojë e tija. Prej tij OEA na vuri sanksione, por do të shohim kush do të qeshë i fundit. Asmiu i pallatit të Miraflores, as Munjos Marini, narkomani i Porto Rikos, as gangsteri kostarikas Figeres, nuk e shqetësonin. Kisha, po. Peroni e paralajmëroi, kur u nis nga Qyteti Truhijo drejt Spanjës: "Kujdes nga priftërinjtë, Gjeneralissimo. Nuk qe e majmura oligarki dhe as ushtarakët, ata që më rrëzuan, qenë veladonët. Ose merru vesh me ta, ose hiqi qafe njëherë e mirë". Atë nuk do ta rrëzonin. Do ta shqetësonin, sigurisht. Qysh prej asaj dite të zezë, 25 janari i vitit 1960, bënte plot një vit e katër muaj që nuk e kishin lënë një ditë pa i hapur probleme. Letra, kërkesa, mesha, nëntëditëshe, predikime. Çdo gjë që zuzarët me veladonë thonin e bënin kundër tij, përcillej jashtë vendit dhe gazetat, radiot e televizionit flisnin për rënien e shpejtë të Truhijos, tani që "kisha i ktheu shpinën".

Veshi mbathjet, këmishën dhe çorapët që Sinforosoja i kishte bërë gati sikaq dhe i kishte vendosur te rafti i rrobave, pranë varëses ku shquhej kostumi gri, këmisha e bardhë me

jakë dhe gravata blu me pika të kuqe që do t'i vishte atë mëngjes. Si po i kalonte ditët dhe netët peshkopi Reji në Kolegjin Santo Domingo? Duke palluar murgeshat? Ato shëmtaraqet. Disa nga ato kishin qime në fytyrë. I kishte parë kur Angjelita studionte në atë kolegji, kolegji i njerëzve të nderuar. Edhe të mbesat atje kishin mbaruar. Sa lajka i bënin ato murgesha, derisa erdhi Karta Pastorale. Ndoshta Xhoni Abesi kishte të drejtë, ishte ora për të vepruar. Me gjithë manifestimet, artikujt, protestat në radio e televizion, protestat e institucioneve dhe të Kongresit, ata nuk kishin vënë mend. Të goditeshin. E bëri vetë populli! Shpërtheu kordonin e rojave të vendosur atje për të mbrojtur peshkopët e huaj, u fut në Kolegjin Santo Domingo dhe në peshkopatën e La Vegas dhe i nxorri jashtë për flokësh gringon Reji dhe spanjollin Panal dhe i vrau. U hakmor për fyerje ndaj atdheut. Do t'i dërgonin ngushëllime dhe kërkesë Vatikani. Atit të Shenjtë Nuan Trupit – Balageri ishte një mjeshtër i vërtetë për të shkruar – dhe do t'u jepnin dënim shembullor fajtorëve që do t'i zgjidhnin mes kriminelëve të rëndomtë. A do të vinin mend korbat e zinj kur të shihnin kufomat e peshkopëve të copëtura nga zemërimi popullor? Jo, jo. Ende s'ishte çasti i duhur. S'duhej dhënë asnjë shkak që Kenedi t'u bënte qejfin Betankurit, Munjos Marinit dhe Figereasit, duke urdhëruar zbarkimin në ishull. Duhet ruajtur gjakftohtësia e duhej vepruar me kujdes, si një marins.

Por arsyeja nuk i bindte dot ndjenjat. Po vishej qorrasi. Zemërimi iu ngjit nëpër dejet dhe lumi i llavës ia pushtoi trurin, a thua po i pëlcitste. Me sytë mbyllur numëroi deri në dhjetë. Inati ishte i keq për qeverisje dhe për zemrën e tij, ia afronte infarktin. Një natë, në Shtëpinë me Mogan, tërbimi e çoi deri te të ndalurit e zemrës. Po qetësohej. Gjithmonë dinte ta kontrollonte veten kur ishte nevoja. Po ta donte puna, dinte të shtirej, të tregohej i përzemërt, i dashur me plehrat më të pështira njerëzore, me vejushat, me bijtë apo vëllezërit e tradhtarëve. Prandaj kishte pothuajse tridhjetë e dy vjet që mbante mbi shpatulla peshën e një vendi.

Po merrej me çorapët, duke i shtrirë e duke i lëmuar që të mos u mbetej asnjë rrudhë. Ah, ç'kënaqësi ishte ta lije të lirë zemërimin kur në nuk kishte rrezik për shtetin, vetëm ashtu mund t'u jepte atë që meritonin minjve, thithlopave, hijenave dhe gjarpërinjve. Stomakët e peshkaqenve ishin dëshmitarë

se nuk e kishte shmangur këtë kënaqësi. A nuk ndodhej atje në Meksikë kufoma e galicianit të pabesë Hose Almoina? Ajo e baskut Hesus de Galindes, i cili kafshonte dorën që e ushqente? E Ramon Marrero Aristit, i cili mendoi se, duke qenë shkrimtar i famshëm, mund t'i jepte informacion "The New York Times" kundër qeverisë që i paguante zdërhalljet, botimet dhe kurvat? Po tri motërzat Mirabal, të cilat hiqeshin komuniste dhe heroina, a nuk ishin atje, duke dëshmuar se po t'i hipnin atij xhindet, nuk kishte djall që ta mbante? Madje dhe Valeriano dhe Barahita, të marrët e El Kondes, mund ta besonin për këtë.

Mbeti me këpucën në dorë duke kujtuar këtë çift të famshëm. Një institucion i vërtetë në qytetin kolonial. Banonin nën dafinat e parkut Kolombi, midis harqeve të katedrales, dhe në orën e dyndjes së madhe, dukeshin te dyert e këpucarive elegante dhe argjendarive të El Kondes duke bërë numrat e tyre idiote, që njerëzit t'u hidhnin ndonjë monedhë apo diçka për të ngrënë. Ai i kishte parë shumë herë Valerianon dhe Barahitën, me harpat dhe stolitë e tyre të pavlera. Kur Valeriano bënte Krishtin, zvarriste një kryq, kur bënte Napoleonin, vringëllinte një bisht fshese, duke dhënë urdhëra me ulërima e duke u vërsulur mbi armikun. Një spiun i Xhoni Abesit, informoi se i marri Valeriano kishte përqeshur Shefin prej njëauajtur Trap. U bë kureshtar. Vajti për ta parë vetë djalin, duke e fshehur me xhama të errët. Plaku i çmendur, me gjoksin plot pasqyra, kaçole birre, etj, me pamjen e një palaçoje, krekosej duke treguar si medalje xhingla-minglat përpara një turme njerëzish, të cilët, të trembur, s'dinin ç'të bënin, të qeshnin apo t'ia mbathnin. "Duartrokisni për Trapin, ou trapër", bërtiste Barahita, duke treguar gjoksin rrëzëllitës të të marrit. Ato çaste ndjeu zjarrin t'i përvëlonte trupin, ndjeu tërbimin verbuas dhe rrëmbyes për ta ndëshkuar guximtarin. Dha urdhër menjëherë. Po, të nesërmen në mëngjes, kishte menduar se të marrët nuk dinin se ç'bënin, dhe në vend të dënonte Valerianon, duhej të vinte dorë mbi ata maskarenj që e kishin mësuar çiftin e budallenjve. Urdhëroi Xhoni Abesin atë mëngjes të errët, sikurse edhe ky sot: "Të marrët janë të marrë. Lëshoi." Shefi i Shërbimit Sekret Ushtarak ishte shtrembëruar në fytyrë duke i thënë: "Është vonë, Shkëlqesi. Ua hodhëm peshkaqenve qysh dje. Siç urdhëruat ju".

Ai u ngrit në këmbë, tashmë i veshur dhe i mbathur. Një burrë shteti nuk duhet të pendohet për vendimet e tij. Ai nuk ishte penduar kurrë për asgjë. Ata dy peshkopët do t'ua hidhte të gjallë peshkaqenve. Filloi të pastrohej, gjë që e bënte me kënaqësi të vërtetë çdo mëngjes, duke kujtuar të vetmin roman që kishte lexuar në rini dhe që e kishte gjithmonë rasysh: "Quo vadis?". Një histori romakësh e kristianësh, nga e cila kurrë nuk harroi imazhin e të pasurit elegant Petronio, Zot i sqimës, i cili rigjallërohej çdo mëngjes, falë masazheve dhe larjes, pomadave, esencave, parfumeve dhe përkëdheljeve të skllevërve të veta. Po të kishte kohë, do të bënte atë që bënte ky personazh, i cili çdo mëngjes u dorëzohej masazhistëve, pedikuristëve, manikyristëve, berberëve e banjatorëve, pastaj ushtrimeve për të gjallëruar muskulit dhe për të aktivizuar zemrën. Bënte një masazh të shkurtër në mesditë, pasi drekonte. Ndërsa të dielave, në qetësi të plotë dëfrente dy a tri orë me gjëra që i përthithnin energjitë. Po nuk ishin kohërat për t'u argëtuar me sensualitetet e Petronios së madh. Duhej kënaqur me këto dhjetë minuta, duke hedhur deodorant dhe parfumuar Yardley që ia dërgonte nga Nju Jorku Manuel Alfonzoja – i shkreti Manuel, kushedi si do t'i vazhdonte shëndeti pas operacionit – krem i lagësht Francez Bienfait du Matin për fytyrën dhe kolonjë, po ashtu yardley, me një aromë të lehtë, që i bënte të cilën fërkonte gjoksin. Kur po krehej dhe po rregullonte cepat e mustaqeve të vogla, që kishte njëzet vjet që i mbante, e pudrosi fytyrën më nge, derisa e fshehu nën një shtresë bardhoshe tepër të hollë atë zeshkanësi, të trashëguar nga paraardhësit e mamasë, negrit haitjanë. Gjithmonë e kishte përbuzur atë lëkurë të të tjerët dhe të të vjetra.

Në pesë pa pesë minuta ishte i veshur me xhaketë dhe kishte vënë gravatën. Provoi kënaqësi: Ishte i përpiktë në kohë. Ishte besëyt. Nëse nuk hynte në zyrë në pesë fiks, diçka e keqe do t'i ndodhte atë ditë.

U afrua te dritarja. Errësira vazhdonte si të ishte mesnatë. Veçse, yjet që ngjanin si të trembur, dukeshin më të rrallë se një orë më parë. Po afrohej dita dhe shpejt do të zhdukeshin. Kapi një bastun dhe u nis drejt derës. Me ta hapur, dëgjoi trokëllimën e takave të dy adjutantëve ushtarakë:

-Mirmëngjes, Shkëlqesi! - e përshëndetën në një gojë.
Iu përgjigj me një përkulje të lehtë koke. Me një vështrim i

kontrolloi nëse ishin të rregullt. Nuk lejonte pakujdesi e parregullsi tek asnjë oficer apo ushtar i thjeshtë i Forcave të Armatosura. Sidomos tek adjutantët, trupa e ngarkuar për ruajtjen e tij, një kopsë e rënë, një njollë apo rrudhë në uniformë, një kasketë e vënë keq, qenë gabime të rënda që ndëshkoheshin me disa ditë ndalimi dhe shpesh me heqje nga detyra dhe dërgim në batalionin e trupave ushtarake.

Një fllad i lehtë përkundte pemët e Vila Radamesit dhe ndërsa kalonte duke dëgjuar fërfërimën e gjetheve, nga stalla erdhi sërish hingëllima e një kali.

Punët e ditës: Informimi nga Xhoni Abesi mbi ecjen e fushatës, vizitë në Bazën Ajrore, në San Isidro, informim nga Çirinoja, drekë me marinsin, takim me Sekretarin e Shtetit për Punët e Brendshme dhe Kultet, takim me Balagerin, takim me Kuço Alvares Pina, president i Partisë Domenikane dhe shëtitje në Malekon, pasi të përshëndeste Mama Hulian. Do të shkonte të flinte në San Kristobal, për të hequr shijen e keqe të natës së kaluar?

Hyri në zyrën e vet, në Pallatin Kombëtar, kur ora e tij shënonte pesë. Mbi tryezën e punës ishte vendosur mëngjesi: lëng frutash, feta buke të thekur me gjalpë, kafe e ngrohtë. Dhe, duke u ngritur në këmbë vëren siluetën e dobët të drejtorit të Shërbimit Sekret, kolonel Xhoni Abesin që i thotë: - Mirmëngjes, Shkëlqesi!

III

-Nuk do të vijë, - thirri, menjëherë, Salvadori. - Tjetër natë e humbur, do ta shihni.
-Do të vijë, - iu kundërvu në çast me padurim Amaditoja. - Ka veshur uniformën ngjyrë ulliri. Adjutantët ushtarakë kanë marrë urdhër ta kenë gati Shevroletin e kaltër. Pse nuk më besoni? Do të vijë.
Salvadori dhe Amaditoja rrinin në vendet e prapme të automobilit të parkuar përballë Malekonit dhe kishin bërë të njëjtin debat nja dy herë gjatë gjysmë ore që qëndronin atje. Antonio Imberti në timon dhe Antonio de la Masa në krah të tij, me bërrylin e mbështetur në dritare, nuk thanë asgjë kësaj radhe. Të katër shikonin me ankth autoveturat e rralla të Qytetit Truhijo që kalonin përballë tyre, që vinin nga ana e San Kristobalit, duke shpuar errësirën me dritat e tyre të verdha. Asnjëra prej tyre nuk ishte Shevroleti i kaltër që prisnin, model i 1957-të, me perde në dritare. Ndodheshin disa qindra metra nga Panairi Blegtoral, ku kishte restorante të ndryshme - Poni, më popullori, ishte plot me njerëz që hanin mish të pjekur - dhe nja dy bare me muzikë. Era frynte drejt lindjes dhe zhurma nuk arrinte deri aty, edhe pse nga larg mes trungjeve dhe kurorave të palmave dukeshin dritat. Përkundrazi, zhurma e dallgëve që përplaseshin te shkëmbi dhe rënga e copëtimit të tyre ishin aq të forta, sa duhej ta ngrinin shumë zërin për ta dëgjuar njëri-tjetrin. Automobili, me dyert e mbyllura e dritat e shuara, ishte gati të nisej.
-Ju kujtohet kur u bë modë të shëtisje për t'u freskuar këtu në Malekon dhe ishte nevoja që ruheshe nga fuksat? - Antonio Imberti nxori kokën nga dritarja për të mbushur mushkëritë me flladin e mbrëmjes. - Këtu filluam të flisnim seriozisht për atë ndyrësirë.
Asnjë nga miqtë e tij nuk iu përgjigj menjëherë, si të konsultoheshin me kujtesën e tyre apo të mos i kishin kushtuar vëmendje për çka tha.

-Po, këtu në Malekon, ka nja gjashtë muaj, - tha Estreja Sadalai pas një nhope.

-Më përpara, - murmuriti Antonio de la Masa, pa e kthyer kokën. - Në nëntor, kur vranë Mirabalet, këtu e komentuan krimin. Për këtë jam i sigurt. U bë kohë prej atyre netëve këtu në Malekon.

-Dukej si një ëndërr, - ndërroi temë Imberti. - E vështirë, tepër e largët. Si ajo fantazia e një djaloshi për t'u bërë hero, eksplorues, artist kinemaje. Akoma s'më besohet se ai mund të kalojë këtu, e marrtë djalli!

-Po nëse nuk vjen? - u ankua Salvadori.

-Vë bast me çfarë të duash, Turko, - nguli këmbë Amaditoja. - Ajo që më bën të dyshoj është që sot është e martë, - hungëroi Antonio de la Masa. - Gjithmonë shkon në San Kristobal të mërkurave. Ti që je në trupën e rojave, e di më mirë se askush, Amadito. Pse e ndryshoi ditën?

-Nuk e di pse, - insistoi togeri. - Por do të vijë. Veshi uniformën ngjyrë ulliri. Dha urdhër për Shevroletin e kaltër. Do të vijë patjetër.

-Do të jetë ndonjë alamet pidhi ajo që po e pret në Shtëpinë me Mogan, - tha Antonio Imberti. - Ndonjë fringo, e virgjër.

-Nëse mundesh mos fol për punë pidhi, - ia preu Salvadori.

-Oh, më fal, gjithmonë harroj se jam përpara se jam përpara sikur kërkoi ndjesë shoferi. - Po sikur të shembet një goxha fundbarku që e pret atje në San Kristobal? Mund ta them kështu, Turko? Apo prapë i fyej veshët e tu apostolikë?

As të tjerët nuk kishin qejf për shaka. Edhe vetë Imberti. Fliste ashtu më shumë për të shmangur ankthin e pritjes.

-Kujdes! - gati klithi De la Masa, duke ngritur kokën.

-Është kamion, - tha Salvadori me një vështrim të shpejtë mbi dritat e verdhëreme që po afroheshin. - Nuk jam fanatik, as shenjt, Antonio. Jam një praktikant i fesë sime, asgjë më shumë. Dhe qysh nga Karta Pastorale e peshkopëve e 31 janarit të vitit të kaluar, jam krenar që jam katolik.

Vërtet ishte një kamion. Kaloi duke uturitur me një ngarkesë të lartë me arka të lidhura me litar. Uturima e tij erdhi duke u shuar, derisa u zhduk fare.

-Një katolik nuk mund të flasë për pidhin, ndërsa për vrasje po, ëë, Turko? - e ngacmoi prapë Imberti.

Ndodhte shpesh kështu, midis tyre. Antonio Imberti dhe Salvador Estreja Sadalai, ishin miqtë më të ngushtë në atë grup. Gjithmonë bënin shakara, ndonjëherë aq të rënda, sa ata që ndodheshin me ta, mendonin se do të kërciste grushti. Po nuk ishin grindur kurrë, vllazëria e tyre qe e pathyeshme. Veç këtë natë Turku nuk ishte në formë:

-Të vrasësh këdo, jo. Po të mbarosh punë me një tiran, po. E ke dëgjuar fjalën tiranicidio? Do të thotë tiranvrasës. Në raste ekstreme, Kisha e lejon. E ka shkruar Shën Tomas de Akuino. Do ta dish se nga e kam mësuar? Kur fillova të ndihmoj njerëzit e "14 Qershori" dhe e kuptova se duhet tërhequr këmbëza nganjëherë, një prift kanadez i Santiagos. Ai më siguroi një takim me timzot Lino Zanini, nunci i Shenjtërisë së Tij. Dhe e pyeta: "Do të ishte mëkat për një besimtar ta vriste Truhijo, imzot?" Mbylli sytë dhe u mendua. Nuk do t'i harroj fjalët e tij me theks italian. Më tregoi citatin e Shën Tomasit, te "Suma Teologica". Po të mos e kisha lexuar, nuk do të isha këtu me ju sonte.

Antonio de la Masa ishte kthyer dhe po e përpinte me sy:

-U këshillove për këtë gjë me atin tënd shpirtëror? - zëri i tij qe i hidhur.

Togeri Amado Garsia Gerrero pati frikë mos ndodhte ndonjë nga ato shpërthimet e papritura të tij, të njohura qysh nga koha kur Truhijo i kishte vrarë të vëllanë, Oktavion, vite të kaluara. Një shpërthim i tillë mund të prishte miqësinë që e lidhte me Salvador Estreja Sadalain. Po Salvadori e qetësoi:

-Ka shumë kohë, Antonio. Që kur fillova ta ndihmoj ata të "14 Qershorit". Më pandeh aq trap, sa t'ia besoj një prifti të mjerë një gjë të tillë?

-Të lutem, Turko, më shpjegto pse mund të thuash "trap", ndërsa fjalët: bythë, pidh, palloj, e kësi gjërash, jo, - bëri sërish shaka Imberti, duke u munduar të ftohte gjakrat. - A nuk e fyen Zotin çdo fjalë e padenjë?

-Zotin nuk e fyejnë fjalët, po mendimet e fëlliqura, - u pajtua Turku, duke lëshuar pe. - Trapat që pyesin për budallallëqe, mbase nuk e fyejnë. Për e mërzisin shumë.

-U kungove sot në mëngjes për të ardhur në ngjarjen e madhe me shpirt të qetë? - vazhdoi ta ngacmonte Imberti.

-Unë kam dhjetë vjet që kungohem çdo ditë, - tha Salvadori

serioz. - Nuk e di nëse kam shpirtin që duhet të ketë një kristian. Një Zot e di.

-E ke", mendoi Amaditoja. Ndër gjithë njerëzit që kishte njohur në tridhjetë e një vitet e jetës së vet, Turku ishte më i admirueshmi. Ishte martuar me Urani Mieses, një tezen e tij që e donte shumë. Që kur ishte kadet në Akademinë Ushtarake "Beteja e Karrierave", që kur e drejtonte koloneli Hose Leon Esteves (Peçito), burri i Angjelita Truhijos, e kishte bërë zakon t'i kalonte ditët e liridaljes në shtëpinë e Estreja Sadalajve. Salvadori qe bërë shumë i rëndësishëm në jetën e tij: Ia besonte atij hallet e veta, shqetësimet, ëndrrat, dyshimet e këshillohej me të para se të merrte çdo vendim. Estreja Sadalajt organizuan ceremoninë për të festuar gradimin e Amaditos me Shpatën e Nderit - i pari në tridhjetë e pesë oficerë të gradës së tij! - kur morën pjesë të njëmbëdhjetë tezet e tij. Një vit më vonë, togeri i ri do të merrte një lajm të tillë të mirë që kurrë s'do ta besonte: I ishte pranuar kërkesa për të hyrë në njësinë më të famshme të Forcave të Armatosura, ajo e adjutantëve ushtarakë, të ngarkuar me detyrën e rojave personale të Gjeneralissimit.

Amaditoja mbylli sytë dhe thithi ajrin e kripur që hynte nga të katër dritaret e hapura. Imbertin dhe De la Masën i kishte njohur në shtëpinë e rrugës Mahatma Gandhi dhe rastësia bëri që të ishte dëshmitar i zënkës midis Turkut dhe Antonios, një grindje aq e dhunshme, sa priste edhe ai vetë të goditej. Muaj më pas sërish u bë dëshmitar i pajtimit të tyre në emër të një qëllimi: Vrasjes së Çjapit. Kush mund t'i thoshte Amaditos atë ditë të vitit 1959, kur Urania dhe Salvadori i përgatitën atë festë, ku u pinë tërë ato shishe rum, se pas dy vjetësh, në këtë natë të ngrohtë e plot yje, të së martës së 30 majit të vitit 1961, do të kishte ikur duke pritur Truhijo për ta vrarë? Sa gjëra kishin ndryshuar qysh nga ajo ditë, kur të mbritur në shtëpinë e rrugës Mahatma Gandhi 21, Salvadori, me një pamje serioze, e mori për krahu dhe e çoi në cepin më të mënjanuar të kopshtit.

-Do të të them diçka, Amadito. Për dashurinë që kam për ty. Që e kemi të gjithë në këtë shtëpi.

Fliste me zë aq të ulët, sa Amaditoja zgjati kokën për ta dëgjuar.

-Pse ma thua këtë, Salvador?

-Sepse nuk dua ta dëmtoj karrierën tënde. Duke ardhur këtu, mund të kesh probleme.

-Çfarë problemesh?

Pamja e Turkut, zakonisht e qetë, u acarua. Një dritë alarmi shkëlqeu në sytë e tij.

-Unë bashkëpunoj me djemtë e "14 Qershorit". Po të na zbulojnë, do të jetë shumë e rrezikshme edhe për ty. Një oficer i trupës së rojave ushtarake të Truhijos. Si të duket?!

Togeri kurrë s'e kishte menduar që Salvadori të ishte një komplotist i fshehtë, që u ndihmonte njerëzve të organizuar për të luftuar kundër Truhijos, pas sulmit kastrist të 14 qershorit në Kostanca, Maimon dhe Estero Hondo, sulm që mori shumë jetë njerëzish. E dinte që Turku e urrente regjimin, edhe pse Salvadori me të shoqen ruheshin nga ai, nganjëherë u shpëtonte ndonjë shprehje kundër qeverisë. Heshtin pa pritur, ngaqë e dinin se Amaditoja, pavarësisht mosinteresit politik, sikurse çdo oficer tjetër ushtrie, ruante një besnikëri të verbër e të thellë ndaj Shefit të Madh, Bamirësit dhe Babait të Kombit të Ri, i cili për tri dekada po udhëhiqte fatet e Republikës, jetën dhe vdekjen e domenikanëve.

-Asnjë fjalë më shumë, Salvador. M'i the ç'duhej thënë dhe unë i dëgjova. Qysh tani i harrova të gjitha. S'më ke thënë asgjë dhe unë do të vazhdoj të vij këtu si gjithmonë. Kjo është shtëpia ime.

Salvadori e këqyri me atë vështrimin e tij të pastër, që Amaditos i transmetonte vetëm kënaqësitë për jetën.

-Shkojmë e kthejmë ndonjë birrë, atëherë. Të mos ma mbysë trishtimi.

Dhe sigurisht, pas teze Mekas – më e preferuara në mes njëmbëdhjetë tezeve – të parët njerëz që ia paraqiti të dashurës së vet, kur ra në dashuri dhe mendoi të martohej, qenë Salvadori dhe Urania. Luisita Hil! Kur e kujtonte, e dërrmonte brerja e ndërgjegjes dhe e pushtonte zemërimi. Nxori një cigare dhe e vuri në gojë. Salvadori ia ndezi me çakmakun e tij. Zeshkania e bukur, e këndshmja, lozonjarja Luisita Hil. Pas stërvitjes kishte shkuar me dy shokë për të bërë shetitje me një varkë me vela në La Romana. Në skelë, dy vajza po blinin peshk të freskët. Hynë në bisedë me to dhe shkuan së bashku të dëgjonin orkestrën e Bashkisë. Atë e ftuan në një dasmë. Vetëm Amaditoja mund të shkonte sepse e kishte ditën

të lirë, ndërsa shokët e tij duhej të kthehesin në repart. Ra në dashuri të marrë me atë zeshkanen shtathedhur e mendjemprehtë, me sy të ndritshëm, e cila vallëzonte si një artiste e "Zërit Domenikan". Edhe ajo me të. Në takimin e dytë, në kinema dhe në një disko, e përkëdheli dhe e puthi. Ishte femra e jetës së tij, kurrë nuk do të donte tjetër më. I hijshmi Amadito ua kishte thënë këto fjalë edhe shumë femrave të tjera, po këtë herë i tha me të gjithë mend. Luisa e ftoi në La Romana ta njihte me familjen e vet, ndërsa ai e ftoi të drekonin te teze Meka në Qytetin Truhijo, dhe një të diel tek Estreja Sadalajt, të cilët mbetën të kënaqur nga Luisa. Kur u tha se mendonte t'i kërkonte martesë, i dhanë zemër: Ishte vërtet një femrë e mrekullueshme. Amaditoja e kërkoi formalisht te prindërit e saj, i kërkoi autorizim komandës së adjutantëve ushtarakë për t'u martuar.

Ajo ishte përplasja e parë me një realitet, të cilin deri atëherë nuk e njihte fare edhe pse ishte njëzet e një vjeç, me një inteligjencë të shquar dhe me të dhëna të shkëlqyera kadeti dhe oficeri. ("Si shumica e domenikanëve", mendoi). Përgjigjia e kërkesës po vonohej. I thanë se komanda e tij do t'ia kalonte kërkesën SIM-it që të verifikonin se kush ishte ajo vajzë. Për një javë apo dhjetë ditë do të merrte përgjigjen e dëshiruar. Po përgjiggje nuk mori as për dhjetë ditë, as për pesëmbëdhjetë dhe as për njëzet. Ditën e njëzetenjëjtë, e thirri Shefi i tij. Qe hera e parë që këmbeu ca fjalë me Shefin, megjithatë ishte ndodhur shpeshherë pranë tij në veprimtari publike. Ishte hera e parë që ai burrë, të cilin e shikonte përditë, hodhi sytë mbi të.

Togeri Garsia Gerrero kishte dëgjuar qysh në fëmijëri në familjen e vet - veçmas gjyshin, gjeneralin Ermohenes Garsia - në shkollë e më vonë si kadet e oficer, të flitej për vështrimin e Truhijos. Një vështrim që askush nuk do t'i rezistonte dot pa ulur sytë i frikësuar. Rrezatonim një fuqi asgjësuese ato bebusha shpuese dhe të dukej se lexonin edhe mendimet më sekrete, dëshirat dhe joshjet më të fshehta, që e bënin njeriun të ndihej i zhveshur. Amaditoja qeshte me vete për tërë ato fjalë që endeshin poshtë e lart. Shefi ishte një burrë shteti i madh, largpamësia, vullneti dhe aftësia e të cilit e kishin bërë Republikën Domenikane një vend të madh. Por ai nuk ishte Perëndi. Vështrimi i tij është vështrimi i një të vdekshmi.

Ia doli të hynte në zyrë, të përplaste takat dhe të lajmëronte me zërin më ushtarak që mundi të nxirrte nga fyti i vet - "Nëntogeri Garsia Gerrero, sipas urdhërit Tuaj, Shkëlqesi! - për t'u ndier sa më i elektrizuar. "Afrohu", tha zëri i mprehtë i burrit, i cili, i ulur në skajin tjetër të dhomës, pas një tavoline të mbuluar me lëkurë të kuqe, shkruante diçka pa e ngritur kokën. Oficeri i ri bëri disa hapa përpara dhe qëndroi gatitu, pa lëvizur asnjë muskul, duke vërejtur flokët gri, midis asaj veshjeje të kujdesshme dhe pa të metë - xhaketë dhe xhup me ngjyrë blu. Në dotën e majtë vari re një unazë me gurë të çmuar me ngjyrat e ylberit, që sipas supersticiozëve ishte një hajmalie që tjetri e mbante qysh nga rinia, kur si anëtar i Gardës Kombëtare, ndiqte "keqbërësit", të cilët qenë ngritur kundër pushtimit amerikan. Thuhej se ia kishte dhënë një magjistar haitjan, duke e siguruar se nëse nuk do ta hiqte, do të ishte i paprekshëm nga armiqtë.

-Një vlerësim i mirë për shërbimin, toger, - tha tjetri.

-Shumë faleminderit, Shkëlqesi.

Koka e thinjur lëvizi dhe ata sy të mëdhenj, të fiksuar, pa shkëlqim dhe jo të gëzuar, kërkuan të tijët. "Unë nuk dija ç'ishte frika në jetë", i tregonte më pas djaloshi Salvadorit. "Derisa më ra ai vështrim përsipër, Turko. Po them të vërtetën. Ndryshe do të më gërrente ndërgjegjia". Për disa çaste të gjata, në qetësi, ai po i vlerësonte uniformën, rripat, kopsat, gravatën, kapelen. Amaditoja filloi të djersinte. E dinte se çregullimi më i vogël i veshjes, do t'i jepte Shefit një pakënaqësi të tillë që mund të shpërthente në qortime të dhunshme.

-Biografia jote, aq e pastër, nuk mund të njolloset duke u martuar me motrën e një komunisti. Në qeverinë time nuk bashkohen miqtë me armiqtë.

Fliste butë, gjithmonë me atë vështrimin shpues mbi të. Mendoi se në çdo çast do të shpërtente zëri i ashpër i tij.

-Vëllai i Luisa Hil është njëri prej anëtarëve të organizatës armiqësore "14 Qershori". E dije?

-Jo, Shkëlqesi.

-Tani e more vesh, - pastroi zërin dhe pa ndryshuar tonin, shtoi: - Ka vajza plot ky vend. Gjej një tjetër.

-Si urdhëron, Shkëlqesi!

E pa të bënte një shenjë pëlqimi, duke i dhënë të kuptonte ndërkohë se takimi kishte mbaruar.

-Më lejoni të largohem, Shkëlqesi!

Kërciti takat dhe përshëndeti. Doli me hap ushtarak, duke mbytur dëshpërimin që e helmoi. Një ushtarak u bindej urdhërave, mbi të gjitha atyre që vinin nga Bamirësi dhe Babai i Atdheut të Ri, i cili i kishte dhuruar disa minuta nga koha e tij, duke i folur personalisht. Që i kishte dhënë atë urdhër atij, oficerit të privilegjuar, kjo ishte për të mirën e tij. Duhej të bindej. E bëri, duke shtrënguar dhëmbët. Letra e tij dërguar Luisa Hilit nuk kishte fjalë që të mos ishte e vërtetë: "Me shumë mundim dhe duke dukur tërësisht të vërtetë: më shumë mundim dhe duke i thënë të vërtetën vëllait dorë nga dashuria ime për ty dhe më duhet të të lajmin e dhimbshëm se nuk mund të martohemi bashkë. Ma ndalojnë eprorët e mi, për shkak të aktivitetit antitruhijo të vëllait tënd, gjë që ma kishte fshehur. E tmerrshme sepse po pikërisht për këtë, shpresoj që edhe ti të kuptosh vendimin e vështirë që jam i detyruar të marr, kundër vullnetit tim. Edhe pse do të të kujtoj gjithmonë me dashuri, nuk mund të shihemi më. Dëshiroj për ty fat të mirë në jetë. Mos më urre."

Do ta ketë falur e bukura, e qeshura, bojallesha vajzë e La Romanas? Megjithëse nuk e pa më, kurrë nuk e zëvendësoi në zemrën e vet. Luisa qe martuar me një djalë të mbarë fshati në Porto Plata. Por nëse ajo kishte marrë një fjalë për shkëputjen, kurrë nuk do t'ia falte kurrë vetes. Edhe sikur brenda disa minutave, ta kishte të këmbyet e veta kufomën e Cjapit, të bërë shoshë nga plumbat – në ata sytë e ftohtë prej gjarpri donte t'ia shkrehte koburen – prapë s'do t'ia falte vetes çka kishte bërë. "Atë gjë të paktën, Luisa s'duhet ta marrë vesh kurrë." Jo vetëm ajo, po askush tjetër, qoftë edhe shokët e tij të pusisë.

Atë gjë e kishte mësuar vetëm Salvador Estreja Sadalai, në shtëpinë e të cilit, në Mahatma Gandhi 21, togeri Garsia Gerrero mbërriti atë mëngjes herët, i dërrmuar nga urrejtja, alkoli dhe dëshpërimi. Vinte drejt nga bordeli i Puça Vtinit, ndryshe Puça Brasovan, në pjesën e sipërme të rrugës Huana Saltitopa, ku e kishin çuar pas gradimit koloneli Xhoni Abesi dhe majori Roberto Figeroa Karrion, që me disa gota dhe me një femër të mirë, të harronte ato çaste të vështira.

"Çaste të vështira",

"sakrificë për Atdheun", "provë vullneti", "dhuratë gjaku për Udhëheqësin": kësi gjërash i kishin thënë. Pastaj e kishin uruar për gradimin e merituar. Amaditoja e thithi thellë cigaren dhe e flaku në rrugë: një fishekzjarr i vogël që shpërtheu në asfalt. "Në qoftë se nuk e heq me dorën tënde, do të qash," i tha vetes, i turpëruar nga ideja se mund ta shihnin duke dënesur Imberti, Antonioja dhe Salvadori. Do t'u shkonte mendja se qe frikacak. Shtrëngoi dhëmbët, derisa ndjeu dhimbje. Kurrë s'kishte qenë më i sigurt për gjë, si për këtë. Nëse Cjapi do të jetonte, ai nuk do të jetonte. Ai ishte vetë dëshpërimi që lindi, qysh nga ajo natë janari e vitit 1961, kur bota e tij u shemb dhe për të mos i futur vetes një plumb në gojë, vrapoi në Mahatma Gandhi 21 të gjente shpëtim te miqësia e Salvadorit. I tregoi gjithçka. Por jo menjëherë. Sepse, kur Turku hapi derën, i çuditur nga ato trokitje që e zgjuan nga gjumi atë, të shoqën dhe fëmijët qysh pa gëdhirë, e gjeti të pragu i derës të shpartalluar, të qelbej nga alkooli dhe që nuk ishte në gjendje të thoshte asnjë fjalë. Hapi krahët dhe e shtrëngoi fort Salvadorin. "Ç'ka ngjarë Amadito? Kush ka vdekur?" E çuan në dhomën e tyre dhe e shtrinë në shtrat. E lanë të shfrente, duke belbëzuar ca fjalë pa lidhje. Urani Miesesi i përgatiti një çaj dhe i dha ta pinte ca gllënjka me pahir, si të ishte fëmijë.

-Mos më thuaj asgjë që mund të pendohesh më vonë, - ia preu shkurt Turku.

Ishte i veshur me një kimono tërë ideograma dhe qe ulur në një cep të shtratit, duke vërejtur dhimbshëm Amaditon.

-Po të lë me Salvadorin, - tha teze Urania, duke u ngritur pasi e puthi në ballë. - Që të flisni më hapur me njëri-tjetrin e t'i thuash ndonjë gjë që mund të të vijë turp ta dëgjoj unë.

Amaditoja e falënderoi. Turku fiku dritën e mesit të dhomës. Mbulesa e qelqtë e abazhurit e përskuqte dritën që lëshonte llambushka me ca vizatime. Mjegull? Kafshë? Togerit mendoi se po të shpërthente zjarri, ai s'do të lëvizte dot.

-Fli, Amadito. Kur të jetë ditë, gjërat do të të duken më pak tragjike.

-Njësoj do të jetë, Turko. Natë e ditë do të më vijë ndot. Do të jetë më keq kur të jem esëll.

Filloi atë mesditë, në Shtabin e Përgjithshëm të Rojave Ushtarake, pranë Vilës Radames. Sapo qe kthyer nga Boka Çika, ku ndërmjetësi i Shefit të trupës së Shtatmadhorisë të Gjenera-

lisimi Truhijo, majori Roberto Figeroa Karrion, e kishte dërguar me një zarf që t'ia dorëzonte gjeneralit Ramfis Truhijo në Bazën e Forcave Ajrore Domenikane. Togeri hyri në zyrën e majorit për t'i raportuar lidhur me misionin e kryer dhe ky e priti me një shprehje dinake. I tregoi dosjen me kapak të kuq mbi tavolinë.

-E di çfarë ka aty?

-Një javë leje për të shkuar në plazh, majori im?

-Gradimi yt, toger i parë, djalosh! - tha shkurt dhe i qeshur shefi, duke i zgjatur dosjen.

-Mbeta me gojë hapur, sepse nuk më takonte, - Salvadori e dëgjonte pa lëvizur. - Duheshin edhe tetë muaj për të kërkuar gradim. Mendova: "Një çmim ngushëllimi për çështjen e ndarjes nga e fejuara."

Salvadori nga fundi i shtratit prishi fytyrën, s'i erdhi mirë.

-Vërtet nuk e more me mend, Amadito? Shokët e tu, eprorët e tu, nuk të kishin folur për prova besnikërie?

-Kisha menduar se ishin thashetheme, - mohoi Amaditoja me bindje dhe zemërim. - Të betohem. Njerëzit nuk mund të mburren me këto gjëra. U ndodha i papërgatitur.

Ishte vërtet kështu, Amadito? Një gënjeshtër më shumë, një gënjeshtër mëshiruese më shumë në atë botë gënjeshtrash, ku ishte zhytur jeta e tij që kur hyri në Akademinë Ushtarake. Më mirë thuaj që kur lindi, se kishte lindur sa kishte filluar Koha e Madhe. Sigurisht, që duhet ta kishte ditur, të kishte dyshuar; sigurisht që në Fortesën e San Pedro de Makoris dhe pastaj mes rojave ushtarake, duhet ta kishte dëgjuar, ta kisha marrë me mend, ta kishte zbuluar, nisur edhe nga qyfyret, pispillosjet, tepritë, mburrjet; ishte e qartë se të privilegjuarit, të zgjedhurit, oficerët, të cilëve do t'u besoheshin vende me përgjegjësi të madhe, i kishin dhënë prova besnikërie Truhijos, para se të gradoheshin. E dije shumë mirë se ajo praktikë ekzistonte. Por tani togeri i dytë Garsia Gerrero e dinte po ashtu se kurrë s'dëshironte ta mësonte me hollësi se çdo të thoshte ajo provë. Majori Figeroa Karrion i shtrëngoi dorën dhe i tha diçka që s'donte ta besonte kur e dëgjoi.

-Do të bësh karrierë të madhe, djalosh.

E urdhëroi që të shkonte ta vizitonte në shtëpinë e vet në orën tetë të darkës. Do të shkonin të hidhnin ndonjë gotë për të festuar gradimin e tij dhe të bënin ndonjë formalitet.

-Merre Xhipin, - i tha majori dhe e përshëndeti.

Në tetë fiks, Amaditoja u ndodh te shtëpia e shefit. Ky nuk e futi në shtëpi. Duhet ta kishte përgatitur nga dritarja, sepse, para se të mbërrinte Amaditoja, kishte dalë te porta. Hipi në Xhip me një të hedhur dhe pa ia kthyer përshëndetjen togerit, e urdhëroi me një ton të natyrshëm, të shtirë:

-Në Kuarenta, Amadito!

-Në burg, majori im?

-Po, në Kuarenta, - përsëriti togeri. - Atje ishte duke na pritur dhe ti e di se kush, Turko.

-Xhoni Abesi, - murmuriti Salvadori.

-Koloneli Abes Garsia, - plotësoi me ironi të shurdhër Amaditoja. - Shefi i SIM-it.

-Je i sigurt se duhet të ma tregosh këtë, Amadito? - djaloshi ndjeu dorën e Salvadorit mbi gjurin e vet. - Mos do të më urresh më vonë që edhe unë e di këtë gjë?

Amaditoja e njihte nga larg. E kishte parë duke rrëshqitur si hije nëpër korridoret e Pallatit Kombëtar, duke zbritur nga Kadillaku i zi, i blinduar apo duke hipur në të në kopshtet e Vilës Radames, duke hyrë apo duke dalë nga zyra e Shefit, gjë që, me sa dukej, aq lehtë e bënte vetëm ai, Xhoni Abesi. (Askush tjetër, në tërë vendin, s'mund të shkonte për takim në çdo orë të ditës apo të natës në Pallatin Kombëtar apo në rezidencën private të Bamirësit dhe ai ta priste menjëherë). E kishte parë dhe, si shumë shokë të tij të Ushtrisë, Marinës apo Aviacionit, kishte ndier një rrëqethje të fshehtë trazimi, para asaj siluete të flashkët e të futur keq në atë uniformë koloneli. Që një mohim i pamjes, shkathtësisë, gjestit ushtarak, burrërisë, fortësisë dhe elegancës, që duhet të karakterizonin ushtarakët siç thoshte Shefi, sa herë që fliste para ushtarëve në Festën Kombëtare apo në atë të Forcave të Armatosura. E kishte parë atë fytyrë peshkaraqe prej meiti, me ca mustaqe të shkurtuara sipas mënyrës Arturo de Kordova apo Karlos Lopez Moktesuma, aktorët meksikanë më në modë, dhe me një gushë si lafshë kaposhi të tredhur që i varej mbi gjoks të futur. Edhe pse e thonin vetëm në rrethe tepër intime dhe pasi të kishin hedhur disa gota rumi, oficerët e urrenin kolonelin Xhoni Abes Garsia, sepse ai nuk ishte ushtarak i vërtetë. Ai nuk i kishte fituar shiritat dhe yjet si ata, duke studiuar, duke kaluar nëpër akademi dhe kazerma, duke djersitur për

të kapërcyer shkallët hierarkike. Sigurisht, e kishte paguar me shërbime të ndyra për të përligjur emërimin e vet si shef i plotfuqishëm i Shërbimit Sekret Ushtarak. Dhe dyshonin tek ai për bëma të errëta: Zhdukje, ekzekutime, fatkeqësi të papritura njerëzish të shtresave të larta – si ajo më e fundit, e senatorit Agustin Kabral – spiunime të tmerrshme, besimvrasje dhe shpifje në faqen "Forumi Publik" që dukej çdo mëngjes te gazeta "Karaibet", faqe që i mbante njerëzit në tension, sepse ajo që thuhej atje për ta, përcaktonte fatin e tyre. Për intriga dhe veprime të poshtra kundër njerëzve të denjë politikë, qytetarë paqësorë, të cilët, për ndonjë arsye kishin rënë në rrjetën e ngatërruar ta spiunllëkut që Xhoni Abesi dhe ushtria e panumërt e kalecëve të tij kishte shtrirë kudo në shoqërinë domenikane. Shumë oficerë, midis tyre togeri Garsia Gerrero, ndienin përbuzje thellë vetes për këtë njeri, megjithë besimin që i kishte dhënë atij Gjeneralissimi. Shumë njerëz në qeveri, me sa dukej, edhe vetë Ramfis Truhijo, mendonin se koloneli Abes Garsia, me ushtrinë e tij mizore, diskreditonte regjimin dhe u jepte të drejtë kritikëve të tij. Megjithatë, Amaditoja kujtonte një diskutim ku shefi i tij më i afërt, majori Figeroa Karrion, menjëherë pas një dreke të tepruar me birrë, midis një grupi rojash ushtarake, e mori në mbrojtje: "Koloneli mund të jetë një demon, por i shërben Shefit tonë. Çdo e keqe i ngjitet atij, që një qeveri të qëndrojë tridhjetë vjet, është nevoja që një Xhoni Abesi t'i futë duart nëpër qenra. Që të marrë përsipër urrejtjen e armiqve e, nganjëherë dhe të miqve. Shefi e di, ndaj e mban pranë. Nëse koloneli s'do t'ia ruante shpatullat, kush e di se s'do t'i ndodhte ajo që i ndodhi Peres Jimenes në Venezuelë, Batistas në Kubë dhe Peronit në Argjentinë?"

-Mirëmëngjes, toger.

-Mirëmëngjes, koloneli im.

Amaditoja e ngriti dorën te kapelja dhe e nderoi ushtarakisht, po Abes Garsia i shtrëngoi dorën – një dorë e butë si sfungjer dhe e lagët nga djersa – dhe i rrahu shpatullat.

-Kaloni këtej.

Pranë vendrojes, ku shtrëngoheshin gjysmë duzine rojash për të kaluar portën e hekurt të hyrjes, ishte një dhomë e vogël, me një tavolinë dhe dy karrige, që shërbente si zyrë administrative. E ndriçonte keq vetëm një llambë elektrike që

lëkundej në fund të një kordoni të gjatë plot me miza. Rreth llambës zukaste një re insetkesh. Koloneli mbylli derën u tregoi karriget. Hyri një roje me një shishe me Johnny Walker me etiketë të kuqe ("Marka që preferoj, nga emri Huanito Udhëtari, adashi im", bëri shaka koloneli), gota, një kovë me akull dhe disa gota me ujë mineral. Ndërsa shërbente pijen, koloneli i fliste Togeri, sikur majori Figeroa Karrion të mos ishte atje.

-Urime për gradën e re. Dhe për atë shërbimi. E njoh shumë mirë. SIM-i rekomandoi gradimin tënd. Për meritat e tua ushtarake dhe qytetare. Po ju tregoj një sekret. Ju jeni një nga oficerët e rrallë që ju mohua leja për martesë dhe që u bindët menjëherë. Prandaj vetë Shefi jua shpërbleu, duke përshpejtuar gradimin. Hajde, një gotë me Huanito Udhëtarin!

Amaditoja e ktheu me fund. Koloneli Abes Garsia e kishte mbushur gotën me uiski dhe i kishte hedhur edhe pak ujë.

-Në atë shoqëri, në atë vend, me Xhoni Abesin, duke pirë dhe s'e more me mend çfarë do të vinte më vonë? - pëshpëriti Salvadori.

Djaloshi dalloi hidhërimin në fjalët e mikut të vet.

-Që do të ishte e ashpër dhe e shëmtuar, po, Turko, - u përgjigj butë. - Por kurrë atë që do të ndodhte.

Koloneli ua mbushi sërish gotat. Të tre po tymosnin cigare dhe shefi i SIM-it foli se sa e rëndësishme ishte të mos e lije ta ngrinte kokën armiku i brendshëm, t'ia shtypje sa herë që ai tentonte ta ngrinte.

-Në qoftë se Armiku i brendshëm është i dobët dhe i përçarë, nuk ka rëndësi se çfarë bën armiku i jashtëm. Që SHBA bërtet, që OEA hedh vickla, që Venezuela dhe Kosta Rika lehin, kjo nuk na bën përshtypje. Më mirë, sepse ashtu do të bashkohemi si grusht rreth Udhëheqësit tonë.

Fliste me një zë të zvargur dhe nuk i shikonte bashkëbiseduesit në sy. Sytë e tij të vockël, të errët, të shpejtë, bishtnues, ishin gjithmonë në lëvizje dhe i shihnin fshehtas të tjerët. Herë pas here fshinte djersët me një shami të madhe të kuqe.

-Mbi të gjitha, ushtarakët, - bëri një pauzë për të shkundur hirin e cigares. - Pra, mbi të gjitha, ajka e ushtarakëve, toger Garsia Gerrero, së cilës ju i përkisni tani. Vetë Udhëheqësi do ta marrë vesh këtë gjë.

Bëri prapë pushim, piu një gotë ujë e gjerbi një gllënjkë uiski.

Vetëm atëherë pa se ekzistonte edhe majori Figeroa Karrion:

-E di togeri se çfarë pret Shefi prej tij?

-Nuk është nevoja t'ia thotë askush. Është oficeri më me mend në rangun e vet, - majori kishte fytyrë thithlope dhe tiparet e tij të ënjtura spikatnin edhe më duke u skuqur nga alkoli. Amaditoja iu krijua përshtypja se dialogu qe një provë komedie. - E marr me mend se e di, po qo se jo, nuk e meriton këtë gradë të re.

U bë një pauzë tjetër, ndërsa koloneli po mbushte të dyja gotat për herë të tretë. Hodhi me dorë copat e akullit dhe pasi tha "Gëzuar!", e ktheu. Edhe ata i kthyen. Amaditoja mendoi se një mijë herë më mirë rrehej me Coca-cola se ky uiski aq i hidhur. Në atë çast e kuptoi shakanë në lidhje me emrin Huanito Udhëtari. "Sa i trashë që s'e kisha marrë vesh", mendoi. Sa e çuditshme kjo shamia e kuqe e kolonelit! Kishte parë shami të bardha, të kaltra, gri. Po, të kuqe?! Hajde, ç'teka!

-Ju do të keni përherë përgjegjësi më të madhe, - tha koloneli me një pamje solemne. - Shefi do të jetë i sigurt se ndodheni në lartësinë e duhur.

-Ç'duhet të bëj, koloneli im? - Amaditoja nuk i honepste hyrjet. - Gjithmonë kam plotësuar urdhërat e eprorevë të mi. Kurrë nuk do ta zhgënjej Shefin tonë. Bëhet fjalë për ndonjë provë besnikërie?

Koloneli, kokëulur, shikonte tavolinën. Kur ngriti kokën, togeri dalloi një ndriçim kënaqësie në sytë e tij tinzarë.

-Është e vërtetë, oficerëve me koqe, truhijistë deri në palcë, nuk mund t'ia ëmbëlsosh pilulën, - u ngrit në këmbë. - Ke të drejtë, toger. Le t'i lëmë këto. Të festojmë gradimin e ri te Puça Brasovani.

-Po çfarë duhet të bëjë? - Salvadori fliste i sforcuar, me fytin të tharë dhe një shprehje frike në fytyrë.

-Të vrisja një tradhtar me duart e mia. Ashtu më tha: "Pa t'u dridhur duart, toger".

Kur dolën në oborrin e Kuarentas, Amaditoja ndjeu t'i gjëmonin tëmthat. Pranë një peme bambuje, në anë të një shtëpie të kthyer në burg dhe qendër torturash të SIM-it, afër Xhipit me të cilin kishin ardhur, ishte një Xhip tjetër, i njejtë, me drita të fikura. Në ndenjësen prapa, dy roja ushtarake të armatosur ruanin një tip me duar të lidhura dhe me një peshqir futur në gojë e lidhur për koke.

-Eja me mua, toger, - tha Xhoni Abesi, duke u ulur në timonin e Xhipit ku qenë rojat. - Ndiqna, Roberto.

Me të dalë makinat nga burgu dhe sa morën rrugën gjatë bregut, ia bëhu një stuhi dhe nata u mbyt në gjëmime e vetëtima. Rrebeshi i bëri qull.

-Më mirë që bie shi, megjithëse do të lagemi, - tha koloneli. - Do të na freskojë. Fshatarët janë të dëshiruar për një çikë shi.

Nuk i kujtohej sa zgjati rruga, po s'duhej të kishte qenë e gjatë, përkundrazi, ngaqë kujtonte se kur hynë në bordelin e Puça Vtinit, pasi lanë Xhipin në rrugën Huana Satlipota, ora e murit në sallonin e hyrjes ishte dhjetë e natës. Qysh kur mori majorin Figeroa Karrion nga shtëpia e tij, kishin kaluar më pak se dy orë. Abes Garsia doli nga rruga dhe Xhipi u hodh përpjetë, si të donte të zbërthehej nëpër fushën me bar të gjatë e tërë popla. Ndiqte Xhipin e majorit, dritat e të cilit e orientonin. Ishte errësirë, po togeri kuptoi që ecnin paralelisht me detin, sepse gumëzhima e dallgëve po i hynte në vesh. Ju duk se përvijonin portin e vogël La Kaleta. Sapo u ndal Xhipi, shiu pushoi. Koloneli zbriti me një të hedhur dhe Amaditoja e imitoi. Të dy rojat ishin mësuar, pra, pa pritur urdhër, e zbritën me të shtyra të burgosurin. Në dritën e një vetëtime togeri pa se i lidhuri ishte zbathur. Tërë rrugës kishte qenë fare i heshtur, por me të shkelur në tokë, duke e marrë me mend se çdo t'i bënin, filloi të përpiqej, të gulçonte, duke u munduar të çlironte duart dhe gojën. Amaditoja, i cili deri atëherë e kishte shmangur vështrimin prej tij, vuri re përpëlitjet e ethshme të kokës së tjetrit, duke dashur të lironte gojën për të thënë diçka, ndoshta të lutej që t'u vinte keq për të, ndoshta dhe t'i mallkonte. "Po të nxjerr koburen dhe t'ia fus kolonelit, majorit dhe rojave dhe ta lë të ikë?", mendoi.

-Në vend të një, do të ishin dy të pushkatuar, - tha Salvadori.

-Desh Zoti shiu pushoi, - u ankua majori Figeroa Karrion, duke zbritur. - U bëra qull, dreqi ta hajë.

-E ke armën me vete? - pyeti koloneli Abes Garsia. - Mos e lër të vuajë më të shkretin.

Amaditoja bëri po me kokë pa thënë asnjë fjalë. U çapit deri afër të burgosurit. Ushtarët e lanë atë dhe u shmangën. I lidhuri nuk ia dha vrapit sikurse mendoi Amaditoja. Nuk i bindeshin këmbët mbase, ose frika e mbante të lidhur nëpër shkurret dhe baltën e asaj fushe, ku era shkonte me vërtik e kuje. Por,

edhe pse nuk tentoi të ikte, vazhdonte të lëviste kokën me dëshpërim, nga e djathta në të majtë e nga lart poshtë, një përpjekje të kotë për të çliruar gojën. Nxirrte një si hungërrimë të këputur. Togeri Garsia Gerrero i vuri grykën e pistoletës në tëmth dhe qëlloi. E shtëna e shurdhoi dhe mbylli sytë një çast.

-Jepi fund, - tha Abes Garsia. - Nuk i dihet.

Amaditoja, duke u përkulur, preku kokën e të shtririt – ishte i qetë e i pagojë – pastaj shtiu përsëri, nga afër, mbi të.

-Tani po, - tha koloneli, duke e kapur për krahu e duke e tërhequr drejt Xhipit të majorit.

- Rojat e dinë vetë se ç'duhet bërë. Shkojmë te Puçita, të ngrohim trupin.

Në Xhipin që e ngiste Robertoja, togeri Garsia Gerrero rrinte i heshtur, duke dëgjuar përgjysmë bisedën midis kolonelit dhe majorit. I kujtohej që thanë:

-Do ta groposin atje?

-Do ta hedhin në det, - shpjegoi shefi i SIM-it. - Këtë të mirë ka kjo harcë se është e lartë, e prerë si me thikë. Poshtë ka një hyrje deti me thellësi të madhe, si një ngjillë. Është plot me peshkaqenë që presin. Do ta gëlltisin në sekondë. Nuk lënë asnjë gjurmë. Pra: E sigurt, shpejt dhe pastër.

-E mban mend atë shkëmb? - pyeti Salvadori.

Jo. Vetëm kujtonte se para se të mbërrinin, kishin kaluar pranë atij gjirit të vogël, La Kaleta. Por nuk mund ta bënin tërë rrugën që nga Kuarentas.

-Do të të jap një ilaç për gjumë, - Salvadori i vuri përsëri dorën mbi gju. - Që të flesh shtatë-tetë orë.

-Akoma s'kam mbaruar, Turko. Ki pak durim. Që të më pështysh në fytyrë dhe të më shporrësh nga shtëpia.

Kishin qenë në bordelin e Puça Vtinit, ose ndryshe Puçita Brasovan, një shtëpi e vjetër me ballkone dhe me një kopsht të tharë, një bordel i frekuentuar nga kalecët, njerëz të lidhur me qeverinë dhe SIM-in. Si flitej, për këtë punonte edhe ajo plakushja e përfolur dhe simpatike, Puça, e ngjitur në hierarkinë e profesionit të vet deri në administratore dhe drejtore e prostitutave, pasi kishte punuar edhe vetë si prostitutë e suksesshme në bordelet e rrugës "Dy" qysh kur ishte shumë e re. I priti te porta dhe i përshëndeti si miq të vjetër Xhoni Abesin dhe majorin Figeroa Karrion. Amaditos i përkëdheli mjekrën: "Ç'bukurosh!" U priu deri në katin e dytë dhe i uli në një tavolinë pranë barit.

Xhoni Abesi kërkoi t'i sillte Huanito Udhëtari.

-Më vonë e kuptova se ishte uiski, koloneli im, - tha Amaditoja. - Johnny Walker. Huanito Udhëtari. Shumë e thjeshtë dhe mezi e kapa.

-Ky është më i mirë se psikiatrët, - tha koloneli. - Pa Huanito Udhëtari, unë s'do ta mbaja dot ekuilibrin mendor, gjeja më të rëndësishme në punën time. Për ta kryer mirë, duhet të jesh i qetë, gjakftohtë, me koqet akull. Të mos përziesh kurrë emocionet me arsyen.

Nuk kishte klientë, përveç një tullaci me syze që ishte ulur te banaku duke pirë një birrë. Në një cep i binin një muzike bolero dhe Amaditoja njohu zërin e trashë të Tonja la Negras. Majori Figeroa Karrion u ngrit dhe mori për të kërcyer njërën nga femrat që çuçurisnin në një qoshe, poshtë një plakati të një filmi meksikan me Libertad Lamarke dhe Tito Gisar.

-Ju keni nerva tepër të forta, - tha koloneli Abes Garsia. - Jo të gjithë oficerët janë kështu. Kam parë shumë trima, që në çaste kritike, e humbasin. I kam parë të pëgëren nga frika. Sepse, megjithëse askush nuk beson, për të vrarë duhen koqe më të mëdha se për të vdekur.

Mbushi gotat dhe tha: "Gëzuar!". Amaditoja piu me lakmi. Sa gota? Tri, pesë, pastaj humbi nocionin e kohës dhe të vendit. Veç të pirit, kërceu me një indiane, të cilën e përkëdheli dhe e futi në një dhomë të ndriçuar nga një llambë e mbuluar me celofan të kuq, që varej mbi një shtrat me një jorgan plot ngjyra të ndezura. Nuk mund t'i bënte gjë. "Ngaqë jam tapë, moj shpirtkë", dhe i kërkoi falje. Arsyeja e vërtetë qe pesha përvëluese që kishte në gjoks. Nuk i ikte nga mendja ajo që kishte bërë. Më në fund mori guximin t'u thoshte kolonelit dhe majorit se donte të ikte ngaqë ndihej i këputur nga tërë ato gota.

Dolën të tre deri te porta. Atje ishte Kadillaku i zi i blinduar e me shoferin, duke pritur Xhoni Abesin dhe një Xhip me shpurën e rojave të armatosura. Koloneli i dha dorën.

-Nuk je kureshtar të dish cili ishte ai?

-Preferoj të mos e di, koloneli im.

Fytyra e squllët e Abes Garsias u shtendos nga një buzëqeshje ironike, ndërsa fshinte fytyrën me shaminë e tij ngjyrë flake.

-Sa mirë do të ishte që njeriu t'i bënte këto gjëra, pa ditur se

për kë është fjala. Mos u mërzit, toger. Po u fute në ujë, do të lagesh. Ishte njëri prej atyre të "14 Qershorit", më duket vëllai i ish-të fejuarës tënde. Luisa Hil, ë? Mirë, mirë, do të shihemi shpejt besoj, kemi gjëra për të bërë së bashku. Po të kesh nevojë, ti e di ku të më gjesh.

Togeri ndjeu përsëri dorën e Turkut mbi gju.

-Është gënjeshtar, Amadito, - deshi t'i jap zemër Salvadori. - Duhet të ketë qenë tjetër. Të ka gënjyer. Për të të shkatërruar fare, që të ndiheshe më i kompromentuar, më skllav. Harroje ç'të ka thënë. Harroje çfarë ke bërë.

Amaditoja pranoi. Ngadalë tregoi revolverin e futur në një këllëf në brezin e vet.

-Herën tjetër, do të qëlloj për të vrarë Truhijon, Turko, - tha. - Ti dhe Toni Imberti mund të mbështeteni tek unë për çdo gjë. Këtej e tutje s'është nevoja të ruheni nga unë kur të vij në këtë shtëpi.

-Kujdes, kujdes, ja po vjen, - tha Antonio de la Masa, duke ngritur grykën e pistoletës në lartësinë e dritares, gati për të qelluar.

Amaditoja dhe Estreja Sadalai, po ashtu, bënë gati armët. Antonio Imberti ndezi motorin. Por automobili që vinte gja të Malekonit drejt tyre, duke rrëshqitur ngadalë, ishte duke kërkuar dikë. Nuk ishte Chevrolet, ishte një Volkswagen. Kur i pa ata, frenoi dhe u kthye në drejtim të tyre, derisa u afrua ku rrinin ata. U ndal pranë tyre dhe fiku dritat.

IV

-Nuk do të ngjiteni ta shikoni? - thotë më në fund infermierja.

Urania e di se ajo pyetje përpiqej të dilte nga buzët e kësaj gruaje qysh kur ajo hyri në shtëpi, në Qezar Nikolas Penson, dhe në vend t'i kërkonte ta çonte në dhomën e zotit Kabral, u drejtua në kuzhinë dhe përgatiti një kafe. Kishte gati dhjetë minuta që po gjerbte dhe shijonte kafenë.

-Në fillim do të mbaroj së ngrëni mëngjesin, - u përgjigj pa buzëqeshur, ndërsa infermierja uli vështrimin e hutuar. - Po marr forca për të ngjitur ato shkallë.

-E di që ka pasur një ftohje midis jush, diçka kam dëgjuar, - u tërhoq gruaja, pa ditur ç'të bënte me duart. - Vetëm sa pyeta. Zotërisë ia kam dhënë mëngjesin dhe e kam rruajtur. Gjithmonë zgjohet herët.

Urania ulet. Tani është e qetë dhe e sigurt. Vëzhgon edhe një herë shkatërrimin që e rrethon. Veç prishjes së pikturave të murit, syprinës së tavolinës, lavatriçes, gjithçka duket e shkapërderdhur dhe e bërë lëmsh. Ishin po këto mobilje? Asgjë nuk kujtonte dot.

-Vjen ndonjë ta vizitojë? Nga të familjes, dua të them.

-Të bijat e zonjës Adelina, zonja Lusinda dhe zonja Manolita vijnë gjithmonë në këtë kohë, - gruaja e gjatë, e shkuar në moshë, me pantallona poshtë uniformës së bardhë, duke qëndruar në prag të kuzhinës, nuk e fsheh sikletin e vet. - Halla juaj vinte përditë më përpara. Por që kur theu kockën e legenit, nuk del më.

Hallë Adelina ishte shumë më e vogël se babai i saj, duhet të ishte nja shtatëdhjetë e pesë vjeçe, jo më. Paska thyer legenin. Vazhdon të jetë tepër fanatike? Ishte nga ato të kungimit të përditshëm, atëherë.

-Në dhomën e tij është? - Urania mbaroi së piri kafenë. - Mirë, kudo që të jetë. Jo, jo, mos më shoqëro.

Ngjit shkallët me dërrasën e cngjyrosur të parmakut ku

mungonin vazot e dikurshme me lule që ajo i kujtonte gjithmonë. Ka ndenjen se shtëpia është rrënuar. Kur ngjitet në katin e sipërm, vë re që pllakat janë të ciflosura dhe disa madje të çkollosura. Kjo ishte një shtëpi moderne, e lëvduar, e mobiluar me shije. Tani ka marrë rrokullimën, është një mjerim në krahasim me rezidencat dhe shtëpitë e mëdha që para pak më parë në Bella Vista. Ndalet te dera e parë – kjo ishte dhoma e tij – dhe, para se të hyjë, godet me kyçin e gishtit disa herë.

E lëbyr një dritë e fortë që hyn nga dritarja e hapur kanatësh. Shkëlqimi e verbon për disa sekonda, pastaj ecën përgjatë shtratit të mbuluar me një jorgan gri. Ja, komoja e vjetër me pasqyrën e saj vezake, fotografitë në mure – a do ta gjente fotografinë e saj të Harvardit? – dhe sheh në fund në kolltukut e vjetër të veshur me lëkurë dhe me krahëpushore të gjera, i ati, i zhytur në pizhamat dhe pantoflat e kaltra. Duket sikur ka humbur në atë kolltuk. Është rrëgjuar dhe tkurrur, njësoj si shtëpia. I tërheq vëmendjen një objekt i bardhë të këmbët e të atit: Një uturak i mbushur përgjysmë me urinë.

Dikur flokët e tij qenë të zeza, përjashto ca thinja elegante në tëmtha. Tani kaçurelat e rralla në tullën e tij janë të zverdhura, të pista. Sytë e tij, dikur të mëdhenj, të sigurt në vetvete, zot të botës (kur ndodhej pranë Shefit), tani janë dy hulliza që po e shikojnë ngultash, të veckël, si të një harabeli të trembur. Dikur kishte dhëmbë, tani jo. Ia kishin hequr dhëmbët e vënë (ajo e kishte paguar faturën, ka vite), prandaj i ka buzët të fundosura dhe faqet e futura gati takohen me njëra-tjetrën. Këmbët e varura mezi takojnë sheshin. Për të parë se kush erdhi, ai duhej të ngrinte kokën e të zgjaste qafën. Tani, në qoftë se ai do të ngrihej në këmbë, do t'i arrinte deri te supi.

-Jam Urania, - murmuriti, duke iu afruar. U ul mbi shtrat, ndonjë metër nga i ati. - Të kujtohet që ke një vajzë?

Te plakushi ka një shqetësim të brendshëm, lëvizje duarsh eshtake, të zbehta, me gishtat të hollë që prehen mbi gjunjë. Sytë e veckël, dhe pse s'ndahen nga Urania, nuk shprehin gjë.

-Edhe unë nuk të njoh, - pëshpërit Urania. - Nuk e di pse erdha dhe ç'bëj këtu.

Plaku fillon të lëvizë kokën nga lart poshtë e nga poshtë lart. Prej fytit të tij del një si ofshamë e ashpër, e gjatë, e këputur, si një këngë e përzishme. Por, për pak çaste qetësohet, me sytë gjithmonë të ngulur mbi të.

-Shtëpia dikur ishte plot me libra. - Urania vështron muret e zhveshura. - Ç'është bërë me ta? Tani nuk mund të lexosh. E qartë. Po atëherë kishe kohë për të lexuar? Nuk më kujtohet të të kem parë duke lexuar, kurrë. Ishe njeri tepër i zënë. Ashtu siç jam unë sot, po aq e zënë, në mos më shumë se ti në atë kohë. Dhjetë, dymbëdhjetë orë në tavolinën e punës apo duke vizituar klientë. Por e gjej kohën herë pas here duke vizituar çdo ditë. Në mëngjes shumë herët rri duke vrojtuar agimin midis qiellgërvishtësve të Manhattanit, ose natën vonë, duke përgjuar dritat e atyre blloqeve prej qelqi. Më pëlqen shumë kjo gjë. Të dielave lexoj tri apo katër orë, pas "Meet the Press", në televizor. Kam përfituar nga beqaria, baba. Nuk e dije? Jot bijë ka mbetur pa martuar. Ti do thoshe: "Ç'dështim i madh! Nuk u gjet dot burrë për ty?". Jo, baba. Më mirë të them, nuk desha. Pata kërkesa: Në universitet, në Bankën Botërore, në punë. Madje së shpejti do të duket një pretendent tjetër. Me dyzet e nëntë vite në kurriz! Po nuk është e tmerrshme të jesh beqare e vonuar. E shfrytëzoj kohën duke lexuar, në vend që t'ia kushtoj burrit dhe fëmijëve.

Duket se ai kupton dhe i përqendruar nuk guxon të lëvizë asnjë muskul por të mos e ndërpresë. Qëndron si i ngrirë, me gjoksin e vogël që i ulet e ngrihet ngadalë dhe me sytë të ngulur mbi buzët e saj. Në rrugë, herë pas here kalon ndonjë makinë, dëgjohen hapa, zëra, copëra bisedash që afrohen, ngjiten, ulen e humbasin larg.

-Apartamenti im në Manhattan është plot me libra, - vazhdon Urania. - Si kjo shtëpi, kur isha e vogël. Libra për drejtësi, ekonomi, histori. Por në dhomën time të gjumit, ka vetëm libra domenikanë. Dëshmi, ese, kujtime dhe shumë libra historie. E merr me mend se të kujt kohe? Të kohës së Truhijos, të kujt tjetër. Më e rëndësishmja në pesëqind vjetët e fundit. Kështu do të thoshe me bindje të plotë. E kam të qartë, baba. Në ato tridhjetë e një vjet u kristalizua gjithë e keqja që na ka ndjekur qysh nga kolonizimi. Në ndonjë nga ata libra je edhe ti, si personazh: Sekretar Shteti, Senator, Kryetar i Partisë Domenikane. E çfarë nuk ishe, baba. Jam bërë një eksperte e Truhijos. Në vend të luaj brixh, golf, të ngas kuajt apo të shkoj në opera, hobby im u bë të di ç'ka ndodhur në ato vite. Sa keq që nuk mund të bisedojmë. Sa gjëra do të më sqaroje, sa gjëra do të më tregoje, ti që jetove krah për krah me Shefin tënd të dashur, i cili ta shpërbleu aq

poshtërisht besnikërinë tënde. Fjala vjen, doja të dija nëse Shkëlqesia e Tij ka fjetur me mamanë time.

Vëren një lëvizje frike te plaku. Trupi i tij i dobët, i përhumbur, gati u hodh përpjetë në kolltuk. Urania zgjat kokën për ta parë. Mos është ndonjë shenjë e kotë? Duket sikur e dëgjon, sikur bën përpjekje për të kuptuar çfarë thotë ajo.

-E lejove? U nënshtrove? Të përfitoje në karrierën tënde?

Urania merr frymë thellë. Vëzhgon dhomën. Ja, dy fotografi në një kornizë argjendi mbi komodinë. Ajo e kungimit të saj të parë, vitin që i vdiq e ëma. Ndoshta iku nga kjo botë me vegimin e së bijës mbështjellë në tylin e bardhë, me asnjë veshje të zgjedhur dhe me atë shikim ëngjëllor. Fotografia tjetër është e së ëmës: E re, me flokë të zinj të ndarë në mes, me vetulla të hequra, me sy melankolikë dhe ëndërrues. Është një foto e zverdhur, pak e rrudhur. Afrohet te komodina, e merr, e çon te buzët dhe e puth...

...Dëgjon një automobil të frenojë te porta e shtëpisë. Zemra i hidhet përpjetë. Pa lëvizur nga vendi, vë re përmes perdeve, kromin e shndritshëm të karrocerisë që shkëlqen dhe pasqyrimet e vetëtimës të autoveturës luksoze. Nden drita, zilen që bie dy-tri herë dhe – e hipnotizuar, e tmerruar, pa lëvizur – dëgjon shërbyesen që hap portën. Në këmbë, te shkallët, bëhet një dialog i shkurtër që s'merr vesh. Zemra, si e çmendur, kërkon t'i shpërthejë. Trokitje të kokë dhe me një diania e re, vajza e shërbimit, me skufjen në kokë dhe me një shprehje frike në fytyrë, duket te porta e hapur përgjysmë:

-Kanë ardhur për vizitë Presidenti, zonjë. Gjeneralisimi, zonjë!

-I thoni se më vjen keq, po nuk mund ta pres. I thoni se zonja Kabral nuk pret vizita, kur Agustini nuk është në shtëpi. Kështu i thoni...

Hapat e shëbyeses largohen të ndrojtura, të pavendosura, nëpër shkallët me parmak plot vazo të ndezura me lulerratkat. Urania e vë fotografinë e së ëmës mbi komodinë dhe ulet përsëri në cepin e shtratit. I humbur në kolltuk, i ati e shikon i alarmuar.

-Ashtu veproi Shefi me sekretarin e Edukimit në fillim të qeverisjes së tij, ti e di shumë mirë, baba. Me dijetarin e ri, elegantin dhe gjenialin, don Pedro Henrikes Urenja. Shkoi të vizitonte gruan e tij, ndërsa ai ishte në punë. Dhe ajo pati guximin

t'i thoshte se s'priste vizita, kur i shoqi nuk ndodhej në shtëpi. Në fillimet e "Epokës së Tij", ende ishte e mundur që një grua mund të mos e priste Shefin. Kur ajo i tregoi, don Pedro dha dorëheqjen, iku dhe kurrë nuk shkeli më në këtë ishull. Falë asaj ikjeje, u bë i famshëm si profesor, historian, kritik dhe filolog në Meksikë, Argjentinë dhe Spanjë. Përpjekja e Shefit për t'i shtrirë në dorë të shoqen, qe fat për të. Atëherë, në fillim, një ministër mund të jepte dorëheqjen dhe s'pësonte ndonjë "aksident", nuk binte në ndonjë humnerë, nuk i ngulte thikën ndonjë "i çmendur", nuk e hanin peshkaqenët. Si të duket, bëri mirë? Ai veprim e shpëtoi të bëhej si ti, baba. Do të kishte bërë të njëjtën gjë apo do të qëndroje në anën tjetër? Si miku yt i mirë dhe i urryer, kolegu yt i dashur dhe i neveritshëm, don Froilani, fqinji ynë. Të kujtohet, baba?

Plakushi fillon të dridhet dhe të ankohet me një ofshamë si këngë makabre. Urania pret që të qetësohet. Don Froilani? Vinte ta takonte disa herë në ditë të atin dhe pëshpëriste me të në sallon, në terracë, apo në kopsht. Kjo ndodhte në kohën kur ishin aleatë në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, lufte në të cilat luftëtarët e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste, luftonin aleatët në luftërat e brendshme të tarafeve truhijiste. Në atë kohë, don Froilani jetonte në atë shtëpinë gjysmëduzinë me pëllumba. Urania afrohet te dritarja. Nuk ka ndryshuar shumë shtëpia e atij zotërie të fuqishëm, i cili qe ministër, senator, intendent, kancelar, ambasador dhe çdo gjë që mund të ishte në ato vite. Vetë Sekretar Shteti në maj të vitit 1961, kur ndodhën ngjarjet e mëdha.

Shtëpia ka ende fasadën të lyer gri e të bardhë, po gjithashtu, duket se është zvogëluar. I kanë shtuar një strehë nja katër pesë metra, të mbështetur, që stonon me portikun e dalë në formë trekëndëshi, ku ajo pasditeve, sa herë kthehej nga kolegji, shikonte shpesh figurën e bukur të gruas së don Froilanit. Me ta parë, ajo i thërriste: "Urania, Uranitka! Eja këtu, më lër të të shoh, moj zemër. Ç'yjk ke, moj vogëlushe! Je e bukur si jot ëmë, Uranitka". I përkëdhelte flokët me duart e saj të bukura, me thonjtë e lyer me manikyrë të kuqe të ndezur. Urania ndiente një kënaqësi gjumëndjellëse, kur ata gishta i futeshin nëpër flokët e saj dhe i përkëdhelnin bu-

tësisht kokën. Eugenia? Laura? Kishte emër luleje? Manjola? I është fshirë nga kujtesa. Por jo fytyra e saj, lëkura borë e bardhë, sytë mëndafsh të butë, silueta prej mbretëreshe. Gjithmonë vishej si për festë. Urania e donte për ëmbëlsinë e saj, për dhuratat, ngaqë e çonte në "Country Club" të lahej në pishinë dhe, mbi të gjitha, se kishte qenë mike e mamasë së saj. Përfytyronte se, po të mos ndodhej në qiell, mamaja do të ishte po aq e bukur dhe madhështore, sa gruaja e don Froilanit. Ai, përkundrazi, nuk ishte aspak i pamshëm. I shkurtër, tullac, mollopup. Asnjë grua nuk do t'ia hidhte sytë. Kishte mbyllur sytë nga nxitimi apo u martua për interes me të?

Kështu pyeste veten e çuditshur, tek hapte kutinë e çokollatave me një letër metalike që zonja sapo ia kishte dhënë, bashkë me një të puthur në faqe, pasi kishte dalë nga porta e shtëpisë së saj. E kishte thirrur: "Uranitka! Eja, kam një surprizë për ty, o shpirti im!", ndërsa vajza zbriste nga kamioçina e kolegjit. Urania hyni në shtëpi, puth zonjën simpatike - mbante një fustan të hollë, të kaltërem, këpucë me taka; e rregulluar si për një vallëzim, me varëse me perla dhe byzylyk në duar - hap pakon me letër fantazie, lidhur me një shirit të kuq. Shikon e kënaqur çokollatat e mbështjella bukur, e papërmbajtur për t'i provuar, por nuk guxon, se "do të ishte mungesë edukate", kur një autoveturë luksoze ndalet në rrugë, pranë shtëpisë. Zonja bën një kërcim të çuditshëm, papritur, siç bëjnë kuajt kur dëgjojnë një urdhër misterioz. Është zbehur dhe zëri i saj shpreh ngut: "Duhet të ikësh". Dora e saj mbi supet e vajzës, nervozohet, e shtrëngon, e shtyn të ikë. Kur ajo, e bindur, merr çantën e vet të librave dhe niset të ikë, porta hapet kanatësh: Silueta e nxituar e një zotnie veshur në një kostum të errët, me mansheta të bardha të kollarisura dhe me butonë ari, të dala nga mëngët e xhaketës, i pret rrugën. Një zotni që mban syze të errëta dhe që ndodhet kudo, përfshirë edhe kujtesën e saj. Mbetet e paralizuar, gojëhapur, me vështrimin të ngulur mbi të. Shkëlqesi e Tij i hedh një buzëqeshje qetësuese.

-Kush është kjo?

-Uranitka, vajza e Agustin Kabralit, - përgjigjet zonja e shtëpisë. - Tani po ikën.

Dhe Urania ikën, pa përshëndetur nga tronditja. Kapërcen rrugën, hyn në shtëpinë e saj, ngjit shkallët, hyn në dhomën e

vet dhe vëzhgon nga perdja, duke pritur e duke pritur që Shefi të dalë nga shtëpia përballë.

-dhe jot bijë ishte aq naive, sa nuk mori vesh pse Babai i Kombit vinte atje, kur don Froilani nuk ndodhej në shtëpi, - i ati tani i qetësuar, e dëgjon o bën sikur e dëgjon, pa ia ndarë sytë. - Aq naive sa, kur erdhe nga Kongresi, vrapova të të tregoja: "Kam parë Presidentin, babi! Erdhi të vizitonte gruan e don Froilanit, babi! Si të iku fytyra! Sikur befas t'i kishin dhënë lajmin e vdekjes së të dashurit, sikur befas t'i kishin treguar diagnozën e vet të kancerit, po shtrëngohej, po vurxosej e po nxihej, duke kaluar sytë herë pas here mbi fytyrën e vajzës së tij të vogël. Si t'ia shpjegonte? Si ta alarmonte për rrezikun që po i kanosej familjes?

Sytë e babait duan të mbyllen, si për t'u menduar.

-Dëgjo, bijëza ime. Ka gjëra që mund t'i dish, që ende nuk mund t'i kuptosh. Jam unë ai që mendoj për ty, që të mbroj. Je njeriu më i dashur në botë për mua. Mos më pyet pse, por duhet ta harrosh çfarë më tregove. Nuk qe në shtëpinë e Froilanit. Nuk e ke parë gruan e tij. Dhe kurrë atë që t'u duk sikur e pe. Për të mirën tënde, bija ime. Edhe për të mirën time. Mos e përsërit më, mos e kujto më. Më premton? Askujt. Më betohesh?

-T'u betova, - thotë Urania. - Por as që më shkoi mendja për keq. As kur kërcënove shërbëtorët se, nëse do të përsërisnin trillimet e fëmijës, do të humbisnin punën. Ashtu isha, e padallëzuar. Pastaj zbulova se Henrike Urenja, nëse Gjeneralisimi vizitonte gratë e tyre, ishin të detyruar të pranonin t'u viheshin brirët, si don Froilani. Dhe meqë s'kishin ç'bënin, të paktën të përfitonin diçka. E bëre ti? E vizitoi Shefi mamanë time? Para se të lindja unë? Apo kur isha shumë e vogël dhe unë s'mund ta kujtoj? Ai e bënte këtë me gratë e bukura. Mamaja ime ishte e bukur. Apo jo? Unë nuk mbaj mend të ketë ardhur, po mund të ketë ardhur më përpara. Ç'bëri mamaja ime? U nënshtrua? U gëzua, ishte krenare që preferohej prej tij? Ishte normë e kohës kjo gjë, vërtet? Domenikanet e mira e falënderonin nëse Shefi do të denjonte t'i pallonte. Të duket vulgaritet? Por kjo qe folja që përdorte vetë Shefi yt i dashur.

Po, kjo folje. Urania e di mirë. E ka lexuar në materialet e shumta të bibliotekës së saj mbi Epokën. Truhijo, aq i kujdes-

shëm, i mprehtë, elegant në të folur – një yshtës i vërtetë gjarprinish kur propozonte – shumë lehtë, netëve, pas kupave të konjakut spanjoll "Karlos I", mund të përdorte fjalët më vulgare, të fliste si flitet në turnet e natës, në anijet e rëndomta, si flitet midis dokerëve të portit mbi lumin Ozama, në stadiume apo në bordelo, të fliste siç flasin burrat kur duan të duken më meshkuj se ç'janë. Kishte raste që Shefi të ishte barbarisht vulgar dhe të përsëriste fjalët nydra nga më të neveritshmet, si rini, kur ishte kryeshërbëtor pronash në San Kristobal apo roje nate. Kurtizanët e tij e përgëzonin për ato fjalë, me të njëjtin entuziazëm, si për fjalimet e tij të shkruara nga senatori Kabral dhe Kushtetucionalisti Sarhosh. Arrinte të mburrej për "femrat që kishte palluar", gjë për të cilën kurtizanët e përgëzonin edhe kur mund të mësonin se donja Marie Martinesin, Damën e Hijshme, edhe kur ato femra mund të ishin gratë, nënat apo motrat e tyre. Nuk ishte një tepri e fantazisë domenikane të ethshme dhe të pakufi, për të shtuar virtytet dhe veset dhe për të fuqizuar anekdotat e vërteta, derisa t'i bënin fantastike. Kishte historira të sajuara, të shtuara, të ngjyrosura nga prirja e bujshme e bashkatdhetarëve të tij. Por ajo e Barahonas duhej të ishte e vërtetë. Atë Urania nuk e ka lexuar, ia ka dëgjuar (duke i ardhur të përzier), të treguar nga dikush që kishte qenë dëshmitar me sy, shumë afër Bamirësit.

> -Kushtetucionalisti Sarhosh, baba, apo senatori Henri Çirinos, juda që të tradhtoi. Nga goja e tij e kam dëgjuar. Çuditshme që jam takuar me të? Isha e dërguar, si funksionare e Bankës Botërore. Drejtori kërkoi që ta përfaqësoja në atë takim me ambasadorin tonë. Me ambasadorin e Presidentit Balager. Çirinosi e bëri më mirë se ti, baba. Të shmangu nga rruga, kurrë nuk pësoi gjë nga Truhijo dhe në fund ndërroi ngjyrën dhe u rehatua në demokraci, edhe pse kishte qenë po aq truhijist sa ti. Ishte atje, në Uashington, më i shëmtuar se kurrë, i fryrë si një thithlopë, duke pritur të ftuarit e duke u dendur si sfunxher me pije. Duke i kënaqur bashkëbiseduesit me anekdota mbi Kohën e Truhijos. Ai!

Invalidi ka mbyllur sytë. Mos e zuri gjumi? Ka mbështetur kokën në shpinën e karriges, me gojën e rrudhosur, të hapur e të zbrazët. Duket më thatim e më delikat ashtu, nga rrobëdëshambri i hapur, dallohet një gjoks i vogël pa qime,

me lëkurë të zbardhur, ku shquhen mirë kockat. Merr frymë me ritme të njëjta. Urania tani vë re se ai është pa çorape. Qafat e këmbëve dhe kycet i ka si të një fëmije.

Çirinosi nuk e kishte njohur. Si mund ta imagjinonte se ajo funksionare e Bankës Botërore, e cila ia transmentonte në frëngjisht përshëndetjen e drejtorit, ishte bija e kolegut dhe bashkëpunëtorit të tij të vjetër, inteligjent Kabralit? Urania u kujdes të mbante distancë nga ambasadori pas përshëndetjes protokollare, duke këmbyer biseda të rëndomta me njerëz të tjerë që ndodheshin atje, sikurse dhe ajo, të detyruar nga detyra e tyre. Dikur bëhet gati të ikë. Kalon pranë grupit që po dëgjon ambasadorin e demokracisë, por kur dëgjon se çfarë tregon ai, mban këmbët. Lëkurë e butë e puçrruar, gojë prej shtaze të damllosur, gushë e trefishtë, bark bualli, gati t'i shpërthejë kostumi blu me jelek, po, blu, nën të cilin është mbërthyer një gravatë e kuqe. Ambasadori Çirinos rrëfente se diçka që kishte ndodhur në Barahona, në kohën e fundit, kur Truhijo, në njërën nga ato krekosjet e tij të zakonshme, shpalli se ai, për të dhënë shembull dhe për të gjallëruar demokracinë, do të tërhiqej nga qeveria (kishte vendosur si President vëllanë dhe bashkëpunëtorin e vet, Hektor Bienvenidon, i ashtuquajturi Negro) dhe nuk do të kandidonte më për President, veç për ndonjë qeverisje province të mënjanuar. Dhe si kandidat i opozitës!

Ambasadori i demokracisë gulçon, merr frymë dhe me sytë, shumë pranë njëri-tjetrit, përgjon ndikimin e fjalëve të veta. "E kuptoni, zotërinj", ironizon ai: "Qesh dhe vazhdon duke shpjeguar pikërisht në regjimin e tij!" Qesh dhe vazhdon duke shpjeguar se në atë fushatë elektorale, don Froilan Arala, njëri nga krahët e djathtë të Gjeneralisimit, mbajti një fjalë duke e këshilluar Shefin të paraqiste kandidaturën jo si guvernator, por të vazhdonte të qëndronte në zemër të popullit domenikan: President i Republikës. Të gjithë besuan se don Froilan ndiqte udhëzimet e Shefit. Po nuk ishte ashtu. Të paktën atë natë nuk ishte ashtu – ambasadori Çirinos piu gllënjkën e fundit të uiskit me një shkëlqim djallëzor në sy. - pasi kishte ndodhur edhe që don Froilani kishte bërë atë që i kishte urdhëruar Shefi dhe ky i fundit të ndërronte opinion dhe të vendoste ta mbante edhe ca ditë më shumë farsën. Këtë e bënin shpesh edhe pse bëheshin qesharakë në sytë e bashkëpunëtorëve

të tyre më të talentuar. Koka e don Froilanit nuk shkëlqente vetëm nga brirët e bukur që i vinte e shoqja, por edhe nga mendja e djallëzuar. Shefi e ndëshkoi për atë fjalim panegjerik, duke e goditur aty ku i dhimbte më shumë: Te nderi i tij prej mashkulli.

Gjithë ajka e shoqërisë vendase u ndodh një lekë në pritjen që u bë për Shefin nga drejtuesi i Partisë Domenikane të Barahonas. Shefi, shumë i gëzuar atë mbrëmje, përpara një auditori të gjerë, vetëm me burra – ushtarakë të repartit lokal, ministra, senatorë dhe deputetë që e shoqëronin në atë xhiro, guvernatorë dhe njerëz të shquar – të cilët ishte duke i zbavitur me kujtime nga jeta e parë politike, tri dekada të kaluara, duke dedhur një vështrim sentimental, nostalgjik, që zakonisht e përdorte në fund të festave, si të jepte një shenjë dobësie, papritur shpalli:

> -Unë gjithmonë kam qenë një njeri i dashur. Një njeri që ka shtrënguar në krahët e vet gratë më të bukura të këtij vendi. Ato më kanë dhënë energji për të drejtuar. Pa ato kurrë nuk do të kisha bërë atë që kam bërë. - Ngriti gotën e vet për ta parë në dritë, vëzhgoi mirë lëngun, tejdukshmërinë, qartësinë dhe ngjyrën e tij. - E dini ju cila ka qenë më e mira nga tërë femrat që kam palluar? – ("Më falni, miqtë e mi, për fjalën e ndyrë", kërkoi ndjesë diplomati, "po citoj Truhijon, po citoj listht"). Bëri një tjetër pauzë, i mori erë gotës së tij me konjak. Koka e tij e thinjur kërkoi një rrethin e rrethinës të rrethinës të rrethinjve që dëgjonin, fytyrën e nxirë dhe bullafiqe të ministrit. Dhe përfundoi: - Gruaja e Froilanit!

Urania bëri një ngërdheshje neverie, si atë natë kur dëgjoi ambasadorin Çirinos të shtonte se don Froilani kishte buzëqeshur heroikisht, kishte qeshur dhe kishte gëzuar me të tjerët me shakanë e Shefit. "I bardhë si letër, pa i rënë të fikët, pa u rrëzuar nga ndonjë atak i beftë zemre", saktësonte diplomati.

> -Si ishte e mundur, baba? Që një njeri si Froilan Arala, i ditur, i përgatitur, inteligjent, arriti ta pranojë këtë gjë. Çfarë ju bënte ai? Çfarë ju jepte për t'ju kthyer në paçavure: don Froilanin, Çirinosin, Manuel Alfonson, ty, të gjithë, në të djathtë e në të majtë të tij?

Nuk e kupton dot, Urani. Ka shumë gjëra të asaj kohe që ke arritur t'i kuptosh; disa prej tyre, në fillim të dukeshin të pashpjegueshme, por duke lexuar, krahasuar dhe

menduar, arrite të kuptosh se miliona njerëz, të sakatuar nga propaganda, nga mungesa e informacionit, të trullosur nga indoktrinimi e izolimi, të zhveshur nga vullneti i lirë, nga dëshira dhe deri nga kureshtja prej frikës, duke praktikuar servilizmin dhe nënshtrimin e përditshëm, arritën ta hyjnizonin Truhijon. Jo vetëm t'ia kishin frikën, po edhe ta donin, siç duan fëmijët prindërit autoritarë, të bindur se kamxhiku dhe ndëshkimi, janë për të mirën e tyre. Ajo që nuk ka arritur të kuptosh ende, është që domenikanët më të përgatitur, kokat e kombit: avokatë, mjekë, inxhinierë, të dalë shpesh nga universitetet më të mira të Shteteve të Bashkuara apo të Evropës, të ndershëm, të ditur, me përvojë, të lexuar, me shije, shumë herë me një ndjenjë të zhvilluar humori, me dëshira të forta, pranuan të poshtëroheshin në mënyrën më çnjerëzore, si atë natë në Barahona, don Froilan Arala.

> -Sa keq që s'mund të flasësh, - thotë, duke u kthyer në të tashmen. - Le të përpiqemi ta kuptojmë së bashku. Si mundet që Froilani të ruante një besnikëri prej qeni ndaj Truhjlos? I qëndroi besnik deri në fund, sikurse edhe ti. Nuk mori pjesë në komplot, sikurse deri në fund, sikurse edhe ti. Vazhdoi t'ia lëpinte dorën Shefit, edhe kur u mburr në Barahona se kishte fjetur me gruan e tij. I lëpinte dorën Shefit që e kishte dërguar të bënte vizita nëpër Amerikën e Jugut që e kishte dërguar të bënte vizita nëpër Amerikën e Jugut që e kishte dërguar të bënte vizita nëpër Amerikën e Jugut (Buenos Airesi në Karakas, nga Karakasi në Rio o Brazilia, nga Brazilia në Montevideo, nga Montevideo në Karakas), vetëm e vetëm që të vazhdonte në qetësi të bënte qejf me fqinjën tonë të bukur.

Është një përfytyrim që prej kohësh nuk e lë të qetë Uraninë, përfytyrim që e indinjon dhe e bën të buzëqeshë hidhur. Përfytyronte Ministrin e Jashtëm të asaj kohe, duke hipur e duke zbritur avionëve, duke shkuar kryeqyteteve amerikanojugore, duke iu bindur urdhrave të prera që e prisnin në çdo aeroport për të vazhduar udhëtim të marrë, duke i bezdisur qeveritë e atyre vendeve me pretekste boshe. Vetëm të mos kthehej në Qytetin Truhijo, ku Shefi ia hipte shoqes. Këtë gjë e tregonte vetë Krisueleri, biografi më i njohur i Truhijos. Dhe të gjithë e dinin, përfshirë edhe don Froilanin.

> -A ia vlente, baba? A thua ndodhte nga iluzioni i gëzimit të pushtetit? Shpesh mendoj se jo. Mendoj se përfitimi ishte në radhë të dytë. Se, në të vërtetë, ty, Aralas, Piçardos, Çirinosit, Alvares Pinas, Manuel Alfonsos, ju pëlqente të fëlliqeshit. Se

Truhijo ju nxori nga fundi i shpirtit prirjen perverse të qenieve që kanë nevojë t'i pështyjnë, t'i keqtrajtojnë, të qenieve që vetëm duke u poshtëruar, e gjejnë vetveten.

Invalidi eshikon pa lëvizur as qerpikët, as buzët, as duart e vockla mbështetur mbi gjunjë. Thua ishte një mumje, një kufomë e balsamuar, një kukull prej dylli. Rrobëdëshambri i tij ishte i çngjyrosur i rrepur vende-vende. Duhet të ishte shumë i vjetër, dhjetë a pesëmbëdhjetë vjeç. Troket dera. Ajo thotë "Hyr". Shfaqet infermierja me një pjatë me thela mangu, të prera në formë gjysmëhëne e llapë mollë o bananeje.

-Në mes të paradites gjithmonë i sjell ndonjë frut, - shpjegon ende pa hyrë. - Doktori thotë se nuk duhet të shkojë shumë orë me stomakun bosh. Ngaqë mezi ha, duhet t'i japësh diçka tri-katër herë në ditë. Natën vetëm lëng mishi apo perimesh. Mund të hyj?

-Po, hyr.

Urania shikon të atin dhe sytë e tij të ngulur mbi të. Ai nuk kthehet të shikojë infermieren, edhe kur ajo ulet përballë tij dhe fillon ta ushqejë.

-Ku e ka protezën e dhëmbëve?

-Na u desh t'ia hiqnim. Ngaqë është dobësuar shumë, i vriste mishrat e dhëmbëve. Ngaqë është dëshirë lëngje, fruta të prera, të buta, pure dhe gjëra të rrahura, as që i duhet. Për një çast të gjatë, sundon qetësia. Kur invalidi mbaron së gëlltituri ushqimin, infermierja ia afron lugën me goja dhe pret e qetë që plaku të hapë gojën. Atëherë me kujdes i jep kafshatën tjetër. A thua bën gjithmonë kështu? Apo ky kujdes tregohet vetëm në prani të vajzës së tij? Patjetër, kur është vetëm me të, duhet ta shajë, ta pickojë, siç bëjnë dadat me fëmijët që akoma nuk flasin, kur e ëma nuk i shikon.

-Jepini ndonjë kafshatë ju, - thotë infermierja. - Ai e dëshiron këtë. Mirë, don Agustin? Doni që t'ju ushqejë vajza juaj? Po, po, do t'i pëlqente shumë. I jepni ndonjë lugë, ndërkohë unë po zbres poshtë të marr një gotë ujë, se harrova të sjell.

Vendos pjatën e përgjysmuar në duart e Uranisë, e cila e mori mekanikisht, dhe doli, duke e lënë derën hapur. Pas disa çastesh ngurrimi, Urania i afron te goja një lugë me copëza mangoje. Invalidi, pa i hequr sytë prej saj, mbyll gojën, duke shtrënguar buzët, si një fëmijë i vështirë.

V

-Mirëdita, - u përgjigj.

Koloneli Xhoni Abesi ia kishte lënë mbi tryezë informacionin e përditshëm me vërejtjet përkatëse, parashikimet dhe sugjerimet. I pëlqente t'i lexonte; koloneli nuk humbiste kohë me kotësira, si shefi i mëparshëm i Shërbimit Sekret Ushtarak, gjenerali Arturo R. Espajat, Neshteri, i diplomuar në Shkollën Ushtarake West Point, i cili e mërziste me deliret strategjike. A thua punonte Neshteri për CIA-n? E kishin siguruar që jo. Po Xhoni Abesi nuk mund ta konfirmonte. Nëse kishte njeri që nuk punonte për CIA, ishte koloneli: I urrente jankit.

-Kafe, Shkëlqesi?

Xhoni Abesi ishte me uniformë. Edhe pse përpiqej të mbahej siç donte Truhijo, prapë nuk mundej, për shkak të trupit të tij të flashkët e të çrregullt. Ishte i shkurtër, me mjekrën, që i shkonte me gushën e dyfishtë, ndarë nga një rrëke e thellë. Me faqe të fishkura. Vetëm sytë e lëvizshëm, mizorë, tregonin inteligjencën e atij shëmtimi fizik. Ishte nuk kishte qenë në West Point, as në ndonjë shkollë ushtarake. Ishte nga ata që instruktori Gitleman, kur Bamirësi ishte marinas, i quante "një thithlopë nga trupi dhe nga shpirti", për shkak të mungesës së muskujve, dhjamit të tepërt dhe zellit për intriga. Truhijo e bëri kolonel brenda një nate. Të dy të njëjtën kohë, gjatë atyre shpërthimeve që përcaktonin rrugën e tij politike, vendosi ta emërojë shef të SIM-it, duke zëvendësuar Neshterin. Pse e bëri? Jo se ishte vetëm mizor, po më shumë ngaqë ishte i ftohtë: Ishte qenia më e akullt që kishte njohur në këtë vend, me njerëz me trup e shpirt të ndezur. Që një vendim fatlum? Përfundimisht, i dëshiruar. Dështimi i atentatit kundër Presidentit Betankur nuk ishte i vetmi. Po ashtu u gabua me të ashtuquajturin rebelim kundër Fidel Kastros, të komandantëve Eloy Gutierres Menojo dhe Uiliam Morgan, që

përfundoi në kurthin e përgatitur nga mjekroshi, për të tërhequr të arratisurit kubanë në ishull e për t'i përdorur si donte. Bamirësi mendohej, ndërkohë që shfletonte informacionin, duke gjerbur kafenë.

-Ju ngulni këmbë për ta nxjerrë peshkopin Reji nga Kolegji Santo Domingo, - murmëriti.

- Uluni, merrni kafe.

-Më lejoni, Shkëlqesi.

Zëri melodioz i kolonelit vinte nga vitet e djalërisë, kur ishte radio komentator futbolli, basketbolli dhe garash me kuaj. Nga ajo kohë, ruante vetëm pasionin e tij për lexime ezoterike – deklarohej rosacruz – për ato shami që i porosiste të kuqe, sepse, siç thoshte, ishte ngjyra e fatit për Ariesët dhe aftësisë për të dalluar broreren te çdo njeri (budallallëqe që Gjeneralisimit ia shpifnin). U ul përballë tryezës së Shefit, me filxhanin e kafes në dorë. Jashtë ishte ende errët dhe zyra, përgjysmë në hije, ndriçohej nga drita e ngrirë e një abazhuri të vogël të artë që rrethonte duart e Truhijos.

-Duhet plasur ky infeksion, Shkëlqesi. Problemi kryesor nuk është Kenedi, ai është tepër i zënë me dështimin e ndërhyrjes së tij në Kubë. Problemi është Kisha. Në qoftë se nuk i japim fund kolonës së pestë këtu, do të kemi probleme. Reji është një motiv i mrekullueshëm për ata që duan të na sulmojnë. Çdo ditë e fryjnë më shumë, ndërkohë që i bëjnë presion Shtëpisë së Bardhë të dërgojë marinsat për të shpëtuar të mjerin peshkop që përndiqet. Mos harroni se Kenedi është katolik.

-Të gjithë katolikë jemi, - mori frymë Truhijo. - Dhe për ta mënjanuar argument, shtoi: - Kjo është një arsye për të mos e prekur. Do t'u jepte gringove pretekstin që kërkojnë.

Edhe pse kishte çaste kur Truhijo mbetej i pakënaqur nga sinqeriteti i kolonelit, i bënte lëshime. Shefi i SIM-it kishte urdhër t'i fliste gjithmonë hapur, edhe kur e vërteta të ishte e hidhur për veshët e tij. Neshteri nuk guxoi ta përdorte këtë të drejtë si Xhoni Abesi.

-Nuk më duket një hap prapa në marrëdhënie me Kishën. Ai idil i tridhjetë viteve, tashmë ka mbaruar, - fliste ngadalë, me sytë e shqetësuar brenda orbitave, si të kërkonin të zbulonin rreth tij ndonjë hije. - Na kanë deklaruar luftë qysh më 25 janar të vitit 1960, me Kartën Pastorale e Peshkopatës, dhe qëllimi i tyre është të përmbysin regjimin. Priftërinjtë nuk do t'u mjaftonin disa koçensione. Nuk do të na mbështesin më,

Shkëlqesi. Po ashtu si jankit, Kisha kërkon luftë. Dhe në luftë ka vetëm dy rrugë: Të dorëzohesh ose të shkatërrosh armikun. Peshkopët Panal dhe Reji po rebelojnë hapur.

Koloneli Abesi kishte dy plane. Një: Duke përdorur si mbrojtje humbjen e armatosur me hunj dhe çomange me gozhdë të Balait, ish-i burgosur në shërbim të tij, ndërkohë që fuksat do të hynin dhunshëm në peshkopatën e La Vegas dhe në Kolegjin Santo Domingo, si grupe të pabindura, të dala nga një manifestim proteste kundër peshkopëve terroristë dhe do t'i vrisnin prelatët, para se të arrinin forcat e rendit për t'i shpëtuar. Ky plan ishte me rrezik. Mund të provokonte ndërhyrje të huaj. Por kishte përgatitësin se vdekja e dy peshkopëve do të paralizonte klerin për një kohë të gjatë. Plani i dytë: Forcat e rendit do t'i shpëtonin Panalin dhe Rejin para se të vriteshin prej turmës dhe qeveria do t'i dëbonte në Spanjë dhe Shtetet e Bashkuara, duke argumentuar se ishte e vetmja rrugë për të garantuar sigurinë e tyre. Pastaj, Kongresi do të miratonte një ligj, sipas të cilit të gjithë priftërinjtë që do të ushtronin misionin e tyre në vend, duhet të ishin domenikanë, të ktheheshin në vendet e tyre. Kësisoj – koloneli konsultohej me një fletëza me të dhëna – kleri katolik do të reduktohej në një të tretën e vet. Një pakicë priftërinjsh vendas, do të ishin të manipulueshëm.

Heshti kur Bamirësi ngriti kokën e tha:

> Ashtu siç bëri Fidel Kastroja në Kubë.
> Xhoni Abesi pranoi:
> -Edhe atje Kisha filloi me protesta dhe pastaj me komplote, duke përgatitur terren për jankit. Kastroja i dëboi priftërinjtë e huaj dhe mori masa të ashpra kundër atyre që ngelën. Çfarë i ndodhi? Asgjë.
> -Ende s'e dimë, - e korrigjoi Bamirësi. - Kenedi mund t'i zbarkojë çdo çast marinsat në Kubë. Dhe herën tjetër s'do të bëjnë gabimin që bënë muajin e kaluar në Bahia de Koçinos.
> -Në një rast të tillë, mjekroshi do të përleshej deri në vdekje, - shtoi Xhoni Abesi. - Edhe këtu nuk përjashtohet zbarkimi i marinsave. Edhe ju, po ashtu keni vendosur që do të vdisni duke luftuar.

Truhijo lëshoi një buzëqeshje tallëse. Nëse duhej të vdiste duke luftuar, sa domenikanë do të sakrifikoheshin për të?

Ushtarët, pa dyshim. E treguan në sulmin që bëri Fideli në 14 qershor 1959. Luftuan mirë, i shfarosën pushtuesit në pak ditë në malet e Konstansës dhe në plazhet Maimon dhe Estero Hondo. Po kundër marinsave...
-Druaj se s'do të jenë shumë me mua. Arratisja e minjve do të ngrejë një re të madhe pluhuri. As ju nuk do të keni shpëtim tjetër, veç meje. Kudo që të shkoni, ju pret burgu, ose do t'ju vrasin armiqtë që keni nëpër botë.
-I kam bërë për të mbrojtur këtë regjim, Shkëlqesi.
-Nga tërë ata që më rrethojnë, i vetmi që nuk do të mundte të më tradhtonte, jeni ju, - nguli këmbë Truhijo, duke u argumentuar. - Jam njeriu i vetëm ku mund të mbështeteni, që nuk ju urren, as i shkon në mendje t'ju vrasë. Jemi martuar bashkë, vetëm vdekja na ndan.
Qeshi përsëri me humor, duke vërejtur kolonelin, ashtu siç vëzhgon entomologu një insekt të vështirë për ta studiuar. Thuheshin shumë gjëra për të, sidomos për mizorinë e tij. Ishte gjetur tamam njeriu për të ushtruar atë detyrë. Për shembull, i ati, një amerikan me prejardhje gjermane, zbuloi se Xhoni i vogël, akoma me pantallona të shkurtra, u pëllciste sytë me gjilpërë zogjve të vegjël të pulave. Kur ishte i ri, u shiste studentëve të Mjekësisë kufoma që i vidhte në varrezat Indipendenca. Edhe se, edhe pse e martuar me Lupitën, atë meksikanen e tmerrshme e të stërvitur, e cila ecte rrugëve me kobure në brez, ishte homoseksual. Derisa flinte edhe me gjysmëvëllanë e Gjeneralisimit, Vogëlushin Truhijo.
-Besoj i dini fjalët që qarkullojnë poshtë e lart për ju, - ia këputi, duke e parë drejt në sy dhe gjithmonë duke qeshur.
-Disa duhet të jenë të vërteta. Vërtet luaje duke u nxjerrë sytë zogjve të pulave? Ke nxjerrë nga varri kufoma për t'i shitur?
Koloneli Buzëqeshi me zor.
-E para nuk duhet të jetë e vërtetë, nuk e mbaj mend. E dytë është gjysmë e vërtetë. Nuk ishin kufoma, Shkëlqesi. Qenë eshtra, kafka, gjysmë të zbuluara nga shirat. Për të fituar diçka. Tani thonë se si shef i SIM-it, po i kthej prapë ato koka.
-Po ajo puna e homoseksualit?
As kësaj here koloneli nuk u trazua. Zëri i tij vazhdonte të ruante një shpërfillje klinike.
-Kurrë nuk kam mbërritur deri aty, Shkëlqesi. Nuk kam fjetur me asnjë mashkull.

-Mirë, mirë, mjaft me këto budallallëqe, - ia preu shkurt ai, dhe u bë serioz: - Mos i prek peshkopët, tani për tani. Të shohim si do të zhvillohen gjërat. Në qoftë se mund t'i ndëshkojmë, do ta bëjmë. Veç të jenë nën vëzhgim të përhershëm. Vazhdo me luftën e nervave. Që të mos flenë e të mos hanë të qetë. Mundet që vetë ata të vendosin të ikin.
Do t'u shkonte e tyrja dhe do të mbeteshin të patundur ata peshkopë, si edhe ai miu i zi Betankur? Përsëri i erdhi rrotull zemërimi. Ai, kandrra i Karakasit kishte bërë që OEA ta dënonte Republikën Domenikane, duke arritur që të gjithë vendet t'i prisnin marrëdhëniet me të dhe të ushtronin presione ekonomike, derisa ta asfiksonin vendin. Çdo ditë, çdo orë, linte gjurmë të këqia në ekonominë e shkëlqyer të vendit. Dhe Betankuri, ende i gjallë, flamurtar i lirisë, tregonte në televizion duart e veta të djegura, krenar që kishte arritur t'i shpëtonte atij atentati idiot, që kurrë s'duhej ta kishte lënë në duart e atyre ushtarakëve budallenj venezuelanë. Në të ardhmen do t'ia linte në dorë vetëm SIM-it. Në mënyrë teknike, në formë pavetore, Abesi i shpjegoi operacionin e ri, që do të arrinte kulmin me shpërthimin e fuqishëm, të komanduar nga larg me pult, të një bombe të blerë në Çekosllovaki me një çmim ari, që tani ndodhej në konsullatën domenikane, në Haiti. Prej aty, nuk ishte e vështirë ta çoje në çastin e duhur në Karakas.
Qysh prej vitit 1958, vit kur e ngarkoi me detyrën që kishte, Bamirësi takohej përditë me kolonelin, në këtë zyrë, në Shtëpinë me Mogan a në çdo vend ku gjendej Truhijo, gjithmonë në këtë orë. Ashtu si Gjeneralisimi, Xhoni Abesi kurrë nuk merrte pushime. Truhijo dëgjoi të flasë për herë të parë për të gjeneral Espajat. Shefi i mëparshëm i Shërbimit Sekret ishte habitur me një informacion të saktë dhe të hollësishëm mbi të arratisurit domenikanë në Meksikë: Çfarë bënin, ç'kurdisnin, ku jetonin, ku mblidheshin, kush i ndihmonte dhe cilët diplomatë i vizitonin.
-Sa keni futur në Meksikë që jeni kaq i informuar për larot?
-Gjithë informacioni vjen vetëm nga një njeri, Shkëlqesi. - Neshteri bëri një gjest kënaqësie profesionale. - Dhe shumë i ri. Xhoni Abes Garsia. Mund ta keni njohur babain e tij, një gringo gjysmë gjerman, i cili erdhi të punojë në kompaninë elektrike dhe u martua me një domenikane. I biri ishte një gazetar sporti dhe gjysmë poet. Fillova ta përdor si informator

për njerëzit e radios dhe të shtypit, po ashtu për mbledhjet në Farmacinë Gomes, ku mblidhen intelektualët. E bëri aq mirë, sa e dërgova në Meksikë me një bursë të rreme. Dhe, siç e shihni, fitoi besimin e të gjithë të arratisurve. Ia kalon mirë me qentë dhe me macet. Nuk di si ia bën, Shkëlqesi. Arriti të futet deri te Lombardo Toledano, drejtuesi i sindikatave të majta. Pa mendoni! U martua me një shëmtirë që ishte sekretare e atij farë komunisti.
I mjeri Neshter! Duke folur me aq entuziazëm, do të humbiste postin e vet si shef i Shërbimit Sekret, për çka e kishin përgatitur në West Point.
-Sille dhe emëroje në një vend ku mund ta vëzhgoj, - urdhëroi Truhijo.
Kështu u shfaq në korridoret e Pallatit Kombëtar ajo figurë e ngathët, e përunjur, me sytë në shqetësim të përhershëm. I dhanë një detyrë të ulët në zyrën e informacionit. Truhijo, nga larg, e studionte. Qysh i ri në San Kristobal, e kishte patur intuitën që, me një vështrim çasti, me një bisedë të shkurtër ose me një referencë të thjeshtë, ta gjente njeriun që mund t'i shërbente. Ashtu kishte zgjedhur një numër të mirë bashkëpunëtorësh dhe nuk i kishte dalë keq. Xhoni Abes Garsia punoi disa javë në një zyrë të errët, nën drejtimin e poetit Ramon Emilio Himenes, me Dip Velarde Fontin, Kerolin dhe Grimaldin, kinse duke u shkruar letra lexuesve në "Forumi Publik" të gazeta "Karaibet". Para se ta vinte në provë, priti, pa ditur se çfarë do të sillte rasti. Sinjali erdhi fare papritur, ditën që Xhoni Abesi e habiti njërin prej Sekretarëve të tij të Shtetit, i cili po bisedonte me të në një korridor të Pallatit. Për çfarë mund të fliste i pastri, i lumturi dhe i rrepti Hoakin Balager me informatorin e Neshterit?
-Për asgjë të veçantë, Shkëlqesi, - shpjegoi Balageri gjatë orës së takimit ministror. - Nuk e njihja atë djalosh. Kur e pashë aq të përqendruar në lexim, sepse lexonte duke ecur, më bëri kureshtar. Ju e dini se pasioni im i madh janë librat. U habita. Duhet të ketë ndonjë dërrasë mangut. E dini çfarë e kënaqte aq shumë atë tip? Një libër torturash kineze, me fotografi kokash të prera dhe rrjepje për së gjalli.
Atë natë urdhëroi ta thërrisnin. Abesi dukej tepër i tronditur – nga gëzimi, frika, ose të dyja bashkë – nga nderi i papritur, sa mezi i dilnin fjalët kur përshëndeste Bamirësin.

-Ke bërë një punë të mirë në Meksikë, - i tha Gjeneralisimi me një zë të ëmbël e të mprehtë që, sikurse vështrimi i tij, ushtronte një ndikim paralizues mbi bashkëbiseduesit e tij. - Espajati më informoi. Mendoj se mund të kryesh detyra më serioze. Je gati?
-Çdo gjë që të urdhëroni Ju, Shkëlqesi, - tani ishte i qetë, me këmbët të bashkuara, si një shkollar përpara mësuesit.
-E njohët Hose Almoinan atje në Meksikë? Një galician që erdhi këtu me republikanët spanjollë të arratisur.
-Po, Shkëlqesi. E kam parë. Ishte njëri nga ata të grupit, me të cilët mblidhej në kafe Tregtia. "Spanjollët domenikanë", siç e quanin veten.
-Ai njeri ka botuar një libër kundër meje, "Një satrap në Karaibe", i paguar prej qeverisë së Guatemalase. Me pseudonimin Gregorio Bustamante. Pastaj, për të humbur gjurmët, pati vetësigurinë të botojë një libër tjetër në Argjentinë, kësaj radhe me emrin e vet, "Unë isha sekretar i Truhijos", duke më ngritur në qiell. Meqenëse kanë kaluar disa vjet, ndihet i shpëtuar atje në Meksikë. Mendon se kam harruar që ka përgojuar familjen time dhe regjimin që e ushqeu. Këto faje nuk falen. E merr përsipër?
-Do të ishte një nder i madh për mua, Shkëlqesi, - u përgjigj Abes Garsia menjëherë, me një siguri që nuk e kishte treguar deri në atë çast.
Pak kohë më vonë, ish-sekretari i Gjeneralisimit, mësuesi privat i Ramfisit dhe shkrimtaruci i donja Marie Martinesit, Damës së Hijshme, do të vdiste në kryeqytetin meksikan, i bërë shoshë nga plumbat. Pati ankesa të fuqishme nga të arratisurit dhe nga shtypi, por askush nuk mund ta provojë atë që thoshin ata, se vrasësi kishte qenë "dora e gjatë e Truhijos". Një operacion i shpejtë, i patometë dhe që kushtoi vetëm një mijë e pesëqind dollarë, sipas faturës që solli Xhoni Abesi kur u kthye nga Meksika. Bamirësi e përfshiu në Ushtri me gradën kolonel.
Zhdukja e Hose Almoinas qe vetëm njëri mes më të zëshmëve, në vargun e gjatë të operacioneve të shkëlqyera, të realizuara nga koloneli, ku u vranë ose mbetën sakatë apo të plagosur keq, dhjetëra të arratisur në Kubë, Meksikë, Guatemalë, Nju Jork, Kosta Rika dhe Venezuelë. Punë rrufe dhe të pastra që e mahnitën Bamirësin. Secila prej tyre qe një kryevepër për

nga shkathtësia dhe fshehtësia, një punë orëndreqësi. Shumë herë, veç zhdukjes së armikut, Abes Garsia, i kushtohej shkatërrimit të famës së tyre. Sindikalisti Roberto Lamada, refugjat në Havanë, vdiq si pasojë e një të rrahure që i bënë në një bordel në lagjen kineze, disa rrugaçë, të cilët thanë në polici se ai kishte dashur të vriste me thikë një prostitutë, vetëm se ajo nuk deshi t'i nënshtrohej perversiteteve sadomazokiste që refugjati donte t'i bënte. Prostituta, një mulate me flokët ngjyrë të kuq, u duk në Karteles dhe në Bohemia, duke qarë e duke treguar plagët që i shkaktoi i degjeneruari. Avokati Bajardo Siprioti, u ndodh në Karakas, në një grindje tavolinash: e gjetën të vrarë me thikë. Një vdekje e pështirë, në një hotel, i veshur me rrobat e një mbajtëseje grash dhe me buzë të lyera. Në raportin ligjor shpjegohej se kishte spermë në anus. Si arrinte koloneli Abesi të krijonte lidhje aq të shpejta me yjet që s'i njihte mirë me ata plehra, fundërria të shoqërisë: vrasës, mujsharë, trafikantë, sherrxhinj, prostituta, zuzarë, hajdutë xhepash, të cilët gjithmonë merrnin pjesë në ato bëma të dhunshme, bëma që ushqenin shtypin sensacional, ku përgojoheshin armiqtë e regjimit? Si mund të krijojë gati në tërë Amerikën Latine dhe në Shtetet e Bashkuara një rrjet aq të saktë informatorësh dhe të përdorë vrasës të regjur me aq pak para? Koha për Truhijen qe tepër e çmuar që ta humbiste duke u marrë me vogëlsira. Por nga larg, si një njohës i mirë i gurëve të çmuar, admironte mprehtësinë dhe origjinalitetin me të cilin Xhoni Abes Garsia shpëtonte regjimin nga armiqtë e vet. As grupet e të arratisurve, as qeveritë kundërshtare, nuk mundën të zbulojnë ndonjë lidhje midis këtyre aksidenteve, këtyre bëmave terrori dhe Gjeneralisimit. Njëri nga aksionet më të përsosura qe ajo e Ramon Marrero Aristit, autori i "Over"-it, roman mbi hidraulikët e La Romanas, i njohur në tërë Amerikën Latine. Drejtor i dikurshëm i "La Nacion", gazetë tërësisht truhijiste, Marrero, ishte Sekretar i Punës në vitin 1956 dhe, në vitin 1957, kur u zgjodh për herë të dytë, filloi t'i dërgonte informacione gazetarit Ted Shulc, për të hedhur baltë mbi regjimin në artikujt e vet në "The New York Times". Kur kuptoi se u zbulua, i dërgoi letra korrigjimi gazetës amerikane dhe me bishtin ndër shalë, shkoi në zyrën e Truhijos: I ra në gjunjë, qau, i kërkoi ndjesë, iu betua se kurrë nuk e kishte tradhtuar dhe as do ta tradhtonte. Bami-

rësi e dëgjoi, pa thënë asgjë, pastaj, ftohtësisht, e qëlloi me një dackë. Marrero, i mbytur në djersë, po mundohej të nxirrte një shami, ndërkohë që shefi i adjudantëve ushtarakë, koloneli Guaroneks Estreja Sandalai, i futi një plumb dhe e vrau në zyrën e Shefit. Abes Garsia u ngarkua me mbylljen e aksionit. Pas një ore, një autoveturë që udhëtonte drejt Konstancës, në prani të disa dëshmitarëve, u rrëzua në një humnerë në Kordileret Qendrore. Marrero Aristi dhe shoferi i tij nuk mund të njiheshin ngaqë qenë bërë copash. A nuk kishte ardhur koha që koloneli Xhoni Abes Garsia të zëvendësonte Neshterin si kreu i Shërbimit Sekret? Në qoftë se do të kishte qenë ai drejtuesi i atij organizmi dhe jo Espajati, kur u bë sekuestrimi i Galindesit në Nju Jork, sigurisht s'do të kishte plasur ai skandal që i shkaktoi aq dëm imazhit ndërkombëtar të regjimit.
Truhijo duke shenjuar informacionin mbi tryezë, me një gjest përbuzës, tha:
-Tjetër komplot për të më vrarë, me Huan Tomas Dias në krye? E organizuar edhe nga konsulli Henri Dearborn, ai zabërhani i CIA-s?
Koloneli Abes Garsia hoqi dorë nga qëndrimi gatitu dhe i rehatoi të ndenjurat në karrige.
-Po, Shkëlqesi, - pranoi, pa i dhënë shumë rëndësi çështjes.
-Sa të pafytyrë! - e ndërpreu Truhijo. - Prishën marrëdhëniet me me për të qenë dakort me vendimin e OEA-s. I tërheqin diplomatët, por na lenë Henri Dearbornin dhe agjentët e tij të na kurdisin komplote. E sigurt që Huan Tomasi komploton?
-Jo, Shkëlqesi, janë të dhëna gati të paqarta. Por qyshkur e shkarkuat nga detyra, gjenerali Dias është bërë pus inati, prandaj po e vëzhgoj nga afër. Bën ato mbledhjet në shtëpinë e tij në Gaske. Nga zemërimi, gjithmonë duhet pritur një e keqe.
-Nuk qe punë nshkarkimit, - foli Truhijo me zë të lartë, si të fliste me veten e vet. - Ngaqë i thashë burracak. Për t'i kujtuar se kishte turpëruar uniformën.
-Unë isha në atë drekë, Shkëlqesi. Mendova se gjenerali Dias do të ngrihej të ikte. Po duroi, i zymtë e duke djersitur. Kur doli i merreshin këmbët si i dehur.
-Huan Tomasi gjithmonë ka qenë krenar, prandaj i duhej dhënë një mësim, - tha Truhijo. - Sjellja e tij në Konstanca qe ajo e një të dobëti. Unë nuk pranoj gjeneralë të dobët në Forcat e Armatosura Domenikane.

Incidenti kishte ndodhur disa muaj pas shpalllimit të zbarkueses të Konstancës, Maimonit dhe Estero Hondos, ku të gjithë pjesëmarrësit e asaj ekspedite – atje, veç domenikanëve, kishte kubanë, amerikanë dhe venezuelanë – mbetën të vdekur ose robër. Incidenti ndodhi ato ditë janari të vitit 1960, kur regjimi zbuloi një komplot të gjerë klandestinësh, i cili, për nder të ajt sulmi, quhej "14 Qershor". Kishte në të studentë dhe profesionistë të rinj të klasës së mesme dhe të lartë, shumë prej tyre nga familje që i përkisnin regjimit. Në kulmin e operacionit për pastrimin e asaj organizate armiqësore, ku më aktivet qenë motrat Mirabal me burrat e tyre – kujtimi i tyre e tërbonte Gjeneralisimin – Truhijo organizoi atë drekë në Pallatin Kombëtar me nja pesëdhjetë figura ushtarake e civile, për të fyer mikun e tij të fëmijërisë, shokun e karrierës ushtarake, i cili kishte detyrën më të lartë në Forcat e Armatosura gjatë Epokës së tij dhe që e kishte shkarkuar si shef të Rajonit të La Vegas, ku përfshihej Konstanca, kur ende nuk ishin shfarosur të gjithë shkelësit e shpërndarë maleve. Më kot gjenerali Tomas Dias, kishte kërkuar atëherë një audiencë me Gjeneralisimin. U çudit kur i erdhi ftesa për drekën, pasi motra e tij, Grasita, ishte futur në ambasadën braziliane për azil politik. Shefi as që e përshëndeti, nuk iu drejtua asnjëherë gjatë drekës dhe as sytë nuk i hodhi mbi atë cep të humbur të tavolinës, shumë larg kryesorëve, ku e kishin ulur gjeneralin Dias, në shenjë të qartë të rënies së tij nga karriera. Kur po shërbenin kafenë, papritur, mbi zhurmërimin e bisedave që fluturonin nga tavolina e gjatë, në mermerët e mureve dhe kristalet e shandanëve të ndezur, u ngrit zëri i mprehtë i Isabel Majerit – e vetmja grua aty, udhëheqëse truhijiste e veriperëndimit të vendit – zë, të cilin e njihnin të gjithë domenikanët. Me një ton të çeliktë që sillte furtunë tha:
-Zotërinj, a s'na çudit prania në këtë tryezë, mes ushtarakëve e civilëve më të shquar të regjimit, e një oficeri të shkarkuar nga detyra, sepse s'ishte në lartësinë e duhur në fushëbetejë?
Pllakosi heshtja. Pesëdhjetë kokët që mbulonin anët e qëndresës të katërkëndëshit të madh të mbulesës së tryezës, ngrinë. Bamirësi nuk pa fare nga nga cepi ku rrinte gjenerali Dias. Vështrimi i tij kontrollonte mysafirët e tjerë, një për një, me një si shprehje habie, me sytë dhe buzët të hapura, si t'u kërkonte të ftuarve të tij ta ndihmonin të deshifronte misterin.

-E dini për kë e kam fjalën? - vazhdoi ajo, pas një pauze teatrale. - Për gjeneralin Huan Tomas Dias, shefi i Rajonit Ushtarak të La Vegas, i cili, gjatë sulmit kubano-venezuelan, u shkarkua nga detyra në kulmin e betejës për sjellje të padenjë përpara armikut. Kudo, veprime të tilla ndëshkohen me gjyq të shpejtë dhe pushkatim. Ndërsa në "diktaturën" e Rafael Leonidas Truhijo Molinas, gjenerali burracak ftohet të drekojë në Pallat me ajkën e vendit.
Frazën e fundit e tha ngadalë, duke u mëshuar fjalëve, për ta theksuar sarkazmën.
-Nëse më lejoni, Shkëlqesi, - belbëzoi, duke bërë një përpjekje mbinjerëzore, gjenerali Huan Tomas Dias. - Doja t'ju kujtoja se, kur u shkarkova, shkelësit ishin shpartalluar. Unë e kreva detyrën time.
Ishte një burrë i gjatë dhe i madh, po qe mpakur shumë në vendin ku rrinte. Qe zverdhur dhe përcillte herë pas here. Shikonte nga Bamirësi, po ky, pa e vështruar dhe pa e dëgjuar fare, hodhi sytë mbi të ftuarit, për të dytën herë, i bezdisur sërishmi:
-Dhe jo vetëm ftohet në Pallat, po del në lirim me rrogë të plotë dhe privilegjet e gjeneralit me tre yje, që të prehet i qetë, me ndërgjegjen se e ka kryer detyrën. Dhe kënaqet në pronat e veta, në shoqëri me Çana Diasin, gruan e tij të pastë, e cila është gjithashtu edhe mbesa e gjakut të vet. Pra gëzon pensionin, bukuri. Ç'provë më e madhe duhet për zemërgjerësinë e kësaj "diktature gjakatare"?
Kur mbaroi së foluri, vështrimi i Bamirësit, i cili e kishte përfunduar vëzhgimin mbi tërë të tjerët, u ndal befas te cepi i gjeneralit Huan Tomas Dias. Tani fytyra e Shefit nuk ishte më ironike, as melodramatike, si më parë. Atë e pushtoi një seriozitet mortal. Ishte mësuar ta ngulte vështrimin e zymtë, zhibirues, të pamëshirshëm, me të cilin të kujtonte se ishte ai që komandonte këtë vend, dhe jetën e çdo domenikani. Huan Tomas Dias uli vështrimin.
-Gjenerali Dias nuk pranoi të zbatonte një urdhër timin dhe e qortoi oficerin që po e kryente, - tha, ngadalë me përbuzje. - Gjatë sulmit të huaj, kur armiqtë e armatosur nga Fidel Kastroja, Munjos Marini, Betankuri dhe Figeresi, ato banda smirëze që kishin zbarkuar me zjarr dhe hekur, duke vrarë ushtarë domenikanë, donin të prisnin kokat e të gjithë neve

që jemi në këtë tavolinë. Atje, komandanti ushtarak i La Vegas, e tregoi veten që ishte zemërlëshuar, i brishtë, pa ndjenja të forta, që s'mund 'të shohë gjakderdhje. Dhe iu shmang urdhrit tim për të pushkatuar të gjithë shkelësit e kapur me armë në dorë. Shau një oficer që respektonte urdhrat, i cili po u jepte atë që meritonin atyre që erdhën këtu të vendosnin një diktaturë komuniste. Në ato çaste rreziku për Atdheun, gjenerali mbolli konfuzion e uli moralin tek ushtarët tanë. Ndaj s'bën më pjesë në Ushtrinë tonë, edhe pse uniformën e mban ende. Pushoi për të pirë një gllënjkë ujë. Kur sapo e kaloi poshtë, në vend të vazhdonte, papritur e prerë, u ngrit në këmbë dhe përshëndeti duke i dhënë fund drekës: "Ditën e mirë, zotërinj".
-Huan Tomasi as që u përpoq të ikte, sepse e dinte që s'do të dilte i gjallë andej, - tha Truhijo. - Në ç'komplot bën pjesë?
Asgjë nuk është shumë e qartë. Në shtëpinë e tij, në Gaske, prej ka kohësh gjenerali Dias dhe e shoqja, Çana, prisnin shumë vizitorë. Preteksti qe se shihnin filma që shfaqeshin në oborr, në ajër të lirë, me një aparat projekti që e drejtonte dhëndri i gjeneralit. Përzierje e rrallë e të pranishmeve. Nga njerëz të shquar të regjimit, si vjehrri i të zotit të shtëpisë, Modesto Dias Kesada, vëllai e vet, deri tek ish-funksionarë të rënë nga rrethi i ngushtë, si Amiama Tio dhe Antonio de la Masa. Koloneli Abes Garsia kishte bërë fuks njërin nga shërbëtorët përtej rrugës nga regjimi, si vetmi i tij ishte se zotërinjtë, ndërsa shihnin filmin, flisnin pa pushim, sikur filmi të qe vetëm për të mos u dëgjuar bisedat. Së fundi, nuk qenë ato mbledhjet ku flitej keq për regjimin, përmes gotave me rum apo uiski, pra s'ishin të denja për t'i pasur në konsideratë. Veçse, gjenerali Dias pati një takim sekret me një emisar të Henri Dearbornit, i ashtuquajturi diplomat janki që, siç e di Shkëlqesia juaj, ishte shef i CIA-s në Qytetin Truhijo.
-Kërkon një milion dollarë për kokën time, - tha Truhijo. - Gringos duhet t'i ketë ardhur mendja rrotull me tërë atë mal me para që i kërkon për të më hequr qafe. Ku është parë?
-Në Hotel Ambasadori, Shkëlqesi.
Bamirësi u mendua një çast. A do të ishte i aftë Huan Tomasi të fabrikonte diçka serioze? Njerëzit vjet më parë, mbase. Atëherë ishte njeri i veprimit. Pastaj qe bërë i ndjeshëm. I pëlqente shumë të hidhte ndonjë gotë, të shkonte në ndeshjet me gjela, të hante, të dëfrehej me miqtë, të martohej dhe të çmontohej,

të hynte në lojë për të fituar. Në dru të kalbur po mbështeteshin gringot. Jo, jo, nuk kishte pse shqetësohej.

-Në rregull, Shkëlqesi, mendoj se tani për tani nuk ka rrezik nga gjenerali Dias. Po e ndjek këmba-këmbës. Dimë kush e viziton dhe dhe kë viziton. Telefoni i tij është nën kontroll.
A kishte tjetër gjë? Bamirësi hodhi vështrimin nga dritarja: errësira vazhdonte, edhe pse po afrohej ora gjashtë. Veç qetësia nuk mbretëronte më. Së largu, në periferi të Pallatit Kombëtar, ndarë prej rrugëve nga një shesh i gjerë me bar e pemë dhe e rrethuar me gardh të lartë teli me heshta, kalonte, herë pas here, ndonjë automobil duke i rënë borisë. Brenda ndërtesës ndiheshin pastruesit që lëviznin, fshinin, dyllosnin, shkundnin. Korridoret dhe zyrat duhet të qenë të pastra dhe të shkëlqenin kur kalonte ai. Kjo gjë i jepte kënaqësi.

-Më falni, Shkëlqesi, po doja të rivendosej sistemi i sigurisë në Maksimo Gomes dhe Malekon, ndërkohë që ju shëtisni. Po ashtu gjatë rrugës kur shkoni në Shtëpinë me Mogan.
Pas dy muajsh kishte urdhëruar që për një kohë të pacaktuar të pritej sistemi i sigurisë për të? Pse? Ndoshta sepse një mbasdite vonë, në njërën nga shëtitjet e veta të mbrëmjes, duke zbritur nga Maksimo Gomesi drejt detit, vuri re në çdo fillim rruge prita policësh që ndalonin kalimtarët dhe makinat të hynin në bulevard dhe Volksvagenëve me kalecë që Xhoni Abesi lëshonte në të katër anët përreth tij. Ndjeu angështi, claustrofobi. Po ashtu i kishte ndodhur ndonjë natë duke shkuar për në fermën Fundasion, t'i zinte sytë gjatë rrugës, morra dhe prita ushtarake që ruanin kalimin e tij. Mos ishte magjepsja që rreziku kishte ushtruar gjithmonë mbi të - shpirti i pashtruar i marinsit - ajo që e çonte të sfidonte ashtu fatin në çastë kërcënimi të madh për regjimin? Sidoqoftë, ishte një vendim që nuk do ta kthente.
-Urdhëri vazhdon të jetë në fuqi, - përsëriti me një ton që s'pranonte diskutim.
-Si urdhëron, Shkëlqesi.
Mbeti për një çast duke e parë në sy – koloneli uli të tijët menjëherë – dhe e shpoi me një shtëzë humori:
-Besoni ju se i admirueshmi juaj, Fidel Kastroja, del në rrugë si unë, pa mbrojtje?
Koloneli mohoi me kokë.

-S’besoj që Fidel Kastroja të jetë romantik sa ju, Shkëlqesi.
Romantik ai? Ndoshta me ndonjë nga femrat që kishte dashur, mbase me Lina Lovatonin. Por jashtë fushës sentimentale, në politikë, ai kishte qenë gjithmonë një klasik. Racionalist, i qetë, pragmatik, me kokë të ftohtë dhe vizion të largët.
-Kur e kam njohur në Meksikë, ai përgatiste ekspeditën me jahtin Granma. E pandehnin një kuban të marrë, një aventurier, aspak serioz. Mua më habiti qysh në fillim mungesa e emocioneve tek ai, edhe pse në fjalimet e veta dukej tropikal, shumë i gjallë, i apasionuar. Është ashtu për publikun. Jashtë publikut, është i kundërt. Ka një mendje të akullt. Unë kurrë s’pata dyshuar se do të arrinte në pushtet. Por më lejoni një sqarim, Shkëlqesi. Admiroj personalitetin e Kastros, mënyrën se si ka ditur të tallet me gringot, si të bëhet aleat me rusët dhe vendet komuniste, duke i përdorur këta si mbrojtje kundër Uashingtonit. Nuk admiroj idetë e tij, nuk jam komunist.
-Ju jeni kokë e këmbë kapitalist, - u tall Truhijo me një buzëqeshje sarkastike. - Me Ultramarin bëni mjaft tregti, duke importuar mallra nga Gjermania, Austria e vendet socialiste. Idetë e mëdha nuk kanë humbje kurrë.
-Një tjetër gjë më shumë për t’ju falënderuar, Shkëlqesi, - pranoi koloneli. - Në të vërtetë, as që më kishte shkuar në mendje. Kurrë s’jam interesuar tregtisë. E hapa Ultramarin, sepse më urdhëruat Ju.
-Preferoj që bashkëpunëtorët e mi, më mirë të bëjnë para se sa të vjedhin, - sqaroi Bamirësi. - Tregtia e mirë i shërben vendit, hapin vende pune, krijojnë pasuri, ngrenë moralin e popullit. Përkundrazi, vjedhjet demoralizojnë. E marr me mend se prej sanksioneve, edhe për Ultramarin shkuan keq punët.
-Praktikisht, i paralizuar. Po nuk më intereson, Shkëlqesi. Tani, të njëzet e katër orët e mia të ditës, ia kushtoj ndalimit të armiqve për të mos përmbysur regjimin e për t’ju ruajtur.
Foli pa emocion, me të njëjtin ton të paqartë, asnjëanës, me të cilin shprehej normalisht.
-Duhet të nxjerr përfundimin se më admiron po aq sa atë torollakun Kastro? - tha Truhijo e kërkoi sytë e tij bishtnues.
-S’ju admiroj, Shkëlqesi, - mërmëriti koloneli Abes syulur.
-Unë jetoj nga Ju. Për Ju. Nëse më lejoni, jam qeni iro jë i juaj.
Bamirësit iu duk se kur i tha frazën e fundit, Abes Garsias iu drodh zëri. Veçse e dinte mirë se nuk ishte aspak i dobtë dhe i

ndjeshëm, dhe prej gojës së tij nuk dilnin kurrë shpërthime të ngrohta, nga ato që dëgjonte përditë prej kurtizanëve të tjerë, prandaj po e shqyrtonte me vështrimin e vet të thiktë.

-Nëse më vrasin, këtë do ta bëjë ndonjë shumë i afërt, si të thuash, ndonjë i tradhtuar nga familja, - tha, si të mos fliste për vete. - Për ju do të ishte një fatkeqësi e madhe.
-Për gjithë vendin, Shkëlqesi.
-Prandaj vazhdo me këmbëngulje mushke, - i pranoi Truhijo. - Po të mos ishte ashtu, do të isha tërhequr, siç më këshillonin të dërguarit e Presidentit Eisenhower, Uliam Paulei, gjeneral Klarku dhe senatori Smaters, miqtë e mi janki. "Do mbetesh në histori si një burrë shteti zemërmadh, që ua la timonin të rinjve." Kështu më tha Smaters, miku i Rusveltit. Ishte një mesazh nga Shtëpia e Bardhë. Për këtë gjë erdhën. Më këshilluan të shkoja e të kërkoja azil në Shtetet e Bashkuara. "Aty do ta kesh të siguruar edhe pasurinë tënde." Ata qelbashër më ngatërrojnë me Batistën, me Rohas Pinijan, me Peres Himenesin. Po mua, vetëm të vdekur, më nxjerrin këtej.
Bamirësi filloi të bënte sërish shaka, sepse iu kujtua Guadallupja, Lupja për miqtë, meksikania e trashë, me tipare burri, me të cilën u martua Xhoni Abesi gjatë periudhës misterioze dhe aventureske të jetës së tij në Meksikë, kur nga njëra anë i dërgonte informacione të hollësishme Neshterit për veprimtarinë e refugjatëve politikë domenikanë dhe, nga ana tjetër, frekuentonte rrethet revolucionare, si atë të Fidel Kastros, Çe Gevarës dhe kubanëve të 26 Korrikut, të cilët përgatisnin ekspeditën e Granmas apo të njerëzve si Visente Lombardo Toledano, shumë i lidhur me qeverinë meksikane dhe që kishte qenë mbrojtësi i tij. Gjeneralisimi nuk kishte patur kurrë kohë për ta pyetur me qetësi mbi atë periudhë të jetës së tij, kur koloneli zbuloi prirjen dhe talentin e vet për spiunazh dhe veprimtari të fshehta. Pa dyshim, një jetë e këndshme, plot të papritura. Po pse u martua me atë grua të tmerrshme?
-Gjithmonë kam dashur t'ju pyes për një gjë, - tha me vrazhdësinë me të cilën u fliste bashkëpunëtorëve të tij. - Pse u martove me një femër aq të shëmtuar?
S'dalloi asnjë shenjë fyerjeje në fytyrën e Abes Garsias.
-Nuk qe prej dashurisë, Shkëlqesi.
-Një gjë, gjithmonë e kam ditur, - tha Bamirësi, duke buzëqeshur. - Ajo nuk ishte e pasur, pra nuk qe punë interesi.

-Për mirënjohje. Lupja më ka shpëtuar jetën një herë. Ajo ka vrarë për mua. Kur ishte sekretare e Lombardo Toledanos, unë sapo kisha mbërritur në Meksikë. Falë Lombardos fillova të kuptoj se ç'ishte politika. Shumë gjëra që kam bërë, s'do të mundja pa ndihmën e Lupës, Shkëlqesi. Ajo s'di se ç'është frika. Por ka një instinkt që deri tani ka funksionuar mirë.
-E di që është e guximshme, që s'di të jepet, që shëtit me kobure në brez, që shkon në shëtitë publike si meshkujt, - tha Gjeneralisimi plot humor. - Madje kam dëgjuar se Puçita Brasovan i rezervon çupka. Po ajo që më habit është se ai përbindësh ka lindur fëmijë.
-Përpiqem të jem një bashkëshort i mirë, Shkëlqesi.
Bamirësin e mori gazi. Qeshte me zë, si dikur.
-Kështu që jeni martuar me të vetëm për mirënjohje, - vazhdoi shakanë ai. - Sigurisht dëfreni sa herë ju do qejfi. Më sa duket ju ngrefet instinktivisht.
-Sa për bisedë, Shkëlqesi. E vërteta është se as e dua Lupen, as ajo më do mua. Të paktën, sipas mënyrës se si kuptohet dashuria. Ne na bashkon diçka më e fortë. Rreziku për ta parë vdekjen në sy, të mbështetur te njëri-tjetri. Dhe gjaku i shumtë që na ka spërkatur të dyve.
Bamirësi pranoi. E kuptonte se ç'donte të thoshte. Atij do t'i pëlqente të kishte një grua ashtu, dordolec. Hej, dreq o punë. Nuk besoj se do të ndihej aq i vetmuar, sa herë që i duhej të merrte vendime. E qartë, asgjë nuk të lidh aq shumë, sa gjaku. Për këtë gjë, ai do të ishte aq i lidhur me këtë vend mosmirënjohësish, burracakësh dhe tradhtarësh. Sepse, për ta nxjerrë nga prapambetja, kaosi, padija dhe barbaria, i ishte dashur shumë herë të ngjyhej në gjak. A do ta falënderonin në të ardhmen këtë zabërhanë?
U dekurajua sërish. Duke bërë sikur po shikonte orën, pa me bisht të syrit pantallonat. Nuk kishte ndonjë njollë në të çarën e pantallonave mes këmbëve. Po ky verifikim nuk ia ngriti moralin. Përsëri i kaloi nëpër mendje vajzukja në Shtëpinë me Mogan. Ngjarje e shëmtuar. Nuk do të kishte qenë më mirë, sikur t'i kishte këputur një plumb, pikërisht kur po e shikonte me ata sy? Marrëzia. Ai kurrë nuk kishte qëlluar kot. Aq më pak për çështje shtrati. Vetëm kur nuk kishte alternativë tjetër, kur ishte absolutisht e domosdoshme për të çuar përpara këtë vend ose për të larë ndonjë borxh.

-Më lejoni, Shkëlqesi.
-Hë?
-Presidenti Balager njoftoi mbrëmë në radio se qeveria do të lirojë një grup të burgosurish politikë.
-Balageri bëri atë që urdhërova unë. Pse?
-Dua të kem listën e atyre që do të lirohen. Për t'i qethur, rruar e veshur hijshëm. Mendoj se do të dalin para medias.
-Do t'jua dërgoj listën me ta kontrolluar. Balageri mendon se këto veprime janë të përshtatshme në fushën diplomatike. Të shohim. Sidoqoftë, e ka paraqitur mirë çështjen.
Kishte mbi tryezë fjalën e Balagerit. Lexoi me zë të lartë paragrafin e nënvizuar: "Vepra e Shkëlqesisë së Tij, Gjeneralisimit Dr. Rafael L. Truhijo Molina, ka arritur të tillë qëndrueshmëri që na lejon, në këta tridhjetë vjet paqeje, rregulli dhe udhëheqjeje të vazhdueshme, të jemi për Amerikën një shembull i aftësisë latinoamerikane për të vendosur me ndërgjegje një demokraci përfaqësuese e të vërtetë".
-Bukur është shkruar. Apo jo? - tha. - Është epërsi të kesh për President të Republikës një poet e letrar. Kur ishte President im vëlla, fjalimet që lexonte Negroja, qenë të mërzitshme. E më punë, e di që nuk ju pëlqen Balageri.
-Unë nuk i përziej simpatitë dhe antipatitë e mia personale me punën time, Shkëlqesi.
-S'e kuptoj, pse s'ke besim tek ai. Balageri është më paqësori nga bashkëpunëtorët e mi. Prandaj kam vënë aty ku është.
-Unë mendoj se mënyra për t'i matur, është një strategji. Në thelb nuk është një njeri i regjimit. Balageri punon vetëm për Balagerin. Mund të jem i gabuar. Veç kësaj, nuk kam gjetur asgjë të dyshimtë në sjelljen e tij. Por nuk do t'i fusja duart në zjarr për besnikërinë e tij.
Truhijo pa orën e vet. Gjashtë pa dy minuta. Takimi i tij me Abes Garsian nuk zgjaste më shumë se një orë, përveç rasteve të veçanta. U ngrit në këmbë dhe Shefi i SIM-it e imitoi.
-Nëse ndërroj mendimin për peshkopët, do t'ju them, - tha në vend të përshëndetjes. - Për çdo rast të jesh i përgatitur.
-Do të zbatohet në çastin që ju do të vendosni. Më lejoni të largohem, Shkëlqesi.
Sa doli Abes Garsia nga zyra, Bamirësi pa qiellin nga dritarja. Ende asnjë rreze drite.

VI

-Ah, e mora vesh kush është, - tha Antonio de la Masa.
Hapi derën e makinës dhe pa e lëshuar nga dora pushkën me tytë të shkurtuar, doli në rrugë. Asnjëri prej shokëve të tij – Toni, Estreja Sadalai dhe Amaditoja – nuk e shoqëroi. Nga brenda makinës shihnin siluetën e tij të plotë, e përvijuar përmes hijeve nga ndriçimi i dobët i hënës, tek drejtohej për nga Volksvageni i vogël me drita të shuara që kishte ndaluar afër tyre.
-Mos më thuaj që Shefi ndërroi mendje, - i tha i shqetësuar Antonioja, pa e përshëndetut, duke e futur kokën nga dritarja dhe duke iu afruar fytyrës së shoferit që ishte vetëm në makinë. Ishte një burrë guluçes, me kostum dhe kravatë, aq i trashë, sa të çudiste se si kishte mundur të hynte në autoveturë, nga e cila dukej se s'do të dilte dot më.
-Përkundrazi, Antonio, - e qetësoi Migel Anhel Baes Dias me duart e shtrënguar në timon. - As bëhet fjalë fare. Do të shkojë në San Kristobal. U vonua sepse pas shëtitjes në Malekon, çoi Pupo Romanin në Bazën e San Isidros. Erdha të të qetësoj. E merrrja me mend padurimin tënd. Pritet të vijë në çdo çast. Jeni gati.
-Do ta mbarojmë, Migel Anhel. Shpresoj që edhe ju të bëni tuajën.
Folën një çast me fytyrat pranë e pranë. Trashaluqi mbante timonin mbërthyer, ndërsa De la Masa, i paqetë, hidhte vështrime mbi rrugën që vinte nga Qyteti Truhijo, se mos dukej autovetura e shumëpritur dhe ai nuk ndodhej te vendi i duhur në makinën e vet.
-Mirupafshim dhe ju vaftë mbarë, - përshëndeti Migel Anhel Baes Dias që u nis në drejtim të Qytetit Truhijo, gjithmonë me drita të shuara.
Në këmbë, duke ndier ajrin e freskët e duke dëgjuar dallgët që përplaseshin aty pranë – ndiente piklat e ujit t'i njomnin fytyrën dhe flokët që filluan t'i zbuteshin – Antonioja pa të largohej

autovetura e Migel Anhelit dhe pastaj të zhytej tutje në natën e errët, ku regëtinin dritat e qytetit dhe të restoranteve, sigurisht plot me njerëz. Migel Anheli dukej i sigurt. Pra, pa dyshim: Do të vinte edhe këtë të martë, 30 mars të vitit 1961 dhe ai do të plotësonte më në fund betimin e bërë në pronën familjare në Moka, para të atit dhe vëllezërve, kunatave dhe kunetërve, katër vjet e katër muaj më parë, më 7 janar të vitit 1957, ditën që varrosën Taviton.
Mendoi se sa afër ishte lokali Poni dhe sa mirë do të ishte të ulej diku në ato karriget prej kashte, të larta, të barit, të hidhte një gotë rum me akull, siç bënte shpesh kohët e fundit; të ndiente alkolin t'i pushtonte trurin dhe t'ia largonte mendjen nga Tavitoja, nga hidhërimi, nga pezmi dhe nga ethet që nuk po i ndaheshin që kur vrasësi burracak i mori jetën njeriut më të afërt, më të dashur, vëllait të tij të gjashtë. "Mbi të gjitha, me shpifjet e turpshme që u përhapën, e vranë për së dyti", mendoi. U kthye ngadalë te Shevroleti. Ishte një nga autoveturat flakë e re që Antonioja e kishte sjellë nga Shtetet e Bashkuara dhe e kishte përsosur edhe më, duke i thënë mjeshtrit se si pronar tokash dhe administrator i sharrave në Restauracion, në kufi me Haitin, i duhej një makinë e shpejtë dhe e fortë. Kishte ardhur çasti ta vinte në provë atë Shevrolet të modelit të fundit, e aftë, falë përforcimit në orë në pak minuta, të bënte 200 kilometra në orë në pak minuta, gjë që autoveturat e Gjeneralisimit nuk mund t'i arrinin dot. U kthye dhe u pranë Antonio Imbertit.
-Kush ishte? - pyeti Amadoja nga vendi prapa.
-Nuk pyetet për këto gjëra, - tha nëpër gojë Toni Imberti, pa u kthyer ta shihte togerin Garsia Gerrero.
-Nuk është më sekret tani, - tha Antonio de la Masa. - Ishte Migel Anhel Baes. Kishte të drejtë, Amadito. Do të shkojë në San Kristobal sonte, patjetër. U vonua, pot nuk po presim kot.
-Migel Anhel Baes Dias? - gati ulëriti Salvador Estreja Sadalai. - Edhe ai është përzier në këtë? Ai është një truhijist ontologjik. A nuk ka qenë nënkryetar i Partisë Domenikane? Është nga ata që e shoqërojnë çdo ditë Cjapin në Malekon, duke i lëpirë bythën. Edhe në Hipodrom e shoqëron çdo të diel.
-Edhe sot ka shëtitur me të, - pranoi De la Masa. - Prandaj e di që do të vijë patjetër.

-Unë e di se duhet të jem praktik, ngaqë e do puna, - mori frymë Turku. Po, ç'është e vërteta, ndiej neveri që dikush si Migel Anheli të bëhet tani aleati ynë.
-Ja, e nxorri kokën fanatiku, puritani, engjëlli i duarve të pastra, - thumboi me shaka Imberti. - E sheh, Amadito, se është më mirë të mos pyesësh, të mos dish gjë fare se kush është në këtë mes?
-Ti, Salvador, flet sikur asnjë nga ne të mos ketë qenë truhijist, - tha nëpër dhëmbë Antonio de la Masa. A nuk ishte Toni guvernator në Puerto Plata? A nuk është Amaditoja adjudant ushtarak? A nuk po administroj unë qysh prej njëzet vjetësh sharrat e Cjapit në Restauracion? Po kompania e ndërtimit ku punon ti, nuk është e Truhijos?
-E tërheq atë që thashë, - Salvadori i hodhi dorën në krah De la Masës. - Më shpëtoi fjala dhe thashë një budallallëk. Keni të drejtë. Kushdo mund të thotë për ne atë që sapo thashë për Migel Anhelin. Shkurt, s'kam thënë asgjë dhe s'keni dëgjuar asgjë.
Por e kishte thënë, sepse, megjithë sjelljen e qetë dhe të arsyeshme, që aq shumë u pëlqente të gjithëve, nganjëherë Salvadori, i pushtuar nga një shpirt drejtësie, rrëmbehej e thoshte gjërat më mizore. I kishte thënë njëherë atij, mikut të jetës, në një bisedë: "Unë nuk do ta kisha vrarë atëherë...". Antonio de la Masa ia kishte vrarë atëherë... Kjo frazë që i ndau për gjashtë muaj, pa u parë e pa folur me njëri-tjetrin, i përsëritej herë pas here si një ëndërr e keqe. Në ato çaste, ndiente nevojën të hidhte disa gota rum njëra pas tjetrës. Edhe pse i dehur tapë, e rrëmbyente një tërbim i verbër, që e kthente në grindavec dhe fillonte t'i provokonte e t'i zinte me grushte e shqelma njerëzit përreth.
Me dyzet e gjashtë vitet që sapo kishte mbushur, ishte më i madhi në grupin prej shtatë vetësh që rrinte gjatë rrugës së San Kristobalit duke pritur Truhijon. Se, veç këtyre të katërve që prisnin në Shevrolet, dy kilometra më tej ndodheshin Pedro Livio Sedenjo dhe Uaskar Teheda Pimenteli, në një autoveturë të huajtur nga Estreja Sadalai. Dhe një kilometër akoma më përpara, ishte Roberto Pastorisa Nereti, i vetëm në makinën e tij. Kësisoj do t'ia bllokonin kalimin dhe do ta grinin me zjarr nga të dy anët, pa i lënë rrugë shpëtimi. Pedro Livio dhe Uaskari ishin të përbethur dhe prisnin në ankth sikurse ata të

katërt. Ndërsa Robertoja edhe më shumë i shqetësuar, sepse ishte vetëm dhe s'kishte me kë të shkëmbente kurajo. "Do të vinte?" Po, do të vinte. Dhe kalvari i gjatë në jetën e Antonios, i filluar qysh nga vrasja e Tavitos, do të mbaronte.
Hëna, e rrumbullt si një monedhë, vullonte e shoqëruar nga një mantel yjesh dhe u hidhte argjend degëve të palmave aty pranë, që Antonioja i shikonte si lëkundeshin ritmikisht prej flladit të lehtë. Megjithatë të keqen që e kishte pllakosur, ky vend ishte i bukur. Po do të ishte edhe më i bukur pas vdekjes së atij të mallkuari, i cili e kishte dhunuar dhe helmuar në këto tridhjetë e një vite shumë më tepër se gjatë shekujve që shkoi nën dyndjen haitiane, pushtimin spanjoll dhe amerikan, luftërat civile dhe mudit fraksioneve e prijësve, shumë më tepër se të gjithë fatkeqësitë – tërmetet, ciklonet – që ishin derdhur mbi domenikanët nga qielli, deti apo fundi i tokës. Ajo që nuk mund t'ia falte Cjapit mbi të gjitha ishte, ashtu siç e kishte çnderuar dhe poshtëruar këtë vend, kishte çnderuar dhe poshtëruar edhe Antonio de la Masën.
E fshehu angështimin para shokëve të vet, duke ndezur një cigare tjetër. E thithte cigaren pa e hequr nga buzët, duke e nxjerrë tymin nga goja dhe hundët, ledhatonte skopetën grykëshkurtër, duke menduar për plumbat e përforcuar me çelik, që i bëri njohu falë një komplotisti tjetër, Manuel Ovin, ekspert për armët dhe qitës i shkëlqyer. Po aq i mirë sa edhe vetë Antonio de la Masa, i cili qysh fëmijë, në pronat familjare në Moka, i admiroi gjithmonë prindërit, vëllezërit, të afërmit dhe miqtë si shenjues. Prandaj i kishin lënë vendin e privilegjuar, në të djathtë të shoferit: për të qëlluar i pari. Pasi diskutuan aq shumë për gjithçka, kishin rënë dakort: Antonio de la Masa dhe togeri Amado Garsia Gerrero, qitësit më të mirë, do të merrnin pushkët e dërguara nga CIA për komplotistët dhe do të zinin vendet në të djathtë për të qëlluar të parët.
Njëra nga krenaritë për Mokën, tokën dhe familjen e tyre, ishte se qysh në çastet e para, qysh në vitin 1930, De la Masajt kishin qenë antitruhijistë. Në Moka, nga më i pasuri e deri te fshatari më i varfër, ishin të gjithë horacistë, sepse Presidenti Horacio Vaskes ishte nga Moka, vëllai i nënës së Antonios. Qysh ditën e parë, de la Masajt i panë me dyshim dhe antipati intrigat që përdori atëherë komandanti i brigadës së Policisë

Kombëtare – e krijuar nga i ngarkuari amerikan dhe menjëherë me ikjen e tij do të bëhej Ushtria Domenikane – Rafael Leonidas Truhijo, për të mundur don Horacio Vaskes në zgjedhjet e para të manipuluara në vitin 1930. Qe një histori e gjatë mashtrimesh elektorale që bëri për t'u zgjedhur President i Republikës. Kur kjo ndodhi, De la Masajt bënë atë që bënin familjet fisnike dhe prijësit krahinorë kur nuk u pëlqenin qeveritë: Dilnin malit të armatosur dhe të financuar me xhepin e tyre.
Pothuajse tre vjet, midis moshës shtatëmbëdhjetë dhe njëzetvjeçare, me ndërprerje jo të mëdha – si atlet, kalorës i palodhur, gjahtar i apasionuar, gazmor, kokëkrisur dhe qejfli në jetë – Antonio de la Masa, me të atin, ungjërit dhe vëllezërit u ngritën me armë kundër forcave të Truhijos, edhe pse nuk i dëmtuan. Pak nga pak, forcat shtetërore i shpërndanë bandat e armatosura, duke u shkaktuar ndonjë humbje, po mbi të gjitha duke blerë zhgënjësit dhe përkrahësit e tyre, derisa, të lodhur e gati të shkatërruar, De la Masajt përfunduan duke pranuar ofertën për paqe nga qeveria dhe u kthyen në Moka për të punuar tokat e tyre gjysmë të braktisura. Përveç të panënshtruarit dhe kryeneçit Antonio. Qeshi duke kujtuar këtë kokëfortësi të tij aty nga fundi i vitit 1932 e fillimi i vitit 1933, kur me më pak se njëzet vetë, mes të cilëve dhe vëllezërit e tij Ernesto e Tavito (ky ende fëmijë), sulmonte posta policie dhe u bënte pritë patrullave ushtarake, të tre vëllezërit mund të shkonin përhërë në shtëpinë e tyre në Moka, për të fjetur disa herë në muaj. Po në një pritë që iu bënë në rrethinat e Tamborilit, ushtarët vranë dy nga njerëzit e tyre dhe plagosën Erneston dhe vetë Antonion.
Nga Spitali Ushtarak i Santiagos, i shkroi të atit, don Visentes, se nuk do të pendohej për asgjë dhe se për të mirën e familjes nuk do t'i vinte turp t'i kërkonte mëshirë Truhijos. Dy ditë pasi i dha këtë letër kryeinfermierit, bashkë me një bakshish të mirë për ta dërguar në Moka, erdhi një kamioçinë ushtarake me një shportë rrushsh, e marrën dhe e shpunë të lidhur në Santo Domingo. (Pas tre vjetësh Kongresi i Republikës do t'ia ndërronte këtë emër të lashtë kryeqytetit). Për çudi të djaloshit Antonio de la Masa, makina ushtarake, në vend ta çonte në burg, e çoi në Selinë e Qeverisë, atëherë pranë Katedrales

së Vjetër. Atje i hoqën prangat dhe e futën në një dhomë të shtruar me qilim, ku, me uniformë ushtarake, i rruar dhe i krehur pa të metë, e priste gjenerali Truhijo.
Ishte hera e parë që e shihte.
-Duhen koqe për të shkruar një letër të tillë, - kryetari i shtetit e tundte në dorë letrën. - Ke treguar që ke ke të tilla, duke më shpallur luftë gjatë tre vjetëve. Prandaj doja ta shihja fytyrën. Është e vërtetë që je shenjues i mirë? Do të matemi bashkë ndonjë ditë, të shohim nëse qëllon më mirë se unë.
Njëzet e tetë vjetë më pas, Antonioja po kujtonte atë zë të ashpër, atë përzemërsi që nuk e priste, të zbutur me një ton ironie. Dhe thellësinë e atyre syve, vështrimit të të cilëve – edhe pse tepër krenar – nuk mundi t'i rezistojë.
-Lufta mbaroi. I dhashë fund me të gjithë prijësit krahinorë, përfshi edhe De la Masajt. Mjaft me plumba. Duhet rindërtuar ky vend i bërë copa. I dua në anën time më të mirët. Je i rrëmbyer dhe do të ndeshesh. Apo jo? Mirë. Eja të punosh pranë meje. Do të kesh rastin të qëllosh. Të ofroj një vend të besuar midis adjutantëve ushtarakë të ngarkuar me ruajtjen time. Kështu, nëse ndonjë ditë do të zhgënjehesh, mund të më futësh një plumb.
-Por unë nuk jam ushtarak, - belbëzoi djaloshi De la Masa.
-Je. Qysh këtë çast, - tha Truhijo. - Toger Antonio de la Masa.
Që përulja e tij e parë, thyerja e parë ndaj atij mjeshtri manipulimi të të çiltërve, leshkove dhe budallenjve, ndaj atij përfituesi dinak të sqimës, lakmisë dhe marrëzisë së njerëzve. Sa vjet e pati Truhijon në dorë edhe më pak se një metër larg? Siç e kishte pasur edhe Amaditoja këto dy vitet e fundit. Dhe sa tragjedi do t'i kishte shmangur vendit, familjes së vet, nëse do ta kishte bërë me kohë këtë që donte të bënte tani. Tavito, sigurisht, do të ishte gjallë.
Dëgjonte prapa tij Amaditon dhe Turkun në kulmin e bisedës. Me sa pasion futej Imberti në bisedë. Nuk çuditeshin që Antonioja qëndronte i heshtur. Gjithmonë ishte fjalëpak, por fjalëpakësinë e kishte fituar në pjekuri, sidomos pas vdekjes së Tavitos, fatkeqësi që e dëmtoi aq sa e quante të pashërueshme, duke e kthyer në një njeri me idenë fikse: Të vriste Cjapin.
-Huan Tomasi duhet të jetë i nervoruar më keq se ne, - dëgjoi t'i thoshte Turkut. - S'ka gjë më të tmerrshme se sa të priturit. Ore, do të vijë apo jo?

– Gati të vijë, - u përgjigjua togeri Garsia Gerrero. - Besomë, dreqi ta hajë!
Po, gjenerali Huan Tomas Dias duhet të ishte në këto çaste në shtëpinë e tij në Gaske, duke ngrënë thonjtë, duke vrarë mendjen nëse, më në fund, kishte ndodhur ajo që ai dhe Antonioja kishin ëndërruar, përgatitur, farkëtuar, mbajtur gjallë e në fshehtësi të plotë për katër vjet e katër muaj. Pra, qysh nga dita kur pas atij takimi të mallkuar me Truhijon (sa e kishin varrosur Taviton), Antonioja u hodh në makinën e vet dhe me 120 kilometra në orë, vajti të takonte Huan Tomasin në pronën e tij në La Vega.
– Për njëzet vjet miqësi që na bashkon, ndihmomë. Duhet ta vras! Duhet të marr hakun e Tavitos, Huan Tomas!
Gjenerali i mbylli gojën me dorë. Hodhi një vështrim rrotull, duke i bërë shenjë se mund t'i dëgjonte shërbëtori. E çoi paa stallave ku zakonisht bënin qitje.
– Bashkë do ta bëjmë, Antonio. Për t'i marrë hakun Tavitos dhe sa e sa domenikanëve, për turpin që mbajmë mbi vete.
Antonioja dhe Huan Tomas i ishin miq të ngushtë, qysh kur De la Masa qe adjutant ushtarak i Bamirësit. Të vetmin njeri të mirë që kujtonte në tërë ato vite që shërbeu si oficer pranë Gjeneralisimit, i cili e shoqëronte në udhëtimet brenda vendit, në daljet nga Selia e Qeverisë, në Kongres, në Hipodrom, në pritje dhe shfaqje, në mitingje politike dhe aventura erotike, në vizita dhe takime me ortakë, aleatë e bashkëpunëtorë, në mbledhje publike, private apo tepër sekrete. Pa mundur të bëhej një truhijist i vendosur, siç ishte atëherë Huan Tomas Dias, Antonioja ato vite, edhe pse ruante fshehtësish diçka nga zemërimi i tërë horacistëve ndaj atij që i kishte dhënë fund karrierës politike të Presidentit Horacio Vaskes, nuk mundi t'i shmangej magnetizmit që rrezatonte Gjeneralisimi, ai njeri i palodhshëm që mund të punonte njëzet orë rresht dhe pastaj, me dy-tri orë gjumë, të fillonte përsëri pa gdhirë mirë, i freskët si një adoleshent. Ai njeri që, sipas besimit popullor, nuk djersinte e nuk flinte, kurrë nuk kishte një rrudhë në uniformë, në frak apo në kostumin e thjeshtë dhe që në vitet kur Antonioja bënte pjesë në gardën e hekurt, në të vërtetë po e transformonte këtë vend. Për rrugët, urat dhe industrinë që ndërtoi mirë, po e grumbullonte në duart e veta tërë pushtetin - politik, ushtarak, institucional, social, ekonomik

– një pushtet aq të pakufishëm, sa tërë diktatorët që kishte mbajtur në kurriz Republika Domenikane gjatë historisë së vet. Ulises Hëréz (Lilís), i cili dikur ishte dukur aq mizor, në krahasim me Truhijon, ishte një engjëll.
Ai respekt dhe ajo magjepsje, në rastin e Antonios, nuk u shndërrua kurrë në admirim, as në dashuri servile e të ulët që i shprehnin udhëheqësit të tyre plot truhijistë të tjerë. Edhe Huan Tomasi, i cili që nga viti 1957 kishte diskutuar me të gjitha format e mundshme, për ta çliruar Republikën Domenikane nga ajo figurë shushonjëse dhe shtypëse; në vitet dyzet qe ndjekës fanatik i Bamirësit, i gatshëm të bënte çdo krim për njeriun, të cilin e pandehte shpëtimtarin e Atdheut, burrin e shtetit që ktheu në duart e domenikanëve doganat, të administruara nga jankit deri atëherë, që zgjidhi problemin e borxhit të jashtëm me Shtetet e Bashkuara, duke fituar prej Kongresit titullin Arkitekt të Pavarësisë Ekonomike, që krijoi Forcat e Armatosura moderne dhe profesionale, më të pajisurat në tërë Karaibet. Në ato vite, Antonioja as që kishte guxuar t'i fliste keq për Truhijon, Huan Tomas Diasit. Ky i fundit ngjiti shkallët në Ushtri, derisa u bë gjeneral me tre yje dhe arriti komandën e Rajonit Ushtarak të La Vegas, ku edhe e zuri sulmi i 14 korrikut 1959, që ishte dhe fillimi i fatkeqësisë së tij. Pasi ndodhi kjo, Huan Tomasi nuk kishte më iluzione për regjimin. Në intimitet, kur ishte i sigurt se nuk e dëgjonte njeri, gjatë gjahut nëpër kodra, në Moka apo La Vega, në drekat familjare të dielave, i rrëfente Antonios se gjithçka e turpëronte: Vrasjet, zhdukjet, torturat, pasuria e jetës, korrupsioni dhe dorëzimi i trupave, i shpirtrave dhe i ndërgjegjes së milionave domenikanëve ndaj një njeriu të vetëm.
Antonio de la Masa kurrë nuk kishte qenë një truhijist me zemër. As kur ishte adjutant ushtarak, as më pas, kur, pasi kërkoi leje për të dalë në lirim, punoi për të si civil, duke administruar sharrat e familjes Truhijo në Restauracion. Shtrëngoi dhëmbët i neveritur: Kurrë s'kishte pushuar së punuari për Shefin. Si ushtarak apo si civil, për njëzet e dy vjet me radhë, punonte për fatin dhe pasurinë e Bamirësit dhe Babait të Atdheut të Ri. Qe dështimi i madh i jetës së vet. Kurrë nuk diti të dilte nga kurthet që i kurdiste Truhijo. Duke e urryer me gjithë shpirt, kishte vazhduar t'i shërbente edhe pas vdekjes së Tavitos. Prandaj e kishte fyer turku: "Unë nuk do ta shisja

– vëllain për pesë groshë". Ai nuk e kishte shitur Taviton. Nuk e dha veten, duke e gëlltitur hidhërimin. Ç'mund të bënte tjetër? Ta linte veten që ta vrisnin agjentët e Xhoni Abesit dhe të vdiste me ndërgjegje të qetësuar? Po Antonioja nuk hahej nëse e kishte ndërgjegjen e qetë apo jo të qetë. Ai duhej të hakmerrej për Taviton. Për të arritur këtë, duhej t'i hidhnin përsipër bëzhdile e lëmishter, deri edhe fjalët vrasëse që i tha miku i tij më i dashur, që ishte i sigurt se i thonin edhe të tjerë pas shpine.
Ai nuk e kishte shitur Taviton. Ai, vëllai i vogël, ishte edhe një mik i shtrenjtë për të. Më çiltërsinë e tij, me pafajsinë e tij prej djaloshi të mirë, Tavitoja, ndryshe nga Antonioja, qe një truhijist i bindur, njëri prej atyre që besonte te Shefi, si te Perëndia. Debatonin shpesh, sepse Antonioja nuk duronte dot që vëllai i tij i vogël t'i përsëriste refrenin se Truhijo qe një dhuratë e rënë nga qielli për vendin. Në të vërtetë Tavitos, Gjeneralisimi i kishte bërë favorë. Falë një urdhëri të tij, u pranua në Aviacion dhe u bë pilot. Ëndrra fëminore e tij. Më vonë hyri në Aviacionin Domenikan, gjë që i mundësonte udhëtime të shpeshta në Majami, gjë që si një djalë i ri e lumturonte, sepse atje do të gjente bjondina pa numër. Më përpara, Tavitoja kishte qenë në Londër si atashe ushtarak. Atje, i dehur e në grindje e sipër, vrau me një të shtënë konsullin domenikan, Luis Bernardino. Truhijo e shpëtoi nga burgu, duke kërkuar për të imunitetin diplomatik dhe duke urdhëruar gjykatën e Qytetit Truhijo, që e gjykoi, ta nxirte të pafajshëm. Po, Tavitoja kishte plot arsye t'i ishte mirënjohës Truhijos dhe i kishte thënë Antonios se: "Jam gati të jap jetën për Shefin dhe të bëj çdo gjë që të më urdhërojë". Frazë profetike, vërtet.
"Po, jetën dhe për të", mendoi, duke thithur cigaren. Çështja ku Tavitoja ishte përzier në vitin 1956, Antonioja nuk i kishte pëlqyer qysh në krye. I vëllai i kishte thënë se nuk i fshihte asgjë. Dukej si ndonjëra prej atyre bëmat e turbullta, me të cilat historia domenikane ishte plot qysh nga ardhja në pushtet e Truhijos. Në vend të shqetësohej, të trembej dhe të hapte sytë me misionin që i kishin ngarkuar - të shkonte të merrte në Montekristi, me një Cessna të vogël, një njeri të fshehtë, të droguar, të cilin e kishin sjellë me avion nga Shtetet e Bashkuara, dhe ta çonte në fermën Fundasion, në San Kristobal - u kënaq duke e marrë si shenjë besimi që Gjeneralisimi

kishte ndaj tij. Edhe kur shtypi i Shteteve të Bashkuara dha alarmin dhe Shtëpia e Bardhë filloi presionet që qeveria domenikane të lehtësonte hetimet mbi sekuestrimin në Nju Jork të profesorit bask Hesus de Galindes, Tavitoja nuk tregoi më të voglin shqetësim.

– Kjo puna e Galindesit më duket shumë serioze, - e paralajmëroi Antonioja. - Ai ishte njeriu që çove nga Montekristi në pronën e Truhijos, kush mund të ishte tjetër. E sekuestruan në Nju Jork dhe e sollën këtu. Kujdes. Leri të gjitha. Po luan me jetën tënde, vëlla.

Tani Antonio de la Masa kishte një ide se ç'kishte ndodhur me Hesus de Galindesin, njeri prej republikanëve spanjollë, të cilëve Truhijo u kishte dhënë azil në Republikën Domenikane në mbarim të luftës civile. Nuk e kishte njohur atë profesor, por shumë miq të tij, po. Nga ata mori vesh se ai kishte punuar për qeverinë në Sekretarinë e Shtetit për Punën dhe në Shkollën Diplomatike, në varësi të Ministrisë së Jashtme. Në vitin 1946, Galindesi e la Qyetetin Truhijo dhe u vendos në Nju Jork, prej nga filloi të ndihmonte të mërguarit domenikanë dhe të shkruante kundër regjimit të Truhijos, që e njihte nga brenda.

Në mars të vitit 1956, Hesus de Galindesi, tashmë qytetar amerikan, u zhduk pasi qe parë të dilte për herë të fundit nga një stacion metroje në Broduej, në zemër të Manhatanit. Kishte disa javë që ishte shpallur botimi i një libri të tij mbi Truhijon, të cilin e kishte prezantuar si tezë doktorature në Universitetin Kolumbia ku jepte mësim. Zhdukja e një azilanti të thjeshtë spanjoll, në një qytet dhe në një vend ku zhduken plot njerëz, do të kishte kaluar në heshtje dhe askush nuk do t'ia vinte reshin zhurmës që bënë mërguart domenikanë për motivet e kësaj zhdukjeje, nëse Galindesi nuk do të kishte qenë qytetar amerikan dhe, mbi të gjitha, bashkëpunëtor i CIA-s, siç u zbulua pas shpërthimit të skandalit. Propoganda e fuqishme me gazetarë, kongresistë, bashkiakë, avokatë dhe afaristë që Truhijo kishte në Shtetet e Bashkuara, nuk mundi ta përballonte zhurmën që bëri shtypi, duke filluar nga "The New York Times" dhe mjaft kongresistë, se si ishte e mundur që një diktator qesharak karaibas, të arrinte të sekuestronte dhe të vriste një qytetar amerikan në territorin e Shteteve të Bashkuara.

Në javët dhe muajt në vazhdim për zhdukjen e Galindesit

- trupi i tij nuk u gjet kurrë - u bënë hulumtime dhe hetime nga shtypi dhe FBI-ja dhe u zbulua përfundimisht përgjegjësia e plotë e regjimit. Pak përpara ngjarjes, gjenerali Espajat, Nenshteri, shefi i Shërbimit Sekret, ishte emëruar konsull domenikan në Nju Jork. FBI-ja gjeti prova kompromentuese rreth Galindesit, për Minerva Bernardinon, diplomate domenikane pranë OKB-së dhe mjaft e besuar për Truhijon. Dhe akoma më keq, FBI-ja indetifikoi një avion të vogël, me matrikull të falsifikuar, i drejtuar nga një pilot i panjohur, avion që ishte ngritur ilegalisht nga një aeroport i vogël në Long Island dhe kishte fluturuar në drejtim të Floridës natën e sekuestrimit. Piloti quhej Murfi dhe qysh prej asaj dite ndodhej në Republikën Domenikane, duke punuar në Aviacionin Domenikan. Murfi dhe Tavitoja fluturonin bashkë dhe ishin bërë shumë miq.
  Këto qenë copëza lajmesh që Antonioja i dëgjonte nga stacionet e radiove të Porto Rikos, Venezuelës apo në "Zëri i Amerikës", që mund t'i kapte me valë të shkurtra ose nga ndonjë gazetë, si "Majami Herald" dhe "The New York Times", që hynin në vend nga xhepat dhe uniformat e pilotëve dhe stjuardesave, sepse censura nuk i lejonte gazetat dhe radiot domenikane të flisnin për këtë gjë.
  Kur, gjashtë muaj pas zhdukjes së Galindesit, emri i Murfit doli në shtypin ndërkombëtar, si piloti i avionit që nxori një Galindes të droguar nga Shtetet e Bashkuara dhe e solli në Republikën Domenikane, Antonioja, i cili e njihte Murfin nga Tavitoja - kishin ngrënë bashkë të tre një drekë të shoqëruar me verë Rioha në Kasa de Espanja, në rrugën Padre Billini - u hodh në kaminionçinën e tij, atje në Tiroli, pranë kufirit haitjan dhe me mendjen që po i ziente nga një mijë mendime të mbrapshta, me gazin e shkelur deri në fund, sosi në Qytetin Truhijo. E gjeti Taviton shumë të qetë në shtëpinë e vet, duke luajtur letra me Altagrasian, gruan e tij. Për të mos e shqetësuar kunatën, Antonioja e mori të vëllanë dhe shkuan te lokali plot zhurmë Tipiko Nahajo, ku, falë muzikës së Kombo de Ramon Gajardos dhe këngëtarit Rafael Martinesit, mund të flisje pa të dëgjuar veshët kureshtarë. Atje, pasi porositi një makiato dhe dy shishe birrë President, Antonioja i tha se duhej të hynte menjëherë në ndonjë ambasadë për strehim politik. I vëllai filloi të qeshte: Ç'ishte kjo marrëzi. S'dinte gjë që emri i Murfit

– ishte kudo në shtypin amerikan. Nuk u alarmua fare. Besimi i tij te Truhijo qe i patundur, si dhe çiltërsia e tij.
– Duhet të lajmëroj gringon, - i tha Antonios së habitur. - Është duke shitur gjërat e veta, ka vendosur të kthehet në Shtetet e Bashkuara, të martohet. Ka të dashurën në Oregon. Po të shkojë atje, do ta fusë kokën në gojë të ujkut. Këtu s'do ta gjejë asgjë. Këtu është Gjeneralisimi, vëllaçko.

  Antonioja e ndërpreu. Pa e ngritur zërin që të mos tërhiqte vëmendjen e tavolinave fqinje, me një zemërim të shurdhër dhe plot seriozitet, u përpoq ta bindte:
– Nuk po e merr vesh, torollak? Është tepër e rëndë gjendja. Sekuestrimi i Galindesit e ka futur Truhijon në një situatë shumë delicate me jankit. Të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë sekuestrim janë në presë të briskut. Murfi dhe ti jeni dëshmitarë tepër të rrezikshëm. Ti, më shumë nga Murfi. Sepse ti e çove Galindesin në fermën Fundasion, në shtëpinë e vetë Truhijos. A ke tru në kokë?
– Unë nuk çova Galindesin atje, - nguli këmbë i vëllai, duke çokur gotën me të tijën. - Unë çova një tip që nuk e di kush ishte, një të dehur të humbur. Nuk di gjë më shumë. Po pse nuk ke besim te Gjeneralisimi? Pse ai do të besoi tek unë për një mision aq të rëndësishëm?

  Kur u ndanë atë natë te dera e shtëpisë së Tavitos, më në fund ky, pasi vëllai i madh këmbënguli shumë, i tha të mos shqetësohej se do ta mendonte mirë atë punë dhe do të heshhte.

  Ishte hera e fundit që Antonioja e shikonte të gjallë. Tri ditë pas asaj bisede, Murfi u zhduk. Kur Antonioja u kthye në Qytetin Truhijo, Taviton e kishin arrestuar. E kishin izoluar në Viktoria. Antonioja kërkoi takim me Gjeneralisimin, po ai nuk e priti. Deshi të fliste me kolonel Kobian Parra, shef i SIM-it, po ai nuk dihej ku ishte dhe, pak më pas, një ushtar e vrau në zyrën e vet me urdhër të Truhijos. Gjatë dyezet e tetë orëve në vazhdim, Antonioja foli në telefon dhe takoi gjithë autoritetet dhe funksionarët e lartë që njihte, nga kryetari i Senatit, Agustin Kabral, deri te kryetari i Partisë Domenikane, Alvares Pina. Të tërë gjithë po të njëjtin shqetësim. Të gjithë i thanë se, për të mirën e tij dhe të tyre, të mos i kërkonte ndihmë askujt. "Ishte si t'i bije murit me kokë", i tha më vonë Antonioja, gjeneralit Huan Tomas Dias. Në qoftë se Truhijo do ta kishte pri-

– tur, do t'i lutej, do t'i binte në gjunjë, çdo gjë do të bënte për të shpëtuar Taviton.
Më vonë, një mëngjes, një autoveturë e SIM-it me kalecë të armatosur me automatikë, ndaloi te porta e shtëpisë së Oktavio de la Masas. Nxorën kufomën e tij dhe pa kurrfarë nderimi e hodhën në oborrin e vogël të hyrjes, midis luleve. Kur Altagrasia doli te dera me këmishën e gjumit dhe e tmerruar, e pa dhe ata duke u larguar, i thirrën:

– Yt shoq vari veten në burg. E sollëm ta varrosni, si e do Zoti.
Po nuk ishte kjo më e keqja, mendoi Antonioja. Jo. Të shikosh kufomën e Tavitos, me litarin e gjoja vetëvarjes në grykë, të hedhur si një qen në pragun e shtëpisë së vet nga një takëm rrufjanësh me patentë, siç ishin kalecat e SIM-it, jo, kjo s'qe më e keqja. Antonioja e kishte përsëritur këtë me dhjetëra, qindra herë, këto katër vjet e gjysmë, ndërsa ia përkushtonte ditët dhe mbetur, të gjithë forcat mendore dhe shpirtërore që i kishin mbetur, hakmarrjes, të cilën këtë natë - Zoti e bekoftë - do ta konkretizonte. Më e keqja qe vdekja e dytë e Tavitos, disa ditë më vonë, kur, duke përdorur gjithë makinën informative dhe publicistike, "Karaibet" dhe "La Nacion", radiotelevizionin "Zëri domenikan", radiot "Zëri i Tropikut", "Radio Karaibe" dhe një duzinë gazetash e radiosh krahinore, regjimi, në një nga maskaradat më mizore të tij, publikoi një letër, kinse dorëshkrim i Oktavio de la Masës, ku shpjegonte shkakun e vetëvrasjes: Brerja e ndërgjegjes se kishte vrarë pilotin Murfi, mikun dhe shokun e vet të Aviacionit Domenikan. Duke mos u mjaftuar duke e vrarë, Cjapi, për të fshirë gjurmët e historisë së Galindesit, pati idenë makabre ta shpallë Taviton vrasës. Kështu i hoqi qafe dy dëshmitarët e mërzitshëm. Dhe, për ta bërë edhe më poshtëruese, letra e shkruar kinse nga Tavitoja, shpjegonte pse e kishte vrarë Murfin: Punë homoseksualiteti. Amerikani e kishte kapur Taviton, ngaqë kishte rënë në dashuri me të dhe ky i fundit, duke reaguar me zemërimin e një mashkulli të fyer, mbrojti nderin e vet dhe e vrau atë të degjeneruar. Pastaj e fshehu krimin me alibinë e një aksidenti.
Iu desh të përkulej te vendi në Chevrolet, duke shtrënguar pushkën fort mbi bark, për të përballuar një dhimbje që sapo e kapi. E shoqja kishte ngulur këmbë të shkonte te mjeku,

– sepse mund të kishte ulcer ose diçka më keq, po ai s'ia kishte vënë veshin. Nuk kishte nevojë për mjek, pasi e dinte se shëndeti i tij qe keqësuar këto vitet e fundit për shkak të hidhërimit shpirtëror. Pas asaj që ndodhi me Taviton, humbi tërë iluzionet, entuziazmin dhe dashurinë për këtë jetë, por dhe për atë tjetrën. Vetëm ideja e hakmarrjes e mbante në këmbë. Jetonte vetëm për të plotësuar betimin që kishte bërë me zë të lartë dhe që u kishte shtirë frikën banorëve të Mokës që shoqëronin De la Masajt - prindër, vëllezër dhe motra, nuse dhe kunata, bij, nipër, ungjër, teze, halla - gjatë përcjelljes së Tavitos:
– Për atë Zot në qiell, do ta vras me duart e mia atë maskara që na bëri këtë!
Të gjithë e dinin se e kishte fjalën për Bamirësin, Babanë e Atdheut të Ri, Gjeneralisimin, doktor Rafael L. Truhijo Molina, i cili kishte dërguar një kurorë të madhe me lule të freskëta e plot aromë për ceremonialin. Familja De la Masa nuk guxoi të mos e pranonte, as ta hiqte nga ai vend aq i dukshëm, se të gjithë ata që kalonin pranë arkivolit, për të bërë kryqin dhe për të thënë lutjen, e morën vesh se Gjeneralisimi shprehte dhimbje për vdekjen tragjike të atij aviatori, "njëri nga më të besnikët, më të afërmit dhe më guximtarët prej ithtarëve të mi", siç lexohej në shënimin e ngushëllimit.
Një ditë pas varrimit, dy adjutantë të Shefit të Pallatit zbritën nga një Kadillak me targa shtetërore te shtëpia e De la Masajve, në Moka. Kërkonin Antonion.
– Do të më arrestoni?
– Kurrsesi, - nxitoi të sqaronte togeri Roberto Figeroa Karrion. - Shkëlqesia e tij dëshiron t'ju takojë.
Antonioja nuk e pa të udhës të fuste ndonjë pistoletë në xhep. E dinte se, para se të hynte në Pallat, nëse do ta çonin atje dhe jo në Viktoria apo Kuarenta, ose nëse nuk do ta hidhnin në ndonjë humnerë, do ta çarmatosnin. Nuk kishte fare rëndësi për të. E njihte forcën e vet. Dihte gjithashtu që kjo forcë dyfishohej nga urrejtja për vrarë tiranin, siç qe betuar. Ishte i vendosur ta bënte, edhe pse e dinte se do ta vrisnin. Le ta paguante me atë çmim, vetëm të mbaronte punë me tiranin që i kishte shkatërruar jetën atij dhe familjes së tij.
Me të zbritur nga autovetura zyrtare, adjutantët e shoqëruan deri te zyra e Bamirësit, pa e kontrolluar fare. Oficerët duhet

- të kishin udhëzime të sakta: Sapo zëri i veçantë, i rreptë iu përgjigj "Hyr", togeri Roberto Karrion dhe shoku i vet, u shmang, e la të hynte vetëm. Zyra ishte në gjysmëerrësirë, ngaqë grilat e dritares që shihte nga kopshti, ishin të mbyllura përgjysmë. Gjeneralisimi ishte në tryezën e vet, i veshur me një uniformë që Antonios nuk i kujtohej: xhaketë ushtarake e bardhë dhe e gjatë, me bishta, me kopsa ari dhe me supore të mëdha me thekë të praruar mbi gjoks, ku varej një shumicë medaliesh dhe dekoratash shumëngjyrëshe. Pantallonat i kishte prej stofi të hollë, ngjyrë e kaltër, me vijë të bardhë anash. Duket se qe përgatitur të merrte pjesë në ndonjë ceremoni ushtarake. Drita e llambushkës i ndriçonte fytyrën e rruar me kujdes, me mustaqkat e vogla, imitim nga Hitleri (të cilin, Antonioja kishte dëgjuar ndonjëherë të thonin se, Shefi e admironte "jo për idetë, po për mënyrën e veshjes dhe drejtimin e parakalimeve"). Ai shikim i sigurt e mbërtheu Antonio sapon kapëceu pragun e derës. Pasi e kishte vëzhguar mirë, Truhijo i ishte drejtua atij:
- E di që mendon se Oktavioja është vrarë me urdhrin tim dhe që vetëvrasja është një farsë e sajuar nga Shërbimi Sekret. Të kanë sjellë këtu të të them personalisht se gabohesh. Oktavioja qe njeri i regjimit. Gjithmonë besnik, një truhijist i vërtetë. Sapo kam krijuar një komision, të kryesuar nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës, juristi Francisko Elpidio Beras. Me fuqi të plotë për të hetuar gjithëkënd, ushtarakë e civilë. Në qoftë se vetëvrasja është gënjeshtër, fajtorët do ta paguajnë, - i fliste pa armiqësi, pa i mëshuar theksit, duke e parë ngulshëm dhe ngrohtësim, siç shikonte gjithmonë vartësit, miqtë dhe armiqtë.
  Antonioja qëndronte i palëvizur, më i vendosur se kurrë të hidhej mbi atë mashtrues dhe ta mbërthente për gryke, pa i lënë kohë të kërkonte ndihmë. Si për t'ia lehtësuar këtë ndërmarrje të guximshme, Truhijo u ngrit në këmbë dhe bëri përpara drejt tij, me hapa të ngadaltë, solemnë. Këpucët e tij të zeza shkëlqenin shumë më tepër se dërrasat e dyllosura të zyrës.
- Po ashtu kam autorizuar FBI-në të vijë këtu për të hetuar lidhur me vdekjen e atij Murfit, - shtoi po me atë ton më të mprehtë. - Sigurisht që është një dhunim i sovranitetit tonë. Do të lejojmë gringot që policia jonë të shkonte për të hetuar vrasjen e

një domenikani në Nju Jork, Uashington apo Majami? Po, le të vijnë. Që bota ta dijë se nuk kemi asgjë për të fshehur.

Qëndroi një metër larg. Antonioja nuk mundi t'i rezistonte vështrimit të qetë të Truhijos dhe përdrodhi qerpikët.

– Mua nuk më dridhet dora, kur duhet të vras, - shtoi pas një pauze. - Të qeverisurit kërkon ndonjëherë t'i lyesh duart me gjak. Dhe e kam bërë shumë herë për këtë vend. Por jam një njeri që e njeh nderin. Besnikët i çmoj, nuk i vras. Oktavio ishte besnik, njeri i regjimit, një truhijist i provuar. Prandaj rrezikova që të mos dënohej, kur i shkau dora dhe vrau Luis Bernardinon në Londër. Vdekja e Oktavios do të hetohet. Hi dhe familja jote mund të merrni pjesë në komision, - ai u ktheye përgjysmë dhe me të njëjtën mënyrë të qetë, u kthye te tryeza.

Ende pas katër viteve e gjysmë, e pyeste veten: Pse nuk u hodh mbi të kur e pati aq afër? Jo se i besoi ndonjë fjalë të tij. Ajo që pjesë e farsës për të cilën Truhijo ishte aq i prirur dhe me të cilën diktatura mbulonte krimet e veta; ishte si një sarkazmë më shumë ndaj bëmave të kobshme, mbi çka ngrihej ajo diktaturë. Po pse, atëherë? Jo nga frika e vdekjes, sepse mes të metave që i njihte vetes, kurrë nuk ishte frika. Qysh nga koha kur u bë njëra nga harrakat dhe më tepër i vogël horacistësh luftoi kundër diktatorit, e kishte vënë jetën disa herë në rrezik. Ishte diçka më fine dhe e papërcaktueshme: Së frika: Ishte paralizë dhe mpirje vendosmërie, arsyetimi, vullneti të lirë që ai personazh i veshur shik, deri qesharak, me atë zëth flautik dhe sy hipnotizues, ushtronte mbi domenikanët e varfër apo të pasur, të ditur apo të paditur, miq apo armiq, të cilin e pati aq afër, dhe si vuv, i ngrirë, dëgjonte gënjeshtrat e tij, spektator i vetmuar i atij trillimi, i paaftë ta kthente në veprim vullnetin e vet për t'u hedhur mbi të dhe për t'i dhënë fund asaj nate të errët shtriganish në çka qe kthyer historia e vendit të tij.

– Veç kësaj, si provë që regjimi e konsideron familjen De la Masa një familje besnike, sot në mëngjes kam firmosur koncesionin e pjesës tënde për ndërtimin e rrugës Santiago-Puerto Plata.

Bëri një pauzë tjetër dhe duke lagur buzët me majën e gjuhës, përfundoi me një frazë që njëkohësisht jepte të kuptohej se takimi kishte mbaruar:

– Kështu që do të mund ta ndihmosh vejushën e Oktavios. E shkreta Altagrasia, do të jetë duke kaluar situatë të vështirë. Jepi dorën nga ana ime, po ashtu edhe prindërve të tu. Antonioja doli nga Pallati Kombëtar më i trullosur se dikush që ka pirë tërë natën. A ishte ai? I kishte dëgjuar vërtet ato që i tha ai burrë? Pranoi shpjegimet e Truhijos dhe, veç kësaj, një tregti përfituese, një pjatë thjerrëzash me të cilën do të fuste në xhep ka mijëra peso, për të gëlltitur hidhërimin dhe për t'u kthyer në një bashkëpunëtor, po, në një bashkëpunëtor për vrasjen e Tavitos? Pse nuk guxoi ta akuzonte, t'i thoshte se e dinte shumë mirë se ajo kufomë e hedhur te porta e së kunatës qe vrarë me urdhër të tij, sikurse dhe Murfi më parë, se maskarada e homoseksualitetit të pilotit gringo dhe brerjen e ndërgjegjes së Tavitos si shkak për ta vrarë atë, e kishte sajuar ai me diabolizmin e tij? Në vend që të kthehej në Moka, atë mëngjes Antonioja, pa ditur as vetë se si, shkoi te kabareja famëkeqe "Llamba e kuqe", te kryqëzimi i Visente Noble dhe Barahona, pronari i së cilës, Çmendaraku Frias, organizonte konkurse vallëzimi. Pa e kuptuar sa gota rum ktheu, i përhumbur, duke dëgjuar së largu merengat e krahinës Sibao (San Antonio, Con la alma, Juanita Morel, Jarro Pichao, etj.), një çast, pa kurrfarë shkaku, tentoi të qëllonte tamburistin e orkestrës që gjallëronte lokalin. Dehja ia errësoi mendjen. Godiste me grushte ajrin. Ra përtokë e s'mundi t'i ngrihej dot më.
Kur mbërriti në Moka një ditë më pas, i prishur në fytyrë e me rroba të ndotura, në shtëpi po e prisnin i ati, don Visente, vëllai, Ernestoja, nëna dhe Aida, e shoqja, me një pamje të trembur. E shoqja që i foli e para, duke u dridhur:

– Kudo flitet se Truhijo të ka mbyllur gojën, duke të dhënë rrugën nga Santiago në Puerto Plata. Sa njerëz flasin për këtë.
Antonioja kujtonte habinë e tij kur dëgjoi që Aida t'i çirrej përpara prindërve dhe Ernestos. Ajo ishte një grua tipike domenikane, e heshtur, e gjendur, e vuajtur, që kishte duruar dehjet e tij, aventurat e tij me gra të tjera, grindjet, netët e rënda jashtë shtëpisë dhe që e priste gjithmonë fytyrëqeshur, duke i ngritur moralin, duke qenë e gatshme t'i besonte arsyet kur ai guxonte t'i thoshte dhe duke kërkuar në mesat e të dielave, në romanet, rrëfimet dhe lutjet ngushëllim për pakënaqësitë me të cilat qe mbushur jeta e saj.

– Nuk mund ta shtyja që të më vriste për një gjest të thjeshtë, - tha, duke u lëshuar në karrigen e vjetër lëkundëse, ku don Visente kalonte orët e prehta së pasdites. - U hoqa sikur i besoja shpjegimet që më shiti.
Fliste duke ndier një lodhje shekullore, me vështrimin mbi të shoqen, mbi Erneston dhe prindërit, me ndërgjegjen copash.
– Ç'mund të bëja tjetër? Mos mendo keq, baba. Jam betuar t'i marr hakën Tavitos. Dhe do ta bëj, mama. Nuk do të turpërohesh kurrë për mua, Aida. Të betohem. Ju betohem, përsëri.
Në çdo çast ai betim të përmbushej. Brenda dhjetë minutash, ujku i vjetër, në një një Chevrolet, me të cilën shkonte çdo javë në Shtëpinë me Mogan në San Kristobal, vrasësi i Galindesit, i Murfit, i Tavitos, i Mirabaleve, i mijëra domenikanëve, sipas planit të ndërtuar me shumë kujdes, do të binte i grirë nga plumbat e një tjetër viktime të tij, Antonio de la Masas, të cilin Truhijo, e kishte bërë po ashtu në mënyrën më të ngadaltë dhe më perverse, se sa ata që i likujdoi me plumba apo duke ua hedhur peshkaqenve. Atë e vrau pak e nga pak, duke i vrarë sjelljen, nderin, respektin për vetveten, gëzimin për të jetuar, shpresat, dëshirat, duke e katandisur në një kockë e lëkurë, të munduar nga ndërgjegja, që po e bluante prej disa vjetësh.
– Do të shtrij këmbët, - i tha Salvadori Sadalait. - Më janë mpirë nga të ndenjurit.
Pa Turkun të dilte nga makina dhe të çapitej anës rrugës. A ishte Salvadori aq i shqetësuar sa ai? Pa dyshim. Edhe Toni Imberti, edhe Amaditoja. Po ashtu, edhe ata më tej, Roberto Pastorisa, Uaskar Teheda dhe Pedro Livio Sedenjo. Të trembur nga ndonjë e papritur se, diçka ose dikush, mund ta pengonte Cjapin të vinte në atë pritë. Për Truhijo me atë kishte llogari të vjetra. Askujt prej gjashtë shokëve të tij, as prej dhjetëra të tjerëve që ishin në këtë komplot, si Huan Tomas Dias, nuk i kishte bërë aq dëm sa Antonios. Hodhi një vështrim nga dritarja. Pa Turkun që shkundte këmbët me lëvizje energjike. Mundi të dallonte se Salvadori mbante koburen në dorë. Pastaj erdhi te makina dhe u ul prapa, pranë Amaditos.
– E po mirë, po nuk erdhi do të shkojmë te Poni, të pimë ndonjë birrë të ftohtë, - e dëgjoi të thoshte i mërzitur.

Pas asaj grindjeje, ai dhe Salvadori nuk ishin parë me muaj. Kishin qenë në takime me shokët, por pa u përshëndetur. Ajo prishje ia rëndoi edhe më shumë stuhinë e brendshme që përjetonte. Kur komploti po përparonte shumë, Antonioja pati guximin të shkonte në Mahatma Gandhi 21 dhe të futej drejt në sallën ku gjendej Salvadori.

– Është e kotë që të shpërndajmë forcat, - i tha, si përshëndetje. - Planet e tua për të vrarë Cjapin janë lojëra fëmijësh. Ti dhe Imberti duhet të bashkoheni me ne. Puna jonë ka ecur mirë dhe nuk do të dështojmë.

Salvadori e vështroi në sy, pa i folur. Nuk bëri asnjë gjest armiqësor. As e nxori nga shtëpia.

– Kam ndihmën e gringove, - i tha Antonioja me zë të ulët. - Ka dy muaj që po e trajtojmë hollësisht me ambasadën. Huan Tomas Dias ka folur gjithashtu me njerëz të konsullit Dearborn. Do të na japin armë dhe eksploziv. Kemi kompromentuar shefa ushtarakë. Ejani me ne.

– Jemi tre, - foli më në fund Turku. - Amadito Garsia Gerrero bën pjesë në grupin tonë, ka disa ditë.

Ishte një pajtim tepër i përciptë. Nuk kishin patur ndonjë bisedë serioze këta muaj, ndërsa plani për vrasjen e Truhijos bëhej, zhbëhej, ribëhej dhe çdo muaj, çdo javë, çdo ditë merrte forma dhe data të ndryshme, nga lëkundjet e jankëve. Avioni me armë që u premtua në fillim nga ambasada u reduktua në fund në tri pushkë, që ua dorëzoi pak kohë më parë miku i tij Lorenso Berri, pronari i supermarketit "Wimpy's", i cili quhej tërisht qenkej njeriu i CIA-s në Qytetin Truhijo. Megjithë takimet e ngrohta, tema e vetme e të cilëve ishte plani, mes tyre nuk u vendos përsëri ai komunikim vëllazëror i dikurshëm. Shakatë, afrimiteti, lidhjet e ngushta që ekzistonin tani mes Turkut, Imbertit dhe Amaditos, ishin diçka që për Antonion kishin ngelur në kohën para grindjes. Pra, një tjetër e keqe për llogari të Cjapit: Kishte humbur një mik shumë të mirë, përgjithmonë. Tre shokët e tij të makinës, dhe ata tre të tjerët që qëndronin më tutje, ndoshta ishin ata që dinin më pak për komplotin. Mundet të dyshonin për pjesëmarrje të njerëzve të tjerë, po, nëse dëshironte diçka dhe binte në duart e Xhoni Abes Garsias, dhe kalecët e tij të çonin në Kuarenta që t'u nënshtroheshin torturave të njohura, si Turku, as Imberti, as Amaditoja,

as Uaskari, as Pastorisa, as Pedro Livio, nuk do të mundnin të përfshinin njerëz të tjerë: Gjeneralin Huan Tomas Dias, Luis Amiama Tion dhe dy tre të tjerë. Pothuajse asgjë nuk dinin për të tjerët, midis të cilëve gjendeshin figura nga më të lartat në qeveri si Pupo Romani, për shembull – Shef i Forcave të Armatosura, i dyti i regjimit – as për një mori ministrash, senatorësh, funksionarësh civilë, hierarkë ushtarakë – si rasti i vetë Balagerit, Presidentit teorik të Republikës. – Këta ishin në dijeni për planet, kishin marrë pjesë në përgatitjen e tyre apo në njohjen tërësore dhe u kishin bërë të ditur apo të nënkuptuar ndërmjetësve se sa të eliminohej Cjapi, do të ishin të gatshëm të bashkëpunonin për rikonstruksionin politik, për likujdimin e gjithë llumit truhijist, për hapjen, për Juntën qytetaro-ushtarake, me të cilën, dhe me ndihmën e Shteteve të Bashkuara do të siguronin rendin, do t'u mbyllnin portat komunistëve, do të kërkonin zgjedhje, etj. A do të ishte më në fund Republika Domenikane një vend normal, me një qeveri të zgjedhur, me shtet të lirë dhe me një drejtësi të denjë për emrin e saj? Antonioja mori frymë thellë. Sa kishte punuar për këtë dhe nuk e besonte ende. Ishte i vetmi që e njihte si në pëllëmbë të dorës, me emra, gjithë rrjetin e komplotistëve. Shpesh, ndërsa ndodhnin përplasje bisedash sekrete dhe gjithë ç'ishte bërë rrezohej për t'u nisur prapë nga asgjëja, ai kishte kuptuar pikërisht këtë gjë: Një merimangë në zemër të rrjetit të ngritur nga vetë ajo, merr nga turma individë të panjohur mes tyre. Dhe sa shumë qenë! As ai vetë mund t'i kujtonte të gjithë tani. Ngaqë ky vend ishte ashtu, ngaqë domenikanët ishin të atillë, ishte një mrekulli që nuk kishte pasur ndonjë kallëzim, sepse do të shkatërrohej gjithçka. Ndoshta Zoti është me ne, mendonte Salvadori. Kishte funksionuar kujdesi, ajo që secili dinte shumë pak. Përveç objektivit kryesor, nuk dihej mënyra, rrethanat, çasti. Jo më shumë se tre-katër njerëz e dinin se ata të shtatë ishin aty, atë natë, dhe se ç'duar do të ekzekutonin Cjapin.

Shpesh e dërrmonte ideja se duke qenë i vetmi i tillë, po ta kapte Xhoni Abesi, mund t'i identifikonte të gjithë të kompromentuarit. Kishte vendosur të mos kapej i gjallë, ta ruante plumbin e fundit për vete. Po ashtu, kishte marrë masa dhe kishte futur në takën e këpucës një helm me bazë cianuri, të

përgatitur nga një farmacist i Mokas, kinse për të helmuar një qen të egër, që po i batërdiste pulat në prona. Nuk do ta kapnin të gjallë, nuk do t'ia linte Xhoni Abesit kënaqësinë për ta parë të përpëlitej nga dhimbjet në karrigen elektrike. Pas Truhijos, do të ishte një lumturi e vërtetë të merreshe me shpirtin e SIM-it. Mund t'i ketë marrë vesh vdekjen e Shefit, të zhdukej. Mund t'i ketë marrë të gjitha masat. E di sa e urrejnë, sa duan të hakmerren me të. Jo vetëm opozitarët. Ministrat, senatorët, ushtarakët e thoshnin hapur.

Antonioja ndezi një cigare tjetër dhe e thithi duke kafshuar fort bishtin e saj për të shfryrë ankthin. Trafiku ka ndërprerë plotësisht. Ishte fat që nuk kalonte as një kamion apo autoveturë, në asnjë drejtim.

– Ai qen s'ka për të ardhur kurrë, ia bëfsha nënën, - shfryu i egërsuar në cepin e tij Toni Imberti.

VII

Kur Urania këmbëngul për të tretën herë me lugën në dorë, invalidi e hap gojën. Ndërsa infermierja kthehet me gotën e ujit, zoti Kabral, i shtendosur dhe i hutuar, pranon lugën me qumësht që i jep e bija dhe e pi me gllënjka gjysmë gote uji. Disa pika i kullojnë nga buzët deri te mjekra. Infermierja ia fshin me kujdes. Invalidi nuk denjon t'i hedh sytë.

– Shumë mirë, shumë mirë, - e hëngri frutin si një fëmijë i mirë, - e përgëzon. - Është i kënaqur dhe i habitur që e ushqen e bija. Vërtet, zoti Kabral?

Invalidi nuk denjon t'i hedh sytë.

– A të kujtohet Truhijo? - pyet Urania papritur infermieren.

Ajo e shikon e shpërqendruar. Është e gjerë të kelltqet, gjithë gjeste e me sy të dalë. Flokët i ka të kuq të oksiduar, veç rrënjët e errëta të tyre e tradhtojnë bojën. Më në fund reagon:

– Ç'mund të kujtoj, unë isha katër-pesë vjeçe kur e vranë. Nuk më kujtohet asgjë, veç ç'kam dëgjuar në shtëpi. Babai juaj ka qenë shumë i rëndësishëm në atë kohë, këtë e di.

Urania ulet.

– Senator, ministër, gjithçka, - mërmërit. - Dhe ra nga fiku.

Plaku e shikon i alarmuar.

– Mirë, mirë, - përpiqet të duket e gëzuar infermierja. - Thonë se ka qenë diktator, por atëkohë jetohej më mirë. Të gjithë kishin punë e s'kishte krime. S'është kështu, zonjushë?

– Po t'ju kuptonte, im atë do të e i lumtur ta dëgjonte këtë.

– Sigurisht që më kupton, - thotë infermierja tashmë te dera. - Vërtet, zoti Kabral? Babai juaj dhe unë bëjmë biseda të gjata. Mirë, më thërrisni po të keni nevojë.

Ajo del duke mbyllur derën.

Mbaese qe e vërtetë se për shkak të qeverive të mëvonshme shkatërrimtare, shumë domenikanë kishin mall për kohën e Truhijos. I kishin harruar abuzimet, vrasjet, korrupsionin, spiunllëqet, izolimin, frikën: Tmerri kthehet në mit. "Të gjithë kishin punë, kishte siguri".

– Bëheshin krime, baba, - kërkon sytë e invalidit që përpëliten. - S'hynin kaq shumë hajdutë nëpër shtëpira, s'kishte sulme në rrugë për t'iu rrëmbyer kalimtarëve portofole, orë dhe varëse, por kishte arrestime, burgosje, tortura, vrasje dhe zhdukje. Edhe ndaj miqve të regjimit. Për shembull, i biri, bukuroshi Remfis sa abuzime bëri. Si dridheshe, kur më hidhte sytë.
I ati nuk e dinte, pasi Urania kurrë nuk ia kishte thënë, se ajo dhe shoqet e saj të kolegjit Santo Domingo, e ndoshta tërë vajzat e brezit të saj, ëndërronin për Ramfisin. Me mustaqkat e prera bukur sikurse artistët e filmave meksikanë, me syzet Ray-Ban, me veshjen ngjyrë hiri për trupi dhe uniformat e ndryshme të tij si shef i Aviacionit Domenikan, me sytë e mëdhenj të errët, me trupin prej atleti, orët dhe unazat prej ari dhe me Mercedes-Benzin e tij, dukej si i favorizuari i perëndive. I pasur, i fuqishëm, i pamshëm, i shëndetshëm, i fortë, i lumtur. I kujtohet shumë mirë: Kur motrat nuk mund t'i shihnin dhe t'i dëgjonin, ajo me shoqet e saj tregonin koleksionet e tyre me fotografi të Ramfis Truhijos si civil, ushtarak, me kostum banje, me gravatë, me rroba sporti firmato, kostum kalorësi, duke drejtuar ekipin domenikan të polos apo i ulur në komandim të avionit të tij. Trillonin se e kishin parë, se kishin folur me të nëpër klube, në panaire, festa, parakalime, mbrëmje dhe pastaj guxonin të thoshnin ca gjëra – të skuqura, të trembura, sepse e dinin se ishte mëkat të fulore dhe të menduari, për çka duhej t'i rrëfeheshin kapelanit – duke pështpëritur: Sa i bukur, sa i mirë; ah, sikur të më donte, të më puthte, të më përqafonte Ramfis Truhijo.
– S'e merr me mend sa herë kam ëndërruar për të, baba.
I ati nuk qeshi. Lëvizi dhe hapi sytë me të dëgjuar emrin e djalit të madh të Truhijos. Kanakari dhe zhgënjimi i madh i tij. Babai i Atdheut të Ri donte që fëmija i tij i parë – "Ishte djali i tij, baba?" – të kishte etjen e tij për pushtet dhe të ishte po aq energjik dhe komandues sa ai. Po Ramfisi nuk trashëgoi asnjë nga virtytet dhe veset e tij, përveçse mbase kurvërimin e papërmbajtur, nevojën për të hedhur femra në shtrat, si të donte të bindej se qe mashkull. Mbi të gjithë ambiciet, i mungonte ambicia politike dhe qe i mefshët, i prirur për melankoli, për vetëmbyllje neurotike, i ngarkuar me komplekse, ankthe dhe dyshime, me një sjellje plot dredha histerike dhe periudha të gjata pavullneti, ku zhytej në drogë dhe alkool.

– E di se ç'thonë biografët e Shefit, baba? Që u bë ashtu me të marrë vesh se ishte lindur kur e ëma nuk ishte e martuar ende me Truhijon. Se filloi të binte në melankoli sapo mësoi se babai i vërtetë i tij, ishte doktor Dominisi, ai kubani të cilin Truhijo urdhëroi ta vrisnin, dashnori i parë i donja Marie Martinesit, e ashtuquajtura Espanjolita, kur ajo ende s'ndërronte të bëhej Dama e Hijshme dhe ishte një njeri që kushedi çfarë dhe me një jetë të dyshimtë. Po qesh? Nuk më besohet.
Ai mund të qeshë. Por mund të jetë edhe një tkurrje e thjeshtë e muskujve të faqeve. Gjithsesi nuk duket si fytyra e dikujt që argëtohet. Më shumë ngjan me fytyrën e dikujt që gogësin ose çirret, që ka mbetur nofullshqyer, sypicërruar, fleguzuar dhe gojëhapur, duke treguar një zgavër të errët, pa dhëmbë.
– Dëshiron që t'i flas infermieres?
Invalidi mbyll gojën, shtendos fytyrën, ndryshon shprehjen e vëmendshme dhe të alarmuar. Qëndron i mbledhur, i qetë, duke pritur. Uranisë i tërheq vëmendjen një klithmë e papritur papagalli që bën zhurmë në banesë. Pastaj pushon, aq papritur siç filloi. Një diell i ndritshëm shigjeton çatinë dhe kristalet dhe fillon të ngrohë dhomën.
– E di çfarë? Me gjithë urrejtjen që kam pasur dhe vazhdoj të kem për Shefin tënd, për familjen e tij, për çdo gjë që mori për të, ndiej hidhërim, keqardhje.
Ka qenë një monstër si gjithë ajo familje monstrash. Ç'mund të ishte tjetër, duke qenë biri i atij që ishte, i krijuar dhe i edukuar siç ishte ai? Ç'mund të kishte qenë tjetër i biri i Heliogabalos, i Kaligulës, i Neronit? Ç'mund të kishte qenë tjetër një fëmijë i emëruar me ligj, qysh në moshën gjashtëvjeçare ("ti e prezantove në Kongres apo Senator Çirinosi, baba?"), kolonel i Ushtrisë domenikane dhe kur mbushi dhjetë vjeç, u gradua gjeneral, në një ceremoni publike ku duhej të merrte pjesë trupi diplomatik dhe ku shefat ushtarakë duhet ta nderonin? Uranisë i është ngulur në kujtesë një foto nga albumi që i ati e ruante në dollapin e sallës – a thua është ende atje? - ku senatori elegant Agustin Kabral ("Apo ishe ministër në atë kohë, baba?"), me frakun e rregullt, nën një diell përcëllues, i përkulur plot respekt, po i paraqiste nderimet e tij gjeneralit të vogël. Fëmija me uniformë rrinte në këmbë mbi një

podium të vogël të mbuluar me tëndë, ku sapo kishte kaluar në revistë nderi parakalimi ushtarak dhe priste, sipas radhës, urimet e ministrave, parlamentarëve dhe ambasadorëve. Në fund të tribunës, fytyrat e kënaqura të Bamirësit dhe Damës së Hijshme, mamasë krenare.

– Ç'gëzjetë tjetër mund të ishte, veç bjerraditës, pijanec, përdhunues, mendjelehtë, bandit, i çekuilibruar, siç qe ai? Asgjë nga këto nuk dinim unë dhe shoqet e mia të Kolegjit Santo Domingo, kur endeshim të dashuruara pas Ramfisit. Ndërsa ti po, i dije, baba. Prandaj tmerroheshe po të më shihte, po t'i tekej për bijëzën tënde, prandaj u bëre dhë një herë që më përshëndeti me ëmbëlsi dhe më hodhi një kompliment. Por unë atëherë nuk kuptoja asgjë!

Invalidi përplasi qerpikët dy-tri herë.

Në ndryshim nga shoqet e saj, zemrat e të cilave rrihnin për Ramfis Truhijon dhe trillonin sikur e kishin parë dhe kishin folur me të, sikur u kishte buzëqeshur dhe u kishte bërë komplimenta, Uranisë i kishte ndodhur vërtet. Po kremtohej inaugurimi i madh i njëzet e pesë vjetorit të Epokës së Truhijos: Festa e Paqes dhe e Bashkëvllazërimit të Botës së Lirë, që do të vazhdonte nga 20 dhjetori i vitit 1955 dhe gjatë tërë vitit 1956 dhe do të kushtonte ("Kurrë nuk u mësua shifra e saktë, baba") midis njëzet e pesë dhe dyzet e gjashtë milionë dollarëve, midis të gjitha ato imazhe, emocionin, bujën, mrekullinë që mbuloi tërë vendin me atë festë të paharrueshme: Truhijo festonte vetveten, duke sjellë në Santo Domingo ("Në Qytetin Truhijo, më fal, baba") orkestrën e Havier Kugatit, koristët e Lido de Parisit, patinatorët amerikanë të Ise Kapads. Me atë rast u ndërtuan gjashtëdhjetë e një godina prej mermeri, alabastri dhe oniksi, në një sipërfaqe tetëqind mijë metra katrore, rrethi festiv për të strehuar delegacionet e dyzet e dy vendeve të Botës së Lirë që mbërritën: grupe personalitetesh, midis më të shquarve Presidenti i Brazilit, Huskelino Kubiçeku dhe silueta e purpurt e kardinalit Fransis Spelman, kryepeshkop i Nju Jorkut. Ngjarjet më të rëndësishme të atij përkujtimi, qenë gradimi Gjeneral-leitnant i Ramfisit, për shërbime të shkëlqyera ndaj vendit dhe vënia në fron e Lartmadhërisë së Saj të Hirshme, Anxhelita I, Mbretëreshë e Festës, e cila mbërriti atje me barkë, e shoqëruar nga sirenat e Marinës dhe këmbanat e

gjithë kishave të kryeqytetit. Ajo mbante në kokë një kurorë me gurë të çmuar dhe në trup një veshje delikate prej nape dhe dantelle, e qepur në Romë nga dy modiste të shquara, motrat Fontana, të cilat përdorën për të dyzet e pesë metra hermini rus, bishti i të cilës ishte tre metra i gjatë dhe toga e së cilës përngjante me atë të Isabelës të Anglisë në kurorëzimin e saj. Midis damave të vogla dhe pazhëve, midis atyre çupkave dhe djemve të zgjedhur të shoqërisë domenikane, është dhe Urania, me një fustan të gjatë e të mrekullueshëm museline, me dorashka mëndafshi dhe me një tufë trëndafilash të kuq në dorë. Është pazhi më i ri i shpërblyer së zgjedhur që përcjell vajzën e Truhijos nën diellin ngadhnjimtar, midis asaj turme që duartroket poetin dhe sekretarin e Shtetit të Presidencës, don Hoakin Balagerin, kur i bën elozhe Lartmadhërisë së Saj Anxhelita I dhe vendos nën këmbët e hirësisë dhe bukurisë së saj popullin domenikan. Duke u ndier një grua e re, Urania dëgjon të atin, i cili i veshur për ceremoni, lexon një pajegjirik për arritjet e këtyre njëzet e pesë viteve, falë aftësisë, vizionit dhe patriotizmit të Truhijos. Është tejet i lumtur. ("Kurrë nuk të pashë më si atë ditë, baba"). Beson se është qendra e vëmendjes. Tani, në qendër të festës, zbulohet statuja prej bronxi e Truhijos, me xhaketë të togë akademike, me diplomat e profesorit në dorë. Papritur - guri i çmuar i atij mëngjesi magjik - Urania dallon Ramfis Truhijon, me uniformën e paradës së madhe, i cili po e shikonte me ca sy të ëmbël.

– Po kjo çupkë kaq e bukur, cila është? - i buzëqesh Gjeneralleitnanti fare i ri. Urania ndjen disa gishta të ngrohtë, të hollë, që po i përkëdhelnin mjekrën. - Si quhesh?
– Urani Kabral, - belbëzon ajo, me zemrën që po i shpërthen.
"Sa e bukur je, por mbi të gjitha, sa e bukur do të jesh", përkulet Ramfisi dhe buzët e tij puthin dorën e vajzës së vogël që dëgjon zhurmën, psherëtimat, lojërat me të cilat festonin damat e vogla dhe pazhët e tjerë të Lartmadhërisë së Saj Anxhelita I. I biri i Gjeneralisimit iku. Urania fluturon nga gëzimi. Ç'do të thonë shoqet e saj, kur të marrin vesh se Ramfisi, vetë Ramfisi, i tha që je e bukur, që e kapi për faqeje dhe i puthi dorën, si të ishte një damë e vërtetë?
– Sa u ligështove, kur të tregova, baba. Si u tërbove ashtu! Oh, sa për të qeshur ishte!
Ai shqetësim që pushtoi të atin, me të marrë vesh se Ramfisi

e kishte prekur, bëri që Urania të dyshojë për herë të parë, se jo gjithçka ishte e përsosur në Republikën Domenikane, siç thoshin të gjithë, e veçanërisht senatori Kabral.

– Ç'të keqe ka të më thotë e bukur dhe të më përshëndesë me përkëdheli, baba?
– E keqja më e madhe në botë, - e ngriti zërin i ati, duke e trembur, sepse kurrë nuk e kishte paralajmëruar me atë gjest të prerë mbi kokën e saj. - Kurrë më! Dëgjoje mirë, Urania. Po t'u afrua, mbathja me vrap. Mos e përshëndet, mos i fol. Ik. Është për të mirën tënde.
– Po... po... - vajza zhytet e hutuar në paqartësi.
Sapo qenë kthyer nga Festa e Paqes dhe e Bashkëvllazërimit të Botës së Lirë, ajo ende me veshjen e zgjedhur të damës së shoqërisë të Lartmadhërisë së Saj Anxhelita I, dhe i ati me frakun me të cilin kishte mbajtur fjalën e vet përpara Truhijos, presidentit Negro Truhijo e diplomatëve, ministrave, të ftuarve dhe mijëra njerëzve që kishin mbytur bulevardet, rrugët dhe ndërtesat plot flamuj festivë. Po pse aq i prishur në fytyrë?
– Sepse Ramfisi, ai djalë, ai njeri është... i keq, - i ati sforcohet të mos thotë gjithçka që mendon. - Me femrat, me vajzat e vogla. Mos u thuaj shoqeve të tua të kolegjit. Askujt. Ta them ty, se je bija ime. Është detyra ime të të kem nën kujdes. Për të mirën tënde, Uranitka. E kupton? Duhet ta kuptosh, se je e zgjuar. Mos e lër të të afrohet, as të të flasë. Po e pe, ik me vrap dhe eja tek unë, kudo që të jem. Pranë meje, asgjë nuk do të të bëjë. S'e kupton, Urani. Je ende një lule e brishtë. E padjallëzuar. Mendon se babai yt është xheloz dhe nuk do që të të përkëdhelë askush, as të të thotë se je e bukur, veç atij. Ai reagim i senatorit Kabral tregoi se atëherë bukuroshi Ramfis, romantiku Kamfas, kishte filluar paudhësitë me çupka, me vajza dhe gra, me të cilat mori famë, një famë që çdo domenikan, i mirë apo i keq, e ëndërronte. Kurvar i Madh. Kafshë Mashkull. Përçitës i Fortë. Do t'i mësosh këto më vonë në klasat dhe korridoret e Santo Domingos, kolegji i vajzave të zgjedhura, i motrave dominikane amerikane dhe kanadeze, me uniforma moderne, nxënëset e të cilave nuk duken rishtare, sepse vishen me rozë, blu dhe të bardhë dhe mbajnë çorape të trasha e këpucë bardhë e zi, gjë që u jep një pamje sportive. Por as ato nuk do t'i shpëtojnë dot Ramfisit gjatë bredhjeve të tij, vetëm ose me shokë, në

kërkim të femrave, rrugëve, parqeve, klubeve, diskotekave apo në shtëpitë e posaçme në pronën e tij Kiskeja. Sa domenikane mashtroi, rrëmbeu e përdhunoi bukuroshi Ramfis? Vendasve nuk u dhuronte Kadillakë, as pellush kunadheje, si artisteve të Hollivudit, para apo pas shtënies në dorë. Sepse, ndryshe nga i ati dorëlëshuar, është koprac si donja Marie. Domenikaneve ua bën falas. Ato duhet ta kenë për nder të flenë me princin trashëgimtar, kapitenin e ekipit të pamposhtur të polos së vendit, Gjeneral-leitnantin, shefin e aviacionit.
Gjithsesi do ta marrësh vesh nga sekretet dhe thashethemet, fantazitë dhe teprimet e përziera me realitet që fshehtas nga motrat, këmbejnë midis tyre nxënëset në pushime, duke besuar e mosbesuar, duke dëshiruar e duke pasur frikë, derisa më në fund ndodh termeti më i madh, në Qytetin Truhijo: Viktima e birit të babit, kësaj radhe, është njëra nga vajzat më të bukura të shoqërisë domenikane, e bija e një koloneli të Ushtrisë. Bukuroshja Rosali Perdomo, bjondja flokëgjatë, me sy të kaltër, lëkurë të përndritshme, që bënte Virgjëreshën Marie në shfaqjen Pasioni, duke derdhur lot si një Zonjë e Dhimbshme e vërtetë kur vdes Biri i saj. Përfliten shumë versione për atë që ndodh. Se Ramfisi e njohu në një festë, se e pa në "Country Club", në një festë, se i hodhi sytë në Hipodrom, e ngacmoi, i foli, i shkroi, një tjetër bandill ky. Po vëllai i vogël ta kishte parë, në orën sportive të volejbollit ku Rosalia merrte pjesë. Shumë shoqe e panë të dilte - Uranisë nuk i kujtohej ta kishte parë, po nuk ishte e pamundur - dhe në vend të merrte autobusin, hipi në autoveturën e Ramfisit që e priste pak metra nga porta. Nuk ishte vetëm. I biri i babit kurrë nuk dilte vetëm. Gjithmonë e shoqëronin dy a tre miq, që e qerasnin, e lajkatonin, i shërbenin dhe ata vetë, në sajë të tij ecnin përpara. Ose ishte me të i kunati, burri i Anxhelitës, Peçitoja, koloneli Luis Hose Leon Esteves, një tjetër bandill ky. Po vëllai i vogël vinte me ta? Shëmtaraqi, i pagdhenduri, i shpëlari Radames? Patjetër. Janë të dehur apo do të dehen pasi të bëjnë ç'kanë për të bërë me të bukurën, të ëmblën Rosalia Perdomo? Sigurisht, nuk presin që vogëlushja të përgjaket. Ndaj sillen si kavalierë. Në fillim e përdhunojnë. Ramfisit, meqenëse është ai që është, i takon ta zhvirgjërojë atë bukuri. Pastaj të tjerët. Radha sipas moshës apo afërsisë me Ramfisin? Apo e bëjnë me short? E, si e bënin, baba? Dhe në kulmin e aktit dhunues, i habit hemorragjia.

Nuk e shtrinë në ndonjë hendek, në mes të fushës, siç bënin me vajzat pa mbiemër dhe pa pasuri. Meqë ishte e bardhë, bjonde, e pasur dhe nga familje e respektuar truhijiste, vepruan me respekt, e çuan te porta e Spitalit Marion (fat i mirë apo i keq për Rosalinën?) ku mjekët e shpëtuan. Kështu u përfol historia. Thonë se i ligu kolonel Perdomo kurrë nuk gjeti prehje, sa e mori vesh që e bija adhuronte Ramfisin Truhijon, dhe miqtë e tij e poshtëronin gjithë qejf gjatë drekave dhe darkave, si të vrisnin kohën duke parë ndonjë film. E ëma nuk shkeli më në rrugë, e shkatërruar nga turpi dhe dhimbja. As në meshë nuk e panë më.

– Asaj i trembeshe, baba? - Urania s'ia ndan sytë invalidit. - Se mos më bënin dhe mua atë që i bënë Rosalisë?

"Kupton", mendoi e heshtur. I ati ia ka ngulur sytë, thellë në bebëzat e tij lexohet një lutje: Hesht, mos i lëndo më ato plagë, mos i rrëmo ato kujtime. Po nuk ka aspak ndërmend që të heshtë. Për këtë ke ardhur në këtë vend, për të cilin ishe betuar se s'do vije më?

– Po, baba, për këtë duhet të vija, - thotë me një zë që mezi dëgjohet. - Të bëj që të kalosh çaste të vështira. Edhe pse me atak cerebral, i ke marrë masat. I ke shkulur nga kujtesa gjërat e këqija. Edhe të miat, tonat, i ke fshirë? Unë, jo. Asnjë ditë nuk i kam harruar. Asnjë ditë, në këto tridhjetë e pesë vjet, baba. Kurrë nuk do t'i harroj, as nuk do të t'i fal. Prandaj kur më flisje në telefon në "Siena Heights University" ose në Harvard, dëgjoja zërin tënd dhe e mbyllja, pa të lënë të mbaroje. "Bijëz, ti je?..." brram. "Uranitka, dëgjo...", brram. Prandaj, kurrë s'iu përgjigja asnjë letrës tënde. Sa më shkrove, njëqind, dyqind? Të gjitha i grisa, i dogja. Ishin shumë hipokrite letrat e tua. Flisje larg e larg, me hamendje, nuk duhet të binin në sy të të tjerëve, të mos e mësonin të tjerët atë histori. E di pse nuk mund të të fal kurrë? Sepse kurrë nuk u pendove në të vërtetë. Pas aq vjet shërbimi ndaj Shefit, i kishe humbur skruplujt, ndjeshmërinë, s'kishe as më të voglën shenjë drejtësie. Njësoj si kolegët e tu. Ndoshta njësoj si i gjithë vendi. Apo ishte një nevojë për të qëndruar në pushtet, pa vdekur nga të pështirët? Të ktheheshe në një mizor, në një monstër, si Shefi yt. Të ishe i freskët dhe i kënaqur si bukuroshi Ramfis pas përdhunimit dhe braktisjes së Rosalisë të gjakosur te Spitali Marion.

Vajza Perdomo nuk u kthye më në kolegj, po fytyra e saj e

brishtë e Virgjëreshës Marie, vazhdoi të ishte në klasat, korridoret dhe oborret e Kolegjit Santo Domingo. Vijuan thashethemet, peshpëritjet, fantazitë se fatkeqësia e saj vazhdoi javë, muaj, edhe pse motrat e kishin ndaluar të përmendej emri i saj. Por në vatrat e shoqërisë domenikane, edhe në familjet më truhijiste, ai emër rishfaqej herë pas here, si shenjë frike, paralajmërim tmerri, sidomos në shtëpitë me vajza dhe gra në moshë. Ajo histori zgjonte frikën se bukuroshi Ramfis (që ishte, veç kësaj, i martuar me të divorcuarën Oktavia - Tantana - Rikart!) shpejt do t'u merrte vajzën dhe do të bënte me të ndonjë nga ato qejfet e trashëgimtarit të lastuar që bënte sa herë t'i tekej, sepse kush do t'i kërkonte llogari djalit të Shefit dhe njerëzve të tij?

– Për shkak të Rosalia Predomos e dërgoi Ramfisin në akademinë ushtarake në Shtetet e Bashkuara, Shefi yt. Po, baba?
Në Akademinë Ushtarake të Fort Leavenworth në Kansas City në vitin 1958. Për ta mbajtur nja dy vjet larg Qytetit Truhijo, ku historia e Rosalia Perdomos, thonin, kishte zemëruar edhe vetë Shkëlqesinë e Tij. Jo për arsye morale, veç për ato praktike. Ky djalë budalla, në vend që t'u kushtohej çështjeve serioze, të përgatitej si trashëgimtar i Shefit, merrej me polo, i jepej shturjes dhe alkoolit, i shoqëruar nga një takëm dhembelësh e parazitësh dhe po e turpëronte duke përdhunuar e përgjakur vajzën e një prej familjeve më besnike të Truhijos. Djalë i lastuar dhe i paedukatë. Atje, në Akademinë Ushtarake të Fort Leavenworth, në Kansas City, të shkojë.
Një buzëqeshje histerike e kapi Uraninë dhe invalidi u mblodh, si të donte të fshihej brenda vetes, i çorientuar nga ajo e qeshur e papritur. Urania qesh lot dhe fshin sytë me shami.
– Ilaçi që më i keq se sëmundja. Udhëtimi në Fort Livenvorth, nuk qe ndëshkim për bukuroshin Ramfis. Qe shpërblim.
Duhet të ishte komike. Apo jo, baba? Ai palo oficer domenikan arrin të ndjekë atë kurs elite, midis një klase të seleksionuar oficerësh amerikanë dhe krekosej me gajtanët e Gjeneral-leitnantit, dhjetëra dekorata, një karrierë të gjatë ushtarake në shpinë (kishte filluar që gjashtë vjeç), me një shpures shoqëruesish, muzikantësh dhe shërbëtorësh, një jaht të ankoruar në gjirin e San Franciskos dhe një flotilje automobilësh. Gjë e habitshme për ata kapitenë, togerë, rreshterë, instruktorë dhe profesorë. Mbërriti në Akademinë Ushtarake të Fort Livenvor-

thit për të vazhduar një kurs, ai zog tropikal që kishte aq shumë grada e tituj, sa s'i pati kurrë Aisenhaueri. Si ta trajtonin? Si ta lejonin të gëzonte tërë ato privilegje, duke e diskretituar Ushtrinë amerikane? Si mund të durohej ky trashëgimtar, një javë po dhe një javë jo, që ikte nga Kansas City spartan në Hollivudin e potershëm, ku me mikun e tij Profirio Rubirosa, bënte si milioner i zërhallur me artistet e famshme, për të cilat shkruante e komentonte marrëzisht shtypi i mashtrimit dhe i thashethemeve? Artikullshkruesja më e shquar e Los Anxhelosit, Luella Parsons, zbuloi se i biri i Truhijos i kishte dhuruar një Kadillak të modelit të fundit Kim Novakut dhe një pellush kunadheje Ça Ça Gaborit. Në sesionin e Dhomës, një kongresist demokrat ironikisht llogariti se ato dhurata kishin një vlerë të barabartë me ndihmën ushtarake që Uashingtoni i jepte Shtetit Domenikan dhe pyeti nëse ajo ishte mënyra më e mirë për të ndihmuar dhe mbrojtur vendet e varfra nga komunizmi, duke harxhuar paratë e popullit amerikan.
Ishte e pamundur t'u shmangej skandalin në Shtetet e Bashkuara, jo si në Republikën Domenikane, ku nuk u publikua dhe nuk u tha asnjë fjalë për shthurjet e Ramfisit. Atje po. Atje, le të thonë ç'të duan, por ka një opinion publik dhe një shtyp të lirë, dhe politikanët e Kongresit, ndihma ushtarake qe alibi. Të kujtohet kjo, baba? Akademia, thjesht i bëri të ditur Departamentit të Shtetit dhe ky, akoma më thjesht, njoftoi Gjeneralisimin Truhijo se nuk kishte më të voglën mundësi që djali i tij të ndiqte kursin dhe meqenëse fleta e shërbimit të tij qe tepër e kursyer, ishte më e preferueshme që të largohej vetë nga Akademia Ushtarake e Fort Livenvorthit, sesa të njollosej me dënimin e të përjashtuarit.

– Dhe babushit nuk i pëlqeu që t'i bënin një ligësi të tillë të shkretit Ramfis. Apo jo, baba? E ç'paskej bërë, në fund të fundit?! Vetëm kishte dëfryer. Po shiko se ç'bëjnë gringot puritanë. Për hakmarrje, Shefi yt deshi të përndiqte misionet detare dhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara dhe thirri ambasadorin për të protestuar. Këshilltarët e tij më të afërt, Paino Piçardo, ti vetë, Balageri, Çirinosi, Arala, Manuel Alfonsoja, iu desh të bënin të pamundurën për ta bindur se një prishje e tillë do të ishte tepër e dëmshme. Të kujtohet? Historianët thonë se në atë kohë ti ishe njëri nga kryesorët që pengoi acarimin me

Uashingtonin për shkak të bëmave të Ramfisit. Ia arrite vetëm pjesërisht, baba. Qysh nga ajo kohë, prej atyre teprimeve, Shtetet e Bashkuara kuptuan se ai aleat ishte një pengesë dhe se do të ishte e arsyeshme të kërkoje diçka më të hijshme. Por, a kemi mbaruar së foluri për bijtë e Shefit, baba?
Invalidi ul dhe ngre supet si të thotë: "Ku di gjë unë, ti e di". As atëherë nuk kuptonte? Jo. Të paktën, jo gjithë kohën. Nuk besoj se hemorragjia ia ka asgjësuar plotësisht aftësinë për t'i kuptuar gjërat. Duhet t'i ketë reduktuar dhjetë apo pesë për qind të aftësisë normale. Ai tru i kufizuar, i varfëruar, që ecën me xhirim të ngadaltë, pa dyshim ishte i aftë ta mbante dhe ta përpunonte informacionin, që shqisat e tij mezi e kapnin në pak minuta, mbase sekonda, para se të errësohej. Prandaj, menjëherë, sytë, pamja, gjestet e tij, sikurse ajo lëvizje supesh, tregojnë se dëgjon, se e kupton atë që i thua. Kupton imtësitë në fytyrën tënde, tkurrjet e muskujve, dritësimet, por nuk i lidh dot. Mos ki iluzione, Urani. Ai për një çast kupton, por harron. Pra nuk komunikon dot me të. Vazhdo të flasësh vetëm, siç ke bërë tridhjetë vjet.
Nuk është e trishtuar, as e ligështuar. Ndoshta s'e lë të jetë ashtu dielli që hyn nga dritaret dhe ndriçon objektet me një dritë të fortë, që i shquan dhe i zbulon të tëra detajet e tyre, duke u treguar dëmtimet, shngjyrosjen, vjetërsinë. Sa e shëmtuar, e braktisur, e vjetër, është tani dhoma, tërë shtëpia e presidentit të fuqishëm të Senatit të dikurshëm, Agustin Kabral. Si e kujton tani Ramfis Truhijon? Gjithmonë e magjepsin këto udhëtime të çuditshme të kujtesës, gjeografitë që përgatit në funksion të nxitjeve misterioze, të bashkëshkëndijimeve të papritura. Ah, po, kjo ka të bëjë me lajmin që lexove në "The New York Times", në çastin që dole nga Shtetet e Bashkuara. Artikulli fliste për vllanë e vogël, vrasësin, të shëmtuarin Radames. Uh ç'lajm! Ç'fund! Reporteri kishte bërë një zbulim të kujdesshëm. Kishte disa vjet që jetonte në Panama, i mbetur keq, duke iu kushtuar punëve të dyshimta, pa e ditur kush se çfarë, derisa një ditë humbi. U zhduk një vit më parë. Përpjekjet e bëra nga të afërmit dhe policia panameze - kontrollet në dhomën ku jetonte, në Balboa, mundën të gjenin vetëm veshjet e tij të ndyra - nuk dhanë as më të voglën pistë. Derisa, më në fund, njëri prej karteleve kolumbiane të drogës njoftoi nga Bogota, me bujë të madhe, karakteristikë

të Athinës Latinoamerikane, se "qytetari domenikan D. Radames Truhijo Martines, me banim në Panama, u ekzekutua në një vend të paditur në selvës kolumbiane, pasi u provua saktë sjellja e tij e pandershme me plotësimin e detyrave". "The New York Times" shpjegonte se, me sa dukej, dështaku Radames kishte vite që punonte në shërbim të mafies kolumbiane. Pa dyshim, në gjendje të vajtueshme, po të gjykoje nga jeta modeste që bënte; duke vepruar si korrier i kapove të mafies, u zinte atyre shtëpi me qira, i çonte hoteleve, aeroporteve, në shtëpi takimesh, kur duhej, shërbente edhe si ndërmjetës për larje parash. A thua u përpoq t'u vidhte ndonjë dollar për të përmirësuar kushtet e jetës së vet? Me që ishte gdhë, u pashkua menjëherë. E sekuestruan dhe e çuan në pyjet e Darienit, ku qenë zotërit dhe kapot e mafies. E torturuan egërsisht, ashtu siç pati torturuar e vrarë ai dhe Ramfisi në vitin 1959, pushtuesit e Kostansës, Mamionit dhe Estero Hondos, dhe në vitin 1961, tërë përfshirët në ngjarjen e 30 majit.

– Një fund i merituesshëm, baba. - I ati që po dremit, hap sytë. - Kush vret nën thundër, në thundër vdes. E pagoi Radamesi, nëse vdiq siç thuhet. Sepse e vërteta nuk dihet saktësisht. Artikulli thoshte gjithashtu se ka nga ata që thonë me siguri se ishte informator i DEA-s, e cila i ndërroi fytyrën dhe e mbronte nga shërbimet e futura mes mafiozëve. Thashetheme, mendje. Pra, shiko se ç'fund për bijtë e Shefit tënd dhe të Hijshmen Damë. Bukuroshi Ramfis bëhet copash në një aksident automobilistik në Madrid. Aksident që, siç thuhet, qe një vepër e CIA-s dhe e Balagerit për të mbaruar punë me trashëgimtarin, i cili, që nga Madridi komplotonte duke hedhur miliona për të rikuperuar zotërimin familjar. Radamesi, i kthyer në një mjeran, vritet nga mafia kolumbiane, sepse tentoi të vidhte paratë e pista, që ndihmonte për t'i larë, ose nga një agjent i DEA-s. Anxhelita, Lartmadhëria e Saj Anxhelita I, dama shoqëruese e së cilës isha unë, e di si jeton? Në Majami, e mbrojtur nën krahët e pëllumbit hyjnor. Tani është një New Born Christian. Njëra nga ato mijëra sekte evangjelike, drejt të cilëve e shtyjnë çmenduria, idiotizmi, ankthi dhe frika. Ashtu ka përfunduar mbretëresha dhe zonja e këtij vendi. Jeton në një shtëpizë të pastër dhe pa shije, një nga ato vulgaritetet hibride gringo-karibenjo, ku iu përkushtohet punëve misionere. Thonë se shihet nëcepat e Dade County, në lagjet latine dhe haitjane, duke

kënduar psalme e duke u bërë thirrje kalimtarëve t'i hapin zemrën Zotit. Çfarë do të thoshte për tërë këto Babai i Denjë i Atdheut të Ri?
Invalidi përsëri ngre dhe mbledh supet, duke pulitur qerpikët përgjumësh. Mbyll përgjysmë qepallat dhe kruspullohet, i gatshëm të marrë një sy gjumë.
Në të vërtetë, kurrë nuk ke ndier urrejtje për Ramfisin, Radamesin apo Anxhelitën. Asgjë e krahasueshme me çfarë të ngjallin akoma Truhijo dhe Dama e Hijshme. Sepse, të tre fëmijët e paguan me rrënim apo vdekje të dhunshme, pjesën e tyre të krimeve të familjes. Dhe për Ramfisin kurrë nuk ke mundur të shmangësh njëfarë dashamirësie. Pse, Urani? Ndoshta për krizat e tij psikike, për melankolitë e tij, për çmenduritë e tij, për atë çekuilibër që familja gjithmonë e fshehu dhe, për të cilin, pas vrasjeve që urdhëroi në qershor 1959, Truhijo, i detyruar, e shtroi në një spital psikiatrik në Belgjikë. Në të gjithë veprimet e tij, edhe në ato më mizoret, kishte te Ramfisi diçka karikatureske, të shtirë, patetike. Si dhuratat spektakolare që u jepte artisteve të Hollivudit, të cilat Profirio Rubirosa i shtinte në dorë falas (kur nuk paguhej nga ato). Apo se si i prishte planet që i ati hartonte për të. Nuk ishte groteske, për shembull, mënyra se si si Ramfisi rrënoi pritjen që organizoi Gjeneralisimi, për të shfajësuar dështimin e tij në Akademinë Ushtarake të Fort Leanvenworthit? I ati bëri që Kongresi ("Ti e paraqite projektligjin, baba?") ta emëronte shef të Shtatmadhorisë së Bashkuar të Forcave të Armatosura dhe që me mbërritjen e tij të njihej si i tillë, në një paradë ushtarake në Bulevard, tek Obelisku. Gjithçka ishte gati, trupat të rreshtuara, atë mëngjes kur jahti Anxhelita, që Gjeneralisimi kishte dërguar në Majami për ta marrë, hyri në port në lumin Ozama. Vetë Truhijo, i shoqëruar nga Hoakin Balageri, shkoi ta priste në port gjatë ankorimit, për ta shpënë në paradë. Ç'e papritur, ç'zhgënjim dhe turbullim e pushtoi Shefin, kur hyri në jaht dhe pa atë gjendje ligësie, kotësie të përgjakur, ku e kishte katandisur orgjia gjatë udhëtimit të mjerin Ramfis. Rrinte atje me sytë e qelqtë të shqyer dhe me rroba të pista nga të vjellat. Akoma më keq ishin miqtë e tij të ngushtë dhe femrat që e shoqëronin. Ja ç'thotë Balageri në kujtimet e tij: Truhijo u zbardh në fytyrë dhe filloi të dridhej nga zemërimi. Urdhëroi të anulohej parada ushtarake dhe betimi i Ramfisit

si shef i Shtatmadhorisë së Bashkuar. Dhe para se të ikte, mori një gotë dhe ngriti një dolli që donte të ishte një dackë për atë budallanë, të cilin dehja do ta pengonte të mësonte: "Për përpunën, e vetmja që do t'i sjellë përparim Republikës".
Një tjetër gaz histerik e mbërtheu Uraninë dhe invalidi hap sytë i tmerruar.

– Mos u tremb, - Urania bëhet serioze. - Nuk e mbaj dot gazin kur imagjinoj atë skenë. Ku ishe në ato çaste kur Shefi yt e pa të dehur të birin, të rrethuar nga kurvat dhe miqtë, po ashtu të dehur? Në tribunën e Bulevardit, i veshur me frak, duke pritur shefin e ri të Shtatmadhorisë së Bashkuar të Forcave të Armatosura? Çfarë shpjegimi u dha? Anulohet parada prej delirium tremens të gjeneral Ramfisit?
Qesh prapë nën vështrimin e thellë të invalidit.

– Një familje për të qeshur dhe për të qarë. Aspak serioze, - mërmërit Urania. - Shpesh ndiej turp për të gjitha këto. Edhe frikë, edhe brerje ndërgjegjeje, kur të lejohej ai guxim, edhe pse në sekret të plotë. Do të më pëlqente të dija se ç'ke menduar për fundin melodramatik të fëmijëve të Shefit. Apo për atë historinë e fëlliqur të viteve të fundit të donja Marie Martinesit, Damës së Hijshme, të tmerrshmes, hakmarrëses, e cila, duke klithur, kërkonte t'u nxirrnin sytë dhe t'i ripnin të gjallë vrasësit e Truhijos. E di që u katandis keq nga arterioskleroza? Që ajo makutja i nxorri fshehtas nga Shefi tërë ata miliona dollarë? Që kishte të gjithë çelësat e llogarive të fshehura në Zvicër dhe që ua kishte fshehur fëmijëve të vet? Pa dyshim, me plot arsye. Trembej se do t'ia rrëmbenin dollarët e saj dhe do ta mbyllnin në ndonjë azil, ku do të kalonte vitet e fundit në shkretim të zi. Po qe ajo që, e ndihmuar nga arteriosklerozа, ua hodhi atyre. Do të jepja çdo gjë për të parë Damën e Hijshme, atje në Madrid, të dërrmuar nga fatkeqësia, të rendë drejt humbjes së kujtesës, veç duke ruajtur, në thellësi të pracisë së saj, mjaft zgjuarsi për të mos u treguar të bijve numrat e llogarisë zvicerane. Për të parë përpjekjet e të mjerëve që Dama e Hijshme në Madrid, në shtëpinë e vrasësit Radames apo në Majami, tek Anxhelita, para se kjo të bëhej mistike, të kujtonte ku i kishte shënuar apo fshehur. E imagjinon, baba? Duke kërkuar, duke hapur, duke prishur, duke shqyer në atë kërkim të lig. E çuan në Majami, e kthyen prapë në Madrid, po kurrë s'arritën gjë. Iku dhe mori me vete në varr sekretin. Si

të duket, baba? Ramfisi i bëj rrush e kumbulla pak miliona që nxorri nga vendi gjatë muajve pas vdekjes së të atit, sepse Gjeneralisimi (vërtet, ishte ashtu, baba?) bëri ç'ishte e mundur të mos nxirrte asnjë qindarkë nga vendi për ta detyruar familjen e vet dhe larot përreth të vdisnin këtu, duke dhënë llogari. Por Anxhelita dhe Radamesi mbetën rrugëve. Edhe Dama e Hijshme, bashkë me arteriosklerozën e vet, vdiq e varfër në Panama, ku e varrosi Kalil Haçeja, që e çoi në varreza me një taksi. Dhe ua la trashëgim bankierëve të Zvicrës milionat e familjes. Për të qarë dhe për të qeshur me të madhe, po jo për ta marrë seriozisht. Vërtet, baba?

Dhe përsëri qesh me lot. Ndërsa fshin sytë, lufton kundër njëfarë ligështimi që e pushton së brendshmi. Invalidi e vëren. I mësuar tani me praninë e saj, s'e çudit më monologu i saj.

– Mos kujto se jam bërë histerike, - pështjellohet. - Ende jo, baba. Jam duke u endur në të kaluarën, duke rrëmuar kujtimet, gjë që s'e kam bërë kurrë më parë. Nuk më pëlqejnë më pushimet. Kur isha fëmijë këtu, më pëlqenin. Por, që kur vajta në Universitet, në Adrian, falë motrave, kurrë më. Më iku jeta duke punuar. Kurrë s'kam bërë pushime në Bankën Botërore. As në avokatore, në Nju Jork. Kështu që s'kam pasur kohë të bëj monologë për historinë domenikane.

Duket se jeta e saj në Manhatan është rrapaskapitëse. Çdo orë është e llogaritur, që nga nëntë e mëngjesit kur hyn në zyrën e vet në Medison dhe 74 Street. Deri atëherë ka vrapuar nja tri orë në Parkun Qendror nëse është kohë e mirë, ose duke bërë aerobi në Fitness Center ku është abonuar. Dita e saj e punës është një mori takimesh, informacionesh, diskutimesh, konsultash, verifikimesh në arshivë, drekë pune në rezervimin e studios apo në ndonjë restorant aty afër. Edhe pasdita po ashtu e ngarkuar dhe zakonisht zgjat deri në tetë të darkës. Nëse i del koha, kthehet duke shëtitur. Përgatit një sallatë dhe hap një kuti me kos para se të shohë lajmet. Lexon ca çaste dhe futet në shtrat, aq e lodhur, sa shkronjat e librit apo imazhet e televizorit fillojnë t'i vallëzojnë pas dhjetë minutash. Gjithmonë bën një ose dy udhëtime në muaj nëpër SHBA, Amerikë Latine, Evropë apo Azi. Kohët e fundit edhe në Afrikë, ku më në fund disa investitorë guxuan të rrezikojnë paratë e tyre dhe kanë nevojë për këshilltarë juridikë. Specialiteti i saj është ana ligjore e veprimeve financiare të firmave në çdo

vend të botës. Një specialitet që e ka fituar me shumë vjet pune në Departamentin Juridik të Bankës Botërore. Udhëtimet janë më dërrmuese se ditët e punës në Manhatan. Pesë, dhjetë apo dymbëdhjetë orë duke fluturuar drejt Meksikos, Bangkokut, Tokios, Ravalpindit ose Harare dhe, pastaj të kalosh menjëherë për të dhënë apo për të marrë informacione, të diskutosh shifra, të vlerësosh projekte, duke ndërruar vendet dhe klimën, nga vapa në të ftohtë, nga lagështira në thatësirë, nga anglishtja në japonisht, spanjisht, urdu, arabisht, indisht, duke përdorur përkthyes, gabimet e të cilëve mund të kushtojnë vendime të gabuara. Prandaj duhet t'i kesh gjithmonë në alarm të pesë shqisat. Është një gjendje përqendrimi që të lë përherë të rrapaskapitur dhe në shumë takime të mbytin gogësimat.

– Kur vjen e shtuna apo e diela, qëndroj në shtëpi e lumtur, duke lexuar historinë domenikane, - thotë dhe i duket se i ati e miraton. - Një histori tepër e veçantë vërtet. Por mua më shlodh. Është mënyra ime për të mos humbur rrënjët. Edhe pse kam jetuar atje dy herë më shumë vite se këtu, nuk kam kthyer në gringo. A jam duke folur si domenikane, baba?

Në sytë e invalidit shkëlqen një rreze ironie.

– E po mirë, një domenikane jo e plotë, nga ato atje. Ç'mund të presësh prej dikujt që ka jetuar më shumë se tridhjetë vjet midis gringove, që i kalon javët pa folur spanjisht. E di që isha e sigurt se s'do të shikoja më? As për të të varrosur nuk do të vija. Ishte një vendim i prerë. E di se do të dish pse e theva vendimin. Pse erdha. Në të vërtetë, nuk e di. Qe një shtytje dhe nuk u mendova shumë. Kërkova një javë pushime dhe ja ku jam. Mbase kam ardhur të të kërkoj diçka. Ndoshta, ty. Të të shikoj si je. E dija që je keq, dhe se nga hemorragjia cerebrale nuk do të bisedonim dot bashkë. Do të dish se çfarë ndiej? Se çfarë ndjeva kur u ktheva në shtëpinë e fëmijërisë sime? Kur pashë rrënimin tënd?

I ati përsëri mpreh vëmendjen. Pret me kureshtje që ajo të vazhdojë. Çfarë ndien, Urani? Hidhërim? Melankoli? Trishtim? Një rilindje të zemërimit të vjetër? "Më e keqja është se nuk ndiej asgjë", mendon ajo.

Bie zilja e portës së rrugës. Vazhdon të bjerë duke vibruar në ajrin e nxehtë të mëngjesit.

VIII

Mungesa e flokëve ia bënte shumë të dallueshëm veshët, tufat e qimeve të zeza të ashpra, një kompensim qesharak në tullën e Konstitucionalistit Sarhosh. A thua ia kishte ngjitur atë nofkë, para nofkës së parë, Lyrash, të vënë në intimitet? Bamirësit nuk i kujtohej. Mund të ishte ashtu. Qysh në rini kishte qenë i zoti të vinte nofka. Shumë prej këtyre emrave të dytë mizorë që ai u ngjiste njerëzve, zinin mish të viktimat dhe arrinin t'ua zëvendësonin emrat e vërtetë. Kështu kishte ndodhur me senatorin Henri Çirinos, të cilin, askush në Republikën Domenikane, duke përjashtuar shtypin, nuk e njihte me emrin e tij të vërtetë, por me ofiqin rrënues Kontitucionalisti Sarhosh. E kishte bërë zakon t'i fërkonte qimet e yndyrshme si prej derri që i shfaqeshin mbi veshë. Megjithëse Gjeneralisimi, me maninë e tij të fiksuar pas pastërtisë, ia kishte ndaluar ta bënte këtë veprim në sy të tij, atë çast jo vetëm që po e bënte, por po e shoqëronte edhe me të kruarit e hundës, gjë po aq të krupshme. Ishte i nervozuar. Shumë i nervozuar. Veçse fajtori përse: Po i sillte informacion që nuk ishte i mirë. Veçse fajtori po i sillte informacion që nuk ishte i mirë. Apo ishte i pakënaqur sepse sanksionet e vendosura nga OEA, që po e asfiksonin vendin.

– Po vazhdove të kruash hundët e veshët, do të thërras adjutantët të t'i mbyllin, - tha Gjeneralisimi i nervozuar. - Ta kam ndaluar t'i bësh këto ndyrësi këtu. Apo je i dehur?
Konstitucionalisti Sarhosh lëvizi nga vendi përballë, të tryezës e punës së Bamirësit dhe i largoi duart nga fytyra.

– Jo, s'kam pirë asnjë pikë alkool, - u shfajësua i hutuar. - I nderuar Shef, ju e dini që unë nuk pi ditën. Vetëm në muzg e tutje, natën.

Ai mbante veshur një kostum që Gjeneralisimit i dukej si një dordolec i keqngjyrosur: mes ngjyrës së plumbit dhe të verdhë me shkëlqime larushane. Dukej sikur trupin e tij trashaluq e kishin futur me zor në atë veshje pa shije. Mbi këmishën e bardhë i kërcente një kravatë kaltëroshe me pikla

të verdha, ku vështrimi i egër i Shefit dalloi ca njolla yndyre.
Mendoi me neveri se ato njolla i kishte bërë gjatë të ngrënit. Kur hante, Senator Çirinosi i gëlltiste kafshatat të mëdha, si të trembej se mos fqinjët do t'ia rrëmbenin pjatën. Ngaqë përtypjej i nxituar dhe me gojën gjysmëhapur, prej gojës i derdhej një shi mbeturinash.

– Të betohem se nuk kam në trup asnjë pikë alkool, - përsëriti. - Vetëm kafe puro kam pirë në mëngjes.
Me sa dukej ishte e vërtetë. Kur hyri pak më parë në zyrë, duke lëkundur trupin e vet elefantesk dhe duke kërkuar kuturu vendin ku të vendoste këmben, Truhijo mendoi se ishte i dehur. Po, jo. Siç dukej dehja i ka bërë sëmundje fizike. Edhe kur ishte esëll, ecte i pasigurt dhe duke u lëkundur si i dehur.

– Je rregjur në alkool. Edhe kur nuk pi, dukesh i dehur, - i tha, duke e këqyrur me sy nga lart poshtë.

– Është e vërtetë, - u nxitua të pranonte me një gjest teatral Çirinosi. - Unë jam një *poète maudit*, Shef. Si Bodleri dhe Ruben Dario.
Ai kishte lëkurë të hirtë, një gushë të dyfishtë, qime të rralla të lyrshme e ca sy të fshehur pas kapakëve të fryrë të tyre. Hunda prej boksieri, e shtypur nga aksidenti, dhe goja pothuajse pa buzë, i shtonin një veti të mbrapshtë shëmtisë së tij të pacipë. Ishte aq i shëmtuar, sa dhjetë vjet më parë, kur shpëtoi gjallë një aksidenti automobilistik, miqtë e tij menduan se kirurgjia estetike do ta përmirësonte, por ai mbeti i shëmtuar. Madje u bë më keq.
Që vazhdonte të ishte njeriu i besuar i Bamirësit, anëtar i rrethit të ngushtë të tij si Alvares Pina, Paino Piçardoja, Inteligent Kabrali (tani fatkeq) apo Hoakin Balageri, ishte një provë se në orën e zgjedhjes së bashkëpunëtorëve të vet, Gjeneralisimi vazhdonte të prirej nga dëshira dhe inati personal. Megjithë neverinë që i jepte pamja, kërkesat dhe sjelljet e Henri Çirinosit, qysh në krye të qeverisjes së tij, ai kishte qenë i privilegjuar me ca detyra delicate, që Truhijo ua besonte njerëzve jo vetëm të sigurt, por edhe të aftë. Ai ishte njëri nga më të aftët mes atyre që kishin hyrë në atë klub të veçantë. Ishte një avokat që shërbente si konstitucionalist. Në moshë fare të re, ai bashkë me Agustin Kabralin, kishte qenë redaktori kryesor i Kushtetutës që në fillim të Epokës së Truhijos, dhe i gjithë ndryshimeve të tekstit kushtetues prej asaj kohe. Kishte

redaktuar, gjithashtu, ligjet kryesore organike dhe normale, kishte qenë përgjegjësi i të gjitha vendimeve të përshtatura nga Kongresi për të legjitimuar nevojat e regjimit. Askush si ai nuk mundte t'u jepte fjalimeve të parlamentare, të mbushura me citate latine dhe franceze, vendimeve më arbitrare, vendimeve të ekzekutivit, pamje dhe forcë juridike, ose të hidhte me një logjikë dërrmuese të gjitha propozimet që nuk i pëlqenin Truhijos. Mendja e tij e organizuar si një kod, e gjente menjëherë argumentin teknik, që çdo propozim i Truhijos të merrte pamje të ligjshme, të bëhej vendim i Kamara de Kuentas, i Gjykatës së Lartë apo ligj i Kongresit. Pjesa e madhe e sistemit ligjor të asaj Epoke, qe thurur prej mendjes së mbrapshtë të atij sharlatani, siç e quajti njëherë përpara Truhijos, senatori Agustin Kabral, miku dhe armiku i tij i dashur brenda rrethit të favoritëve.

Për të gjitha këto veti, parlamentari i përhershëm, Henri Çirinos qe gjithçka që mund të ishte në tridhjetë vitet e asaj Epoke: deputet, senator, ministër i Drejtësisë, anëtar i Gjykatës Kushtetuese, ambasador fuqiplotë dhe i ngarkuar për tregtinë, Guvernator i Bankës Qendrore, president i Institutit Truhijoniano, anëtar i Këshillit Qendror të Partisë Domenikane. Dy vitet e fundit iu ngarkua një detyrë mjaft e besueshme, inspektor i zhvillimit të ndërmarrjeve të Bamirësit. Si i tillë, prej tij vareshin Bujqësia, Tregtia dhe Financat. Përse t'i jepej një përgjegjësi kaq e madhe një alkooliku të pandreqshëm? Sepse, përveç ngatërresave juridike, njihte edhe ekonominë. Për disa muaj e drejtoi si duhej Bankën Qendrore dhe atë të Financave. Por edhe sepse vitet e fundit, për shkak të mashtrimeve të shumta që kishin ndodhur, në atë post nevojitej një njeri tepër i besuar, i tillë që të mund të hynte në intrigat dhe problemet familjare. Për këtë punë, ai top dhjami dhe alkooli, ishte i pazëvendësueshëm.

Si mundej që ky pijanec i papërmbajtur, të mos e humbte zotësinë për intriga juridike, as aftësinë për punë, të vetmen gjë që mbase Bamirësi mund t'ia vlerësonte njëlloj me atë të Anselmo Paulinos, të cilit i kishte rënë tashmë fatkeqësia? Lyrashi mund të punonte dhjetë-dymbëdhjetë orë pa pushuar, të dehej e të bëhej shakull, dhe ditën tjetër të ishte në zyrën e Kongresit, në Ministri apo në Pallatin Kombëtar i freskët dhe i kthjellët, duke u diktuar stenografëve dijet e tij juridike, ose

duke parashtruar me oratori të zgjedhur tema politike, ligjore, ekonomike dhe kushtetuese. Veç kësaj, shkruante poema akrostike dhe festive, artikuj e libra historikë dhe ishte njëra nga penat më të mprehta që Truhijo e përdorte për të derdhur helmin në Forumin Publik të Karibeve.

- Si venë punët?
- Shumë keq, Shef, - senator Çirinosi mori frymë. - Me këtë rrugë, do të shkojmë shpejt drejt agonisë. Më falni që jua them, po ju nuk më paguani t'ju gënjej. Nëse nuk hiqen shpejt sanksionet, na vjen katastrofa.

Ai hapi çantën e madhe dhe nxorri prej andej tufa letre dhe fletore. Për të bërë një analizë të ndërmarrjeve kryesore, e nisi me Korporatën e Sheqerit Domenikan dhe vazhdoi me Aviacionin Domenikan, industrinë e çimentos, kompanitë e drurit dhe të sharrave, zyrat e import-eksportit dhe institucionet tregtare. Muzika e emrave dhe e shifrave e vuri në gjumë Gjeneralisimin, i cili mezi e dëgjonte: Atlas Comercial, Caribben Motors, Compania Anonima Tabacalera, Consorcio Algodonero dominicano, Chocolatera Industrial, Dominicana Industrial del Calzado, Distribuidores de Sal en Grano, Fabrica de Aceites Vegetales, Fabrica Dominicana del Cemento, Fabrica Dominicana de Discos, Fabrica de Baterias Dominicana, Fabrica de Sacos y Cordeleria, Ferreteria Read, Ferreteria El Marino, Industrial Dominico Suiza, Industria Nacional de Vidrio, Industrial Lechera, Industria Licorera Altagrasia, Industria Nacional del Papel, Molinos Dominicanos, Pinturas Dominicanas, Planta de Reencauchado, Quisqueya Motors, Refineria de Sal, Sacos y Tejidos Dominicanos, Seguros San Rafael, Sociedad Inmobiliaria, gazeta "Karibet". Lyrashi e la për në fund, duke i thënë me gjysmë zëri se nuk kishte "lëvizje pozitive" as në ndërmarrjet ku familja Truhijo kishte përqindje të vogla. Nuk tha asgjë nga ato që Bamirësi nuk i dinte: firmat që nuk ishin paralizuar për mungesë furnizimi apo pjesë këmbimi, punonin me një të tretën deri një të dhjetën e kapacitetit të vet. Pra, katastrofa kishte mbërritur tashmë. Por të paktën - mori frymë Bamirësi - me gringot nuk kishte ndodhur ajo që do të qe goditja e fundit: t'i prisnin furnizimin e naftës dhe të pjesëve të këmbimit të makinave dhe avionëve. Xhoni Abes Garsia e kishte rregulluar që karburantet të vinin nga Haiti, duke kaluar ilegalisht kufirin. Çmimi do të ishte tepër i lartë,

po regjimi do ta kompesonte me ndihma. Por shteti nuk do t'i rezistonte shumë kësaj hemorragjie. Jeta ekonomike qe në amulli të plotë në kushtet e kufizimit të valutës dhe paralizimit të import-eksporteve.

- Praktikisht në asnjë ndërmarrje nuk ka prurje, Gjeneralisim. Ka vetëm dalje e rrjedhje. Por mbahen ende ngaqë janë në kulmin e zhvillimit. Veç, jo përgjithmonë.
  Psherëtiu teatralisht, si në elegjitë e tij funerale, një tjetër specialitet i tij.
- Dua t'ju kujtoj se nuk është pushuar asnjë punëtor, bujk apo ndihmës, edhe pse lufta ekonomike po zgjat qysh prej një viti. Gjashtëdhjetë për qind të vendeve të punës, ndërmarrjet i kanë me humbje. Kuptohet, gjendja është e rëndë. Regjimi nuk mund të vazhdojë duke mbajtur dy të tretat e familjeve domenikane, kur, nga sanksionet, e gjithë tregtia është gjysmë e paralizuar. Në mënyrë që...
- Në mënyrë që...
- Që ju të më autorizoni për kursimet personale, me qëllim që të shkurtojmë harxhimet, në pritje të kohëve më të mira...
- Kërkon të shpërthejë ndonjë papunësi? - e ndërpreu ashpër Truhijo. - T'u shtosh edhe një problem tjetër atyre që kam?
- Ka një mundësi, së cilës duhet t'i drejtohemi në rrethana të jashtëzakonshme, - tha senatori Çirinos me një buzëqeshje mefistofelike. - A s'jemi në një rrethanë të tillë? Mirë atëherë. Shteti, që të mund të garantojë punën dhe aktivitetin ekonomik, merr përsipër drejtimin e shoqërive strategjike. Shteti nacionalizon, të themi, një të tretën e ndërmarrjeve tona dhe dy të gjashtën e atyre bujqësore e blegtorale. Ka akoma fonde në Bankën Qendrore për këtë punë.
- Ç'mut fitoj unë me këtë? - e ndërpreu Truhijo i acaruar. - Çfarë fitoj nga ata dollarë që kalojnë nga Banka Qendrore në llogarinë time?
- Fitoni atë që, duke nisur qysh tani, dëmi i treqind firmave që po punojnë me humbje, të mos e prekë xhepin tuaj, Shef. Jua përsëris, nëse do të vazhdojnë kështu, të gjithë do të falimentojnë. Këshilla ime është teknike. E vetmja mënyrë për të shpëtuar pasurinë tuaj nga shkatërrimi, për faj të kushteve ekonomike, është t'ia kalojmë humbjet shtetit. Askujt nuk i bëhet mirë nga shkatërrimi juaj, Gjeneralisim.
  Truhijo ndjeu një si lodhje. Dielli digjte gjithmonë e më

shumë dhe, sikurse të gjithë vizitorët e zyrës së tij, senatori Çirinos filloi të djersinte. Herë pas here fshinte fytyrën me një shami kaltëroshe. Ai gjithmonë kishte kërkuar që zyra e Gjeneralisimit të kishte ajër të kondicionuar. Po Truhijo e urrente atë ajër të rremë që të ftohte dhe atë atmosferë të gënjeshtërt. Në ditët shumë të nxehta pranonte vetëm ventilator. Veç kësaj, krenohej se ishte njeriu-që-nuk-djersinte-kurrë.
Heshti një çast duke u menduar, por fytyra iu thartua.

– Ti, me trurin tënd të qelbur, mendon që duhet të monopolizoj pronat dhe ndërmarrjet nga atje për fitim, - monologoi me një ton të lodhur. - Mos më ndërprit. Kur ti që ke kaq vite pranë meje, nuk më ke njohur ende, ç'pret nga të tjerët? Nga ata që mendojnë se pushteti më intereson vetëm për t'u pasuruar.
– E di shumë mirë se nuk është ashtu, Gjeneralisim.
– Mos ke nevojë të ta shpjegoj për të njëqindtën herë? Nëse ato ndërmarrje nuk do të ishin të familjes Truhijo, ato vende pune nuk do të ekzistonin. Dhe Republika Domenikane do të ishte një vend afrikan, siç qe kur e mora në dorë. Nuk e ke marrë vesh ende?
– E kam marrë vesh shumë mirë, Shef.
– Ti më vjedh gjë?
Çirinosi lëvizi përsëri nga vendi dhe ngjyra e hirtë e fytyrës iu errësua. Filloi të përpëlidhte qepallat i turbulluar.
– Ç'thoni, i nderuar Shef? Zoti është dëshmitar...
– Mirë, mirë, e di që nuk është ashtu, - e qetësoi Truhijo. - Përse nuk vjedh ti, me atë fuqi që ke për të bërë dhe zhbërë gjërat? Për besnikëri? Mbase. Por mbi të gjitha, nga frika. Ti e di se po të zbulova se më vjedh, do të të lë në duart e Xhoni Abesit, i cili të çon në La Kuarenta, të ul në *fron* dhe të karbonizon, para se të të hedhë te krokodilët. Janë gjëra që i pëlqejnë mendjes së sëmurë të shefit të SIM-it dhe ekipit që ka formuar. Prandaj nuk më vjedh. Prandaj nuk më vjedhin as drejtorët, administratorët, llogaritarët, inxhinierët, veterinerët, përgjegjësit, etj., etj. Prandaj punojnë mirë dhe me efektivitet, dhe prandaj ndërmarrjet kanë lulëzuar dhe janë vend modern dhe të përparuar. E kupton?
– Sigurisht, Shef, - u tremb edhe më shumë Konstitucionalisti Sarhosh. - Ju keni shumë të drejtë.

– Përkundrazi, - vazhdoi Truhijo, si të mos e dëgjonte fare, - do të vdiqte sa të mundte, nëse këtë punë që bën për familjen Truhijo, do ta bënte për Visinët, Valdesët apo Armenterosët. Dhe akoma më shumë, nëse ndërmarrjet do të ishin të shtetit. Oh, si do t'i mbushje xhepat atje! E kupton tani rradakja jote se përse më duhen mua tërë këto tregëtira, toka e kope?
– E di shumë mirë. Për t'i shërbyer vendit, - u bë tua senatori Çirinos. Ishte i alarmuar, çka Truhijo e pikasi nga të shtrënguarit fort mbi bark të çantës me dokumente dhe mënyrës pështirosëse me të cilën fliste. - Nuk desha t'ju sugjeroj asgjë të kundërt, Shef. Zoti më dënoftë!
– Por e vërteta është se po të gjithë Truhijot janë si unë, - e zbuti tonin Bamirësi, me një nojmë prej të zhgënjyeri në fytyrë. - As vëllezërit e mi, as gruaja ime, as bijtë e mi, nuk e kanë pasionin që kam unë për këtë vend. Janë makutër. Më e keqja është se në këto çaste të vështira më hanë kohën, duke u kujdesur që ata të mos tallen me urdhërat e mia. Hodhi atë vështrimin luftarak dhe të drejtpërdrejtë që të kallte datën. Lyrashi u mrról aty ku ishte.
– Hëm, tani e kuptoj se dikush nuk më bindet, - mërmëriti. Senatori Henri Çirinos miratoi pa guxuar të flasë.
– Kanë tentuar të tërheqin përsëri para? - pyeti, duke e ftohur zërin. - Kush? Plaka? Fytyra e flashkët e mbushur me pikla djerse miratoi sërish me keqardhje:
– Më hoqi mënjanë gjatë mbrëmjes poetike, - ngurroi dhe e uli zërin duke e shuar fare. - Tha se po mendonte për ju, jo për vete, as për fëmijët. Për t'ju siguruar një pleqëri të qetë, nëse ndodhte diçka. Ju siguroj që është e vërtetë. Ajo ju adhuron.
– Çfarë donte?
– Një transfertë tjetër në Zvicër, - ngurroi senatori. - Vetëm një milion kësaj here.
– Në të mirën tënde shpresoj të mos ia kesh plotësuar dëshirën, - tha Truhijo me zë të thatë.
– Nuk e kam bërë, - belbëzoi Çirinosi, gjithmonë me angështinë që ia deformonte fjalët dhe me trupin të pushtuar nga një dridhje e lehtë. - Ku ka kapiten, nuk komandon ushtari. Me gjithë respektin dhe përkushtimin që kam për donja Marien, në krye ju jam besnik juve. Është një situatë tepër delicate për mua, Gjeneralisim. Nga kjo e keqe, po humbas

miqësinë e donja Maries. Është e dyta herë brenda një jave që ma kërkon këtë gjë.

- Edhe Dama e Hijshme trembej se regjimi do të shembej? Katër muaj më parë i kishte kërkuar Çirinosit një transfertë prej pesë milionë dollarësh në Zvicër. E donte urgjent. Mendonte se në çdo çast do t'i duhej të ikte me nxitim, se duhej t'i kishte të siguruara paratë jashtë shtetit për të gëzuar një mërgim të artë. Sikurse ata plehrat, Peres Himenes, Batista, Rohas Pinija apo Peroni. Plakë koprace. Si të ishte fare e pambrojtur. Për të asgjë nuk ishte e mjaftueshme. Ashtu kishte qenë qysh e re, po me kalimin e kohës ishte bërë më keq. A thua do t'i merrte me vete në botën tjetër ato para. Ishte e vetmja gjë për të cilën kishte guxuar gjithmonë të sfidonte autoritetin e të shoqit. Pa shih, dy herë këtë javë. Komplotonte pas shpinës së tij. As më pak, as më shumë. Asisoj e bleu edhe shtëpinë në Spanjë, atëherë kur i bënë vizitën zyrtare Frankos më 1954. Pa i thënë Truhijos. Po ashtu kishte bërë duke hapur llogari bankare në Zvicër dhe Nju Jork, që ai i kishte zbuluar fare rastësisht. Në fillim nuk ishte shqetësuar shumë. Ishte mjaftuar duke i hedhur nja dy të shara, po më vonë ishte habitur para tekave të plakës në menopauzë, për të cilën ruante njëfarë konsiderate, vetëm se qe gruaja e tij legjitime. Tani ishte ndryshe. Kishte dhënë urdhër të prerë që asnjë domenikan, përfshirë edhe familjen Truhijo, të mos nxirrte qoftë edhe një peso nga vendi, ndërkohë që vazhdonin sanksionet. Nuk do ta pranonte të ndiqte atë rrugë minjsh, duke u përpjekur të shpëtonte prej një barku ku, në të vërtetë, do të mbytej nëse i gjithë ekuipazhi, duke nisur nga kapiteni dhe oficerët, iknin. Jo, kurrë. Këtu ishin të afërmit, miqtë dhe armiqtë, me gjithë ç'kishin, për të fituar betejën ose për të lënë kockat në fushën e nderit. Si marinsat, e marrtë djalli. Plakë e budallaqe dhe koprace! Sa mirë do të kishte bërë po ta kishte ndarë dhe të ishte martuar me ndonjë nga gratë të mrekullueshme që kishte kaluar nëpër duar. Sikurse bukuroshja dhe e urta Lina Lovaton, të cilën e sakrifikoi për këtë vend mosmirënjohës. Damën e Hijshme do ta qortonte atë pasdite dhe do t'i kujtonte se Rafael Leonidas Truhijo Molina nuk ishte Batista, as derri Peres Himenes, as fanatiku Rohas Pinija, as gjenerali spitullaq Peron. Ai nuk do t'i kalonte vitet e fundit në dhe të huaj si burrë shteti në pension. Do të jetonte deri në çastin e fundit në këtë vend, që falë

tij nuk ishte më një tribu, një bandë apo një karikaturë, por qe kthyer në Republikë.

- Vuri re se Konstitucionalisti Sarhosh po dridhej. Një fill shumë po i dilte nga goja. Sytë i hapeshin dhe i mbylleshin furishëm pas atyre kapakëve që ngjanin si dy topa dhjami.
- Kemi ndonjë gjë tjetër. Çfarë?
- Javën e kaluar ju kam informuar se mundëm të shmangnim bllokimin e pagesës së "Lloyd's de Londres" për pjesën e sheqerit të shitur në Britaninë e Madhe dhe në Vendet e Ulëta. Pak gjë. Nja shtatë milionë dollarë, nga të cilat katër u takojnë firmave tuaja dhe pjesa e mbetur fabrikave të Visinëve dhe Central Romanas. Sipas udhëzimeve tuaja, i kërkova "Lloyd's" që t'ia kalojë paratë Bankës Qendrore. Po sot në mëngjes më thanë se kishin marrë një kundërudhër.
- Nga kush?
- Nga gjenerali Ramfis, Gjeneralisim. Na telegrafoi që t'ia dërgonin të gjithë detyrimin në Paris.
- Dhe te "Lloyd's de Londres" ka të tilla qelbësira që i binden urdhërit të Ramfisit?
- Gjeneralissimi fliste zorshëm, duke e mbajtur me pahir veten që të mos shpërthente. Ajo fyryfyçkë po i hante shumë kohë. Veç kësaj, i dhembte që përpara të tjerëve, aq më tepër kur ata ishin njerëz të besuar, i zbuloheshin të palarat e familjes së tij.
- Ende nuk e kanë plotësuar kërkesën e gjeneral Ramfisit, Gjeneralisim. Janë të paqartë, ndaj më lajmëruan. Ua përsërita që paratë duhet t'i dërgohen Bankës Qendrore. Por, meqë gjenerali Ramfis i ka kompetencat tuaja dhe ngaqë edhe në raste të tjera ka tërhequr para, do të ishte me vend t'i bëhej e ditur "Lloyd's" se ka një keqkuptim. Çështje imazhi, i nderuar Shef.
- Merre në telefon dhe thuaji t'i kërkojë falje "Lloyd's". Sot. Çirinosi, i shqetësuar, lëvizi nga vendi.
- Si urdhëroni! Do ta bëj, - pëshpëriti. - Por, a mund të bëj një lutje, Shef. Si miku juaj i vjetër. Si më besniku i shërbëtorëve. Unë tashmë e kam fituar inatin e donja Maries. Por mos më armiqësoni edhe me djalin tuaj të madh.
- Shqetësimi i tij ishte aq i dukshëm, sa Truhijo buzëqeshi.
- Njoftoje, mos ki frikë. Akoma nuk kam vdekur. Do të jetoj të paktën edhe dhjetë vjet, aq sa të kem mundësi ta kryej veprën time. Kaq kohë më mjafon. Ti do të jesh me mua deri

ditën e fundit. Sepse, edhe i shëmtuar, i dehur dhe i pistë, je një nga bashkëpunëtorët e mi më të mirë, - bëri një pauzë dhe duke parë Lyrashin me të njëjtën ëmbëlsi që një lypës shikon qenin e vet të zgjebosur, nxori diçka të pazakonshme nga goja: - Sa mirë do të ishte, sikur njëri nga vëllezërit e mi të ishte si ti, Henri.

– Senatori, i çuditur, nuk arriti t'i përgjigjej dot.
– Ajo që thashë është shpërblimi i tërë përkushtimit tim, - bëbëzoi, duke ulur kokën.
– Je me fat që s'je martuar dhe nuk ke familje, - vazhdoi Truhijo. - Mbase shpesh do të kesh menduar se është një fatkeqësi të mos lësh pasardhës. Marrëzi! Gabimi i jetës sime ka qenë familja. Vëllezërit, vetë gruaja, fëmijët e mi. A ke pasur telashe të tjera? Asnjë kokëçarje tjetër veç të pirit, parave dhe qejfit me femra. Më gjej një tjetër të aftë të vazhdojë fjalën time. A nuk është turp që Ramfisi dhe Radamesi në këto çaste, në vend që të jenë këtu, përkrah meje, luajnë polo në Paris?
– Çirinosi dëgjonte me sytë ulur, pa lëvizur, me pamje serioze dhe miqësore, pa thënë asnjë fjalë, i trembur, pa dyshim, për rrezikun e të ardhmes së vet, nëse lëshonte ndonjë fjalë kundër të bijve dhe vëllezëve të Shefit. Është e çuditshme se si ky njeri lëshonte mendime aq të hidhura. Kurrë nuk kishte folur për familjen e tij apo për gjëra intime, aq më pak me fjalë aq të ashpra.
– Urdhëri im është në fuqi, - tha tjetri, duke ndërruar tonin dhe temën e bisedës. - Askush, e sidomos një Truhijo, të mos nxjerrë para nga vendi, derisa të ketë sanksione.
– Në rregull, i nderuar Shef. Në të vërtetë, edhe sikur të duan, nuk do të munden. Veç nxjerrjes së dollarëve tauj me valixhe dore, nuk ka transaksione jashtë vendit. Veprimtaria financiare është në pikën e vdekjes. Turizmi është shuar. Rezervat po pakësohen përditë. A mund të përjashtoni ju ndonjë ndërmarrje nga plani i shtetit? Për shembull ato që janë në gradë të fundit.
– Ta shohim, - sikur lëshoi pe Truhijo. - Ma lër propozimin, do ta studioj. Ka ndonjë gjë tjetër urgjente?
– Senatori hapi fletorkën e tij dhe afroi sytë mbi të. Mori një pamje tragjikomike.
– Është një situatë paradoksale atje, në Shtetet e Bashkuara. Ç'do të bëjmë me miqtë e rremë? Kongresistët, politikanët, lobistët,

të cilët paguhen për të mbrojtur vendin tonë? Manuel Alfonsoja vijon t'u jepte derisa u sëmur. Qysh atëherë janë ndërprerë. Disa janë ankuar pa rënë në sy.

– Kush ka urdhëruar t'u ndërpriten?
– Askush, i nderuar Shef. Thjesht bëra një pyetje. Fondet e valutave të përcaktuara për këtë në Nju Jork, po ashtu kanë mbaruar. Nuk mund të zëvendësoheshin në rrethanat e krijuara. Janë disa miliona peso në muaj. Do të vazhdoni ende me zemërgjerësinë taj ndaj atyre gringove që janë të paaftë të na ndihmojnë për të na hequr sanksionet?
– E di, janë ca shushunja ata... - Gjeneralissimi bëri një shenjë përbuzjeje. - Po ama janë e vetmja shpresë që kemi. Ata mund të ushtrojnë ndikimin e tyre, për t'u hequr ose zbutur sanksionet, në varësi të situatës politike në Shtetet e Bashkuara. Dhe do të arrijmë menjëherë që Uashingtoni të na paguajë, të paktën, sheqerin që ka marrë.
– Çirinosi nuk dukej optimist. Lëvizi kokën i ngrysur.
– Edhe sikur Shtetet e Bashkuara të pranojnë lëvrimin e atyre që na kanë bllokuar, kjo do të shërbente pak, Gjeneralisim. E ç'anë nxjerrjet e dy milionë dollarë? Valutë për ushqimet bazë dhe importin e nevojave elementare vetëm për disa javë. Por, nëse ju e keni vendosur, u jepni urdhër konsujve Merkado dhe Morales t'ua lëvrojnë dërgesat atyre parazitëve. Meqë ra fjala, i nderuar Shef, fondet e Nju Jorkut duhet të jenë të ngritura, po të vihet në jetë projekti i tre anëtarëve të Partisë Demokratike për të ngrirë llogaritë e domenikanëve jorezidentë në SHBA. Tani e di se ata shtiren si të jenë shoqëri anonime me "Chase Manhatten" dhe "Chemical". Po nëqoftë se ato banka nuk e respektojnë sekretin bankar? Më lejoni t'ju sugjeroj t'i transferoni në një vend më të sigurt. Në Kanada, për shembull, ose në Zvicër.
– Gjeneralissimi ndjeu një zbrazëti në stomak. Nuk qe zemërimi që i prodhonte acid. Qe zhgënjimi. Kurrë nuk kishte humbur kohë në jetën e tij duke lëpirë plagët. Por ajo që po ndodhte me Shtetet e Bashkuara, vendit që regjimi i tij i kishte dhënë gjithmonë votën në OKB për çdo nevojë që kishte, po e tërbonte. Për çfarë i shërbeu që e priti si princ dhe e dekoroi çdo janki që shkeli në këtë ishull?
– Është vështirë t'i kuptosh gringot, - përmëriti. - Nuk mund ta kuptoj pse sillen ashtu me mua.

– Kurrë nuk u kam besuar atyre hajdunëve, - i erdhi pas ëndës Lyrashi. - Të gjithë janë njëlloj. Nuk mund të thuash se këtë reng na e bënte vetëm Ajzenhauri. Edhe Kenedi të njëjtën gjë po na bën.
– Truhijo e mblodhi veten: - Në punë, ta marrë djalli! - dhe prapë ndërroi temën.
– Abes Garsia ka përgatitur gjithçka për ta nxjerrë atë trapin, peshkopin Reji, nga shalët e murgeshave, - tha. - Ka dy propozime. Ose ta ndjekim, ose t'ia lëmë popullit ta linçojë që t'i japim një mësim priftërinjve komplotistë. Çfarë të pëlqen më shumë?
– Asnjëri, i nderuar Shef, - senatori Çirinos e mori veten. - Ju e dini opinonin tim. Ky konflikt duhet zbutur. Kishën, me dy mijë vjet në shpinë, askush nuk ka mundur ta shkatërrojë ende. Ju e patë çfarë i ndodhi Peronit, i cili u konfliktua me kishën.
– Këtë ma tha vetë ai, i ulur aty ku je ti, - pranoi Truhijo. - Cila është këshilla jote, që të heq pantallonat para atyre mutërve?
– T'i korruptosh me favore, i nderuar Shef, - sqaroi Konstitucionalisti Sarhosh. - Ose, në rastin më të keq, t'i trembësh, por pa veprime të pandreqshme, duke e lënë gjithnjë hapur derën e pajtimit. Propozimi i Xhoni Abesit do të ishte një vetëvrasje. Kenedi do të dërgonte menjëherë marinsat. Ky është mendimi im. Ju do ta merrni vetë vendimin dhe do të jetë më i miri. Unë do ta mbroj me penë dhe me fjalë. Si gjithmonë.
– Fjalët e mëdha poetike, për të cilat Lyrashi ishte i prirur, e dëfrenin Bamirësin. Këto të fundit ia shkundën shkurajimin që e kishte pushtuar.
– E di, e di, - i buzëqeshi. - Ti je besnik dhe prandaj të çmoj. Tani më thuaj në konfidencë. Sa para ke jashtë, nëse do të të duhet t'ia mbathësh për tërë natën?
– Për të tretën herë Senatori u hodh nga vendi, sikur karrigia e tij të kishte marrë flakë.
– Shumë pak, zoti Gjeneralissimo. E po mirë, dua të them...
– Sa? - nguli këmbë përzemërsisht Truhijo. - Dhe ku?
– Nja katërqind mijë dollarë, - u rrëfye shpejt tjetri, duke ulur zërin. - Në dy llogari të ndara. Në Panama. Sigurisht, të hapura para sanksioneve.
– Një mut, thuaj, - e qortoi Truhijo. - Me detyrat që ke patur ti, duhet të kishe shumë.

– Nuk jam kursimtar, Gjeneralisim. Veç kësaj, ju e dini, kurrë nuk më kanë interesuar paratë. Gjithnjë kam dashur të bëj jetë.
– Të pish, do të thuash.
– Të vishem mirë, të ha e të pi mirë, të blej librat që më pëlqejnë, - pranoi senatori me vështrimin te tavani dhe llamba e kristaltë e zyrës. - Falë Zotit, përkrah jush kam bërë punët më interesante të miat. A mos duhet t'i ndajmë ato para? Unë do ta bëja vetë po të më urdhëronit.
– Lëri atje ku janë. Po të kem nevojë në mërgim, do të më ndihmosh.
– Qeshi gjithë humor. Ndërsa qeshte, papritur iu kujtua vajzukja e frikshme e Shtëpisë me Mogan, dëshmitare shqetësuese, akuzuese, e cila e ligështonte. Do të kishte qenë më mirë t'i kishte futur një plumb, apo t'ua kishte dhënë rojave që ta hidhnin në short ose ta bënin me radhë. Kujtimi i asaj fytyre budallaqe, e cila e shikonte që vuante në ato çaste, e mbushte vrer.
– Kush ka qenë më i kujdesshëm? - pyeti, duke fshehur turbullimin e vet. - Cili ka nxjerrë më shumë para jashtë? Paino Pikardo? Alvares Pina? Inteligjenti Kabral? Modesto Dias? Balageri? Kush ka grumbulluar më shumë? Pse, asnjëri nga ju s'e ka besuar që unë do të dal nga ky vend vetëm në arkivol?
– Nuk e di, Gjeneralisim. Por, nëse më lejoni, nuk besoj se ndonjëri prej tyre mund ketë aq para jashtë. Për një arsye fare të thjeshtë. Askush nuk ka menduar se regjimit do t'i vijë fundi, se do të vijë çasti për t'ia mbathur. Cili do ta besonte se një ditë toka do të pushonte së ardhuri rrotull diellit?
– Ti, - iu përgjigji Truhijo me sarkazmë. - Ndaj i nxorre paratë në Panama, e ke logaritur se unë s'do të isha i përjetshëm, se do të më përmbyste ndonjë komplot. Të zbulova, more kërriç.
– Do t'i riatdhesoj qysh tani kursimet e mia, - protestoi Çirinosi, duke dhënë e marrë me gjeste hutimi. - Do t'ju tregoj formularët e Bankës Qendrore për hyrjen e valutave. Ato kursime ka kohë që janë në Panama. Misionet diplomatike ma kanë bërë të mundur ndonjë kursim. Valutë e mbledhur në shërbimin tuaj, Shef. Kurrë nuk e kam tepruar me shpenzimet e përfaqësuesit diplomatik.
– Je trembur, ke menduar se do të ndodhte si me Inteligjentin, - vazhdoi duke qeshur Truhijo. - Bëj shaka. Harrova që ma

tregove sekretin. Hajde tani, tregomë ndonjë gjë për të qeshur, para se të ikësh. Nga ato të dhomave të fjetjes, jo nga politika.

- Lyrashi buzëqeshi i lehtësuar. Por sapo filloi të rrëfente se tema e ditës në ato kohë në qytetin Truhijo, ishte e rrahura që konsulli gjerman i kishte dhënë të shoqes ngaqë dyshonte se ajo e mashtronte, Bamirësit iu errësua mendimi. Sa para mund të kishin nxjerrë jashtë bashkëpunëtorët e tij më të afërt? Kur e kishte bërë Konstitucionalisti Sarhosh, duhej ta kishin bërë të gjithë. Vetëm katërqind mijë të kishte siguruar? Sigurisht, më shumë. Të gjithë kishin jetuar, deri në skutat më të errëta të shpirtit, me frikën e shembjes së regjimit. Hëm, plehrat. Besnikëria nuk ishte virtyt domenikan. Këtë e dinte shumë mirë. Gjatë tridhjetë vjetëve e kishin lajkatuar, duartrokitur, hyjnizuar, por sapo të kthente era, do t'i jepnin shkelmin.
- Kush e shpiku sllloganin e Partisë Domenikane duke përdorur inicialet e emrit tim? - pyeti krejt papritur. - Rectitud, Libertad, Trabajo, Moralidad*. Ti apo Inteligjenti?
- Një shërbëtori yt, Shef, - thirri krenar senatori Çirinos. - Nisi në përvjetorin e dhjetë. Njëzet vjet më vonë është në të tëra rrugët dhe sheshet e vendit. Dhe në pjesën më të madhe të shtëpive tona.
- Duhet të ishte në ndërgjegjen dhe kujtesën e domenikanëve, - tha Truhijo. - Ato katër fjalë përmbledhin gjithë ç'ju dhashë.
- Por në çast, si nga një goditje çomangeje pas koke, i lindi dyshimi. I kishte humbur siguria që kishte. Fshehtas, pa menduar më për himnet lavdëruese ndaj Epokës, për çka shquhej Çirinosi, ai uli kokën, si për t'u përqendruar te një ide, me vështrimin e mprehur dhe ankthshëm po vëzhgonte për ta zbuluar. I drodh mishi. E pa. Ja ku ishte: njolla e errët shfaqej tek e çara e pantallonave dhe mbulonte një pjesë të këmbës së djathtë. Si dukej, sapo e kishte bërë. Ishte ende e lagët. Pikërisht në këto çaste, fshikëza e pandjeshme vazhdonte të nxirrte lëng. Nuk e kishte ndier dhe po e ndiente ende. E rrëmbeu një valë tërbimi. Mund të sundonte njerëzit, t'i vinte në gjunjë tre milionë domenikanë, po s'mund ta kontrollonte sfinkterin e vet.
- Nuk dua të dëgjoj thashetheme, nuk kam kohë, - i tha si me keqardhje, pa e ngritur vështrimin. - Shko dhe rregulloje atë punën e "Lloyd's", të mos xhirohen paratë e Ramfisit. Nesër, qysh në mëngjes. Mirupafshim.

- Mirupafshim, Gjeneralisim. Nëse më lejoni, a do të shihemi sot mbasdite te Bulevardi.
- Sapo e ndjeu që Konstitucionalisti Sarhosh mbylli derën, thirri Sinforoson. E urdhëroi t'i sillte një kostum të ri ngjyrë gri, dhe një palë rroba të brendshme. U ngrit në këmbë me shpejtësi, duke u penguar të një ndjenjë, shkoi në banjë. Ndiente turbullim dhe krupë. Hoqi këmishën, pantallonat dhe mbathjet, të njollosura nga urinimi i pavullnetshëm. Këmisha nuk ishte ndotur, por e hoqi dhe u ul mbi bide. U la, me kujdes, me sapun. Ndërkohë që fshihej, mallkoi dhe një herë rengjet që i bënte trupi i vet. Ishte në betejë me armiq të shumtë dhe s'kishte kohë për këtë dreq sfinkter. Hodhi pudër talk në vendet e flashkëta midis shalëve dhe i ulur në banjë priti Sinforoson të vinte.
- Biseda me Lyrashin i kishte lënë njëfarë shqetësimi. Ishte e vërtetë ajo që i kishte thënë: Ndryshe nga vëllezërit e tij kopukë, nga Dama e Hijshme e etur dhe e pangopur, nga të bijtë parazitë e të babëzitur, atij kurrë nuk i ishin interesuar aq shumë paratë. I përdorte ato në shërbim të pushtetit. Në fillimet e veta nuk kishte mundur të hapte rrugën e vet me para, sepse vinte nga një familje tepër modeste e San Kristobalit. Ai, një djalosh i varfër, kishte qenë gjithnjë i preokupuar për t'u veshur hijshëm. Më vonë paratë i shërbyen për të blerë a korruptuar njerëz që i nevojiteshin dhe për të ndëshkuar ata që ia zinin rrugën. Ndryshe nga Maria, e cila, qyshkur sajoi atë tregëtinë e lavanterisë për rojat (asokohe ende qenë të dashur), ëndërronte vetëm të mblidhte para, atij paratë i ishin dashur për t'i ndarë me të tjerët. Në qoftë se nuk do të ishte ashtu, a do t'i kishte bërë tërë ato dhurata për vendin, tërë ato shpërblime turmave çdo 24 tetor, që domenikanët të mund të festonin ditëlindjen e Udhëheqësit? Sa milionë peso kishte harxhuar gjithë ato vite për ambalazhet e karameleve, çokollatave, lojërave të fëmijëve, frutave, veshjeve, pantallonave, këpucëve, byzylykëve, varëseve, pijeve freskuese, bluzave, disqeve, setrave, karficave, revistave dhe për organizimet e pambarimtë që duhej të bënte Pallati ditën e Shefit? Dhe sa shumë dhurata të tjera për fëmijët e pagëzuar prej tij dhe për prindërit e tyre, në ato pagëzime kolektive në kishëzën e Pallatit, ku për tridhjetë vjet, një herë ose dy herë në javë, ishte bërë kumbar i qindra të

sapolindurve. Miliona e miliona peso. Sigurisht, një investim që e vlente. Këtë kishte bërë me mendjemprehtësinë e tij qysh në vitin e parë të qeverisjes, falë njohjes së thellë të psikologjisë domenikane. Të bësh lidhje kumbarie me një fshatar, një punëtor, një artizan, një tregtar, do të thotë të sigurosh besnikërinë e atij njeriu të varfër, të asaj gruaje të mjerë, të atyre, të cilët, pas pagëzimit i përqafonte dhe u dhuronte dy mijë peso. Dy mijë në kulmin e tyre. Sepse lista e të pagëzuarve shtohej nga njëzet, pesëdhjetë, njëqind, dyqind në javë, por nga ulërimat protestuese të donja Maries, apo nga rënia e ekonomisë domenikane, sidomos pas festave të mëdha të Paqes dhe Bashkëvëllazërimit të Botës së Lirë të vitit 1955, ato u reduktuan në një mijë e pesëqind, një mijë, pesëqind, dyqind, njëqind peso për çdo fëmijë të pagëzuar. Lyrashi këmëngulte që tani pagëzimet kolektive të ndërpriteshin, ose dhuratat të ishin simbolike, një kulaçkë apo dhjetë qindarka për fëmijë, derisa të mbaronin sanksionet. Hëm, jankit e poshtër!

– Kishte krijuar ndërmarrje dhe kishte bërë tregëtira për t'u dhënë punë dhe për të zhvilluar këtë vend, për të shtuar mirëqenien, duke dhuruar majtas e djathtas, për t'i kënaqur kështu domenikanët.
  Po me miqtë, bashkëpunëtorët dhe shërbëtorët, a nuk kishte qenë bujar si Petronio te "Quo Vadis"? I kishte groposur paratë duke u bërë dhurata të rëndësishme në përvjetorët, ditëlindjet, martesat e tyre, për misionet e kryera mirë, ose the thjesht për t'u treguar se ai dinte ta shpërblente besnikërinë. U kishte dhuruar para, shtëpi, toka, aksione, i kishte bërë ortakë në pronat dhe ndërmarrjet e veta, u kishte krijuar mundësira për tregti, që të fitonin para dhe të mos e grabisnin shtetin.
– Dëgjoi disa trokitje të lehta në derë. Sinforosoja hyri me kostumin dhe ndërresat e brendshme. Ia zgjati me sytë ulur. Kishte mëse njëzet vjet pranë tij. Nga ordinancë në ushtri, e gradoi kryeshërbëtor në Pallat. Nuk i ruhej për asgjë Sinforosos. Ishme memec, shurdh dhe qorr për gjithçka që kishte të bënte me Truhijo. Ai kishte nuhatje të mjaftueshme për të kuptuar se, për ca gjëra të vogla intime si, për shembull, urinimi i pavullnetshëm, edhe fjala më e vogël do ta privonte nga gjithë ç'kishte (një shtëpi, një fermë e vogël me bagëti, një makinë, një familje të madhe), ndoshta edhe nga jeta. Kostumi dhe të brendshmet, të mbështjella mirë me një mbulesë,

nuk duhej të tërhiqnin vëmendjen e askujt. Bamirësi e kishte bërë zakon të ndërrohej disa herë në ditë në zyrën e tij.

– U vesh, ndërkohë që Sinforosoja, me trupin e lidhur, me kën e rruar, i pastër sa më s'ka, me uniformën: pantallona të zeza, bluzë e jelek të bardhë me kopsa të praruara, po mblidhte rrobat e hedhura sheshit.
– Ç'duhet të bëj me peshqopët terroristë Sinforoso? - e pyeti, ndërsa mbërthente pantallonat. - T'i flak nga ky vend apo t'i fus në burg?
– T'i vrisni, Gjeneralisim, - u përgjigji pa kurrfarë ndrojtje tjetri. - Njerëzit u urrejnë ata. Në qoftë se nuk e bëni ju, do ta bëj populli. Askush nuk e fal atë jankin, atë spanjollin, të cilët kanë ardhur në këtë vend dhe e kafshojnë dorën që i ushqen.
– Gjeneralissimi nuk po e dëgjonte më. Duhej të merrte Pupo Romanin. Atë mëngjes, pasi kishte pritur Xhoni Abesin dhe ministrat e Punëve të Jashtme dhe të Brendshme, kishte vizituar Bazën Ajrore në San Isidro, për një mbledhje me shefat e Aviacionit. Aty kishte ndeshur një pamje neveritëse: Në hyrje, pak metra nga vendi i rojes, nën flamurin dhe emblemën e Republikës, një tub me ujëra të zeza rridhte dhe kishte formuar një zhermë të madhe të qelbur anës rrugës. Ndali autoveturën, zbriti dhe u afrua. Tubi derdhte me tepri ujë të karkërtueshëm, të mbyllur, hundët me shami - dhe kishte krijuar një re mizash e mushkonjash. Ujërat derdheshin dhe e mbytnin vendin përreth, duke ndotur ajrin dhe tokën e garnizonit të mbytur vrer. E kishte përmbajtur veten pa u kthyer në Bazë dhe t'u ulërinte komandantëve të pranishëm dhe t'i pyeste nëse ishte ai imazhi që duhet t'i jepnin Forcave të Armatosura: Një institucion i zhyer nga ujëra të qelbura dhe infektuese. Por menjëherë kishte vendosur ta qortonte kreun. Duhej ta detyronte Pupo Romanin të gëlltiste vetë ca nga ai mut i lëngshëm. Vendosi ta thërrasë në çast. Por gjatë kthimit në zyrë e harroi. Po e linte kujtesa dhe urinën nuk po e përmbante dot? Tëmen! Këto gjëra i kishin funksionuar terë jetën më mirë se gjithçka. Tani, në të shtatëdhjetat, po e linte shëndeti.
– I veshur dhe elegant, u kthye te tavolina e punës dhe ngriti telefonin që e lidhte drejtpërdrejt me Komandën e Forcave të Armatosura. Nuk vonoi të dëgjohej zëri i gjeneral Romanit.
– Alo? Po. Jeni ju, Shkëlqesi?

– Eja te Bulevardi këtë mbasdite, - i tha fare thatë në vend të përshëndetjes.
– Si urdhëroni, Gjeneralisim, - zëri i gjeneral Romanit ishte i alarmuar. - Nëse ju preferoni, vij qysh tani në Pallat? Ka ndodhur gjë?
– Ti e di çfarë ka ndodhur, - tha ngadalë, duke përfytyruar nervozizmin e burrit të mbesës së tij, Mireja, nga thonjtë e zërit me të cilin po fliste. - Ka ndonjë gjë të re?
– Gjithçka në rregull, Shkëlqesi, - nxitorei gjeneral Romani. - Isha duke marrë të dhënat e ditës nga rajonet. Po, nëse ju prefe...
– Te Bulevardi, - ia preu ai dhe i mbylli telefonin.
– I kënaqur, përfytyroi vramendjet e pyetjeve, hamendjeve, shqetësimeve e dyshimeve të dyndura në kokën e atij tuhafi, që ishte ministër i Forcave të Armatosura. Çfarë t'i kenë thënë për mua Shefit? Ç'thashetheme, çfarë shpifjesh t'i kenë çuar armiqtë e mi? O Zot, ç'fatkeqësi! Mos kam shkelur ndonjë urdhër të tij? Deri pasdite do të jetonte si në ferr.
– Por ky mendim e mbajti pak sekonda, se përsëri e ngacmoi kujtimi i pështirë i asaj vajze. Zemërimi, trishtimi e nostalgjia, iu përzien në shpirt dhe e pushtoi mërzitja. Dhe atëherë i shkoi në mendje: "Dhimbja shërohet me dhimbje". Fytyra e një gruaje të bukur, e përhumbur nga kënaqësia në krahët e tij, tek e falënderon për lumturinë që i ka dhënë. Dhe atëherë ta largojë nga mendja fytyrën e humbur të asaj idioteje? Po, të shkonte atë natë në San Kristobal, në Shtëpinë me Mogan, të lajë fyerjen po në atë shtrat dhe po me ato armë. Ky vendim - preku të çarën e pantallonave në shenjë yshtjeje - i dha kurajë dhe forcë për të vazhduar axhendën e ditës.

IX

– Ndonjë të re nga Segundo? - pyeti Antonio de la Masa.
I mbështetur te timoni, Antonio Imberti u përgjigj pa u kthyer:
– E pashë dje. Tani më lenë ta shoh çdo javë. Një vizitë e shkurtër, gjysmë ore. Shpesh, atij bir kurve, drejtorit të Viktorias, i teket t'i shkurtojë gati çerek ore vizitat. Nga shpirtligësia.
– Si është?
– Si mund të jetë një njeri, i cili, me besimin tek amnistia, lë Porto Rikon, ku ka punë dhe jetë të siguruar, duke punuar për familjen Ferre në Ponce dhe kthehet në vendin e vet, ku sheh se mezi e presin për ta gjykuar për krimin e pandehur të vrasjes së një sindikalisti, qëkur s'mbahet mend, dhe e dënojnë tridhjetë vjet? Si mund të ndihet dikush, i cili, edhe nëse vrau, e bëri për regjimin e Truhijos dhe si shpërblim po kalbet në burg prej pesë vjetësh?
– Por Imberti nuk tha këtë, sepse e dinte që Antonio de la Masa e kishte bërë atë pyetje më shumë për të vrarë mërzinë e pritjes së gjatë, sesa nga interesi për të vëllanë, Segundon. - Segundoja është i fortë. Nuk e jep veten edhe kur është keq. Shpesh, është ai që më jep kurajo mua.
– Besoj se nuk i ke thënë gjë për këtë punë.
– Sigurisht që jo. Për të bërë kujdes dhe për të mos pasur iluzione. Ja dështuam.
– Nuk do të dështojmë, - ndërhyri nga vendi mbrapa togeri Garsia Gerrero. - Cjapi do të vijë.
– A do të vinte? Imberti pa orën. Ende kishte kohë për të ardhur. Nuk duheshin humbur shpresat. Kishte vite që nuk e humbiste durimin. Kur ishte më i ri, për fat të keq, nga padurimi i kishte bërë gjërat keq duke u penduar shumë më pas. Si ai telegrami që dërgoi nga provinca e Puerto Platës, ku ishte guvernator në vitin 1949, kur antitruhistët, të kryesuar nga Horacio Hulio Ornes, zbarkuan në plazhin Luperon. I tërbuar nga zemërimi kishte shkruar: "Ju jepni urdhër, dhe unë do ta

djeg tërë Puerto Platan, Gjeneralisim". Kjo gjë e mundoi gjithë jetën. Ajo frazë u botua në të gjitha gazetat, pasi Shefi donte që të tjerët ta merrnin vesh se deri në ç'masë ishte i bindur dhe fanatik një guvernator i ri.

- Pse Horacio Hulio Ornes, Feliks Kordova Boniçe, Tulio Hostilio Avelo, Gugu Henrikes, Migeluço Feliu, Salvador Rejes Valdes, Federiko Horacio dhe të tjerë, zgjodhën Puerto Platën atë 19 janar 1949? Sulmi qe një dështim i plotë. Njëri prej avionëve të asaj ndërhyrjeje, as që mundi të mbërrinte dhe u kthye prapë në ishullin Kosumel. Hidroavioni Katalina me Horacio Hulion dhe shokët e tij në bord, mundi të ulej mbi ujë në baltovinën e bregut të Luperonit, por para se të zbarkonin sulmuesit, një anije e rojës bregdetare i goditi me top dhe i bëri copa. Patrullat ushtarake, në pak orë, i kapën pushtuesit. Truhijo e përdori këtë për të përligjur një nga ato marifetet e tij. I fali të zënët rob, përfshirë këtu edhe Horacio Hulio Ornes dhe, për të treguar fuqi dhe madhështi, i la të iknin. Por, ndërsa bënte këtë gjest shpirtmadhësie për të huajt, Antonio Imbertin, guvernatorin e Puerto Platës dhe të vëllanë e tij, majorin Segundo Imbert, komandantin ushtarak të vendit, i shkarkoi, i burgosi dhe i pwrndoqi, ndërkohë që i shtypi pamëshirshëm komplotistët e hamendur, duke i arrestuar, torturuar e pushkatuar fshehtas shumë prej tyre. "Komplotistë që nuk ishin komplotistë", mendoi. "Besonin se të gjithë do të dilnin t'i këqyrnin kur të zbarkonin. Por në të vërtetë askush nuk doli." Sa njerëz të pafajshëm e paguan atë aventurë.
- Sa të pafajshëm do të paguanin nëse do të dështonin këtë natë? Antonio Imberti nuk ishte aq optimist sa Amaditoja apo Salvador Estreja Sadalai, të cilët, sapo morën vesh nga Antonio de la Masa që gjenerali Hose Rene Roman, shefi i Forcave të Armatosura, ishte pjesëmarrës në përbetim, u bindën se me vdekjen e Truhijos, gjithçka do të shkonte mbarë. Pra ushtarët, duke iu bindur urdhrave të Romanit, do t'i arrestonin vëllezërit e Cjapit, do të vrisnin Xhoni Abesin dhe truhijistët e vendosur, pastaj do të instalonin një qeveri qytetaro-ushtarake. Populli do të dilte në rrugë të vriste spiunët, i lumtur që kishte fituar lirinë. A do të ecnin ashtu gjërat? Qëkur Segundoja ra në grackën e marrë, zhgënjimet e kishin bërë Antonio Imbertin alergjik ndaj entuziazmit të nxituar. Ai donte ta shihte kufomën e Truhijos te këmbët e veta. Të tjerët pak i interesonin.

Të çlirohej ky vend nga ai njeri, kjo ishte më e rëndësishmja. Të hiqej ajo pengesë, edhe sikur gjërat të mos shkonin të gjitha vaj menjëherë, të paktën hapej porta. Kështu do të përligjej puna e asaj nate, edhe sikur ata të mos dilnin gjallë.

– Jo, Toni nuk i kishte thënë asnjë fjalë mbi këtë konspiracion të vëllait, Segundos, në vizitat javore që i bënte në Viktoria. Flisnin për familjen, për futbollin, për boksin. Segundo kishte qejf të tregonte anekdota nga jeta e burgut. Atë temë të rëndësishme nuk e zunë ngoje. Në takimin e fundit, kur u ndanë, Antonioja i tha, duke i pëshpëritur: "Gjërat do të ndryshojnë, Segundo". Ai si t'i nuhaste gjërat, kishte folur shumë pak. Ta kishte marrë me mend? Sikurse Toni, edhe Segundoja, pas rënies nga detyra, nga truhijist entuziast që ishte, u ftoh, dhe më vonë u bë komplotist. Kishte kohë që kishte arritur në përfundimin se e vetmja mënyrë për t'i dhënë fund tiranisë, ishte zhdukja tiranin. Çdo gjë tjetër ishte e padobishme. Duhej likuiduar njeriu që ishte qendra e tërë atij rrjeti të zi merimage.
– Ç'do të kishte ndodhur nëse ajo bomba në Maksimo Gomes, do të shpërthente në kohën që do të kalonte Cjapi? - hamendësoi Amaditoja.
– Fishekzjarre truhijistësh në qiell, - u përgjigji Imberti.
– Unë do të të isha njëri nga ata që do të hidheshin në erë, po të isha roje shoqëruese, - qeshi togeri.
– Dhe unë do të të vendosja një kurorë të madhe me trëndafila mbi varr, - tha Toni.
– Hajde, ç'plan! - tha Estreja Sadalai. - Të hedhësh në erë Cjapin me tërë shoqëruesit. Sa të pashpirt!
– Por unë e dija se ti nuk do të ishe atje, në audiencën përuruese, - tha Imberti. - Veç kësaj, kur u vendos ajo punë, ty nuk të njihja, Amadito. Tani do ta mendoja dy herë këtë gjë.
– Çfarë ngushëllimi, - falënderoi togeri.
– Për më shumë se një orë duke pritur në rrugën e San Kristobalit, kishin tentuar disa herë të bisedonin, ose të bënin shaka atë çast, por prapseshin dhe secili mbyllej në ankthin, shpresat dhe kujtimet e veta. Antonio de la Masa ndezi radion një çast, por sapo dëgjoi zërin e sheqerosur të spikerit të "Zërit të Tropikut" tek prezantonte një program kushtuar spiritizmit, e fiku.
– Po, në atë planin për të vrarë Cjapin, të dështuar dy vjet e

gjysmë më parë, Antonio Imberti ishte i gatshëm të hidhte në erë bashkë me Truhijo një numër të mirë servilësh që e shoqëronin çdo mbasdite në shëtitjen e tij nga shtëpia e donja Hulias, Zonja Madhështore, përgjatë Maksimo Gomesit dhe Bulevardit, deri tek Obelisku. A thua nuk ishin përlyer me gjak e ndyrësi, sikurse ai, edhe ata? Do të ishte një shërbim i mirë ndaj vendit që, bashkë me tiranin, të zhdukte edhe një grusht larosh.

- Atentatin e përgatiti ai vetë, pa u konsultuar as me mikun e tij më të mirë, Salvador Estreja Sadalain, sepse, megjithëse Turku ishte antitruhist, Toni i trembej. Për shkak të katolicizmit të tij, mund të mos e miratonte planin. Ndaj e planifikoi dhe e llogariti gjithçka me kokën e vet, duke vënë në shërbim të planit gjithë mundësitë që kishte në dorë, i bindur se sa më pak njerëz të merrnin pjesë në të, aq më i madh do të ishte suksesi. Vetëm në fazën e fundit përfshiu dy djem në projektin e tij, që më vonë do të quhej "Lëvizja e 14 qershorit". Atëherë ishte një grup profesionistësh klandestinë dhe studentësh të rinj, që përpiqej të organizohej për të vepruar kundër tiranisë, megjithatë pa ditur se si.
- Plani ishte i thjeshtë dhe praktik. Të shfrytëzonte atë disiplinë maniake me çka Truhijo mbushte rutinën e tij, në atë rast, shëtitjen e mbrëmjes gjatë Maksimo Gomesit dhe Bulevardit. Studioi me kujdes terrenin duke e përshkuar drejtpërdrejt në drejtimin e kundërt atë bulevard ku ngriheshin shtëpitë e njerëzve të shquar, të dikurshëm dhe të tanishëm të regjimit. Shtëpia pompoze e Hektor Truhijos, Negros, ish-Presidenti kukull i të vëllait në dy periudha. Shtëpia rozë e Mama Hulias, Zonja Madhështore, të cilën Shefi e vizitonte çdo pasdite, para se të fillonte shëtitjen. Shtëpia e Luis Rafael Truhijo Molinas, me nofkën Vogëlushi, i çmendur pas ndeshjeve me gjelat. Ajo e gjeneralit Arturo Espajat, Neshterit. Ajo e Hoakin Balagerit, Presidenti kukull i tanishëm, pranë nunciaturës. Pallati i vogël antik i Anselmo Paulinos, tani njëra nga shtëpitë e Ramfis Truhijos. Shtëpia e madhe e vajzës së Cjapit, së bukurës Angelita dhe burrit të saj, kolonelit Luis Hose Leon Esteves, Peçitos. Ajo e Kaseres Tronkosos dhe një pallat i të fuqishmve Visini. Ngjitur me Maksimo Gomes ishte një fushë loje që Truhijo e ndërtoi për fëmijët e tij, përballë Vilës Madames e truallit ku ndodhej shtëpia e gjeneralit Ludovino Fernandes, i cili ishte

vrarë me urdhër të Cjapit. Midis pallateve kishte hapësira bosh, të mbuluara me barëra të egra dhe ngastra të shkreta, të mbrojtura me gardh teli të gjelbërt, të ngritur mu në anë të rrugës. Dhe në trotuarin e djathtë, ku përherë kalonte shpurnja, kishte disa troje ndërtimi, të rretheuar me tela që Antonioja i kishte vëzhguar me orë të tëra.

- Zgjodhi një copë rrethimi që fillonte nga shtëpia e Vogëlushit Truhijo. Me pretekstin se po rregullonte pjesë të rrethimit të ndërmarrjes Shoqëria e Përbashkët, ku ai ishte menaxher (ajo i përkiste Pako Martinesit, vëllait të Damës së Hijshme), bleu dhjetëra metra nga i njëjti tel dhe tubat për të fiksuar rrethimin. Brenda tubave fshehu kallëpet e dinamitit. Meqenëse Shoqëria e Përbashkët zotëronte një rrethinë e Qytetit Truhijo dy gurore prej nga nxirrte lëndën e parë, e pati të lehtë që, sa herë shkonte atje, të vidhte kallëpe dinamiti që i fshihte në zyrën e tij, ku hynte i pari dhe dilte i fundit.
- Kur gjithçka ishte gati, planin e tij e diskutoi me Luis Gomes Peres dhe Ivan Tavares Kastejanos. Ishin më të rinj se ai, të dy studentë, i pari për avokati dhe i dyti për inxhinieri. Bënin pjesë në celulën e tij mes grupeve klandestine antitruhistë. Pasi i kishte studiuar javë të tëra, u bind se ishin seriozë, të besueshëm dhe të gatshëm për aksione. Të dy pranuan me entuziazëm. U morën vesh që të mos u thoshin asnjë fjalë të tjerëve, atyre tetë a dhjetë shokëve të asamblesë, me të cilët mblidheshin herë pas here në vende të ndryshme, ku diskutonin mënyrat se si do ta mobilizonin popullin kundër tiranisë.
- Bashkë me Luisin dhe Ivanin, të cilët i dolën edhe më të mirë nga ç'i priste, i mbushën tubat me kallëpë dinamiti e kapsolla me fitil, duke respektuar me saktësi largësinë midis tyre. Për të pasur të qartë sa kohë do të duhej saktësisht për të hequr pjesën e rrethimit të vjetër dhe për të vendosur të riun me tubat plot dinamit, bënë provën në territorin e fabrikës kur të gjithë punonjësit ishin larguar. Duheshin më pak se pesë orë. Më 12 qershor gjithçka ishte gati. Aksionin e planifikuan më 15 qershor, sapo Truhijo të kthehej nga një udhëtim në Sibao. E kishin siguruar edhe kamionin me të cilin do të prishnin atë pjesë të rrethimit, dhe me pretekstin e riparimit të tij - të veshur me kominoshet blu të Shërbimit Bashkiak - do të vinin atje tubat e mbushura me dinamit. Caktuan dy pikat e eksplozionit, pesëdhjetë hapa larg nga njëra-tjetra. Në

të djathtë do të ishte Imberti, dhe në të majtë Luisi me Ivanin. Do t'i komandonin shpërthimet në një ndërhyrje të shkurtër nga njëri-tjetri. I pari për ta vrarë Truhijo në çastin që do të kalonte pranë tubit, dhe i dyti për ta rivrarë.

- Dhe atëherë, një ditë para ditës së caktuar, më 14 qershor 1959, ndodhi ajo ulja e papritur me malet Konstanca e avionit të ardhur nga Kuba, i maskuar me shenjat e Aviacionit Domenikan, plot me partizanë antitruhistë. Ishte ndërhyrja që u pasua një javë më vonë me zbarkimet në plazhet Maimon dhe Estero Hondo. Zbarkimi i atij njësiti të vogël, ku bënte pjesë edhe komandanti mjekërosh kuban Delio Gomes Oçoa, bëri që t'i kalonin të rrëqethura regjimit. Tentativë e çmendur, e pakoordinuar. Grupet klandestine vendase nuk patën asnjë informacion për çka po përgatitej në Kubë. Ndihma e Fidel Kastros ndaj revolucionarëve antitruhistë, qysh prej rënies së Batistës gjashtë muaj të shkuar, ishte tema e ankthshme e mbledhjeve fshehta. Në planet që thureshin e shthureshin, logariteshin ndihma prej atyre që mblidhnin armë gjahu, pistoleta dhe ndonjë pushkë të vjetër. Por asnjëri prej të njohurve të Imbertit, që kishin kontakte me Kubën, nuk e kishte as idenë më të vogël se revolucionarët që do të zbarkonin më 14 qershor, pasi të ndesheshin me rojat e aeroportit të Konstancës, do të shpërndaheshin maleve përreth. Më vonë, ditëve në vazhdim, u gjuajtën dhe u vranë ferrave se lepujt, ose u kapën dhe u dërguan në Qytetin Truhijo, ku me urdhër të Ramfisit u vranë pothuajse të gjithë. Më përjashtim të kubanit Gomes Oçoa dhe djalit të tij të adoptuar, Pedrito Mirabal, të cilët regjimi (një tjetër gjest teatral) ia ktheu pas ca kohësh Fidel Kastros.
- Përndjekjet e mëdha që bëri qeveria për shkak të atij zbarkimi priteshin nga të gjithë. Për javë dhe muaj ato, në vend që të pakësoheshin, u shtuan. Agjentët zinin mbi çdo të dyshimtë dhe ia çonin SIM-it, ku i nënshtrohej torturave - tredhje, shpuarje veshësh e plasje sysh, ulje në Fron - që të tregonin emra. Burgjet Viktoria, Kuarenta dhe Nueve ishin plym me të rinj të dyja sekseve, studentë, profesorë dhe punonjës, pjesa më e madhe e të cilëve qenë bijtë ose të afërmit e njerëzve të pushtetit. Truhijo u habit: Si mundej që bijtë dhe nipërit e atyre që kishin përfituar më shumë se askush nga regjimi, të komplotonin kundër tij? Nuk u morën parasysh as mbiemrat

e tyre, as fytyrat e bardha dhe as veshjen e klasës së mesme.

- Luis Gomes Peres dhe Ivan Tavares Kastejano ranë në duart e agjentëve të SIM-it mëngjesin e ditës së caktuar për atentatin. Nga përvoja e tij, Antonio Imberti e ndjeu se nuk kishte as më të voglën mundësi të strehohej: Të gjitha ambasadat qenë rrethuar me policë, ushtarë dhe kalecë. E besoi edhe se nga torturat, Luisi dhe Ivani, apo kushdo prej grupeve të fshehta, do t'ia përmendte emrin dhe do ta kapnin. Atëherë, sikurse edhe këtë natë, e dinte mirë se ç'durej të bënte: T'i priste me plumbat e kalecët. Do të arrinte kështu të dërgonte ndonjë prej tyre në botën tjetër, para se ta bënin shoshë. Nuk do t'ua jepte kurrë atyre mundësinë t'ia shkulnin thonjtë me pincat, t'ia prisnin gjuhën apo ta mbërthenin në karrigen elektrike. Do ta vrisnin, po nuk do ta poshtëronin kurrë.
- Sajoi njëfarë shkaku dhe e nisi të shoqen, Guarinën, dhe të bijën, Leslin, të cilat nuk dinin gjë, te të afërmit që jetonin në pronat në La Romana, dhe me një shishe rum në dorë, u ul në tarracë. Pistoletën e mbushur dhe të pavënë në siguresë, e mbante në xhep. Por agjentët nuk u dukën as atë ditë, as të nesërmen, as të pasnesërmen, as në shtëpi, as në zyrë të Shoqërisë e Përbashkët, ku vijoi të shkonte rregullisht dhe me gjakftohtësi të plotë. Luisi dhe Ivani nuk kishin treguar asgjë, as ata të grupeve klandestine që e njihnin. Shpëtoi mrekullisht nga përndjekja që godiste fajtorë e të pafajshëm, që mbushi burgjet dhe që për herë të parë në njëzet e nëntë vitet e regjimit, tmerroi familjet e klasës së mesme, tradicionalisht mbështetëse të Truhijos. Pjesa më e madhe e të burgosurve ishin anëtarë të asaj lëvizjeje që, për shkak të atij zbarkimi të dështuar, u quajt "Lëvizja e 14 Qershorit". Një i afërm i Tonit, Ramon Imbert Rainieri - Monçoja - ishte njëri prej udhëheqësve të tyre.
- Përse shpëtoi? Pa dyshim prej trimërisë së Luisit dhe Ivanit, të cilët tani, dy vjet më vonë, vazhdonin të ishin në qelitë e Viktorias, dhe e vajzave e djemve të tjerë që nuk ia zunë emrin me gojë. Mbase e njihnin për një kureshtar të thjeshtë dhe jo një aktivist. Sepse, me druajtjen e vet, Toni Imberti mezi e hapte gojën në ato mbledhje ku e çoi për herë të parë Monçoja. Vetëm dëgjonte dhe fliste me fjalë njërrokëshe. Veç kësaj, SIM-i nuk duhej t'i kishte hapur dosje atij, ndryshe nga i vëllai, majori Segundo Imbert. Faqja e shërbimeve të tij ishte e pastër. E kishte kaluar jetën duke punuar për regjimin- inspektor

i përgjithshëm i Hekurudhave, guvernator i Puerto Platës, mbikëqyrës i përgjithshëm i Lotarisë Kombëtare, drejtor i zyrës së letërnjoftimeve - dhe tani ishte menaxher i Shoqërisë së Përbashkët, fabrika e kunatit të Truhijos. Përse duhej të dyshonin për të?

- Në ditët pas 14 qershorit, duke qëndruar natën në fabrikë, ai hoqi me kujdes dinamitin nga tubat dhe e ktheu në gurore, ndërkohë që vriste mendjen se me kë do ta vinte herë tjetër në jetë planin për të vrarë Truhijo. Ia rrëfeu gjithçka që kishte ndodhur (dhe çfarë mendonte për më vonë) mikut të tij më të ngushtë, Turkut, Salvador Estreja Sadalait, me të cilin bëri fjalë se përse nuk e kishte përfshirë edhe atë në atë komplot. Edhe vetë Salvadori kishte mbërritur në të njëjtin përfundim: Asgjë nuk do të ndryshonte sa të qe gjallë Truhijo. Filluan të shqyrtojnë të dy atentate të mundshme, por pa folur në sy të Amaditos, i mënjanuari i treshes, pasi u dukej i pamundur që adjutant ushtarak të donte të vriste Bamirësin.
- Por jo shumë kohë më pas, ndodhi një ngjarje traumatike në karrierën e Amaditos, i cili, për t'u graduar më lart, duhej të vriste një të burgosur (vëllanë e ish-të fejuarës, siç e pandehte), gjë që e bëri të ndërronte qëndrim. Së shpejti do të mbusheshin dy vjet nga zbarkimi në Konstanca, Maimon dhe Estero Hondo. Një vit e njëmbëdhjetë muaj e katërmbëdhjetë ditë, për të qenë të saktë. Antonio Imberti pa orën. Tani Cjapi nuk vjen më.
- Sa gjëra kishin ndodhur në Republikën Domenikane, nëpër botë dhe në jetën e tij personale. Shumë. Bastisjet masive të janarit të vitit 1960, ku u vranë shumë djem e vajza të "Lëvizjes 14 Qershorit", e mes të tjerëve motrat Mirabal dhe bashkëshortët e tyre. Prishja e Truhijos me bashkëpunëtorën e tij më të vjetër, Kishën Katolike, për shkak të Kartës Pastorale të peshkopëve në janar 1960, ku denoncohej diktatura. Atentati ndaj Presidentit të Venezuelës, Betankurit në qershor të vitit 1960, që mobilizoi kundër Truhijos shumë vende, përfshirë edhe aleatin e vet të përhershëm, Shtetet e Bashkuara, që votuan pro sanksioneve në Konferencën e Kosta Rikës më 6 gusht të vitit 1960. Dhe më 25 nëntor të vitit 1960 - Imberti ndjeu në gjoks të njëjtën zbrazëti të pashmangshme sa herë e kujtonte atë ditë të kobshme - vrasja e tri motrave, Minerva, Patria dhe Marie Teresa Mirabal dhe e shoferit të tyre, në Kumbre, në

lartësinë e kordiliereve veriore, tek ktheheshin nga vizita e burrave të tyre të burgosur në Fortesën e Puerto Platës.

- Lajmi për atë masakër u përhap shpejt dhe mistershëm në gjithë vendin. Ai qarkulloi gojë më gojë e shtëpi më shtëpi dhe në pak orë mbërriti në cepat më të largët, edhe pse nuk pati asnjë rresht në shtyp. Shpesh, lajmet e përcjella nga njerëzit, përziheshin, rrudheshin ose shtoheshin gjatë udhëtimit, deri- sa bëheshin mite, legjenda, trillime, gati pa lidhje me ngjarjen e vërtetë. Kujtoj atë natë të dikurshme në Malekon, ku pak muaj pas asaj masakre, jo shumë larg vendit ku ishte tani, duke pritur Cjapin, me mendimin për të marrë edhe hakun e tyre. Ishin ulur te parmaku me gurë, siç bënin përnatë - ai, Salvadori, Amaditoja dhe Antonio de la Masa - për t'u freskuar dhe për të biseduar larg veshëve të padëshiruar. Ngjarja e mo- trave Mirabal i mbushte të katër me urrejtje. Xhindoseshin kur komentohej se vdekja e atyre motrave të famshme lart në kordiliere kishte ndodhur prej një të ashtuquajturi aksident automobilistik.
- Po na vrasin prindërit, vëllezërit, miqtë. Tani edhe gratë. Dhe ne po presim radhën të nënshtruar, - tha Toni.
- Aspak të nënshtruar, Toni, - u hodh Antonio de la Masa. Kishte mbërritur nga Restauracioni. Ai ua solli lajmin e vdekjes së Mirabaleve që e kishte dëgjuar në rrugë. - Truhijo do ta pa- guajë. Gjithçka është gati. Por duhet bërë me kujdes.
- Në atë kohë atentati po përgatitej në Moka, gjatë një vizite të Truhijos në tokat e De la Masajve, mes udhëtimeve që po bënte në tërë vendin, për shkak të dënimit të OEA-s dhe sank- sioneve ekonomike. Një bombë do të shpërthente në kishën kryesore, të shuguruar Zemra e Shenjtë e Jezusit, dhe një rre- besh të shtënash do të vinin nga ballkonet, tarracat dhe nga kulla me sahat mbi Truhijo, kur ai të fliste në tribunën e ngritur në atrium, përpara njerëzve të grumbulluar rreth sta- tujës së San Huan Boskos, gjysmë e mbuluar me trinitaria. Im- berti e kishte kontrolluar vetë kishën dhe kishte menduar se vendi më i përshtatshëm për pusinë ishte kulla e sahatit.
- Toni i njihte Mirabalet, - i shpjegoi Turku Antonios. - Pran- daj u bë ashtu.
- Megjithëse nuk kishte të bënte me to, ai i njihte. Të tria gratë dhe burrat e Minervës dhe Patrias, Manolo Tavare Husto e Leandro Gusman, i kishte takuar rastësisht në mbledhjet e

atyre grupeve, ku me modelin e së famshmes Trinitaria de Duarte, që organizuar “Lëvizja 14 Qershori”. Të tria motrat ishin drejtuese të asaj organizate të rrallë dhe aktive, por pa rregulla dhe e çorganizuar, prandaj edhe u shkatërrua nga shtypja. Ato motra e kishin habitur për bindjet e tyre dhe guximin me të cilin qenë futur në atë luftë aq të pabarabartë e të pasigurt. Veçmas Minerva Mirabal. Kjo u kishte ndodhur të gjithë atyre që e kishin njohur, tek e dëgjonin të jepte mendime, të diskutonte, të propozonte dhe të merrrte vendime. Edhe pa e vrarë mendjen për ato gjëra, Toni Imberti tha pas vrasjes së tyre, se para se të njihte Minerva Mirabalin, kurrë nuk i kishte shkuar në mendje se një grua mund t’u kushtohej asisoj bëmave të burrave, si përgatitja e një revolucioni, gjetja dhe fshehja e armëve, e dinamitit, e bombave molotov, thikave, bajonetave, të bërit të atentateve, të strategjisë dhe taktikës dhe diskutimit me gjakftohtësi për glltitjen e helmit nga militantët, për të mos rrezikuar prej torturave kallëzimin e shokëve në rast se binin në duart e SIM-it.

Minerva fliste dhe të gjithë mbanin vesh kur diskutonte për gjëra si këto dhe se si të bëhej më mirë propaganda e fshehtë dhe rekrutimi i studentëve. Sa inteligjente ishte dhe sa qartë shpjegojhej. Bindjet e qëndrueshme dhe gojëtaria, u jepnin fjalëve të saj një forcë të çuditshme. Por ishte edhe shumë e bukur: Me ata sy dhe flokë pendë korbi, me tipare aq fine, me hundën dhe gojën të vizatuara kurore bukur dhe me atë bardhësi të dhëmbëve që spikasnin në ngjyrën qiellore të fytyrës së saj. Po, tmerrësisht e bukur. Kishte tek ajo diçka femërisht të fuqishme, një brishtësi, një lajkatim tepër të natyrshëm në lëvizjet e trupit dhe në buzëqeshje, megjithë thjeshtësinë e veshjes nëpër ato mbledhje. Toni nuk mbante mend ta kishte parë të lyer apo me grim ndonjëherë. Vërtet e bukur, mendoi, po kurrë ndonjëri nga të pranishmit nuk kishte guxuar t’i bënte ndonjë nga ato komplimentet, joshjet apo shakatë, që janë aq normale, të natyrshme, madje shpesh të detyruara mes domenikanëve, dhe akoma më shumë, kur janë të rinj e vërtet të bashkuar vëllazërisht për idealet, iluzionet dhe rreziqet e përbashkëta. Te figura e guximshme e Minerva Mirabalit, diçka i pengonte burrat që të silleshin ndaj saj me të njëjtën ndjesi besimi e lirie, sikurse me gratë e tjera.

Ajo ishte një legjendë e kohës, në atë botë të vogël të luftës

së fshehtë kundër Truhihos. Mes gjërave që thuheshin për të, çfarë ishin të vërteta, çfarë të tepruara e çfarë të sajuara? Askush nuk do të kishte guxuar ta pyeste, për të mos nde-shur atë vështrim të ashpër, përbuzës, dhe ndonjë nga ato përgjigjet e prera, që shpesh e linin të nemitur kundërshtarin. Thuhej se qysh adoleshente e kishte shpërfillur vetë Truhijon, duke refuzuar të vallëzonte me të, për ç'shkak i ati qe hequr si kryetar bashkie i Toho de Aguas dhe qe dërguar në burg. Kishte prej atyre që shtonin se ajo, jo vetëm e fyu, por e qëlloi edhe me shuplakë, ngaqë ai, duke vallëzuar me të, i futi duart dhe i tha diçka harbute. Këtë gjë të tjerët nuk e besonin ("Nuk do të ishte e gjallë. Menjëherë ai do të urdhëronte ta vrisnin ose do ta kishte vrarë vetë në vend"), kurse Antonio Imberti, po. Qysh herën e parë që e pa dhe e dëgjoi, ai nuk dyshoi kurrë se, nëse ajo shuplakë nuk kishte ndodhur, nuk do të thoshte se s'mund të ndodhte. Mjafton ta shikoje dhe ta dëgjoje disa minuta Minerva Mirabalin (të themi, duke folur me një natyrshmëri të vetën për nevojën e përgatitjes psikologjike të militantëve për t'u rezistuar torturave), për të kuptuar se sa e aftë ishte ta shuplakte vetë Truhijon nëse ai e fyente. Ajo ishte burgosur nja dy herë dhe për guximin e saj të çmendur tregoheshin anekdota, në fillim në Kuarenta, e më pas në Viktoria, ku kishte bërë grevë urie, i kishte rezistuar ndëshkimit me bukë dhe ujë me krimba dhe ku thuhej se e kishin keqtrajtuar barbarisht. Vetë ajo nuk fliste kurrë as për të kaluarën e vet në burg, as për torturat dhe as për të zezat që kishte hequr familja e saj qysh kur ishte diktuar si antitruhijiste. Nuk e kishte përmendur ndonjëherë përndjekjen dhe shpronësimin që u kishin bërë, as arrestin shtëpiak. Diktatura e lejoi Minervan të studionte për avokati, me synimin të hakmerrej keq me të pas diplomimit, me mohimin e së drejtës së profesionit, pra duke e dënuar me papunësi, me pamundësi për të jetuar, për t'u ndier qysh në rini të saj e dështuar dhe ato pesë vjet studime që bëri, të humbura. Por asgjë nga këto nuk e mposhti. Ajo vijoi e palodhshme t'u jepte kurajo të gjithëve, ishte një motorr i pandalshëm, lajmëtare – thoshte shpesh Imberti – e këtij vendi të ri, të bukur, entuziast, idealist, që një ditë do të bëhej vërtet Republika Domenikane.
U ndie ngushtë dhe sytë iu mbushën me lot. Ndezi një cigare dhe e thithi disa herë, duke e shfryrë tymin drejt detit,

në syprinën e të cilit ndriste një lojë drite e hënës. Ende nuk kishte nisur fladi. Së largu dukeshin rrallë e më rrallë drita makinash që vinin nga Qyteti Truhijo. Të katër shihnin andej, duke zgjatur kryet e duke shpuar errësirën me sytë plot ankth, por sapo afrohej ndonjë dritë rreth tridhjetë-dyzet metra dhe vërenin se nuk ishte Shevroleti i shumëpritur, fundoseshin të zhgënjyer në vendet e tyre.
Ai që dinte t'i përmbante më mirë emocionet, ishte Imberti. Gjithmonë kishte qenë i heshtur, por vitet e fundit, qekur e pushtoi ideja e vrasjes së Truhijos, që si një shushunjë po ia thithte energjitë, lakonizmi i tij u bë më i theksuar. Kurrë nuk kishte pasur shumë miq. Muajt e fundit jeta e tij u kufizua mes zyrës së vet në "Shoqërinë e Përbashkët", familjes e takimet e përditshme me Estreja Sadalain dhe toger Garsia Gerreron. Pas vdekjes së motrave Mirabal, mbledhjet e fshehta u ndërprenë. Përndjekjet e rrënuan "Lëvizjen 14 Qershori". Ata që shpëtuan, u tërhoqën në jetën e vet familjare dhe duke u përpjekur të mos dukeshin u persekutuan përditë nga pyetja: "Kur do të vijnë të më arrestojnë?" Pasigurija i bënte të ndiheshin keq, si të ishin fajtorë, si të ishin përgjegjës për ata që vuanin, për ata që kishin rënë në duart e Xhoni Abesit, ndërkohë që ata gëzonin lirinë.
Sigurisht, një liri e kufizuar. Qysh kur mori vesh se në ç'regjim jetonte, kujt qeverieje i kishte shërbyer që në të ri dhe vazhdonte ende t'i shërbente – çdo të bënte po të mos ishte menaxher i një fabrike të klanit? – ndihej i burgosur. Ideja për të eliminuar Truhijon, i ishte ngulur aq fort në ndërgjegje mbase për t'i shpëtuar ndjenjës se çdo hap ishte i kontrolluar, se çdo rrugë dhe çdo lëvizje e kishte të përcaktuar. Pakënaqësia ndaj regjimit, e gjatë dhe e fshehtë, që sa vinte e shtohej, ishte shumë më e hershme nga konfliktet politike të të vëllait, Segundos, i cili kishte qenë më truhihist se ai. Po kush nuk ishte truhihist gjatë atyre njëzet e pesë viteve? Të gjithë besonin te Cjapi si shpëtimtar i Atdheut. Ai u dha fund luftërave mes kapove dhe e shpëtoi vendin nga rreziku i pushtimit haitjan, i dha fund varësisë së turpshme nga Shtetet e Bashkuara, që kontrollonin doganat dhe nuk lejonin që vendi të kishte një monedhë domenikane dhe tha se miratonte vetë buxhetin. Truhijo, me të mirat e të këqiat e veta, e kaloi pushtetin te krerët e vendit. Ç'rëndësi kishte përpara kësaj se

ai shkonte me gratë që ia kishte qejfi? Apo se kishte shumë fabrika, ferma e kope për vete? A nuk qe shtuar pasuria e vendit? A nuk e pajisi këtë vend me Forcat e Armatosura më të fuqishme në Karaibe? Toni Imberti i kishte thënë dhe i kishte mbrojtur këto gjëra njëzet vjet rresht në jetën e tij. Prandaj xhindosej tani.
Tashmë Tonit nuk i kujtohej mirë se kur i kishin nisur dyshimet e para, pasiguritë, mospajtimet, që e çuan te pyetja: A shkonte vërtet aq mirë gjithçka apo qe një fasadë pas së cilës ky vend, nën drejtimin e ashpër të një burri jo të zakonshëm shteti, bënte përpara me hapa të sforcuara, fasadë, ku nuk shfaqej pamja e zymtë e njerëzve të paushqyer, të keqtrajtuar dhe të mashtruar, nga propaganda e fryrë dhe dhuna e një gënjeshtre të paparë. Këto dyshime, që si një pikëlim i pandalshëm kishin pikuar e pikuar përherë, e kishte gërryer truhihizmin e tij. Kur e hoqën si guvernator të Puerto Platës, ai u bind se ky regjim ishte diktatorial i dhe korruptuar dhe thellë-thellë vetes nuk ishte më truhihist. Por askujt nuk i tha, as Guarinës. Në sy të njerëzve vijonte të ishte truhihist, sepse regjimi, edhe pse i vëllai, Segundoja, ishte arratisur në Porto Riko, në shenjë zemërgjerësie vazhdoi t'i jepte poste, përfshirë (çfarë shenje besimi donte më?) edhe atë të firmës së familjes Truhijo.
Kishte qenë shqetësuese qe përditë, për vite me radhë, të bëje tjetër gjë nga ajo që mendoje, të bëje diçka kundër vetes. Në mendjen e tij kjo gjë e çoi fshehtas në vendimin për ta dënuar me vdekje Truhijon. E çoi në bindjen se sa të ishte i gjallë Cjapi, ai dhe shumë domenikanë të tjerë do të ishin të dënuar nga ajo torturë e tmerrshme dhe ai shqetësim i brendshëm: Të gënjehesh veten dhe të tjerët në çdo çast, të jesh i dyzuar, të jesh rob i një gënjeshtre publike dhe një të vërtete private, kjo e fundit e ndaluar për t'u shprehur.
Ky vendim i bëri mirë. Ia ngriti moralin. Jeta e tij pushoi së qeni e turpshme. Tani mund ta ndante me dikë të vërtetën, ndaj s'ishte më i dyzuar. Miqësia me Salvadorin ishte si e dërguar nga qielli. Përpara Turkut mund të fliste lirshëm për gjithçka që urrente. Miku i tij më i mirë, Salvador Estreja, me pastërtinë morale dhe ndershmërinë me çka përpiqej të përkryhej përmes besimit fetar, duke iu dorëzuar fesë asisoj sa e habiste Tonin, u bë model për të.
Pasi u bënë miq të ngushtë, Imberti filloi të frekuentojë grupet

e fshehta, falë kushëririt të tij, Monços. Edhe pse dilte nga ato mbledhje me përshtypjen se ato vajza e djem rrezikonin lirinë, të ardhmen dhe jetën e tyre, pa e gjetur ende rrugën e duhur për të luftuar kundër Truhijos, përsëri, prania atje një apo dy orë, pasi kishte mbërritur në atë shtëpi të panjohur (që çdo herë e ndërronin) përmes një mijë dredhash e duke ndjekur lajmëtarë të cilëve u identifikohej me kode të ndryshme, i dha një arsye për të jetuar, ia pastroi ndërgjegjen dhe ia orientoi jetën.
Guarina u mrekullua kur më në fund pa (nuk donte ta quante çudi këtë të papritur) se me çfarë merrej Toni. Edhe pse së jashtmi dukej e kundërta, ai nuk ishte më truhihist dhe, veç kësaj, punonte fshehtas kundër qeverisë. Ajo nuk u përpoq t'ia ndërronte mendjen. Nuk e pyeti se çfarë do të ndodhte me bijën e tij, Leslin, nëse atë e kapnin dhe e dënonin tridhjetë vjet burg, ose akoma më keq, nëse do ta vrisnin.
As gruaja, as vajza nuk dinin gjë për atë natë. Menduan se kishte shkuar në shtëpinë e Turkut për të luajtur letra. Ç'do të ndodhte po qe se dështonin?
– Ti beson te gjeneral Romani? – pyeti rrëmbimthi, më shumë për ta detyruar veten të mendonte tjetër gjë. – Është vërtet nga tanët? Edhe pse është i martuar me mbesën e Truhijos dhe është kunati i gjeneralëve Hose e Virhilio Garsia Truhijo, nipërve të dashur të Shefit?
– Po të mos ishte në anën tonë, me kohë do të ndodheshim të gjithë në Kuarenta, – tha Antonio de la Masa. – Është me ne, derisa të plotësohet kushti i tij: Të shohë kufomën.
– Vështirë ta besosh, – mërmëriti Toni. – Ç'do të fitojë me këtë Sekretari i Shtetit i Forcave të Armatosura? Do t'i humbasë të gjitha.
– E urren Truhijon më shumë se ti dhe unë, – u përgjigj De la Masa. – Edhe shumë të tjerë atë brenda. Truhijizmi është një kështjellë letrash bixhozi. Do të shembet, ke për ta parë. Pupo Romani ka bërë shumë ushtarakë për vete. Ata presin urdhërat e tij. Ai do t'ua japë dhe nesër ky do të jetë tjetër vend.
– Nëse vjen Cjapi, – u ankua nga vendi mbrapa Estreja Sadalai.
– Do të vijë, Turko, do të vijë, – iu përgjigj dhe njëherë togeri.
Antonio Imberti u zhyt përsëri në mendimet e veta. Do të gdhihej të nesërmen e lirë kjo tokë? E dëshironte me gjithë

zemër, por edhe tani, pak minuta para se të ndodhte, e kishte të vështirë ta besonte. Sa të tjerë ishin pjesë të përbetimeve, veç gjeneral Romanit? Kurrë nuk deshi ta mësonte. Më mirë të mos e dinte. Gjithmonë i ishte dukur e domosdoshme që të përbetuarit të dinin sa më pak, për të mos rrezikuar operacionin. I kishte dëgjuar me interes të gjitha ato që Antonio de la Masa u shpjegoi mbi zotimin e shefit të Forcave të Armatosura për të marrë pushtetin nëse vrisnin tiranin. Kështu rrethi i afërt i Cjapit dhe truhihistët kryesorë, do të kapeshin a do të vriteshin para se të shpërthente një aksion përndjekjesh. Ishte më mirë që djemtë e tij, Ramfisi e Radamesi, ndodheshin në Paris. Me sa njerëz kishte folur Antonio de la Masa? Shpesh, nëpër mbledhjet e gjata të muajve të fundit për të ribërë planin, Antonio de la Masa ndodhte të përmendte copëza informatash, gjysma fjalësh, që bënin të mendoje se kishte shumë njerëz të përfshirë. Toni ishte tejet i kujdesshëm. Kështu një ditë i kërkoi Salvadorit ta qepte gojën, kur ky, i indinjuar, nisi t'i tregojë se ai dhe Antonio de la Masa, në një mbledhje në shtëpinë e gjeneralit Huan Tomas Dias, patën një grindje me një grup konspiratorësh, të cilët e kishin kundërshtuar pranimin e Imbertit në përbetim. Nuk e besonin për të kaluarën e tij truhihiste. Dikush ia kujtoi madje telegramin e famshëm dërguar Truhijos ku ai kishte qenë i gatshëm për dëgjim e Puerto Platës. ("Do të më ndjekë deri në vdekje, edhe pas vdekjes", mendoi.) Turku dhe Antonioja kishin protestuar, duke thënë se vinin duart në zjarr për Tonin, por ai nuk e lejoi më Salvadorin të fliste:
– Nuk dua ta di, Turko. Ata që nuk më njohin nuk kanë pse të besojnë tek unë? Është e vërtetë se tërë jetën kam punuar për Truhijon, drejtpërdrejt ose jo.
– Po unë çfarë po bëj? – u hodh Turku. – Ç'bëjnë tridhjetë apo dyzet për qind e domenikanëve? Nuk punojmë për qeverinë ose për ndërmarrjet e tyre? Vetëm më të pasurit mund të kenë luksin të mos punojnë për Truhijon.
– As ata", mendoi Toni. Edhe të pasurit, nëse donin të vazhdonin të ishin të pasur, duhet të rreshtoheshin pas Shefit, duhet t'i shisnin atij pjesë nga pasuria e tyre ose të blenin pjesë nga pasuria e tij për të ndihmuar kështu madhështinë dhe fuqinë e atij veti. Me sytë gjysmëmbyllur, i nanurisur nga zhurma e qetë e detit, mendoi për mbrapshtinë e sistemit që

Truhijo kishte qenë i aftë të krijonte, për atë ku të gjithë domenikanët, kush më shumë e kush më pak, kishin marrë pjesë si bashkëpunëtorë. Nga ky sistem mundën të shpëtojnë vetëm të arratisurit (jo gjithmonë) dhe të vdekurit. Në këtë vend, në një mënyrë apo në një tjetrën, të gjithë kishin qenë, ishin dhe do të ishin pjesë e regjimit. "Më e keqja që mund t'i bjerë një domenikani, është të jetë inteligjent dhe i aftë", kishte dëgjuar të thoshte njëherë Alvaro Kabrali ("Një domenikan shumë inteligjent dhe i aftë", thuhej për të) dhe e kishte ngulur në mendje frazën "sepse atëherë, shpejt a vonë, Truhijo do ta thërrasë t'i shërbejë regjimit ose personalisht atij. Dhe nëse ai thirret, askush nuk thotë jo". Ai vetë ishte një provë e kësaj të vërtete. Kurrë nuk i shkoi në mendje ta kundërshtonte sadopak për ato emërime. Siç thoshte Sullani, Cjapi u kishte hequr njerëzve vetinë e shenjtë që ua fali Zoti: Vullnetin e lirë.
Ndryshe prej Turkut, në jetën e Antonio Imbertit, feja nuk qe kurrë e rëndësishme. Katolik i mënyrës domenikane, ai kishte kaluar nëpër të gjitha ceremonitë fetare të jetës së një njeriu – pagëzim, krezmim, kungim, kolegj katolik, martesë në kishë – dhe sigurisht do të varrosej i predikuar dhe dhe i bekuar nga prifti. Po kurrë nuk kishte qenë besimtar aq i ndërgjegjshëm, as i lidhur me çështjet e fesë në të përditshmen e vet, as i shqetësuar nëse sjellja e tij përkonte me urdhërat fetare, siç bënte Salvadori, që atij i dukej si një sëmundje.
Por ajo puna e vullnetit të lirë, e preku. Ndoshta këtë këtë vendosi që Truhijo duhej të vdiste. Që ai dhe të gjithë domenikanët të rifitonin aftësinë për të pranuar apo për të refuzuar, të paktën të drejtën për të jetuar. Tani Toni nuk e dinte çfarë ishte. Kur ishte fëmijë mbase e kishte ditur, po tani e kishte harruar. Duhej të ishte gjallë e bukur. Kupa e kafesë ose gota me rum duhej ta dinin më mirë. Tymi i duhanit, banja në det në një ditë të nxehtë, filmi i të shtunave apo merengat në radio, të linin në trup dhe në shpirt një ndjenjë më të këndshme, po të kishe atë që Truhijo ua rrëmbeu domenikanëve për tridhjetë e një vjet rresht: Vullnetin e lirë.

X

Sa dëgjohet zilja, Urania dhe i ati shtangin, duke parë njëri-tjetrin si të zënë në befasi. Në katin përdhes dëgjohen zëra dhe një thirrje habie. Hapa të nxituar që ngjisin shkallët. Dera hapet pothuajse njëherësh me ka trokitje të paduruara, dhe te hapësira e saj duket një fytyrë e hutuar, që Urania e njoh menjëherë: Kushërira e saj, Lusinda.
– Urania? Vërtet, Urania? - Sytë e mëdhenj e të shqyer nga habia, e këqyrin nga lart poshtë e poshtë lart. Hap krahët dhe ecën drejt saj, si për të provuar se nuk është një vegim.
– Unë e tëra, Lusindita. - Urania e përqafon të kushërirën, pak a vogël e hallë Adelinës, e cila është në një moshë me të, shoqen e saj të dikurshme të kolegjit.
– Nuk po më besohet, moj vajzë! Ti këtu? Pa të shikoj mirë! Po si është e mundur? Pse nuk më lajmërove? Përse nuk erdhe në shtëpi? Ke harruar se sa shumë të duam? Nuk e kujton më hallë Adelinën, Manolitën? Mua, të shkretën?
Është tepër e habitur, plot pyetje dhe kureshtje: - "O Zot, moj kushërirë! Po si ke duruar tridhjetë e pesë vjet – vërtet tridhjetë e pesë?! – pa e parë vendin tënd, pa parë familjen tënde?! Oh, moj vajzë! Kush e di sa gjëra ke për të treguar?!" Dhe s'e lë t'u përgjigjet pyetjeve që bën. Në këtë s'ka ndryshuar shumë. Qysh e vogël fliste shumë. Lusinda, entuzjastja, shpërthyesja, lojkacja. Kushërira me të cilën përherë shkoi mirë. Uranisë iu kujtua me veshjen e saj të shëtitjes, një fustan me dhë e xhaketë blu, ose me atë të së përditshmes në ngjyra rozë dhe të kaltër: një bullafiçe e shkathët, me baluke, me aparat dhëmbësh e një buzëqeshje në anë të buzëve. Tani është një zonjë e rëndë, e shëndetshme, me lëkurën e fytyrës shumë të tendosur e pa asnjë rrudhë, e veshur me një fustan të thjeshtë me lule. E vetmja stoli e saj, dy vathë të gjatë të artë që shndrisnin. Menjëherë ajo ndërpret shpalljen e dashurisë dhe pyetjet ndaj Uranisë për t'u afruar tek invalidi dhe e puth në ballë.

– Çfarë të papritur të këndshme të dha jot bijë, dajo. Nuk e

prisje që vajza të të ngjallej dhe të vinte për të vizituar. Çfarë gëzimi! Apo jo, dajë Agustin? Lusindita e puth burrin sërish në ballë dhe me të njëjtin hov largohet prej tij. Shkon dhe ulet pranë Uranisë, në anë të shtratit. I kap krahun, ia përkëdhel, e shikon me admirim dhe përsëri, duke klithur, e sulmon me pyetje:
– Sa mirë je mbajtur, moj vajzë. Jemi një moshë, apo jo? Po dukesh dhjetë vjet më e re. S'është e drejtë! Mbase, ngaqë s'je martuar dhe s'ke lindur fëmijë. Asgjë s'të shkatërron sa burri dhe fëmijët. Çfarë trupi, çfarë lëkure! Je si një vashë, Urani.
Urania dallon te zëri i së kushërirës ngjyrat, tonet dhe muzikën e asaj çupëline, me të cilën lozte aq shumë në oborret e Kolegjit Santo Domingo, duke i shpjeguar aq herë gjeometrinë dhe trigonometrinë.
– Një jetë pa u parë, Lusindita, pa lajme për njëra-tjetrën, - thërret më në fund.
– Për fajin tënd, o mosmirënjohëse, - e qorton kushërira me dashuri, po në sytë e saj regëtin tani ajo pyetje, ajo pyetje që të ungjit dhe të emtat, të afërmit dhe të afërmit kishin bërë shpesh vitet e para pas ikjes së Uranita Kabralit në fund të majit të vitit 1961, drejt qytetit të largët Adrian, në Miçigan, në "Siena Heights University", ku e kishin selinë Nunsat Domenikanë, të cilët drejtonin Kolegjin Santo Domingo. - Kurrë nuk e kam kuptuar, Urani. Ti dhe unë, përveç se kushërira, ishim edhe mikesha aq të ngushta. Çfarë ndodhi që nuk doje të dije më për ne? As për tët atë, as për ungjërit e tu, as për farefisin. Për mua. Të kam dërguar nja tridhjetë letra, por s'më ke kthyer asnjë rresht. Për të mos thënë kartolina, urime për ditëlindje. Edhe Manolita dhe mamaja. Ç'të bënim? Pse ishe aq e zemëruar, sa të mos na shkruaje kurrë dhe të mos shkelje në tokën tënde për tridhjetë e pesë vjet?
– Marrëzi rinie, Lusinda, - qesh Urania, duke e kapur për dore. - Por siç e sheh, kaloi dhe ja ku më ke.
– Vërtet që nuk je fantazmë? - E kushërira largohet pak si për ta vëzhguar, duke anuar kokën në shenjë mosbesimi. - Po si erdhe kështu, pa lajmëruar? Do të të kishim pritur në aeroport.
– Doja t'ju befasoja, - gënjen Urania. - E vendosa në çast. Qe befas. Hodha ç'më zuri dora në valixhe dhe mora avionin.
– Në shtëpi ishim të sigurt se nuk do të ktheheshe kurrë. - Lusinda merr pamje serioze. - Edhe dajë Agustini. Më duhet të të

them se ai ka vuajtur shumë. Ngaqë nuk doje të flisje me të, që nuk i përgjigjeshe në telefon. Dëshpërohej dhe qante para mamasë. Kurrë nuk u ngushëllua që e trajtove ashtu. Më fal, nuk e di pse t'i them këto, nuk dua të ndërhyj në jetën tënde, kushërirë. Flas nga besimi që kam pasur gjithmonë te ti. Më fol për veten. Në Nju Jork ke jetuar? Sigurisht, ia ke kaluar mirë. Të kemi ndjekur hap pas hapi, je një legjendë në familje. Vërtet punon në një studio shumë të rëndësishme?

– Jo, ka firma avokatësh më të mëdha se jona.

– Unë nuk habitem që ia ke dalë mbanë në Shtetet e Bashkuara, - thërret Lusinda, por Urania dalloi një shije të athët në zërin e së kushërirës. - Qysh e vogël dalloheshe për inteligjencë dhe studjuese. E thonin eproret tanë, motër Helen Kler, motër Francis, motër Susana dhe të gjitha, ajo që të donte shumë, motër Maria: Urani Kabral, një Ajnshtajn me fustan.

- Urania zë e qesh. Jo për ato çfarë thotë e kushërira, por nga mënyra se si e thotë: Me fjalë shumë dhe të bukura, duke folur njëherësh me gojë, me sy, me duar e me trup dhe me atë kënaqësinë e gëzimin e të folurit domenikan. Këtë të folur, krejt ndryshe nga e folura anglisht e njerëzve që e rrethonin nga mëngjesi në darkë në Adrian, Miçigan, në "Siena Heights University", e kishte zbuluar këto e tridhjetë e pesë vjet të shkuara, me të mbërritur atje.
- Kur ike as që u përshëndete me mua. Gati vdiqa nga dëshpërimi, - thotë e kushërira me nostalgji për ato kohë të shkuara. - Askush në familje nuk e mori vesh pse. Po ç'është kjo punë?! Si iku Urania në Shtetet e Bashkuara pa na përshëndeturi? E mbytem me pyetje dajën, por edhe ai s'dinte ç'të thoshte. "Murgeshat i ofruan një bursë dhe nuk donte të humbiste rastin." Por asnjë nuk e besonte.
- Ashtu ndodhi, Lusinda. - Urania shikon të atin, i cili sërish rri i palëvizur dhe i vëmendshëm, duke dëgjuar. - M'u dha shansi të studioja në Miçigan dhe ika si e marrë.
- Po, e kuptoj, - pranon e kushërira. - E meritoje atë bursë. Po pse të niseshe me aq nxitim? Pse të shkëputeshe ashtu me familjen tënde, me babanë tënd, me vendin tënd?
- Gjithmonë kam qenë pak e çmendur, Lusindita. Por edhe pse s'ju kam shkruar, gjithmonë ju kam kujtuar. Veçmas ty. Gënjeshtër. Nuk të mori malli për askënd, as për Lusindën besnike, shoqen tënde të shkollës dhe të prapësive. Edhe atë

doje ta harroje, si Manolitën, si hallë Adelinën dhe tët atë, sikurse këtë qytet dhe këtë vend, ato muajt e parë në Adrianin e largët, nëpër atë shesh të zgjedhur universitar me kopshte të pastër, plot begonia, tulipanë, manjola, trëndafila dhe pisha të larta, aroma vajore e të cilave mbërrinte deri në kthinën tënde, ku banoje vitin e parë me katër shoqe, mes të cilave, Alina, zezakja nga Xhorxhia, mikja jote e parë në atë botë re, aq e ndryshme nga ajo e katërmbëdhjetë viteve të tjerë. E dinin domenikanet e Adrianit pse ishe larguar me nxitim, falë motër Maries, drejtoreshës së Kolegjit Santo Domingo? Duhet ta dinin. Nëse motër Maria nuk do ta tregonte ç'kishte ndodhur, nuk do ta kishin dhënë atë bursë aq të nxituar. Motrat qenë model maturie dhe ato katër vite që kalove në "Siena Heights University", Urani, nuk pate as ngacmimin më të vogël ndaj historisë që ta lëndonte kujtesën. Veç kësaj, nuk pushuan së qeni shpirtmira me ty: Ti ishte e diplomuara e parë e atij universiteti që u pranove në Harvard, në universitetin më të famshëm në botë, ku u prite me nderime. Adrian! Miçigan! Sa vjet pa u kthyer më atje? Tani nuk ishte më qytetin provincial të fermerëve që mbylleshin në shtëpitë e tyre me të perënduar dielli, ku rrugët mbeteshin të shkreta shpejt, qyteti i familjeve, horizonti i të cilave mbaronte në këtë apo atë fshatrat të ngjanin si binjakë – Klinton dhe Çelsea – dhe që dëfrimin më të madh të tyre kishin të merrnin pjesë në panairin e famshëm të pulave të pjekura në Miçigan. Qe një qytet i pastër Adriani, i bukur, sidomos në dimër, kur dëbora mbulonte rrugicat e drejta – në to mund të bëje ski – ku fëmijët bënin njerëz prej bore, nën ato fjollëza të bardha, që i shihje e magjepsur se si binin nga qielli. Do të kishe vdekur nga hidhërimi, nga mërzia, nëse nuk do të kishe vendosur me aq nxitim për të studiuar.

Kushërira nuk pushon së foluri.

– Pak më vonë vranë Truhijon dhe erdhën fatkeqësitë. Në kolegjin tuaj u futën ata të SIM-it? Rrahën mësueset, Helenë Klerit iu mbulua fytyra me plagë e me njolla të zeza, vranë Badulakun, pastorin gjerman. Desh e dogjën dhe shtëpinë tonë, për shkak të krushqisë me babanë tënd. Thonin se dajo Agustini të dërgoi në Shtetet e Bashkuara, ngaqë e dinte se ç'do të ndodhte.

– Po, edhe ai donte të largohesha që këtej, - e ndërpreu Urania. - Edhe pse ishte dënuar nga fatkeqësia, e dinte që antitruhijistët do të hakmerreshin.

– E kuptoj, - pëshpëriti Lusinda. - Por që s'doje të dije për ne.
– Ti ke zemër të artë si gjithmonë. Jam e sigurt se nuk më mban mëri për këtë, - qeshi Urania. - Apo jo, moj vajzë?
– Sigurisht që jo, - pranoi e kushërira. - Ata dija se i jam lutur tim eti të më dërgonte në Shtetet e Bashkuara. Të isha me ty, në "Siena Heights University". Besoj se do ta kisha bindur, por erdhi shkatërrimi. Të gjithë nisën të na sulmojnë, duke thënë gënjeshtra të tmerrshme për familjen tonë, vetëm ngaqë mamaja ishte motra e një truhihisti. Askush nuk e kujtonte faktin se, në fond të fundit, Truhijo e trajtoi dajën si një qen. Ishte me fat që nuk u ndodhë ata muaj këtu, Urani. Gati vdiqëm nga frika. Nuk di si shpëtoi dajë Agustini dhe shtëpia juaj pa u djegur. Veç shpesh e sulmuan me gurë.
E ndërpreu një trokitje e lehtë në derë.
– Më falni që ju ndërpreva, - tha infermierja dhe pa nga invalidi. - Tani është ora.
Urania vështron pa kuptuar asgjë.
– Për të kryer nevojat e veta, - shpjegon Lusinda, duke i hedhur një sy aturakut. - Është shumë i rregullt. Lum ai, jo si unë që kam probleme stomaku dhe ha kumbulla të thata. E kam nga nervat, më thonë. Epo mirë, shkojmë në sallon, atëherë.
Ndërkohë që zbresin shkallët, Uranisë i kujtohet koha kur ishte studente në Adrian: Biblioteka e Madhe me qetësinë e ngjyrosur në krah të kishës dhe këndi i mencës ku kalonte pjesën më të madhe të kohës kur nuk kishte mësim apo seminar. Duke lexuar, duke studjuar, duke shkruar në fletore sprova, konspekte librash, e rregullt, këmbëngulëse, e përqendruar, aq sa fitoi admirimin e profesorëve dhe të shumë shoqeve. Pati edhe prej atyre që i tërbonte aftësia e saj. S'ishte dëshira për të mësuar, për të triumfuar, ajo që e mbyllte në bibliotekë, por dëshira vetëm të humbte mendjen, të hante kohën, të shtynte kohën me ato studime – shkenca a letërsia, ishte njësoj për të – për të mos menduar, për të larguar kujtimet domenikane.
– Po ti pse me këtë veshje sportive, - vërejti Lusinda kur u gjendën në holl, pranë dritares që shihte nga kopshti. - Apo ke bërë aerobi sot në mëngjes?
– Bëra vrap gjatë Malekonit. Dhe, duke u kthyer për në hotel, këmbët më sollën këtu. Prandaj jam me këtë veshje. Kam nja dy ditë që kam ardhur dhe hezitoja të vija ta shihja. Mendoja se do të kishte kuptim për të. Por as që më njohu.

– Të ka njohur shumë mirë. - Kushërira, Lusinda, hedh këmbën mbi këmbë dhe nxjerr nga çanta e vet paketën e cigareve dhe çakmakun. - Nuk flet dot, por e si kush hyn, kupton çdo gjë. Manolita dhe unë vijmë çdo ditë për ta parë. Mamaja nuk mundet qëkur theu kockën e legenit. Po të mos vijmë një ditë, ditën tjetër është i mërzitur.
Lusinda e vëren Uraninë asisoj, si të jetë gati për qortime të tjera. S'të vjen keq për babanë që po i kalon vitet e fundit të jetës i braktisur, në duart e një infermierje, dhe që e vizitojnë vetëm dy mbesat? A nuk duhet të jesh pranë tij dhe t'i falësh kujdes e dashuri? Mendon se duke të ardhur keq për të e ke bërë tënden? Të gjitha këto lexohen në sytë e saj. Po nuk guxon t'ia thotë. I zgjat Uranisë një cigare dhe, kur ajo nuk e kthen, gati thërret:
– Patjetër që nuk tymos. E merrja me mend. Jeton në Shtetet e Bashkuara. Ka një psikozë kundër duhanit atje.
– Po. Një psikozë të vërtetë, - pranon Urania. - Edhe në lokale është e ndaluar. Por as më intereson. Kurrë nuk e kam pirë.
– Vajzë e mbarë, - qesh Lusinda. - Moj ti, të pyes në konfidencë: Ke patur ndonjë ves, ti? Ke bërë ndonjëherë ndonjë nga ato marrëzitë që bën e gjithë bota?
– Ndonjë, po, - qesh Urania. - Por nuk tregohen.
Ndërsa bisedon me të kushërirën, këqyr sallonin e vogël. Mobiljet janë po ato. E trishton rrënimi aty: kolltuku ka një këmbë të thyer dhe tyre dhe të saj ka një kunjë; tapiceria, e shqupur, me vrima dhe e çngjyrosur. Urania e mbante mend me ngjyrë të kuqe të butë, një kuqe e ëmbël si e verës. Por më keq se mobiljet, qenë muret: njolla lagështire kudo dhe suvaja e rënë në shumë vende. Perdet nuk ishin më, kishte mbetur vetëm korniza me kapëset, bosh.
– Të bën përshtypje shtëpia që është katandisur kështu? - i thotë e kushërira, duke lëshuar një shtellungë tymi. - Ashtu është edhe jona, Urani. E vërteta është se familja u fundos me vdekjen e Truhijos. Babain tim e hoqën nga Monopoli i Duhanit dhe qysh atëherë mbeti pa punë. Vetëm se ishte kunati i babait tënd. Po yt atë e pësoi më keq. E hetuan, e akuzuan për shumë gjëra, i bënë gjyqe. Atij që e kishte pësuar edhe nga Truhijo. S'mundën t'i provojnë asgjë, por prapëseprapë, jeta e tij u rrënua. Lavdi Zotit që të pa mirë e mund ta ndihmosh. Të gjithë ashtu e kalojmë, hije e mos më keq. I mjeri dajë Agustin!

S’ishte nga ata që përfituan.
Urania dëgjon e mërzitur. Sytë e saj i japin më shumë zemër për të folur Lusindës, por mendja e saj është në Miçigan, në “Siena Heights University”, duke rijetuar ato katër vjet studimi dhe ankthi shpëtimtar. Të vetmet letra që lexonte dhe u përgjigjej, qenë ato të motër Maries. Të përzemërta, të thjeshta, ato kurrë nuk përmendnin ç’kishte bërë për të. Ajo qe e vetmja tek e cila Urania kishte pasur besim, ishte ajo që i bëri një zgjidhje të shkëlqyer, duke e nxjerrë nga ai vend dhe duke e dërguar në Adrian. Për këtë gjë ajo kishte kërcënuar edhe senatorin Kabral që të paguante. Por edhe sikur t’ia përmendte të mirën që i kishte bërë, Urania nuk do të mërzitej. A thua lehtësohej që herë-herë në ato letra, i hapte zemrën motër Maries për atë fantazmën që nuk e la kurrë të qetë?
Motër Maria i tregonte për kolegjin, për ngjarjet e bujshme, për trazirat e mëdha pas vrasjes së Truhijos, për ikjen e Ramfisit e të tërë familjes, për ndryshimet në qeveri, për dhunën e rrugëve, rrëmujën, e pyeste për studimet, i uronte sukseset.
–Përse nuk je martuar, moj vajzë? - Lusinda e shikon si ta përpijë me sy. - S’besoj se s’ke patur raste. Për ende mbahesh mirë. Më fal, por ti e di se sa kureshtare jemi domenikanet.
– Në të vërtetë, as unë nuk e di pse, - mbledh supet Urania. - Ndoshta nuk i kam kushtuar kohë kësaj pune. Gjithmonë kam qenë tepër e ngarkuar me studime dhe me punë. U mësova të jetoj vetëm e s’mundja ta ndaja jetën me ndonjë burrë.
Dëgjon veten dhe nuk e beson që po i thotë ajo ato fjalë. Lusinda, përkundrazi, nuk i vë në dyshim fjalët e saj.
– Ke bërë mirë, moj vajzë, - trishtohet Lusinda. - Çfarë fitova unë që u martova? I pacipi Pedro më braktisi me dy vajza. Iku një ditë dhe kurrë nuk më dërgoi një kacidhe. Për të rritur vajzat kam bërë gjërat më të mërzitshme, kam dhënë shtëpi me qera, kam shitur lule, u kam dhënë mësim shoferëve të rinj, nuk e imagjinon dot. Ngaqë nuk studiova, kjo ishte e vetmja mundësi pune. Lum si ti, moj kushërirë. Ke një profesion dhe e fiton jetën në kryeqytetin e botës me një punë që të pëlqen. Më mirë që s’je martuar. Por besoj se ke aventura edhe ti, hë?
Uranisë i prushiten faqet dhe trupi i saj e bën Lusindën të shpërthejë në qeshura.
– Ha, ha, ha, si u skuqe! Ke të dashur, ë? Tregomë! Është i pasur? Shumë i pamshëm? *Gringo* apo latin?

– Një zotëri me tëmtha të thinjura, tepër i pamshëm, - trillon Urania. - I martuar, me dy fëmijë. Shihemi në fundjavë, nëse nuk jam në udhëtim. Një marrëdhënie e këndshme dhe pa detyrime.
– Sa të kam zili, o vajzë! - përplasi shuplakat Lusinda. - Ëndrra ime. Një moshatar i pasur dhe i pamshëm. Duhet të shkoj ta gjej në Nju Jork, këtu të gjithë moshatarët tanë janë si mos më keq: balldavecë dhe xhepashpurt.
Në Adrian, Urania shkonte shpesh në festa, dilte në ekskursione me djem dhe vajza, shtihej sikur flirtonte me një djalë fermeri, një pikalosh ky, i cili i fliste për kuajt ose për ngjitjet e guximshme në malet me dëborë në dimër, por kthehej si e zbrazët në fletore, ngaqë i ishte dashur të bënte kinse. Pastaj kërkonte ndonjë pretekst për t'i shmangur dëfrimet. E kishte përdorur këtë listë në pretekste: provime, punë, vizita, mërzitje, afati i fundit për të dorëzuar papers. Gjatë viteve në Harvard, nuk mbante mend të kishte shkuar në ndonjë festë apo bar, as të kishte vallëzuar ndonjë herë të vetme.
– Edhe Manolitës si shkoi mbarë martesa. Jo pse i shoqi ishte feminist, si imi. Kokujo (në të vërtetë, quhet Esteban) nuk vret dot një mizë. Veç është njeri i papaftë. Gjithnjë e përzënë nga puna. Tani ka njëfarë pune me një pagë të ulët në njërin prej hoteleve të ngritur përgjatë Punta Kanas dhe ime motër e sheh një ose dy herë në muaj. Martesë i thua kësaj?
– Të kujtohet Rosalia Perdomo? - e ndërpret Urania.
– Rosalia Perdomo? - Lusinda kërkon në kujtesë me sytë gjysmë të mbyllur. - Në të vërtetë, jo... ah, po! Rosalia, ajo e asaj ngatërresës me Ramfis Truhijon? Po kurrë nuk e kam parë më këtu. Do ta kenë dërguar jashtë shtetit.
Hyrja e Uranisë në Harvard qe festuar në "Siena Heights University" si një ngjarje e rrallë. Para se të hynte atje, ajo nuk dinte gjë për famën që kishte ai universitet në Shtetet e Bashkuara dhe për nderimin e madh me të cilin përmendeshin të gjithë ata që studionin dhe mbaronin atje. Hyrja atje u zgjodh shumë thjeshtë. Edhe sikur të ishte munduar, nuk do ta kishte zgjedhur aq lehtë. Ishte në vitin e fundit. Drejtoresha e prirjeve, pasi e uroi për rezultatet e saj, e pyeti se ç'plane profesionale kishte dhe Urania iu përgjigj: "Më pëlqen avokatia". "Një karrierë ku fitohen shumë para", u shpreh doktoresha Doroti Sallison. Por Urania kishte thënë "avokatia", sepse ajo fjalë

i kishte ardhur në mendje. Mund të kishte thënë: mjekësia, ekonomia apo biologjia. Kurrë nuk kishte menduar për të ardhmen e vet. Jetonte e mpirë nga e shkuara. Aa i shkonte në mendje se ç'kishte përpara. Doktoresha Sallison shqyrtoi me mendësi se ç'kishte përpara. Doktoresha Sallison shqyrtoi me mendësi të ndryshme dhe zgjodhën katër universitete të njohura: Jalë, Notrë Dam, Çikago dhe Stenford. Nja dy ditë më vonë do të plotësonin kërkesat. Doktoresha Sallison i tha: "Pse jo dhe Harvardin? Nuk humbet gjë". Uranisë i kujtohen udhëtimet për intervistat, netët në bujtinat fetare që ia siguronin nënat dominikane. Dhe gëzimi i doktoreshës Sallison, i murgeshave dhe shokëve të diplomës, kur erdhën përgjigjet nga universitetet, përfshirë edhe Harvardin: E pranuar. I përgatitën një festë, ku për herë të parë iu desh të vallëzojë.
Jetën që kishte bërë ato katër vite në Adrian, s'besonte se do ta bënte kurrë më. Ndaj ruante një mirënjohje të thellë për dominikanet. Megjithatë, ndaj kujtesën e saj ishte një periudhë e përhershme, e paqartë, ku e vetmja gjë konkrete ishin orët e pafundme në bibliotekë, duke punuar për të mos menduar.
Kembrixh, Masaçuset, ishte tjetër gjë. Atje nisi të jetonte përsëri, të zbulonte se jeta e vlente të jetohej, se studjuarit nuk ishte vetëm një terapi, por edhe një kënaqësi, argëtim me dalllëdisë. Ç'argëtim në leksione, konferenca, seminare! E hutuar nga tepria e mundësive (veç Drejtësisë, vazhdonte si dëgjuese një kurs të historisë latinoamerikane, një seminar mbi Karaibet dhe një cikël mbi historinë e shoqërisë domenikane), nuk i mjaftonin orët e ditës dhe javët e muajit për t'i bërë të gjitha sa donte.
Vite plot punë, dhe jo vetëm intelektuale. Vitin e dytë në Harvard, i ati e njoftoi në njërën prej atyre letrave që kurrë nuk iu përgjigjej, se ngaqë punët s'po i shkonin mirë, ishte i detyruar t'ia shkurtonte dërgesën e parave nga pesëqind dollarë në muaj në dyqind. Falë huamarrjes studentore që siguroi, studimet e saj mbetën të paprekura. Por për të përballuar nevojat e saj modeste, në orët e lira punonte si shitëse në supermarket, kameriere në një piceri të Bostonit, paketuese në një farmaci dhe – puna më pak e lodhshme – damë shoqërimi dhe lexuese për një milioner të paralizuar polak, zotin Melvin Makovski, të cilit, nga ora pesë deri në tetë në mbrëmje, në shtëpinë e tij viktoriane me mure të purpurt, në "Massachusetts Avenue", i lexonte me zë të lartë romane voluminoze të shekullit të nën- tëmbëdhjetë

(Lufta dhe Paqja, Mobi Dik, Shtëpia e zymtë e por që papritmas në muajin e tretë, i propozoi martesë.
– Një paralitik? - shqeu sytë Lusinda.
– Shtatëdhjetëvjeçar, - saktësoi Urania. - Tepër i pasur. Më kërkoi të martoheshim. Dëgjon? Që t'i bëja shoqëri dhe t'i lexoja, asgjë tjetër.
– Ç'marrëzi, moj kushërirë! - u skandalizua Lusinda. - Do të ishe trashëgimtarja e tij. Do të ishe milionere.
– Ashtu është, do të kishte qenë një tregti e shkëlqyer.
– Eh, ke qenë e re, idealiste dhe ke besuar se njeriu duhet të martohet për dashuri, - e përligji e kushërira. - Eh të ishte ashtu. Edhe unë ia ktheva shpinën një rasti të mirë, me një mjek të krimbur në para. Vdiste për mua. Po ishte sterrë i zi, prej së ëmës haitjane, tonin. Nuk është punë paragjykimi, por... Sikur fëmija të më ngjante andej dhe të dilte si qymyr?
Uranisë i kishte pëlqyer shumë të studionte. Kishte qenë aq e kënaqur në Harvard, sa kishte menduar t'u kushtohej studimeve, të merrrte një doktoraturë. Po kush kishte para dhe ekonomike për këtë. I ati zhytej në situata të vështira përherë e më shumë. Vitin e tretë ia ndërpreu edhe pagesën e pjesshme mujore, ndaj iu desh të niste menjëherë t'i fitonte vetë paratë për të paguar borxhet universitare dhe për të jetuar. Autoriteti i Fakultetit të Drejtësisë në Harvard qe tejet i madh. Kur filloi të kërkonte punë, e thirrën në intervista. Vendosi të punonte në Bankën Botërore. E trishtonte mendimi për vendlindjen. Gjatë viteve në Kembrixh, e rrëmbeu "hobby pervers": Të lexonte dhe të mblidhte libra mbi Epokën e Truhijos.
Në hollin e vogël e të shkatërruar gjendet dhe një fotografi e diplomimit të saj. Ai mëngjes me diell të shkëlqyer që ndriçonte oborrin e madh, të stolisur nga tendat, veshjet elegante, berretat dhe togat shumëngjyrëshe të profesorëve dhe të të diplomuarve. Fotografi e njëjtë si ajo që senatori Kabral ka në dhomën e vet të gjumit. Nga e gjeti? Ajo nuk i ka dërguar gjë. Ah, motër Maria. Atë fotografi ia ka dërguar ajo Kolegjit Santo Domingo. Urania, deri në vdekjen e murgeshës, vazhdonte të shkëmbente letra me të. Siç duket ai shpirt i dhimbshur e mbante në dijeni senatorin Kabral për jetën e Uranisë. E kujtoi atë të mbështetur në parmakun e katit të sipërm të godinës së kolegjit, ku jetonin murgeshat dhe ishte i ndaluar për nxënësit, duke parë detin. Silueta e saj e turbullt dukej e zvogëluar

në atë kat ku dy pastorët gjermanë – Badulaku dhe Brutusi – vinin rrotull në fushat e tenisit, të volejbollit dhe pishinat.
Bën vapë dhe ajo po djersin. Kurrë nuk kishte provuar një zagushi të tillë edhe gjatë muajve më të nxehtë nju-jorkezë, atje nuk ndihej tej nxehtit nga rrymat e ftohta të ajrit të kondicionuar. Ndërsa vapa këtu është krejt ndryshe: Është vapa e fëmijërisë së saj. Por edhe veshët e saj ende nuk janë mësuar me këtë simfoni të jashtëzakonshme borish, zërash, muzike, lehjesh, frenash të ashpër, të panjohur atje dhe që tani po i hynte nga dritarja, duke e detyruar atë dhe të kushërirën ta ngrinin zërin.
– Është e vërtetë që babanë e futi në burg Xhoni Abesi kur vranë Truhijon?
– Nuk të ka treguar ai? - u habit e kushërira.
– Po unë isha në Miçigan, - e kujtoi Urania.
Lusinda shfajësohet me një gjysmëbuzëqeshje.
– Po, e futi. U çmendën të gjithë, Ramfisi, Radamesi, tërë truhihistët. Filluan të vrisnin, të burgosnin djathtas e majtas. Por shumë gjëra nuk i mbaj mend. Isha e vogël dhe nuk më interesonte politika. Ngaqë dajë Agustini kishte pasur njëfarë largimi nga Truhijo, menduan se bënte pjesë në komplot. E futën në atë burgun e tmerrshëm, Kuarenta, që u shkatërrua nga Balageri dhe ku u ndërtua një kishë. Mamaja vajti dhe takoi Balagerin. Ju lut. E mbajtën disa ditë brenda, derisa u provua se nuk ishte komplotist. Pastaj presidenti i dha një post të kotë, qesharak: Nëpunës i Gjendjes Civile të Rrethit të Tretë.
– Ju ka rrëfyer se si e trajtuan në Kuarenta?
Lusinda nxori një shtellungë tymi që ia mjegulloi në çast fytyrën.
– Ndoshta prindërit tanë, pasi unë dhe Manolita ishim të vogla. Dajë Agustini e vuajti faktin që për të menduan se e kishte tradhtuar Truhijon. Vite të tëra e kam dëgjuar të ankohet për padrejtësinë që i bënë.
– Shërbëtori më besnik i Gjeneralissimit, - u tall Urania. - Ai që për Truhijon ishte gati të bënte gjërat më monstruoze, u dyshua si bashkëpunëtor në vrasjen e tij. Ç'padrejtësi!
Heshti kur vërejti qortim në fytyrën e rrubullaktë të së kushërirës.
– Atë fjalën monstruoze nuk di pse e the, - mërmëriti e habitur. - Ndoshta ungji u gabua duke qenë truhihist. Tani thonë

se ai qe një diktator. Atë i shërbeu në mirëbesim. Edhe pse pati detyra të larta, nuk përfitoi gjë. Apo, jo? Tani po i kalon vitet e tij të fundit si një qen i braktisur. Pa ty do të ishte në një azil pleqsh.

Lusinda përpiqet të përmbante pakënaqësinë që i shkaktoi Urania. Thith fort për herë të fundit cigaren dhe ngaqë s'ka ku ta fikë (në hollin e shpartalluar nuk ka hirnore), e hedh nga dritarja në kopshtin e shkretuar.

– Unë e di mirë që im atë nuk i shërbeu Truhijos për interes.
– Urania nuk mund ta shmangë tonin e saj sarkastik. - Po kjo nuk më duket lehtësuese për të. Përkundrazi, e rëndon.

Tjetra e vështron pa mundur ta kuptojë.

– E ka bërë nga admirimi dhe dashuri ndaj tij, atëherë, - shpjegon Urania. - Prandaj e ndjeu veten aq të fyer që Ramfisi, Xhoni Abesi e të tjerët nuk kanë patur besim tek ai. Prandaj dhe kur Truhijo i ktheu shpinën, pothuajse u çmend nga dëshpërimi.
– E po mirë, u gabua, - përsërit e kushërira, duke kėkuar me shikimin e saj që të ndërronin temën e bisedës. - Por të paktën duhet ta pranosh se ka qenë shumë i ndershëm. S'mëndoi për rehatinë e vet si shumë të tjerë, të cilët ia kaluan mrekullisht me të gjitha qeveritë, veçmas me të trija qeveritë e Balagerit.
– Do të kisha preferuar t'i shërbente për interes Truhijos, për të vjedhur dhe për pushtet, - thotë Urania, duke qëmtuar sërish pakënaqësi e shqetësim në sytë e Lusindës. - Gjithçka do të kisha parapëlqyer, vetëm të mos e shihja duke qarë, ngaqë Truhijo nuk e pranoi në takim, ngaqë në "Forumin Publik" e kishin fyer me ca letra.

Ishte një kujtim që s'i shkulej nga mendja, që e torturoi në Adrian dhe në Kembrixh, që disi më i fashitur, e shoqëroi gjithkohë në Bankën Botërore, në Uashington D.C., dhe që e pushton ende në Manhattan: i mjeri senator Agustin Kabral, tek vinte rrotull si i tërbuar pikërisht në këtë holl, pyeste veten se çfarë intrigash kishin kurdisur kundër tij, Konstitucionalisti Sarhosh, hija Hoakin Balageri, ciniku Virhilio Alvares Pina dhe Paino Piçardo; përse Gjeneralisimi nuk donte t'ia dinte më nëse ekzistonte, apo jo? Ç'vlerë mund të kishte një senator dhe ish-ministër, të cilit Bamirësi nuk ia përfillte shkresat dhe as e lejonte të asistonte në Kongres? A thua do të përsëritej më të historia e Anselmo Paulinos? Ndonjë mëngjes do të vinin për ta marrë agjentët sekretë dhe do ta ndrynin në një qeli të

nëndheshme? A do të dilnin "La Nacion" dhe "Karaibet" plot me njoftime shpifëse mbi vjedhjet, përvetësimet, tradhtitë dhe krimet te tij?

– Fatkeqësia e tij ishte më e keqe se sa t'i kishin vrarë njeriun më të dashur.
E kushërira e dëgjon, gjithmonë më e pakënaqur.
– Për këtë je zemëruar, Urania? - thotë më së fundi. - Për politikë? Por unë mbaj mend se ty nuk të interesonte fare politika. Për shembull, kur hynë në mes të vitit ato dy vajzat që të mërzitnin i njihte, të gjitha ne thoshnim se ishin fukse. Ty të mërzisnin ato thashetheme politike dhe na e mbyllje gojën.
– Nuk më ka interesuar kurrë politika, - pohon Urania. - Ke të drejtë, po flas për gjëra të tridhjetë viteve të shkuara.
Infermierja duket te shkallët. Zbret duke fshirë duart me një rrobë të kaltër.
– I pastër dhe i pudrosur si një bebe, - njofton. - Mund të ngjiteni kur të doni. Do t'i përgatis drekën don Agustinit. Po ashtu edhe për ju, zonja?
– Jo, faleminderit, - thotë Urania. - Do të shkoj në hotel. Dua të bëj një banjë dhe të ndërrohem.
– Sonte patjetër do të vish te ne për darkë. Mamaja do të gëzohet shumë. Do ta njoftoj edhe Manolitën. Do të lumturohet. - Lusinda sajon një nojmë trishtimi. - Do të habitesh, shtëpinë kopshtin, garazhin dhe dhomat e shërbimit eshte plotësisht siç e ke lënë. Tani ka mbetur vetëm gjysma. Kur vdiq babai, na u desh ta shisnim kopshtin, garazhin dhe dhomat e shërbimit. Po mjaft me bullallallëqe. Sa të pashë, m'u kthyen kujtimet e viteve të fëmijërisë. Ishim të lumtura, ë? As na shkonte në mendje se gjithçka do të ndryshonte, se do të katandiseshim kështu. Mirë, po iki se më mbeti mamaja pa drekë. Do të vish për darkë. Kuptove? Mos na u zhduk si këto tridhjetë e një vjet. Hë, e mban mend shtëpinë? Mbi rrugën Santiago, nja pesë blloqe prej këtej.
– E mbaj mend shumë mirë. - Urania çohet në këmbë dhe përqafon të kushërirën. - Kjo lagje nuk ka ndryshuar fare.
E shoqëron Lusindën deri te porta e rrugës dhe ndahet duke e përqafuar prapë dhe duke e puthur në faqe. Kur e sheh që largohet me atë veshjen e saj me lule, nëpër rrugën e përvëluar nga dielli, ku disa lejeve të forta u përgjigjet një kakarimë pulash, e pushton trishtimi. Ç'bën këtu? Ç'kërkon në Santo

Domingo, dhe në këtë shtëpi? Të shkojë të darkojë me Lusindën, Manolitën dhe hallë Adelinën? E mjera ajo, do të jetë një fosile, si i ati.

- Ngjit shkallët, ngadalë, për të vonuar përballjen. Do Zoti e ndesh në gjumë të atin. E gjen të kruspullosur në kolltukun e vet, me sytë e rrudhur dhe me gojën të hapur. Gjoksi rakitik i ngrihet e i ulet rregullisht. "Si është katandisur: Një grimë njeri." Ulet mbi shtrat dhe e kundron. E këqyr, e përfytyron. Edhe atë e futën në burg me vdekjen e Truhihos. Mendonin se ishte njëri nga truhijistët që komplotoi me Antonio de la Masën, gjeneralin Huan Tomas Dias dhe vëllanë e tij Modeston, Antonio Imbertin dhe të tjerë. Ç'frikë dhe ç'shqetësim i madh, baba. Ajo e mësoi rastësisht, shumë vite më pas se edhe i ati kishte rënë në duart e policisë gjatë bastisjeve, nga një artikull kushtuar ngjarjeve domenikane të vitit 1961. Por kurrë nuk mësoi hollësira. Nga sa kujtonte në letrat e të atit, të cilave nuk iu përgjigj asnjëherë, senatori Kabral kurrë nuk aludonte për gjëra të tilla. "Që dikush për një çast të të imagjinonte se mendoje për të vrarë Truhijon, do të të dhimbte aq shumë, baba, sa thua do të të kishte gjetur hataja." A thua ta ketë hetuar personalisht Xhoni Abesi? Po Ramfisi? Apo Peçito Leon Estevesi? Do ta kenë ulur në Fron? Të ketë qenë i ati i lidhur me ndonjë nga komplotistët? E vërteta ishte se kishte bërë ç'ishte e mundur për të fituar simpatinë e Truhijos. E ç'provë ishte kjo? Shumë komplotistë i lëpinin këmbët Truhijos, deri pak çaste para se ta vrisnin. Kishte të ngjarë që Agustin Kabrali, miku i afërt i Modesto Diasit, të ketë qenë i informuar për atë që po kurdisej. Sipas disave, i tillë qënkej edhe Balageri. Nëse Presidenti i Republikës dhe Ministri i Forcave të Armatosura, ishin në dijeni, pse jo edhe babai i saj? Komplotistët e dinin se vetë Shefi, disa javë më parë kishte urdhëruar gjëmën e senator Kabralit. Pra, s'është çudi që të kenë menduar për të si një aleat të mundshëm.
- Herë pas here, i ati nxjerr ndonjë gërhimë të lehtë. Kur ndonjë mizë i ulet në fytyrë, e tremb pa u zgjuar me një lëvizje koke. Si e mësoi vrasjen e Truhijos? Më 30 maj 1961 ndodhej në Adrian. Ishte shkundur befas prej plogështisë dhe lodhjes që e kishin shkëputur nga bota dhe vetvetja, kur motra e ngarkuar me dhomat e gjumit kishte hyri në dhomën e Uranisë dhe i kishte treguar titullin e një gazete që mbante në dorë: *Truhijo*

killed. “Mund ta mbash”, i tha. Çfarë ndjeve? Betohej se s’kishte ndjerë asgjë, se lajmin e priti pa e lënduar fare, si gjithçka tjetër që dëgjonte dhe shikonte përreth. Kishte mundësi të mos e kishte lexuar fare artikullin, duke u mjaftuar vetëm me titullin. Ndërkohë, i kujtohej mirë se, ditë apo javë më vonë, në një letër të motër Maries kishte mësuar hollësitë mbi atë krim, mbi mësymjen e agjentëve të SIM-it në kolegj për të rrëmbyer peshkopin Reji dhe mbi traziren e katrahurën që përjetohej. Por as ajo letër nuk e nxori nga shpërfillja e thellë për çështjen domenikane dhe domenikanët, ku qe zhytur dhe nga ku, disa vjet më vonë, e nxorri ai kurs historie për Antilet në Harvard.

- Po vendimi i papritur për të ardhur në Santo Domingo dhe për të vizituar babanë, mos i thoshte se ishte shëruar? Jo, për të kishte ndier gëzim, emocion, duke takuar Lusindën, të ishte pranë shoqes së vermutit, e filmave të mëngjesit në kinema Olimpia dhe Elite, e plazheve dhe e “Country Clubit”. Duhet t’i vinte keq për mediokritetin e jetës dhe të ardhmen e paqartë të tjetrës. Por, nuk u gëzua, nuk u emocionua, nuk iu dhimbks. Përkundrazi, sentimentalizmi, vetëkeqardhja e saj, e mërzitën dhe i shkaktuan neveri.
- “Je një copë akulli. As që dukesh fare si domenikane. Më shumë ngjan unë për domenikan, se ti.” Ja, iu kujtua Stiv Dunkan, shoku që kishte në Bankën Botërore. Kur ishte, më 1985 apo 1986? Ishte ajo natë në Taipei, kur po darkonin së bashku në Gran Hotel, në formë pagode te tipit hollivudian, ku kishin bujtur, nga dritaret e të cilit qyteti dukej si një det xixëllonjash. Për të tretën, të katërtën apo të dhjetën herë, Stivi i propozoi martesë dhe Urania, më e prerë se herët e tjera, i tha: “Jo”. E habitur pa se si fytyra faqukuqe e Stivit u shtrembërua. Nuk mundi ta përmbante të qeshurën.
- Se mos fillon të qash, Stiv. Nga dashuria për mua? Apo ke pirë uiski më shumë se ujë?
- Stivi s’buzëqeshi. Qëndroi një çast duke e këqyrur pa iu përgjigjur, pastaj i tha atë frazë: “Je një copë akulli. As që dukesh fare si domenikane. Më shumë ngjaj unë për domenikan, se ti.” Pa shih, pa shih, flokëkuqi qënkej dashuruar me ty, Urani! Kush ishte ai? Njeri i shkëlqyer, i diplomuar për Ekonomi në Universitetin e Çikagos. Interesi i tij për Botën e Tretë lidhej me zhvillimin, gjuhët dhe femrat. Ai përfundoi i martuar me

një pakistaneze, funksionare e Bankës në fushën e Komunikacioneve.

- Vërtet je një copë akulli, Urani? Vetëm me burrat. Por jo me të gjithë. Me ata, vështrimet, lëvizjet, gjestet, tonet e zërit të të cilëve paralajmërojnë rrezik. Kur dallon në mendjen dhe instinktet e tyre qëllime për të t'u afruar rrotull, për t'u lidhur me ty. Atyre, po, u hedh atë ftohtësinë polare, që ti di si ta rrezatosh përreth, sikurse ajo era e pakëndshme që lëshojnë qelbësit për të përzënë armikun. Një teknikë që e zotëron me mjeshtëri dhe e përdor për të arritur synimet e tua: Studime, punë, jetë të pavarur. "Të gjitha, përveç lumturisë." Por a do të kishte qenë e lumtur nëse, e shtyrë nga vullneti dhe disciplina e saj, do të mposhtte kundërshtimin e patundshëm dhe neverinë që e jepnin burrat që tërhiqeshin prej saj? Ndoshta. Të kishte bërë ndonjë terapi, t'i ishte drejtuar ndonjë psikologu apo ndonjë psikoanalisti. Ata dinë shërim për të gjitha, edhe për neverinë ndaj burrave. Por kurrë nuk deshi të kuroheshe. Sepse nuk e konsideroje një sëmundje, por një cilësi të karakterit tënd, ashtu sikurse inteligjencën, vetminë dhe pasionin për ta bërë si duhej çdo punë.
- I ati i hap sytë dhe sheh si i trembur.

- M'u kujtua Stivi, një kanadez i Bankës Botërore, - i tha me zë të ulët, duke e shqyrtuar. - Ngaqë nuk desha të martohem me të, më tha se isha një copë akulli. Një akuzë, nga e cila çdo domenikan do të fyehej. Për ne thonë se jemi të zjarrtë, të etshëm në dashuri. Por mua më doli nami për të kundërtën: Nazemadhe, shpërfillëse, e ftohtë seksualisht. Të besohet, baba? Ja, s'ka pak që kushërirës sime, Lusindës, që të mos mendonte keq për mua, u detyrova t'i them se kam të dashur.
- Ajo hesht se vë re që invalidi, i mbledhur në kolltuk, duket i tmerruar. Tani nuk i tremb më mizat që i shëtisin qetësisht mbi fytyrë.
- Është një temë, për të cilën do të më pëlqente të flisnim, baba. Gratë, seksi. Pate aventura pas vdekjes së mamasë? Nuk kam vënë re gjë kurrë. Nuk dukeshe feminist. Apo pushteti të kënaqte deri në atë masë, sa s'kishe nevojë për seks? Çfarë s'ndodh në këtë botë që vlon. Njëlloj ndodhi dhe me Presidentin tonë të përhershëm, don Hoakin Balagerin. Apo jo? Nëntëdhjetë vjeç beqar. Ka shkruar poema dashurie dhe ka fjalë se ka një bijë të fshehtë. Gjithnjë më ka dhënë përshtypjen

se atij nuk i ka interesuar kurrë seksi, se pushteti i dha atë që të tjerëve ua dha shtrati. Dhe me ty ashtu ka qenë, baba? Apo pate aventura të fshehta? Të pati ftuar Truhijo në orgjitë e tij, në shtëpinë me Mogan? Çfarë ndodhte atje? E kishte edhe Gjeneralisimi, sikurse Ramfisi, kënaqësinë që t'i poshtëronte miqtë dhe kurtizanët, duke i detyruar të rruanin mjekrët, të hiqnin qimet dhe të bënin makiazh si plakat plaka? I bënte ato shakara ai? I ka bërë me ty?

- Senatori Kabral është i zbehtë, aq sa Urania mendon: "Do t'i bëjë të fikët." Për ta qetësuar, largohet prej tij. Shkon te dritarja dhe mbështetet me shpinë nga jashtë. Ndien përvëlimin e diellit mbi kafkë dhe faqet i skuqen si nga ethet. Po djersin. Do të kthehesh në hotel e të bësh një dush me ujë të freskët. Të zhytet në pishinën me pllaka të kaltra e pastaj të provosh menynë vendase që ofron restoranti i Hotel Haragua. Duhet të ketë fasule me oriz dhe me mish derri. Po nuk ka dëshirë për asgjë. Më mirë shko në aeroport dhe merr avionin e parë që niset për Nju Jork e rifillo jetën mbi tryezën e punës dhe në apartamentin tënd në Medison dhe rrugën 73.
- Kthehet e ulet mbi shtrat. I ati mbyll sytë. Fle, apo bën sikur fle, nga frika që i shkakton ti? Je duke e shqetësuar mjerin invalid. Atë dëshiroje? Ta mërzitësh, ta bësh të jetojë ca orë të tmerrshme? Je e kënaqur tani? Lodhja e ka pushtuar plotësisht Uraninë, dhe me sytë që po i mbyllen, ngrihet në këmbë.
- Mekanikisht shkon drejt dollapit të rrobave që të plotësisht në një cep të dhomës. Është gjysmë i zbrazur. Në disa varëse teli varen një kostum ngjyrë plumbi që reflekton si gjethe qepe dhe disa këmisha të lara, të pahekurosura, dy prej të cilave kanë pulla mangut. Ja si qenka katandisur gardëroba e Senatorit Agustin Kabralit! Ka qenë një burrë elegant. I kujdesshëm për veten dhe i pastër, siç i pëlqente Shefit. Ku janë smokingët, fraku, kostumet e prera prej stofi anglez, këmishat e bardha fine? Do t'i kenë vjedhur shërbyesit, infermieret, të afërmit nevojtarë.
- Lodhja është më e fortë se vullneti për të ndenjur zgjuar. Mezi duron që të hidhet në shtrat dhe të mbyllë sytë. Por para se të flerë, arrin të mendojë se ai shtrat mban erë burri plak, erë çarçafësh të vjetër, erë ëndrrash tepër të vjetra dhe të frikshme.

XI

– Një pyetje, Shkëlqesi, - tha Simon Gitlemani, i skuqur nga gotat me shampanjë dhe verë ose mbase prej emocionit. - Nga gjithë masat që keni marrë për ta bërë të madh këtë vend, cila qe më e vështira?
– Fliste një spanjishte të shkëlqyer, me një theks të zgjatur, që s'kishte asgjë të përbashkët me atë folurën karikaturë, plot gabime dhe me intonacion të parregullt të shumë gringove, të cilët kishin hyrë e dalë në zyrat dhe sallonet e Pallatit Kombëtar. Sa qe përmirësuar spanjishtja e Simonit qysh nga viti 1921, kur Truhijo, toger i ri i Gardës Kombëtare, qe pranuar nxënës në Shkollën e Oficerëve të Hainas dhe pati atë si instruktor. Atëherë marinsi llomotiste një gjuhë barbare, të mbushur me fjalë të pista. Gitlemani e kishte formuluar pyetjen me zë aq të lartë, sa bisedat u ndërprenë dhe njëzet koka - kureshtare, të qeshura, të rënda - u kthyen nga Bamirësi, duke pritur përgjigjen e tij.
– Do t'ju përgjigjem, Simon, - bëri Truhijo zërin e zvraitiur e të rrumbullt të rasteve solemne. Nguli vështrimin mbi shandanin e kristaltë në formë petalesh të llambës dhetoshi: - Më 2 tetor 1937, në Dahabon.
– Pati shkëmbime të shpejta shikimesh mes të pranishmëve në drekën e shtruar nga Truhijo për Simon dhe Doroti Gitleman, pas ceremonisë ku ish-marinsi qe dekoruar me Urdhrin "Merito Huan Pablo Duarte". Duke e falenderuar, Gitlemanit iu ngjir zëri. Tani përpiqej të gjente se për çfarë e kishte fjalën Shkëlqesia e Tij.
– Ah, haitjanët! - përplasja e dorës së tij mbi tavolinë, bëri të tringëllinin qelqurinat delikate të kupave të verës, tabakatë, gotat dhe shishet. - Dita kur Shkëlqesia Juaj vendosi të presë nyjen gordiane të sulmit haitjan.
– Të gjithë i kishin gotat me verë, ndërsa Gjeneralisimi pinte veç ujë. Dukej serioz, i zhytur në kujtime. Qetësia u rëndua më shumë. I rreptë, teatral, ngriti duart e ua tregoi të ftuarve:

- Për këtë vend i kam me njolla gjaku, - tha, duke iu mëshuar rrokjeve një për një. - Që zezakët të mos na kolonizonin sërish. Me dhjetëra mijëra me të gjitha anët. Sot nuk do të ekzistonte Republika Domenikane. Sikurse më 1840 i gjithë ishulli do të bëhej Haiti. Një grusht të bardhësh që do të mbijetonin, do t'u shërbenin zezakëve. Ai qe vendimi im më i vështirë në tridhjetë vjet qeverisje, Simon.
- Për të zbatuar urdhrin tuaj, brodhëm nga njëri cep te tjetri, - deputeti i ri Henri Çirinos u përkul mbi hartën e madhe të hapur mbi tryezën e Presidentit dhe shenjoi: - Nëse vazhdon kështu, nuk do të ketë asnjë të ardhme për Kiskejan, Shkëlqesi.
- Situata është më e rëndë nga ç'thotë informacioni, Shkëlqesi, - gishti i brishtë i deputetit të ri Agustin Kabral ndoqi linjën me pika të kuqe që ulej në formë S-je nga Dahaboni në Pedernales. - Mijëra e mijëra kanë ardhur dhe janë ngulur në pronat, fushat e fshatrat. Kanë zhvendosur krahun domenikan të punës.
- Punojnë falas, pa u paguar, vetëm për bukën e gojës. Meqënëse në Haiti s'kanë për të ngrënë, ca oris dhe një dorë fasule u del dhe u tepron.
- Me një gjest Çirinosi ia dha fjalën mikut dhe kolegut të tij.
- Është e kotë të bisedosh me pronarët e tokave dhe zotërit e fermave, Shkëlqesi, - saktësoi Kabrali. - Të përgjigjen duke të treguar xhepin: "Ç'rëndësi kanë se janë haitjanë, nëse janë korrës të mirë të kallamit të sheqerit dhe punojnë për dy kaci dhe? Për patriotizëm nuk do të shkoj kundër interesit tim."
- Heshti dhe pa nga deputeti Çirinos, i cili mori fjalën:
- Në Dahabon, Elias Pinja, Indipendenca dhe Pedernales, në vend të spanjishtes kumbojnë hungërimat kreole afrikane.
- Pa nga Agustin Kabrali dhe vazhdoi:
- Këto besimet afrikane Vudu* dhe Santeria*, po e çrrënjosin fenë katolike, simbol i kombësisë sonë, sikurse gjuha dhe raca jonë.
- Kemi parë priftërinj duke qarë nga dëshpërimi, Shkëlqesi, - u hodh deputeti i ri Çirinos. - Egërsia parakristiane po pushton vendin e Diego Kolombit, të Huan Pablo Duartes dhe Truhijos. Shtriganët haitjanë kanë më shumë rëndësi se priftërinjtë tanë, falltarët e tyre vlejnë më shumë nga mjekët tanë.

- Ushtria s’bënte asgjë? - Simon Gitlemani gjerbi një gllënjkë verë. Një kamerier me uniformë të bardhë nxitoi t’ia mbushte gotën përsëri.
- Ushtria bën atë që urdhëron Gjeneralisimi, Simon, ti e di.
- Vetëm Shefi dhe ish-marinsi flisnin. Të tjerët dëgjonin me kokat që u lëviznin sa nga njëri te tjetri. - Gangrena kishte hyrë thellë. Montekristi, Santiago, San Huan, Azua, qenë mbushur me haitjanë. Murtaja përparonte dhe askush nuk bënte asgjë. Pritej një burrë shteti me vizion, të cilit nuk do t’i dridhej dora.
- Imagjino një hidër me një numër të pafund kokash, Shkëlqesi, - deputeti i ri Çirinos poetizonte me gjeste akrobatike. - Krahu i punës së tyre vjedh punën e domenikanit, i cili, për të mbijetuar, shet tokën dhe fermën e tij. Kush i blen ato? Haitjanët e pasur.
- Është koka e dytë e hidrës, Shkëlqesi, - foli deputeti i ri, Kabrali. - Përveçse zënë punën e vendit dhe rrëmbejnë pak nga pak pavarësinë tonë.
- Po ashtu grabisin edhe gratë tona, - ashpërsoi zërin, duke sjellë një klimë fëlligështie, i riu Henri Çirinos. Gjuha e tij e kuqërremtë dilte gjarbërisht mes buzëve të trasha. - Asgjë nuk e tërheq aq shumë mishin e zi, sesa mishi i bardhë. Përdhunimet e domenikaneve nga haitjanët janë të përditshme.
- Nuk bëhet fjalë për vjedhjet, sulmet ndaj pasurive, - këmbënguli i riu Agustin Kabral. - Bandat e keqbërësve kapërcejnë lumin Masakre, si të mos kishte dogana, kontrolle, patrulla. Kufiri është bërë shoshë. Si një re karkalecësh bandat rrënojnë fshatrat dhe pronat. Pastaj kthehen në Haiti me kopetë dhe gjithçka që kanë rrëmbyer për t’i ngrënë e për t’i veshur. Ajo krahinë nuk është më e jona, Shkëlqesi. Aty kemi humbur gjuhën, fenë dhe racën tonë. Tani është pjesë e barbarëve haitjanë.
- Doroti Gitlemani mezi fliste spanjisht dhe duke se po mërzitej me këtë bisedë mbi ato çfarë kishin ndodhur njëzet e katër vjet më parë, por miratonte tejet serioze duke parë herë nga Gjeneralisimi e herë nga i shoqi, si të përpiqej mos humbiste asnjë rrokje nga ato që thoshte ai. E kishin ulur midis Truhijos dhe Ministrit të Forcave të Armatosura, gjeneralit Hose Rene Roman. Ishte një plakë e vogël, e dobët, e drejtë, e rinuar nga veshja verore me tonë të trëndafiltë. Gjatë ceremonisë,

kur Gjeneralisimi tha se populli domenikan nuk do ta harronte solidaritetin që kishte treguar çifti Gitleman në ato çaste të vështira, kur shumë qeveri bënë të kundërtën, asaj iu mbushën sytë me lot.

– Unë e dija ç'po ndodhte, - pranoi Truhijo. - Por doja ta vërtetoja që të mos më ngelej asnjë dyshim. Asatëherë kur mora informatën e Konstitucionalistit Sarhosh dhe të Inteligjentit, të cilët i dërgova në vendin e ngjarjes, nuk mora një vendim. Vendosa ta shkoj vetë në kufi dhe e shëtita me kalë kufirin, i shoqëruar nga vullnetarët e Gardës Universitare. I pashë me sytë e mi: na kishin pushtuar përsëri, si në vitin 1822. Kësaj here paqësisht. A duhet të lejoja që haitjanët të qëndronin në vendin tim njëzet e dy vjet të tjerë?
– Asnjë patriot nuk do ta kishte lejuar, - thirri senatori Henri Çirinos, duke ngritur gotën. - Jo më, Gjeneralisim Truhijo. Një dolli për Shkëlqesinë e Tij!
– Truhijo vijoi si të mos kishte dëgjuar gjë:
– Mund ta lejoja që, sikurse në ato njëzet e dy vjet pushtimi, zezakët të vrisnin, të përdhunonin, deri edhe brenda në kisha, domenikanët?
– Duke parë se dollia e tij dështoi, Konstitucionalisti Sarhosh gulçoi, hodhi një gotë dhe u kthye të dëgjonte.
– Gjatë atij kontrolli në kufijtë tanë, me Gardën Universitare, lulja dhe ajka e rinisë, isha duke shqyrtuar të kaluarën, - vazhdoi Gjeneralisimi duke e shtuar euforinë. - Kujtova therrjet në kishën e Mokës. Djegien e Santiagos. Marshimin nga Haiti, të Desalinesit dhe Kristoforit dhe nëntëqind njerëzit e shquar të Mokës, që vdiqën rrugës ose u ndanë si skllevër midis ushtarakëve haitjanë.
– Për më shumë se dy javë, po i japim të dhëna dhe Shefi nuk po bën asgjë, - u shqetësua deputeti i ri Çirinos. - A thua do të marrë ndonjë vendim, Inteligjent?
– Mos më pyet mua, - u përgjigj deputeti i ri, Kabrali. - Gjeneralisimi e di që situata është e vështirë. Ai do të vendosë për të vepruar.
– Të dy e kishin shoqëruar Truhijon në udhëtimin e tij me kalë gjatë kufirit, së bashku me qindra vullnetarë të Gardës Univesitare dhe kur mbërritën në qytetin e Dahabonit, gulçonin më shumë se kuajt e tyre. Të dy, edhe pse të rinj, kishin parapëlqyer të shplodhnin kockat e dërrmuara nga kalërimi,

po Shkëlqesia e Tij i kërkoi të ishin në një takim me elitën e Dahabonit dhe s'kishin ç'të bënin. Po rrinin atje, në bashkinë e stolisur, të mbytur nga vapa, me këmishat me jakë të fortë dhe me smokingët e mbërthyer. Ndërsa Truhijo, i freskët, si të mos kishte udhëtuar mbi kalë qysh nga mëngjesi, me uniformën në ngjyrë blu në gri, të mbushur me dekorata dhe gajtanë, lëvizte midis grupeve të ndryshme, duke pritur nderime me një gotë konjaku "Karlos I" në dorën e djathtë. Në ato çaste, dalloi një oficer të ri me çizmet gjithë pluhur, duke hyrë vrundull në sallonin plot famuj.

- Erdhe në këtë festë ceremoniale, i djersitur dhe me uniformën e fushimit, - Bamirësi e ktheu befas vështrimin nga Ministri i Forcave të Armatosura. - Sa neveri ndjeva.
- Vija t'i jepja një informacion shefit të regjimentit tim, Shkëlqesi, - u ngatërrua gjeneral Romani, dhe pas një heshtjeje, gjeti se cilës kujtesa e tij mundohej të gjente atë episod të largët, tha: - Një bandë keqbërësish haitjanë kishte hyrë fshehur në vendin tonë. Atë mëngjes sulmuan tri ferma në Kapotijo dhe Paroli, duke grabitur të gjithë bagëtitë. Madje vranë edhe tre vetë.
- Ti spekulove për karrierën, duke u shfaqur si palaço në praninë time, - e qortoi sërish Gjeneralisimi me një zemërim të hershëm. Mirë atëherë.
- Ka vajtur ku s'mban më. Të rrijë këtu Ministri i Luftës, ai i Qeverisë dhe gjithë ushtarakët e pranishëm. Të tjerët të bëjnë mënjanë, ju lutem.
- E ngriti zërin e çjerrë në një ton histerik, si dikur kur jepte urdhra në gazermë. Vendosi aty për aty mes asaj zhurme grerëzash. Ushtarakët formuan një rreth të ngjeshur përanesh tij. Zonjat dhe zotërinjtë u tërhoqën drejt mureve, duke lënë një hapësirë boshe në qendrën e sallonit të stolisur me shirita e yje letrash, me lule e flamurka domenikanë. Presidenti Truhijo dha urdhrin e prerë:
- Duke nisur nga mesnata, forcat e ushtrisë dhe të policisë të veprojnë për të shfarosur pa mëshirë të gjithë qytetarët haitjanë që kanë hyrë ilegalisht në territorin domenikan, veç atyre që ndodhen në fabrikat e sheqerit, - pasi pastroi zërin, hodhi një vështrim të zymtë mbi rrethin e oficerëve dhe tha: - Qartë?
- Të gjitha kokat miratuan, disa me një shprehje habie, të tjerët me një shkëlqim gëzimi të egër në sy. Përplasën takat para

se të shpërndaheshin.

- Shef i Regjimentit të Dahabonit: Futë në qeli, vetëm me bukë dhe ujë, oficerin që guxoi të hynte këtu në atë gjendje neveritëse. Të vazhdojë festa! Bëni qejf!
- Në çehren e Simon Gitlemanit admirimi përzihej me nostalgjinë.
- Shkëlqesia e Tij kurrë s'është lëkundur në çastin e marrjes së vendimit, - ish-marinsi iu drejtua gjithë tavolinës. - Unë pata nderin ta stërvit në Shkollën Hainas. Qysh në fillim e nuhata që do të ecte përpara. Por kurrë nuk e mora me mend se do të shkonte kaq larg.
- E qeshura e tij e ëmbël jehoi përreth.
- Kurrë nuk më kanë dridhur, - përsëriti Truhijo, duke treguar duart e veta. - Sepse kam dhënë urdhër për të vrarë, kur ishte absolutisht e domosdoshme për të mirën e vendit.
- Diku kam lexuar, Shkëlqesi, se ju urdhëruat që ushtarët të përdornin bajoneta e thika dhe të mos qëllonin me armë, - pyeti Simon Gitlemani. - Për të kursyer municionin?
- Për të sheqerosur pilulën për reagimeve ndërkombëtare, - e korrigjoi Truhijo me tallje. - Nëse do të përdoreshin vetëm armë të ftohta, operacioni mund të dukej si një lëvizje spontane fshatarësh, pa ndërhyrjen e qeverisë. Ne domenikanët jemi të çuditshëm, kurrë nuk kemi kursyer asgjë, aq më pak municionet.
- Gjithë tavolina e festoi me të qeshura. Edhe Simon Gitlemani qeshi dhe foli përsëri:
- Është e vërtetë ajo puna e *perehilit,* Shkëlqesia Juaj? Që për të dalluar haitjanët prej domenikanëve, i detyronin të shqiptonin fjalën *perehil*? Dhe atyre që nuk e shqiptonin mirë, u prisnin kokën?
- E kam dëgjuar atë anekdotë, - mblodhi supet Truhijo. - Ishte një thashethem që qarkullonte.
- Uli kokën, si të donte të përqendrohej i gjithi në një mendim i thellë. Në të vërtetë, vështrimi i tij kërkonte me ngulm tek e çara e pantallonave dhe midis kofshëve të veta, atë njollë tradhtare. Nuk kishte gjë. I hodhi një buzëqeshje miqësore ish-marinsit:
- Nëse do të dish për të vrarët, - tha me shaka. - Pyet këta që janë ulur në këtë tavolinë dhe do të dëgjosh shifra nga më të ndryshmet. Për shembull, ti, senator, sa ishin?

Faqja e errët e Henri Çirinos u përndez, e mbushur me kënaqësi që ishte i pari që u pyet nga Shefi.

– Vështirë ta dish, - tha tërë gjeste, si në fjalimet e veta. - Janë shtuar shumë. Midis pesë dhe tetë mijë, jo më shumë.
– Gjeneral Arredondo, ti ndodheshe në Indipendenca duke prerë koka atë ditë. Sa?
– Nja njëzet mijë, Shkëlqesi, - u përgjigj gjenerali trashaman, Arredondo, i cili dukej i shtrënguar brenda uniformës së vet. - Vetëm në zonën e Indipendencës pati disa mijëra. Senatori i ra shkurt. Unë kam qenë atje. Njëzet mijë, jo më pak.
– Ti sa vrave vetë? - bëri shaka Gjeneralissimi dhe një valë tjetër të qeshurash përshkoi tavolinën e shoqëruar me kërcitje karrigesh e tinguj kristalesh.
– Ajo që qarkullonte si thashethem, është e vërtetë e pastër, Shkëlqesi, - u tërhoq oficeri i dhamosur dhe buzëqeshja e tij u kthye në ngërdheshje. - Tani na i hedhin neve të tërë përgjegjësinë. Gënjeshtër, e gjitha gënjeshtër! Ushtria bëri detyrën e vet. Filluam të ndanim ilegalët nga të tjerët, por populli nuk na la. Të gjithë u hodhën në gjuajtje të haitjanëve. Fshatarë, tregtarë dhe funksionarë i zbulonin ku fshiheshin, i varnin dhe i vrisnin me lopata. Në shumë vende, ushtrisë iu desh të ndërhynte për të ndaluar teprimet. Kishte një tërbim kundër tyre për vjedhjet dhe grabitjet.
– President Balageri, ju ishit njëri prej negociatorëve me Haitin pas ngjarjeve, - vazhdoi Truhijo anketën e vet. - Sa ishin?
E humbura, e mpakura figurë e Presidentit të Republikës, gjysmë e përpirë nga kolltuku, zgjati butësisht kokën e vet. Pasi vëzhgoi të pranishmit që prapa syzeve prej miopi, nxori i kapardisur atë zëthin e vet të butë e të mirë, me çka recitonte poema në Konkurset Poetike, lëvdonte kurorëzimin e Zonjushës Republikë Domenikane (për të cilën ishte gjithmonë Poet i Kurorës), ligjëronte para turmës gjatë vizitave të Truhijos, ose parashtronte politikat e qeverisë para Asamblesë Kombëtare.
– Shifra e saktë nuk mund të njihet kurrë, Shkëlqesi, - fliste ngadalë si të ishte profesor. - Shifra e mundshme shkon nga dhjetë në pesëmbëdhjetë mijë. Në atë marrëveshjen me qeverinë e Haitit, vendosëm për një shifër simbolike: 2.750. Kështu që, teorikisht, çdo familje e prekur do të merrte njëqind peso, nga ato 275.000 peso që pagoi në dorë qeveria e Shkëlqesisë Suaj, si gjest i një vullneti të mirë dhe për nder të harmonisë haitjano-domenikane.

Por, siç e kujtoni edhe ju, nuk ndodhi ashtu.
Heshti, me shenjat e buzëqeshjes në fytyrën e rrubullaktë, duke picërruar sytë e kaltër pas qelqeve të trashë.

– Pse nuk bë kompesimi i atyre familjeve? - pyeti Simon Gitlemani.
– Sepse Presidenti i Haitit, Stenio Vinsenti, që ishte një birbo, i mbajti paratë, - qeshi me të madhe Truhijo. - Vetëm 275.000 u paguan? Me sa mbaj mend unë, ne vendosëm për 750.000 dollarë që ata t'i linin protestat.
– Në të vërtetë, Shkëlqesi, - u përgjigj menjëherë e me të njëjtën qetësi dhe ton të përsosur doktor Balageri, - u morëm vesh për 750.000 peso, por vetëm 250.000 paguam. Gjysmë milion që mbeti, do të jepej me pagesa vjetore nga njëqind mijë në vit për gjatë pesë vjetëve në vazhdim. E kujtoj shumë mirë, isha Ministër i Punëve të Jashtme në atë kohë. Me don Anselmo Paulinon, i cili më shërbente si këshilltar në bisedime, vendosëm një klauzolë, që paratë do të dorëzoheshin pasi të paraqiteshin certifikatat e vdekjes përpara një gjykate ndërkombëtare, gjatë dy javëve të para të tetorit të vitit 1937 për 2.750 viktimat e pranuara. Haiti kurrë nuk e plotësoi këtë kusht. Kështu Republika Domenikane u çlirua nga shuma e mbetur dhe kompensimet u mjaftuan me çka u dorëzua në fillim. Pagesën e bëtë Ju Shkëlqesi nga xhepi Juaj, ndaj shtetit domenikan nuk i kushtoi asnjë qindarkë.
– Pak pará për një çështje prej së cilës edhe mund të zhdukeshim, - përmbylli Truhijo, tanimë serioz. - Është e vërtetë që vdiqën ca të pafajshëm. Por ne domenikanët rifituam sovranitetin tonë. Qysh atëherë, marrëdhëniet tona me Haitin janë të shkëlqyera, falë Zotit.
Pastroi buzët dhe piu një gllënjkë ujë. Kishin filluar të shërbenin kafen dhe likeret. Ai nuk pinte kafe dhe alkool kurrë në drekë, përveçse në San Kristobal, në pronën e tij ose në Shtëpinë me Mogan, rrethuar me miqtë më të ngushtë. Kujtesa e tij sillte imazhe nga ato javë të përgjakshme të tetorit të vitit 1937, kur në zyrën i mbërrinin lajme për përmasat e frikshme që kishte marrë në kufi dhe në të tërë vendin, gjuetia e haitjanëve. Por, e përzier me ato imazhe, i shfaqej ndërfshehtas figura e urryer, budallaqe dhe e habitur e asaj vajze tek kundronte turpërimin e tej. U drithërua.
– Ku është senatori Agustin Kabral, i famshmi Inteligjent? -

Simon Gitlemani tregoi Konstitucionalistin Sarhosh: - Shoh senatorin Çirinos dhe jo partnerin e tij të pandashëm. Ç'ka ngjarë me të?

Qetësia zgjati mjaft sekonda. Drekuesit vinin kupat e kafesë në buzë, gjerbnin nga një gllënjkë dhe i hidhnin sytë sofrabezit, luleve, qelqurinave dhe shandanit në tavan.

– Tani s'është më senator e as që shkel më në këtë Pallat, - tha Gjeneralissimi me ngadalësinë e zemërimeve të veta të ftohta. - Jeton, por sa i përket më këtij pushteti, pushoi së qeni i tillë.

Ish-marinsi, i vënë në vështirësi, ktheu gotën me konjak. Duhej të ishte te të tetëdhjetat, llogariti Gjeneralissimi. Por i mbajtur për mrekulli: me flokët e rrallë të qethur tullë, me shtatin e hedhur, me trupin e drejtë, pa pikë dhjami as në lëkurë, as në qafë, energjik në gjeste dhe në lëvizje. Rrjeta i rrudhëzave mbi kapakët e syve, shtrihej përgjatë fytyrës së regjur dhe tregonte jetën e tij të gjatë. Bëri një ngërdheshje fytyre, duke kërkuar të ndërronte temën.

– Ç'ndjeu Shkëlqesia Juaj kur dhatë urdhrin për të eliminuar ata mijëra haitjanë ilegalë?

– Pyet ish-Presidentin tënd Truman se ç'ndjeu kur dha urdhër për të hedhur bombën atomike mbi Hiroshima dhe Nagasaki. Ashtu do ta mësosh se ç'ndjeva unë atë natë në Dahabon.

– Ka nja një muaj që Shtetet e Bashkuara pësuan një disfatë në Bahia de Koçinos. Komunisti Fidel Kastro kapi qindra pjesëtarë të ekspeditës. Ç'pasoja ka kjo në Karaibe, Simon?

– Ajo ekspeditë e patriotëve kubanë u tradhtua nga Presidenti Kenedi, - murmëriti i trishtuar. - U dërguan në kasaphanë. Shtëpia e Bardhë ndaloi mbrojtjen e tyre ajrore dhe mbështetjen e artilerisë që u premtoi. Komunistët bënin qitje mbi ta. Por, më lejoni, Shkëlqesia Juaj. Më mirë që ndodhi ashtu. Do t'i shërbejë si një mësim Kenedit, qeveria e të cilit është kthyer në fellow travellers. Si thuhet spanjisht? Po, "bashkudhëtarë". Mbase për t'i hequr qafe. Shtëpia e Bardhë s'do të donte tjetër dështim si ai i Bahia de Koçinos. Kjo e largon rrezikun për të dërguar marinsa në Republikën Domenikane.

Me të thënë fjalët e fundit, ish-marinsi u emocionua dhe bëri një përpjekje të dukshme për t'u vetëpërmbajtur. Truhijo u çudit: Mos ishte gati të qante instruktori i tij i vjetër i Hainas, përpara idesë së një zbarkimi të shokëve të tij të armëve për të përmbysur regjimin domenikan?

– Më falni për dobësinë, Shkëlqesia Juaj, - mëmëriti Simon Gitlemani, duke e marrë veten. - Ju e dini që unë e dua këtë vend si të ishte imi.
– Ky vend është yti, Simon, - tha Truhijo.
– Që prej ndikimit të të majtëve, Uashingtoni mund të dërgonte marinsat, për të luftuar qeverinë më mike të Shteteve të Bashkuara, më duket një gjë djallëzore. Për këtë harxhoj kohën dhe paratë, duke u përpjekur t'u hap sytë bashkatdhetarëve të mi. Prandaj kam ardhur me Dorotinë në Qytetin Truhijo, për të qenë në krah të domenikanëve nëse zbarkojnë marinsat.
Një breshëri duartrokitjesh që bëri të tingëllijnë pjatat, gotat, lugët dhe thikat, përshëndeti fjalën e mërzitshme të ish-marinsit. Dorotia buzëqeshte si të solidarizohej me të shoqin.
– Zëri juaj, mister Simon Gitleman, është zëri i vërtetë i Amerikës, - u ekzaltua Konstitucionalisti Sarhosh, duke hedhur një spërkatje pështyme përpara. - Një dollí për këtë mik, për këtë burrë të ndershëm. Për Simon Gitlemanin, zotërinj!
– Një minutë, - zëri prej flauti i Truhijos, e thërrmoi në një mijë copa atmosferën entuziaste. Drekuesit e shihnin të shpërqendruar dhe Çirinosi mbeti me kryet përpjetë. - Për miqtë dhe vëllezërit tanë Doroti dhe Simon Gitleman!
I lodhur, çifti falënderonte me buzëqeshje dhe përshëndetje të pranishmit.
– Kenedi nuk do të dërgojë marinsa, Simon, - tha Gjeneralissimi, pasi u shua jehona e dollisë. - Nuk besoj të jetë aq idiot. Por në qoftë se e bën, Shtetet e Bashkuara do të kenë një tjetër Bahia de Koçinos. Kemi Forca të Armatosura më moderne se ato të mjekëroshit. Dhe këtu, me mua në krye, do të ndeshet deri me domenikanin e fundit. Mbylli sytë, si për të provuar veten nëse do të mundej ta kujtonte me saktësi atë citat. Dhe ja ku e kishte të plotë, të ardhur nga ai përkujtim, nga njëzet e nëntë vjetori i zgjedhjes së tij të parë. E recitoi, ndërkohë që po e dëgjonin në qetësi plot nderim:
– "Çfarëdo qofshin të papriturat që na sjell e ardhmja, për një gjë jemi të sigurt: Bota mund ta shohë të vdekur Truhijon, por refugjat si Batistën, ikanak si Peres Himenesin, të ulur në bankën e të akuzuarit si Rohas Pinijan, kurrë. Ky burrë shteti domenikan është i tjetër morali, i tjetër soji."

Hapi sytë dhe hodhi një vështrim këqyrës mbi të ftuarit e tij, të cilët, pasi e kishin dëgjuar si të përhumbur citatin e tij, bënin gjeste miratuese.

– Kush e ka shkruar frazën që sapo citova? - pyeti Bamirësi.

Panë njëri-tjetrin, duke kërkuar me kureshtje, dyshim dhe alarm. Më në fund vështrimet u përqendruan mbi fytyrën e ëmbël, rrumbullake, të mbarsur me modesti, të autorit të shkrimeve të sakta, në duart e të cilin kishte rënë drejtësia e Republikës, qysh kur Truhijo e detyroi të vëllanë, Negron, të jepte dorëheqjen ngaqë i humbi shpresat se ai do të shmangte sanksionet e OEA-s.

– Më mrekullon kujtesa e Shkëlqesisë Suaj, - peshpëriti Hoakin Balageri me mburrje, por edhe me një përulësi të tepruar, si t'i vinte turp nga nderi që po i bëhej. - Më bëni krenar që kujtoni atë fjalimin tim modest të 3 gushtit të kaluar.

Gjeneralissimi vuri re rëndimin sa u prishën nga zilia fytyrat e Virhilio Alvares Pinas, e Lyrashit, e Paino Piçardos dhe e gjeneralëve. Vuanin. Mendonin se poeti i parëndësishëm dhe i rëndomtë, profesori dhe juristi i paaftë, po triumfonte në garën e rëndë e të pasosur që përjetonin për të fituar nderet e Shefit, për të qenë të njohur, të përmendur, të zgjedhur, të dalluar mbi të tjerët. Ndjeu dhemshuri për ata pinjollë të zellshëm, të cilët i kishte bërë të donin tridhitjetë vjet në pasiguri të përhershme.

– S'është një frazë e thjeshtë, Simon, - siguroi. - Truhijo nuk është nga ata qeveritarë që e lënë pushtetin kur vërshëllejnë plumbat. Unë mësova se atje je përhersh njeri i nderuar. Se burrat e vërtetë nuk ia mbathin. As Kenedi, as OEA, as zezaku i pështirë dhe fendak Betankuri, as komunisti Fidel Kastro, nuk do ta bëjnë dot Truhijon t'ia mbathë prej këtij vendi, që i detyrohet për gjithçka bëri për të.

Konstitucionalisti Sarhosh filloi të duartrokasë, por kur shumië duar u ngritën për ta imituar, Truhijo i ndërpreu menjëherë.

– E dili cili është ndryshimi i atyre burracakëve me mua, Simon? - vazhdoi, duke e parë në sy instruktorin e dikurshëm.

– Se unë jam formuar në këmbësorinë e marinës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kurrë nuk e kam harruar. Të kujtohet? mësove në Haina dhe në San Pedro të Makoris. Të kujtohet?

Ne, të parët që u graduam në Policisë Kombëtare Domenikane, jemi prej çeliku. Ata që na kishin mëri thonin se PND donte të thoshte "Pobres Negritos Dominicanos"*. E vërteta është se ai gradim e ndryshoi këtë vend. Dhe unë e besoj këtë. Nuk më çudit ajo që ti po bën për këtë vend. Sepse je një marins i vërtetë, ashtu siç jam edhe unë. Njeri besnik. Që vdes me kokën lart, si kuajt arabë. Simon, edhe pse po sillet keq, unë nuk i mbaj mëri vendit tënd. Sepse unë u detyrohem marinsave për çka jam.

– Një ditë Shtetet e Bashkuara do të pendohen për mosmirënjohjen ndaj ortakut dhe mikut të tyre të Karaibeve.

Truhijo piu pak ujë. Rifilluan bisedat. Kamerierët po shpërndanin përsëri kafe, konjak, likere dhe cigare puro. Gjeneralissimi vazhdoi të dëgjonte Simon Gitlemanin:

– Si do të përfundojë ajo ngatërresa me peshkopin Reji, Shkëlqesia Juaj?

Tjetri bëri një gjest mospërfillës:

– Nuk ka asnjë lloj ngatërrese, Simon. Ai peshkop ka kaluar në anën e armiqve tanë. Meqë populli u indinjua, ai u tremb dhe vrapoi të fshihej midis murgeshave të Kolegjit Santo Domingo. Se ç'bën midis grave, është puna e tij. Ne po e ruajmë që të mos e masakrojnë.

– Do të ishte mirë që kjo të zgjidhej shpejt, - këmbënguli ish-marinsi. - Në Shtetet e Bashkuara, shumë katolikë të keqinformuar besojnë në deklaratat e imzot Rejit. Se është i frikësuar, se ishte i detyruar të kërkonte strehim nga fushata e kërcënimeve, etj.

– Nuk ka rëndësi, Simon. Çdo gjë do të rregullohet dhe marrëdhëniet me Kishën do të jenë përsëri të mrekullueshme. Mos harro se qeveria ime ka qenë gjithmonë plot me katolikë dhe se Papa Pio XII më dekoroi me Kryqin e Madh të Urdhrit Papal të San Gregorios, - dhe befas ai ndërroi temën: - Ju çoi Petani për të njohur "Zëri domenikan"?

– Sigurisht, - u përgjigj Simon Gitlemani. Dorotia e miratoi me buzëqeshjen e saj të plotë. Ajo qendër kulturore e vëllait të tij, gjeneralit Hose Arismendi Truhijo, Petanit, kishte filluar njëzet vjet të shkuara me një stacion të vogël radioje. "Zëri i Junas" u zgjerua, derisa u kthye në kompleksin e fuqishëm "Zëri domenikan", i pari kanal televiziv, stacioni më i madh i radios, klubi kabare më i

miri dhe një teatër estrade i ishkullit (Petani këmbëngulte se qe më i madhi në tërë Karaibet, por Gjeneralissimi e dinte se nuk arriti ta mposhte qendrën "Tropikana de la Havana"). Çifti Gitleman qe mahnitur prej pajisjeve madhështore. Vetë Petani i shëtliti dhe i çoi në klubin kabare, ku bëheshin provat e baletit meksikan që do të jepte shfaqje atë natë. Po ta vëreje Petani nuk ishte një njeri i keq. Po të kishte nevojë, ishte gjithmonë i gatshëm, ai së bashku me ushtrinë e vet të çuditshme, ata "dunjtë e fortë të kordilierëve". Por njësoj si vëllezërit e tjerë, edhe Petani i kishte bërë më shumë dëm se dobi Shefit, qysh kur, për shkak të asaj grindjes së marrë të këtij vëllai dhe për të ruajtur autoritetin familjar të Truhijos, iu desh të ndërhynte dhe ta asgjesonte atë gjigant - shokun e tij të Shkollës së Oficerëve Haina - gjeneralin Vaskes Rivera. Njëri prej oficerëve më të mirë - një maris, e marrtë djalli! - shërbyes besnik. Por familja, edhe pse një familje parazitësh, me ca tipa të kotë dhe pa dobi, prapë qëndronte mbi miqësinë dhe interesin politik. Ishte një urdhër i shenjtë në katalogun e tij të nderit. Gjeneralissimi, pa e lënë vazhdën e mendimeve të veta, dëgjonte Simon Gitlemanin, i cili tregonte se si qe mahnitur duke parë fotot e njerëzve të shquar të kinemasë, të teatrit dhe të radios të gjithë Amerikës, të cilët kishin ardhur te "Zëri domenikan". Petani i kishte vendosur në muret e zyrës së vet: Pançot, Libertad Lamarke, Pedro Vargas, Ima Sumak, Pedro Infante, Selia Kruz, Tonja la Negra, Ollga Gijot, Marie Luisa Landin, Bobi Kapo, Tintan dhe shumë të Marselon. Truhijo buzëqeshi: Ajo që nuk dinte Simoni, ishte se Petani veç mikut që i jepte natës domenikane me artistet që sillte, donte edhe të jepte dashuri me to, siç bënte me gjithë vajzat, beqare apo të martuara, në mbretërinë e tij të vogël në Bonao. Atje Gjeneralissimi e linte të bënte ç'të donte, por në Qytetin Truhijo nuk duhet ta tepronte kurrsesi. Por zogu i prapë Petan shpesh e bënte edhe në qytet, i bindur se artistet e kontratuara nga "Zëri domenikan" ishin të detyruara të flisnin me gjuha e zërit të atij i tekej. Ndonjëherë ia arrinte, por kishte raste që plaste skandali. Atëherë ai - gjithmonë ai, i madhi - duhej të shuante zjarrin, duke bërë dhurata milionëshe artisteve të fyerra nga ai zuzari ndyrë, Petani, i cili s'dinte të sillej me damat. Ima Sumaku, për shembull, princesha inkase me pashaportë amerikane. Paturpësia e Petanit bëri që të ndërhynte vetë ambasadori

i Shteteve të Bashkuara. Dhe Bamirësi, duke parë mllefin e saj, e dëmshpërbleu dhe e zbuti princeshën inkase, ndërsa të vëllanë e detyroi t'i kërkonte ndjesë asaj. Bamirësi mori frymë thellë. Me kohën që kishte humbur, duke mbyllur gropat që i hapte rrugës banda e njerëzve të tij, do të kishte ndërtuar një vend të dytë.
Veç nga të gjitha marrëzitë që kishte bërë Petani, ajo që kurrë nuk do t'ia falte, ishte grindja e çmendur me shefin e Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Gjiganti Vaskes Rivera ishte miku i afërt i Truhijos, qysh kur ishin stërvitur bashkë në Haina. Kishte një forcë të jashtëzakonshme dhe ushtronte duke praktikuar të gjithë sportet. Ishte njëri nga ushtarakët që ndihmoi të bëhej realitet ëndrra e Truhijos: Ta transformonte Ushtrinë, e lindur nga Policia Kombëtare e vogël në një trupë profesionale, të disiplinuar dhe vepruese, njësoj si ajo amerikane, kuptohet shumë më e vogël. Dhe ja, erdhi ajo grindje e marrë. Petani kishte gradën major dhe shërbente në komandën e Shtatmadhorisë së Ushtrisë. I dehur, nuk iu bind një urdhri, dhe kur gjeneral Vaskes Rivera e qortoi, Petani e fyu rëndë. Gjiganti atëherë, duke hequr xhaketën me grada e dekorata, i tregoi sheshin dhe e ftoi ta zgjidhnin çështjen me grushte, duke i harruar gradat. Qe druri më i rëndë që kishte ngrënë në jetën e vet Petani, me çka pagoi ato që u kishte bërë shumë fatkeqëve.
I mërzitur, por i bindur se nderi i familjes e detyronte vepronte ashtu, Truhijo e hoqi nga detyra gjeneralët dhe e dërgoi në Evropë me një mision simbolik. Një vit më vonë, Shërbimi Sekret e informoi për plane përmbysjeje: Gjenerali i prekur vizitonte garnizonet, takohej me ish-vartësit të vet dhe fshihte armë në pronën e vet në Sibao. Dha urdhër ta arrestonin dhe ta mbyllnin në burgun ushtarak, në grykëderdhjen e lumit Nigua. Pak kohë më vonë, urdhëroi që një gjykatë ushtarake ta dënonte në fshehtësi me vdekje. Për ta zvarrisur derin te pushkatimi, komandanti i burgut iu drejtua për ndihmë dymbëdhjetë kriminelëve që kryenin dënimin atje. Dhe për të mos patur dëshmitarë për atë punë heroik të gjeneralit Vaskes Rivera, Truhijo urdhëroi që të dymbëdhjetët të burgosurit të pushkatoheshin. Megjithëse koha kalonte, shpesh e kujtonte sikurse dhe tani ndiente njëfarë nostalgjie për atë shok të viteve heroike, të cilin e sakrifikoi për marrëzitë e Petanit.

Simon Gitlemani shpjegonte se komitetet e krijuara nga ai në Shtetet e Bashkuara, kishin filluar një mbledhje ndihmash për një operacion të madh: Të njëjtën ditë do të publikohej si lajm i paguar në faqe të tëra, në "The New York Times", "The Washington Post" "Time", "Los Angeles Times" dhe botimet që sulmonin Truhijon e mbështesnin sanksionet e OEA-s, një kundërshtim dhe një mbrojtje në favor të forcimit të marrëdhënieve me regjimin domenikan.
Pse e pyeti Simon Gitlemani për Agustin Kabralin? U mundua të përmbante zemërimin që e pushtoi sa kujtoi Inteligjentin. Nuk mund të kishte pasur qëllim të keq. Në qoftë se dikush e admironte Truhijon, ishte ish-marinsi, trup e shpirt i vendosur në mbrojtje të regjimit të tij. Mbase e kishte përmendur emrin e Inteligjentit – i cili nuk ishte më në marrëdhënie të ngushta me regjimin – ngaqë ia kishte kujtuar Konstitucionalistin Sarhosh. Çirinosi dhe Kabrali ishin shokë të pandarë. Po, ashtu kishin qenë. Truhijo u caktoi shpesh misione të përbashkëta. Si në vitin 1937, kur, duke i emëruar drejtor të përgjithshëm të Statistikave dhe drejtor të përgjithshëm të Emigracionit, i dërgoi të kontrollonin kufirin me Haitin dhe të informonin mbi hyrjet e paligjshme të haitjanëve. Por miqësia e tyre ishte gjithmonë relative: ndërpretej sa herë hynin në lojë konsideratat apo lajkat ndaj Shefit. Truhijo e dëfrente kjo gjë - një lojë e mrekullueshme dhe e fshehtë që mund ta lejonte – të vinte re manovrat e holla, goditjet e fshehta, intrigat fiorentine që kurdisnin njëri kundër tjetrit Lyrashi me Inteligjentin – por po ashtu, Virhilio Alvares Pina me Paino Piçardon, Hoakin Balageri me Fello Bonejin, Modesto Diasi me Visente Tolentino Rojas, e tërë rrethi i afërt – për të shmangur shokun, për të përparuar e për të qenë sa më afër Shefit. "Si femrat e haremit për të qenë të preferuarat", mendoi. Dhe ai, për t'i mbajtur gjithmonë në ethe, për të shmangur ndryshken, rutinën, anomalinë, bënte zhvendosje të herëpashershme në klasifikimin për meritë ose duke e hedhur në fatkeqësi njërin apo tjetrin. Atë kishte bërë me Kabralin: Ta largonte, ta bënte të ndërgjegjësohesh se çfarë ishte, sa vlente dhe çfarë kishte, duhej t'ia detyronte të gjitha Truhijos, se pa Bamirësin ishte një hiç. Një rëng që ua punonte të gjithë bashkëpunëtorëve të vet të afërt apo të largët. Inteligjenti qe vrarë bashkëshumë, qe dëshpëruar si një femër e dashuruar, të cilën e braktis i dashuri. Me qëllimin t'i rregullonte gjërat

para kohe, po i prishte më shumë. Do të hiqte të zitë e ullirit për të ekzistuar.
A thua Kabrali, duke ditur se Truhijo do të dekoronte ish-marinsin, i është lutur këtij që të ndërhynte për të? Mos ndoshta për këtë ish-marinsi përmendi në mënyrë të papërgjegjshme emrin e dikujt, për të cilin tërë domenikanët që lexojnë "Forumin Publik", e dinë se ka humbur privilegjet e pushtetit? Kush e di, ndoshta Simon Gitlemani nuk lexon "Karaibet".
Befas, gjaku iu bëll: Po i shpëtonte urina. E ndjeu, pothuajse pa të dalë atë ujë të të verdhë, duke buruar prej fshikëzës së vet pa i marrë leje asaj valvule, tashmë tashmë përdorimit, atij prostati të vdekur, të paaftë ta përmbante; e ndjeu tek vraponte gëzueshëm nëpër kanalin e vet, duke dalë në kërkim të ajrit dhe dritës, e ndjeu t'i lagë kofshët, mbathjet dhe pjesën e përparme të pantallonave. Pati një marramendje. Mbylli sytë për disa sekonda, i goditur nga zemërimi dhe pafuqia. Për dreq, në vend të Virhilio Alvares Pina, në krah të djathtë të tij kishte Doroti Gitlemanin dhe në të majtë Simonin, të cilët nuk mund ta ndihmonin. Virhilio, po. Ishte kryetar i Partisë Domenikane por funksioni i tij i vërtetë dhe i rëndësishëm ishte pikërisht ky. Qysh kur doktor Pigverti, i sjellë në mënyrë sekrete prej Barcelone, diagnostikoi infeksionin e mallkuar të prostatit, kryetari i Partisë e kishte për detyrë të vepronte menjëherë kur ndodhte akti i mospërmbajtjes së urinës. Ai duhej t'i derdhte Bamirësit kinse pa dashje një gotë ujë ose verë mbi pantallona, duke i kërkuar një mijë herë falje. Ndërmjet herë kur ndodhte në tribunë apo gjatë udhëtimit, ishte i përgatitur t'i hidhte mbi pantallonat e urinura një rrobë të posaçme. Po idiotët e protokollit e paskëshin ulur Virhilion katër karrige më tej. Askush mund ta ndihmonte. Do të mbetej me turp kur të ngrihej, sepse do ta shihnin Gitlemanët dhe të tjerët që i kishte shpëtuar urina në pantallona, si një plaku të mbetur. Tërbimi nuk e la të lëvizte, të bënte sikur donte të pinte ujë dhe të derdhte mbi pantallona gotën apo kanën që kishte përpara.
Fare ngadalë, duke parë përreth i hutuar, lëvizi dorën e djathtë drejt gotës plot me ujë. Fare lehtësisht e afroi deri në buzë të tryezës asisoj, që me lëvizjen më të vogël, ta rrëzonte. Papritur iu kujtua vajza e tij e parë, Flor de Oro, që e kishte me gruan e parë, Aminta Ledesmanin. E bija, ajo çmendurake me

trup femre dhe me shpirt mashkulli, që i ndërronte burrat siç ndërronte këpucët, përmirrte në shtrat derisa u bë vajzë e rritur kolegji. Mori guximin për të parë fshehtas edhe një herë pantallonat e veta. Në vend të pamjes së turpshme, njollës me urinë që priste, vuri re mirë – vështrimi i tij vazhdonte të ishte ende i mprehtë, ashtu si dhe kujtesa e tij – se pantallonat përpara dhe midis kofshëve qenë të thata. Tepër të thata. Paskej qenë një përshtypje e rreme, e shkaktuar nga frika, nga paniku i "plasjes së ujërave" siç thonë për lindjet. E pushtoi lumturia dhe optimizmi. Dita, e filluar me humor të keq dhe paralajmërim të errët, po zbukurohej si një peizazh bregdeti, me shpërthimin e diellit pas stuhisë.
U ngrit në këmbë dhe sikurse ushtarët me komandë, të gjithë e imituan. Ndërsa po përkulej të ndihmonte Doroti Gitlemanin që të ngrihej, vendosi, me tërë forcën e shpirtit të vet: "Këtë natë, në Shtëpinë me Mogan, do ta bëj të vërrrasë një femër si njëzet vjet më parë". Iu bë sikur testikulat nisën t'i vlonin dhe po i ngrihej penisi.

XII

Salvador Estreja Sadalai mendoi se kurrë nuk do ta njihte Libanin dhe ai mendim e trishtoi. Qysh fëmijë kishte ëndërruar shpesh se një ditë do të shkonte në Libanin e Epërm, për të vizituar atë qytet, pothuajse fshat, Baskintan, nga e kishin prejardhjen Sadalajt dhe nga ku, në fund të shekullit të kaluar, i kishin ndjekur se qenë katolikë. Salvadori u rrit duke dëgjuar nga e ëma, Paulina, për tregëtitë e rrezikshme dhe ato të qeta që bënin Sadalajt atje në Liban, për mbarëvajtjen e familjes; se si i kishin humbur të gjitha dhe peripecitë që kishin kaluar don Abraham Sadalai dhe njerëzit e tij kur ikën nga përndjekjet që shumica e myslimanëve i bënte pakicës kristiane. Përshkuan gjysmën e botës, besnikë të Krishtit dhe kryqit, derisa mbërritën në Haiti e pastaj në Republikën Domenikane. U vendosën në Santiago de los Kavajeros dhe duke punuar shumë e ndershmërisht, vetë të njohura për atë familje, arritën të mbijetonin dhe të ishin të respektuar në atdheun e ri. Edhe pse e përfytyronte pak fisin nga e ëma, Salvadori, i magjepsur nga historitë e mamasë, ndihej gjithmonë një Sadalai. Ndaj ëndërronte ta vizitonte atë Baskintan misterioze, që kurrë nuk e gjeti në hartën e Lindjes së Mesme. Po pse dyshonte se nuk do të shkelte kurrë në atë vend ekzotik të të parëve të tij?

– Po më zë gjumi, - u dëgjua të thoshte nga vendi i parë Antonio de la Masa, duke fërkuar sytë.
– Të gjithë po flenë, - tha Salvadori. - Mos u shqetëso se po i shikoj me kujdes autoveturat që vijnë nga Qyteti Truhijo.
– Edhe unë, - tha nga vendi i vet, togeri Amado Guerrero. - Dukem sikur fle ngaqë nuk lëviz asnjë muskul dhe nuk mendoj për asgjë. Është një mënyrë për t'u qetësuar që e kam mësuar në ushtri.
– Është e sigurt që do të vijë, Amadito? - e provokoi nga timoni, Antonio Imberti. Turku dalloi qortim në zërin e tij. Ç'padrejtësi! Si ta kishte fajin Amaditoja, nëse ishte anulluar udhëtimi i Truhijos për në San Kristobal.

- Po, Toni, - u hodh togeri me një siguri fanatike. - Do të vijë.
- Turku nuk ishte aq i sigurt. Po bënte një orë e një çerek që prisnin. Po ikte edhe një ditë entuziazmi, ankthi e shprese. Me dyzet e dy vitet e veta, Salvadori ishte më i madhi midis shtatë burrave të vendosur në tri autovetura që po prisnin Truhijon në rrugën për në San Kristobal. Nuk ndihej i moshuar, aspak. Vazhdonte të ishte jashtëzakonisht i fortë, si dikur tridhjetëvjeçar në pronën e Almasigove, kur thuhej se Turku mund të vriste një gomar me një grusht pas veshit. Fuqia e muskujve të tij ishte legjendare. Ia njihnin ata që kishin shur dorashkat për të bërë boks me të në ringun e Shkollës së Riedukimit të Santiagos, ku, falë përpjekjeve për t'iu futur sportit, kishte lënë përshtypje të mrekullueshme te vagabondët e kriminelët e rinj. Andej doli Kid Dinamita, fituesi i Dorashkës së Artë e që u bë boksieri më i njohur në Karaibet.
- Salvadori i donte Sadalajt dhe ndihej krenar për gjakun e vet arab libanez, por Sadalajt nuk kishin dashur që ai të lindte. E kishin kundërshtuar ashpër nënën e tij, Paulinën, kur u kishte thënë se e donte Piro Estrejan, që ishte zezak, ushtarak dhe politikan, tri gjëra që Sadalajt - Turku buzëqeshi - i rrethonin. Mospranimi i Sadalajve e shtyu Piro Estrejan ta rrëmbente Paulinën dhe ta çonte në Moka, dhe me pistoletë në dorë, ta detyronte priftin e famullisë që t'i martonte. Me kohë Sadalajt dhe Estrejat u pajtuan. Kur mama Paulina vdiq në vitin 1936, vëllezërit Estreja-Sadalai, ishin dhjetë vjeç. Gjenerali Piro Estreja pati dhe shtatë fëmijë të tjerë me martesën e dytë, duke i siguruar Turkut gjashtëmbëdhjetë vëllezër të ligjshëm. Ç'do të bëhej sikur të dështonin këtë natë? Ç'do t'i ndodhte, mbi të gjitha, vëllait të tij Guaro, i cili nuk dinte asgjë për këtë? Gjenerali Guarioneks Estreja Sadalai kishte qenë shef i adjutantëve ushtarakë të Truhijos dhe tani komandonte Brigatën e Dytë në La Vega. Nëse aksioni dështonte, ndërhyrjet do të ishin të pamëshirshme. Po pse duhej të dështonte? Ishte përgatitur me shumë kujdes. Shefi i tij, gjenerali Hose Rene Roman, ishte gati t'i komunikonte se Truhijo kishte vdekur dhe se një juntë qytetaro-ushtarake do të merrte pushtetin dhe atëherë Guarioneksi do të vinte të gjitha forcat ushtarake të veriut në shërbim të regjimit të ri. A do të ndodhte kështu? Shkurajimi po e pushtonte përsëri Salvadorin, për shkak të pritjes.
- Mbylli përgjysmë sytë dhe u lut pa lëvizur buzët. E bënte

disa herë në ditë me zë të lartë, kur ngrihej nga gjumi dhe kur shtrihej për gjumë, si tani. “Ati ynë” dhe “Ave Maria”, qenë gjithashtu lutje që i improvizonte në funksion të rrethanave. Qysh i ri ishte mësuar të kërkonte ndihmën e Zotit për problemet e mëdha dhe të shpeshta, t’i besonte Atij sekretet e veta dhe t’i lypte këshilla. Iu lut që të vinte Truhijo, që shenjtëria e tij e pakufishme t’i lejonte ta ekzekutonin shpejt xhelatin e domenikanëve, atë Përbindësh që tani kakërrohej ndaj Kishës së Krishtit e barinjve të saj. Dikur, një kohë kur përpiqej të vriste Truhijon, Turku ndihej i pavendosur, por qysh kur mori sinjalin, mund t’i fliste Zotit për tiranvrasje me ndërgjegje të pastër. Sinjali qe ajo fraza që i lexoi Shenjtëria e Tij, nunci.

- Falë atij Fortinit, priftit kanadez të ardhur në Santiago, Salvadori pati atë bisedë me timzot Lino Zaninin. Dhe prandaj ndodhej ati tani. Për shumë vite, at Sipriano Fortini qe drejtuesi shpirtëror i tij. Një ose dy herë në muaj bënte biseda të gjata, ku Turku i hapte zemrën dhe ndërgjegjen. Prifti e dëgjonte, u përgjigjej pyetjeve të tij dhe i shfaqte dyshimet e veta. Krejt pandjeshëm, çështjet politike qenë vendosur mbi ato personale në ato biseda. Pse Kisha e Krishtit mbështeste një regjim gjakatar? Si mundej që Kisha të mbronte me autoritetin e saj moral, një sundues që bënte krime të urryera?
- Turku kujtonte turbullimin e atë Fortinit. Shpjegimet që bënte nuk e bindnin as atë vetë: Zotit çfarë është e Zotit dhe Çezarit çfarë është e Çezarit. A thua ekziston ndarje e tillë për Truhijon, atë Fortin? A s’shkon ai në meshë të marrë bekimin dhe osten e shuguruar? A bëhen mesha, tedeume, bekime për gjithë aktet e qeverisë? A nuk shenjtërojnë përditë peshkopët dhe priftërinjtë aktet e tiranisë? Kur do të pushojë kisha së trajtuari njëlloj besimtarët dhe Truhijon?
- Farë i ri, Salvadori e kishte provuar të vështirën, të pamundurën, që i kushtonte shpeshherë t’i nënshtronte sjelljen e përditshme urdhrave të fesë së tij. Parimet dhe bindjet e tij, edhe pse qe tepër i rreptë, nuk e kishin frenuar për të bërë qejf e për të shkuar me femra. Kurrë nuk do të pendohej që kishte lindur dy fëmijë, para se të martohej me gruan që kishte, Urani Miesesin. Ishin gabime që e turpëronin, nëse ishte pjekur ndonjëherë të çlirohej prej detyrimeve fetare, edhe pse me ndërgjegje të shqetësuar. Por ishte tepër e vështirë të mos e fyeje Krishtin gjithë jetën. Ai, i mjeri i vdekshëm, i destinuar

për mëkate njerëzore, ishte prova e dobësive të lindura bashkë me njeriun. Por si gabohej Kisha e frymëzuar nga Zoti, duke ndihmuar një të pashpirt?

- Derisa, para gjashtëmbëdhjetë muajve – kurrë nuk do ta harronte atë ditë e diel të 25 janarit të vitit 1960 – ndodhi ajo mrekulli. Një ylber në qiellin e pastër domenikan. Më datë 21 kishte qenë festa e shenjtorit, Zonja Jonë e Altagrasias, por edhe dita më e keqe e bastisjes ndaj militantëve të 14 Qershorit. Kisha e Altagrasias, atë mëngjes plot diell, ishte plot e përplot. Papritur, nga amvona, me zë të prerë, at Sipriano Fortini filloi të lexojë – të njëjtën gjë bënin barinjtë e Krishtit në gjithë kishat domenikane – atë Kartën Pastorale të Peshkopatës, e cila rrëqethi Republikën. Që nga ciklon edhe më dramatik se i famshmi ciklon San Zenon i vitit 1930, në fillimet e Epokës së Truhijos, i cili rrafshoi kryeqytetin.
- Në errësirën e automobilat, Salvadori, i zhytur në kujtimet e asaj dite, buzëqeshi. Duke dëgjuar at Fortinin të lexojë me spanjishten e vet, paksa frankofile, çdo frazë të asaj Karte Pastorale që e çmendi fare Përbindëshin, i dukej se ishte përgjigje ndaj dyshimeve dhe angështive të tij. E njihte aq mirë atë tekst – që pasi e dëgjoi, do ta lexonte të shtypur fshehtas dhe të shpërndarë kudo – sa e dinte sa herë përmendësh. Një "hije trishtimi" shënonte kremtimi i Virgjëreshës Dominikane. "Nuk mund të qëndrojmë të pandjeshëm para mundimit të thellë që trishton një numër të madh vatrash domenikane", thoshnin peshkopët. Si San Pedro "donin të qanin me ata që qajnë". Kujtonin se "rrënja dhe baza e gjithë të drejtave, mbrohet te dinjiteti i paprekshëm njerëzor". Një citat i Papa Pio XII u bënte thirrje "miliona njerëzve që vazhdojnë të jetojnë nën shtypje dhe tirani", atyre që nuk kanë "asgjë të sigurt: as shtëpi, as pronë, as liri dhe as nder".
- Çdo frazë i përshpejtonte zemrën Salvadorit. "Kujt i përket e drejta për të jetuar, veç Zotit që e ka dhënë jetën?" Peshkopët theksonin se nga ajo "e drejtë parësore", burojnë të tjerat: E drejta për të formuar një familje, e drejta për punë, tregti, emigracion (a nuk ishte dënim nga ai sistem i poshtër që t'i kërkoje leje policisë për të dalë jashtë shtetit?), emër të mirë dhe të mos jesh i përgojuar "nën pretekste të kota apo denoncime anonime", "nga motive të ulëta dhe të poshtra". Karta Pastorale ripohoi se "çdo njeri ka të drejtën e lirisë së

ndërgjegjes, të shtypit, të grumbullimit të lirë...". Peshkopët luteshin që "në këto çaste mundimi dhe pasigurie", duhet të ketë "harmoni dhe paqe" dhe të vendosen në vend "të drejtat e shenjta të bashkëjetesës njerëzore".

- Salvadori u prek aq shumë kur doli nga kisha, sa që mundi ta komentojë Kartën Pastorale me të shoqen apo me miqtë, të cilët, të mbledhur te porta e famullisë, pështpëritnin nga çudia, entuziazmi apo frika për atë që kishin dëgjuar. S'kishte asnjë paqartësi: Në krye të Kartës Pastorale qe emri i peshkopit Rikardo Pitini dhe në fund firma e pesë peshkopëve të vendit.
- Duke mermëritur një shkak, ai doli nga shtëpia dhe si një i përhumbur, u kthye prapë në kishë. Shkoi në sakristi. Atë Fortini po hiqte rrobën ceremoniale. I buzëqeshi. "A je krenar për Kishën tënde tani, Salvador?" Atij nuk i dilnin fjalët. E përqafoi gjatë priftin. Po, Kisha e Krishtit kishte kaluar më në fund nga ana e viktimave.

- Përpjekjet do të jenë të tmerrshme, at Fortin, - mermëriti. - Dhe përndoqën. Por, me atë aftësi të mbrapshtë për intriga të regjimit, hakmarrja u përqendrua te dy peshkopët e huaj, duke shpërfllur të lindurit në tokën domenikane. Amerikani imzot Tomas F. Reji, i San Huande la Maguanas dhe spanjolli imzot Francisko Panal, peshkop i La Vegas, qenë në shënjestër gjatë asaj fushate të poshtër.
- Në javët që ndoqën harenë e 25 janarit të vitit 1960, Salvadori, për herë të parë, shqyrtoi nevojën për të vrarë Truhijon. Në fillim ideja e trembi. Një katolik duhet t'i respektojë rregullat e pestë. Megjithatë, i kthehej prapë papushim, sa herë që lexonte te "Karaibet", te "La Nacion", apo kur dëgjonte te "Zëri domenikan" sulmet kundër imzot Panalit dhe imzot Rejit, agjentë të fuqive të huaja, të shitur te komunizmi, kolonialistë, tradhtarë, nepërka. I mjeri imzot Panal! Të akuzosh si të huaj një prift që kishte kaluar tridhjetë vjet duke bërë vepra apostolike në La Vega, ku e donin të bardhë e të zinj. Intrigat e poshtra të Xhoni Abesit - ç'prapësira nuk i shkonin ndër mend? - që Turku i mësonte nga at Fortini dhe media njerëzore, ia hoqën skrupujt. U bind përfundimisht nga kinse sakrilegji i montuar kundër imzot Panalit në kishën e La Vegas, ku peshkopi jepte meshën e dymbëdhjetë. Në godinën e famullisë e ditës, u ndërpre nga një bandë zuskash tërë grim e gjysmë

të zhveshura, të cilat, përpara habisë së besimtarëve, duke iu afruar amvonës, e shanë dhe e fyen peshkopin plak, duke e akuzuar se ishte një pervers që kishte fëmijë me to. Njëra prej tyre, duke kapur mikrofonin, ulëriti: "Duhet t'i njohësh krijesat që na ke bërë të lindim dhe mos i lër të vdesin urie". Kur disa të pranishëm, dëshmitarë të asaj poshtërsie reaguan dhe tentuan t'i nxirrnin putanat jashtë dhe të mbronin peshkopin, ndërhynë agjentët e ardhur, nja njëzet burra të armatosur me çomange dhe rripa, të cilët sulmuan pa mëshirë famullinë. Të shkretët peshkopë! U shkatërravitën shtëpitë me të shara. Imzot Rejit, në San Huan de la Maguana, i hodhën dinamit në kamionçinën me të cilën udhëtonte nëpër dioqeza, i hodhën në shtëpi kafshë të ngordhura, ujëra të qelbur, minj të gjallë. Këtë e bënin çdo natë, derisa e detyruan të ikte dhe të strehohej në Kolegjin Santo Domingo, në kryeqytet. Stoiku, imzot Panali, vazhdonte t'u rezistonte në La Vega kërcënimeve, poshtërsive, fyerjeve. Ishte një plak i mbrojtur me baltë martirësh.

- Në një nga ato ditë Turku ia bëhu në shtëpinë e at Fortinit me fytyrën e tij të fryrë e të tjetërsuar.

- Ç'ka ndodhur, Salvador?
- Do ta vras Truhijon, at. Dua të di nëse do të ndëshkohem, - u ligështua: - S'i duroj dot më ato që po bëjnë me peshkopët, me kishat, atë fushatë të pështirë në televizion, në radio e gazeta. I rdhi fundi, duhet prerë koka e hidrës. Do të ndëshkohem?
- At Fortini e qetësoi. I bëri një kafe dhe e mori për një shëti tje të gjatë në rrugët e Santiagos, plot pemë dafine anash. Pas një jave e njoftoi se nunci apostolik, imzot Lino Zanini, do ta priste në Qytetin Truhijo, në një audiencë private. Turku u paraqit i ndrojtur në shtëpinë elegante e të madhe të nunciaturës, në bulevardin Maksimo Gomes. Ai princ i Kishës, e bëri të ndihej si në shtëpinë e vet qysh në çastin e parë atë vigan të hutuar, të shtrënguar nga jaka e këmishës dhe kravata që kishte veshur për audiencën me përfaqësuesin e Papës.
- Sa elegant ishte dhe sa mirë fliste imzot Zanini! Pa dyshim, një princ i vërtetë. Salvadori kishte dëgjuar shumë histori ra për nuncion dhe ndiente simpati për të, sepse thonin se Truhijo e urrente. Të ishte e vërtetë që Peroni iku prej vendit të vet (po bënte shtatë muaj në mërgim), sapo mori vesh për mbërritjen e nuncios së ri, Shenjtërisë Së Tij? Të gjithë e thonin atë që u bisedua në Pallatin Kombëtar: "Kujdes, Shkëlqesi.

Me Kishën mos u kap. Kujto ç'më ndodhi mua. Nuk më rrëzuan ushtarakët, po priftërinjtë. Ky nuncio që të ka dërguar Vatikani, është njësoj si ai që më dërgoi mua, kur filluan telashet me veladonët. Kujdes nga ai!". Dhe ish-diktatori argjentinas bëri valixhet gati dhe ia mbathi në Spanjë.

- Pas asaj mbledhjeje, Turku ishte i gatshëm të besonte çdo gjë të mirë që t'i thoshte imzot Zanini. Nuncioja e futi në zyrën e vet, i ofroi një gotë lëngje freskuese dhe i dha zemër për të zbrazur atë që kishte brenda, me fjalë të përzemërta, të thëna në një spanjishte si muzikë italiane, që te Salvadori bënte efektin e një melodie engjëllore. E dëgjoi të thotë se nuk mund ta duronte më atë çka ndodhte, atë që regjimi po bënte me Kishën, me peshkopët. Po çmendej. Pas një çasti të gjatë heshtjeje, ia kapi dorën me unaza nuncios:

- Do ta vras Truhijon, imzot. A ka falje për shpirtin tim?
- Zëri iu pre. Ndenji me sytë poshtë, duke marrë frymë tërë ankth. Ndjeu mbi shpatulla dorën atërore të imzot Zaninit. Kur ngriti sytë, pa nuncion me një libër të shën Tomas de Akuinos në dorë. Fytyra e tij e freskët i buzëqeshte me një pamje domethënëse. Gishti shenjonte një fragment në faqen e hapur. Salvadori u përkul e lexoi: "Eleminimi fizik i Përbindëshit, do të shihet mirë prej Zotit, nëse me të çlirohet një popull".
- Doli si në jerm nga nunciatura. Kaloi çaste tëra përgjatë bulevardit Xhorxh Uashington dhe në breg të detit, duke ndier një qetësi shpirtërore që kishte kohë pa e provuar. Do ta vriste Përbindëshin dhe Zoti e Kisha e tij do ta falnin. Duke i ngjyer duart me gjak, do të lante gjakun që Përbindëshi kishte derdhur në atdheun e tij.
- Por, a do të vinte? Ndiente tensionin e tmerrshëm që prishte kishte shkaktuar te shokët e vet. Askush s'e hapte gojën. Asnjëri nuk lëvizte. I dëgjonte të merrnin frymë: Antonio Imberti, me duar te timoni, disi i qetë merrte frymë me gulçe të gjata; Antonio de la Masa, duke dihatur shpejt, nuk ia ndante sytë rrugës; dhe në krah të tij, me frymëmarrje të thellë dhe ritmike, Amaditoja, me fytyrën po ashtu të drejtuar nga Qyteti Truhijo. Që të tre miqtë e tij i mbanin armët në duar, sikurse ai. Turkut i prekte kofshën qyta e Smith&Wesson 38, e blerë para ca kohësh në shitoren e një miku në Santiago. Amaditoja, përveç një pistoletë 45, kishte edhe një pushkë M1 – ndihmë qesharake nga jankit për komplotistët – dhe, ashtu si Antonio,

edhe njëren nga dy skopetat Browning kalibër 12, tytat e të cilave i kishte shkurtuar në punishten e vet, spanjolli Migel Anhel Bisie, mik i Antonio de la Masës. I kishin mbushur me fishekë specialë, që një tjetër mik i ngushtë i Antonios, edhe ky spanjoll dhe ish-oficer artilerie, Manuel de Ovin Filpo, i kishte përgatitur në mënyrë speciale dhe ua kishte dorëzuar me sigurinë se çdo plumb kishte të tillë fuqi vrasëse, sa të bënte si një elefant. Qoftë e thënë! Salvadori propozoi që karabinate e CIA-s t'i mbanin togeri Garsia Gerrero dhe Antonio de la Masa dhe ata të zinin vendet nga ana e djathtë, pranë dritares. Ishin qitësit më të mirë dhe dhe u takonte të qëllonin të parët, nga largësia më e afërt. Të gjithë pranuan. Por, a do të vijë?

– Mirënjohja dhe admirimi i Salvador Estrejas ndaj imzot Zaninit u shtuan kur, pak javë pas atij takimi në nunciaturë, mori vesh se motrat mëshirënjëse të Bamirësisë kishin vendosur ta lëviznin Giselën, motrën e tij murgeshë – motër Paulina – nga Santiagoja në Porto Riko. Gisela, motra e përkëdhelur, e preferuara e Salvadorit. U bë e tillë edhe më shumë kur u fut në jetën fetare. Ditën kur bëri ritin dhe zgjodhi emrin e mama Paulinës, lot të rëndë rrëshqitën në faqet e Turkut. Sa herë që ishte me motër Paulinën, ndihej i çliruar, i ngushëlluar, i shpirtësuar, i pushtuar nga qetësia dhe siguria që rrethonin nga motërza e dashur, nga qetësia dhe siguria me të cilën ajo e kalonte jetën, jetë që ia kishte dorëzuar Zotit. Ai i kishte thënë at Fortinit e nuncios për frikën që kishte se mos i ndodhte ndonjë gjë të motrës murgeshë, po të zbulohej se ishte komplotist? Nuk besonte kurrë që transferimi i së motrës në Porto Riko të ishte bërë rastësisht. Një vendim i matur, bujar, i Kishës së Krishtit, për ta nxjerrë jashtë rrezikut të Përbindshit një vajzë të re, të pastër e të pafajshme, mbi të cilën mund të binte dhuna e xhelatëve të Xhoni Abesit. Ishte njëra nga praktikat e regjimit që e tërbonte më shumë se gjithçka Salvadorin: Të sjellurit egërsisht me të afërmit e njerëzve që kishte dënuar apo tentonte t'i dënonte, me prindërit, fëmijët, familjarët, duke u konfiskuar pasurinë, duke i burgosur, duke i hequr nga puna, etj. Nëse kjo punë dështonte, dhuna ndaj motrave dhe vëllezërve të tij, do të ishte e pamëshirshme. As i ati, gjenerali Piro Estreja, mik i Bamirësit, të cilin e nderonte me bankete në pronën e tij në Las Lavas, nuk do të shpëtonte. Gjithçka e kishte matur dhe peshuar disa herë. Dhe e kishte

marrë vendimin. U gëzua kur u sigurua se dora kriminale nuk do të mund të arrinte dot te motër Paulina, në kuvendin e saj në Porto Riko. Herë pas here ajo i dërgonte letra me atë shkrimin e saj të qartë, të drejtë, plot dashuri e humor.

- Edhe pse ishte aq fetar, Salvadorit kurrë nuk iu shkoi në mendje të bënte jetë si bëri Gisela, të vishte petkun fetar. Ishte një vendim që e admironte dhe e lakmonte, por që ia kishte përjashtuar Zoti. Kurrë s'do të kishte mundur t'i plotësonte ato kushte, veçmas të bënte veprime aq të pastra. Zoti e kishte bërë tepër tokësor, tepër të prirur për t'iu dhënë atyre instinkteve që një bari i Krishtit duhej t'i shmangte për të plotësuar misionin e tij. Gjithmonë i kishin pëlqyer femrat, edhe tani që bënte një jetë bashkëshortore besnike, ndonjëherë zdërhallej, për çka ndërgjegja i lëndohej për një kohë të gjatë. Prania e ndonjë esmereje, meshollë dhe me vithe të bukura, me gojë sensuale e sy të ndritshëm – bukuria tipike e domenikaneve dinake në vështrim, në të ecur, në të folur, në lëvizjet e duarve – e turbullonte Salvadorin, i ndizte fantazinë e dëshirat.
- Qenë tundime që nganjëherë edhe i mposhtte. Sa herë e gacmonin miqtë e tij për këtë gjë. Mbi të gjithë Antonio de la Masa, i cili pas vrasjes së Tavitos, sikurse ai, ra në zdërhallje. Ai nuk e shoqëronte Salvadorin në zgjimet në bordello apo në vizitat në shtëpira ku ndërmjetëset i siguronin vajza për t'i zhvirgjëruar. Shpesh i ndodhte që nuk e përballonte dot tundimin, sidomos pas një pikëllimi shumëditor. Kishte kohë që e kishte kuptuar se përgjegjës i rënies së tij, ishte Truhijo. Përbindëshi e kishte fajin që plot domenikanë zhyteshin në zdërhallje me femra e alkool, për të shuar angështimin që u shkaktonte të jetuarit pa asnjë shpresë lirie dhe dinjiteti, në një vend ku jeta njerëzore nuk vlente asgjë. Truhijo ishte njëra prej aleatëve më vlefshëm të djallit.

- Është ai! - bërtiti Antonio de la Masa.
  Po ashtu Amadoja dhe Toni Imberti:
- Ai është! Ai është!
- Nisu, jepi dreqit!
- Antonio Imberti, para se t'i thonin, e kishte bërë të tijën dhe Shevroleti, i ndaluar me turi nga Qyteti Truhijo, rrëmbimthi, me klithje gomash, bëri kthesën – si në një film policor, mendoi Salvadori – për t'u futur në drejtim të San Kristobalit, përgjatë rrugës së shkretë e të errët ku ecte autovetura e Truhijos.

Ai ishte? Salvadori nuk e pa, po shokët e tij dukeshin aq të sigurt, sa duhej të ishte ai. Duhej të ishte ai. Zemra po i çante gjoksin. Antonioja dhe Amaditoja ulën xhamat e dritares dhe meqë Imberti, i përkulur mbi timon si kalorësi mbi kalin që kapërcen pengesa, ia kishte shkelur deri në fund, era u bë aq e fortë, sa Salvadori me zor i mbante hapur sytë. I mbronte ata me dorën e lirë, ndërsa me tjetrën shtrëngonte revolverin. Pak nga pak po e shkurtonin distancën nga dritat e kuqe.

– Është e sigurt që është Shevroleti i Cjapit, Amadito?
– E sigurt, e sigurt, - klithi togeri. - Njoha shoferin, është Zakarias de la Krus. Nuk u thashë që do të vinte?
– Jepi dhe më, vëlla! - përsëriti për të tretën apo të katërtën herë Antonio de la Masa. Kishte nxjerrë kokën dhe grykën e shkurtuar var të karabinës së tij jashtë makinës.
– Kishe të drejtë, Amadito, - u dëgjua të thërriste Salvadori. - Erdhi dhe pa eskortë, siç the ti.
– Togeri e kishte mbërthyer pushkën me të dyja duart. Me shpinë të anuar dhe me gishtin në këmbëz, po mbështeste qytën e M1 në supin e djathtë. “Faleminderit, Zoti im, në emër të bijve të tu domenikanë”, lutej Salvadori.
– Shevroleti Biscayne i Antonio de la Masës fluturonte mbi rrugë, duke e shkurtuar gjithmonë largësinë nga Shevroleti Bel Air, ngjyrë qielli, të përshkruar shpesh nga Amado Garsia. Turku dalloi targën e bardhë numrin e zi 0-1823 dhe perdet e pëlhura në dritare. Po, ishte autovetura që Shefit përdorte për të shkuar në Shtëpinë me Mogan, në San Kristobal. Salvadori kishte parë një ëndërr të përsëritur me këtë Shevrolet Biscayne që drejtonte Toni Imberti. Po shkonin në errësirë nën një qiell me hënë e yje, kur papritur ky automobil fare i ri, i përgatitur për ndjekje, filloi të ngecë, duke ecur gjithnjë e më ngadalë, derisa mes mallkimeve të të gjithëve, ndali. Salvadori shihte autoveturën e Bamirësit më shpejt – duhej të ishte mbi njëqind në orë tani – dhe autovetura përpara shquhej qartë nën ndriçimin e dritave të larta që kishte vënë Imberti. Salvadori e njihhte në detaje historinë e kësaj makine, qysh kur duke ndjekur iniciativën e togerit Garsia Guerrero, vendosën për t’i bërë prusi Truhijos, në udhëtimin e tij javor për në San Kristobal. Ishte e qartë se suksesi do të varej nga shpejtësia e makinës që do të përdornin. Antonio de la Masa ishte i pasionuar

pas automobilistikës. Santo Domingo Motors nuk u çudit që dikush, i cili për arsye të punës së vet në kufi me Haitin bënte qindra kilometro çdo javë, donte një makinë speciale. I rekomanduan një Shevrolet Biscayne që e porositi në Shtetet Bashkuara. Mbërriti në Qytetin Truhijo para tre muajsh. Salvadori kujtoi ditën kur hipën në të për ta provuar dhe se si qeshnin duke lexuar instruksionet që shpjegonin se kjo autoveturë ishte e njollosur me ato që përdorte policia njujorkeze për të ndjekur keqbërësit. Me ajër të kondicionuar, transmision automatik, frena hidraulike dhe motorr 3500 cc me tetë cilindra. "Kurrë nuk kam bërë investim më të mirë", tha Antonio për makinën që i kushtoi shtatë mijë dollarë. E provuan në rrethinat e Mokës dhe panë se katalogu nuk e tepronte: Mund të ecte njëqind e shtatëdhjetë kilometra në orë.

- Kujdes, Toni, - dëgjoi të thuhej pas një tronditjeje që u shkaktua nga goditja e parafangos. As Antonioja, as Amaditoja nuk kuptuan gjë, vazhdonin me armët dhe kokat jashtë, duke pritur që Imberti të parakalonte autoveturën e Truhijos. Ndodheshin të paktën nja njëzet metra e pak, e fortë po i asfiksonte dhe Salvadori nuk e ndante vështrimin nga perdja e mbyllur e dritares së prapme. Do të duhej të qëllonin qorrazi, ta mbulonin me plumba tërë vendin ku ishte ulur. Iu lut Zotit që Cjapi të mos eq i shoqëruar nga ndonjëri prej besnikëve të vet që i çonte në Shtëpinë me Mogan.
- Si ta nuhaste befas se po e ndiqnin a nga instinkti sportiv, Shevrolet Bel Air s'i la të parakalonin e përparoi ca metra.
- Jepi! - urdhëroi Antonio de la Masa. - Më shpejt, dreqin!
- Në pak sekonda Shevrolet Biscayne firoi sërish largësinë e humbur dhe vazhdoi t'i afrohej edhe më. Po të tjerët? Ku janë Pedro Livio me Uaskar Tehedën? Prisnin në Oldsmobile, nja dy kilometro përpara tyre, tani duhet t'i kishin prerë rrugën Truhijos. Mos harroi Imberti të jepte shenjën me tri fikje dritash? As Fifi Pastorica nuk u duk me Mërkurin e vjetër të Salvadorit, një pritë tjetër, dy kilometra mënjanë Oldsmobilit. Tani duhej të kishin bërë dy, tre, katër ose më shumë kilometra. Ku ishin?
- Mos harrove të jepje shenjën, Toni?! - bërtiti Turku. - I kemi lënë prapa Pedro Livion dhe Fifin.
- Ndodheshin nja tetë metra larg autoveturës së Truhijos dhe Toni i kërkoi kalim, duke ndërruar dritat e duke i rënë borisë.

– Jepi ende, - hungëriti Antonio de la Masa.
– Përparuan edhe pak, por Shevrolet Bel Air vazhdonte në mes të rrugës, shpërfillës ndaj sinjaleve të Tonit. Po ku dreqin ishte Oldsmobili me Pedro Livion dhe Uaskarin? Ku ishte Mërkuri i tij me Fifi Pastorican? Më në fund autovetura e Truhijos u shmang nga e djathta. Kishte hapësirë të mjaftueshme.
– Afrohu, afrohu akoma, - lutej histerik Antonio de la Masa.
– Toni Imberti i dha akoma gaz dhe në pak sekonda u gjendën paralelisht me Shevroletin Bel Air. Edhe perdja anësore qe e mbyllur, kështu që Salvadori nuk e pa Truhijon, por pa qartë në dritaren e përparme fytyrën kockore dhe të trashë të të famshmit Zakarias de la Krus, në çastin kur timpanët e veshëve iu dukën se plasën nga zhurma e të shtënave të njëkohshme të Antonios dhe togerit. Autoveturat qenë aq pranë sa ciflat e xhamave të dritares së prapme të autoveturës tjetër arritën deri tek ata dhe Salvadori ndjeu t'ia shponin fytyrën. Si në kllapi arriti të shihte që Zakarias bëri një lëvizje të çuditshme të kokës, dhe një sekondë më vonë, edhe ai nisi të shtënte mbi Amaditon.
– Zgjati vetë pak sekonda, ja tani – gërvima e gomave i rreqethi mishin – një frenim në të thatë e la pas autoveturën e Truhijos. Tek ktheu kokën pa nga dritarja e pasme që Shevrolet Bel Air bënte zig-zage, si të shmangte përmbysjen para se të ndalte. Nuk po merrte kthesë, nuk kërkonte të ikte.
– Ndal, ndal! - ulëriti Antonio de la Masa. - Ec prapa, dreqin!
– Po Toni dinte ç'bënte. Kishte frenuar në të thatë, pothuajse në të njëjtën kohë me autoveturën e Truhijos, por e hoqi këmbën nga frenat para tronditjes së dhunshme që pësoi makina, gati për t'u përmbysur dhe pastaj frenoi përsëri, derisa e ndali Shevroletin e vet. Pa humbur asnjë sekondë, manovroi, xhiroi përreth, mbrapsht – nuk po vinte asnjë makinë – derisa u kthye plotësisht në drejtim të kundërt dhe po shkonte drejt makinës së Truhijos, e cila, kishte ndaluar çuditshëm nja njëqind metra prapa, me drita të ndezura, si të ishte në pritje. Sa bënë gjysmën e rrugës, dritat e autoveturës së ndalur u fikën, megjithatë Truhijo u shqua: Ishte atje, i ndriçuar nga dritat e larta të Toni Imbertit.
– Ulni kokat, përkuluni! - tha Amaditoja. - Po na qëllojnë.
– Qelqi i dritares në të majtë të tij u bë copa. Salvadori ndjeu gërvishje në fytyrë e në qafë dhe qe hedhur përpara nga frenimi

i ashpër. Shevroleti Biscayne ulëriti, bëri zig-zag, u afrua plotësisht në anë të rrugës para se të ndalte. Imberti fiku dritat. Gjithçka e mbuloi errësira. Salvadori ndiente plumbat rrotull. Por ku i hodhën nga makina ai, Amaditoja, Toni dhe Antonioja?! Të katërt u ndodhën jashtë, duke shtirë përpara ku ishte ose ku mund të ishte makina e Truhijos e duke u mbrojtur pas dyerve të hapur e parafangove. Kush i qëllonte? Kishte tjetër njeri me Cjapin, veç shoferit? Sepse po i qëllonin. Plumbat vërshëllinin përreth, trokëllinin në çatinë e Shevroletit dhe arrinin të plagosnin ndonjërin prej tyre.

– Turko, Amadito, na mbuloni! - urdhëroi Antonio de la Masa. - Toni, përpara, ta vrasim!
– Pothuajse njëherëzi Salvadori – sytë e tij tani kishin filluar të dallonin profilet dhe siluetat në shkëlqimin e dobët kaltërosh - pa të dyja figurat e tyre të përkulura, duke vrapuar drejt autoveturës së Truhijos.
– Prit, Turko! - tha Amaditoja, i cili me njërin gju në tokë, po merrte shenjë me pushkën e vet. - Gati! Nuk do të na shpëtojë dot. Do ta grijmë.
– Nja pesë, tetë, dhjetë sekonda, ra qetësi e plotë. Si në një fantazmagori, Salvadori shqoi se në rrugë, në të djathtë të tij, po iknin me shumë shpejtësi drejt Qytetit Truhijo dy automobilë. Një çast më vonë u dëgjuat batareja e të shtënave me pushkë dhe me revolver. Zgjati pak sekonda. Pastaj zëri i fuqishëm i Antonio de la Masës, çau natën:
– Eeej, është vrarë, qeni!
– Ai dhe Amaditoja u turrën drejt tyre me vrap. Disa sekonda më pas, Salvadori u ndal dhe po zgjaste kokën mbi supet e Toni Imbertit dhe të Antonios, të cilët, njëri me një çakmak dhe tjetri me një fije shkrepse të ndezur, vëzhgonin trupin e mbytur në gjak, të veshur me kostum ngjyrë ulliri, me fytyrë të copëtuar, i shtrirë në sedile mbi një pellg gjaku. Nuk pati kohë të falënderonte qiellin, dëgjoi të vraponte dikush, diku prapa autoveturës së Truhijos dhe, menjëherë mendoi i sigurt se do të dëgjonte edhe të shtëna. Pa u menduar fare, ngriti revolen dhe qëlloi, i bindur se qenë shoqërues, adjutantë ushtarakë, që po vinin në ndihmë të Shefit. Dhe, fare afër, dëgjoi rënkimin e Pedro Livio Sedenjos që e kishin mbërthyer plumbat e tij. Iu bë sikur iu hap dheu dhe nga ajo e çarë po dilte Qoftëlargu, duke u shqyer së qeshuri me të.

XIII

– Vërtet nuk dëshiron edhe pak hallvë? - këmbëngulte përzemërsisht hallë Adelina. - Hë, më qafsh, merr! Kur ishe e vogël, sa herë vije këtu më kërkoje hallvë. Nuk do më pëlqen?
– Si s'më pëlqen?! - proteston Urania. - Por kurrë s'kam ngrënë kaq shumë. Nuk do më zërë gjumi.
– E po mirë, këtu e ke, kur të duash ha, - u tërhoq e mundur hallë Adelina.
– Siguria e zërit dhe kthjelltësia e mendjes, binte ndesh me pamjen e saj të shëmtuar: e rrëgjuar, gati e shogët – mes xhufkave me qime të bardha, dukeshin copa të rrepura lëkure – me një fytyrë tejet të rrudhosur dhe një protezë që i lëvizte sa herë hante dhe hante. Një grusht grua, e ulur në karrigen lëkundëse, ku e kanë vendosur Lusinda, Manolita, Marianita dhe shërbyesja haitjane, pasi ka humbur shumë peshë. Halla nguli sytë e saj të ftohtë e të mprehtë te vajza e saj të cilën e ka parë për herë të fundit kur ishte katërmbëdhjetë apo pesëmbëdhjetë vjeçe, ndërsa tani është një zonjë e madhe me rrudhat në fytyrë e në qafë, me flokët e ngjyrë me të zezë në blu, mjaft të hollë, duket më e vjetër se ç'është. Marianita, e bija e Manolitës, duhet të ishte nja njëzete vjeçe: e hollë, tepër e zbehtë, me flokët të prera shumë shkurt dhe me ca sy të trishtuar. Nuk pushonte së kundruari Uraninë, si e magjepsur. Ç'mund të kishte dëgjuar për të kjo mbesë?
– Nuk më besohet që je ti, që je këtu, - hallë Adelina nuk ia shkul vështrimin e depërtues. - Kurrë nuk e kisha marrë me mend se do të shihja prapë.
– Ja pra, jam këtu, hallë. Sa e gëzuar jam.
– Edhe unë, moj bijë. Po gëzimin më të madh do t'ia kesh

dhënë Agustinit. Im vëlla qe bindur se nuk do të të shihte më.

– Nuk e di, hallë - Urania, duke parandier qortimet dhe pyetjet pa kujdes, përpiqet të mbrohet. - Ndenja gjithë ditën me të dhe m'u duk se nuk më njohu fare.
– Të dy kushërirat reaguan në një zë:
– Patjetër që të ka njohur, Uranitka, - pohoi Lusinda.
– Ngaqë nuk flet dot, të duket ashtu, - e mbështeti Manolita. - Por kupton gjithçka, mendjen e ka shumë të freskët.
– Vazhdon të jetë ai Inteligjenti që ka qenë, - bëri shaka hallë Adelina.
– E dimë, se e shohim përditë, - përfundon Lusinda. - Të njohu dhe e ke bërë të lumtur me ardhjen tënde.
– Ashtu qoftë, moj kushërirë.
– Qetësia zgjat, vështrimet kryqëzohen mbi tryezën e vjetër, në atë dhomë të ngushtë me një bufe plot qelqurina që Urania i njeh vagëllimthi dhe kuadrat fetarë në muret e gjelbra të dalë boje. Edhe këtu nuk ndien asgjë familjare. Në kujtesën e saj, shtëpia e hallë Adelinës dhe xhaxha Anibalit, ku vinte për të luajtur me Manolitën dhe Lusindën, ishte e madhe, plot dritë, elegante dhe e ajrosur, kurse kjo është si një shpellë e mbushur me mobilje që të ndrydh.
– Kjo kocka e legenit që theva më ndau përgjithmonë prej Agustinit, - lëviz grushtin e vogël, me gishta të deformuar nga skleroza. - Më përpara kaloja orë të tëra me të. Bisedonim gjatë. Unë nuk kisha nevojë të më fliste, për të kuptuar ç'donte të më thoshte. Im mrekulli vëlla! Do ta kisha sjellë këtu. Po, ku? Në këtë fole minjsh?
Flet me zemërim.
– Vdekja e Truhijos qe zanafilla e fundit tonë, - merr frymë Lusinda. Dhe befas acarohet. - Më fal, kushërirë. Ti, vërtet e urren Truhijon?
– Filloi më përpara, - e korregjoi hallë Adelina dhe Urania mban vesh për atë që thotë.
– Kur, gjyshe? - pyet me një fill zëri vajza e madhe e Lusindës.
– Me letrën në Forumit Publik, disa muaj para se të vrisnin Truhijon, - kujton hallë Adelina dhe sytë e saj vëzhgojnë hapësirën. - Në janar ose shkurt të vitit 1961. Ne ia dhamë lajmin babait tënd, në mëngjes. Anibali e kishte lexuar i pari.
– Letër në "Forumin Publik"? - Urania rrëmon kujtesën. - Ah, po.

- Mendoj se s'është asgjë me rëndësi, mendoj se është ndonjë budallallëk që do të sqarohet, - i tha i kunati në telefon. Ishte aq i shqetësuar, aq i rrëmbyer, me një zë aq fals, sa senator Agustin Kabrali u çudit: Ç'e gjeti Anibalin? - Nuk e lexove "Karaibet"?
- Sa ma sollën, akoma s'e kam hapur.
  Dëgjoi një kollitje nervoze.
- Shiko, ka një letër aty, Inteligjent, - u përpoq t'i përcillte humor dhe shkujdesje i kunati. - Marrëzira. Sqaroje sa më parë.
- Faleminderit që më telefonove, - e përshëndeti senator Kabrali. - Puthje për Adelinën dhe vajzat. Do të kaloj andej t'i shoh.
- Tridhjetë vjet në majat e pushtetit politik, e kishin bërë Agustin Kabralin njeri me përvojë në gjërat e paparashikueshme - kurthet, intrigat, hiletë, tradhëtitë - aq sa, me të marrë vesh se kishte një letër kundër tij në "Forumin Publik", kolana më e lexuar dhe më e frikshme e "Karaibet", që kishte autorësinë nga Pallati Kombëtar dhe ishte barometri politik i vendit, nuk e humbi toruan. Ishte e para herë që shfaqej në kolonat e ferrit. Të tjerë ministra, senatorë, guvernatorë ose funksionerë, qenë përzhitur nga ai zjarr. Të gjithë, ani tani, jo. U kthye në dhomën e ngrënies. E bija, me uniformën e kolegjit, po hante mëngjesin: mangu – banane e përzier me gjalpë – dhe djath të pjekur. E puthi të bijën te flokët ("Mirëmëngjesi, babi"), u ul në karrigen e saj dhe, ndërsa shërbyesja i shërbente kafen, e hapi ngadalë, pa u hutuar, gazetën e palosur në një cep të tryezës. E shfletoi, derisa mbërriti te "Forumi Publik".
- **Zoti Drejtor:**
  Po shkruaj nga një shtysë qytetare dhe protestoj për shpërfilljen ndaj qytetarëve domenikanë dhe të lirisë së shprehjes, të qeveria e Udhëheqësit Truhijo ia garanton kësaj Republike. E kam fjalën për atë që nuk është e njohur deri tani në faqet e gazetës tuaj, aq të lexuara dhe të respektuara, faktin e njohur prej të gjithëve, se senatori Agustin Kabrali, i quajturi Inteligjenti (për ç'arsye, vallë?) u hoq nga Presidenti e Senatit sapo iu provua një veprim jokorrekt në Ministrinë e Punëve Publike, që e drejtonte para pak kohësh. Dihet, gjithashtu, që, i përpiktë siç është ky pushtet për ndershmërinë dhe përdorimin e fondeve publike, një komision investigimi për keqpërdorimet e dukshme dhe ngatërresat

(komisione të paligjshme, blerje materialesh të vjetra me çmime mbi vlerë, inflacion fiktiv preventivash, ku senatori vendoste si ministër) qe caktuar për të verifikuar akuzat kundër tij.
A nuk ka të drejtë populli truhijist të jetë i informuar mbi këto fakte kaq të rënda?
Me nderime,
Inxhinier Telesforo Hidalgo Saino
Rruga Duarte N. 171
Qyteti Truhijo

- Po nxitoj, babi, - dëgjoi senatorit të bijën dhe pa e tradhtuar me asnjë gjest qetësinë e rreme të tij, ngriti kokën nga gazeta për ta puthur. - Nuk do të kthehem me autobusin e kolegjit, do të qëndroj të luaj volejboll. Do të vijmë në këmbë me disa shoqe.
- Kujdes kur kalon kryqëzimet, Uranita.
- Piu lëngun e portokallit e pastaj kafen e ngrohtë që avullonte, pa u nxituar, po nuk e zuri me dorë mangunë, as djathin dhe as bukën e thekur me mjaltë. Rilexoi fjalë për fjalë e germë për germë, letrën e "Forumit Publik". Pa dyshim që ishte përpunuar nga Kushtetucionalisti Sarhosh, doktori i dashur i intrigave, por i urdhëruar nga Shefi. Askush nuk do të guxonte të shkruante, e jo më të publikonte, një letër të tillë pa lejen e Truhijos. Kur e pa për herë të fundit? Pardje në shëtitje. Nuk qe caktuar të shëtiste pranë tij. Shefi ishte duke biseduar tërë kohën me gjeneralin Romanin dhe gjeneral Espajatin, por e përshëndeti me shpërfilljen e zakonshme. Apo jo? Mprehu kujtesën. A thua vuri re njëfarë ashpërsie në atë vështrim ngulës, frikësues, që zakonisht shfaqej te pamja e tij për të rrëqethur shpirtin e atij që vëzhgonte? Njëfarë ftohtësie, kur iu përgjigj përshëndetjes? Një ngrisje vetullash? Jo, nuk kujtonte asgjë normale.
- Kuzhinierja e pyeti nëse do të vinte për drekë. Jo, vetëm për darkë dhe miratoi kur Aleli i propozoi menynë e darkës. Sa ndjeu autoveturën e Presidencës së Senatit që mbërriti te porta e shtëpisë, pa orën: tetë fiks. Falë Truhijos, kishte kuptuar që koha është flori. Si shumë të tjerë, përvetësoi qysh i ri zakonet e Shefit: Rregullin, përpikërinë, disiplinën, përsosjen. Senator Agustin Kabrali kishte thënë në një fjalë të tij: "Falë Shkëlqesisë së Tij, Shefit tonë, ne domenikanët zbuluam mrekullitë

e përpikërisë". Duke veshur xhaketën, doli në rrugë: "Po të më kishin pushuar, nuk do të kishte ardhur autovetura e Presidencës së Senatit për të më marrë". Shoqëruesi i tij, togeri i aviacionit, Humberto Arenali, i cili kurrë nuk i fshehu lidhjet e tij me SIM-in, i hapi derën. Autovetura shtetërore me Teodosion shofer. Shoqëruesi. Nuk kishte pse të shqetësohej.

– Asnjëherë s'e mora vesh pse u rrëzua? - pyet me habi Urania.
– Kurrë nuk u bë e qartë, - sqaron hallë Adelina. - Pati vetëm hamendje, asgjë më shumë. Gjithmonë pyeste se ç'ishte bërë Agustini që Truhijo të zemërohej ashtu, nga darka në mëngjes. Që një njeri, i cili i kishte shërbyer tërë jetën, të kthehej befas në një plehrë.
– Urania vëren mosbesimin me të cilin dëgjon Marianita.
– Të duken gjëra nga një planet tjetër, zë mbesë?
Vajza skuqet.
– Jo, po... më duket aq e pabesueshme kjo, teze. Sikurse në filmin "Proçes" me Orson Uelles, i cili u dha në Cine Club. Antonin Perkinsin e gjykojnë dhe e ekzekutojnë pa e marrë vesh pse.
Manolita ndërpreu të freskuarit me duar për të ndërhyrë:
– Thanë që e pësoi, ngaqë Truhijon e bindën se për faj të dajo Agustinit, peshkopët nuk pranuan ta shpallnin Bamirës të Kishës Katolike.
– Thanë një mijë gjëra, - foli zëtartë hallë Adelina. - Më keq se kalvari i tij, qenë dyshimet. Familja mori tatëpjetën e askush nuk dinte për çfarë e akuzonin Agustinin, çfarë kishte bërë apo çfarë kishte lënë pa bërë.
– Nuk kishte asnjë senator në lokalin e Senatit, kur Agustin Kabrali hyri në tetë e pesëmbëdhjetë të mëngjesit, si çdo ditë. Roja i dha përshëndetjen që i takonte dhe mësuesit e punonjësit që i dolën përpara, gjatë rrugës për në zyrë, i dhanë mirëmëngjesin me përzemërsinë e përhershme. Por dy sekretarët e tij, Isabela dhe avokati i ri, Paris Goiko, reflektonin shqetësim në fytyrat e tyre.
– Kush ka vdekur? - bëri shaka. - Ju shqetëson ajo kartka te "Forumi Publik"? Do ta sqarojmë këtë poshtërsi qysh tani. I bëni një telefonatë drejtorit të "Karaibeve", Isabelita. Është në shtëpi. Pançitoja nuk shkon në punë para mesditës.
– U ul në tryezën e punës, i hodhi një shikim pirgut të dokumentave

të korrespondencës dhe të axhendës së ditës, të përgatitura me kompetencë prej Parisit. "Letra ka qenë e diktuar nga Shefi." Një gjarper rrëqethës i hyri në trup shpinën. Të ishte ndonjë nga ato skenat që e argëtonin Gjeneralísimin? Në mes të tensioneve me Kishën, përplasjeve me Shtetet e Bashkuara dhe OEA-në, kishte kohë për shaka, si më përpara kur ndihej i plotfuqishëm dhe i pakërcënuar? Ishin kohërat për humor këto?

– Telefoni, don Agustin.
Ngriti dorezën e aparatit dhe priti disa sekonda para se të fliste.
– Të zgjova, Pançito?
– Ç'thua Inteligjent?! - zëri i gazetarit ishte normal. - Unë jam si kaposh i tredhur, ngrihem me natë. Fle me një sy hapur, për çdo rast. Hë, si është puna?
– Po, ja, siç e merr me mend, të thirra për atë letrën që ka dalë sot te "Forumi Publik", - pastroi zërin senator Kabrali. - Mund të më thuash diçka?
Përgjigja erdhi me të njëjtin ton humori, papërgjegjësie, si të bëhej fjalë për një gjë fare të parëndësishme.
– Erdhi e rekomanduar, Inteligjent. Nuk do ta botoja një gjë të tillë pa e verifikuar. Besomë, për miqësinë që kemi. Nuk më erdhi fare mirë që e publikova.
"Po, po. E qartë", mërmëriti. Nuk duhej ta humbiste në asnjë çast gjakftohtësinë.
– Kam ndërmend t'i përgjigjem asaj letre, - tha, ngadalë. - Me mua s'ka ndodhur asgjë. Po të flas nga Presidenca e Senatit. Ai ashtuquajturi komision hetimi për drejtimin tim të Punëve Publike, është një gënjeshtër.
– Dërgoma përgjigjen tënde sa më parë, - iu përgjigj Pançitoja. - Do të bëj ç'është e mundur për ta botuar. Ti e di se sa të çmoj. Nga ora katër do të jem te gazeta. Puthma Uranitkën. Përqafime, Agustin.
Pastaj e mbylli telefonin. Dyshoi. A bëri mirë vallë që foli me drejtorin e "Karaibeve". Mos ishte ndonjë manovër nga ana e gazetarit për të spiunuar alarmin e tij? Po ç'mund t'i kishte thënë tjetër: Ai merrte letra për "Forumin Publik" drejtpërdrejtë nga Pallati Kombëtar dhe i botonte pa pyetur. Pa orën: nëntë pa një çerek. Kishte kohë. Mbledhja e Tryezës Drejtuese të Senatit ishte në nëntë e gjysmë. I diktoi Isabelitës përgjigjen

e letrës në po atë mënyrë të thjeshtë e të qartë me të cilën bënte shkrimet e tij. Një letër e shkurtër, e thatë dhe goditëse: Vazhdonte të ishte president i Senatit dhe askush nuk i kishte bërë vërejtje për drejtimin e rregullt të Ministrisë së Punëve Publike, që i kishte besuar ky regjim i drejtuar nga domenikani me famë, Shkëlqesia e Tij, Gjeneralissimi Rafael Leonidas Truhijo, Bamirës dhe At i Atdheut të Ri.

– Kur Isabelita shkoi ta daktilografonte letrën, në zyrë hyri Paris Goiko.
– Është anulluar mbledhja e Tryezës Drejtuese të Senatit, zoti kryetar.
Ishte i ri, nuk dinte të shtirej. Gojën e mbante gjysmë të hapur dhe në fytyrë qe murrëtyer.
– Pa u konsultuar me mua? Kush?
– Zëvendëskryetari i Kongresit, don Agustin. Ai vetë më tha t'jua komunikoja.
E gjykoi mirë atë që sapo dëgjoi. Mos ishte ndonjë gjë tjetër që s'kishte të bënte me letrën e "Forumit Publik"? Parisi, i pikëlluar, priste në këmbë pranë tryezës.
– Është në zyrë doktor Kintanija? - pyeti dhe kur sekretari miratoi me kokë, u ngrit nga karrigia: - Thuaji se po vij.
– Është e pamundur të mos e kujtosh, moj Uranita, - iu ankua hallë Adelina. - Ishte katërmbëdhjetë vjeçe. Ishte gjëja më e madhe që i ndodhi familjes, më e madhe se vdekja e mamasë tënde. Dhe ti nuk mbake mend asgjë?
Kishin pirë kafe dhe çaj. Urania provoi një kafshatë hallve. Bisedonin rreth tavolinës së ngrënies, në dritën e mekur të llambës së abazhurit. Shërbëtorja haitjane, e pandjeshme si një mace, mblodhi enët.
– Sigurisht që më kujtohet ankthi i babait, hallë, - sqaroi Urania. - Po nuk mbaj mend hollësirat, të papriturat e përditshme. Ai përpiqej të m'i fshinte në fillim. "Kam probleme, Uranita, por do të zgjidhen." Nuk e kisha imagjinuar se qysh atëherë jeta ime do të përmbysej ashtu.
Ndien që e djegën vështrimet e hallës, të kushërirave dhe të mbesës. Lusinda shpreh çfarë mendojnë:
– Veç ty të doli mirë, Urani. Nuk do të ishe ku je, po të ndodhte ndryshe. Kurse për ne qe një katastrofë.
– Për të ziun tim vëlla, më keq nga të gjithë, - i qahet halla. - Ia

ngulën thikën dhe e lanë t'i rrjedhë gjak për më se tridhjetë vjet.
Një papagall këlthet mbi kokën e Uranisë dhe e bën të hidhet përpjetë. As që e kishte vënë re farë atë shpend. Ai është i nervoruar dhe lëviz sa andej-këndej mbi një cilindër druri, brenda kafazit të madh me tela blu. Halla, kushërirat dhe mbesa, ia japin gazit.

– Është Samsoni, - e prezanton Manolita. - U egërsua ngaqë e zgjuam. Është gjumash.
Falë papagallit, atmosfera u shtendos.

– Jam e sigurt se po të kuptoja çfarë thotë, do të merrja vesh shumë sekrete, - bën shaka Urania, duke treguar Samsonin.

– Senatori Agustin Kabral, pa buzëqeshur, i përgjigjet me një përkulje të thatë përshëndetjes së sheqerosur të doktor Heremias Kintanijas, zëvendëspresidenti i Senatit, në zyrën e të cilit sapo hyri dhe, pa e zgjatur fare, i foli me ton:

– Pse e ke anulluar mbledhjen e Tryezës Drejtuese të Senatit? A nuk i takon kjo detyrë kryetarit? M'u shpjego.
Mimika e fytyrës së trashë, ngjyrë kakao, e senator Kintanijas pranonte gjithshka, ndërsa buzët e tij, me një spanjishte të ngutshme, plotë ëmbëlsi, mundohen ta qetësojnë:

– Patjetër, Inteligjent. Mos u nxeh. Gjithçka, përveç vdekjes, ka arsyen e vet.
Është një burrë rondokop, rreth të gjashtëdhjetave, me sytë e enjtur, me gojën plot pështymë, i veshur krëk me një kostum të kaltër e gravatë me vija të argjenta që shkëlqente. Ai buzëqesh me këmbëngulje duke hequr syzet, i shkel syrin Kabralit, hedh një vështrim të shpejtë përreth me sytë e zgurdulluar dhe, duke bërë një hap drejt tij, e merr për krahu, e tërheq dhe ndërkohë i thotë me zë të lartë:

– Ulemi këtu që të jemi më qetë.
Veç, nuk e shpie te kolltuqet këmbërënda, me lëkurë tigri, të zyrës së tij, por te ballkoni me dyer gjysmë të hapura. Duke e tërhequr për krahu, del bashkë me të për të biseduar në ajër një diell i fortë. Mëngjesi i ndritshëm zien nga motorrat dhe boritë e makinave që vijnë prej Malekonit e nga zërat e kasnecëve ambulantë.

– Ç'dreqin po ndodh, Mono? - mërmërit Kabraler.

Kintanija që vazhdon ta mbajë për krahu, bëhet serioz. Vë re në shikimin e tij një ndjenjë të shpërqendruar solidariteti apo keqardhjeje.

– Ti e di mirë se ç'po ndodh, Inteligjent. Mos u bëj budalla. Nuk e ke marrë vesh se ka tri-katër ditë që s'po të thërrasin më "i nderuar zotëri" në gazeta, po thjesht "zotëri"? - i pëshpëriti në vesh Mono Kintanija. - Nuk e ke lexuar "Karaibet" sot në mëngjes? Ja pra, çfarë po ndodh.

Për herë të parë, qysh nga koha kur lexoi në "Forumin Publik", Agustin Kabrali ndien frikë. Vërtet, dje ose pardje, dikush pati bërë shaka në "Country Club" se faqja shoqërore e "La Nacion", nuk e quante "i nderuar zotëri", gjë që ishte një ogur i keq: Gjeneralissimi e argëtonin këto paralajmërime. Kjo qe tepër serioze. Ishte një stuhi. Duhej të përdorte tërë përvojën dhe guximin e vet vetë që të mos e pësonte.

– Erdhi nga Pallati urdhëri për anullimin e mbledhjes së Tryezës Drejtuese? - pëshpëriti. Zëvendëskryetari, i përkulur, e ngjit veshin te goja e Kabralit.

– Nga do të vinte? Por ka akoma. Janë anuluar gjithë komisionet ku ti bën pjesë. Direktiva thotë: "Derisa të rregullohet situata e presidentit të Senatit."

Kabrali mbetet si vuv. Ja pra mënyra. Ja ajo ëndërr e tmerrshme që, herë pas here, vinte për të rrëzuar ngjitjet e tij, për të përmbysur arritjet e tij politike: E kanë prishur me Shefin.

– Kush ta dha urdhërin, Mono?

Fytyra bullafiqe e Kintanijas tkurret e shqetësuar dhe Kabrali kupton më në fund se në ç'vështirësi është Monoja. A do t'ia thoshte dot zëvendëskryetari se nuk mund të bënte një pabesi të tillë? Por aty për aty, ai vendos:

– Henri Çirinos, - dhe pësëri e kap për krahu. - Të kërkoj ndjesë, Inteligjent. Nuk besoj që mund të bëj shumë, por diçka do ta bëj për ty. Ki besim tek unë.

– Të tha gjë Çirinosi për çfarë më akuzojnë?

– U mjaftua të më përcillte urdhërin dhe të më thoshte: "Nuk di asgjë. Jam thjesht përcjellës i një vendimi të ardhur nga lart.

– Yt atë gjithmonë dyshonte se intrigant ishte Çirinosi, Konstitucionalisti Sarhosh, - kujton hallë Adelina.

– Ai barkaleci i zi dhe i pështirë që njëri prej atyre që përfitoi më shumë, - ndërhyri Lusinda.
– Nga shtrati dhe tryeza e Truhijos përfundoi ministër dhe ambasador i Bagalerit. E shikon se ç'vend është ky, Urani?
– E mbaj mend shumë mirë atë fytyrë. Ka ca vite që e kam parë në Uashington, kur ishte ambasador, - thotë Urania. - Vinte shpesh në shtëpinë tonë kur isha e vogël. Dukej si mik i afërt i babait.
– Edhe i Anibalit, dhe imi, - shton hallë Adelina. - Vinte këtu tërë lajka, na recitonte vargjet e veta. E kalonte kohën duke cituar libra dhe hiqej si i ditur. Njëherë na ftoi në "Country Club". S'doja ta besoja se do të tradhtonte mikun e tij vjetër. Nejse, kështu është politika, të hapësh rrugë mes kufomave.
– Dajo Agustini ishte tepër i drejtë, tepër i mirë, prandaj u sollën aq mizorisht me të. Lusinda pret që Urania ta mbështesë, që dhe ajo të protestojë për këtë poshtërsi, por Urania nuk gjen forca të shtiret. Kufizohet vetëm të dëgjojë me pamje të trishtuar.
– Përkundrazi, im shoq, që u prehtë në paqe, u soll si një zotni i vërtetë, i dha babait tënd gjithë mbështetjen e vet, - dhe hallë Adelina lëshon një qeshje sarkastike. - Çfarë Don Kishoti! Humbi vendin në Fabrikën e Duhanit dhe kurrë nuk gjeti më punë.
Papagalli Samson shpërthen përsëri në një rrebesh britmash e çirrash që ngjajnë si sharje. "Pusho, gjumash", e qorton Lusinda.
– Falë Zotit, s'kemi humbur humorin, vajza, - thotë Manolita.
– Ma gjej senatorin Henri Çirinos dhe thuaji se dua ta takoj menjëherë, Isabela, - urdhëron senatori Kabral, duke hyrë në zyrën e vet. Pastaj, i drejtohet doktor Goikos: - Me sa duket, ai e ka gatuar tërë këtë ngatërresë.
Ulet në tryezën e punës, i hedh përsëri një sy axhendës së ditës, por e kupton se në ç'situatë ndodhet. A ka më kuptim të firmosësh letra, rezoluta, memorandume, nota, si kryetar i Senatit të Republikës? Është tepër e dyshimtë qenia e tij ende aty. Por më e keqja është të japë shenja shkurajimi përpara vartësve të vet. Në kohë të keqe, fytyrë të qeshur. Merr dosjen dhe fillon të lexojë shkrimin e parë, por vë re se Parisi vazhdon të qëndrojë aty me duart që i dridhen:

– Zoti kryetar, doja t'ju them, - belbëzon i tronditur prej emocionit. - Të ndodhë ç'të ndodhë, jam me ju. Për gjithçka. E di mirë se sa ju detyrohem, doktor Kabral.
– Faleminderit, Goiko. Ti je i ri dhe do të shikosh gjëra edhe më të këqija në këtë botë. Mos u shqetëso fare. Do ta shmangim këtë stuhi. Dhe tani, o burra në punë.
– Senatori Çirinos ju pret në shtëpinë e vet, zoti president, - thotë Isabelita, duke hyrë në zyrë. - U përgjigj ai vetë. E di ç'më tha? "Dera e shtëpisë sime është e hapur ditë e natë për mikun tim të madh, senatorin Kabral."
Kur del nga godina e Kongresit, roja e nderon me përshëndetjen e zakonshme ushtarake. Ja tek është autovetura e zezë, e përmorshme. Por shoqëruesi i tij, togeri Humberto Arenal, është zhdukur. Teodosio, shoferi, i hap derën.
– Në shtëpinë e senatorit Henri Çirinos.
Shoferi miraton pa hapur gojën. Pasi morën drejt bulevardit Mella, në periferi të qytetit kolonial, shoferi, i cili po shikonte nga pasqyra, e informon:
– Që kur dolëm nga Kongresi, na është qepur pas një morr me sigurimsa, doktor.
Kabrali kthen kokën: pesëmbëdhjetë a njëzet metra mbrapa dallon një Volkswagen të zi, i cili dukej qartë që ishte i Shërbimit Sekret. Në shkëlqimin verbues të mëngjesit nuk mund të dallojë sa koka kalecësh ka brenda. "Tani më përcjellin njerëzit e SIM-it, në vend të shoqëruesit tim." Ndërsa makina futet në rrugët e ngushta plot me njerëz dhe me shtëpi një e dykatëshe, me hekura në dritare dhe me xokla guri të qytetit kolonial, mendon se çështja është edhe më e rëndë nga sa pandehu. Nëse Xhoni Abesi po e ndjek, ndoshta ka marrë vendimin ta arrestojë. Njëlloj si historisht a Anselmo Paulinos. Asaj që i trembej aq shumë. Kokën e ka flakë. Çfarë kishte bërë? Çfarë kishte thënë? Ku kishte gabuar? Me kë ishte takuar për herë të fundit? Po e trajtonin si armik të regjimit. Ai, ai!
Automobili u ndal në kryqëzimi i Salome Urenjas me Duarten dhe Teodosio zbriti t'i hapte derën. Morri qëndroi pak metra më tej, por asnjë kalec nuk doli prej saj. U bë gati të afrohej dhe t'i pyeste pse e ndiqnin kryetarin e Senatit, por u përmbajt: Për çfarë do t'i shërbente kjo zbrazje dufi ndaj ca shërbëtorëve të mjerë që u bindeshin urdhërave?
Shtëpia e vjetër dykatëshe, me një ballkon të vogël dhe

dritare me grila, e senatorit Henri Çirinos, i ngjante të zotit. Koha, vjetërsia, pakujdesia, e kishin rrënuar, i kishin prishur simetrinë; qe zgjeruar aq shumë në mes, sa dukej sikur do t'i pëlcliste barku i fryrë. Dikur duhej të kishte qenë një vilë hijerëndë fisnike, kurse tani qe e pistë, e braktisur dhe gati të shembej. Harta dhe njolla lagështire i shëmtonin muret, nga strehët dhe çatia vareshin shtretër merimagash. Sapo lajmëroi, i hapën portën. Ngjiti disa shkallë të zymta që kërcisnin e me parmakun plot lyrë. Në krye të shkallëve e priste kryeshërbëtori, i cili i hapi një derë të qelqtë kuitëse: njohu bibliotekën e madhe, perdet e rënda prej kadifeje, raftet e larta plot libra, qilimin e butë e të çngjyrosur, kuadrot vezake dhe fijet e argjendta të merimagave, mbi të cilat binin rrezet e ndritshme diellore që depërtonin përmes dyerve. Vinte erë myku, kalbësire dhe të zihej fryma nga të nxehtit. Çirinosi po e priste në këmbë. Kishte qenë shumë herë këtu, në mbledhje, negociata, konspiracione, në shërbim të Shefit.

– Mirë se erdhe në shtëpinë tënde, Inteligjent! Pak herët? Të ëmbël apo brusko? Më mirë majhoshe, e hollë. Është e freskët.
Me pizhamat dhe i mbështjellë me një rrobëdëshambër madhështor prej cohe të gjelbër, me garniturë mëndafshi, që e theksonte edhe më rrumbullakësinë e trupit të tij, me një shami e trashë të futur në xhep dhe ca pantofla pambuku të deformuara prej këmbëve të tij të enjtura, senatori Çirinos po i buzëqeshte. Flokët e rrallë e të shprishur, sytë e buhavitur plot sklepa, buzët e mavijosura e tërë pështymë ngjitëse anëve, tregonin se ai akoma nuk qe larë.
Kabrali e la t'i rrihte shpatullat e ta drejtonte për nga kolltuqet e vjetra, të veshur me pëlhurë të trashë liri, pa iu përgjigjur llomotitjeve të përzemërta të tij.
– Ka vite që njihemi, Henri. Bashkë kemi bërë shumë gjëra. Të mira, por edhe ndonjë të ligë. Nuk ka dy njerëz në këtë regjim që të kenë qenë aq të bashkuar, sa ti dhe unë. Ç'po ndodh? Pse është duke më rënë qielli përsipër qysh sot në mëngjes?
Iu desh të heshtte, se në dhomë hyri kryeshërbëtori, një plak me një sy, po aq i shëmtuar dhe shkatërraq sa dhe i zoti i shtëpisë, me një kanë qelqi mbushur me heres dhe dy gota. I la mbi tavolinë dhe u tërhoq çalë-çalë.
– Nuk e di, - Konstitucionalisti Sarhosh rrahu gjoksin. - Nuk do të më besosh. Do të mendosh se e kam kurdisur unë, e kam

frymëzuar dhe nxitur unë atë që po të ndodh. Po, për shpirt të sime ëme, më e shenjta e kësaj shtëpie, nuk di gjë. Kur mora vesh dje pasdite, ngela pa mend. Hajde, gëzuar, pa kjo e keqe do të zgjidhet shpejt, Inteligjent.

Fliste me gjallëri dhe emocion, me zemrën në dorë e me atë sentimentalizmin e sheqerosur të radionovelave që HIZ importonte para revolucionit kastrist nga radio CMCG e Havanës. Por Agustin Kabrali e njihte mirë: Ishte një palaço i nivelit të lartë. Mund të thoshte të vërtetën ose të gënjente. S'kishte si ta vërtetonte. Gjerbi një gllënjkë heres, me zor, ngaqë kurrë nuk pinte alkool në mëngjes. Çirinosi po merrej me qimet e hundës.

– Dje, duke punuar me Shefin, papritur më urdhëroi të udhëzoja Mono Kintanijan që, si zëvendëspresident i Senatit, të anulonte të gjitha mbledhjet, derisa të vihej vendi bosht i Presidencës, - vazhdoi duke bërë gjeste. - Mendova ndonjë aksident, ndonjë pushim zemre, nuk e di. "Ç'i ka ndodhur Inteligjentit, Gjeneralissim?" "Këtë doja të dija", m'u përgjigj me atë vrazhdësinë që të rrëqeth deri në palcë. "Nuk është më yni, ka kaluar me armikun". Nuk guxova ta pyes më tej, toni i tij qe vrasës. Më urdhëroi të zbatoja porosinë. Dhe sot në mëngjes, lexova, si të gjithë, letrën në "Forumin Publik". Edhe njëherë, të betohem, për shpirt të nënës, kaq di.
– Ti e shkrove letrën e "Forumit Publik"?
– Unë e shkruaj me korrektësi spanjishten, - u indinjua Konstitucionalisti Sarhosh. - Ai i padituri ka bërë tre gabime sintaksore. I kam të shënuara.
– Kush, atëherë?

Sytë e dhamosur të senatorit Çirinos derdhën një vështrim plot keqardhje mbi të.

– Ç'rëndësi ka kjo, Inteligjent? Je njeri nga burrat e zgjuar të këtij vendi, mos u sill si një fëmijë me mua që të njoh qysh djalosh. Ajo që ka rëndësi është se e ka zemëruar Shefin për diçka. Fol vetë me të, kërkoi falje, zotohu se do të ndreqesh. Rifito besimin e tij. Mori kanën me verë, e mbushi sërish gotën e vet dhe e rrëkëlleu. Zhurma në rrugë ishte më e pakët se në Kongres. Nga trashësia e mureve koloniale, apo sepse në rrugët e ngushta qëndresë trembëshin hynin makinat.
– T'i kërkoj falje, Henri? Çfarë kam bërë? A s'ia kam kushtuar gjithë ditët dhe netët e mia Shefit?

– Mos m'i thuaj mua këto. Unë e di shumë mirë. Binde atë. Mos e humb toruan. Ti e njeh mirë. Është shpirtmadh. Tepër i drejtë. Po të mos ishte dyshues, nuk do të kishte qëndruar tridhjetë e një vjet. Ka një gabim këtu, një keqkuptim. Duhet ta sqarosh. Kërkoi takim. Ai të dëgjon.
  Fliste duke tundur dorën, i vetëkënaqur nga çdo fjalë që i dilte prej buzëve të hirta. Ulur duke edhe më i ngjallur në këmbë: barku i madh i kishte dalë nga rrobëdëshambëri i zbërthyer dhe lëvizte me batica e zbatica ritmike. Kabrali imagjinoi zorrët atje brenda, që i kushtoheshin ditë e natë detyrës së vështirë të gëlltitjes dhe tretjes të masave të mëdha ushqimore, të përtypura e të pështymosura. I erdhi keq që ishte aty. A thua do ta ndihmonte Konstitucionalisti Sarhosh? Edhe sikur të mos e kishte kurdisur vetë këtë, brenda vetes Lyrashi do të ishte duke festuar një fitore të madhe kundër tij. Pas asaj dukjeje babaxhane, fshihej gjithmonë një rival.
– Jep e merr me kaq mundim, - shtoi Çirinosi me një sjellje fshehtësie, - kam arritur në përfundimin se ndoshta arsyeja që i solli zhgënjim Shefit, mund të jetë mosdashja e peshkopëve për ta shpallur Bamirës të Kishës Katolike. Ti ishe në komisionin që dështoi.
– Ishim tre, Henri! Ishte edhe Balageri me Paino Piçardon, Ministri i Brendshëm dhe i Kulteve. Ato bisedime kanë muaj, pak pas Pastorales të peshkopëve. Pse e gjithë kjo dashka të bjerë mbi mua?
– Nuk e di, Inteligjent. Vërtet, duket si i tërhequr për hunde. As unë nuk shoh ndonjë arsye që të të bjerë e keqja. Ta them sinqerisht, për miqësinë tonë të kaq viteve.
– Kemi qenë më shumë se miq. Kemi qenë bashkë pas Shefit në të tëra vendimet që e kanë transformuar këtë vend. Jemi histori e gjallë. Kemi pësuar stërkëmbësha, kemi marrë goditje të palejueshme, kemi bërë kurthe për të nxjerrë përfitime nga njëri-tjetri. Por, asgjësime s'kemi bërë. Mund të shkatërrohem, të diskreditohem, të përfundoj në burg. Dhe pa ditur përse! Po ta kesh kurdisur ti tërë këtë, përgëzime! Është një vepër prej mjeshtri, Henri!
  Qe ngritur në këmbë. Fliste i qetë, njëtrajtshëm, pothuajse në mënyrë didaktike. Edhe Çirinosi qe ngritur, duke u mbështetur mbi një krah kolltuku për të mbajtur peshën e trupit trashaluq. Qenë pranë njëri-tjetrit, gati ngjitur. Kabrali

pa një kornizë të vogël në mur, midis rafteve të librave, ku shquhej një citat i Tagorës: "Një libër i hapur, është një mendje që flet; i mbyllur, një mik që pret; i harruar, një shpirt që flet; i shkatërruar, një zemër që qan". Një shtojancë në gjithçka që bën, që prek, që thotë dhe ndjen, mendoi.

– Sinqeriteti me sinqeritet, - Çirinosi i afroi fytyrën dhe Agustin Kabrali u tmerrua nga ndjenja e frymës me të cilën ai shoqëronte fjalët. - Para pesë apo dhjetë vjetësh, nuk do të kisha nguruar të kurdisja çdo gjë për të të shporrur, Agustin. Si dhe ti mua. Qofte edhe shfarosjen. Kurse tani, pse? I kemi ndonjë borxh njëri-tjetrit? Jo. Tani s'kemi pse bëjmë më garë, Inteligjent. Ti e di aq mirë sa dhe unë. Dhe sa frymë i ka mbetur atij që po vdes? Po ta them për herë të fundit: nuk jam përzier fare me çka po të ndodh. Dëshiroj dhe shpresoj që ta zgjidhësh. Vijmë ditë të vështira dhe regjimit ti i duhesh për të përballuar dallgët.

  Senatori Kabral miratoi me kokë. Çirinosi i rrahu shpatullat.

– Po të shkoj tek agjentët që më presin poshtë e t'u tregoj atë që më the, se regjimi po asfiksohet, se është duke vdekur, do të vije edhe ti pas meje, - mërmëriti, si përshëndetje.

– Nuk do ta bësh, - qeshi fytyra e trashë dhe e errët e zotit të shtëpisë. - Ti nuk je si unë. Ti je një zotni.

– Ç'ka ndodhur me të? - pyet Urania. - Jeton?

  Hallë Adelina lëshon një të qeshur dhe papagalli Samson, i cili dukej se flinte, reagon me një sërë klithmash. Kushërira, Urania dëgjon drangadrungun ritmike të lëkundëses ku rrinte Manolita.

– Fara e keqe nuk zhduket, - shpjegon halla. - Gjithmonë në strofkën e tij të qytetit kolonial, në Salome Urenja. Lusinda ka pak kohë që e ka parë, me bastun dhe me pantofla, duke shëtitur në parkun Independenca.

– Disa fëmijë vraponin pas tij duke bërtitur "Gogoli, gogoli!" - qesh Lusinda. - Është më i shëmtuar dhe më i pështirë se më parë. Është shumë se nëntëdhjetë, hë?

  A ka kaluar koha e mjaftueshme e bisedës së pasdarkës? Urania tërë kohën rrinte si në gjemba. Më mirë, të themi, e tendosur, si të priste një sulm. Këto janë të vetmet të afërta që i kanë ngelur dhe prapë ndihet më e largët me to, sesa me yjet. Dhe fillojnë ta bezdisin sytë e mëdhenj të Marianitas të gozhduara mbi të.

– Ato ditë qenë të tmerrshme për familjen tonë, - i rikthehet përsëri hallë Adelina.
– Më kujtohet im atë dhe dajë Agustini duke pështpëritur në këtë sallë, - thotë Lusinda. - Dhe babai yt duke thënë: "Por, o Zot, çfarë i kam bërë Shefit që të më keqtrajtojë kështu?"
E ndërpret një qen që leh agshë e diku jashtë, të cilit i përgjigjen dy, pesë të tjerë. Nga një baxhë e vogël në lartësinë e dhomës, Urania dallon hënën: e rrumbullaktë, e verdhë, e ndritshme. Në Nju Jork nuk kishte të tillë hënë.
– Ajo që e hidhëronte më shumë qe e ardhmja jote nëse atij i ndodhte gjë, - hallë Adelina ka një vështrim plot qortim. - Kur i bllokuan llogaritë bankare, atëherë mori vesh se s'kishte më shpëtim.
– Llogaritë bankare! - miraton Urania. - Ishte hera e parë për të cilat im atë më foli.

– Ajo ndodhej në shtrat dhe i ati hyri pa e lajmëruar. U ul në fund të shtratit. Ai ishte në këmishtë, tepër i zbehtë dhe asaj iu duk më i dobët, më brishtë dhe i plakur. I dridhej buza në çdo rrokje.

– Punët po shkojnë keq, bijëza ime. Duhet të jesh e përgatitur për çdo gjë. Deri tani ta kam fshehur situatën e rëndë. Por mbase sot do të kesh dëgjuar diçka në kolegj.
Vajza miratoi e patrazuar. Nuk shqetësohej, besimi tek i ati ishte i pakufishëm. Si mund t'i ndodhte diçka e keqe një njeriu kaq të rëndësishëm?
– Po, babi, që kanë shkruar letra kundër teje në "Forumin Publik", që të akuzojnë për shkelje të rënda. Askush nuk do ta besojë, ç'marrëzi. Të gjithë e dinë që je i paaftë për kësi ligësish.
I ati e përqafoi përmbi jorgan.
Çështja është më serioze se kolonat e gazetës, moj bijë. E kishin hequr nga Presidenca e Senatit. Një komision i Kongresit po verifikonte nëse kishte shpërdorime dhe mashtrime në fondet publike gjatë drejtimit të tij ministror. Kishte ditë që e ndiqnin morrat e SIM-it; pikërisht tani ndodhej njëri te porta e shtëpisë, me tre kalecë. Javën e fundit mori njoftimin e dëbimit nga Instituti Truhijoniano, nga "Country Club", nga Partia Domenikane dhe këtë mbasdite, kur shkoi të tërhiqte para nga banka, qe goditja përfundimtare. Administrata, miku i

tij Josef Heredia, e informoi se ia kishin ngrirë të dyja llogaritë rrjedhëse, derisa të zgjaste hetimi i Kongresit.

– Çdo gjë mund të ndodhë, bija ime. Të na e konfiskojnë shtëpinë dhe të na nxjerrin në rrugë. Llogaritë edhe burgun. Nuk dua të të tremb. Mund të mos ndodhë asgjë. Por duhet të jesh e përgatitur. Të kesh guxim.

E dëgjonte e çuditur, jo për ato që thoshte, por për zërin e tij të humbur, për shprehjen e tij të shkretuar, për sytë e tij të tmerruar.

– Do t'i lutem Virgjëreshës, - tha. - Zonja Jonë e Altagrasias do të na ndihmojë. Po pse nuk flet me Shefin? Ai gjithmonë të ka dashur. Jep një urdhër e gjithçka të rregullohet.

– I kam kërkuar takim dhe as që më përgjigjet, Uranita. Shkoj në Pallatin Kombëtar dhe sekretarët e adjudantët mezi më përshëndesin. As Presidenti Balager nuk do të më shohë, as Ministri i Brendshëm, Paino Piçardo. Jam një i vdekur i gjallë, moj bijëz. Ndoshta ke të drejtë dhe vetëm ma mbetet ta lëmë në dorë të Virgjëreshës.

Iu këput zëri. Por kur e bija iu hodh në qafë, e mori veten. I buzëqeshi:

– Duhej që ta dije këtë, Uranita. Po më ndodhi gjë, shko te halla. Anibali dhe Adelina do të të kenë në kujdes. Mund të jetë një provë. Ndonjëherë Shefi bën gjëra të tilla për të vënë në provë bashkëpunëtorët e tij.

– Ta akuzojë për shpërdorime atë, - mori frymë hallë Adelina.

– Përveç asaj shtëpie në Gaske, kurrë nuk pati gjë tjetër. As prona, as firma, as investime. Vetëm ca kursime, ato njëzet e pesë mijë që po t'i jepte pak e nga pak kur studioje andej. Politikani më i ndershëm dhe babai më i mirë në botë, Uranita. Dhe nëse ia lejon një ndërhyrje në jetën tënde private kësaj halle të vjetër dhe matufe, duhet të të them se nuk u solle me të si duhej. E di që e mban dhe i paguan një infermiere. Por, a e di sa e bëre të vuajë pa iu përgjigjur asnjë letre, pa iu afruar telefonit kur donte të fliste me ty? Sa herë, unë dhe Anibali, e kemi parë të qajë këtu. Tani që ka kaluar aq kohë, a mund ta dij pse-në, moj vajzë?

Urania mendohet, duke i rezistuar vështrimit qortues të plakushes së lëmshuar në kolltukun e saj.

– Sepse nuk ishte aq baba i mirë sa beson ti, hallë Adelina, - thotë më në fund.

Senatori Kabral kërkoi që taksia ta linte te Klinika Internacionale, nja katër blloqe nga Shërbimi Sekret, që ndodhej po ashtu, mbi bulevardin Meksiko. Kur i tha taksistit në fillim se do të shkonte në SIM, e pushtoi një ndjenjë e fortë turpi, prandaj i përmendi klinikën. Eci në këmbë katër blloqe, pa u nxituar. Pa dyshim, zotërimet e Xhoni Abesit ishin të vetmet seli të rëndësishme të regjimit ku nuk kishte shkelur asnjëherë deri tani. Mori me kalecët e ndiqte hapat, ngadalë, ngjitur me trotuarin dhe ai vinte re lëvizjet e kokës dhe fytyrat e alarmuara të kalimtarëve me të parë Volkswagenin e frikshëm të tyre. Kujtoi që në komisionin e Buxhetit të Kongresit, ai kishte diskutuar në favor të importimit të qindra morrave, me çka agjentët e Xhoni Abesit lëvizin tani në të katër anët e Atdheut, në ndjekje të armiqve të regjimit.

Në godinën e shëmtuar dhe të çngjyrosur, roja me automatik që ruante portën pas telave me gjemba dhe thasëve me rërë, e la të kalojë pa e kontrolluar dhe pa i kërkuar dokumenta. Brenda e priste Qesar Baes, njëri nga adjudantët e kolonelit Abes. Shulak, me fytyrë vrarëlije, me kaçurela të kuqe, të denda, i dha një dorë të djersitur dhe i priu nëpër korridoret e ngushtë, ku kishte njerëz me kobure në brez apo varur nën sqetull, duke pirë cigare, duke biseduar ose duke qeshur në dhomëzat plot tym e tabela kujtesash. Binte erë djersë, urinë e këmbë të palara. U hap një derë. Brenda ishte shefi i SIM-it. Kabralin e çuditi varfëria murge e zyrës: muret pa kuadro, pa pllakate, përveç një portreti të Bamirësit me uniformë parade (kapele trekëndëshe me pendë dhe xhaketë e mbushur me medalje), që shkëlqente pas shpatullave të kolonelit. Abes Garsia qe veshur civil, me një këmishë verore me mëngë të shkurtra dhe me cigare në buzë. Në dorë mbante shaminë e kuqe që Kabrali ia kishte parë edhe herë të tjera.

– Mirëdita, senator - i zgjati një dorë të butë, si dorë femre. - Uluni. Nuk kemi shumë komoditet këtu. Do të na falni.

– Ju faleminderit që më pritët, kolonel. Jeni i pari. As Shefi, as Presidenti Balager dhe asnjë ministër nuk i është përgjigjur kërkesës sime për takim.

Figura e vogël, barkalecu, e shtrembër miratoi heshtur. Kabrali shihte gushën palë-palë, gojën e vogël, faqet e flashkëta e sytë e futur të lagësht të kolonelit që lëviznin shqetësueshëm.

– Të gjithë ruhen, zoti senator, - tha ftohtë Xhoni Abes. Senatorit i shkoi në mendje se, sikur të flisnin gjarpërinjtë, do të kishin zërin e tij. - Të të zërë e keqja është një sëmundje ngjitëse. Si mund t'ju shërbej?
– Më thoni për çfarë akuzohem, kolonel, - ndali pak për të marrë frymë dhe për t'u dukur më i qetë. - Ndërgjegjen e kam të pastër. Për njëzet vjet rresht ia kam kushtuar jetën time Truhijos dhe atdheut. Sigurisht, ka ndonjë keqkuptim, ju betohem.
Koloneli, me një lëvizje të dorës së vet të butë, ku mbante shaminë e kuqe, fiku cigaren në një tavëll tunxhi dhe tha:
– Mos humbisni kohë duke më dhënë shpjegime, doktor Kabral. Politika nuk është fusha ime, unë mbuloj sigurimin. Nëse Shefi nuk ju pret ngaqë është i zemëruar me ju, i shkruani.
– E kam bërë, kolonel. Po nuk e di nëse ia kanë dhënë letrat e mia. Ia kam çuar personalisht në Pallat.
Fytyra e enjtur e Xhoni Abesit u shtendos disi:
– Askush nuk do të mbante një letër drejtuar Shefit, senator. Do t'i ketë lexuar, dhe nëse ju keni qenë i sinqertë, do t'ju përgjigjet, - bëri një pauzë të gjatë, duke parë gjithnjë me ca sy të paqetë dhe shtoi sfidueshëm: - Shoh se ju bën përshtypje që përdor një shami me ngjyrë të tillë. E kuqja është ngjyra që më vjen për shtat. Ju nuk besoni tek rosacruz-es, ju duket një bestytni, diçka primitive.
– Nuk di asgjë për fenë rosacruz, kolonel. S'kam asnjë mendim për të.
– Tani nuk kam kohë, po kur kam qenë i ri, kam lexuar shumë për rosacruzismo-n. Mësova mjaft gjëra. Për të lexuar brororen e njerëzve. Për shembull, brororja juaj në këto çaste, është si ajo e dikujt që po vdes nga frika.
– Po, po vdes nga frika, - iu përgjigj aty për aty Kabrali. - Ka ditë që njerëzit e tu më ndjekin këmba-këmbës. Më thoni, të paktën, nëse do të më arrestoni.
– Kjo nuk varet nga unë, - tha Xhoni Abes shkujdesshëm, si të bëhej fjalë për diçka pa kurrfarë rëndësie. Po të më urdhërojnë, do ta bëj. Shoqërimi është për të mos u arratisur, për të mos kërkuar strehim politik. Nëse do të tentoni, njerëzit e mi do t'ju arrestojnë.
– Të kërkoj strehim? Ç'thoni kolonel? Të iki si armik i regjimit? Po unë jam i këtij regjimi prej tridhjetë vjetësh.

– Mbase për t'u strehuar te miku juaj, Henri Dearborn, shefi i misionit që na kanë lënë jankit, - vazhdoi sarkastik koloneli Abesi.
Çudia e la pa mend Agustin Kabralin. Ç'donte të thoshte me këtë?
– Miku im, konsulli i Shteteve të Bashkuara?! - belbëzoi. - Vetëm dy-tri herë e kam parë në jetën time zotin Dearborn.
– Është armiku ynë, siç e dini, - vazhdoi Abes Garsia. - Jankit e kanë lënë këtu, kur OEA na vuri sanksionet, që të vazhdojë të intrigojë kundër Shefit. Tërë konspiracionet, qysh prej një viti, dalin nga zyra e Dearbornit. Megjithatë, ka pak kohë kur ju, presidenti i Senatit, shkuat në një koktej në shtëpinë e tij. Ju kujtohet?
Habia e Agustin Kabralit arriti kulmin. Ja ç'na qenka?! Kishte asistuar në atë koktej, - sqaroi. - Për të hetuar planet që kishin lënë Shtetet e Bashkuara kur mbyllën ambasadën.
– Shefi udhëzoi ministrin Paino Piçardo dhe mua të merrnim pjesë në atë koktej, - sqaroi. - Për të hetuar planet e qeverisë së tij. Ngaqë kam zbatuar atë urdhër, po më ndodh kjo gjëmë?! Kam bërë një informacion me shkrim mbi atë takim.
Koloneli Abes Garsia mblodhi supet e imta e të rëna, si të një kukulle:
– Nëse ka qenë urdhëri i Shefit, harrojeni komentin tim, - pranoi me një ftohtësi ironike. Veprimi i tij tregonte njëfarë shqetësimi, po Kabrali nuk iu nda. Ushqente një iluzion të rremë se kjo bisedë do të kishte ndonjë frut.
– Ju dhe unë nuk kemi qenë kurrë armiq, kolonel, - tha, duke u sforcuar të fliste sa më natyrshëm.
– Unë nuk mund të kem armiq, - replikoi Abes Garsia. - Do të dëmtoja punën time. Miqtë e mi dhe armiqtë e mi janë po ata të regjimit.
– Më lini të mbaroj, ju lutem, - vazhdoi Agustin Kabrali. - Unë gjithmonë i kam pranuar dhe i kam respektuar shërbimet e jashtëzakonshme që i bëni vendit. Edhe kur kemi pasur ndonjë mospajtim mes nesh.
Koloneli u duk se lëvizi dorën për të bërë shenjë që të pushonte, por e paskej ngritur thjesht për të ndezur cigaren. Thithi tymin tërë babëzi, pastaj e nxori i qetë nga goja dhe nga hundët.
– E vërtetë që kemi pasur mospajtime, - pranoi. - Ju keni qenë

njëri prej atyre që i keni luftuar më shumë tezat e mia, të cilat, nisur nga tradhtia amerikane, synonin afrimin me rusët dhe vendet e Lindjes. Ju, me Balagerin dhe Manuel Alfonson, jeni përpjekur ta bindni Shefin se ripajtimi me jankit është i mundshëm. Vazhdon të besosh në këtë marrëzi?

Të ishte kjo arsyeja? T'ia kishte ngulur Abes Garsia thikën? Ta kishte pranuar Shefi këtë budallallëk? Ta hiqnin qafe për t'u afruar me komunizmin? Ishte e kotë të vazhdonte të përulej para një specialisti torturash dhe vrasjesh, i cili, për shkak të krizës, guxonte tani të mbahej për strateg politik.

– Vazhdoj të mendoj njëlloj, se nuk ka tjetër alternativë, kolonel, - foli i vendosur. - Ajo që propozoni ju, më falni për çiltërsinë, është një fantazi. As Bashkimi Sovjetik, as satelitët e tij nuk do të pranojnë kurrë afrimin me Republikën Domenikane, bastionin antikomunist në këtë kontinent. Edhe Shtetet e Bashkuara nuk do ta lejonin. Ju kërkoni edhe tetë vjet të tjerë pushtim amerikan? Duhet të arrijmë të merremi vesh me Uashingtonin, ndryshe do të jetë fundi i regjimit.

Koloneli e la hirin e cigares të bjerë përtokë. Nxitimthi thithi shtëllunga tymi njëra pas tjetrës, si të trembej mos ia rrëmbenin cigaren nga buza dhe, herë pas here, fshinte ballin me shaminë e vet të flakërimtë.

– Miku juaj Henri Dearborn nuk mendon ashtu. Sa keq! - mblodhi supet si një komik i rëndomtë. - Ai vazhdon duke u përpjekur të financojë një grusht shteti kundër Shefit. Përfundimisht, ky diskutim është i kotë. Shpresoj të sqaroni situatën tuaj, për t'ju hequr "shoqëruesit". Faleminderit për vizitën, senator.

Nuk ia dha dorën. U kufizua t'i bëjë një përshëndetje të vogël me fytyrën e vet faqefryrë, gjysmë të mbuluar nga një areolë tymi, në sfondin e së cilës dukej fotografia e Shefit me uniformën e paradës së madhe. Ndërkohë senatorit iu kujtua citati i Ortega e Gasetit, shënuar në bllokun e vogël që e mbante gjithmonë në xhep.

Edhe papagalli Samson duket i ngrirë habie prej fjalëve të Uranisë. Rri i qetë dhe memec, njësoj si hallë Adelina, e cila ka pushuar së lëvizuri freskoren dhe ka mbetur e habitur. Lusinda dhe Manolita shikojnë të papërqendruara. Marianita përpëlit qerpikët pa ndalur. Uranisë i duket absurde ideja se ajo

henë e bukur që vështron nga dritarja, miraton ato që tha.

– Nuk e di si flet kështu për tët atë, - hidhet hallë Adelina. - Në jetën time të gjatë, kurrë nuk kam njohur kënd që të sakifikojë aq shumë për të bijën, sa vëllai im i mjerë. Dhe për të "baba i keq", vërtet? Ti ishe adhurimi i tij. Dhe tortura e tij. Për të mos vuajtur ti, nuk u martua më, pasi vdiq nëna jote, edhe pse qe akoma i ri. Falë kujt pate fatin të studioje në Shtetet e Bashkuara? A nuk harxhoi ai gjithë ç'kishte? Për këto e quan një baba të keq? Nuk duhet të replikosh, Urani. Ç'faj ka kjo plakushe që i kalon vitet e fundit të jetës, muajt dhe javët, e palëvizur dhe e hidhëruar, për diçka aq të largët? Mos iu përgjigj. Shtiru se pranon. Jep një shkak të ikësh, përshëndetu dhe harroje atë përgjithmonë. Meqetësi, pa më të voglin kundërshtim, thotë:

– Nuk i bënte ato sakrifica nga dashuria për mua, hallë. Donte të më blinte. Të lante ndërgjegjen e vet të keqe. Duke e ditur se ishte e kotë sido që të bëhej, le të jetonte ditët që i kishin mbetur, duke e ndier se ishte njeri i ulët dhe i keq.
Me të dalë nga zyrat e Shërbimit Sekret, te kryqëzimi i bulevardeve Meksiko dhe 30 Mars, iu duk se policët e rojës i hodhën një vështrim mëshirues dhe se njeri prej tyre, duke i ngulur sytë, përkëdhelte qëllimisht automatikun San Kristobal që mbante në krah. Iu mbajt fryma e ndjeu marramendh. A e kishte citatin e Ortega e Gasetit në bllokun e vet? Citat aq i përpiktë, aq profetik. Liroi gravatën dhe hoqi xhaketën. Bri tij kalonin taksi, po s'ndali asnjë. Ç'të bënte në shtëpi? Që të ndihej i burgosur e të vriste mendjen duke zbritur nga dhoma e gjumit në studio apo duke u ngjitur prapë në dhomën e gjumit, duke kaluar nëpër sallon dhe duke pyetur për të njëqindën herë veten: Ç'po ndodh me mua? Mos ishte një lepur i ndjekur nga gjahtarë të padukshëm? Ia kishin marrë zyrën e Kongresit, autoveturën shtetërore dhe fletë-hyrjen e "Country Club", ku do të mund të strehohej, duke pirë diçka freskuese e duke parë aty peizazh kopshtesh të mirëmbajtur dhe lojtarë të largët golfi. Apo të mund të dëgjonte një mik. Por, a i kishte mbetur ndonjë? Të gjithë i kishte marrë në telefon dhe i kishte dalluar nga zëri se ishin të trembur, të rezervuar, armiqësorë: i dëmtonte, po t'i takonte. Ecte pa drejtim, me

xhaketën e palosur në qafë të dorës. Mund të ishte shkaku ai koktej në shtëpinë e Henri Dearbornit? E pamundur. Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, Shefi vendosi që ai dhe Paino Piçardo të asistonin atje "për të zbuluar terrenin". Si mund ta ndëshkonte se iu bind? Mos vallë, Paino i ka hamendësuar Truhijos që ai ishte treguar në atë koktej tepër i përzemërt me gringon? Jo, jo, jo. S'mundet që për një gjë aq të parëndësishme, Shefi të hedhë poshtë dikë që i ka shërbyer me devotshmëri dhe me përkushtim se askush.
Ecte si i humbur, duke ndryshuar drejtimin në çdo bllok ndërtesash. Bënte vapë dhe qe bërë ujë në djersë. Për herë të parë, pas kush e di sa vitesh, po sillej kot rrugëve të Qytetit Truhijo. Qytet, të cilin e kishte parë të rritej e të transformohej, nga një fshat i vogël, i shkatërruar e i bërë gërmadhë prej ciklonit San Zenon në vitin 1930, tani në një metropol modern, të bukur, të lulëzuar, me rrugë të shtruara, të ndriçuara, me bulevarde të gjerë, plot autovetura të modeleve të fundit.
Pa orën. Ishte pesë e një çerek e pasdites. Kishte dy orë duke bredhur dhe po vdiste prej etjes. Ndodhej në Kasimiro de Moja, midis Pasteur dhe Servantes, pak metra nga bari El Turei. Hyri në bar dhe u ul në tavolinën e parë. Kërkoi një Presidente të ftohtë. Nuk kishte ajër të kondicionuar, por ventilatorë dhe qe një hije të plotë. Rruga e gjatë e kishte qetësuar. Ç'do të bëhej me të? Po me Uranitën? Ç'do të bëhej me të bijën, po ta fusnin në burg, apo nëse, në një rrëmbim zemërimi, Shefi do të urdhëronte ta vrisnin? A do të ishte Adelina në gjendje ta edukonte, të bëhej si një nënë e vërtetë për të? Po, motra e tij qe një grua e mirë dhe shpirtmadhe. Urania do të ishte për të një bijë më shumë, si Lusinda dhe Manolita.
E piu birrën me etje, ndërsa kontrollonte bllokun e shënimeve, duke kërkuar citatin e Ortega e Gasetit. Birra e ftohtë, duke rrjedhur nëpër rropullitë e tij, i shkaktoi një ndjesi kënaqësie. Mos i humb shpresat. Ëndrra e keqe do të davaritet. Kështu ndodhi shpesh. I kishte dërguar tri letra Shefit. Të çiltra, të prekshme, duke i hapur zemrën. I kishte kërkuar falje për ndonjë gabim që mund të kishte bërë, i ishte betuar se do të bënte çdo gjë për t'ia shpërblyer dhe paguar, nëse në ndonjë veprim të nxituar apo të pamatur, e kishte zhgënjyer. I kujtonte kohën e gjatë të vetëmohimit, të ndershmërisë së plotë të tij, si e provonte edhe fakti që tani, me t'i bllokuar llogaritë

rrjedhëse në Bankën e Kursimit (nja dyqind mijë peso, kursimet e tërë jetës), kishte ngelur në rrugë, vetëm me shtëpinë në Gaske, ku jetonte. (Vetëm se i fshehu ato njëzet e pesë mijë dollarë, të depozituar në Chemical Bank të Nju Jorkut, që i ruante për ndonjë urgjencë). Truhijo, vërtet qe zemërmadh. Mund të ishte mizor kur e lypnin nevojat e vendit. Por, po ashtu, shpirtmadh, madhështor, si ai Petronio te "Quo Vadis?", të cilin gjithmonë e citonte. Në çdo çast do ta thërriste në Pallatin Kombëtar apo në Vila Radames. Do të bënin ndonjë shpjegim të këndshëm, nga ato që Shefit i pëlqenin. Gjithçka do të sqarohej. Do t'i thoshte se për të Truhijo, jo vetëm kishte qenë Udhëheqësi, burri i shtetit, themeluesi i Republikës, por edhe një model njerëzor, një baba. Dhe ëndrra e keqe do të shuhej. Jeta e tij e mëparshme do të rikthehej, si me magji. Citati i Ortega e Gasetit u shfaq në cepin e një faqeje, e shkruar me shkronjat e tij të vogla: "Nga's ka qenë, ç'është e ç'do të jetë njeriu, asgjë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë përgjithmonë; ajo që një ditë të bukur ka mundur të jetë, ditën tjetër do të pushojë së qeni". Ai vetë ishte një shembull i gjallë i paqëndrueshmërisë së ekzistencës që mbështeste ajo filozofi.
Në njërin prej mureve të Tureit, një afishe lajmëronte se në orën shtatë luante në piano mjeshtri Enrikijo Sançes. Dy tavolina qenë zënë nga dy çifte, të cilët i çuçurisnin dhe e shikonin njëri-tjetrin plot romantizëm. "Të akuzosh për tradhti, mua". Atë, i cili, për Truhijon, hoqi dorë nga kënaqësitë, nga dëfrimet, nga paratë, nga dashuria, nga gratë. Dikush kishte lënë në një karrige ngjitur një gazetë "La Nacion". E mori dhe, për t'u marrë me diçka, e shfletoi. Në faqen e tretë, në një kolonë, lajmërohej se shumë i ndrituri dhe i shquari ambasador don Manuel Alfonso sapo kishte mbërritur në atdhe, në një udhëtim për shkaqe shëndeti. Manuel Alfonso! Askush nuk kishte afëri më të madhe me Shefin. Ndryshe nga të tjerët, atij Shefi i besonte çështjet më të ngushta, që nga rrobat dhe parfumet e veta, deri tek aventurat e tij të dashurisë. Manueli qe dhe miku i tij. Ai i detyrohej shumë. Mund të ishte njeriu kyç.
Pagoi dhe doli. Morri nuk ishte aty. Iu shmang pa e ditur apo e kishin ndërprerë përndjekjen? Në gjoks i buroi një ndjenjë mirënjohje dhe shprese gëzimplote.

XIV

Bamirësi hyri në zyrën e doktor Balagerit në orën pesë, siç bënte nga e hëna deri të premten, për nëntë muaj me radhë, qysh më 3 gusht të vitit 1960, kur, në përpjekjet për të shmangur sanksionet e OEA-s, e kishte detyruar të vëllanë, Hektor Truhijo (Negro), të jepte dorëheqjen si President i Republikës, duke e zëvendësuar me poetin dhe juristin e kujdesshëm e gojëmbël, i cili qe ngritur sakaq në këmbë dhe qe afruar për ta përshëndetur:

– Mirëdita, Shkëlqesi.

Pas drekës me çiftin Gitelman, Gjeneralissimi pushoi gjysmë ore, u ndërrua (kishte veshur një kostum lini të bardhë tepër fin) dhe vetëm pesë minuta më parë kishte përfunduar çështjet e ditës me katër sekretarët e tij. Vinte me fytyrë të ngrysur dhe pa e fshehur zemërimin e vet, u fut menjëherë në temë:

– Keni autorizuar ju, para dy javësh, udhëtimin jashtë shtetit të vajzës së Agustin Kabralit?

Sytë miopë të burrit të vogël, doktor Balagerit, përpëlitëshin që pas qelqeve të rasha.

– Në të vërtetë po, Shkëlqesi. Urani Kabral, po. Nunciat Dominikane i kishte akorduar një bursë në Universitetin e Miçiganit. Vajza duhej të nisej sa më parë për disa provime. Ma bëri të qartë drejtoresha. U interesua për këtë gjë të mbarë edhe kryepeshkopi Rikardo Pitini. Mendova se me këtë gjest të vogël mund lidheshin urat me hierarkinë kishtare. Jua kam shpjeguar të gjitha në një relacion, Shkëlqesi.

Njeriu i vogël fliste me atë butësinë e vet të zakonshme damashirëse dhe me një buzëqeshje të vizatuar në fytyrën e vet rrumbullake, duke i shqiptuar fjalët me saktësinë e përsosur të një aktori të radioteatrit apo të një profesori të fonetikës. Truhijo ia nguli sytë, duke u përpjekur ta hante me sy të tij, në sytë e tij të turbullt, nuk dallohej as treguesi më i vogël i ndonjë lloj të tillë turbulli, nuk dallohej as treguesi më i vogël i ndonjë lloj

aludimi. Me gjithë mosbesimin e vet të pafund, Truhijo nuk mundi të merrte vesh gjë. E qartë, Presidenti kukull ishte një politikan i rrahur dhe gjakftohtë e veta zor e tradhtonin.

– Kur ma keni dërguar relacionin?
– Ka nja dy javë, Shkëlqesi. Pas çështjes të kryepeshkopit Pitini. Ju thosha se, meqënëse udhëtimi i vajzës ishte urgjent, do t'i jepja lejen nëse ju nuk do të kishit ndonjë kundërshtim. Meqë nuk mora përgjigjen tuaj, u mora vetë me të. Ajo e kishte marrë vizën e Shteteve të Bashkuara.

  Bamirësi u ul përballë tryezës së Balagerit dhe i tha atij të ulej. Tek ajo zyrë e katit të dytë të Pallatit Kombëtar, ndihej mirë. Ishte e gjerë, e ajrosur, e qetë, me raftet plot libra, me dysheme e mure tërë shkëlqim dhe me tryezën e punës gjithmonë të pastër. Nuk mund të thoshe se Presidenti kukull ishte një burrë elegant (si mund të ishte ndryshe me atë fytyrë të vogël dhe buçkane, që e bënte të dukej jo vetëm një shkurtabiq, por gati, në xhuxh?), por vishej me korrektësinë që fliste, respektonte protokollin dhe ishte një punëtor i palodhshëm, për të cilin nuk ekzistonin as festa, as orare. Duke i alarmuar: E kishte kuptuar se duke i dhënë atë leje të bijës së Inteligjentit, mund të kishte bërë një gabim të rëndë.
– S'ka gjysmë ore që e kam parë këtë relacion, - tha qortueshëm. - Edhe mund të kishte humbur. Kjo do të më çudiste. Letrat e mia gjithmonë janë të sistemuara. Asnjëri nga sekretarët e mi nuk e kishte parë këtë rani. Kjo më lë të dyshoj se ndonjë nga miqtë e Inteligjentit, duke u trembur se unë mund ta refuzoja lejen, diku e ka ngatërruar.

  Doktor Balageri dukej i tmerruar në fytyrë. I dha trupit përpara dhe e hapi përgjysmë gojën, nga ku zakonisht dilnin tinguj të butë muzikorë dhe cicërima delikate, sa herë që recitonte, ndërsa në ligjëratat e tij politike, fraza kumbuese dhe deri të tërbuara.
– Do të bëj një investigim të thellë, për të marrë vesh kush e çoi në zyrën tuaj relacionin dhe kujt ia dorëzoi. Këtë do ta bëj menjëherë. Duhet të kisha folur personalisht me ju. Ju lutem, të më falni për këtë pakujdesi, - duart e vogla, të fryra, me thonj të prerë, hapeshin në shenjë pendimi. - Çështja e vërteta, mendova se çështja nuk ishte aq e rëndësishme. Ju na i bëtë të qartë në Këshillin e Ministrave, se situata e Inteligjentit nuk do të përfshinte familjen e tij.

Me një lëvizje të kokës, Truhijo e bëri Balagerin të heshtë.

- E rëndësishme është se dikush ma ka fshehur atë relacion prej dy javësh, - tha prerë. - Në sekretari ka një tradhtar ose një të paaftë. Shpresoj të jetë një tradhtar, të paaftët janë më të dëmshëm.
- Mori frymë thellë, disi i lodhur dhe mendja i shkoi te doktor Enrike Litgou Seara: kishte dashur ta vriste vërtet apo e kishte rrëmbyer zemërimi? Vështronte nga dy dritaret të zyrës së tij detin: re të bardha të dendura mbulonin diellin, dhe në atë pasdite të hirtë sipërfaqja e detit dukej e shqetësuar, shkumëzuese. Dallgë të mëdha rrihnin bregun e thërmuar. Edhe pse kishte lindur në San Kristobal, larg detit, pamja e dallgëve të shkumëzura dhe sipërfaqja ujore që tretej në horizont, i jepte kënaqësi.
- Murgeshat i kanë akorduar bursë ngaqë e dinë fatkeqësinë e Kabralit, - mërmëriti i pakënaqur. - Pasi mendojnë se është koha t'i shërbejnë armikut.
- Ju siguroj që jo, Shkëlqesi. - Gjeneralisimi vuri re se doktor Balageri lëkundej në zgjedhjen e fjalëve. - Nënë Maria, motër Maria dhe drejtoresha e Santo Domingos nuk kanë mendim të mirë për Agustinin. Më sa duket ai nuk shkonte me të bijën dhe ajo vuante në shtëpi. Donin të ndihmonin të bijën, jo të atin. Më siguruan se është një vajzë tepër e dalluar në studime. U nxitova që e firmosa lejen, më vjen keq. Më shumë e bëra për të zbutur marrëdhëniet me Kishën. Ky konflikt më duket i rrezikshëm, Shkëlqesi. Ju e dini mirë opinionin tim.
- Truhijo përsëri e bëri të heshtë me një gjest gati të papërcaktueshëm. A thua do ta tradhtonte tani Inteligjenti? Të ndihesh i shkretuar, i braktisur, pa funksione, pa burime ekonomike, i zhytur në pasiguri. Mos vallë, kështu ka shtyrë në radhët e armikut? Dashtë Zoti, jo. Kabrali ishte një bashkëpunëtor i vjetër, i cili i kishte kushtuar tërë ato shërbime të mira në të kaluarën dhe që mund t'i kushtonte edhe në të ardhmen.
- E keni parë Inteligjentin?
- Jo, Shkëlqesi. Ndoqa udhëzimet tuaja për të mos e pritur, as për të mos iu përgjigjur telefonatave të tij. Më ka dërguar ato dy letrat që ju tashmë i dini. Nga Anibali, kunati i tij, ai i Fabrikës së Duhanit, di që është shumë i vrarë. "Në prag të vetëvrasjes", më tha.
- Mos ishte mendjelehtësi ta fusje një shërbëtor të përkushtuar

si Kabrali, në një provë të tillë në këto çaste të vështira për regjimin? Ndoshta.

- Mjaft humbëm kohë me Agustin Kabralin, - tha. - Kisha, Shtetet e Bashkuara. Këtu fillojmë. Ç'do të bëhet me peshkopin Reji? Sa do të vazhdojë të rri me murgeshat e Santo Domingos, duke bërë martirin?
- Kam folur gjatë me kryepeshkopin dhe me nuncion lidhur me këtë. Ngula këmbë që imzot Reji duhet të braktisë Santo Domingon, sepse prania e tij atje është e patolerueshme. Besoj t'i kem bindur. Kërkojnë të garantohet integriteti i peshkopit, të ndërpritet fushata në "La Nacion", "Karaibet" dhe "Zëri dominikan". Dhe të kthehet në dioqezën e vet në San Huan de la Managua.
- Mos kërkojnë që edhe ju ta lini Presidencën e Republikës? - pyeti Bamirësi, të cilin vetëm emri i Rejit dhe Panalit e nervozonin. A thua, pas tërë atyre që ndodhën, shefi i SIM-it kishte të drejtë? Po të shpërthente befas ajo vatër infeksioni? - Abes Garsia më këshillon që Rejin e Panalin t'i fus në një avion e t'i kthej në vendet e tyre. T'i përzë si të padëshiruar. Ashtu siç po bënë Fidel Kastroja në Kubë me priftërinjtë dhe murgeshat spanjolle.
- Presidenti nuk tha asnjë fjalë, nuk bëri as më të voglin gjest. Priste i palëvizur.
- Ose ta lësh popullin që t'i ndëshkojë ata tradhtarë, - vazhdoi pas një pauze Gjeneralisimi. - Njerëzit mesi presin ta bëjnë. I kam parë vetë në udhëtimet e ditëve të fundit. Në San Huan de la Maguana dhe Në La Vega, mezi po përmbaheshin.
- Doktor Balageri pranoi se populli, nëse do të lejohej, do t'i vriste. Ishte acaruar nga ata kardinalë, bukëshkalë ndaj dikujt që kishte bërë për Kishën Katolike më shumë se të gjitha qeveritë e Republikës, qysh prej 1844-ës. Por, Gjeneralisimi ishte tepër i arsyeshëm dhe realist për të ndjekur këshillat e pamatura dhe apolitike të shefit të SIM-it, që po të zbatoheshin, do t'i sillnin pasoja ogurzeza kombet. Fliste pa u nxituar, me një ritëm, që përzier me oratorinë e tij të pastër, të vinte në gjumë.
- Në këtë regjim, ju jeni njeriu që e urreni më shumë Abes Garsian, - e ndërpreu. - Pse? Doktor Balageri e pati përgjigjen në majë të gjuhës.
- Koloneli është një teknik në punët e sigurimit dhe i bën një

shërbim të mirë shtetit, - tha. - Po, në përgjithësi gjykimet e tij politike, janë të tmerrshme. Me gjithë respektin dhe admirimin që ndiej për Shkëlqesinë Tuaj, më lejoni t'ju bëjë thirrje që të hiqni dorë nga ato ide. Dëbimi, dhe akoma më keq, vdekja e Rejit dhe e Panalit, do të na sillte një pushtim ushtarak të ri. Dhe fundin e Epokës së Truhijos.

– Ngaqë toni i tij ishte tepër i butë e i ngrohtë dhe muzika e fjalëve tepër e këndshme, dukej se ato që thoshte doktor Hoakin Balageri, nuk e kishin atë vendosmëri gjykimi dhe atë këmbëngulje, që nganjëherë, sikurse tani, ky burrë i vogël ia lejonte vetes me Shefin. Mos po e tepronte? Mos e kishte pushtuar, ashtu si edhe Inteligjentin, ndjenja idiote e të qenit i sigurt dhe kishte nevojë për një dush që të vinte në vete? Tip i çuditshëm ky Hoakin Balageri. Ndodhej përkrah tij qysh nga viti 1930, kur i kishte dërguar dy roja për ta thirrur në një hotelth të Santo Domingos, ku Balageri kishte bujtur. Truhijo e mori në shtëpinë e tij për një muaj, që ta ndihmonte në fushatën elektorale ku pati si aleat ditëshkurtër liderin Estreja Urenjan, përkrahës i zjarrtë i të cilit ishte i riu Balager. Një ftesë dhe një bisedë gjysmë ore mjaftuan që poeti, profesori dhe avokati njëzetekatërvjeçar, i lindur në fshatin e humbur Navarrete, të kthehej në truhijist besnik, në shërbëtor kompetent dhe mjaft i mirë për çdo detyrë diplomatike, administrative dhe politike që i besohej. Edhe pse 30 vjet krah tij, edhe pse Truhijo mburrej se kishte një nuhatje prej zagari për njerëzit, në të vërtetë, ky tip i parëndësishëm - ishte diçka hermetike për të. Një nga qartësitë e pakta që kishte për të, ishte mungesa e ambicieve tek ai. Ndryshe nga të tjerët, në grupin e bashkëpunëtorëve të tij të afërm, oreksi i të cilëve mund të lexohej qartë në sjelljet, bëmat dhe lajkat e tyre, Hoakin Balageri gjithmonë i kishte dhënë përshtypjen se dëshironte vetëm atë që atij i tekej t'i jepte. Në postet diplomatike në Spanjë, Francë, Kolumbi, Honduras, Meksikë, në postet e Ministrit të Edukimit, të Presidentit apo në atë të Ministrit të Jashtëm, ishte dukur i merakosur dhe i shqetësuar nga ato detyra përmbi ëndrrat dhe aftësitë e tij, dhe se pikërisht për këtë, përpiqej me tërë forcat e veta për t'i kryer mirë. Por (i shkoi atij për atë mendje Bamirësit), falë asaj përulësie, poeti dhe juristi i vogël kishte qëndruar gjithmonë në majë,

pa kaluar kurrë, për shkak të parëndësishëm të tij, në periudha fatkeqësie si të tjerët. Prandaj ishte President kukull.

Në vitin 1957, kur duhej emëruar një zëvendëspresident në listën që kryesonte vëllai i tij, Negro Truhijo, Partia Domenikane, nën urdhërat e Negros, zgjodhi ambasadorin e Republikës Domenikane në Spanjë, Rafael Bonelin. Por, aty për aty, Gjeneralisimi vendosi ta zëvendësojë atë aristokrat me të parëndësishmin Balager, me një argument bindës: "Nuk ka ambicie". Por tani, falë mungesës së ambicieve, ky intelektual i sjelljeve delicate dhe i diskutimeve fine, ishte pushtetari i parë i kombit dhe i lejohej të dërdëlliste kundër shefit të Shërbimit Sekret. Prandaj i duhej ulur hunda ndonjëherë.

- Balageri qëndronte i qetë si vuv, pa guxuar t'i ndërpriste mendimet e tij, duke pritur që të denjonte t'i drejtonte ndonjë fjalë. Dhe Shefi, më në fund, atë bëri, por pa u rikthyer te tema e Kishës:
- Gjithmonë ju kam trajtuar mirë. Apo jo? Jeni i vetmi nga bashkëpunëtorët e mi, të cilit kurrë nuk i jam drejtuar me "ti". Nuk e keni vënë re?

  Fytyra e rrumbullakët u përflak.
- Ashtu është, Shkëlqesi, - pëshpëriti i turpëruar. - Gjithmonë kam menduar se nuk më drejtoheni me "ti", ngaqë besoni më pak tek unë, sesa te kolegët e mi.
- Vetëm në këto çaste po e marr vesh, - shtoi Truhijo i çuditur, - se edhe ju, kurrë bashku, ju jeni mjaft misterioz për mua. Kurrë nuk kam mundur t'ju zbuloj dobësitë njerëzore, doktor Balager.
- Jam plot me të tilla, Shkëlqesi, - buzëqeshi Presidenti. - Por më duket se ky është më shumë një qortim, sesa një elozh.
- Gjeneralisimi nuk po bënte shaka, kryëzoi e shkryëzoi këmbët, pa ia hequr vështrimin therës Balagerit. E shkoi dorën mbi mustaqet e vogla dhe mbi buzët e thara. Po e vëzhgonte me ngulm.
- Ka diçka jonjerëzore te ju, - foli gati me vete, sikur objekti për të cilin fliste të mos qe i pranishëm. - Nuk keni joshjet që janë të natyrshme te burrat. E di se nuk ju pëlqejnë as gratë, as djemtë. Bëni një jetë më askete se ajo e fqinjit tuaj të bulevardit Maksimo Gomes, nuncios. Abes Garsia nuk ju ka zbuluar as shoqe, as dashnore, asnjë lëshim ndaj vetes suaj. Duket se

shtrati nuk ju intereson. As paraja. Pothuajse s'keni kursime, veç shtëpisë ku jetoni, s'keni prona, aksione, investime. Të paktën këtu. Nuk jeni futur në intrigat dhe luftërat e egra ku përleshen bashkëpunëtorët e mi, edhe pse të gjithë intrigojnë kundër jush. Më është dashur t'ju shtyj për detyra ministrore, ambasadorësh, zëvendëspresidentësh dhe deri Presidentësh ku ndodheni tani. Nëse do t'ju heq prej këtej dhe do t'ju dërgoj në një vend të humbur si Montekristi apo Azua, ju do të shkonit atje, njësoj i kënaqur. Ju nuk pini alkool, as duhan, nuk keni babëzi për të ngrënë, nuk shkoni pas fustaneve, as pas parasë, as pas pushtetit. Jeni vërtet ashtu? Apo sjellja juaj është një strategji me një qëllim të fshehtë?

- Faqet e rruara të doktor Balagerit, përsëri u përvëluan. Po zëri i tij i dobët nuk u lëkund të thoshte:
- Qysh kur kam njohur Shkëlqesinë Tuaj, atë mëngjes prilli të vitit 1930, veten ime kam qenë i vendosur t'ju shërbej. Qysh atëherë mësova se, duke i shërbyer Truhijos, i shërbeja vendit tim. Kjo e ka bërë të pasur jetën time shumë më tepër se ç'mund ta bënte një femër, paraja apo pushteti. Kurrë nuk do të gjej dot fjalë për të falënderuar Shkëlqesinë Tuaj që më ka lejuar të punoj pranë jush.
- Ja, lajkat e përhershme, që edhe truhijisti më i pamësuar do t'i thoshte. Për një çast imagjinoi sikur ky njeri i vogël dhe i parrezikshëm do t'ia hapte zemrën, si në rrëfimtore, dhe do t'i zbulonte mëkatet e veta, frikërat, urrejtjet, ëndrrat. Por mbase nuk kishte asnjë sekret dhe jeta e tij ishte ajo që e njihnin të gjithë: funksionar i përkorë dhe punëtor, ipi i pranishëm dhe joëndërrimtar, i cili dinte të përshtaste mirë, në fjalimet, deklarimet, letrat, marrëveshjet, negociatat diplomatike dhe ligjëratat e veta të bukura, idetë e Gjeneralisimit; poet, i cili dinte t'i thurte akrostike dhe lavde bukurisë së gruas dome-nikane dhe peizazhit të Kiskejas; vajzave që stolisnin gjatë përvjetorëve, Konkurset e Poezisë në përvjetorët e Zonjushës Republikë Domenikane dhe në festat patriotike. Një burrec pa dritën e vet, sikurse hëna, i ndriçonte ylli diellor, Truhijo.
- Po, e di, ju keni qenë një shok i mirë, - siguroi Bamirësi. - Qysh atë mëngjes të vitit 1930. Po. Dërgova t'ju thërrisnin, sipas këshillës së gruas sime të atëhershme, Bienvenida. Më duket ishte e afërmja juaj, kështu?
- Kushërira ime e parë, Shkëlqesi. Ajo drekë qe vendimtare

për jetën time. Më ftuat t'ju shoqëroja në fushatën elektorale. Më bëtë nderin të më kërkonit t'ju prezantoja në mitingjet e San Pedro de Makoris, kryeqendra e La Romanas. Qe debutimi im si orator politik. Duke nisur prej andej, fati im mori tjetër drejtim. Deri atëherë, prirja ime ishin letrat, mësuesia, drejtësia. Falë jush, politika doli në krye.

- Një sekretar trokiti në derë dhe kërkoi leje për të hyrë. Balageri pa në sy Gjeneralisimin dhe ky e miratoi heshtazi. Sekretari, me një kostum të shtrënguar, me mustaqka të vogla dhe me flokë të lëpirë nga brilantina, sillte një memorandum të firmosur nga pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë banorë të rëndësishëm të San Huan de la Maguanas, "që të ndalohej kthimi në atë peshkopatë i imzot Rejit, peshkopit tradhtar". Një komision i drejtuar nga kryetari i Bashkisë dhe kryetari lokal i Partisë Domenikane, donte t'ia dorëzonte Presidentit. Si të bënte? T'i priste? U konsultua përsëri me Bamirësin, i cili miratoi me një lëvizje koke.
- Të kenë mirësinë të presin, - i tha Balageri. - Do t'i pres zotërinjtë kur të mbaroj punë me Shkëlqesinë e Tij.
- Të ishte Balageri aq katolik sa tregohej? Qarkullonin shaka të panumërta mbi beqarinë e tij dhe devotshmërinë për të ndenjur tepër i përqendruar në meshë, tedeum dhe procesione të ndryshme. Vetë Shefi e kishte parë se si afrohej për t'u kunguar, me duart të bashkuara dhe me sytë ulur. Kur u ndërtua shtëpia ku jetonte me motrat e tij, në Maksimo Gomes, pranë nunciaturës, Truhijo urdhëroi Lyrashin të shkruante një letër në "Forumin Publik", duke u tallur me atë fqinjësi dhe duke pyetur se ç'krushqi e fshehtë e lidhte doktorushin e vogël me të dërguarin e Shenjtërisë së Tij. Nga fama që kishte si ithtar feje dhe nga marrëdhëniet e shkëlqyera që kishte me priftërinjtë, e ngarkoi të ndërtonte politikën e regjimit me Kishën Katolike. Dhe Balageri e bëri shumë mirë. Deri më 25 janar të vitit 1960, kur në famullitë u lexua Karta Pastorale e atyre ngrehaliçëve, Kisha kishte qenë një aleate e fortë. Konkordati midis Republikës Domenikane dhe Vatikanit, të cilin e bëri Balageri dhe e firmosi Truhijo në Romë në vitin 1954, solli si pasojë një përkrahje të fuqishme për regjimin dhe figurën e tij në botën katolike. Poeti dhe juristi duhet të vuante tepër nga ky ballafaqim që po zgjaste një vit e gjysmë midis qeverisë dhe veladonëve. A thua të ishte aq katolik? Gjithmonë

ishte përpjekur që regjimi të shkonte mirë me peshkopët, priftërinjtë dhe Vatikanin, duke paraqitur argumente pragmatike e politike, jo fetare: Aprovimi i Kishës Katolike legjitimon veprimet e regjimit para popullit domenikan. Truhijos nuk duhet t'i ndodhte ajo që i ndodhi Peronit, qeveria e të cilit filloi të shembet, qëkur Kisha e vuri në shënjestër. A kishte të drejtë? A thua, asaj partie eunukëve bodrumesh, do t'i jepte fund Truhijos? Veç, më parë, Panali dhe Reji do të bëheshin ushqim për peshkaqenët në det, te harcat.

- Do t'ju them diçka që do t'ju kënaqë, President, - tha, papritur. - Unë nuk kam kohë për të lexuar budallallëqet që shkruajnë intelektualët. Poezitë, romanet. Punët e shtetit ma bëjnë tërë kohën. Nga Marrero Aristi, edhe pse punoi kaq vite me mua, nuk kam lexuar asgjë. As "Over"-in, as artikujt që ka shkruar për mua, as "Historinë Domenikane". Po ashtu, nuk kam lexuar qindra libra që më kanë dedikuar poetët, romancierët, dramaturgët. As marrëzitë e sime shoqeje nuk i kam lexuar. Nuk kam kohë për to, as për të parë filma, për të dëgjuar muzikë, për të shkuar në balet apo në ndeshje me gjelat. Veç kësaj, kurrë nuk i kam besuar artistët. Janë pa bythë, s'dinë ç'është nderi, janë të prirur për tradhti, dhe shumë servilë. Edhe vargjet tuaja nuk i kam lexuar, as esetë. Mezi kam shfletuar librin tuaj mbi Duarten "Krishti i lirisë" që më keni dërguar me atë dedikim aq të ëmbël. Veç, ka një përjashtim: fjalimi juaj që mbajtët për shtatë vjetësh tek Artet e Bukura, kur ju pranuan në Akademinë e Gjuhës. Ju kujtohet?
- I mpakuri Balager u skuqur edhe më. Rrezatonte një dritë mburrjeje dhe hareje të papërshkrueshme:
- "Zoti dhe Truhijo: Një ngjizje e vërtetë", - mërmëriti, duke mbyllur sytë.
- E kam lexuar shumë herë, - cicëriti me një zëth mjaltë Bamirësi. - Di paragrafe përmendsh, si poezi.
- Ç'ishte ky rrëfim ndaj Presidentit torollak? Ishte një dobësi? Jo, ai kurrë nuk u dorëzohej dobësive. Balageri le të mburrej për atë fjalim, le të ndihej i rëndësishëm. Por nuk ishte çasti për të hequr dorë nga një bashkëpunëtor i dytë, në një kohë aq të shkurtër. Duke menduar se cilësia më e mirë e këtij burri ishte, jo vetëm të dinte ç'ishte e dobishme, por mbi të gjitha, të mos merrte vesh ç'ishte e padobishme, u qetësua. Për të mos krijuar armiqësi vrasëse te kurizanët e tjerë, nuk

duhej përsëritur ajo që u bë me Kabralin. Ai fjalim i Balagerit e kishte prekur thellë, e kishte bërë të pyeste veten shumë herë, nëse shprehte një të vërtetë të madhe, një nga ato vendimet e mistershme hyjnore, që përcaktojnë fatin e një populli. Atë natë, kur dëgjoi paragrafet e para që akademiku i ri, i veshur me një frak dosido, lexonte në skenën e Teatrit të Arteve të Bukura, Bamirësi nuk i kushtoi shumë rëndësi. (Ai, gjithashtu, kishte veshur një frak, si gjithë meshkujt e kohës, ndërsa damat mbanin fustane të gjata dhe shkëlqenin gjithandej nga bizhuteritë dhe arturinat). Ai fjalim qe një sintezë e historisë domenikane, qysh nga mbërritja e Kristofor Kolombit në Hispanjola. Filloi të prekej, kur në fjalët e mençura dhe në prozën elegante të konferencierit, po nxirrte kokë një vizion, një tezë. Republika Domenikane u përballoi mësë katër shekuj - plot katërqind e tridhjetë e tetë vjet - fatkeqësive të shumta - piratët, pushtuesit haitianë, sulmet aneksioniste, masakra dhe ikja e të bardhëve (vetëm gjashtëdhjetë mijë mbetën pas çlirimit nga Haiti) - falë Perëndisë. Detyrën për të shpëtuar këtë vend, deri atëherë e kishte marrë përsipër vetë Krijuesi. Por duke nisur nga viti 1930, Rafael Leonidas Truhijo Molina e zëvendësoi Zotin në këtë mision të mundimshëm.

- "Një vullnet energjik dhe i kalitur në betejë, që është pjesë e veprës mbrojtëse dhe bamirëse të atyre forcave mbinatyrore në marshimin e Republikës drejt majave të arritjeve të saj," - recitoi Truhijo, me sytë gjysmëmbyllur. - "Zoti dhe Truhijo: paksa i prosperitetit aktual të jetës domenikane."
- I hapi përgjysmë sytë dhe mori frymë me melankoli. Balageri e dëgjonte i magjepsur, i zvogëluar edhe më nga mirënjohja.
- Ju ende besoni se Zoti ma la mua për detyrë? Se më ngarkoi përgjegjësinë për të shpëtuar këtë vend? - pyeti me një përzierje të paqartë ironie dhe ankthi.
- Më shumë se atëherë, Shkëlqesi, - replikoi zëthi i qartë dhe brishtë. - Truhijo nuk do të kishte mundur ta kryente misionin mbinjerëzor pa mbështetjen hyjnore. Ju keni qenë për këtë vend instrument i Qenies Supreme.
- Sa keq që ata peshkopët e trashë nuk e kanë marrë vesh, - buzëqeshi Truhijo. - Nëse teoria juaj qëndron, shpresoj që Zoti t'ua ketë shpërblyer verbërinë atyre.
- Balageri nuk qe i pari në hyjnizimin e veprës së tij. Bamirësit

i kujtohej se dikur, profesori i ligjeve, avokati dhe politikani don Hasinto B. Peynado (të cilin e vuri President kukull në vitin 1938, kur, për shkak të kasaphanës ndaj haitianëve, pati protesta ndërkombëtare kundër rizgjedhjes së tij për të tretën herë), vendosi një tabelë të madhe të ndriçuar te porta e shtëpisë së vet: "Zoti dhe Truhijo". Qysh atëherë, tabela të njëjta ndriçonin në shumë shtëpi të kryeqytetit dhe të qyteteve të tjera. Jo, jo nuk ishte një frazë. Ishin argumentet që përligjnin atë aleancë që kishte mahnitur Truhujon, si një e vërtetë dërrmuese. S'ishte e lehtë të ndieje mbi shpatullat e veta peshën e një dore të mbinatyrshme. I ribotuar çdo vit nga Instituti Truhijonian, fjalimi i Balagerit ishte lexim i detyruar në shkolla dhe teksti kryesor i Edukatës Qytetare, me fatin të edukonte shkollarët dhe universitarët me Doktrinën Truhijiste, që e redaktoi një treshe e zgjedhur prej tij: Balageri, Inte-ligjent Kabrali dhe Lyrashi.

- Shpeshherë e kam vrarë mendjen për atë teorinë tuaj, doktor Balager, - u rrëfye. - Qe një vendim hyjnor? Po pse unë? Pse mua?
- Doktor Balageri njomi buzët me majën e gjuhës para se të përgjigjej:
- Vendimet hyjnore janë të pashmangshme, - tha me devocion. - Kanë pasur parasysh prirjet e tuaja të jashtëzakonshme për udhëheqje, si aftësinë për punë dhe, mbi të gjitha, dashurinë për këtë vend.
- Pse po humbiste kohën me këto marrëzira? Kishte punë të ngutshme. Megjithatë, si rrallëherë ndiente nevojën ta zgjaste këtë bisedë të kotë, refleksive, personale. Po pse me Balagerin? Brenda rrethit të bashkëpunëtorëve, ai ishte njeriu që do të donte të kishte sa më pak intimitetet për të ndarë. Kurrë nuk e kishte ftuar në darkat private në San Kristobal, në shtëpinë me Mogan, ku derdhej likeri lumë dhe shpesh bëheshin teprime letraresh. Ndoshta sepse, mes gjithë asaj turme intelektualësh dhe sias, Presidentin e rrethonte një brerore e ndotur).
- Mendimi im për intelektualët dhe shkrimtarët gjithmonë ka qenë i keq, - tha përsëri. - Në listën e njerëzve me merita, në vend të parë vë ushtarakët. Kryejnë detyrën, thurin pak intriga, nuk e humbasin kohën kot. Pastaj vijnë fshatarët. Kudo, në

të korra, në kasolle, në përpunim sheqeri, janë njerëzit më të shëndetshëm, më punëtorë dhe më të ndershëm të këtij vendi. Më tej janë funksionarët, punëdhënësit, tregtarët. Shkrimtarët dhe intelektualët vijnë të fundit. Madje, pas priftërinjve. Ju jeni një përjashtim, doktor Balager. Po të tjerët?! Një varg ndyrësirash. Ata që përfituan më shumë dhe që më shumë e dëmtuan regjimin, që i ushqeu, i veshi dhe i mbushi me ndere. Ja për shembull, ata çapetonët*, si Hose Almoina apo Hesus Galindes. U dhamë strehë, punë. Dhe nga lajkatarë e lypsarë, u bënë shpifarakë e shkrues poshtërsish. Po Osorio Lizaraso, ai çalashi kolumbian që sollët ju? Erdhi të shkruante biografinë time, të më ngrinte në qiell e të jetonte si mbret, po kur u kthye në Kolumbi me xhepat plot, u bë antitruhijist.

– Tjetër meritë e Balagerit ishte se dinte kur duhej heshtur, kur duhej kthyer në sfinks, mbi të cilin Gjeneralisimi mund të shfrente. Truhijo heshti. Mbajti vesh, duke u munduar të dallonte zhurmën e asaj sipërfaqe të hirtë, me linja paralele dhe të shkumta që dukej nga dritaret e mëdha. Por s'arriti dot të dëgjonte zhurmërimin e detit, ngaqë e mbysnin motorrët e makinave.
– Ju besoni se Ramon Marrero Aristi më tradhtoi? - pyeti befasish, duke e thyer heshtjen e bisedës. - Që i dha atij gringos së "The New York Times" informacion për të më sulmuar?
– Doktor Balageri kurrë nuk gjendej i papërgatitur nga këto pyetje kompromentuese dhe të rrezikshme të Truhijos, para të cilave të tjerët ziheshin ngushtë. Ai gjente shteg për të dalë nga situata:
– Ai betohej që jo, Shkëlqesi. Me lot në sy, i ulur aty ku jeni ju, m'u betua për të ëmën dhe për tërë shenjtorët, se nuk kishte qenë informator i Ted Shulcit.
Truhijo reagoi me një gjest inati:
– Mos prisje të vinte këtu Marrero e të betohej se ishte shitur? Po ju pyes ju: Tradhtoi, apo jo?
Balageri dinte gjithashtu se, kur nuk kishte më shpëtim, të dorëzohej; tjetër aftësi që Bamirësi njihte tek ai.
– Me dhimbje në shpirt, nga respekti intelektual dhe personal që ndiej për Ramonin, me thonë se ai që e informoi Ted Shulcin, - tha me zë të ulët, gati të pakapshëm. - Provat ishin të plota, Shkëlqesi.
Në të njëjtin përfundim kishte arritur edhe ai. Për tridhjetë

vjet në krye të qeverisë (edhe më përpara, kur kishte qenë roje, edhe akoma më parë kryepunëtor i kallamsheqerit), që mësuar të mos humbiste kohë duke parë pas e duke i ardhur keq apo mirë për vendime tashmë të marra. Por ndodhia me Ramon Marrero Aristin, atë "injorant gjenial", siç e quante Maks Henrikes Urenja, për të cilin arriti të kishte vërtet respekt, atë shkrimtar dhe historian, të cilin e mbuloi me ndere, para dhe funksione (kolumnist dhe drejtor i "La Nacion", Ministër i Punës dhe autor i tre vëllimeve të "Historisë së Republikës Domenikane", që i pagoi nga xhepi i vet), sa herë i vinte ndër mend, i linte një shije të hidhur.

– Nëse ishte vënë duart në zjarr për dikë, ky ishte autori i romanit domenikan më të lexuar brenda dhe jashtë vendit – romani "Over" mbi Central Romanan – i përkthyer edhe në anglisht. Një truhijist i paepur. Si drejtor i "La Nacion" e tregoi veten të tillë, duke e mbrojtur Truhijon dhe regjimin e tij me ide të qarta dhe prozë luftarake. Një Ministër i shkëlqyer i Punës, që ia kaloi mrekullisht dhe me sindikalistët dhe me pronarët. Prandaj, kur gazetari i "The New York Times", Ted Shulc, njoftoi se do të vinte për të bërë disa kronika në Republikën Domenikane, ia besoi Marrero Aristit detyrën për ta shoqëruar. Aristi udhëtoi me të gjithandej dhe i siguroi intervistat që kërkoi, përfshi një intervistë edhe me vetë Truhijon. Kur Ted Shulci u kthye në Shtetet e Bashkuara, Marrero Aristi e përcolli deri në Majami. Gjeneralisimi nuk priste kurrë që artikujt në "The New York Times" të ishin një apologji e regjimit të tij. Por as që t'i kushtoheshin korrupsionit të "sundimit satrap truhijist", as që Ted Shulci të tregonte me të atillë saktësi të dhëna, data emra dhe shifra mbi pronat e familjes Truhijo dhe tregtitë nga të cilat kishin përfituar të afërmit, miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Vetëm Marrero Aristi mund ta kishte informuar. Ishte i sigurt se Ministri i tij i Punës nuk do të shkelte më në Qytetin Truhijo. Dhe u çudit kur ky që nga Majami, i dërgoi një letër gazetës njujorkeze duke përgënjeshtruar Ted Shulcin, por akoma më shumë që pati guximin të kthehej në Republikën Domenikane. U paraqit në Pallatin Kombëtar. Qau e tha se ishte i pafajshëm, se janki ia kishte hedhur, duke iu shmangur vigjilencës së tij e duke biseduar fshehtas me kundërshtarët. Ishte nga herët e rralla që Truhijo kishte humbur kontrollin e nervave të veta. I pështirosur nga

qaravitjet, i futi një shuplakë, sa e bëri t'i merreshin këmbët, t'i mbahej goja e të zbythej i tmerruar. E futi në dhe, duke e quajtur tradhtar dhe, pasi komandanti i rojave ushtarake e vrau, urdhëroi Xhoni Abesin që të merrej me kufomën. Më 17 korrik të vitit 1959 Ministri i Punës dhe shoferi i tij, u rrëzuan në një humnerë në Malet Qendrore, kur po shkonin drejt Konstancës. Ju bë varrim zyrtar dhe në ceremoninë mortore senatori Henri Çirinos vuri në dukje veprën politike të të ndjerit, ndërsa doktor Balageri bëri panegjirikun letrar.

– Megjithatë tradhtinë e tij, më erdhi keq që vdiq, - tha Truhijo me sinqeritet. - Ishte i ri, sa kishte mbushur dyzet e gjashtë vjet, do të kishte bërë shumë për vete.
– Vendimet hyjnore janë të pashmangshme, - përsëriti pa kurrfarë ironie Presidenti.
– U larguam prej problemeve tona, - u kujtua Truhijo. - A shikon ndonjë mundësi për t'u rregulluar punët me Kishën?
– Tani për tani, jo, Shkëlqesi. Mosmarrëveshja është acaruar. T'ju flas hapur, kam frikë se punët do të shkojnë keq e më keq, nëse ju nuk do të urdhëroni kolonel Abesin që "La Nacion" dhe "Radio Karaibe" të shmangin sulmet ndaj peshkopëve. Pikërisht sot kam marrë një ankesë zyrtare nga nuncio dhe kryepeshkopi Pitini për fyerjen që i kanë bërë dje timzot Panalit. E keni lexuar ju?
– E kishte përpara shkrimin e prerë dhe ia lexoi Bamirësit me shumë respekt. Kryeartikulli i "Radio Karaibe", i riprodhuar nga "La Nacion", siguronte se imzot Panali, peshkopi i La Vegas, "dikur i njohur me emrin Leopoldo de Ubrike", ishte i arratisur nga Spanja dhe i kërkuar nga Interpoli. Akuzohej se kishte mbushur "me beata shtëpinë kuriale të La Vegas, para se t'u përkushtohej punëve të tij terroriste" dhe tani, "ngaqë i trembet një hakmarrjeje të drejtë popullore, fshihet pas beatave dhe grave patologjike, me të cilat, me sa duket, ka një tregti të ndyrë seksuale".
– Gjeneralisimi qeshi me gjithë dëshirë. Ju i shkonte mendja Abes Garsias! Po të ishte për atë punë, duhej t'ia kishin prerë bibilen atij spanjolli të asaj kohe këtu, njëzet a tridhjetë vjet më parë. Ta akuzoje se kishte kurvëruar me beatat e La Vegas, ishte një marrëzi. Shumë shumë, mund ta akuzoje për futje duarsh djelmoshave të meshës, siç bënin mjaft priftërinj epshorë dhe homoseksualë.

- Koloneli nganjëherë i zmadhon gjërat, - komentoi tërë gaz Truhijo.
- Po ashtu, kam marrë një tjetër ankesë zyrtare nga nuncio dhe nga kuria, - vazhdoi Balageri, tepër serioz. - Për fushatën e lëshuar më 17 maj në shtyp dhe radio kundër fretërve të San Karlos Borromeo, Shkëlqesi.
- Ngriti një dosje të kaltër, me prerje gazetash, me tituj të dukshëm. "Fretërit françeskano-kapuçinë terroristë" fabrikoheshin dhe grumbullonin bomba artizanale në ato kisha. I kishin diktuar vendasit nga një shpërthim i rastit i një eksplozivi. "La Nacion" dhe "Karaibet" kërkonin që forcat publike të pushtonin strofkën terroriste.
- Truhijo hodhi një vështrim të mërzitshëm mbi ato prerje gazetash.
- Ata priftërinj nuk kanë këllqe të fabrikojnë bomba. Vetëm sulmojnë me predikime.
- Njoh abatin, Shkëlqesi. Frei Alonso de Palmira, është njeri i shenjtë, i është përkushtuar misionit të tij apostolik, e respekton qeverisë. Absolutisht i paaftë për një veprie përmbysëse.
- Bëri një pauzë të shkurtër dhe po me atë zë të përzemërt, me të cilin do të kishte biseduar në një pasdarke, dha një argument që Gjeneralisimi e kishte dëgjuar edhe nga Agustin Kabrali. Që të hidheshin përsëri urat me hierarkinë, Vatikani dhe priftërinjtë (shumica e të cilëve vazhdonin të ishin të përzemërt me regjimin nga frika e komunizmit ateist), ishte e domosdoshme të ndalej, ose të paktën, të qetësohej, kjo fushatë e përditshme me akuza dhe sulme, që do t'u jepte mundësi armiqve ta paraqisnin regjimin si antikatolik. Doktor Balageri, gjithmonë me mirësjelljen e vet të pandryshueshme, i tregoi Gjeneralisimit një protestë të Departamentit të Shtetit për shqetësimet ndaj fetarëve të Kolegjit Santo Domingo. Ai ishte përgjigjur duke shpjeguar se policia mbronte murgeshat nga veprimet armiqësore. Por, në të vërtetë, puna e bezdisjes ishte e vërtetë. Për shembull, njerëzit e kolonel Abes Garsias vinin tërë natën altoparlantët e lokaleve me merenga truhijiste të modës, në mënyrë që murgeshat të mos mbyllnin sy. Të njëjtën gjë bënin dhe në San Huan de la Maguana, në rezidencën e timzot Rejit dhe po ashtu vazhdonin të bënin në La Vega me timzot Panalin. Ishte ende e mundur një pajtim me Kishën. Por kjo fushatë po e çonte krizën drejt prishjes së plotë.

- Flisni me rosacruzët dhe bideni, - tha ftohtë Truhijo. - Ai është priftërinësi. Është e sigurt se tashmë është vonë për të qetësuar Kishën. Po ashtu, është e sigurt që priftërinjtë duan të më shohin në ekzil, në burg ose në varr.
- Ju siguroj që nuk është ashtu, Shkëlqesi.
- Bamirësi nuk ia vuri veshin. Po vërente Presidentin kukull që s'thoshte asgjë, me ata sytë zbirues që të hutonin e të kallnin datën. I mpakuri Doktor, zakonisht rezistonte për një kohë më të gjatë se të tjerët atë inkuizicion okular, por tani pas nja dy minutash, duke e ndier veten të zhveshur nga ai vështrim i pacipë, filloi të shqetësohej vërtet: sytë e tij hapeshin e mbylleshin pa pushim përtej qelqeve të trasha.
- Besoni ju te Zoti? - e pyeti Truhijo me njëfarë kërshërie. Po e shponte me sytë e vet të ftohtë, duke i kërkuar një përgjigje të sinqertë. - Besoni ju se ka një jetë tjetër pas vdekjes? Besoni se ka qiell për të mirët dhe ferr për të këqinjtë? Besoni në këto, vërtet?
- Ju duk se figurëza e Hoakin Balagerit po përhumbej edhe më, e hutuar nga ato pyetje. Ju duk se fotografia e vet, pas Presidentit (kostumi dhe kapelja trekëndëshe me pendë, shiriti presidencial tërthor gjoksit, pranë dekoratës që e krenonte edhe më, kryqi spanjoll i Karlit III), zmadhohej në kornizën e praruar. Duart e vogla të Presidentit kukull kërkonin njëra-tjetrën, ndërsa fliste, si të rrëfente një sekret:
- Nganjëherë dyshoj, Shkëlqesi. Por ka vite që kam mbërritur në këtë përfundim: Nuk ka tjetër alternativë. Duhet të besoni. Është e pamundur të jesh ateist në një botë si kjo e jona, sidomos nëse je i futur shërbimit publik dhe politikës.
- Juve ju ka dalë nami se jeni besimtar i përshpirtshëm, - këmbënguli Truhijo, duke lëvizur nga vendi. - Kam dëgjuar, gjithashtu, se jeni i pamartuar, nuk keni të dashur, nuk pini, nuk merreni me tregti, sepse keni bërë kushtime fshehtas. Pra, që je një prift laik.
- Kryetari i impakur i shtetit, mohoi me kokë: Asgjë nga këto nuk ishte e vërtetë. Nuk kishte bërë, as bënte ndonjë kushtim. Ndryshe ndonjërit prej shokëve të Shkollës Normale, të cilët torturoheshin të dinin nëse qenë zgjedhur nga Zoti për të shërbyer si pastorë të grigjës katolike, ai e dinte me kohë se prirja e tij nuk ishte priftëria, por puna intelektuale dhe veprimit politik. Feja i jepte një qetësi shpirtërore, një etikë për të

përballuar jetën. Shpesh dyshonte te epërsia e Zotit, por kurrë te funksioni i pazëvendësueshëm i katolicizmit, si një instrument frenues shoqëror i pasioneve dhe i etjeve të shfrenuara të kafshës njerëzore. Nuk dyshonte te Republika Domenikane si forcë përbërëse e kombësisë, njësoj sa dhe gjuha spanjolle. Pa fenë katolike vendi do të ishte shpërbërë dhe barbarizuar. Sa për besimin, ai praktikonte recetën e san Ignacio de Lojolës, në veprën e tij "Praktikat shpirtërore": Të veprosh ashtu siç të besojet, duke përkëdhelur ritet dhe urdhëresat: meshat, lutjet, pranimet e fajit, kungimet. Apo përsëritje sistematike e formës fetare, do të krijonte përmbajtjen, duke mbushur boshllëkun – në ndonjë çast – me praninë e Zotit.

- Balageri puatof fushën e shpirtit të vet, pikëtakimet e veta personale me Qënien Supreme.

- Nëse do të kisha pasur dyshime dhe nëse do të kisha pritur ndonjë sinjal nga qielli para se të veproja, kurrë nuk do të kisha qëndruar dot në këmbë, - tha Truhijo. - Kam besuar gjithmonë te vetja, tek askush tjetër, kur bëhej fjalë për të marrë vendime për jetë a vdekje. Sigurisht, ndonjëherë, edhe kam gabuar.
- Bamirësi spikati diçka te shprehja e Balagerit: Ai donte të dinte se për çfarë dhe për kë e kishte fjalën Shkëlqesia e Tij. Por nuk i tha se s'kishte në mendje fytyrën e doktorucit Enrike Litgou Seara. Ishte urologu i parë që e vizitoi – i rekomanduar nga Inteligjenti Kabral si profesionist i shquar – kur mori vesh se kishte probleme me urinimin. Nga fillimet e viteve pesëdhjetë, doktor Marioni, pasi e operoi nga një infeksion periuretral, e siguroi se nuk do të kishte më shqetësime. Por shpejt i rifilluan ato vështirësitë me urinën. Pas shumë analizash dhe një ndërhyrjeje të bezdisshme në zorrën e trashë, doktor Litgou Seara, me një pamje prej putane apo kujdestari pisanjoz i një kishe, dhe duke derdhur broçkulla të pakupftimta për ta demoralizuar ("sklerozë uretral perineal", "uretrografias", "prostatis acinosa"), formuloi atë diagnozë që do t'i kushtonte shtrenjtë:
- Duhet ta lini në dorë të Zotit, Shkëlqesi. Infeksioni në prostatë është kanceroz.
- Shqisa e tij e gjashtë i la të kuptonte se doktori e zmadhonte ose gënjente. U bind për këtë kur urologu nguli këmbë për

një operacion të menjëhershëm. Kishte shumë rreziqe, nëse nuk e hiqte prostatën. Mund të prodhoheshin metastazat. Biopsia dhe një trajtim kimik do t'i zgjasnin jetën edhe disa vjet. Ekzagjeronite dhe gënjente, sepse ishte një mjek i trashë, ose një armik. Që ai donte të përshpejtonte vdekjen e Babait të Atdheut të Ri, e mori vesh saktësisht, kur solli nga Barcelona një specialist të vërtetë. Doktori Antonio Pigvert mohoi se kishte kancer. Zmadhimi i asaj gjëndreje, i shpjegoi mjeku i shquar, mund të kurohej me ilaçe, pa e kërcënuar jetën e Gjeneralisimit. Heqja e prostatit ishte e panevojshme. Po atë mëngjes Truhijo dha urdhërin, dhe adjutanti ushtarak, togeri Hose Oliva, mori përsipër që i pacipi Litgou Seara të zhdukej në molin e Santo Domingos, bashkë me helmin dhe shkencën e tij të keqe. Ah, po! Presidenti kukull nuk po firmoste akoma gradimin kapiten të Penja Riverës. Zbriti nga ekzistenca hyjnore te tema e rëndomtë e pagës së shërbimeve të njërit prej rrufjanëve më të aftë të rekrutuar nga Abes Garsia.

- Gati harrova, - tha, duke bërë sikur mërzitje me kokë. - Nuk e keni firmosur vendimin e gradimit kapiten për merita të jashtëzakonshme të togerit Penja Rivera. Ka një javë që ju kam dërguar dosjen me miratimin tim.
- Fytyra e rrubullaktë e Presidentit Balager u thartua dhe goja iu shtrembërua. Por e mblodhi veten dhe përsëri mori qëndrimin e qetë, të zakonshëm.
- Nuk e kam firmosur, sepse e kam parë me vend ta diskutoj me ju këtë gradim, Shkëlqesi.
- Nuk ka ç'të diskutojmë, - ia preu me ashpërsi Gjeneralisimi. - Ju i keni marrë udhëzimet. Nuk i keni të qarta?
- Pa dyshim që po, Shkëlqesi. Ju lutem të më dëgjoni. Nëse arsyet e mia nuk do t'ju bindin, do ta firmos menjëherë gradimin e toger Penja Riverës. Këtu e kam, gati për nënshkrim. Si çështje delikate, m'u duk e arsyeshme t'jua komentoj personalisht.
- I dinte shumë mirë arsyet që do t'i parashtronte Balageri dhe filloi të nervozohej. Do të guxonte vërtet ky hiç të mos i bindej një urdhri tim, ngaqë mendon se jam tepër i plakur apo i lodhur? E fshehu pakënaqësinë e vet dhe dhe e dëgjoi pa e ndërprerë. Balageri bënte një mrekulli retorike, që gjërat që thoshte të dukeshin sa më pak të guximshme, falë fjalëve të buta dhe tonit tepër të edukuar. Megjithë respektin e madh

që kishte, ia lejonte vetes ta këshillonte Shkëlqesinë e Tij për ta rishqyrtuar vendimin e gradimit, për merita të jashtëzakonshme, sidomos, për dikë si toger Viktor Alisinio Penja Rivera. Kishte një të kaluar aq negative, aq të njollosur me vepra të qortueshme – ndoshta padrejtësisht – saqë ky gradim do të përdorej nga armiqtë, më të gjitha në Shtetet e Bashkuara, si një shpërblim për vdekjen e motrave Minerva, Patria dhe Marie Teresa Mirabal. Edhe pse drejtësia vendosi që motrat dhe shoferi i tyre vdiqën në një aksident rrugor, jashtë vendit është paraqitur si një vrasje politike e kryer nga togeri Penja Rivera, shef i SIM-it në Santiago, aty ku ndodhi tragjedia. Presidenti do t'i lejonte vetes të kujtonte skandalin e armatosur nga kundërshtarët, kur me urdhër të Shkëlqesisë së Tij, më 7 shkurt të këtij viti autorizoi, përmes dekretit presidencial, që t'i jepej togerit Penja Rivera prona prej 4 hektarësh dhe shtëpia e Patria Mirabalit dhe burrit të saj, të shpronësuar nga shteti për veprimtari armiqësore. Zhurma për këtë akoma vazhdonte. Komitetet e ngritura në Shtetet e Bashkuara vazhdonin të bënin protestë të madhe, duke paraqitur atë dhurim tokash e shtëpie të Patria Mirabalit toger Penja Rivera, si një pagesë për një krim. Doktor Hoakin Balageri i bënte thirrje Shkëlqesisë së Tij, të mos u jepte pretekst të ri armiqve që të përsërisnin të njëjtën histori, se mbante nën sqetull vrasësit dhe torturuesit. Edhe pse, padyshim, Shkëlqesia e Tij e mbante mend mirë, ai ia lejonte vetes për t'i kujtuar se, sipas fushatave shpifëse të të mërguarve, zëvendësi i preferuar i kolonelit Abes Garsia, jo vetëm kishte lidhje me vdekjen e Mirabaleve, por edhe me aksidentin e Marrero Aristit e me shumë zhdukje të hamendësuara. Në këto rrethana, ishte e pamatur ta shpërbleje togerin kaq publikisht. Pse jo në një mënyrë që të mos binte në sy: me shpërblime ekonomike ose me ndonjë detyrë diplomatike në vend të largët? Pasi heshti, fërkoi duart. Përplaste qepallat i shqetësuar dhe i trembur nga një qortim i mundshëm, pasi e rrethe me mend se argumentet e tij të kujdesshme, nuk do të shërbenin fare. Truhijo frenoi zemërimin që i gurgullonte nga brenda.

– Ju, Presidenti Balager, keni fatin të merreni me pjesën më të mirë të politikës, - tha i akullt. - Ligje, reforma, marrëveshje diplomatike, transformime shoqërore. Këtë punë keni bërë tridhjetë e një vjet. Ju ka takuar ana e këndshme, e butë e qeverisjes.

Ju kam zili. Do të më pëlqente të isha vetëm një shtetar, një reformator. Por, qeverisja ka edhe një fytyrë të pistë, pa të cilën, ajo që bëni ju, do të ishte e pamundur. Po rregulli? Po stabiliteti? Po siguria? Jam përpjekur që ju të mos merreni me këto gjëra të këqija. por mos më thoni se nuk dini si sigurohet paqja. Me shumë sakrifica dhe me shumë gjak. Falënderomëni që ju kam lejuar të shikoni vetëm anën tjetër, t'i kushtoheni anës së mirë, kurse unë, Abes Garsia, togeri Penja Rivera dhe të tjerë, të vendosim rregull në këtë vend, që ju të mund të shkruani i qetë poemat dhe fjalimet tuaja. Jam i sigurt se inteligjenca juaj e mprehtë më kupton shumë mirë.

- Hoakin Balageri miratoi. Ishte zverdhur.
- Të mos flasim më për gjëra të pakëndshme, - përfundoi Gjeneralisimi. - Firmoseni gradimin e togerit Penja Rivera, që të publikohet nesër në Gazetën Zyrtare dhe i dërgoni një urim të nënshkruar prej jush.
- Ashtu do të bëj, Shkëlqesi.
- Truhijo vuri dorën para fytyrës së vet, sepse iu duk se do të gogësinte. Qe alarm i kotë. Këtë natë, në Shtëpinë me Mogan, duke thithur aromën e mirë të pemëve dhe bimëve e duke parë mizërinë e yjeve në një qiell të errët si qymyri, nga dritaret e hapura, do të përkëdhelte trupin lakuriq të një vajze të ëmbël e të ndrojtur, me elegancën e Petronios, Zotit të tij, dhe do të ndiente t'i lindte eksitimi midis shalëve të veta, ndërkohë që do të thithte lëngëzimet e ngrohta të seksit të saj. Do t'i ngrihej e do t'i qëndronte i fortë për një kohë të gjatë, si dikur. Do ta bënte atë vajzë të rënkonte e të pshertinte nga kënaqësia, duke u shkrifëruar prej kënaqësisë edhe ai vetë. Kështu do të fshihej kujtimi i keq i asaj budallaqes tjetër si skelet.
- E pashë listën e të burgosurve që qeveria do t'i lirojë, - tha me një ton shpërfillës. - Përveç atij profesorit të Montekristit, Humberto Melendes, nuk kam vërejtje. Veproni. Thërrisni familjet e tyre në Pallatin Kombëtar, të enjten mbasdite. Do të takohen atje me të liruarit.
- Do të filloj procedurën, menjëherë, Shkëlqesi.
- Gjeneralisimi u ngrit në këmbë dhe ia bëri me dorë Presidentit kukull, i cili donte të ngrihej, që të mos lëvizte nga vendi. Nuk po ikte akoma. Donte të çpinte këmbët. Bëri disa hapa përgjatë tryezës.
- A thua do t'i qetësojë ky lirim i ri të burgosurish jankit? - tha

si me vete. - Dyshoj. Henri Dearborni vazhdon me konspiracione. Ka nisur një tjetër sipas Abesit. Dhe Huan Tomas Diasi është brenda.

– Heshtja që dëgjoi pas shpatullave të veta – e dëgjoi si një prani të rëndë, ngjitëse – e çuditshme. U kthye menjëherë për të parë Presidentin kukull: Ishte aty, i palëvizshëm, duke e parë me atë pamjen e tij të përshpirtshme. Nuk u qetësua. Intuita kurrë nuk e kishte gënjyer. Mundet që ky rondokop mikroskopik, ky pigmen, të dinte diçka?

– Keni dëgjuar ju për këtë konspiracion të ri?
– E pa të mohojë me një lëvizje energjike të kokës.
– Do t'ia kisha kallëzuar unë vendit kolonelit Abes Garsia, Shkëlqesi. Siç kam bërë sa herë ka mbërritur tek unë ndonjë pështjellim armiqësore.
– Bëri dhe dy-tri hapa të tjera drejt tryezës, pa thënë asnjë fjalë. Jo. Nëse do të ishte dikush midis tërë njerëzve të regjimit, i pazoti të futej në një komplot, ai do të ishte i maturi President. Ai e dinte mirë se pa Truhijon nuk do të ekzistonte, se Bamirësi ishte lëngu që i jepte jetë, se pa të ai do të zhdukej nga politika përgjithmonë.
– U ndal përpara njërës prej dritareve të mëdha të hapur. I qetë hodhi vështrimin larg, duke parë detin. Retë kishin mbuluar diellin dhe grinë e qiellit, në ajër notonin grumbuj të lehtë resh të lara në argjend; ujërat blu të errëta shndrisnin vende-vende. Një barkëz brazdonte ujërat e gjirit drejt grykëderdhjes së lumit Ozama. Peshkatari duhet të kishte mbaruar punën dhe kthehej për t'u ankoruar. Ecte duke lënë një vazhdë shkume. Edhe pse nga kjo largësi nuk mund t'i shihte, i mori me mend pulëbardhat që klithnin e përplasnin krahët pa pushim. Mendoi me gëzim shëtitjen prej një orë e gjysmë që do të bënte gjatë Maksimo Gomesit dhe Bulevardit, duke thithur ajrin e kripur dhe duke dëgjuar zhaurimën e valëve, pasi të përshëndeste nënën e vet. Nuk do të harronte t'i hiqte veshët shefit të Forcave të Armatosura për atë tubin e prishur te porta e Bazës Ajrore. T'ia fuste hundën Pupo Romanos në atë pellgace të qelbur, pa të shihte nëse do të shiheshin më pamje aq të ndyra në portën e një garnizoni.
– Doli nga zyra e Presidentit Hoakin Balager, pa e përshëndetur.

XV

– Nëse ne, vetë i dytë, po luajmë mendsh nga padurimi, mendo se në ç'gjendje do të jetë Fifi Pastorica, atje, i fill i vetëm, - tha Uaskar Teheda, duke u mbështetur mbi timonin e Oldsmobilit të madh të zi, me katër dyer, i parkuar në kilometrin e shtatë të rrugës San Kristobal.
– Ç'dreqin bëjmë këtu? - tha me tërbim Pedro Livio Sedenjo.
– Dhjetë pa një çerek. Tani nuk vjen më.
– E shtrëngoi karabinën gjysmëautomatike M-1 që mbante mbi gjunjë, si të donte ta thërrmonte. Pedro Livioja ishte i prirur për shpërthime zemërimi. Karakteri i tij idhnak i kishte shkatërruar karrierën ushtarake. E kishin pushuar, kur ishte hapur ten. Vetëm atëherë e pati kuptuar se nga antipatitë që fitonte me karakterin e tij, nuk do të bënte kurrë përpara në hierarki. Iku nga ushtria i dëshpëruar. Në akademinë amerikane, ku studioi, u diplomua me nota të shkëlqyera. Por natyra e tij agresive që e bënte të ndizej si barut, kur ndokush i thoshte Negro apo të qëlluarit me grusht për çfarëdo motivi, ia pengoi karrierën në ushtri, megjithë vlerësimet e shkëlqyera të shërbimit. E zhveshën se i nxori revolen një gjenerali, i cili i hoqi vërejtjen se vëllazërohej shumë si oficer që ishte me trupat. Megjithatë, ata që e njihnin, si shoku i pritës, inxhinieri Uaskar Teheda Pimentel, e dinin se pas asaj pamjeje të sertë, fshihej një njeri i mirë dhe i ndjeshëm, i cili mund të qante (Teheda e kishte parë vetë) për vrasjen e motrave Mirabal, edhe pse nuk i kishte njohur kurrë.
– Dhe padurimi vret, Negro, - bëri shaka Uaskar Teheda.
– Negro i sat ëme.
– Teheda Pimenteli deshi të qeshte, por reagimi i ashpër i shokut, e preku. Pedro Livio nuk ndreqej.
– Më fal, - e dëgjoi të thoshte një çast më vonë. - I kam nervat të shkatërruara nga kjo pritje e mallkuar.
– Edhe unë ashtu jam, Negro. Ptuuu, ta marrë dreqi! Prapë të thashë Negro. Do të më shash prapë nga nëna?

– Kësaj radhe jo, - qeshi Pedro Livio.
– Po pse tërbohesh kur të themi Negro? Ta themi me dashuri, pa të keq, mor burrë.
– E di, e di, Uaskar. Ama, në Shtetet e Bashkuara, në Akademi, kur kadetët apo oficerët më thoshin nigger, nuk ma thoshin për dashuri, por për racizëm. Duhet t'i bëja të më respektonin.
– Kaluan disa autovetura në autostradë, nga perëndimi drejt San Kristobalit, ca për në lindje drejt qytetit Truhijo, por jo Shevroleti Bel Air i Truhijos, i ndjekur nga Shevrolet Biscay-ne i Antonio de la Masës. Udhëzimet qenë të thjeshta: Me t'u afruar të dyja autoveturat, që do të njiheshin nga sinjali i Toni Imbertit – shuarje dhe ndezje tri herë e dritave – do të futnin Oldsmobilin e zi për t'i prerë rrugën Cjapit. Atëherë ai, me karabinën gjysmëautomatike M-1, për të cilën Antonioja i kishte dhënë tjetër municion, dhe Uaskari me Smith&Wesson 9 mm, model 39, me 9 plumba, do të shtinin mbi Cjapin pa u ndalur, bashkë me ata të anës tjetër: Imberti, Amaditoja, Antonioja dhe Turku. Nuk do të kalonte dot. Por, edhe sikur të kalonte, dy kilometra më tej, në perëndim, Fifi Pastorica me Mërkurin dhe Estreja Sadalait, do t'i hidhej përsipër, duke ia mbyllur përsëri rrugën.
– Jot shoqe e di ku je këtë natë, Pedro? - pyeti Uaskar Teheda.
– E di se jam te Huan Tomas Diasi, duke parë një film. Është shtatzënë dhe...
– Pa të kalonte me shpejtësi një autoveturë e ndjekur nga një tjetër, jo më shumë se dhjetë metra që në errësirë iu duk si Shevroleti Biscayne i Antonio de la Masës.
– Mos ishin ata, Uaskar? - tha duke u munduar të shpajë mjegullën me sy.
– A pe t'i shuanin e t'i ndiznin dritat? - bërtiti i shqetësuar Teheda Pimenteli. - A e pe?
– Jo, nuk dhanë sinjal. Po, janë ata.
– Ç'të bëjmë, Negro?
– Nisu, jepi!
– Zemra e Pedro Livios po rrihte me aq forcë, sa nuk e linte të fliste. Uaskari e xhiroi në vend Oldsmobilin. Stopat e kuq të dy autoveturave po largoheshin e po largoheshin dhe së shpejti do t'u humbisnin nga vështrimi.
– Janë ata, Uaskar, duhet të jenë ata. Po pse djalli e marrtë, nuk dhanë sinjal?

– Dritëzat e kuqe tashmë qenë zhdukur. Përpara dukeshin vetëm konet e dritave të Oldsmobilit dhe nata e mbyllur. Retë e kishin fshehur hënën. Pedro Silvio, me karabinën gjysmëautomatike i mbështetur në dritare, mendonte për Ollgën, gruan e vet. Si do të reagonte ajo kur të merrte vesh se burri i saj ishte njëri nga vrasësit e Truhijos? Ollga Despradeli ishte gruaja e tët. Ia kalonin shumë mirë bashkë, sepse Ollga – ndryshe nga gruaja e parë, e cila ia kishte nxirë jetën – kishte një durim të paparë ndaj çasteve shpërthyese të tij, duke iu shmangur, në ato çaste tërbimi, në çdo përplasjeje apo diskutim. Ajo, si një shtëpiake e zonja dhe shumë e pastër, e kishte bërë Pedron të lumtur. Ngjarja do të ishte një befasi e jashtëzakonshme për të. Ajo mendonte se ai nuk e çante kokën fare për politikë, megjithë miqësinë e ngushtë që kishte lidhur kohët e fundit me Antonio de la Masën, gjeneral Huan Tomas Dias dhe inxhinierin Uaskar Teheda, antitruhijistë të njohur. Pak muaj më parë, kur miqtë e tij njëherë filluan të flisnin keq për regjimin, ai heshti si një sfinks dhe nuk dha mendim. Nuk donte të humbiste vendin e punës në Fabrikën Domenikane të Baterive, që i përkiste familjes Truhijo. Punët u kishin shkuar mirë në fabrikë, por kur erdhën sanksionet, ata filluan tatëpjetën.
– Pa dyshim, Ollga e dinte se Pedroja e urrente këtë regjim, sepse gruaja e parë, truhijiste e tërbuar dhe mikeshë e ngushtë e Gjeneralisimit, i cili e kishte bërë edhe guvernatore të San Kristobalit, duke shfrytëzuar pushtetin e saj, kishte ndikuar që në gjyq të merrej një vendim i tillë, që ia ndalonte Pedros të takonte vajzën e vet Adanelën, e cila ishte nën kujdesin e së ëmës. Ndoshta të nesërmen Ollga do të mendonte se ai u fut në këtë komplot për të marrë hak për padrejtësinë që i ishte bërë. Jo, nuk ishte kjo arsyeja pse ndodhej këtu, me armë në dorë, duke vrapuar pas Truhijos. Ai ishte aty – Ollga nuk do ta kuptonte dot – për vrasjen e Mirabaleve.
– Të shtëna janë këto Pedro?
– Po, po, të shtëna. Janë ata, për Zotin! Jepi shpejt, Uaskar.
– Veshët e tij i kishin dalluar mirë të shtënat. Ajo që kishin dëgjuar duke çarë natën, ishte disa breshëri – karabinat e Antonios dhe Amaditos, revolveri i Turkut apo Imbertit – që e mbushën plot gëzim shpirtin e tyre të pikëlluar nga pritja e gjatë. Oldsmobili fluturonte tani mbi asfalt. Pedro Livioja nxorri kokën nga dritarja, po nuk mundi të dallojë Shevroletin

e Cjapit, as të atyre që e ndiqnin. Ja, në një kthesë njohu Mërkurin e Estreja Sadalait dhe për një sekondë, e ndriçuar nga dritat e Oldsmobilit, fytyrën e hequr të Fifi Pastorikës. Edhe Fifin e paskan kaluar, - tha Uaskar Teheda. - Prapë paskan harruar të japin sinjal. Ç'trapër!

– Ja, tek u duk Shevroleti i Truhijos, nja njëqind metra më tutje, i ndaluar dhe i mënjanuar në të djathtë të rrugës me fenerët të ndezur. "Ai është, mor ia bëfsha nënën!" bërtitën Pedroja dhe Uaskari dhe në çast filluan përsëri të shtëna revolveri, pushke dhe automatiku. Uaskari fiku dritat dhe nja dhjetë metra pranë Shevroletit, frenoi me forcë. Pedroja hapi menjëherë derën dhe u vërvit në rrugë, para se të qëllojë. Ndjeu gërvishje dhe goditje në tërë trupin e vet dhe arriti të dëgjojë zërin e hareshëm të Antonio de la Masës të thoshte: "Tani skifteri nuk do të hajë më pula" ose diçka të tillë dhe zëra e britma të Turkut, Toni Imbertit dhe Amaditos. U hodh drejt tyre, qorrazi, por nuk mundi t'i arrinte. Bëri dy-tri hapa të tjerë dhe dëgjoi prapë të shtëna. Tani qenë shumë afër. Një djegie e fortë e ndali në vend dhe u rrëzua, duke shtrënguar barkun me dorë.
– Ej, mos qëlloni, mor qorra, jemi ne! - bërtiste Uaskar Teheda.
– Jam plagosur, - u ankua Pedroja dhe papritmas, ankthshëm, me sa zë kishte: - U vra Cjapi?
– Më i vdekur se të vdekurit, Negro, - tha në krah të tij Uaskari. - Shikoje!
– Pedro Livioja ndjeu se po e linin forcat. Kishte rënë përtokë, midis hedhurinave dhe copave të qelqeve. Dëgjoi dikë t'i thoshte Uaskar Tehedës të shkonte të gjente Fifi Pastoricën dhe ndjeu Oldsmobilin që u nis. Dëgjonte entuziazmin dhe harenë e miqve të tij, por ndihej i trullosur dhe nuk mund të shkëmbente fjalë me ta. Mezi kuptonte çfarë thoshnin, sepse e gjithë vëmendja e tij qe përqendruar tani te zjarri që kishte në stomak. Edhe krahu i digjte. Të kishte marrë dy plumba? e gjithë shtëpia e tij po rrotullohej. Dalloi thirrjet e Fifi Pastoricës: "Vaftë në esfel, në të s'ëmës! Zoti është i madh, vëllezër!"
– Ta futim në bagazh, - urdhëroi Antonio de la Masa tepër i qetë. - Duhet t'ia çojmë kufomën Pupos për të vazhduar Planin.
– I ndiente duart të lagëta. Ai lëng i trashë dhe ngjitës duhet të ishte vetëm gjak. I tij, apo i Cjapit? Asfalti qe i lagur. Shi nuk kishte rënë. Duhej të ishte gjak. Dikush i vuri dorën në

sup dhe e pyeti se si ndihej. Zëri i tij tingëllonte i trishtuar. E njohu që ishte Salvador Estreja.

- Një plumb në stomak, besoj, - në vend të fjalëve, i dilnin ca tinguj grykorë.
- Shqoi siluetat e shokëve të vet që ngrinin diçka të rëndë dhe po e futnin në bagazhin e Shevroletit të Antonios. Ky është Truhijo, e marrtë djalli! Më në fund ia kishin arritur. Ndjeu më shumë lehtësim, sesa gëzim.
- Po shoferi ku është? Nuk e pa njeri Zakariasin?
- Edhe ai, i stërvdekur, atje në errësirë, - tha Toni Imberti.
- Mos humb kohë ta kërkosh, Amadito. Duhet të ikim. E rëndësishme është t'ia çojmë këtë kufomë Pupo Romanit.
- Pedro Livioja është i plagosur, - thirri Salvador Estreja.
- E kishin mbyllur bagazhin e Shevroletit me kufomën brenda. Silueta pa fytyra e rrethonin Pedron, i fërkonin shpatullat, e pyesnin si ndihej. A do t'ia jepnin goditjen e fundit? Ashtu e kishin vendosur së bashku. Nuk do ta linin shokun e plagosur të binte në duart e kacefëve që, pastaj, Xhoni Abesi ta torturonte e ta poshtëronte. Kujtoi atë bisedë në kopshtin me mango, flambojanë dhe fikusësh të gjeneralit Huan Tomas Dias dhe gruas së tij Çana, ku ishte dhe Luis Amiama Tio. Të gjithë ranë në një mendje: Kurrsesi, vdekje prej torturave. Po të dilte keq dhe ndonjë mbetej i plagosur rëndë, do t'i jepej goditja e fundit. Do të vdiste? Do ta vrisnin shokët e tij?
- Futeni në autoveturë! - urdhëroi Antonio de la Masa. - Të shtëpia e Huan Tomasit. Do të thërrasim një mjek.
- Hijet e shokëve të tij po mundoheshin të nxirrnin autoveturën e Cjapit në autostradë. I ndiente tek dihasnin. Fifi Pastorica vërshëlleu: "Qenka bërë pellg, ta marrë dreqi, ta marrë!"
- Kur shokët e ngritën për ta futur në Shevroletin Biscayne, dhimbja qe aq e fortë sa humbi ndjenjat. Por për pak sekonda erdhi në vete dhe pa se ende nuk qenë nisur. Ishte në vendin prapa, Salvadori i kishte kaluar krahun shpatullave dhe po e mbështeste mbi gjoksin e vet si mbi një jastëk. Njohu Toni Imbertin në timon dhe në krah të tij, Antonio de la Masën. Si je, Pedro? Deshi të thoshte: "Me Cjapin e vrarë, më mirë", por nxorri vetëm një mërmërimë.
- Puna e Negros është serioze, - tha nëpër dhëmbë Imberti.
  Qëllonte që miqtë e tij t'i thoshnin Negro, kur nuk ishte i pranishëm. Po ç'rëndësi kishte kjo. Ishin miqtë e tij, dreqi ta

hajë. Askujt nuk do t'i bënte dora të shtinte mbi të. Të gjithëve iu duk e natyrshme ta fusnin në makinë dhe tani e çonin në shtëpi të Çanës dhe Huan Tomas Diasit. Djegia në stomak dhe në krah qe pakësuar. Ndihej i këputur dhe nuk përpiqej të fliste. Mendjen e kishte të kthjellët dhe kuptonte me hamendje se çfarë thoshnin. Edhe Toni, Antonioja e Turku, me sa duket qenë plagosur, por lehtë. Antonioja e Salvadori kishin marrë plagë të lehta nga gërvishtje plumbash. I pari në ballë dhe i dyti në kokë. Fshinin gjakun me shamitë që kishin në duar. Tonit një kapsulle i kishte çarë sisën e majtë dhe ankohej se gjaku po i njolloste këmishën dhe pantallonat.

- Njohu godinën e Llotarisë Kombëtare. A thua kishin marrë rrugën e vjetër Sançes, për t'u kthyer në qytet nga një rrugë me sa më pak trafik? Jo, nuk ishte për këtë. Toni Imberti donte të kalonte nga shtëpia e mikut të tij Hulito Senjor, që jetonte në bulevardin Anhelita dhe t'i telefononte që andej gjeneralit Dias për ta lajmëruar se po ia çonin kufomën Pupo Romanit, me frazën e caktuar qysh më parë: "Zojtë janë gati për t'u turr në furrë, Huan Tomas". U ndalën para një shtëpie në errësirë. Toni zbriti nga makina. Nuk dukej asnjeri përreth. Pedro Livioja dëgjoi Antonion të thotë se Shevroleti i tij i shkretë ishte shpuar nga dhjetëra plumba dhe një gomë i ishte shfryrë. Pedroja e kishte ndier, i shkaktonte një si gërrmimë të tmerrshme dhe një troshitje që i dërrmonte stomakun.
- Imberti u kthye. Nuk kishte njeri në shtëpinë e Hulito Senjorit. Më mirë të shkonin drejt e te Huan Tomasi. U nisën nga dalë. Makina e anuar dhe duke kërkëllitur, u shmangej bulevardeve dhe rrugëve me shumë njerëz.

Salvadori u përkul mbi të:

- Si je, Pedro?
- Mirë, Turko, mirë, - bëri të thoshte dhe i shtrëngoi krahun.
- Ja, edhe pak. Te Huan Tomasi do të vizitojë një mjek.
- Sa keq që s'ka forcë t'u thuash miqve të tu të mos shqetësohen, t'u thuash se je i kënaqur për vdekjen e Cjapit. U ishte marrë haku motrave Mirabal dhe të ziut Rufino de la Krus, shoferit që i çoi ato në Fortesën e Puerto Platës për të vizituar burrat e burgosur, të cilin Truhijo urdhëroi ta vrisnin për të bërë më të besueshëm farksën e aksidentit. Vrasja e Mirabaleve i kishte tronditur fijet më intime Pedro Livios dhe e kishte nxitur, qysh nga 25 nëntori i vitit 1960 të futej në përbetimin

që kishte organizuar miku i tij Antonio de la Masa. Motrat Mirabal i njihte vetëm me të dëgjuar. Por, si shumë domenikanë, tragjedia e vajzave të Salsedos e kishte prekur thellë. Hëm, tani po vriteshin edhe gratë e pambrojtura, si pa gjë të keq! Deri aty kishte arritur turpi në Republikën Domenikane? Nuk kishte më burra ky vend, e marrtë djalli! Duke dëgjuar Antonio Imbertin të fliste aq i tronditur – ai gjithmonë përmbahej t'i shfaqte ndjenjat – për Mirabalet, kishte qërë përpara miqve të vet, për herë të parë në jetën e tij prej burri. Po Republika Domenikane kishte ende burra. Prova ishte kjo kufomë që troshitej në bagazh.

– Po vdes! - bërtiti. - Mos më lini të vdes!
– Ja, arritëm, Negro, - e qetësoi Antonio de la Masa. - Tani do të të mjekojmë.

– Bëri një përpjekje për të mos humbur vetëdijen. Pak më tej njohu kryqëzimin e Maksimo Gomesit me bulevardin Bolivar.

– E patë atë autoveturën zyrtare? - tha Imberti. - Mos ishte gjenerali Roman?
– Pupoja është në shtëpi, duke pritur, - u përgjigj Antonio de la Masa. - I tha Amiamës e Huan Tomasit se s'do të dilte sonte.
– Tmerrësisht vonë autovetura u ndal. Kuptonte nga biseda e miqve të tij se ndodheshin në hyrjen e pasme të shtëpisë së gjeneral Diasit. Dikush po hapte portën. Hynë në oborr dhe qëndruan përballë garazheve. Nën dritën e dobët të fenerëve të rrugës dhe të dritareve, njohu kopshtin plot pemë dhe lule që Çana e kishte aq kujdes, dhe ku, kushedi sa të diela, kishte ardhur vetëm ose me Ollgën, dhe ku, kushedi sa herë, kishin ngrënë darkat tradicionale që gjenerali përgatiste për miqtë e vet. Në të njëjtën kohë, i dukej se nuk ishte ai, por një soditës, i çoroditur nga tërë ajo lëvizje njerëzish. Këtë pasdite, kur mori vesh se do të ishte në pritë, u përshëndet me të shoqen, duke i thënë se do të vinte te kjo shtëpi për të parë një film, Ollga i futi një pesë në xhep dhe i kërkoi t'i sillte akullore me çokollatë e vanilje. E shkreta Ollga! Shtatzënia i jepte teka oreksi. Mos nga kjo e papritur mund të humbiste fëmijën? Jo, o Zot! Fëmija do të ishte vajzë dhe do të bëhej çift me Luis Marienon, birin e tij dy vjeç. Turku, Imberti dhe Antonioja kishin zbritur. Ishte vetëm, i shtrirë në kolltukun e Shevroletit, në gjysmëerrësirë. Mendoi se askush nuk do ta shpëtonte dot nga vdekja dhe se do të vdiste pa ditur kush e fitoi ndeshjen që luhej këtë natë midis ekipit të

fabrikës së tij Bateria Herkul dhe Kompanisë Domenikane të Aviacionit në fushën e bejsbollit të Brirarisë Kombëtare Domenikane.
Shpërtheu një diskutim i ashpër në oborr. Estreja Sadalai u bërtiste Fifit, Uaskarit dhe Amaditos, të cilët sapo kishin mbërritur me Oldsmobil, sepse kishin lënë në vend Mërkurin e tij. "Budallenj! Idiotër! Kuptoni apo jo? Më keni tradhtuar! Duhet të shkoni tani menjëherë të gjeni makinën time." Situatë e çuditshme: Të ndihesh që je dhe nuk je aty. Fifi, Uaskari dhe Amaditoja qetësonin Turkun. Nga nxitimi, ishin hutuar dhe asnjëri nuk qe kujtuar për autoveturën e tij. Po ç'rëndësi kishte, gjeneral Romani do ta merrte pushtetin pikërisht atë natë. Nuk kishte pse të shqetësohej. Tërë vendi do të dilte në rrugë për të brohoritur ndëshkuesit e tiranit.

– E kishin harruar fare atë? Zëri plot autoritet i Antonio de la Masës vendosi rregull. Askush nuk do të kthehej në rrugë, sepse rruga ishte plot me kalecë. Kryesorja ishte të takonin Pupo Romanin dhe t'i tregonin kufomën, siç kishte porositur. Por kishte një problem: Huan Tomas Diasi dhe Luis Amiama sapo shkuan në shtëpinë e tij – Pedro Livioja e dinte që ndodhej në cepin tjetër – dhe Mireja, gruaja e tij, u tha se Pupoja kishte dalë me gjeneralin Espijat, "sepse, më duket, i kishte ndodhur diçka Shefit". Antonio de la Masa i qetësoi: "Mos u alarmoni. Luis Amiama, Huan Tomas Diasi dhe Modesto Diasi kanë shkuar të kërkojnë Bibin, vëllanë e Pupos. Ai do të na ndihmojë ta gjejmë se ku është".
– Po, e kishin harruar fare atë. Do të vdiste në këtë autoveturë të bërë shoshë, pranë kufomës së Truhijos. Pati një nga ato shpërthimet e inatit, që kishin qenë fatkeqësia e jetës së tij, po aty për aty u qetësua. Kujt do t'i shërbesh po të tërbohesh në këto çaste, mor hajvan?
– Puliti qepallat, sepse një dritë e fuqishme baterie i ra mbi fytyrë. I njohu, të ngjeshura me njëra-tjetrën, fytyrat e dhëndrit të Huan Tomas Diasit, të dentistit Bienvenido Garsias, të Amaditos dhe atë të... Të qe Linitoja? Po, Linitoja, mjeku, doktor Marselino Veles Santana. Përkuleshin mbi të, e preknin, i ngrinin këmishën. E pyetën për diçka që nuk e kuptoi. Deshi t'u thoshte se dhimbja e qeshur dhe t'i shihnin sa vrima plumbi kishte në trup, po nuk i doli zëri. I mbante sytë të hapur me zor, që të shihnin se ishte gjallë.

- Duhet çuar në klinikë, - vendosi doktori Veles Santana. - Po humbet gjak.
- Doktorit i kërcisnin dhëmbët, sikur po vdiste nga të ftohtët. Nuk qenë aq miq sa Linitoja të dridhej nga keqardhja për të. Dridhej sepse sapo kishte marrë vesh se kishin vrarë Shefin.
- Ka hemoragji të brendshme, - tha me zë të dridhur, - një plumb i ka hyrë në zonën prekordiale. Duhet operuar shpejt.
- Bisedonin. Nuk kishte rëndësi se po vdiste. Mbi të gjitha ndihej i kënaqur. Zoti, sigurisht, do ta falte që po e braktiste Ollgën gjashtëmuajshe me barrë, dhe Luis Marienon. Zoti e dinte se ai nuk kishte fituar asgjë nga vdekja e Truhijos. Përkundrazi, administronte njërën nga kompanitë, kishte vënë në rrezik punën dhe sigurinë e familjes së tij. Zoti do ta kuptonte dhe do ta falte.
- Ndjeu një tkurrje të fortë në stomak dhe bërtiti. "Qetësohu, qetësohu, Negro!", iu lut Uaskar Teheda. Pati dëshirë t'i përgjigjej "Negro i sat'ëme", po nuk mundi. E nxorrën nga Shevroleti. I kishte fare pranë fytyrën e Bienvenidos – dhëndrit të Huan Tomasit, burrit të Marienelës – dhe atë të doktor Veles Santanës, të cilit akoma i kërcisnin dhëmbët. Njohu Miriton, shoferin e gjeneralit Amaditon që po çalonte. Me shumë kujdes, e vendosën te Opeli i ndaluar pranë Shevroletit. Pedro Livioja pa hënën: ndriçonte përmes mangos dhe trinitarias në një qiell, tani, pa re.
- Do të shkojmë te Klinika Internacionale, Pedro, - tha doktor Veles Santana. - Duro, mbahu ca.
- Gjithnjë e më pak i interesonte se ç'do të ndodhte. Ishte në Opel, Miritoja e ngiste, Bienvenidosja rrinte përpara, prapa, pranë tij qe doktor Veles Santana. Linitoja i jepte për të nuhatur diçka me erë të fortë eteri. "Aromë karnavalesh". Dentisti dhe mjeku i jepnin kurajo: "Ja, mbërritëm, Pedro" Nuk i interesonte fare se çfarë thoshnin, as se çfarë ishte më e rëndësishme për Bienvenidos dhe Linidon: "Ku shkoi gjeneral Romani? Nëse nuk duket, kësaj i thonë të tallesh". Ollga, në vend të akullores me çokollatë e vanilje, do të marrë lajmin se burri i saj po operohet në Klinikën Internacionale, tre bllorqe nga Pallati, pasi ka ndëshkuar vrasësin e Mirabaleve. Pak blloqe qenë nga shtëpia e Huan Tomasit deri te Klinika. Pse po vonoheshin aq?

Më në fund Opeli frenoi. Bienvenidosja dhe doktor Veles Santana zbritën. I pa të trokisnin te porta ku përshëndetej një dritë floreshente: "URGJENCA". U duk një infermiere me skufje të bardhë dhe më pas një barrelë. Kur Bienvenido Garsia dhe Veles Santana po e ngrinin nga vendi, ndjeu dhimbje të tmerrshme: "Më lënduat, e marrtë djalli!" Puliti sytë nga bardhësia e një korridori. E ngjitën me një ashensor. Tani ndodhej në një dhomë të pastër, me ikonën e një virgjëreshe në krye. Bienvenidoja dhe Veles Santana ishin zhdukur. Dy infermiere e zhveshën dhe një djalë i ri me mustaqe e goditi në fytyrë.

– Jam doktor Hose Hoakin Pejo. Si ndihesh?
– Mirë, mirë, - mërmëriti, i lumtur që po i vinte zëri. - Është e rëndë plaga?
– Do t'ju jap diçka për dhimbjen, - i tha doktor Pejo. - Ndërkohë do t'ju përgatitim. Duhet nxjerrë plumbi nga aty brenda.
– Mbi supet e mjekut u dukën një fytyrë e njohur, ballëgjerë dhe me sy të mëdhenj, depërtues: doktori Arturo Damiron Rikart, pronar dhe shef i kirurgjisë së Klinikës Internacionale. Nuk ishte i qeshur dhe dashamirës, si zakonisht, por i zemëruar. I kishin treguar gjithçka Bienvenidoja dhe Linitoja?
– Ky injeksion është për t'ju përgatitur, Pedro, - e parandaloi. - Mos ki frikë, qëndro i fortë. Do të lajmërosh të tutë?
– Ollgën jo, është shtatzënë, nuk dua ta tremb. Më mirë i thoni kushërirës time, Maries.
– Zëri po i dilte më i fortë. U dha telefonin e Marie Despradelit. Hapet sapo i kishte gëlltitur, injeksioni dhe shishet me dezinfektant që infermieret i kishin derdhur mbi krah dhe stomak, i kishin bërë mirë. Tani nuk ndiente më se do të humbiste ndjenjat. Doktor Damiron Rikarti i vuri dorezën e telefonit në dorë. "Po, po?"
– Jam Pedro Livio, Marie. Jam te Klinika Internacionale. Një aksident. Mos i thuaj gjë Ollgës, mos e tremb. Do të më operojnë.
– O Zot i madh! Po nisem për aty, Pedro.
– Mjekët e ekzaminonin, e lëviznin, po ai nuk i ndiente duart e tyre. E kishte pushtuar një siguri e madhe. Me tërë kthjellësinë e mendjes i tha vetes se për miqësinë që kishte, Damiron Rikarti nuk mund të informonte SIM-in për mbërritjen në urgjencë të një njeriu të plagosur me plumb, siç ishin të detyruar ta bënin të gjithë klinikat dhe spitalet. Mjekët dhe

infermieret që s'e bënin, futeshin në burg. Ndryshe, aty do të suleshin ata të SIM-it për të bërë të tyrën. Por, jo. Huan Tomasi, Antonioja, Salvadori, tani i kishin treguar Pupos kufomën dhe Romani do të kishte ngritur ushtrinë dhe njoftuar Juntën qytetaro-ushtarake. Kushedi, në këto çaste, ushtarakët besnikë ndaj Pupos, arrestonin dhe likujdonin Abes Garsian dhe bandën e tij të vrasësve, fusnin në burg qelizat dhe miqtë e ngushtë të Truhijos dhe populli do të ishte duke u derdhur në rrugë, i thirrur nga radiot që njoftonin vdekjen e tiranit. Qyteti kolonial, parku Indipendenca, El Konde, rrethinat e Pallatit Kombëtar, do të përjetonin një festë të vërtetë, duke kremtuar lirinë. "Ç'dënim të ndodhësh në tavolinën e operacionit, në vend që të jesh duke vallëzuar, Pedro Livio."

– Dhe ja tek pa fytyrën e përlotur dhe tmerrin e së shoqes:
"Ç'është kjo, zemra ime, ç'të ka ndodhur, ç'të kanë bërë?!" Ndërsa e përqafonte dhe e puthte Ollgën, duke u përpjekur ta qetësonte ("një aksident, e dashur, mos ki frikë, do të më operojnë."), njohu kunatën dhe kunatin e vet, Marien dhe Luis Despradel Braçen. Ky ishte mjek dhe po pyeste doktor Damiron Rikartin mbi operacionin. "Pse e bëre këtë, Pedro?" "Që bijtë tanë të jetojnë të lirë, e dashur." Ajo e mbyti së pyeturi, pa pushuar të qarit. "O Zot, je mbytur në gjak!" Duke e lënë të lirë përroin e emocioneve të përmbajtura, e rrëmbeu të shoqen në krahët e veta dhe duke e parë në sy, bërtiti:
– Është i vdekur, Ollga! I vdekur! I vdekur!
– Ndodhi si në filma, kur imazhi ngrin dhe del nga koha. I vinte për të qeshur, duke parë mosbesimin që shfaqnin Ollga, kunatit e tij, infermieret dhe doktorët.
– Mbylle gojën, Pedro, - mërmëriti doktor Damiron Rikarti.
– Të gjithë panë nga dera. Ishte zhurma e një rrëmuje hapash, njerëz duke përplasur takat, pa e çarë kokën për tabelat "Qetësi" që vareshin në mure. Pedro Livioja njohu në çast, midis siluetave ushtarake, fytyrën e flashkët, gushën e dyfishtë të trashë, mjekrën e shkurtër dhe sytë rrethuar nga mollëza të fryra të Xhoni Abesit.
– Mirëmbrëma, - tha ky, duke shikuar Pedro Livion, por duke iu drejtuar të tjerëve. - Kini mirësinë, të dilni jashtë. Doktor Damiron Rikart?! Ju qëndroni, doktor.
– Është burri im, - u qaravit Ollga, duke e marrë për qafe Pedron. - Dua të rri me të.

– Nxirreni! - urdhëroi Abes Garsia, pa ia hedhur sytë.
Kishin hyrë edhe më njerëz në dhomë, sigurimsa me revolverë në brez dhe ushtarakë me automatikë "San Kristobal" në krah. Me sytë gjysmëmbyllur, pa ta merrnin Ollgën që po qante ("Mos i bëni gjë, është shtatzanë"), Marien dhe kunatin e tij, i cili po i mbronte ato nga të shtyrat. Po e shikonin Pedron me kureshtje dhe neveri. Ai dalloi gjeneralin Feliks Hermida dhe kolonelin Figeroa Karrion, të cilët i kishte njohur në Ushtri. Thonnin se Karrion ishte krahu i djathtë i Abes Garsias në SIM.
– Si është? - pyeti Abesi doktorin, me një zë tëngëllues dhe të ngadaltë.
– Rëndë, kolonel, - u përgjigj doktor Damiron Rikarti. - Plumbi duhet të jetë afër zemrës, mbi epigastrio. I dhamë ilaçe për t'i ndaluar hemoragjinë dhe për ta operuar.
Shumë prej tyre pinin cigare dhe tymi mbushi dhomën. Sa dëshirë kishte për një cigare, të thithje një Salem me mentol, me aromë freskuese, nga ata që pinte Uaskari dhe që u ofronte Çana Diasi në shtëpinë e saj.
Përsipër kishte fytyrën e mufatur të Abes Garsias, me sytë me qepalla të rëna si të breshkës, që i dukej sikur e shtypte.
– Ç'ju ka ndodhur juve? - dëgjoi t'i thotë me të butë.
– Nuk e di, - u pendua. Përgjigja e tij nuk mund të ishte më idiote. Por as që donte t'ia dinte.
– Kush t'i futi ata plumba? - nguli këmbë Abes Garsia pa zemërim.
Pedro Livio Sedenjoja heshti. E pabesueshme që kurrë nuk e kishin menduar, në tërë ata muaj, ndërsa përgatisnin ekzekutimin e Truhijos, një situatë të tillë si kjo që po përjetonte. Asnjë alibi, asnjë përgjigje dredhuese për t'iu shmangur pyetjeve. "Ç'idiotë!"
– Një aksident, - dhe përsëri u pendua për atë gënjeshtër aq të trashë.
Abes Garsia nuk po e humbiste durimin. Kishte një qetësi alarmuese. Pedro Livioja i ndiente, të rënda, armiqësore, vështrimet e atyre që e rrethonin. Kokat e cigareve skuqnin, kur i vinin në gojë.
– Tregomë për aksidentin, - tha shefi i SIM-it me të njëjtin ton.
– Më qëlluan kur po dilja nga një bar, më qëlluan nga një autoveturë. Nuk e di kush.

– Nga një bar?
– Nga bari Biondi, në rrugën Palo Hinkado, nga parku Indipendenca.
Në pak minuta sigurimsat provuan se kishte gënjyer. Miqtë e tij, duke mos e përmbushur betimin për t'i dhënë goditjen e fundit atij që do të mbetej i plagosur, i kishin bërë nder të zi.
– Ku është Shefi? - pyeti Xhoni Abesi. Njëfarë emocioni i kishte depërtuar në pyetjen e tij.
– Nuk di gjë, - fyti filloi t'i ngushtohej. Përsëri po humbiste forcat.
– Është i gjallë? - pyeti shefi i SIM-it. Dhe përsëri: - Ku është?
Edhe pse ndiente përsëri marramendje dhe shenjat e një humbjeje ndjenjash, Pedroja vuri re se nën në pamjen e qetë të shefit të SIM-it ziente shqetësimi. Dora me të cilën shpinte cigaren në gojë, lëvizte me ngadalësi, duke kërkuar buzët.
– Shpresoj se në ferr, nëse ka ferr, - tha. - Atje e dërguam.
Fytyra e Abes Garsias, disi e fshehur nga tymi, as këtë herë nuk u turbullua. E shikonte në sy, dhe Pedroja e duronte atë vështrim, duke kujtuar fëmijërinë e vet në Higej, kur luanin në shkollë se kush do të puliste sytë i pari. Dora e kolonelit u ngrit, mori cigaren e ndezur nga buzët e veta e pa ndërruar pamje, ia ngjeshi në fytyrë, pranë syrit të majtë. Pedro Livioja nuk bërtiti, as u ankua. Mbylli sytë. Djegia qe e tmerrshme. I erdhi era e mishit të përcëlluar. Kur hapi sytë, aty vazhdonte të ishte Abes Garsia. Tortura kishte filluar.
– Këto gjëra, nëse nuk bëhen tamam, më mirë të mos bëhen fare, - e dëgjoi të thoshte. - E di kush është Zakarias de la Krus? Shoferi i Shefit. Ndodhet në Spitalin Marion. Nga andej po vij. Fola me të. Është më keq nga ti, i grirë prej plumbave nga koka te këmbët. Por i gjallë. Siç e shikon, nuk ju shkoi. Je i mbaruar. Po as për të vdekur nuk të lemë. Do të jetosh dhe do të na tregosh për çdo gjë që ndodhi. Kush qe me ty në rrugë?
Pedro Livioja fundosej, dilte mbi ujë, në çdo çast ishte gati të villte. A nuk kishin thënë Toni Imberti dhe Antonioja se Zakarias de la Krus kishte vdekur? Thua gënjente Abes Garsia për t'i nxjerrë emrat? Ç'budallenj. Duhet të ishin siguruar që edhe shoferi i Cjapit të kishte vdekur.
– Imberti tha se Zakariasi ishte i vdekur se i vdekur, - protestoi. E habitshme, je ti apo ndonjë tjetër.

Fytyra e shefit të SIM-it u përkul. Ndjeu erën e rëndë të duhanit në frymën e tij. Sytë e veckël i kishte të zymtë dhe të bardhë e sytë të zverdhur. Ah sikur të kishte forca t'i kafshonte ato faqet bullafiqiqe e të qullëta. Të paktën t'ia pështynte.

– Ka gabuar, vetëm sa ishte plagosur, - tha Abes Garsia. - Kush Imbert?
– Antonio Imberti, - sqaroi ai i përhumbur nga ankthi. - Pra, më gënjeu? Në djall, në djall, vaftë! - Ndjeu hapa, lëvizje trupash, të pranishmit po ngjisheshin rreth shtratit. Tymi shpërndahej mbi fytyra. Ndiente bllokim frymëmarrjeje, si t'i shkelnin mbi gjoks.
– Antonio Imberti dhe kush tjetër, - i thoshte në vesh koloneli Abes Garsia. Iu rrethqeth mishi duke menduar se kësaj here do t'i fusnin në sy cigaren e ndezur dhe do të mbetej me një sy.
– Imberti komandon? Ai e organizoi këtë?
– Jo, nuk ka shef, - bëlbëzoi, i tmerruar se forcat nuk do ta linin ta mbaronte frazën. - Po të kishte, do të ishte Antonioja.
– Antonio kush?
– Antonio de la Masa. - shpjegoi. - Po të kishte, do të ishte ai, sigurisht. Por nuk ka shef. Pati prapë një qetësi të gjatë. T'i kishin dhënë pentotal sodico që u bë kaq fjalaman? Por, me pentotal njeriu vihet në gjumë, kurse ai qe i zgjuar, i tejnxitur, me dëshirë për të treguar, për të nxjerrë nga brenda ato sekrete që i gërryenin zorrët. Do të vazhdonte të tregonte për çfarë do t'i kërkonin. Dreq o punë! Mërmërima, hapa që rrëshqisnin mbi mbi pllaka. Po iknin? Ndaj portët që hapet e mbyllet.
– Ku janë Imberti dhe Antonio de la Masa? - shefi i SIM-it nxori një shtëllungë tymi dhe Pedros iu duk se iu fut nga gryka e nga hunda dhe i zbriti në stomak.
– Duke kërkuar Pupon, ku mutin do të jenë. - Do të kishte fuqi për ta mbaruar fjalinë? Çudia e Abes Garsias, gjeneral Feliks Hermidas dhe kolonel Figeroa Karrionit, ishte aq e madhe, sa bëri një përpjekje mbinjerëzore për t'u shpjeguar atë që nuk kuptonin: - Nëse nuk e shikon kufomën, nuk do të lëvizë as gishtin.
Kishin hapur sytë jashtë mase dhe hetonin me mosbesim e tmerr bashkë.
– Pupo Romanin? - tani po, Abes Garsia kishte humbur sigurinë.

– Gjeneral Roman Fernandesin? - përsëriti Figeroa Karrioni
– Shefi i Forcave të Armatosura? - thirri gjeneral Feliks Hermida, i shpërfytyruar.
Pedro Livioja nuk u habit që ajo dorë të binte përsëri dhe t'i ngjiste cigaren e ndezur në gojë. Një shije e hidhur duhani dhe hiri në gjuhë. Nuk pati fuqi ta pështynte atë pleh të qelbur dhe djegës që i përvëloi mishin e dhëmbëve dhe qiellzën.
– I ra të fikët, kolonel, - dëgjoi të mërmëriste doktor Damiron Rikarti. - Nëse nuk e operojmë, do të vdesë.
– Ai që do të vdesë, nëse nuk e merr veten ky, jeni ju, - ia ktheu Abes Garsia me zemërim të shurdhër. - Bëni transfuzion apo çfarë duhet, por që të përmendet. Ky subjekt duhet të flasë, përndryshe jua futa në trup gjithë plumbat e këtij revolveri.
Me që flisnin ashtu, nuk kishte vdekur. Do ta kishin gjetur Pupo Romanin? Do t'ia kishin treguar, vallë, kufomën? Nëse do të kishte filluar revolucioni, as Abes Garsia, as Feliks Hermida, as Figeroa Karrion nuk do të ishin te krevati i tij. Do të ishin të burgosur ose të vdekur, si vëllezërit dhe nipërit e Truhijos. U përpoq më kot t'u kërkonte shpjegim se përse nuk ishin në burg apo të vdekur. Stomaku nuk i dhimbte, i dhimbnin qepallat dhe goja nga djegia me cigare. Po i bënin injeksion dhe i kishin vënë në hundë pambuk që vinte era mentol si cigare Salem. Pa një shishe me serum pranë shtratit të vet. I dëgjonte, por ata nuk besonin.
– Të jetë e vërtetë? - Figeroa Karrion dukej më shumë i bur, sesa i habitur. - Ministri i Forcave të Armatosura i futur në këtë? E pamundur, Xhoni.
– E çuditshme, absurde, e pashpjegueshme, - e rregulloi Abes Garsia. - Por, jo e pamundur.
– Pse, për çfarë? - ngrinte tonin gjeneral Feliks Hermida. - Ç'do të fitojë? I detyrohet Shefit për gjithçka është, për gjithë çfarë ka. Ky qelbanik lëshon emra për të na ngatërruar me duket.
Pedro Livioja u shtrëmbërua dhe u përpoq të ngrihej, që ta merrnin vesh se nuk i kishte rënë të fikët, as i vdekur dhe që kishte thënë të vërtetën.
– Ti nuk do ta besosh se e tëra kjo është një komedi e Shefit për të zbuluar se cilët janë besnikët dhe cilët të pabesët, Feliks, - tha Figeroa Karrion.
– Jo, ore, jo, - pranoi i trishtuar, gjeneral Hermida. - Nëse

këta maskarenj e kanë vrarë, ç'dreqin do të ndodhë me këtë vend?
Koloneli Abes Garsia i ra ballit me dorë:

- Tani e mora vesh pse më thirri Romani në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. E qartë që është përzier në këtë. Do të shtjerë në dorë njerëzit e besuar të Shefit për t'i futur brenda, para se të realizojë grushtin e shtetit. Nëse do të kisha shkuar, tani do të isha i vdekur.
- Për djall, nuk më besohet, - përsëriste gjeneral Feliks Hermida.
- Dërgo patrullat e SIM-it të bllokojnë Urën Radames, - urdhëroi Abes Garsia. - Që askush nga qeveria dhe, mbi të gjitha, nga të afërmit e Truhijos, të mos kalojnë Ozamen, as të mos i afrohen fortesës "18 Dhjetori".
- Ministri i Forcave të Armatosura, gjenerali Hose Rene Roman, burri i Mireja Truhijos, - monologonte i trullosur gjenerali Feliks Hermida. - Nuk po marr vesh asgjë, ta hajë dreqi.
- Besoje dhe mos dysho se është i përfshirë, - tha Abes Garsia. - Tani vrapo të kujdesesh për vëllezërit e Shefit. Të mblidhen në Pallatin Kombëtar. Mos u thuaj gjë për Pupo Romanin. Thuaju që qarkullojnë fjalë për atentate. Fluturo! Si është subjekti? Mund ta pyes?
- Është duke vdekur, kolonel, - e siguroi doktor Damiron Rikarti. - Si mjek, detyra ime...
- Detyra juaj është të mbyllni gojën, nëse nuk doni të trajtoheni si bashkëpunëtor.
Pedro Livioja pa edhe një herë shumë afër fytyrën e shefit të SIM-it. "Nuk po vdes", mendoi. "Doktori gënjeu që të mos vazhdojnë më të më fikin më cigare në fytyrë".
- Gjeneral Romani ju dërgoi për të vrarë Shefin? - Prapë në hundë dhe në gojë era e ndyrë e kolonelit. - Është e vërtetë kjo?
- Po e kërkojnë t'i tregojnë kufomën, - klithi. - Ashtu është ai. Shikoje që ta besosh. Do të shikosh edhe çantën.
Mundimi e rrapashkiti edhe më. Në këto çaste, u tremb se mos agjentët do ta digjnin me cigare në fytyrë edhe Ollgën. O Zot, ç'dënim! Do të humbiste fëmijën, do të mallkonte fatin që e martoi me ish-kapitenin Pedro Livio Sedenja.
- Çfarë çante? - pyeti shefi i SIM-it.
- Çanta e Truhijos, - u përgjigj në vend, duke i shqiptuar mirë

fjalët. - Gjithë gjak nga jashtë dhe plot peso e dollarë brenda.

– Me çfarë iniciale? - nguli këmbë koloneli. - Inicialet RLTM, metalike?
Nuk mundi të përgjigjej, kujtesa e tradhtonte. Toni dhe Antonioja e gjetën në makinë, e hapën dhe thanë se ishte plot me peso domenikane dhe dollarë. Miliona. Dalloi shqetësimin e shefit të SIM-it. Ah, maskara, çanta të bindi që është e vërtetë, që e kanë vrarë për atë.
– Kush tjetër është përzier në këtë punë? - e pyeti Abes Garsia. - Më jep emrat, në do që të të çojnë në sallën e operacionit e të të nxjerrin plumbat. Kush tjetër?
– E gjetën Pupon? - pyeti ai, i gjallëruar e rrëmbyeshëm. - Ia treguan kufomën? Edhe Balagerit?
Koloneli Abes përsëri shtrëngoi nofullat. Ishte aty i habitur nga të papriturat dhe shqetësimi. Ishte duke fituar në njëfarë mënyre, betejën e fshehtë.
– Balagerit? - tha, rrokje për rrokje e germë për germë. - Presidentit të Republikës?
– Është në Juntën qytetaro-ushtarake, - sqaroi Pedroja, duke u munduar të përmbante të përzierat. - Unë isha kundër. Po thonë se është i nevojshëm për të qetësuar OEA-n.
Kësaj here e përziera nuk ia la kohën të anonte kokën për të vjellë jashtë shtratit. Diçka e ngrohtë dhe e trashë i rrodhi nëpër gushë dhe i njollosi gjoksin. Pa shefin e SIM-it të prapësohej nxitimthi. Kishte të prera të forta dhe ftohtë deri në palcë. Tashmë nuk mund të fliste dot. Për pak çaste fytyra e kolonelit i qëndroi përsipër, përsëri e deformuar nga paduria. E shikonte si të donte t'i futej në tru për të zbuluar gjithë të vërtetën.
– Edhe Hoakin Balageri?!
I rezistoi atij vështrimi vetëm disa sekonda. Mbylli sytë. Donte të flinte. Ose të vdiste. Ç'rëndësi kishte. Dëgjoi dy-tri herë pyetjen: "Edhe Balageri?" Nuk u përgjigj, as i hapi sytë. Po ashtu, as foli, as i hapi sytë, edhe kur djegia e tmerrshme në tulin e veshit të djathtë, e bëri të tkurrej. Koloneli i kishte fikur cigaren atje dhe tani po ia përdridhte e po ia dërrmonte veshin. Nuk bërtiti dhe as lëvizi. Pedro, kështu mbarove, i kthyer në tavëll cigaresh për shefin e spiunëve?! Eh, djalli e mori! Cjapi i vdekur. Të flesh. Të vdesësh. Nga honi i thellë ku po binte, vazhdonte të dëgjonte Abes Garsian. "Një beato si

ai duhet të ishte duke komplotuar me priftërinjtë. Është një komplot i peshkopëve, i lidhur me gringot". Heshtje e madhe, e përzier me mërmërima dhe ja, për një çast, lutja e ndrojtur e doktor Damironit: Nëse nuk atë ndërhyjmë, pacienti do të vdesë. "Por unë atë dëshiroj, të vdes", mendonte Pedro Livioja.

Vrapime, hapa të nxituara, një përplasje dere. Dhoma qe mbushur prapë me njerëz dhe midis të ardhurve ishte përsëri koloneli Figeroa Karrion:

– Kemi gjetur një protezë dhëmbësh në rrugë pranë Shevroletit të Shkëlqesisë së Tij. Është duke e ekzaminuar dentisti i tij, doktor Fernando Kamino Sertero. E zgjova vetë. Për një gjysmë ore do të na japë informacion. Në pamje të parë dukej se ishte e Shefit.

Zëri i tij qe i kobshëm. Po ashtu dhe qetësia me të cilën dëgjonin të tjerët.

– Nuk gjetë gjë tjetër? - Abes Garsia fliste duke kafshuar ato që thoshte.
– Një pistoletë automatike, kalibër .45, - tha Figeroa Karrioni. - Do të na hajë disa orë verifikimi i kontrollit. Ka një autoveturë të braktisur, nja dyqind metra prej vendit të atentatit. Një Mërkuri.

Pedro Livioja mendoi se Salvadori kishte të drejtë të zemërohej me Fifi Pastorizën që e braktisi autoveturën e tij në mes të rrugës. Kalecët do ta identifikonin të zotin, e brenda pak kohe do të nisnin të nisin me cigare edhe fytyrën e Turkut.

– Nxorri më gjë?
– Balagerin, asgjë më, - tha si me fështëllimë Abes Garsia. - Merr vesh? Shefi i Forcave të Armatosura dhe Presidenti i Republikës. Foli për një Juntë qytetaro-ushtarake, ku do të përfshinin edhe Balagerin për të qetësuar OEA-n.

Koloneli Figeroa Karrion lëshoi një "në djall!" tjetër.

– Është një manovër për të na humbur gjurmët. Futin emra të rëndësishëm, i ngatërrojnë të gjithë.
– Edhe mund të jetë, do ta shohim, - tha koloneli Abes. - Një gjë është e sigurt. Janë futur shumë njerëz në këtë valle, tradhtarë të rangut të lartë. Dhe, sigurisht, priftërinjtë. Duhet nxjerrë peshkopi Reji nga Kolegji Santo Domingo. Më të mirë ose me të keq.
– Ta çojmë në Kuarenta?

– Jo, se atje do të shkojnë ta kërkojnë sa ta marrin vesh. Më mirë në San Isidro. Po prit, është me rrezik, duhet të konsultohemi me vëllezërit e Shefit. Nëse ka ndonjë që nuk është në komplot, është gjenerali Virhilio Garsia Truhijo. Shko dhe informoje, personalisht.
Pedro Livioja ndjeu hapat e kolonel Figeroas duke u larguar. Të kishte mbetur vetëm me shefin e SIM-it? Do ta digjte më me cigare? Por nuk ishte ajo që e mundonte tani. Por po mësonte se, edhe pse e kishin vrarë Truhijon, gjërat nuk kishin dalë siç ishte planifikuar. Pse Pupoja nuk po e merrte pushtetin te urdhëra kalecëve për arrestimin e peshkopit Reji? Akoma vazhdonte të komandonte ky gjakatar i degjeneruar? E kishte gjithmonë mbi vete. Nuk e shikonte, po aty ishte. Fryma e keqe e tij i futej në hundë dhe në gojë.
– Ca emra të tjerë dhe ju do të të shlodhesh, - dëgjoi t'i thoshte.
– Nuk ju dëgjon dhe nuk ju shikon, kolonel, - iu përgjigjua doktor Damironi. - Është në komë.
– Operojeni, atëherë, - tha Abes Garsia. - E dua të gjallë, dëgjojeni mirë. Jeta juaj varet nga jeta e këtij subjekti.
– Ju nuk mundeni të më merrni më shumë, - dëgjoi Pedrojazërin psherëtimë të mjekut. - Unë kam vetëm një jetë, kolonel.

XVI

– Manuel Alfonsoja?! - hallë Adelina vuri dorën te veshi si të mos kishte dëgjuar, por Urania e dinte që e vjetra dëgjonte shumë mirë dhe e bënte për të shfaqur çudinë. Edhe Lusinda dhe Manolita e shikonin me sy të shqyer. Vetëm Marianita nuk duket e habitur.
– Po, ai, Manuel Alfonsoja, - përsërit Urania. - Një emër pushtuesi spanjoll. E ke njohur, hallë?
– E kisha parë ndonjëherë, - pranon plaka e hutuar dhe me e fyer. - Po ç'ka të bëjë ai me marrëzinë që the për Agustinin?
– Ishte playboy që i gjente femrat Truhijos, - e kujton Manolita. - Apo jo, mama?
"Playboy, playboy", këlthet Samsoni. Këtë herë qesh veç mbesa.
– Ishte djalë shumë i pashëm, një bukurosh, - thotë Urania. - Para kancerit.
Kishte qenë domenikani më i hijshëm i brezit të tij, por gjatë javëve apo muajve që Agustin Kabrali nuk e kishte parë, ky gjysmëperëndi, eleganca dhe bukuria e të cilit në bënin vajzat të ndalnin e ta shikonin, qe kthyer në një hije të vetvetes. Senatori s'donte t'u besonte syve. Manuel Alfonsoja duhet të kishte rënë dhjetë ose pesëmbëdhjetë kile; i holluar, i tretur, me ca rrathë mavi përqark ca syve të thellë, dikur të qeshur e të kënaqur. Vështrimi i gazmorit dhe buzëqeshja e ngadhnjimtarit, tashmë nuk ishin më. Ai kishte dëgjuar për një tumor të vogël poshtë gjuhës, të zbuluar rastësisht nga dentisti, kur Manueli, akoma ambasador në Uashington, po bënte pastrimin vjetor të dhëmbëve. Thoshnin se lajmi e kishte prekur Truhijon, si të ishte zbuluar tumori te ndonjëri nga djemtë e vet dhe ai nuk iu nda telefonit kur Manuel Alfonson po e operonin në Klinikën Majo, në Shtetet e Bashkuara.
– Të kërkoj thellësisht ndjesë që vij e të shqetësoj, kur sapo ke mbërritur, Manuel, - Kabrali u ngrit në këmbë, me të parë të hyjë i zoti i shtëpisë në sallonin ku ai po priste.

– I dashur Agustin, ç'gëzim, - Manuel Alfonsoja e përqafoi. - Më kupton? U desh të më hiqnin pjesë nga gjuha. Por me pak terapi do të flas përsëri normalisht. Mund të më kuptosh?
– Plotësisht, Manuel. Nuk dalloj asgjë të rrallë te zëri yt, të siguroj.
Nuk ishte e vërtetë. Ambasadori fliste sikur përtypte guriçka, si të kishte freth në gojë apo të ishte bëlbacuk. Nga ngërdheshjet në fytyrë dukej se i kushtonte mundim çdo frazë.
– Ulu, Agustin. Një kafe? Ndonjë gotë?
– Asgjë, faleminderit. Nuk do të të ha shumë kohë. Edhe një herë, të kërkoj falje për bezdinë dhe të uroj shërim të shpejtë nga operacioni. Jam në një situatë shumë të vështirë, Manuel.
Zëri i turpëruar. Manueli i vuri dorën miqësisht mbi gju.
– E marr me mend, Inteligjent. Vend i vogël, llafazanëri e madhe: Deri në shtetet e Bashkuara mbërritën fjalët. Se u shkarkove nga Presidenca e Senatit dhe se po hetojnë mbi drejtimin tënd në Ministri.
Sëmundja dhe vuajtjet e kishin plakur domenikanin e hijshëm. Dikur, fytyra e përsosur dhe dhëmbët e rregullt e bënë të bardhë të Manuelit, e kishin habitur Gjeneralissimusin në udhëtimin e tij të parë zyrtar në Shtetet e Bashkuara. Falë Shefit, fati i Manuel Alfonson kishte pësuar një përmbysje të ngjashme me atë të Hirushes, të prekur nga shkopi magjik. Edhe tani vazhdonte të ishte ende një burrë elegant, i veshur si manekin, njësoj si në rininë e vet të emigrantit domenikan në Nju Jork: këpucë kamosh, pantallona kadife ngjyrë kremi, këmishë mëndafshi italian dhe një shall të hollë për gushe. Në gishtin e vogël i shkëlqente një unazë floriri. Ishte përherë i rruar, i parfumuar dhe i krehur bukur.
– Të falënderoj shumë që më prite, Manuel, - Agustin Kabrali rimori forca. Gjithmonë i kishte përbuzur njerëzit që mallëngjeheshin për vetveten. - Je i vetmi. Jam kthyer në një murtajë. Askush nuk do të më presë.
– Unë nuk i harroj nderet që më ke bërë, Agustin. Gjithmonë ke qenë bujar, me ke mbështetur të gjitha emërimet e mia në Kongres, më ke bërë një mijë favore. Do të bëj ç'të mundem. Çfarë akuzash bëjnë kundër teje?
– Nuk e di, Manuel. Po t'i dija do të mundja të mbrohesha. Deri tani askush nuk më thotë se ç'gabime kam bërë.

- Po, shumë i pamshëm. Të gjithave na dridhej zemra kur e shikonim, - pohon e padurueshme, hallë Adelina. - Po ç'lidhje ka ai me ato që the për Agustinin.
  Uranisë i është tharë fyti dhe pi disa gllënjka uji. Po pse ngul këmbë të flasë për këtë gjë? Për çfarë?
- Sepse Manuel Alfonso qe i vetmi midis gjithë miqve të tij, që u përpoq ta ndihmojë babanë? Këtë nuk e ke ditur. As ju, kushërira.
  Të trija e shikojnë, si të mos ishte në vete me ato që thoshte.
- E po, jo, nuk e di, - mërmërit hallë Adelina. - U përpoq ta ndihmonte kur e zuri e keqja? Je e sigurt?
- Shumë e sigurt. E di edhe pse babai nuk jua tregoi as ty, as xhaxha Anibalit bisedën që bëri Manuel Alfonsoja me të për ta nxjerrë nga ajo situatë e keqe.
  Hesht sepse hyn në dhomë shërbëtorja haitiane, e cila pyet në spanjishte të pasigurt e të njëtrajtshme, nëse kishin nevojë për të apo të shkonte të flinte. Lusinda e heq qafe, duke i bërë shenjë me dorë: ik, na lër të qetë.
- Kush ishte Manuel Alfonsoja, teze Urani? - pyet me një fill zëri Marianita.
- Njëfarë personazhi, moj mbesë. I hijshëm dhe nga familje e shkëlqyer. Kishte shkuar në Nju Jork për të kërkuar fatin dhe përfundoi duke pozuar me kostume modelistësh dhe dyqanesh luksoze, duke dalë në pllakatat e reklamave të rrugës, me gojën hapur për të propaganduar "Colgate", pastën që freskon, pastron dhe u jep shkëlqim dhëmbëve. Në një udhëtim në Shtetet e Bashkuara, Truhijo mësoi se bandilli i afisheve ishte një tigër domenikan. Dërgoi t'ia sillnin dhe e kompromentoi. E bëri një njeri me vlerë: Përkthyesin e tij, ngaqë fliste anglisht shkëlqyeshëm; mësuesin e vet të protokollit dhe të etiketës, ngaqë ishte një profesionist elegant. I dha funksione të tjera shumë të rëndësishme: T'i zgjidhte kostumet, gravatat, këpucët, çorapet dhe rrobaqepësit nju jorkezë që e vishnin. Ai ia siguronte përditë të dhënat për modën e fundit për burra. E ndihmonte në dizenjimin e uniformave të tij, një hobi për Shefin. - Apo
- Mbi të gjitha, i zgjidhte femrat, - e ndërpreu Manolita. - Apo jo, mama?
- E mirë de, po ç'ka të bëjë e gjithë kjo me tim vëlla, moj xhaxha? - përplasi grushtin e vogël me zemërim hallë Adelina.

– Femrat ishin gjëja më e vogël, - vazhdon të sqarojë Urania të mbesën. - Pak i interesonte Truhijos kjo gjë, sepse ai i kishte në dorë të gjitha femrat. Rrobat dhe stolitë po, i interesonin shumë. Manuel Alfonsoja e bënte të ndihej i zgjedhur, i përsosur, elegant. Si Petronio te "Quo Vadis?", të cilin gjithmonë e citonte.
– Nuk e kam parë akoma Shefin, Agustin. Do të më presë sot mbasdite në shtëpinë e tij, në Vila Radames. Do ta diskutoj, të premtoj.
E kishte lënë të fliste pa e ndërprerë, duke u mjaftuar me miratimin në heshtje, ndërkohë që senatorit i kishte rënë morali. Pikëllimi dhe anktheia ia prishnin zërin. I tregoi ambasadorit ç'kishte ndodhur, ç'kishte thënë, ç'kishte bërë dhe ç'kishte menduar këto dhjetë ditë, qëkur u duk letra e parë në "Forumin Publik". Iu zbraz të gjitha gjitha dyfetet e koshme, duke i treguar pari që e priti ngrohtë qeshta nga dita e kobshme, duke i treguar hollësi intime të jetës së vet, jetë të cilën, qush njëzetvjeçar, ia kishte kushtuar njeriut më të rëndësishëm të historisë domenikane. A është e drejtë të mos pranojë ta dëgjohet atë, njeriun që për tridhjetë vjet rresht jeton për të? Ishte i gatshëm të pranonte gabimet e veta, nëse i kishte bërë ato. Të bënte një shqyrtim të ndërgjegjes. T'i shlyente gabimet e mia, nëse ekzistonin. Po Shefi t'i kushtonte, të paktën, pesë minuta. Manuel Alfonsoja ia vuri përsëri dorën mbi gju.
Shtëpia në lagjen e re Përroi i Thellë ku jetonte, ishte e madhe, e rrethuar me park, e mobiluar dhe e stolisur me shije të hollë. I pagabueshëm për të zbuluar te njerëzit pasuritë e fshehura thellë - aftësi që gjithmonë e kishte çuditur Agustin Kabralin - Shefi e kishte njohur me rrënjë e dhëmballë modelin e vjetër të Nju Jorkut. Mauel Alfonsoja ishte i aftë, falë pamjes simpatike dhe dhuntisë së gojtarisë, të luante me lehtësi në botën e diplomacisë dhe të siguronte përfitime për regjimin. E kishte bërë këtë gjë në të gjitha misionet, sidomos në atë të fundit në Uashington, periudha më e vështirë, kur Truhijo e bëri të kalonte nga një fëmijë i përkëdhelur i qeverisë janki, në një shqetësim të madh për ta, i sulmuar nga shtypi dhe shumë parlamentarë. Ambasadori e vuri dorën në fytyrë në një gjest dhembjeje.
– Ndonjëherë s'dimë nga na vjen e keqja, - tentoi ta zbuste.

– Kështu më ka ndodhur edhe mua. Po shpresoj që kirurgu të më ketë thënë të vërtetën. Ngaqë e kapën në kohë. Suksesi garantohet nëntëdhjetë për qind. E pse të më gënjente? Gringot ia thonë troç, nuk e kanë delikatesën tonë, nuk bian anash.
Pushon, sepse një cëmbisje tetë i ngërdhesh fytyrën e rrënuar. Reagon në çast, përkeqësohet, filozofon:
– E di ç'po ndodh me ty dhe si ndihesh, Inteligjent. Gjatë njëzet vjetëve miqësi me Shefin, më ka ndodhur edhe mua nja dy herë kështu. Nuk arriti në këto kufij si me ty, por u largua, pati një ftohtësi që nuk mundja ta shpjegoja. E kujtoj atë shqetësim të madh dhe vetminë që më pushtuan. E kisha humbur fare toruan. Por çdo gjë u sqarua dhe Shefi përsëri më nderoi me besimin e tij. Duhet të jetë një intrigë e ndonjë zilqari, i cili të urren për talentin tënd, Agustin. Por ti e di, Shefi është i drejtë. Sonte do të flas me të. Të jap fjalën.
Kabrali u ngrit në këmbë, i mallëngjyer. Kishin mbetur ende njerëz të ndershëm në Republikën Domenikane.
– Do të jem tërë ditën në shtëpi, Manuel, - tha, duke i shtrënguar dorën fort. - Mos harro t'i thuash se jam gati të bëj gjithçka për të rifituar besimin e tij.
– Unë mendoja për të si për një artist të Hollivudit, Tyrone Power apo Errol Flynn, - thotë Urania. - Dhe ngela tepër e zhgënjyer kur e pashë atë natë. Nuk ishte fare ai që njihja. I kishin hequr gjysmën e gurmazit. Gjithçka mund të qe por jo më një bukurosh.
Hallë Adelina, të kushërirat dhe e mbesa e dëgjojnë në qetësi, duke shkëmbyer shikime me njëra-tjetrën. Madje edhe papagalli Samson duket i interesuar, sepse ka qaste që nuk pushon së dërdëllituri.
– Ti je Urania, vajza e Agustinit? Ua, sa qenke rritur e zbukuruar, moj vogëlushe! Të mbaj mend që kur ishe një bebe. Pa eja këtu, më jep një të puthur.
– Fliste duke u mbllaçitur dhe dukej si i mangët nga mendja. U soll plot dashuri me mua. Nuk mund t'i besoja se ai, i shpërfytyruari, ishte Manuel Alfonsoja.
– Dua të flas me babanë tënd, - tha ai, duke bërë përpara për të hyrë brenda. - E po, sa e bukur qenka bërë! Kush e di sa do të plagosësh në jetë. Këtu është Agustini? Shko, lajmëroje.

Ishte takuar me Truhijon dhe vinte drejt nga Vila Radames në shtëpinë tonë për të treguar ç'kishte folur me Shefin. Babai nuk mund të besonte. I vetmi që nuk më ktheu shpinën, i vetmi që më shtriu dorën, përsëriste.

– Mos më parë ndonjë ëndërr për atë bisedë të Manuel Alfonsos? - hidhet hallë Adelina e turbulluar. - Agustini do të kishte ardhur menjëherë ta tregonte mua dhe Anibalit.
– Mami, lere të vazhdojë, mos e ndërprit, - ndërhyri Manolita.
– Atë natë iu zotova për një gjë Zonjës sonë të Altagrasias, po që se do ta ndihmonte babain të dilte nga ajo e keqe e madhe. E përfytyroni çfarë?
– Që të mbylleshe në manastir? - qesh e kushërira, Lusinda.
– Do të qëndroja e pastër tërë jetën, - qesh Urania.
Qeshën edhe të kushërirat dhe e mbesa, pa dëshirë, po edhe pa druajtje. Hallë Adelina qëndroi serioze, pa ia hequr sytë së mbesës dhe pa e fshehur padurimin e vet. Po më, Urani, hë fol?!
– Sa qenka rritur e sa qenka zbukuruar kjo vajza jote, - përsërit Manuel Alfonsoja, duke u rehatuar në kolltuk, përballë Agustin Kabralit. - Më kujton të ëmën. Po ata sy të përhumbur, po ai trup i hollë e i hijshëm i sat'shofeje, Inteligjent.
Ky e falënderon me një buzëqeshje. E ka shpurnë ambasadorin në stadion e vet dhe jo në sallon, për të mos u dëgjuar biseda e tyre nga vajza dhe shërbëtorët. E falënderon prapë që ka marrë mundimin t'i vijë në shtëpi, në vend që ta thërriste në shtëpinë e vet.
Senatori flet me rrëmbim, duke ndier se çdo fjalë i del nga zemra. Kishte mundur të fliste me Shefin?
– Sigurisht që fola, Agustin. Të premtova dhe e bëra. Folëm për ty rreth një orë. Nuk do të jetë e lehtë. Po nuk duhet humbur shpresa. Kjo është kryesorja.
Mbante një kostum të errët me prerje të përsosur, një këmishë të bardhë me jakë të ngrirë dhe një gravatë blu me pika të bardha, kapur me një perlë. Një shamiçkë mëndafshi e bardhë, nxirrte krashtën nga xhepi i vogël, në gjoksin e xhaketës. Me t'u ulur, i ngriti pak pantallonat për t'i ruajtur nga zhubravitjet, duke bërë kështu t'i dukeshin çorapet blu, pa asnjë rrudhë. Këpucët i shkëlqenin.
– Është shumë i lënduar nga ti, Inteligjent, - duket që plaga

e sëmbonte Alfonson se, herë-herë bënte ca përdredhje të çuditshme me buzë dhe Agustin Kabrali dëgjonte t'i kërcisnin dhëmbët. - Nuk është vetëm një gjë, por shumë gjëra të mbledhura këta muajt e fundit. Shefi ka një intuitë të habitshme. Asgjë nuk i shpëton. Dallon ndryshimet më të vogla te njerëzit. Thotë se që kur filloi kjo krizë: Karta Pastorale, ngatërresat me OEA-n, të nxitura nga majmuni Betankur dhe miu Munjos Marin, ti paske ardhur duke u ftohur. Se nuk ke treguar vetëmohimin që ai priste. Senatori miratonte: Nëse këtë gjë e kishte vënë re Shefi, ajo do të ishte e vërtetë. Por, sigurisht, nuk ishte asgjë e paramanduar dhe, akoma më pak, e shkaktuar nga një ulje e admirimit dhe besnikërisë. Diçka e pavetëdijshme, nga lodhja, tensioni i tmerrshëm i këtij vitit të fundit, komploti kontinental kundër Truhijos, nga komunistët e Fidel Kastros, nga priftërinjtë, Uashingtoni dhe Departamenti i Shtetit, nga Figeresi, Munjosi, Marini e Betankuri, sanksionet ekonomike, poshtësitë e të arratisurve. Po, po, ishte e mundur që atij, Agustinit, pa dashje t'i kishte rënë rendimenti në punë, në Parti, në Kongres.

– Shefi nuk pranon rënie, as dobësi, Agustin. Dëshiron që të gjithë të jenë si ai. Shkëmbij, të hekurt. Ti e di.

– Dhe ka të drejtë, - Agustin Kabrali goditi skriveninë e tij të vogël. - Duke qenë i tillë, e bëri këtë vend. Siç ka thënë vetë në fushatën e viiti 1940, ai ka vrapuar gjithmonë si kali, Manuel. Ka të drejtë të na kërkojë të ecim në gjurmët e tij. E kam rrahur gjoksin me dëshirë, pa e ditur. Ndoshta ngaqë s'arrita dot të bëja dëmshpërblim pas asaj Kartës së ndyrë Pastorale. Unë isha në atë komision me Balagerin dhe Paino Piçardon. A thua, të jetë për atë dështim?

Ambasadori mohoi me kokë:

– Puna jote është delicate. Edhe pse ndihet i fyer për këtë, nuk më tha gjë. Ndoshta është njëra nga arsyet e shumta. Duhet ta kuptojmë. Tridhjetë e një vjet me radhë i tradhtuar nga njerëz, të cilët i ndihmoi aq shumë. Si të mos preket njeriu, kur miqtë e vet më të afërt i ngulin thikën pas shpine?

– Më kujtohet parfumi i tij, - thotë Urania, pas një hopi. - Qysh nga ajo kohë, nuk ju gënjej, sa herë kam afër ndonjë burrë të parfumuar, më del përpara Manuel Alfonsoja. Madje dëgjoj

edhe zhargonin e tij në të folur, në ato dy takime ku pata nderin të kënaqem në shoqërinë e tij.

Dora e saj e djathtë çingëriti mbulesën e tavolinës. E ëmta, të kushërirat dhe e mbesa, të hutuara nga armiqësia dhe sarkazma e saj për atë atin, rrinë si në gjemba.

– Urani, nëse kjo histori të shqetëson, më mirë mos e trego, - ndërhyri Manolita.
– Më shqetëson shumë, më sjell të përziera, - i përgjigjet Urania. - Më mbush me urrejtje dhe neveri. Kurrë nuk kam folur me njeri për këtë. Po bën ndoshta më mirë ta tregoj me veten, njëherësh. Dhe me kë më mirë se me njerëzit e mi?
– Ç'mendon ti, Manuel? Do të më japë Shefi tjetër mundësi?
– Pse nuk kthejmë nga një gotë uiski, Inteligjent? - u hodh ambasadori, duke i bishtnuar pyetjes dhe lëvizi me nervozizëm duart, si të përzinte qortimin. - E di që nuk duhet. Ma kanë ndaluar alkoolin. Bah! A ia vlen të jetosh i privuar nga gjërat e mira. Ja, ky uisk marke është prej tyre.
– Më fal, nuk të ofrova asgjë deri tani. Patjetër. Edhe unë do të pi një gotë me ty. Zbresim poshtë në sallë me mirë. Urania tani do të jetë në gjumë.

Po ajo ende s'ka shkuar për të fjetur. Sapo ka mbaruar së ngrëni darkën. Ngrihet në këmbë, tek i sheh që po zbresin shkallët.

– Ishe fëmijë kur të kam parë herën e fundit, - i thotë Manuel Alfonsoja, duke qeshur. - Tani je një zonjushe shumë e bukur. Ti as që e ke vënë re ndryshimin, Agustin.
– Natën e mirë, babi, - Urania puth të atin. Do t'i japë dorën mysafirit, po ky i jep faqen. Ajo e puth, duke u skuqur nga turpi. - Natën e mirë, zotni.
– Më thirr xhaxhi Manuel, - dhe ai e puth në ballë.

Kabrali i thotë maxhordomit dhe shërbëtores se mund të largohen ndërsa e sjell shishen e uiskit, gotat dhe kovkën me copa akulli. I shërben mikut, mbush gotën edhe për vete.

– Gëzuar, Manuel.
– Gëzuar, Agustin.

Ambasadori, me sytë gjysmë të mbyllur, përplas qiellzën nga kënaqësia. "Ah, sa i këndshëm!", klith. Por me sa duket, ka vështirësi për të çuar lëngun poshtë, se i shtrembërohet fytyra nga dhimbja.

– Kurrë nuk jam dehur, kurrë nuk e kam humbur kontrollin e veprimeve të mia, - thotë. - Ama, gjithmonë kam ditur ta gëzoj jetën. Edhe kur më është dashur të mendoja se ç'do të haja të nesërmen, kam ditur të përfitoj të gjithë nga kënaqësitë e gjërave të vogla: Një gotë pije të mirë, një cigare të mirë, një peizazh, një pjatë me mish dhe salcë të shijshme, një femër që përdridhet me lezet në lastuar.
Qesh, nostalgjik. Kabrali e imiton, pa dëshirë. Si ta kthente te çështja e vetme që e interesonte? Për politesë, e mposht padurimin e vet. Ka ditë që nuk ka pirë asnjë gotë dhe tani dy-tri gllënjka e turbullojnë. Megjithatë, pasi mbush përsëri gotën e Manuelit, mbush edhe të vetën.
– Askush nuk mund të thotë se ke qenë mushtuk ndonjëherë për para, Manuel, - përpiqet ta lajkatojë. - Gjithmonë të kujtoj elegant, të mrekullueshëm, bujar, duke paguar gjithmonë në tavolinë.
Ish-modeli, duke trazuar gotën, pranon i kënaqur. Drita e shandanit i bie në fytyrë dhe vetëm tani Kabrali vë re blanjën e dredha-dredha përgjatë fytit. E rëndë duhet të jetë për një njeri, dikur tepër krenar për fytyrën dhe trupin e vet të hijshëm, të copëtohet ashtu me thikë.
– Unë e di ç'do të thotë uri, Inteligjent. Kur kam qenë i ri në Nju Jork kam fjetur edhe në rrugë si një vagabond. Shpesh e vetmja gjellë për mua ka qenë një pjatë supë ose një copë bukë e thatë. Pa Truhijon, kushedi cili do të kishte qenë fati im. Edhe pse më kanë pëlqyer gjithmonë gratë, kurrë nuk munda të bëhesha një zhigolo, si Profirio Rubirosa ynë i mirë. Më e mundshmja ishte të përfundoja horë rrugësh në Bowery.
Ktheu ç'i kishte mbetur në gotë. Senatori ia mbushi prapë.
– I detyrohem shumë. Gjithçka kam dhe ç'kam arritur të jem. - Ai këqyri kokëulur copat e akullit. - Kam ndenjur krah për krah me ministra dhe presidentë të vendeve më të fuqishëm, më kanë ftuar në Shtëpinë e Bardhë, kam luajtur poker me Presidentin Truman, kam shkuar në festat e Rokfelerëve. Tu-morin ma hoqën në Klinikën Majo, më e mira në botë dhe nga kirurgu më i mirë të Shteteve të Bashkuara. Kush pagoi për operacionin tim? Shefi. E kupton, Agustin? Si i gjithë atdheu, edhe unë i detyrohem shumë Truhijos, për gjithçka.
Agustin Kabrali u pendua që gjithmonë, në rrethe të ngushta, në "Country Club", Kongres apo në ndonjë vilë pushimi

fundjavor, pra midis miqve të afërt (i pandehte të afërt), kishte hedhur romuze kundër ish-reklamaxiut të "Colgate", i cili qe ngarkuar me funksione të larta diplomatike apo bënte detyrën e këshilltarit të Truhijos për sapunët, pudrat, parfumet që i duheshin Shkëlqesisë së Tij dhe që, me shijen e tij të hollë, zgjidhte gravatat, kostumet, këmishët, pizhamat e këpucët që stolisnin Shefin.

– Edhe unë i detyrohem për të gjitha çfarë jam dhe çfarë kam bërë, Manuel, - siguroi. - Të kuptoj shumë mirë. Prandaj jam i gatshëm të bëj gjithçka për të rifituar miqësinë e tij.
Manuel Alfonsoja e pa duke zgjatur kokën. Nuk tha asgjë për një hop të gjatë, por vazhdoi ta hetonte, si të donte t'i peshonte çdo grimë të fjalëve të tij.
– E po t'i përvishemi punës atëherë, Inteligjent.
– Ishte burri i dytë që më bënte komplimente, pas Ramfis Truhijos, - thotë Urania. - Se isha e bukur, se i ngjaja mamasë sime, se sa sy të bukur kisha, etj. Kisha qenë në festa dhe kisha vallëzuar me djem. Nja pesë a gjashtë herë. Por kurrë nuk më kishte folur njeri ashtu. Sepse edhe komplimenti i Ramfisit në festë, ishte si t'i bëhej një fëmije. I pari që më bëri komplimente si një femër qe xhaxhi im, Manuel Alfonsoja.
I tha të gjitha këto shpejt, me zemërim të verbër, por asnjëra nga të afërmet e saj s'e pyeti për asgjë. Qetësia në sallonin e vogël të ngrënies, dukej se po i paraprinte bubullimave të zhurmshme të furtunave të verës. Nga larg natën e shpon një sirenë. Samsoni përpiqet nervos në kafazin e tij të drunjtë, duke shpuzuruar pendët.
– Më dukej një plak, më vinte për të qeshur për mënyrën e tij të të folurit, aq shtrënguar, dregëza e tij në gushë më trembte, - Urania lidh duart. - Unë as që ua varja veshin komplimenteve të tij në ato çaste. Por më vonë i kam kujtuar shumë ato lule që më hodhi. Përsëri heshti e dërmuar. Lusinda bën një koment: - "Ti ishe katërmbëdhjetëvjeçe, vjeç, apo jo?" - Uranisë kjo i duket marrëzi. Lusinda e di shumë mirë që janë në të njëjtën moshë. Katërmbëdhjetë, ç'moshë gënjeshtare. Nuk ishin më fëmijë, por ende nuk ishin zonjushe.
– Tre ose katër muaj më parë më kishin ardhur periodat për herë të parë, - pështjelloi. - Ishin para kohe, më duket.

- Më erdhi ashtu, befas, në mendje. Me ta parë tët bijë kur hyra, më shkoi mendja, - thotë ambasadori dhe zgjat dorën për të mbushur edhe një gotë, po ashtu ia mbush edhe të zotit të shtëpisë. - Gjithmonë ka ndodhur ashtu: i pari shefi, pastaj unë. Sikur u shqetësove, Agustin. Mos gabova? E po zëre se s'thashë gjë, harroje. Unë e harrova. Hajde, gëzuar!
- Senatori Kabral pi pak. Uiski i djeg fytin dhe sytë i skuqen. A thua këndoi gjeli në këtë orë?
- Kështu që... puna është se... - përpiqet, po nuk di ç'të thotë më.
- Ta harrojmë. Mos ma merr për keq, Inteligjent. Harroje. E lamë.
- Manuel Alfonsoja ngrihet në këmbë. Çapitët midis mobiljeve të rëndomta të sallës së vallës që rregulluar e pastruar, por që i mungon dora femërore e një zonje të vërtetë shtëpie. Senatori Kabral mendon - sa herë, vallë, e ka menduar në këto vite? - nëse bëri mirë që nuk u martua më pas vdekjes së të shoqes. Të ishte martuar, të kishte të tjerë fëmijë, mbase nuk do t'i kishte ndodhur kjo fatkeqësi. Po pse nuk e bëri? Për Uranitën, siç u thoshte të gjithëve? Jo. Për t'i kushtuar më shumë kohë Shefit, t'i jepte ditët dhe netët e veta, t'i tregonte se asgjë dhe askush nuk ishte më i rëndësishëm se ai në jetën e Agustin Kabralit.
- Nuk ta mora për keq, - bën një përpjekje të madhe për t'u dukur i qetë. - Ngaqë jam ca i shpërqendruar. Diçka që nuk e prisja, Manuel.
- Beson se është ende e vogël, nuk e ke marrë vesh që është kthyer në një grua, - Manuel Alfonsoja i tund që të tringëllijnë kubkat e akullit në gotë. - Një vajzë e bukur. Duhet të jesh krenar që ke një vajzë të tillë.
- Sigurisht, - shton Agustini ngathët: - Ka qenë gjithmonë e para në klasën e saj.
- E di çfarë, Inteligjent? Unë nuk do të hezitoja aspak. Jo për të fituar besimin e tij, as për t'i treguar se jam i ajtë për çdo sakrificë për të. Thjesht, sepse asgjë nuk do të më jepte më shumë kënaqësi, më shumë lumturi, se sa ajo që Shefi ta kënaqte një vajzë timen, dhe të kënaqej edhe ai vetë me të. Nuk e teproj, Agustin. Truhijo është shembull i atyre anomalitve të historisë si Karli i Madh, Napoleoni, Bolivari: Është nga ai

soj. Forca të Natyrës, instrumente të Zotit, bërës popujsh. Ai është njëri nga ata, Inteligjent. Kemi pasur privilegjin të jemi në krah të tij, të shohim si vepron, të bashkëpunojmë me të. Kjo nuk ka çmim.

– Ai kthen gotën e vet, ndërsa Agustin Kabrali shpie të vetën në buzë, por vetëm sa i lag ato. E ka kapërcyer marramendjen dhe tani ndien një përmbysje në stomak. Në çdo çast mund të vjellë.

– Është ende një fëmijë, - belbëzon.
– Akoma më mirë! - klith ambasadori. - Shefi do ta çmojë edhe më shumë gjestin. Do ta kuptojë se ka gabuar, se është nxituar në gjykim, i udhëhequr nga xhelozia, apo pse ka dëgjuar armiqtë e tu. Mos mendo vetëm për vete, Agustin. Mos ji egoist. Mendo për vajzën. Ç'do të bëhet me të, nëse ti i humbet të gjitha dhe përfundon në burg, i akuzuar për shpërdorim detyre dhe mashtrim?
– Beson se nuk e kam menduar këtë, Manuel?
– Ambasadori ngriti supet.
– E mendova këtë kur pashë sa e bukur është bërë, - përsëriti. - Shefi e vlerëson bukurinë. Po t'i them: "Inteligjenti do t'ju japë vajzën si provë dashurie dhe besnikërie, vajzën e vet të bukur, e cila është ende një zonjushë", nuk do ta refuzonte. E njoh. Është një kavalier, me një ndjenjë të jashtëzakonshme nderi. Do të prekej thellë në zemër. Do të të thërrasë vetë. Do të t'i kthejë të gjitha ç'të kanë hequr. Uranita do të sigurojë të ardhmen e vet. Mendo për të, Agustin, dhe flaki paragjykimet e vjetra. Mos ji egoist.
– Mori përsëri gotën dhe hodhi ca currila uiski në gotën e tij dhe në atë të Kabralit. Me dorën e vet hodhi copa akulli në të dy gotat.
– Më shkoi në mendje me ta parë ç'bukuroshe është bërë, - i këndoi zëri për të katërtën a të pestën herë. E bezdiste, e tërbonte fyti? Lëviste kokën dhe lëmonte dregëzën me mollëzat e gishtave. - Nëse të mërzita, nuk flas më.
– Dhe i poshtër dhe shpirtlig?! - shpërtheu menjëherë hallë Adelina. - Kështu the për tët atë të vdekur së gjalli që po pret fundin?! Për vëllanë tim, për njeriun që kam dashur dhe respektuar më shumë?! Nuk ke për të dalë nga kjo derë, pa më shpjeguar pse tërë këto fyerje, Urani.

– Po, thashë i poshtër dhe shpirtlig, sepse nuk ka fjalë tjetër më të keqe, - shpjegon Urania, ngadalë. - Po të kishte do t'i kisha thënë. Sigurisht, ka patur arsyet e veta. Rrethanat do t'i motivet e veta. Po unë nuk e kam falur dhe as do ta fal.
– Pse e ndihmon, kur e urren aq shumë? - plaka dridhet prej zemërimit dhe është zverdhur si meit. - Pse i paguan infermieren dhe ushqimin? Lëre të vdesë, atëherë?
– Më mirë ashtu, i vdekur e i pakallur. Të vuajë, - flet ajo serioze dhe me sytë poshtë. - Prandaj e ndihmoj, halla.
– Po... po, ç'të ka bërë që ta urresh aq shumë, të thuash gjëra aq monstruoze për të? - Lusinda ngre krahët, duke mos besuar ato që sapo dëgjoi: - Zot i madh!
– Do të çuditesh për çfarë do të të them, Inteligjent, - ngre zërin Manuel Alfonseja, me dramatizim. - Kur shikoj një bukuri, një femër të vërtetë, një nga ato që ta turbullojnë mendjen, unë nuk mendoj për vete. Mendoj vetëm për Shefin. Po, për atë. A do t'i pëlqente vallë, ta shtrëngonte në krahët e vet, ta donte? Këtë gjë nuk ia kam thënë asnjërit. Për mua, ai ka qenë gjithmonë i pari, edhe në këtë gjë. Dhe ki parasysh sa i pëlqej unë femrat, Agustin. Mos beso se kam sakrifikuar, duke i dhënë femra të bukura, për ta lajkatuar, për t'i rrëmbyer favore, për tregti. Kështu besojnë të mbaruarit, derrat. E di pse e kam bërë? Nga dashuria, nga keqardhja e nga dhembshuria. Veç ti mund të më kuptosh, Inteligjent. Ti dhe unë e dimë si ka qenë jeta e tij. Të punosh që kur lind dielli e deri në mesnatë, shtatë ditë në javë, dymbëdhjetë muaj në vit. Pa pushuar kurrë. Të merresh me gjërat më të rëndësishme, por, edhe me më të voglat. Duke marrë në çdo çast vendime, prej të cilave varet jeta dhe vdekja e tre milionë domenikanëve. Për të na futur në shekullin XX. Duke u kujdesur për të prekurit, mediokrit, mosmirënjohësit, rrezikzinjtë. A nuk e meriton një njeri i tillë të dëfrehet nganjëherë? Të gëzojë pak minuta me një femër? Një nga shpërblimet e pakta në jetën e tij, Agustin. Prandaj, ndihem krenar të jem ai që thonë tërë nepërkat: Ndërmjetësi i Shefit. E kam për nder, Inteligjent.
– E çoi gotën me uiski në buzë e hodhi në gotë copën e mbetur të akullit. Qëndroi një copë herë në heshtje, i përqendruar, i rraskapitur prej monologut. Kabrali e vërente, gjithashtu i heshtur, duke përkëdhelur gotën e vet plot me uiski.

– Mbaroi shishja dhe s'kam tjetër, - shfajësohet. - Merr timen, unë nuk pi dot më.
Duke pranuar, ambasadori i zgjat gotën bosh dhe senator Kabrali zbraz gotën e vet në të tijën.
– Më preke me ato që the, Manuel, - mërmëriti. - Po nuk më habit. Atë që ndien ti për të, atë adhurim, atë mirënjohje, kam ndier edhe unë gjithmonë për Shefin. Prandaj, më lëndon aq shumë kjo situatë.
Ambasadori i vuri dorën në sup.
– Do të rregullohet, Inteligjent. Do të flas unë me të. Di unë si t'ia them gjërat. Do t'ia shpjegoj. Nuk do t'i them se është ideja ime, po jotja. Një iniciativë e Agustin Kabralit. Një besnik në provë të plotë, edhe kur është në të keq, i poshtëruar. Ti tashmë e njeh Shefin. I pëlqejnë gjestet e mëdha. Mundet ta ketë nga vitet, nga shëndeti i rënë. Por kurrë s'i ka zmbrapsur sfidat e dashurisë. Do ta organizoj unë gjithçka, me maturi absolute. Mos ki merak fare. Do ta riparosh pozitën tënde. Ata që të kanë kthyer shpinën, shumë shpejt do të zënë radhë te kjo portë. Tani duhet të ikë. Faleminderit për uiskin. Në shtëpinë time nuk më lenë të provoj asnjë pikë alkool. Sa kënaqësi të ndiej në fytin tim të mjerë atë gudulisje pak të nxehtë e pak të hidhur. Lamtumirë, Inteligjent. Mos u ligshto më. Ma ler mua. Ti më mirë përgatit Uranitën. Pa hyrë në hollësi. Nuk është nevoja. Është punë e Shefit. Nuk e përfytyron dot delikatesën, ëmbëlsinë, aftësinë në të folur, me të cilat vepron në këto raste. Do ta bëjë të lumtur vajzën, do ta shpërblejë, do të ketë një të ardhme të siguruar. Ashtu ka bërë gjithmonë ai. Por, akoma më shumë me një krijesë aq të ëmbël, aq të bukur.
– Iku duke u lëkundur deri te dera dhe la shtëpinë me një përplasje të lehtë porte. Që nga sofaja e sallës, ku vazhdonte me gotën bosh në duar, Agustin Kabrali ndjeu motorrin e makinës dhe nisjen e saj. Ndiente lodhje, një shkrehje pa fund. Kurrë s'donte të gjente forca të ngrihej në këmbë, të ngjiste shkallët, të zhvishej, të shkonte në banjë, të lante dhëmbët, të shtrihej, të fikte dritën.
– Po mundohesh të na mbushësh mendjen se Manuel Alfonseja i propozoi babait tënd që... që...? - hallë Adelina nuk mund të vazhdonte dot, zemërimi i zuri frymën. Nuk gjente dot fjalët që shprehin dhe e bëjnë të qartë atë që do të thotë. Për t'i dhënë fund, në njëfarë mënyre, kërcënon me grushtin e saj

të vogël papagallin Samson, i cili as që po e hapte fare sqepin:

– Rri urtë, kafshë e ndyrë.
– Unë nuk po mundohem të të mbush mendjen. Unë po të tregoj se ç'ka ndodhur, - thotë Urania. - Nëse nuk do ta dëgjosh, e lë dhe po iki.
– Hallë Adelina hap gojën, po nuk arrin të thotë dot asgjë.
As Urania nuk dinte hollësira nga biseda midis Manuel Alfonseja dhe të atit, që u bë atë natë kur për herë të parë në jetën e vet, senatori nuk shkoi të flinte. E zuri gjumi në sallon, i veshur, me gotën dhe shishen e uiskit të zbrazur te këmbët. Pamja që gjeti të nesërmen në mëngjes Urania, kur zbriti për të ngrënë sillën dhe për të shkuar në kolegj, e trembi. I ati nuk qe pijanec, përkundrazi, gjithmonë i kishte pasur inat pijanecët dhe sarhoshët. Ai kishte pirë dhe ishte dehur nga dëshpërimi, ngaqë ishte i sulmuar, i përndjekur, i pushuar dhe nën hetim, me llogaritë rrjedhëse të bllokuara, për diçka që nuk e kishte bërë. Qau me ngashërim, duke e përqafuar të bijën pranë tij duke qarë, e puthi shumë herë: "Mos qaj, shpirt. Do të dalim prej së keqes, do ta shikosh, nuk do t'i lemë të na shkatërrojnë". U ngrit, rregulloi rrobat dhe shoqëroi të bijën për të ngrënë mëngjesin. Ndërsa i lëmonte flokët dhe i thoshte të mos tregonte asgjë në kolegj, e shikonte në një mënyrë të çuditshme.
– Ishte në mëdyshje, në vramendje, - imagjinon Urania. - Mbase mendonte për t'u arratisur. Po kurrë s'do të mund të hynte në ndonjë ambasadë. Tashmë, qysh nga sanksionet, nuk kishte më legata latinoamerikane. Sigurimsat vinin rrotull, duke vëzhguar portat e atyre legatave që kishin ngelur akoma. Do të kalonte një ditë të tmerrshme, duke u grindur me ngurrimet e veta. Atë mbasdite, kur u ktheva nga kolegji, ia kishte dalë mbanë.
– Hallë Adelina nuk kundërshton. Vetëm e shikon, që nga fundi i humbëtirës ku është zhytur, me qortim e habi përzier dhe me një mosbesim, që për shkak të përpjekjeve të saj, sa vinte e po shuhej. Manolita dredh me shpërdredh një kaçurelë floku. Lusinda dhe Marianita rrinë si statuja.
– Ka bërë banjë dhe është veshur me përpikërinë e zakonshme.

Nuk i ka më në fytyrë gjurmët e këqia të natës së kaluar. Por nuk ka futur gjë në gojë dhe prapë mëdyshjet e hidhërimi duken te zbehtësia e tij prej meiti, te rrethët mavi të syve dhe te shkëlqimi tutës i syve të tij.

– Nuk je mirë, babi? Pse je kaq i zverdhur?
– Duhet të flasim, Uranita. Eja, ngjitemi në dhomën tënde. Nuk dua që të na dëgjojë shërbyesi.
"Do ta fusin në burg", mendoi vajza. "Do të më thotë se duhet të shkoj të jetoj te xhaxha Alibali dhe hallë Adelina."
Hynë në dhomë. Urania i flaku librat mbi tryezën e punës dhe u ul në anë të shtratit ("Me mbulesë të kaltër dhe kafshëzat e "Walt Disney") dhe i ati u mbështet në dritare.
– Ti je ajo çka dua më shumë në këtë botë, - i buzëqeshi. - Gjëja më e mirë që kam. Qysh kur vdiq jot ëmë, e vetmja gjë që më ka ngelur në këtë jetë. Më kupton, moj bijë?
– Po, babi e di, - u përgjigj. - Ç'gjë tjetër e tmerrshme ka ndodhur? Do të të fusin në burg?
– Jo, jo, - mohoi ai me kokë. - Diçka e mirë. Ka një mundësi që çdo gjë të rregullohet.
Bëri një pauzë, i paaftë të vazhdonte më tej. I dridheshin buzët dhe duart. Ajo e shikonte e habitur. E po, atëherë, ky ishte një lajm i mirë. Paska një mundësi që radiot dhe gazetat nuk do ta sulmojnë më? Se përsëri mund të jetë president i senatit? Kur qenka kështu, pse kjo pamje, babi? Pse kaq i ligështuar dhe kaq i trishtuar?
– Sepse më lypin një sakrificë, bija ime, - mërmëriti. - Dua që të dish një gjë. Unë kurrë nuk do të bëja asgjë, ta dish mirë, fute në kokë këtë, asgjë që të mos ishte për të mirën tënde. Betomu se kurrë nuk do ta harrosh këtë që po të them tani.
Urania u nervozua. Për çfarë po fliste? Pse s'ia tregonte?
– Sigurisht, babi, - i thotë më në fund, me një gjest lodhjeje. - Po, ç'ka ndodhur? Pse vjen rrotull e s'ma thua?
I ati erdhi dhe iu ul në qoshe të shtratit, e kapi nga supet, e tërhoqi nga vetja dhe i puthi flokët.
– Bëhet një festë dhe Gjeneralissimi të ka ftuar, - i mbante buzët shtrënguar mbi ballin e së bijës. - Në shtëpinë që ka në San Kristobal, në fermën Fundasion.
Urania u lirua nga krahët e tij.
– Një festë? Dhe Truhijo na ka ftuar? Do të thotë se gjithçka u rregullua. Vërtet, babi?

Senator Kabrali mblodhi supet.

– Nuk e di, Uranita. Shefi është i paparashikueshëm. Jo gjithmonë është e lehtë të marrësh me mend qëllimet e tij. Nuk na ka ftuar të dy. Vetëm ty.
– Mua?
– Do të të çojë Manuel Alfonseja. Dhe ai do të të sjellë, përsëri. Nuk e di pse të fton ty dhe mua jo. Sigurisht është gjesti i parë, një mënyrë për të më bërë të ditur se nuk i kam humbur të gjitha... Të paktën kështu mendon Manueli.
– Pashë se ndihej shumë keq, - thotë Urania, duke marrë me mend se hallë Adelina, kokëvarur, nuk e qorton më me atë vështrimin e vet, tek i cili ka humbur siguria. - Ngatërrohej, binte në kundërshtim me veten. Dridhej se mos unë nuk do t'i besoja gënjeshtrat e tij.
– Edhe Manuel Alfonseja mund ta ketë gënjyer... - fillon të thotë hallë Adelina, por e lë në mes frazën. Bën një gjest pendimi, duke u shfajësuar me duar dhe me kokë.
– Nëse nuk do të shkosh, mos shko, Uranita, - Agustin Kabrali fërkon duart, sikur atë mbrëmje të nxehtë, të kishte ftohtë. - E thërras tani Manuel Alfonsen dhe i them se nuk ndihesh mirë, që dhe ai të shfajësohet para Shefit. Nuk ka asnjë detyrim, bija ime. Urania nuk di si t'i përgjigjet. Pse duhet ta mirrte ajo një vendim të tillë?
– Nuk e di, babi, - ngurron, hutohet. - Më duket e çuditshme. Pse më fton mua, vetëm? Çfarë do të bëj unë atje, në një festë pleqsh? Janë ftuar vajza të tjera të moshës time? Kokrra e vogël e gurmazit ulet e ngrihet në qafën e hollë të senator Kabralit. Sytë e tij u ikin atyre të Uranisë.
– Kur të ka ftuar ty, do të ketë edhe vajza të tjera, - belbëzon. - Besoj se tani nuk të quan më një fëmijë, por një zonjushë.
– Po, nëse më njeh, më ka parë nga larg mes shumë njerëzve. Ç'mund të kujtojë për mua, babi.
– Do t'i kenë folur për ty, Uranita, - rrëshqet i ati. - Ta përsëris, nuk ke asnjë detyrim. Po të duash, e thërras Manuel Alfonsen t'i them se nuk ndihesh mirë.
– Nuk di ç'të të them, babi. Po të duash ti, shkoj, po qe se jo, jo. Ajo që dua unë, është të të ndihmoj. Mos zemërohet, mos e merr si mospërfillje?

– Nuk kuptove asgjë? - guxon dhe e pyet Manolita.
Asgjë, Urani. Ishe ende një fëmijë, dhe të jesh fëmijë, do të thotë të jesh akoma plotësisht e pafajshme për disa gjëra që kanë të bëjnë me dëshirën, instinktet dhe pushtetin, me tepëritë dhe shtazëritë e pafundme, ca gjëra të ngatërruara që mund të kishin rëndësi në një vend të gatuar nga Truhijo. Për asaj, një vajzë të zgjuar, natyrisht, e gjithë kjo i dukej e nxitur. Ku ishte parë një ftesë brenda po asaj dite që bëhej festa, pa i lënë kohë të ftuarit të përgatitet? Por ishte një vajzë e vogël, por normale dhe e shëndetshme – dita e fundit që do të ishte ashtu, Urani – që i pëlqenin gjërat e reja dhe, papritur, ajo festë, në San Kristobal, në të famshmen pronë të Gjeneralissimit, nga dilnin kuajt dhe lopët që fitonin gjithë garat, nuk mund të mos e nxiste, ta mbushte me kureshtje, duke menduar se kishte çfarë t'u tregonte shoqeve të saj të San-Domingos. Ato shoqe, të cilat, pikërisht ato ditë, e kishin bërë Uranitkën të kalonte çaste tepër të këqija, duke folur për gjërat mizore që thuheshin kundër të atit në gazeta dhe radio, do të bëheshin ziliqare. Pse duhet të ndihej mosbesuese për diçka që e ngrinte lart babanë e saj? Më mirë ta kënaqte shpirtin me këtë, siç thoshte edhe senatori, ajo ftesë do të ishte shenja e parë e një dëmshpërblimi, një gjest që do t'i bënte ditur të atit se kalvari kishte mbaruar.
– Nuk dyshoi për asgjë. Si një vashëz në shpërthim që ishte, u preokupua për gjëra të lehta: Ç'do të vesh, babi?, ç'këpucë? Sa keq që s'kishte kohë për të thirrur floktaren, e cila e krehu dhe e rregulloi muajin e kaluar, kur u bë dama e vogël e Mbretëreshës së Santo Domingos. Qe i vetmi shqetësim i saj, qysh nga çasti kur, për të mos fyer Shefin, i ati dhe ajo vendosën që të shkonte në festë. Don Manuel Alfonseja do të vinte ta merrte në tetë të darkës. Nuk kishte kohë për të bërë detyrat e kolegjit.
– Deri në ç'orë i ke thënë zotit Alfonse se do të qëndroj?
– E po mirë, derisa të largohen njerëzit, - tha senatori Kabral. - Nëse do të ikësh më shpejt, se mund të ndihesh e lodhur apo për çfarëdo, thuaja, dhe Manuel Alfonseja do të të sjellë menjëherë.

XVII

Kur doktor Veles Santana dhe Bienvenido Garsia, dhëndri i HuanTomas Diasit, e çuan me kamioçinë Pedro Livio Sedenjon në Klinikën Ndërkombëtare, treshja e pandashme – Amaditoja, Antonio Imberti dhe Turku Estreja Sadalai – vendosi se kishte më kuptim të prisnin atje, derisa gjenerali Dias se kishte më mirë të gjenin një mjek për plagët, të ndërronin rrobat e gjakosura dhe një vend për strehim, derisa gjërat të qetësoheshin. Po cilit mjek t'i besuar t'i drejtoheshin në këtë orë? Ishte afër mesnatës.

– Kushëriri im, Manueli, - tha Imberti. - Manuel Duran Barreras. Jeton këtu afër dhe klinika e tij është në pranë shtëpisë. Është i besuar.

Toni kishte marrë një pamje të zymtë, gjë që e habiti Amaditon. Qyteti ishte i qetë dhe rrugët pa trafik. Lajmi ende nuk qe përhapur. Në makinën me të cilën Salvadori po i çonte në shtëpinë e doktor Duran Barreras, Amaditoja pyeti Tonin:

– Pse me këtë fytyrë meiti?

– Në djall vaftë kjo mërzi! - u përgjigj Imberti zëulët.

Turku dhe togeri po e shikonin.

– A ju duket normale që Pupo Romani të mos gjendet? - shtoi, nëpër dhëmbë. - Ka vetëm dy shpjegime: Ose e kanë zbuluar dhe e kanë futur brenda, ose është trembur. Në të dyja rastet, na fundosi.

– Por kemi vrarë Truhijon, Toni! - i dha zemër Amaditoja. - Askush s'e ngjall dot më.

– Kujton se jam penduar, - tha Imberti. - Në të vërtetë, kurrë s'kam menduar për grusht Shteti, për Juntë qytetaro-ushtarake, ëndrra si ato të Antonio de la Masës. Unë e kam parë grupin tonë si një komando vetëvrasëse.

– Duhet ta kishe thënë më parë, vëlla, - bëri shaka Amaditoja. - Të kisha shkruar testamentin.

Turku i la te doktor Duran Barrerasi dhe vajti në shtëpinë e

vet. Meqenëse kalecët do ta zbulonin shpejt makinën e tij të braktisur në rrugë, duhet të siguronte gruan e fëmijët dhe të gjente rrobat e gjumit, duke u shtrirë. U shtang kur Imberti i shpjegoi se përse ishin tërë baltë e gjak dhe prisnin ndihmën e tij. Disa çaste mori pamje të habitur në atë fytyrën e tij të madhe eshtake, të parruar, të shtrajtuar nga hutimi. Amaditoja shihte mollën e Adamit që ulej e ngrihej përgjatë fytit të mjekut. Herë pas here mjeku fërkonte sytë si i trembur prej fantazmave. Por më në fund reagoi:

- Fillimisht duhet t'ju kuroj. Shkojmë në klinikë.
  Më keq ishte Amaditoja. Një plumb i kishte shpuar kyçin e këmbës. Dukeshin vrimat e hyrjes e të daljes së plumbit dhe bijë therëse që i shkonte deri te gjuri. Mjeku ia fashoi, i bëri një injeksion dhe i dha një rresht me kapsula për t'i pirë çdo katër orë.
- Ke ku të shkosh? - e pyeti Imberti, ndërsa e mjekonin.
  Amaditoja mendoi aty për aty tezen e vet, Mekan. Mes të njëmbëdhjetë tezave të tij, ishte ajo që e kishte përkëdhelur më tepër kur ishte fëmijë. E vjetra jetonte vetëm në një shtëpi druri plot me vazo lulesh në bulevardin San Martin, jo shumë larg parkut Indipendenca.
- Në fillim do të na kërkojnë në shtëpitë e të afërmve tanë, - e paralajmëroi Toni. - Prandaj më mirë shko te ndonjë mik besnik.
- Të gjithë miqtë e mi janë ushtarakë, vëlla. Truhijistë të tërbuar.
  E shikonte Imbertin aq të shqetësuar dhe pesimist dhe nuk e kuptonte pse. Pupo Romani do të gjendej dhe Plani do të vihej në jetë me siguri. Sidoqoftë, me vdekjen e Truhijos, regjimi i tij do të zbehej si një kështjellë prej rëre.
- Besoj se mund të të ndihmoj, djalosh, - ndërhyri doktor Durani.

- Mekaniku që më rregullon kamionçinën ka një shtëpi fshati që do ta japë me qira. Në zonën e Ozamas. Ti i them?
Ashtu bëri dhe për fat qe shumë e thjeshtë. Mekaniku quhej Antonio Sançes (Tonjo) dhe, edhe pse vonë, erdhi aty menjëherë, sapo e thirri doktori. I treguan të vërtetën. "Ashtu?! Në shtëpinë time do të do tehem", thirri. Ishte ndër për të ta strehonte në shtëpinë e tij. Togeri do të ishte i sigurt. Nuk kishte fqinj afër. Ai do ta çonte vetë me Xhipin e tij dhe do të interesohej të mos i mungonte ushqimi.

– Si mund të ta shpërblej gjithë këtë, doktor, - pyeti Amaditoja Duran Barrerasin.
– Kujdesu, djalosh, - i dha dorën mjeku, duke e parë me keqardhje. - Nuk do të doja të isha në vendin tënd po të të kapnin.
– Kjo s'do të ndodhë kurrë, doktor.
Nuk kishte më municion dhe Imberti që kishte me tepri, i dha një grusht me fishekë. Togeri mbushi pistoletën 45 dhe, duke përshëndetur, tha:
– Ja, tani ndjehem i sigurt.
– Shpresoj të shoh sa më shpejt, Amadito, - e përqafoi Toni. - Miqësia jote ka qenë ndër gjërat më të mira që kam pasur.
Ndërsa ecnin me Xhipin e Tonjo Sançesit drejt zonës së Ozamas, qyteti ishte zgjuar. U shkëmbyen me nja dy morra plot me kalecë dhe, duke kaluar Urën Radames, panë të mbërrinte një kamion me roja, të cilët u hodhën nga makina për të vendosur një pritë.
– Tani e kanë marrë vesh se Cjapi ka vdekur, - tha Amaditoja.
– Sa qejf kam t'i shoh se ç'pamje kanë zanë të mbetën pa Shefin e tyre.
– Askush nuk do ta besojë, derisa ta shohin dhe t'i marrin erë kufomës, - tha i kënaqur mekaniku. - Dreq o punë, sa ndryshe do të jetë ky vend pa Truhijon!
Shtëpia e vogël ishte një ndërtesë fshati në qendër të një prone 15 dynymësh të papunuar. Banesa qe e mobiluar për gjysmë: Një shtrat me dyshek, ca karrige të prishura dhe një bidon me ujë të distiluar. "Nesër do të të sjell diçka për të ngrënë", i premtoi Tonjo Sançesi. "Mos ki merak. Këtu nuk vjen njeri".
Shtëpia nuk kishte dritë elektrike. Amaditoja hoqi këpucët dhe u shtri i veshur mbi shtrat. Motorri i Xhipit të Tonjos u largua, duke humbur zhurma, derisa nuk u dëgjua më. Ishte

i lodhur dhe i dhimbtë kyçi i këmbës, veç ndihej më i qetë. Vrasja e Truhijos i kishte hequr peshë të madhe. Brerja e ndërgjegjes e pati rënduar shpirtërisht që kur, i detyruar, kishte vrarë atë njeri të pafat – vëllai i Luisa Hilit, o Zot! – Tani ishte i sigurt se do të qetësohej. Po të ishte përsëri si më parë, një djalosh që do të shihej në pasqyrë pa ndier neveri për fytyrën e vet përballë. Ah sikur të mbaronte punë edhe me Abes Garsian dhe major Roberto Karrion! Atëherë nuk do ta çante më kokën për asgjë. Do të vdiste i qetë. U mblodh kruspull, u përpoq disa herë në shtrat, duke u përpjekur të flinte, por nuk mundi. Në errësirë dëgjonte zhurma karrocash. Në sytë e tij të mbyllur, duke u hedhur prej nga frika. Kishte përjetuar një ëndërr të keqe, që nuk i kujtohej se çfarë.

– E kaloi tërë ditën tjetër duke vëzhguar nga dritarja mos dukej Xhipi. Nuk kishte asgjë për të ngrënë, por s'kishte uri. Gllënjkat e ujit që gjerbte herë pas here, ia gënjenin stomakun. Po e torturonte vetmia, mërzia dhe mungesa e lajmeve të reja. Sikur të kishte një radio! I rezistoi tundimit për të shkuar në ndonjë qendër banimi e të kërkonte ndonjë gazetë. Ruaj qetësinë, djalosh, Tonjo Sançesi është duke ardhur.
– Po ai erdhi vetëm ditën e tretë. U duk aty nga mesdita e dy qershorit, pikërisht ditën kur Amaditoja, gjysmë i vdekur nga uria dhe i dëshpëruar nga mungesa e lajmeve, i mbushte tridhjetë e dy vjeç. Tani Tonjoja nuk ishte më i çiltër, i pafajshëm dhe i sigurt në vetvete, si atë ditë kur e solli këtu. Ishte i zbehtë, i torturuar nga shqetësimi, i parruar dhe belbëzonte. I zgjati një termus me kafe të ngrohtë dhe disa sanduiçë, sallam e djathë, që Amaditoja i përlau, ndërsa dëgjonte lajmet e këqija. Fytyra e tij ishte te të gjitha gazetat dhe jepjej çdo çast në televizion, bashkë me gjeneralin Huan Tomas Dias, Antonio de la Masën, Estreja Sadalain, Fifi Pastoricën, Pedro Livio Sedenjon, Antonio Imbertin, Uaskar Tehedën dhe Luis Amiamën. Pedro Livio Sedenjo i burgosur, i kishte denoncuar. I ofronin një thes me para atij që do të jepte informacion për ta. Kishin filluar përndjekjet e tmerrshme për gjithë të dyshuarit si antitruhijistë. Ndërkohë, ishte arrestuar doktor Duran Barrerasi. Tonjoja trembej se mos nga torturat, do t'i tregonte edhe ata. Ishte me shumë rrezik qëndrimi i Amaditos aty.

– Nuk do të qëndroja më këtu, edhe sikur të ishte vend i sigurt,

Tonjo - i tha togeri. - Më mirë të më vrasin, se sa të rri edhe tri ditë të tjera në këtë lloj vetmie.

– Po ku do të shkosh?
Mendoi njëherësh te kushëriri i tij, Maksimo Miesesi, i cili kishte një pronë të vogël gjatë rrugës Duarte. Por Tonjoja e trembi: Rrugët ishin plot patrulla dhe kontrolloheshin të gjitha makinat. Kurrë s'do të arrinte te prona e të kushëririt pa u njohur.
– Nuk e merr me mend se ç'situatë është, - shfrynte Tonjo Sançesi. - Ka qindra të ndaluar. Po kërkojnë si të tërbuar.
– Në djall, vafshin! - tha Amaditoja. - Le të më vrasin. Cjapi vajti në esfel dhe nuk e ngjallin dot më. Ti mos u shqetëso, vëllaçko. Bëre shumë për mua. Mund të më nxjerrësh deri në rrugë? Do të shkoj në kryeqytet në këmbë.
– Frikë kam, por jo aq sa të të hedh në rrugë. Nuk jam maskara, - tha Tonjoja, tani më i qetë. I rrahu shpatullat. - Hajde, të të çoj. Po qe se na kapin, ti më ke detyruar me pistoletë. Në rregull?
E sistemoi Amaditon në pjesën e prapme, poshtë një mushamaje e mbi të vuri një rrotull litari dhe ca teneqe karburanti, të hedhura mbi togerin e mbledhur lëmsh. Qëndrimi kutullaç e mpiu dhe i shtoi dhimbjet e këmbës. Në çdo gropë përplaste shpinën dhe kokën. Por me asnjë çast nuk e harroi pistoletën 45. E mbante në dorën e djathtë, gati për të shtënë. Të bëhej ç'të bëhej, nuk do ta kapnin të gjallë. Nuk ndiente frikë. Në të vërtetë, nuk ushqente shumë shpresë të dilte paq nga ky rrezik. Por ç'rëndësi kishte. Nuk kishte qenë asnjëherë kaq i qetë, qysh nga ajo natë e kobshme e Xhoni Abesit.
– Po mbërrijmë tek Ura Radames, - dëgjoi të thoshte Tonjo Sançesi i tmerruar. - Mos lëviz, mos u ndiej, një patrullë.
Xhipi u ndal. Dëgjoi zëra, koha pa pas një pauzë, thirrje miqësore: "Oo, qenke ti, Tonjito". "Ç'kemi, o mik?" E lanë të ikte pa e kontrolluar makinën. Duhet të ishin në mes të urës, kur dëgjoi përsëri Tonjon:
– Kapiteni, tataniku Rasputin, që miku im. Eeh dreqi e mori, çfarë fati! Ende e kam gjakun të ngrirë, Amadito. Ku të të le?
– Te bulevardi San Martin.
Pak më vonë, Xhipi frenoi.
– Nuk shikoj asnjë kalec, përfito nga momenti, - i tha Tonjoja.
– Zoti qoftë me ty, vëlla!

Togeri doli nga mushamaja dhe teneqet dhe u hodh në trotuar. Kalonte ndonjë makinë, por këmbësorë nuk pa, përveç një burri me bastun që po largohej me shpinë nga ai.

– Zoti ta shpërbleftë, Tonjo!
Edhe ty të ndihmoftë, - përsëriti Tonjo Sançesi dhe u nis. Shtëpiza e teze Mekës – e tëra prej druri, njëkatëshe, me kopshtella dhe oborr, plot vazo me lule shumëngjyrëshe nëpër dritare – ishte nja njëzet metra larg, që Amaditoja i kapëceu me hapa të nxituar duke çaluar dhe pa e fshehur revolen. Me të trokitur, u hap porta. Teze Meka nuk pati kohë për t'u habitur, sepse togeri, me një të kërcyer, hyri duke hapur dhe mbyllur portën pas tij.
– Nuk di ç'të bëj dhe ku të fshihem, teze Meka. Do të rri një ose dy ditë, derisa të gjej një vend të sigurt.
Tezja e puthte dhe e përqafonte me dashuri si gjithnjë. Nuk dukej aq e frikësuar sa mendonte Amaditoja.
– Duhet të të kenë parë, mor bir. Ç'të tha mendja të vish në mes të ditës. Fqinjët e mi janë truhijistë të çmendur. Je tërë gjak, o bir. Po këto fasho? Të kanë plagosur?
Amaditoja vëzhgonte rrugën përmes perdeve. Në rrugë nuk kishte njerëz. Dyert dhe dritaret nga ana tjetër e rrugës, ishin të mbyllura.
– Që kur pashë lajmet, po i lutem shenjtit Pedro Klaverit për ty, Amadito. Ai është shenjti më i mrekullueshëm, - teze Meka po ia shtrëngonte me duar fytyrën të nipit. - Kur dolë në televizor dhe në "Karaibet", disa fqinj erdhën të më pyesnin, por më shumë për të vëzhguar e spiunuar. Do Zoti nuk të ka parë njeri. Ç'je bërë kështu, mor bir?! Do ndonjë gjë?
– Po, teze, - qeshi ai, duke i përkëdhelur flokët e bardhë. - Një dush dhe diçka për të ngrënë. Po vdes urie.
– Më raftë pika! Sot ke dhe ditëlindjen, - u kujtua teze Meka dhe e përqafoi përsëri.
Ishte një plakë e paketë në trup, por energjike, e prerë në pamje, me sy të thellë e me shpirt të madh. I tha të nipit t'i jepte pantallonat dhe këmishën për t'i larë. Ndërsa Amaditoja bënte banjë – ç'kënaqësi përzish – tezja në kuzhinë ngrohu gjellën që kishte tepruar. Në mbathje e kanatiere, togeri gjeti në tavolinë një banket të vërtetë: Zarzavate të fërguara, sallam të skuqur e pilaf me të përbrendshme pule. Hëngri me oreks, duke dëgjuar historira nga teze Meka. Lajmi se ai ishte njëri

nga vrasësit e Truhijos, kishte sjellë në familje shqetësim të madh. Në shtëpitë e tri motrave të saj, kishin mbërritur që pa gdhirë kalecët dhe kishin pyetur për të. Këtu nuk kishin ardhur ende.

– Nëse nuk të bezdis, dësha të fle pak, teze. Ka ditë që pothuajse nuk i kam mbyllur sytë. Nga mërzia. Jam i lumtur që ndodhem këtu me ty. Tezja e çoi te dhomat e saj të gjumit dhe i tha të shtrihej te shtrati i saj, nën figurën e shenjtit Pedro Klaver, shenjti i saj i preferuar. Mbylli grilat për të errësuar dhomën dhe i tha se sa të flinte ai, ajo do t'i pastronte dhe hekuroste rrobat. "Eja, pa do ta mendojmë se ku do të fshihesh, Amadito". E puthi disa herë në ballë e flokë: "E unë të pandehja aq truhijist, bir". E zuri gjumi menjëherë. I doli në ëndërr Turku Sadalai dhe Antonio Imberti që i thërrisnin fort: "Amadito, Amadito!". Donin t'i thoshin diçka me rëndësi, por ai nuk po i merrte vesh as nga gjestet, as nga fjalët. I duk se sa kishte mbyllur sytë, kur ndjeu që po e tundnin fort. Pranë tij ishte teze Meka, aq e zbehtë dhe e tmerruar, sa i erdhi keq për të. E rriste ndërgjegjja që e kishte futur në telashe teze Mekën.
– Erdhën, jan këtë, - asaj po i zinte fryma dhe bënte kryqin.
– Dhjetë a dymbëdhjetë morra dhe një kope me kalecë, or bir.
Ai tani ishte i kthjellët dhe e dinte mirë se ç'do të bënte. E detyroi plakën të shtrihej në tokë, pas shtratit, pranë murit, poshtë portretit të shenjtit Pedro Klaver.
– Mos lëviz fare, për asgjë në botë nuk do të ngrihesh andej, - e urdhëroi. - Të dua shumë, teze Meka.
Në dorë mbante pistoletën 45. I zbathur, i veshur vetëm me kanatiere dhe mbathje kaki, shkoi rrëshqitazi ngjitur për muri, deri te dera kryesore. Vëzhgoi përmes perdeve, pa u vënë re. Ishte një pasdite me qiell të vrenjtur dhe që larg dëgjohej muzika e një boleroje. Shumë Volkswagen të zinj të sim-it mbushnin rrugën. Kishte, të paktën, nja njëzet kalecë të armatosur me automatikë dhe revolverë, të cilët kishin rrethuar shtëpinë. Tre prej tyre qenë te porta. Njëri trokiti fort me grusht, duke tundur kanatët. Bërtiti me sa zë kishte:
– E dimë që je aty, Garsia Gerrero! Dil me duart lart, nëse nuk do që të ngordhësh si qen.
"Si një qen, jo", mërmëriti. Ndërkohë që hapte derën me dorën e majtë, me të djathtën qëlloi. E shkrehu tërë karikatorin e pistoletës dhe e pa të binte duke klithur, i goditur në

gjoks, atë që i bërtiste për t'u dorëzuar. Por, i bërë shoshë nga plumba të panumërt automatiku dhe pistoletë, nuk pa dot se, përveç kalecit që u vra në vend, kishte plagosur edhe dy të tjerë, para se të vritej vetë. Nuk pa dot se trupi i tij që mbërthyer - siç mbërthehen dyert e duarve e të një Volkswageni gjakatar dreqi dhe që, ashtu, të kapur nga kyçet e duarve, e shëtisnin triumfalisht nëpër parkun Indipendenca, për t'ua treguar sehirxhinjve. Ndërkohë, kalecë të tjerë hynë në shtëpi, gjetën teze Mekan, më shumë të vdekur se të gjallë atje ku e kishte lënë i nipi dhe e çuan me të shtyra e duke e pështyrë, në lokalet e sim-it. Pas kësaj, një turmë makutërish, në sy të sigurimsave tallës e të pamëshirshëm, filloi të plaçkiste shtëpinë, duke rrëmbyer çka kishte mbetur nga grabitja e mëparshme e kalecëve. Pas plaçkitjes, zbërthyen, shembën e shkatërruan dhe, në fund, e dogjën, derisa në të ngrysur të ditës nuk mbeti asgjë prej saj, veç hirit dhe mbeturinave të karbonizuara.

XVIII

Kur njëri prej adjutantëve ushtarakë çoi në zyrë Luis Rodrigesin, shoferin e Manuel Alfonsos, Shefi u ngrit ta priste, gjë që nuk e bënte për njerëz të rëndësishëm.

– Si është ambasadori? - e pyeti tërë interes.

– Mirë, Gjeneralissim, - shoferi mori pamjen që duhej e pastroi zërin. - Prapë me dhimbje të forta. Sot në mëngjes më dërgoi dhe i solla mjekun për t'i bërë një injeksion.
I shkreti Manuel! Nuk ishte e drejtë, drejti ta hajë. Ai, i cili i kushtoi jetën e vet kujdesit për trupin, për të qenë i bukur, elegant, rezistues ndaj atij ligji të mallkuar të Natyrës që donte ta shemtonte, ai të dënohet ashtu, duke u poshtëruar asaj; Ajo fytyrë që frymëzonte jetë, mirësjellje, shëndet. Do të qe më mirë të kishte mbetur në atë sallë operacioni. Kur pas operacionit në Klinikën Majo, erdhi në Qytetin Truhijo, Bamirësit iu mbushën sytë me lot kur e pa ashtu. Ishte kthyer në një rrënojë. I kishin hequr gjysmën e gjuhës dhe mezi merrej vesh se ç'thoshte.

– Bëji të fala prej meje. - Gjeneralissimi e pa me kujdes Luis Rodrigesin: Kostum i errët, këmishë e bardhë, gravatë blu, këpucë të lustruara. Zezaku më i pispillosur në Republikën Domenikane. - Ç'të reja kemi?

– Lajme shumë të mira, i nderuar Shef, - tha Luis Rodriges, ndërsa sytë e mëdhenj i ndritën. - E gjeta vajzën, pa problem. Kur të thoni ju.

– E sigurt që është ajo?
Fytyra e gjerë e zeshkët, me blana dhe mustaqe, lëvizi disa herë në shenjë pohimi.

– Shumë e sigurt. Ajo që ju dorëzoi lulet të hënën, në emër të Rinisë Sankristobalese. Jolanda Esterel. Shtatëmbëdhjetë vjeçe. Ja, fotografia e saj.
Ishte fotografia e një dokumenti shkollor. Truhijo njohu sytë e perënduar, gojën e vogël me buzë të trashë dhe flokët e lëshuara që i mbulonin supet. Vajza kishte parakaluar në ballë

të shkollareve, duke mbajtur një fotografi të madhe të Gjeneralissimit, para tribunës së ngritur në parkun qendror të San Kristobalit, pastaj kishte hipur në podium për t'i dhënë atij një tufë trëndafilash e lulebore, mbështjellë me letër celofani. Kujtoi trupin e mbushur, format e zhvilluara, gjinjtë e fortë, të çlirët, fshehur pas bluzës, kofshët që shuheshin mirë. Një gudulisje në herdhe e këndelli.

– Dërgoje te Shtëpinë në Mogan, aty nga dhjeta, - tha dhe e përmbajti me zor atë përfytyrim që i kishte ngrënë kohë. - Përshëndetjet e mia të përzemërta Manuelit. Thuaji të kujdeset. - Si urdhëron, i nderuar Shef. Do ta çoj pak më herët se ora dhjetë.
Iku duke përshëndetur. Gjeneralissimi telefonoi në njërin nga gjashtë telefonat mbi skrivaninë e vet të llakuar, postërojen e Shtëpisë me Mogan e i tha Qenita Sepulveda t'i rregullonte dhomat me aromë anisi dhe t'i mbushte me lule të freskëta. Ishte një kujdes i panevojshëm, sepse kujdestarja, duke ditur se mund të vinte në çdo çast, gjithmonë e mbante pastër Shtëpinë me Mogan, por ai prapë e paralajmëronte. Urdhëroi adjutantin ushtarak të bënte gati Shevroletin e të thërriste shoferin, shoqëruesin dhe bodigardin, Zakarias de la Krus, sepse pas shëtitjes atë natë do të shkonte në San Kristobal.
Ishte i entuziazmuar për atë që e priste. Mos ishte bija e asaj drejtoreshës së shkollës së San Kristobalit, e cila, dhjetë vjet më parë i kishte recituar një poezi të Salome Urenjas gjatë një vizite në qytetin e vet të lindjes? Ajo e kishte eksituar shumë me ato sqetullat pa qime, që i dukeshin qartë kur recitonte dhe për ta çuar atë sankristobale të re në Shtëpinë me Mogan, kishte braktisur edhe pritjen zyrtare të sapofilluar për nder të tij. Terencia Esterel? Ashtu quhej. Dhe përsëri ndjeu një valë të fuqishme eksitimi duke përfytyruar se Jolanda duhet të ishte e bija ose motra e vogël e asaj mësueseje. Ecte me nxit, duke përshkuar kopshtet mes Pallatit Kombëtar e Vila Radamesit dhe mezi po i dëgjonte shpjegimet e një adjutanti të shpurës së tij: Sekretari i Shtetit të Forcave të Armatosura, gjeneral Roman Fernandes, paskësh telefonuar disa herë dhe ishte në dispozicion të tij, nëse Shkëlqesia e Tij donte ta takonte para shëtitjes. Hëëm, është trembur nga telefonata e mëngjesit. Po më shumë do t'i shkisnin pordhët, kur do ta vinte përpara me fjalë të ndyra, duke i treguar gropën me ujë të qelbur.

Hyri si një rrebesh në dhomat e Vila Radamesit. E priste uniforma e ditës në ngjyrë ulliri, gati mbi shtrat. Sinforosoja ishte falltar. Nuk i kishte thënë se do të shkonte në San Kristobal, megjithatë plaku i kishte përgatitur rrobat me të cilat shkonte gjithmonë në fermën Fundasion. Po pse vishte këtë uniformë për në Shtëpinë me Mogan? Nuk e dinte. Një pasion për ritet, për përsëritjen e sjelljeve dhe veprimeve që e shoqëronte qysh nga fëmijëria. Shenjat qenë të mira: As të mbathurat dhe as pantallonat nuk kishin njolla urine. I ishte larguar zemërimi që i shkaktoi Balageri, duke guxuar të bënte vërejtje për gradimin e togerit Viktor Alisinio Penja Rivera. Ndihej optimist, i rinuar, me atë cëmbisjen eksituese në herdhe dhe me mendimin se së shpejti do ta kishte në krahët e veta të bijën me motrën e asaj Terencias, e cila i kishte lënë një kujtim aq të këndshëm. A thua të jetë e virgjër? Kësaj radhe nuk do të provonte me shijen e keqe që pati me atatariaqen.
Ishte i gëzuar se do të kalonte orën që vinte duke thithur ajrin e njelmët, duke u freskuar prej flladit të detit e duke vështruar si thërrmoheshin dallgët te muri i Bulevardit. Gjithashtika do ta ndihmonte të fshinte ato grima të shijes së keqe të kësaj pasditeje të mbarë, që rradhëherë i ndodhte: Kurrë nuk kishte qenë i prirur për melankoli dhe mërzitje.
Kur po dilte, një shërbëtore iu afrua për t'i thënë se donja Maria donte t'i transmetonte një mesazh të të birit, Ramfisit, i cili kishte telefonuar nga Parisi. "Më vonë, më vonë, nuk kam kohë". Çdo bisedë me plakën budallaqe, do t'ia prishte humorin e mirë.
Përshkoi sërish kopshtet e Vila Radamesit, me hapa të nxituara, i paduruar për të mbërritur në breg të detit. Por më parë, si gjithmonë, kaloi nga shtëpia e së ëmës, në bulevardin Maksimo Gomes. Te porta e rezidencës së madhe bojërozë të donja Hulias, e priste njëzetshja e personelit që do ta shoqëronte. Ndjeheshin të privilegjuar se, duke e shoqëruar çdo mbrëmje, do të lakmoheshin e do të urreheshin prej atyre që nuk kishin mundur të meritonin një nder të tillë. Tek kalonte mes dy rreshtave të oficerëve e civilëve të grumbulluar në kopshtet e Zonjës Madhështore, të cilët e përshëndesnin "Mirëmbrëma, Gjeneralissim!", "Mirëmbrëma Shkëlqesi!", dalloi tmerrësisht kolonelin Xhoni Abes Garsia, senatorin Henri

Çirinos, dhëndrin e vet, kolonel Leon Esteves, mikun e tij, vendas Modesto Dias, senatorin Heremias Kintanija, i cili sapo kishte zëvendësuar Agustin Kabralin si kryetar Senati, drejtorin e gazetës "Karaibet", don Pançiton, dhe të humbur midis tyre, të voglin President Balagerin. Nuk i dha dorën askujt. U ngjit në katin e parë, ku donja Julia rrinte gjatë muzgut në kolltukun e vet lëkundës. Plaka ishte aty, e fundosur në kolltukun e saj. E vogël si xhuxhe, me vështrimin e fiksuar mbi diellin flakë të kuq që po zhytej në horizont dhe i rrethuar nga re të përflakura. Zonjat dhe shërbëtorët që rrethonin të ëmën, u larguan. U përkul, puthi faqet e rregulluara të donja Hulias dhe i përkëdheli flokët me ëmbëlsie.

– Të pëlqen shumë muzgu, vërtet mamushe?
Ajo pohoi me lëvizje koke e duke i buzëqeshur, me sytë e fundosur, por të gjallë dhe me dorën e vogël, si një qengjel, i preku faqen. A e njihte vallë? Donja Altagrasia Julia Molina ishte nëntëdhjetë e gjashtë vjeçe dhe kujtesa e saj duhet të qe si ujë i sapunisur, ku kujtimet zhbëheshin njësoj si flluskat e sapunit. Por një instinkt duhej t'i thoshte se ky njeri që vjen rregullisht për ta vizituar, do të ishte një qenie e dashur. Kishte qenë gjithmonë shumë e mirë kjo bijë e paligjshme haitjanësh të emigruar në San Kristobal, tiparat e së cilës i trashëguar ai dhe vëllezërit e tij, gjë që, edhe pse i pëlqente aq shumë, përherë e bënte t'i vinte turp. Shpesh, kur në Hipodrom, "Country Club" ose "Bellas Artes" shihte gjithë ato familje aristokrate domenikane duke e nderuar, mendonte me ironi: "Lepijeni tokën ku shkel një pasardhës skllevërish". Ç'faj kishte Zonja Madhështore që nëpër venat e saj rridhte gjak zezaku? Donja Julia kishte jetuar për burrin e saj, atë pijanec paqësor e feminist, don Hose Truhijo Valdez, dhe për bijtë e saj, duke e harruar dhe e vendosur veten në radhë të fundit. Gjithmonë e kishte habitur kjo grua, e cila nuk kërkoi kurrë as para, as rroba, as udhëtime, as pasuri. Kurrë, asgjë. Të gjitha ia dha ai, me detyrim. Me thjeshtësinë e trashëguar, donja Julia do të vazhdonte të jetonte në shtëpinë modeste të San Kristobalit, ku Gjeneralissimi lindi dhe kaloi fëmijërinë, apo në njërën prej atyre kasolleve të paraardhësve të saj haitjanë të vdekur urie. E vetmja gjë që i kërkonte donja Julia, qe mëshira për Petanin, Negron, Pipin, Anibalin, ata vëllezër dembelë e zuzarë, sa herë që bënin prapësira, ose për Angjelitën,

Ramfisin e Radamesin, të cilët, qysh fëmijë, mbroheshin nga gjyshja prej zemërimit të babait. Dhe për hir të donja Hulias, Truhijo i falte. A e dinte vallë, se qindra rrugë, parqe dhe kolegje të Republikës mbanin emrin e saj? Edhe pse e lajkatonin dhe e festonin, vazhdonte të ishte e thjeshtë, gruaja e pashfaqur në sy që Truhijo kujtonte nga fëmijëria e tij.

- Shpesh qëndronte një kohë të gjatë me të ëmën, duke i treguar ngjarjet e ditës, edhe kur ajo nuk kuptonte asgjë. Sot u kufizua duke i thënë ca fraza të ëmbla dhe u kthye te Maksimo Gomes, i paduruar për të thithur aromën e detit.
- Sapo doli në Bulevardin e gjerë – filloi shëtitjen dhe oficerëve i hapi rrugën – filloi shëtitjen. Shikonte detin e Karabibeve të blloqë më poshtë, i ndezur nga zjarret e florinjta të perëndimit. Ndjeu një tjetër valë kënaqësie. Ecte përpara, i ndjekur nga kurtizanët e shpërndarë në grupe, që zinin rrugën dhe trotuarin. Në atë orë ndërpritej trafiku në Maksimo Gomes dhe Bulevard. Xhoni Abesi kishte urdhëruar që të mos shihnin rojat në rrugët anësore, sepse Gjeneralissimi i shkaktonte klaustrofobi ata cepa të mbushura me roja dhe kalecë. Askush nuk e kapërcente murin e adjutantëve ushtarakë ndonjë metër nga Shefi. Të gjithë prisnin që ai të tregonte se cili mund t'i afrohej. Pas gjysmë blloku, duke thithur aromën e kopshteve, u kthye dhe kërkoi kokën gjysmë të thyer të shokët të Modest Diasit dhe i bëri shenjë. Pati një ngatërresë të vogël, sepse rondokopi, senator Çirinos, duke qenë pranë Modesto Diasit, pandehi se ai qe fatlumi, dhe u vërsul drejt Gjeneralissimit, por e ndalën dy nga rojat të tij të shpejtë. Modesto Diosi, i rënduar nga mishrat e tepërta dhe dhjami, mezi ia dilte të ecte me hapin e Truhijos, në ato shëtitje. Mbytej në djersë. Me një shami në dorë, nuk ndalte së fshiri ballin, qafën dhe faqet e fryra.

- Mirëmbrëma, i nderuar Shef.
- Duhet të mbash dietë, - e këshilloi Truhijo. - As pesëdhjetë vjeç dhe gulçon si derr. Mëso nga unë, shtatëdhjetë vite dhe në formë të shkëlqyer.
- Këtë më thotë përditë ime shoqe, i nderuar Shef. Më përgatit lëng pule dhe sallatë. Por nuk kam vullnet për këtë. Mund të duroj për çdo gjë, po për të ngrënë, mirë jo.
- Kufari i tij i trashë mezi mbahej në këmbë. Modestoja kishte si i vëllai, gjenerali Huan Tomas Dias, të njëjtën fytyrë të gjerë me hundë të shtypur, buzë të trasha dhe një lëkurë me gjurmë

të dukshme të racës, por më inteligjent se ai dhe nga pjesa më e madhe e domenikanëve që njihte Truhijo. Kishte qenë kryetar i Partisë Domenikane, kongresist gjatë në qeveri, Gjeneralissimi nuk e kishte lejuar të qëndronte gjatë në qeveri, sepse qartësia e tij mendore për të parashikuar, analizuar dhe zgjidhur një çështje, i dukej e rrezikshme, ishte një parakusht për t'u rritur mendja dhe për ta tradhtuar.

– Ç'komplot është duke përgatitur Huan Tomasi, tani? - ia këputi dhe u kthye ta shihte. - Ma merr mendja se duhet të jesh në dijeni të bëmave të tët vëllai dhe dhëndrit të tij.
Modestoja qeshi si të bëhej një shaka:
– Huan Tomasi? Më tërë ato prona dhe tregti, mes uiskit dhe shfaqjes së filmave në kopshtin e shtëpisë së tij, nuk besoj t'i ngelet kohë për të bërë komplote.
– Është duke komplotuar me Henri Dearbornin, diplomatin janki, - e siguroi Truhijo, si kishte dëgjuar fare. - Thuaji t'i lerë ato marrëzia, sepse e pësoi një herë, për herën tjetër do ta pësojë edhe më keq.
– Im vëlla nuk është aq budalla sa të komplotojë kundër jush, i nderuar Shef. Megjithatë, do t'i them.
Ç'kënaqësi: filloi i detit i mbushte mushkëritë dhe dëgjonte zhaurimën e dallgëve që përplaseshin e thermoheshin mbi shkëmbinjtë dhe te muri prej betoni i Bulevardit.
Modesto Diosi bëri gjestin për t'u larguar, po Bamirësi e mbajti:
– Prit, nuk kam mbaruar. Apo nuk duron dot?
– Ju po bëni të më bjerë infarkti.
Truhijo ia ktheu me një buzëqeshje. Gjithnjë kishte patur simpati për Modeston, i cili, përveçse inteligjent, ishte i matur, i drejtë, i ëmbël dhe i çiltër. Megjithatë, inteligjenca e nuk ishte e kontrollueshme dhe e dobishme, siç ishte ajo e Inteligjentit, e Konstitucionalistit Sarhosh apo e Balagerit. Tek ajo e Modestos kishte diçka të pashtruar, të pavarur. Tek të kthehej në rebelim po të siguronte shumë pushtet. Ai dhe Huan Tomasi ishin po ashtu nga San Kristobali, kishin kaluar rininë bashkë dhe, veç dhënies së posteve, Modeston e kishte përdorur në shumë raste si këshilltar. Ia kishte nënshtruar provave të egra, prej nga kishte dalë fitues. E para, në fund të viteve dyzet, kur kishte vizituar Panairin e Gjedhëve, me demat e racës dhe lopët qumështore që Modesto Diosi kishte organizuar në Vila Mela. Ç'gjë e papritur: Prona jo shumë e

madhe, ishte aq e pastër, moderne dhe e mbarë, si ferma Fundasion. Më shumë se stallat e përsosura e lopët e mrekullueshme qumështore, ia preku sedrën kënaqësia arrogante me të cilën Modestoja u tregonte fermën e rritjes atij dhe të ftuarve të tjerë. Ditën tjetër i dërgoi Lyrashin me një çek prej dhjetë mijë pesos për të legalizuar shitblerjen. Pa asnjë hezitim, që po jepte dritën e syrit me një çmim qesharak (vetëm një lopë kushtonte më shumë), Modestoja firmosi kontratën dhe i dërgoi një letër Truhijos ku e falënderonte që "Shkëlqesia e Juaj e konsideron ndërmarrjen time të vogël agro-blegtorale të denjë të shfrytëzohet nga dora juaj e sprovuar". Pasi e vlerësoi nëse në ato rreshta kishte ndonjë ironi të dënueshme, Bamirësi arriti në përfundimin që jo. Pesë vjet më vonë, Modesto Diasi kishte një fermë tjetër blegtorale më të madhe dhe më të bukur, në një zonë të mënjanuar të Estrejas. Mos mendonte se aq larg nuk do të binte në sy? Duke u shprehur që qeshuri, Truhijo i dërgoi Inteligjentin me një tjetër çek dhjetë mijë peso, duke i thënë se kishte aq shumë besim te talenti i tij agro-blegtoral, sa ia blinte fermën qorrasi, pa e parë vetë. Modestoja e firmosi shitjen, futi në xhep shumën simbolike dhe e falënderoi Gjeneralissimin me një tjetër pusullë të dashur. Për të shpërblyer bindjen e tij, pak kohë më pas, Truhijo i bëri lëshim të veçantë për të importuar makina larëse dhe rrahëse shtëpiake, me të cilat vëllai i gjeneralit Huan Tomas Dias zhdëmtoi ato humbje.

– Kjo ngatërresa me ata priftërinjtë e dreqit, - u ankua Truhijo. - Ka apo s'ka ilaç?
– Patjetër që ka, i nderuar Shef. - Modestoja ecte me gjuhën jashtë. Veç ballit dhe qafës, po i djersinte edhe tulla. - Por, nëse më lejoni, problemet me Kishën s'llogariten. Ato rregullohen vetë nëse zgjidhet kryesorja: gringot. Nga ata varet gjithçka.
– Atëherë, nuk ka zgjidhje. Kenedi kërkon kokën time. Në qoftë se nuk do t'ia jap, do të ketë luftë menjëherë.
– Ai, të cilit gringot i tremben, nuk jeni ju, por Fidel Kastro, i nderuar Shef. Sidomos pas dështimit në Bahia de Koçinos. Tani, më shumë se kurrë, i tremb fakti se komunizmi mund të përhapet në Amerikën Latine. Është koha t'u tregosh se mbrojtja më e mirë kundër të kuqve në rajon, jeni ju, jo Betankuri, as Figeresi.
– Kanë patur mundësi ta marrin vesh, Modesto.

- U duhen hapur sytë, i nderuar Shef. Gringot janë të trashë, nganjëherë. Të sulmosh Betankurin, Figeresin, Munjos Marinin, nuk mjafton. Më me vlerë do të ishte të ndihmoje me takt komunistët venezuelash dhe kostarikas. Dhe independistët portorikas. Kur Kenedi të shohë se lufta partizane do t'i shqetësojë këto vende dhe do ta krahasojë me qetësinë këtu, atëherë do ta kuptojë.
- Mjaft folëm, - e ndërpreu brutalish Gjeneralissimi.

  Të dëgjonte të flitej për gjëra të mëparshme, i ndikonte keq. Larg mendimeve të errëta. Donte të ruante gjendjen e mirë shpirtërore me të cilën filloi shëtitjen. E shtyu veten të mendonte për fëmijërinë e pankartave dhe luleve. "O Zot, bëma këtë nder. Kam nevojë të jem mashkull si duhet këtë natë, për Jolanda Esterelin. Që ajo ta shohë se nuk jam merhum. Se nuk jam plak. Se mund të vazhdoj në detyrën për të çuar përpara këtë dreq vend me budallenj. As që më interesojnë priftërinjtë, gringot, komplotistët, të arratisurit. Jam vetë i zoti për ata mutër. Por, për të shaluar atë vajzë, kam nevojë për ndihmën tënde. Mos u bëj koprac, mos ji dorështrënguar. Më ndihmo. Më jep fuqinë e duhur." Mori frymë thellë, me një dyshim idhnak ndaj atij të cilit i lutej, nëse ekzistonte, dhe po vëzhgonte si i dehur drejt asaj thellësie mavi ku po shfaqeshin yjet e parë.

  Duke shëtitur përgjatë Maksimo Gomesit, po i buisnin kujtime. Shtëpitë që po linte pas ishin simbole personash të njohur dhe ngjarjesh të rëndësishmegjatë tridhjetë e një viteve të tij në pushtet. Ja shtëpia e Ramfisit, në tokën e Anselmo Paulinos, krahu i tij i djathtë për dhjetë vjet rresht, deri në vitin 1955, kur ia konfiskoi të gjitha pronat dhe, pasi e futi za kohë në burg, e dëgdisi në Zvicër me një çek prej shtatë milionë dollarësh për shërbimet e bëra. Përballë shtëpisë së Angjelitës dhe Peçito Leon Estevesit, më përpara ka qenë ajo e gjeneralit Ludovino Fernandes, shtazës së papërtuar për të ndihmuar të tjerët, i cili derdhi aq gjak për regjimin, por që Truhijo qe i detyruar ta vriste, i helmuar nga ambiciet politike. Pranë Vilës Radames ndodheshin kopshtet e ambasadës së Shteteve të Bashkuara, për më shumë se njëzet e tetë vjet shtëpi miqsh, por tani e kthyer në një fole gjarpërinjsh. Ja ku ishte edhe play i beisbollit, që e ndërtoi për t'u dëfryer Ramfisi dhe Radamesi, duke luajtur top. Ja ku janë si dy motra binjake, shtëpia e Balagerit dhe nunciatura,

edhe kjo e fundit devijoi, u bë mosmirënjohëse dhe e poshtër. Më tej shtëpia madhështore e gjeneralit Espajat, shefit të vjetër të shërbimit të tij sekret. Ndërsa përballë, në zbritje, ajo e gjeneralit Rodrigues Mendes, mik zdërhalljesh i Ramfisit. Pastaj vinin ambasadat e mbetura sekretet: Ajo e Argjentinës, e Meksikës dhe shtëpia e të vëllait, Negros. Në fund, rezidenca e Visinive, milionerëve të kallamsheqerit, me livadhin e gjerë me bar dhe me plot lehe lulesh të mbajtura me kujdes, por që në këto kohë po fishkeshin.
Kapërceu Bulevardin e gjerë dhe u hodh në trotuarin e Malekonit, ngjitur me detin. Duke ecur drejt Obeliskut, ndjeu të spërkatej nga cërkat e dallgëve. U mbështet te bankina dhe, me sytë e mbyllur, dëgjoi klithmat dhe fërfëllitjet e tufave të pulëbardhave. Puhia i mbushi mushkëritë. Një banjë pastruese që e mbushte me forcë. Por nuk duhet të harrohej pas gjërave të kota. Kishte ende për të bërë.

– Më thërrisni Xhoni Abesin.
I shkëputur nga turma e civilëve dhe ushtarakëve – Gjeneralisimi ecte me hap të shpejtë drejt lapidarit prej betoni, imitimi i Obeliskut të Uashingtonit – figura e rëndomtë dhe e squllur e shefit të SIM-it, u afrua në krah të tij. Për shkak të dhjamosjes, Xhoni Abesi e ndiqte me zor Gjeneralissimin.
– Ç'po ndodh me Huan Tomasin? - e pyeti pa ia hedhur sytë.
– Asgjë me rëndësi, Shkëlqesi, - u përgjigj shefi i SIM-it. - Sot ishte në fermën e vet, në Moka, me Antonio de la Masën. Çuan një viç. Pati një zënkë familjare mes gjeneralit dhe së shoqes, Çanës. Ajo qahej se prerja dhe kripja e mishit donte shumë punë.
– A është takuar Balageri me Huan Tomasin, këto ditë? - e ndërpreu Truhijo.
Ngaqë Abes Garsia po vonohej t'i përgjigjej, u kthye për ta parë. Koloneli mohoi me kokë.
– Jo, Shkëlqesi. Me sa di unë, ka kohë që nuk janë parë. Pse më pyesni?
– Për asgjë konkrete, - mblodhi supet Gjeneralissimi. - Sot në zyrë, me t'i përmendur komplotin e Huan Tomasit, vura re diçka të habitshme. Ndjeva diçka të rrallë. Nuk di se çfarë qe. Në gjurmimet e tua, nuk ke vënë re ndonjë gjë të dyshimtë te Presidenti?
– Asgjë, Shkëlqesi. Ju e dini që e kam nën vëzhgim njëzet e

katër orë në ditë. Deri tani nuk ka shkelur në dërrasë të kalbur, nuk takon njeri. Të gjitha telefonatat që bën, kontrollohen.
Truhijo tundi kokën në heshtje. Nuk kishte arsye për të mos besuar te Presidenti kukull. Parandjenja mund të ishte e gabuar. Mund të mos ekzistonte ai komplot. Antonio de la Masa mund të mos ekzistonte? U nervozua sërish: Ngaqë nuk mund të hante dot mirë dhe nuk mund të pinte shumë uiski. Ashtu, e? Dashkan të përlajnë një viç të tërë këtë natë. Po sikur të hyj befas në shtëpinë e Huan Tomasit, në Gaske? "Mirëmbrëma, zotërinj! Ju prishet punë po ta hamë bashkë këtë viç të pjekur? Era e mishit të pjekur më ndolli këtu, që nga Pallati. Oh, ç'erë e këndshme!" Çfarë do t'i pushtonte fytyrat e tyre: Tmerri apo gëzimi? Mos do të pandehnin se kjo vizitë e papritur ishte vula e reabilitimit të gjeneralit? Jo, këtë natë drejt e në San Kristobal. Do ta bënte të rënkonte Jolanda Esterelin dhe të nesërmen do të ndihej më i shëndetshëm, më i ri.

– Pse e le të nisej për në Shtetet e Bashkuara të bijën e Kabralit para dy javësh?
Kjo qe fare e beftë për Abes Garsian. Ea pa të kalonte dorën mbi faqet e fryra, pa ditur ç'të thoshte.
– Bijën e senatorit Agustin Kabral? - pëshpëriti për të fituar kohë.
– Urani Kabrali, bija e Inteligjentit. Murgeshat e Santo Domingos i kanë siguruar një bursë për në Shtetet e Bashkuara. Pse e le të dalë nga vendi pa më pyetur mua?
– Më ndjeni, Shkëlqesi, - tha, duke ulur kokën. - Udhëzimet tuaja ishin të ndiqnim dhe të arrestonim senatorin nëse do të përpiqej të kërkonte azil politik. Nuk më shkoi mendja për vajzën, duke ditur se një natë më parë, ajo ndodhej në Shtëpinë me Mogan, po ashtu dija që kishte një leje-dalje të firmosur nga Presidenti Balager... Në të vërtetë, as që mendova ta diskutoj çështjen, nuk ma mori mendja se qe me rëndësi.
– Duhet t'i mendoje këto gjëra, - e paralajmëroi Truhijo. - Dua të hetosh personelin e sekretarisë sime. Dikush më ka fshehur një relacion të Balagerit për udhëtimin e asaj vajze. Dua të di cili qe dhe pse e bëri.
– Menjëherë, Shkëlqesi. Ju lutem, të më falni për këtë pakujdesi. Nuk do të ndodhë kurrë më.
– Shpresoj të jetë ashtu, - e hoqi qafe Truhijo.
Koloneli bëri një nderim ushtarak (të bënte për të qeshur)

dhe u kthye te kurtizanët. Gjeneralissimi eci ndaj dy blloqe pa thirrur askënd, duke u menduar. Abes Garsia i kishte zbatuar pjesërisht udhëzimet për të larguar rojat dhe kalecët. Në cepat e rrugëve nuk dukeshin më prita me tela dhe barrikada, as Volksvagenët e vegjël, as policë me uniformë dhe automatikë. Por aty-këtu në fillimet e rrugëve që kryqëzonin Bulevardin, dallohej së largu ndonjë morr i zi me koka kalecësh në dritare, apo civilë me pamje rrufanësh, të mbështetur në shtyllat e rrugëve, me sqetulla të fryra nga pistoletat. Nuk qe ndërprerë trafiku përgjatë bulevardit Xhorxh Uashington. Nga dritaret e kamionëve dhe autoveturave, nxitonin kryet njerëz të përshëndesnin: "Rroftë Udhëheqësi!". I përqendruar në punën e shëtitjes, që i kishte dhënë trupit të vet një nxehje të parakohshme e njëfarë lodhjeje këmbësh, i përshëndeste me dorë. Në Bulevard nuk kishte këmbësorë të rritur. Vetëm fëmijë të leckosur, lustraxhinj këpucësh dhe shitës çokollatash e ciguresh, të cilët e shihnin me habi. Duke kaluar, u buzëqeshte e u hidhte monedha (i mbante gjithmonë në xhepat plot). Pak më vonë thirri Lyrashin.

Senatori Çirinos u afrua duke gulçuar, si zagar gjuahu. Djersinte më shumë se Modesto Dias. Merrte frymë me zor. Konstitucionalisti Sarhosh ishte më i ri se Gjeneralissimi, por një shëtitje e vogël e kënaqte. Nuk iu përgjigj fare përshëndetjes së tij, por e pyeti drejtpërdrejt:

– E thirre Ramfisin? Të dha shpjegime lidhur me "Lloyd's" e Londrës?
– Fola dy herë me të, - senatori Çirinos tërhiqte këmbët zvarrë dhe xhollat e këpucëve të deformuara përplaseshin në pllakat e dala prej rrënjëve të pemëve. - I shpjegova çështjen, i përsërita urdhrat tuaja. Pra, kuptohet... Por në fund pranoi arsyet e mia. Më premtoi dokumentin e "Lloyd's", e sqaroi keqkuptimin dhe pranoi se shuma duhet të jetë transferuar në Bankën Qendrore.
– E ka bërë, apo jo? - e ndërpreu Truhijo me ashpërsi.
– Për këtë e thirra herën e dytë, i nderuar Shef. Dua që një përkthyes të kontrollojë telegramin e tij, sepse anglishtja e tij nuk është e saktë e, për pasojë, nuk mund të mbërrijë në "Lloyd's" me gabime. Por, do ta dërgojë patjetër. Më tha se i vinte keq për çfarë kishte ndodhur.

A duhet ta besonte se do t'i bindej Ramfisi tani që ishte kaq i

moshuar? Më përpara nuk do të guxonte t'ia bënte dysh fjalën me ndonjë pretekst të kotë.

– Thirre përsëri, - urdhëroi prerë. - Nëse nuk e rregullon sot këtë ngatërresë me "Lloyd's", do të ketë punë me mua.
– Si urdhëron, i nderuar Shef. Mos ki merak, Ramfisi e ka të qartë situatën.
U nda nga Çirinosi dhe vendosi t'i japë fund shëtitjes i vetmuar, për të mos i zhgënjyer të tjerët, të cilët dëshironin aq shumë të shkëmbenin ndonjë fjalë me të. Por, pak më vonë, priti turmën e lakejve që e ndiqte dhe u përzje me të, duke u futur në llozhën e Virhilio Alvares Pinës dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Brendshme dhe Kultit, Paino Piçardos. Në atë grup ishin edhe Neshteri Espajat, shefi i Policisë, drejtori i "Karaibeve" dhe kryetari i sapoemëruar i Senatit, Heremias Kintanija, të cilit i uroi suksese në detyrën e re. I sapograduari rrezëllinte nga kënaqësia, duke zbrazur falënderime. Me hapin e vet të shpejtë, duke ecur anës detit gjithnjë në drejtim të lindjes, tha me zë të lartë:
– Ejani, zotërinj, tregomëni barsoletat e fundit antitruhijiste.
Një valë të qeshurash iu përgjigj si shpërblim ironisë së tij dhe, pak më pas, të gjithë llomotitnin si papagallë. Për një çast pa gjeneralin Hose Rene Roman që dukej i mërzitur. Sekretari i Shtetit të Forcave të Armatosura nuk mund ta fshihte dot shqetësimin e vet: Ç'qortim do t'i bënte Gjeneralissimi? Së shpejti do ta marrësh vesh, budalla. Duke kaluar sa nga një grup te tjetri, me qëllim që askush të mos ndihej i papërfillur, përshkoi kopshtet e mirëmbajtura të Hotel Haraguas, nga ku deri te veshët e tij mbërritën tingujt e orkestrës që gjallëronin orën e koktejit, dhe një bllok më tej, kaloi nën ballkonet e Partisë Domenikane. Punonjës, zyrtarë dhe njerëz që kishin shkuar për të kërkuar shpërblime, dolën për ta duartrokitur. Me të mbërritur tek obelisku, pa orën: Një orë e tri minuta shëtitje. Po errej. Tani nuk dëgjoheshin më pulëbardhat. Ishin fshehur në foletë e tyre gjatë plazhit. Tek-tuk kishin filluar të regëtinin yje. Disa re të shtrira kishin zënë hënën. Te këmbët e obeliskut e priste Kadillaku, modeli i fundit, që kishte dalë për herë të parë javën e kaluar. I përshëndeti të gjithë ("Natën e mirë, zotërinj, ju faleminderit për shoqërimin") dhe me një gjest autoritar, i tregoi gjeneralit Hose Rene Roman derën e autoveturës që e mbante hapur shoferi me uniformë:

– Ti, eja me mua.
Gjeneral Romani, duke nderuar ushtarakisht, iu bind menjëherë. Hyri në autoveturë dhe u struk në një cyp, ku qëndronte si i ngrirë me kapelen te gjunjët.
– Në San Isidro, në Bazë.
Ndërsa autovetura shtetërore ecte drejt qendrës për të dalë në bregun lindor të Ozamas, tek Ura Radames, pa i shijuar udhëtimin si të ishte vetëm fare. Gjeneral Romani, pa guxuar t'i drejtonte asnjë fjalë, po priste furtunën. Dhe furtuna i dha shenjat e para, pasi kishin bërë nja tri milje, nga dhjetë që ndanin obeliskun me Bazën Ajrore.
– Sa vjeç je? - e pyeti pa ia hedhur sytë.
– Sapo kam mbushur pesëdhjetë e gjashtë, Gjeneralissimo.
Romani (të gjithë e quanin Pupo) ishte një trup atleti. I gjatë, i fortë, me flokë të qethur shkurt, gati të rruar. Falë sportit, kishte një fizik të shkëlqyer, pa pikë dhjami. I përgjigjej me të pakët, me ndrojtje, duke u përpjekur ta qetësonte.
– Sa kohë ke në ushtri? - vazhdoi Truhijo, duke parë gjithmonë jashtë, si të pyeste dikë që s'ekzistonte.
– Tridhjetë e një, i nderuar Shef, qysh nga gradimi im i parë.
Heshtti disa çaste. Më në fund, u kthye nga gradimi im i parë. Armatosura, i shtyrë, si gjithmonë, nga një përcmim i pafund. Në terrin që ishte shtuar shpejt, nuk mund t'ia shihte fytyrën, po ishte i sigurt se Pupo Romani përpëlitej sytë ose i mbante gjysmë të mbyllur, si fëmijët kur zgjohen natën dhe shikojnë errësirën të tmerruar.
– Dhe në kaq vjet, nuk ke mësuar akoma se eproori përgjigjet për vartësit e tij? Se është përgjegjës për mungesat e tyre?
– E di shumë mirë, Gjeneralissimo. Në qoftë se më thoni për se bëhet fjalë, ndoshta mund t'ju jap shpjegime.
– Do ta marrësh vesh pse bëhet fjalë, - tha Truhijo, me atë qetësinë e vet në dukje, së cilës bashkëpunëtorët i trembëshin më shumë se të bërtiturave. - Ti lahesh e sapunisesh çdo ditë?
– Po, i nderuar Shef, - gjeneral Romani u përpoq të buzëqeshte, po ngaqë Gjeneralissimi vazhdoi serioz, heshti.
– Besoj se është ashtu, falë Mirejës. Më duket shumë mirë që lahesh e sapunisesh çdo ditë, që e mban uniformën të hekurosur dhe këpucët të lustruara. Si shef i Forcave të Armatosura të takon t'u japësh shembullin e pastërtisë dhe pamjes korrekte oficerëve dhe ushtarëve domenikanë. Nuk është kështu?

- Pa dyshim që është ashtu, i nderuar Shef, - u përgjigj plot druajtje gjenerali. - Ju lutem, më thoni se ku kam gabuar. Për ta rregulluar, për ta ndrequr. Nuk dua t'ju zhgënjej.
- Pamja është pasqyra e shpirtit, - filozofoi Truhijo. - Një njeri qelbash dhe me qurra të varura, nuk mund t'i besosh kurrësi, higjenën publike. Apo jo?
- E qartë që jo, i nderuar Shef.
- E njëjta gjë ndodh edhe me institucionet. Ç'respekt do të ketë për to, nëse pamja e tyre është si mos më keq?
  Gjeneral Romani parapëlqeu të heshtte. Gjeneralissimi sa vinte e po acarohej dhe filloi t'i bërtasë. Kështu vazhdoi për pesëmbëdhjetë minuta rresht, derisa mbërritën në Bazën Ajrore të San Isidros. I kujtoi Pupos se i kishte ardhur shumë keq që vajza e motrës së tij, Marinës, ishte çmendur duke u martuar me një oficer gjysmak, i cili vazhdonte të ishte akoma i tillë, edhe pse, falë krushqisë politike me Bamirësin, ishte ngjitur në majën më të lartë të hierarkisë ushtarake. Këto privilegje, në vend që ta nxisnin, e kishin bërë t'ia fuste gjumit mbi dafina, duke e zhgënjyer një mijë herë Truhijo. I mbushur vrer për paaftësinë e tij si ushtarak, njëherë e kishte detyruar t'i futej blegtorisë, a thua për të rritur bagëtinë dhe për të administruar tokat, të mos paskej nevojë për tru. Po cili kishte qenë rezultati? Nuk e kishin lënë të qetë detyrimet familjare. Ishte një turp për familjen e tij. Nuk kishte pesëmbëdhjetë ditë që ai vetë kishte paguar një borxh prej katërqind mijë peso të marra nga Romani në Bankën Bujqësore, duke shmangur humbjen e pronës në kilometrin e katërmbëdhjetë të autostradës Duarte. E, prapëseprapë, nuk bënte as më të voglën përpjekje për të vënë pak mend.
  Ndërkohë që qortimet dhe sharjet binin mbi të, gjenerali Hose Rene Roman Fernandes rrinte si vuv dhe i ngrirë. Truhijo nuk rrëmbehej. Zemërimi e bënte t'i shqiptonte fjalët me kujdes, sikur kështu çdo rrokje, çdo shkronjë, do të ishte më goditëse. Shoferi ecte shpejt, pa lëvizur asnjë milimetër nga qendra e rrugës së boshatisur krejt.
- Ndalo, - urdhëroi Truhijo pak para postbllokut të parë të Bazës Ajrore të madhe e të rrethuar të San Isidros.
  Zbriti me një të kërcyer dhe, edhe pse qe errësirë, e shqoi menjëherë pellgacen me ujëra të qelbura. Currili i ndyrë vazhdonte të derdhej prej tubit të çarë dhe dheve veç xhermës e erës

së qelbur, kishte mbushur atmosferën plot miza, të cilat vërtuleshin për të të thumbar.

– Është garnizoni i parë ushtarak i Republikës, - tha Truhijo, ngadalë, duke përmbajtur me zor valën e re të tërbimit. - A të duket mirë që në hyrje të Bazës Ajrore më të rëndësishme të Karaibeve, vizitorin ta presë muti, lera, era e keqe dhe mizat? Romani qe bërë sa një grusht. Përkulej për të parë, drejtohej, përkulej prapë e nuk ngurroi fare të fëlliqte duart duke prekur tubin e ujërave të zeza në kërkim të së çarës. Me të zbuluar shkakun e zemërimit të Shefit, sikur u qetësua. Budallai, ishte trembur për diçka më të rëndë.
– Po, është turp vërtet, - mundohej të tregohej më i shqetësuar se ç'ishte. - Do të marr të gjitha masat që defekti të riparohet menjëherë, Shkëlqesi. Do t'i ndëshkoj përgjegjësit nga i pari tek i fundit.
– Duke filluar nga Virhilio Garsia Truhijo, shefi i Bazës, - shpërtheu Bamirësi. - Përgjegjësi i parë ti, i dyti është ai. Shpresoj se do të guxosh ta ndëshkosh sa më rëndë, edhe pse është nipi im dhe kunati yt. Nëse nuk do të guxosh, do të jem unë ai që do t'ju dënoj të dyve, siç e meritoni. As ti, as Virhilio, as ndonjë gjeneraluc tjetër pa vlerë, nuk do ta shkatërrojë dot veprën time. Forcat e Armatosura do të vazhdojnë të jenë institucion model, siç i kam bërë, edhe sikur ty, Virhilion dhe gjithë hiçërit me uniformë, të më duhet t'ju fus në burg ditët që ju kanë mbetur.
Gjeneral Romani përplasi takat dhe qëndroi gatitu.
– Si urdhëron, Shkëlqesi. S'do të përsëritet më, ju betohem.
Por Truhijo kishte bërë një gjysmëkthesë dhe qe futur në autoveturë.
– I mjeri ti, në qoftë se mbetet ndonjë gjurmë nga kjo që po sheh dhe po merr erë kur të kthehem këtu. Pisa ushtarakë!
Duke iu kthyer shoferit, urdhëroi: "Ikim!". U nisën, duke e lënë ministrin e Forcave të Armatosura në llucë.
Sapo la mbrapa Romanin, figurën patetike që llocoitej në atë zhermë të ndyrë, iu largua humori i keq. Lëshoi një të qeshur. Për një gjë ishte i sigurt: Pupoja do të përmbyste qiell e tokë dhe do të vinte në punë tërë djemtë e nevojshëm për të ndrequr çdo gjë. Kur ndodhte kështu sa qe ai ende gjallë, çdo të bëhej kur ai nuk do të ishte më? Kush do ta pengonte padijen, shkujdesjen dhe budallallëkun që të mos hidhnin për

tokë atë që ai kishte ngritur me aq mund? Mos do të kthehej përsëri anarkia dhe varfëria, ai bar aq i dëshiruar, të kishte qenë i 1930? Ah sikur Ramfisi, ai bar aq i dëshiruar, të kishte qenë i aftë të vazhdonte veprën dhe vendin. I interesonin vetëm të pirët, loja e polos dhe femrat. Në djall vaftë! Gjenerali Ramfis Truhijo, shefi i Shtatmadhorisë së Forcave të Armatosura të Republikës Domenikane, ishte duke luajtur polo dhe duke ia hipur balerinave të Lido de Parisit, kurse babai i tij ndeshej i vetëm këtu me Kishën Shtetët e Bashkuara, me armiqtë e brendshëm dhe budallenjtë si Pupo Romani. Tundi kokën, në orën e gjysmë të ishhte në San Kristobal, në vatrën e vet, në fermën Fundasion, të rretheuar nga fushat, me stallat e pastra, me korijet e bukura dhe me lumin e gjerë Nigua. Udhëtimin e ngadaltë gjatë luginës së këtij lumi, do ta vëzhgonte midis kurorave të moganeve, palMAve mbretërore dhe pemës së madhe anakahuita te shtëpia në kodër. Do t'i bënte mirë të ngrihej atje në mëngjes, duke pakedhelur shalët e Jolanda Esterelas, ndërsa do të kundronte atë pamje të pastër e prehese. Receta e Petronios dhe Solomonit: Një duc i njomë për t'i kthyer rininë një veterani shtatëdhjetëvjeçar.
Në Vila Radames, Zakarias de la Krus kishte nxjerrë, tashmë nga garazhi Shevrolet Bel Air 1957, ngjyrë qielli, me katër dyer, me të cilën shkonte gjithmonë në San Kristobal. Një adjutant ushtarak e priste me çantën plot me dokumente, që do t'i studionte të nesërmen në Shtëpinë me Mogan, dhe njëqind e dhjetë mijë peso për llogari të paparashikuara të fermës. Kishte njëzet vjet që nuk e ndante atë çantë, qoftë edhe për pak orë, një çantë ngjyrë kafe, me inicialet e tij të gdhendura, ku transportonte mijëra dollarë apo pesë për dhurata dhe harxhime të papritura. I tregoi adjutantit ta vendoste çantën në vendin përpara dhe i tha Zakariasit, zezakut të gjatë dhe truplidhur, i cili e shoqëronte për tridhjetë vite rresht – kishte qenë ordinanca i tij qysh në ushtri – që të zbriste shpejt. Ora nëntë. Qe vonë.
U ngjit në dhomat e tij për t'u përgatitur dhe sapo hyri në dhomën e banjës, dalloi njollën tek e çara e pantallonave, midis shalëve. Ndjeu drithma nga këmbët deri te koka: Ku ma gjete tani, e mori dreqi! I kërkoi Sinforosos një kostum tjetër ngjyrë

ulliri e rroba të brendshme të tjera. Humbi pesëmbëdhjetë minuta në bide e në lavaman, duke sapunisur e shpëlarë seksin, fytyrën dhe sqetullat e duke u parfumar para se të ndërrohej. Shkaku ishte humori i keq që i solli ai pis Pupo. Menjëherë u zhyt në një gjendje të përzishme. Ishte si një parashikim falltari për San Kristobalin. Kur po vishej, Sinforosojai zgjati telegramin: "Çështja 'Lloyd's' e zgjidhur. Fola me personin e përzemërta. Ramfis". Pra vijeshi drejtpërdrejt në Bankën Qendrore. Të fala vend ta merrte në telefon, i dërgonte telegram.

– Është ca vonë, Zakarias, - tha. - Pra, nxitohu.
– Si urdhëron, i nderuar Shef.
Rehatoi shpinën te mbështetja e kolltukut të autoveturës dhe mbylli sytë, duke u përgatitur të pushonte atë një orë e dhjetë minuta që do të mbante rruga deri në San Kristobal. Po shkonin drejt jugperëndimit, përmes bulevardit Xhorxh Uashington dhe magjistrales, kur i hapi sytë përgjysmë:
– Të kujtohet shtëpia e Monit, Zakarias?
– Atje, në Vanseslao Alvares, ku jetonte Marrero Aristi?
– Shkojmë atje.
Kishte qenë një shkëndijë, një flakërimë. Befas pa fytyrën e rrumullaktë, ngjyrë kanelle të Monit, floknajën e saj të kaçureltë, dinakërinë e atyre syve në formë bajameje e plot shkëlqim, format e saj të shtrënguara, gjinjtë e kërcyer, vithet dhe mollaqet e forta, kofshët epshndjellëse, dhe ndjeu përsëri një gudulisje të ëmbel të seksi i tij. Ndjeu t'i ngrihej dhe t'i fërkohej për pantallonash. Moni. Pse jo. Ishte një vajzë e bukur dhe e dashur, e cila kurrë nuk e kishte zhgënjyer, qysh atëherë në Kinigua, kur vetë babai i saj ia çoi në festën që e organizonin amerikanët e La Jukeras: "Shiko të pastërtin që po të bëj, i nderuar Shef". Shtëpizën ku jetonte, në qendrën e re urbane në fund të bulevardit Meksiko, ia kishte dhuruar ai, ditën e martesës së saj me një djalë nga një familje e mirë. Kur e kërkonte, dhe kjo ndodhte shpesh, e çonte në ndonjë apartament te Ambasadori apo Haragua, që Manuel Alfonsoja i kishte në gatishmëri për këto raste. Ideja të bënte dashuri me Monin në shtëpinë e saj, e eksitoi. Ta dërgonin të shonqin të pinte birrë të qoshku Poni me paratë e Truhijos – qeshi – ose të kalonte kohën me Zakarias de la Krus. Rruga qe e errët dhe e shkretë, por shtëpia kishte dritë në

katin e parë. "Thirre". Pa shoferin të kapërcente parmakun e oborrit dhe t'i binte ziles. Vonuan për t'ia hapur derën. Më në fund doli shëbyesja, me të cilën Zakariasi bisedoi me zë të ulët. Pastaj shoferi mbeti vetëm, duke pritur te dera. E bukura Moni! Ai ishte një drejtues i mirë i Partisë Domenikane në Sibao dhe ia çoi vetë të bijën te sporteli i hotelit. Një gjest simpatik. Kjo kishte ndodhur para ca vitesh, po në të vërtetë, të gjitha herët që kishte shkuar me këtë femër të bukur, ishte ndier tepër i kënaqur. Dera u hap përsëri dhe nga ndriçimi i brendshëm, pa siluetën e Monit. Pati një tjetër valë eksitimi. Ajo, pasi foli një çast me Zakariasin, eci drejt autoveturës. Në gjysmëerrësirë, nuk mund ta shihte dot si ishte veshur. Hapi derën e autoveturës që të hynte dhe e priti duke i puthur dorën:

– Nuk e prisja këtë vizitë, bukuroshe?
– Pa shiko, ç'nder! Si jeni, Shef?
Truhijo vazhdonte t'ia mbante dorën në duart e veta. Duke e patur aq afër, duke e fërkuar, duke ndier aromën e saj, u ndje zot i gjithë forcave të tij.
– Po shkoja në San Kristobal, por papritur u kujtova për ty.
– Ç'nder i madh, i nderuar Shef, - përsëriti ajo në tyren në një det hutimi. - Po ta dija, do të isha përgatitur për t'ju pritur.
– Ti gjithmonë je e bukur, sido që të ndodhesh, - e tërhoqi nga vetja dhe duke i futur duart në gjinj e shalë, e puthi. Filloi t'i ngrihej dhe ndjeu një harmoni me botën dhe jetën. Moni e linte ta përkëdhelte dhe e puthte e përmbajtur. Zakariasi qëndronte jashtë, pak metra tej Shevroletit dhe, i kujdesshëm si gjithmonë, mbante në duar pushkën automatike. Ç'po ndodhte? Moni kishte një nervozizëm të pazakontë.
– Është në shtëpi yt shoq?
– Po, - u përgjigj ajo me zë të ulët. - Ishim duke darkuar.
– Le të shkojë të kthejë ndonjë birrë, - tha Truhijo. Po bëj një xhiro rreth bllokut. Kthehem për pesë minuta.
– Po unë... - bëlbëzoi ajo dhe Gjeneralissimi ndjeu që po shtangej. U lëkund dhe më në fund pëshpëriti, aq sa gati nuk dëgjohej. - Jam me perioda, zoti Udhëheqës. Gjithë ai eksitim që pati iu zhduk në çast.
– Perioda? - gati thirri i zhgënjyer.
– Ju kërkoj ndjesë një mijë herë, zoti Udhëheqës, - bëlbëzoi ajo. - Pasnesër do të jem në rregull.

E lëshoi dhe mori frymë thellë i pakënaqur.

– Mirë, do të vij të të shoh. Adio, - nxorri kokën nga zgavra e derës prej nga Moni sapo kishte dalë. - Shkojmë, Zakarias!
Pak më vonë pyeti de la Krusin nëse kishte shkuar ndonjëherë me ndonjë femër kur ishte me perioda.
– Kurrë, zoti Udhëheqës, - u skandalizua ky me një ndjenjë krupe. - Thonë që të fut sifizilin.
– Mbi të gjitha është pisllëk, - u ankua Truhijo. Po sikur edhe Jolanda Estereli, për rastësi të djallit, të ketë, gjithashtu, periodat sot?
Kishin marrë rrugën e San Kristobalit dhe në të djathtë të tij pa dritat e Panairit Blegtoral dhe të lokalit Poni, plot me çifte që hanin e pinin. A s'ishte gjë e rrallë që Moni të tregohej aq e rezervuar dhe e frikësuar? Ajo zakonisht ishte e gjallë, gjithmonë e gatshme. Ta ketë bërë ashtu prania e burrit? A thua i kishte sajuar periodat për ta hequr qafe? Vagëllimthi dëgjoi që një makinë i binte bories. Ecte me dritat e gjata të ndezura.
– Eh, këtë të dehur... - tha Zakarias de la Krus.
Në atë çast Truhijos i shkoi në mendje se ndoshta nuk qe një i dehur dhe u kthye të gjente revolen, që e mbante në sedilje, po nuk arriti ta kapte, sepse në të njëjtën kohë, dëgjoi shpërthimin e një arme, plumbi i së cilës e thërrmoi kristalin e dritares së pasme dhe i shgiti një copë të supit dhe të krahut të majtë.

XIX

Kur Antonio de la Masa pa se me ç'fytyra u kthyen gjenerat Huan Tomas Diasi, vëllai i tij Modestoja dhe Luis Amiama, e mori vesh, para se ata të flisnin, se kërkimi i gjeneral Romanit ishte i kotë.

– Nuk mund ta besoj, - mërmëriti Luis Amiama, duke kafshuar buzët e holla. - Kuptohet qartë që Pupoja ua ka mbathur këmbëve. S'i gjendet asnjë gjurmë.
Nuk kishin lënë vend pa kërkuar, kudo ku mund të ishte, përfshirë edhe Shtatmadhorinë, te Fortesa "18 Dhjetori". Por Luis Amiama dhe Bibin Romani, vëllai i vogël i Pupos, qenë përzënë harbutshe prej aty nga rojat: Kumbari nuk mund, ose nuk donte t'i priste.
– Shpresa ime e fundit është të vihet në jetë Plani për llogari të tij, - ëndërroi jo fort i bindur Modesto Diasi. - Të mobilizojmë garnizonet dhe të bindim komandantët ushtarakë. Sidoqoftë, tani jemi në situatë të ndërlikuar.
Bisedonin në sallonin e gjeneral Diasit. Çana, gruaja e tij, u shërbeu nga një limonadë me akull.
– Duhet të fshihemi derisa të marrim vesh se ç'po ndodh me Pupon, - tha gjenerali Huan Tomas Dias.
Antonio de la Masa, i cili kishte qëndruar i heshtur, ndjeu t'i përshkonte trupin një valë zemërimi.
– Të fshihemi?! - thirri i acaruar. - Burracakët fshihen. Le ta mbajmë atë që nisëm, Huan Tomas. Vish uniformën e gjeneralit, na jep edhe ne nga një uniformë dhe ejani të shkojmë drejt e në Pallat. Prej aty t'i bëjmë thirrje popullit që të ngrihet.
– Të marrim Pallatin vetëm ne të katër? - u përpoq t'i thërriste arsyes Luis Amiama. - Je çmendur, Antonio?
– Atje s'ka njeri tani, përveç rojes, - nguli këmbë tjetri. - Duhet të veprojmë para se truhijistët të reagojnë. T'i bëjmë thirrje popullit, duke shfrytëzuar të gjithë stacionet e radiove të vendit. Që të dalë në rrugë. Ushtria do të na mbështesë.
Shprehjet skeptike të Huan Tomasit, Amiamës dhe Modesto

Diasit, e nervozuan edhe më shumë De la Masën. Pak më vonë aty mbërritën Salvador Estreja Sadalai dhe Veles Santana, i pari sapo ishte ndarë me Antonio Imbertin dhe Veles Santana, duke i lënë ata të dy te mjeku. Doktor Santana kishte shoqëruar Robert Livion deri te Klinika Internacionale. Edhe këtë mbetën të tronditur nga zhdukja e Pupo Romanit. Po ashtu, u dukej një guxim i çmendur, një vetëvrasje, ideja për të hyrë në Pallatin Kombëtar të veshur si oficerë. Të gjithë iu kundërvunë energjikisht edhe propozimit tjetër të Antonios: Ta çonin trupin e Truhijos në parkun Independencia dhe ta varnin te ledhi që populli kryeqytetas ta shihte se si kishte përfunduar. Kundërshtimi i shokëve të vet, provokoi tek Antonio de la Masa një nga ato zemërimet shpërthyese të kohëve të fundit. Frikacakë dhe tradhtarë! S'ishin në lartësinë e asaj që kishin bërë, duke çliruar atdheun nga Përbindëshi! Kur pa të hynte në sallon Çana, me sytë e shqyer nga klithmat e tij, u kuptua se i kishte tepruar. U kërkoi falje nëpër dhëmbë miqve të vet dhe heshti. Veç nga brenda ndonjë vrundull pakënaqësie.

– Të gjithë jemi nxehur, Antonio, - i rrahu shpinën Luis Amiama. - E rëndësishme tani është të gjejmë një vend të sigurt. Derisa të marrim vesh ç'bëhet me Pupon. Le ta shohim si do të reagojë populli kur të marrë vesh se Truhijo ka vdekur.
Fare i zbehtë, Antonio de la Masa, pohoi me krye. Mbi të gjithë kishte të drejtë, Amiama, i cili kishte punuar shumë për të tërhequr ushtarakët e hierarkisë të regjimit në përbetim. Luis Amiama dhe Modesto Diasi vendosën të iknin të ndarë nga njëri-tjetri. Mendonin se po të largoheshin ashtu, kishte më tepër mundësi të dilnin pa u vënë re. Antonioja e lindi Huan Tomasin dhe Turkun që të qëndronin bashkë. Shqyrtuan mundësitë (të afërm, miq) që duheshin përjashtuar. Të gjitha ato shtëpi që mund të kontrolloheshin nga policia. Ai që dha një emër të pranueshëm qe Veles Santana:
– Robert Reid Kabral. Është miku im. Plotësisht apolitik. Jeton vetëm për Mjekësinë. Nuk do t'ua mbyllë derën.
I çoi ata tek ai me makinën e tij. As gjenerali Dias, as Turku nuk e njihnin personalisht. Për Antonio de la Masa e kishte mik vëllanë e madh të Robertit, Donald Reid Kabralin, i cili punonte në Washington dhe Nju Jork për komplotin. Habia e mjekut të ri, kur i shkuan në mesnatë dhe e zgjuan, ishte e madhe. Nuk dinte asgjë për komplotin. As kishte dijeni se

i vëllai, Donaldi, bashkëpunonte me amerikanët. Megjithatë, kur e mblodhi veten, nxiton t'i ftonte të hynin në shtëpinë e tij dykatëshe të stilit morisko, aq e ngushtë, sa dukej si ato përrallave me shtriga. Ishte një djalosh mustaqepadisur, me sy dashamirës, që po bënte përpjekje mbinjerëzore për të fshehur shqetësimin e vet. U prezantoi të shoqen, Lihian, e cila ishte shtatzënë. Ajo e priti ardhjen e beftë të huajve me mirësi, pa shumë alarm. U tregoi të birin dyvjeçar, të cilin e kishin rregulluar në një kënd në dhomën e ngrënies. Çifti i ri i shoqëroi komplotistët deri te një dhomë e ngushtë në katin e dytë, që shërbente si baxho dhe depo. Ngaqë s'kishte ventilim dhe prej tavanit shumë të ulët, të nxehtit ishte i padurueshëm. Duhet të rrrinin ulur dhe me këmbët të mbledhura. Po të ngriheshin, duhej të përkuleshin të mos e përplasnin kokën te tavanit. Natën e parë mezi e duruan siktetlin dhe të nxehtit. E kaluan duke biseduar me gjysmë zëri e duke u munduar të merrnin me mend se ç'kishte ndodhur me Pupo Romanin. Pse u zhduk, kur gjithçka varej prej tij? Gjenerali Dias kujtoi bisedën që kishte bërë me të, më 24 maj – në ditëlindjen e Pupos – në fermën e tij në kilometrin e katërmbëdhjetë. I kishte siguruar atë dhe Luis Amiamën se ishte plotësisht gati të mobilizonte Forcat e Armatosura, sapo t'i tregonin kufomën.

Marselino Veles Santana ndenji me ta për t'i shoqëruar, nuk kishte arsye të fshihej. Mëngjesin e së nesërmes doli për të mësuar lajmet e reja. U kthye i shqetësuar pak para mesditës. Nuk kishte kurrfarë kryengritje ushtarake. Përkundrazi, shihej një mobilizim i ethshëm i morrave të SIM-it, i Xhipave dhe i kamionëve ushtarakë. Patrullat kontrollonin gjithë lagjet. Siç flitej, qindra burra, gra, pleq dhe fëmijë, ishin nxjerrë me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe qenë dërguar në Viktoria, El Nuevo apo Kuarenta. Po ashtu në brendësi të vendit bëheshin bastisje kundër të dyshuarve antitruhijistë. Një koleg nga La Vegas, i kishte treguar doktor Veles Santanas, se e gjithë familja e De la Masës, duke filluar nga i ati, don Vincente, të vëllezërit, motrat, nipërit, mbesat dhe të afërmit e Antonios, ishin arrestuar në Moka. Moka ishte tani një qytet i pushtuar nga rojat dhe sigurimsat. Shtëpia e Huan Tomasit, e vëllait të tij, Modestos, e Imbertit dhe e Salvadorit, ishte të rrethuar me barrikada me tela dhe me roja të armatosur.

Antonioja nuk foli. S'kishte pse të çuditej. Gjithmonë e kishte patur të qartë se po të mos fitonte komploti, reaksioni i regjimit do të ishte i një egërsie të pashoqe. I dhembi zemra kur përfytyroi të atin plak dhe të vëllezërit të poshtëruar e të keqtrajtuar nga Abes Garsia. Aty rreth orës një e gjysmë e pasdites, në rrugë u dukën dy Volksvagen të zinj plot me kalecë. Lihia, e shoqja e Reid Kabralit – vetë ai kishte shkuar në konsultore, për të mos zgjuar dyshime te fqinjët – erdhi ngadalë për t'i njoftuar se civilët të armatosur po kontrollonin shtëpinë e fqinjit. Antonioja shpërtheu me të shara (megjithatë zëulët):

– Duhet të më kishit dëgjuar, dreqi ta hajë! A s'do të qe më mirë të vdisje duke u përleshur në Pallat, se në këtë grackë?

Gjatë ditës, diskutuan dhe debatun herë pas here. Në njërin prej debateve, Veles Santana shpërtheu. E mbërtheu për këmishë gjeneral Huan Tomas Dias, duke e akuzuar se e kishte ngatërruar kot në një komplot të marrë dhe absurd, ku nuk ishte parashikuar as ikja e komplotistëve. Ku dihej se ç'do t'u ndodhte tani?! Turku Estreja Sadalai u fut midis tyre që të mos rriheshin. Antonioja mezi e mbajti të vjetërt.

Natën e dytë, tepër të lodhur nga debatet e të grindjet, zanë të flinin, duke përdorur njëri tjetrin si jastëk. Prej hapësirës së ngushtë e mbytëse, u bënë ujë në djersë gjatë u asfiksuan.

Të tretën ditë, kur doktor Santana solli në strofkën e fshehtë "Karaibet" dhe panë fotografitë e tyre nën titullin e madh: "Vrasës të kërkuar për vdekjen e Truhijos" dhe më poshtë fotografia e gjeneralit Roman Fernandes, duke përqafuar Ramfisin në funeralin e komandantit, e kuptuan se ishin të humbur. Nuk do të kishte më Juntë qytetaro-ushtarake. Ramfisi dhe Radamesi ishin kthyer dhe i tërë vendi qante për diktatorin.

– Pupoja na tradhtoi, - gjenerali Huan Tomas Dias dukej i rraskapitur. Kishte hequr këpucët. Këmbët i qenë ënjtur dhe gulçonte.
– Duhet të dalim që këtej, - tha Antonio de la Masa. - Nuk duhet ta rrezikojmë më këtë familje. Po të na zbulojnë neve, edhe ata do t'i vrasin.
– Ke të drejtë, - e mbështeti Turku. - Është gabim. Duhet të dalim nga kjo shtëpi.

Ku të shkonin? Tërë ditën e 2 qershorit e kaluan duke bërë plane të mundshme ikjeje. Pa ardhur mirë mesdita, dy morra me sigurimsa u ndalën te shtëpia përballë dhe gjysmë duzine

me njerëz të armatosur hynë në të, duke e hapur derën me shkelma. Të shqetësuar për Lihian, ata pritën me revolverët gati. Po kalecët ikën, duke hequr zvarrë një të ri, të cilit i kishin hedhur prangat. Nga e gjitha planet, më i miri dukej ai i Antonios: të gjenin një autoveturë apo kamioçinë dhe të bënin ç'ishte e mundur për të shkuar në Restauracion, te pronat e tij me pisha dhe kafe, te sharrat e Truhijos që i administronte vetë e ku ai njihte shumë njerëz. Duke qenë fare afër kufirit, nuk ishte e vështirë të kaloje në Haiti. Po si do ta siguronin makinën? Kujt t'ia kërkonin? Atë natë nuk mbyllën sy, të torturuar nga ankthi, lodhja, dëshpërimi e dyshimet. Në mesnatë, me njerëz, me lot në sy, u ngjit në baxho:

– Kanë kontrolluar tri shtëpi në këtë rrugë, - u përgjërua. - Në çdo çast do të trokasin edhe në derën time. Aq më bën për vete, nëse vdes. Po ime shoqe dhe im bir? Fëmija që pret të lindë?

Iu betuan se do të niseshin të nesërmen, më 4 qershor. Salvador Estreja vendosi të ikte vetëm. Nuk e dinte se ku, por mendonte se kishte më shumë mundësi për të shpëtuar duke qenë vetëm, sesa me Huan Tomasin dhe Antonion, emrat dhe fytyrat e cilëve ishin ato që shfaqeshin më tepër në televizion dhe gazeta. Turku u nis i pari, në gjashtë pa dhjetë, sa filloi të zbardhë e të errej. Nga persianët e dhomës së gjumit të Kabralëve, Antonio de la Masa e pa të ecte shpejt deri te cepi, ku i ngriti dorën një taksie që ndali. Ndjeu keqardhje: Turku kishte qenë miku i tij i zemrës, por kurrë nuk qenë pajtuar se do të kishte qysh nga ajo grindje e mallkuar. Nuk besonte se do të kishte tjetër mundësi. Doktor Marselino Veles Santana vendosi të rrijë edhe pak me kolegun dhe mikun e tij, doktor Reid Kabralin, të cilin e shihte tepër të mërzitur. Antonioja rruajti mustaqet dhe ngjeshi deri te veshët një kapele të vjetër që gjeti në baxho. Huan Tomas Diasi, përkundrazi, nuk bëri as më të voglën përpjekje për t'u maskuar. Të dy u përqafuan me doktor Santanan.

– Pa qejfmbetje?

– Pa qejfmbetje. Paçi fat.

Lihia Kabrali, kur i pa e falënderuan për mikpritjen, qau dhe duke bërë kryqin, u tha: "Zoti ju ruajttë!".

Kaluan tetë blloqe nëpër rrugë të shkreta, me duart në xhepa, duke shtrënguar revolverët, deri te shtëpia e një kunati të

Antonio de la Masës, Tonxhit Matos. Ky kishte një kamionçinë Ford. Ndoshta do t'ua huante apo do t'i linte t'ia "vidhnin". Po Tonxhitoja nuk ishte në shtëpi, as makina nuk ishte në garazh. Kujdestari që u hapi portën, e njohu menjëherë de la Masën: "Don Antonio! Ju këtu!". Duke i tmerruar në fytyrë. Antonioja dhe gjenerali, të sigurt se sapo të largoheshin, ai do të lajmëronte policinë, u larguan me nxit. S'dinin çfarë të bënin.

– Të të them diçka, Huan Tomas?
– Çfarë, Antonio?
– Jam i gëzuar që dolëm nga ajo vrimë minjsh. Ajo vapë dhe ai pluhur që na futej në mushkëri, nuk na linin të merrnim frymë. Ishte bezdi e madhe. Sa mirë të jesh në ajër të lirë, të ndiesh se të mbushet gjoksi.
– Toni, mos do të më thuash: "Hajde, kthejmë ndonjë birrë të ftohtë për të festuar bukurinë e kësaj jete". As që e çan trapin fare, more derëzi.
Qeshën të dy. Një e qeshur e fortë, por e shkurtër. Të bulevardi Pasteur, provuan të ndalnin ndonjë taksi. Të gjitha ishin plot.
– Më vjen keq që nuk isha me ju atje në rrugë, - tha befas gjenerali Dias, si të kujtohej për diçka të rëndësishme. - Të kisha qëlluar edhe unë mbi Çapin. Në djall të shkonte!
– Zëre se ke qenë, Huan Tomas. Për ty ata, Petanin, Negron, Petanin, Ramfisin, dhe do të shohësh. Për ata, ke qenë me ne atje te vendi, duke e ngopur me plumba Shefin. Mos e vrit mendjen. Jemi bashkë me Çapin. Në djall të shkonte!
Më në fund ndaloi një taksi. Hipën. Kur pa se ata po nxitonin të tregonin se ku do të shkonin, shoferi, një zeshkan i nginjur dhe i thinjur, i veshur me këmishë, u kthye për t'i parë. Antonioja e kuptoi që ai e kishte njohur.
– Në San Martin, - e urdhëroi.
Shoferi pranoi pa folur. Pak më vonë pështpëriti se i qe mbaruar benzina. Duhej ta mbushte. Kaloi nëpër rrugën 30 Mars, ku trafiku qe i dendur dhe te kryqëzimi i San Martinit me Tiradentesin, u ndal në një një benzinatë Teksako. Zbriti nga makina për të hapur depozitën. Antonioja dhe Huan Tomas i mbanin revolet në duar. De la Masa zhveshi këpucën dhe i hoqi takën. Prej andej nxorri një qeskë të vogël celofani dhe e futi në xhep. Ngaqë Huan Tomas po e shihte me habi, i shpjegoi:

— Është striktinë. E sigurova në Moka, kinse për një qen të tërbuar.
Gjenerali i shëndetshëm mblodhi supet, mospërfillës, dhe i tregoi revolen e vet:
— S'ka striktinë më të mirë se kjo, vëlla. Helmi është për qentë dhe gratë, mos e lodh kokën me marrëzira të tilla. Pastaj: Helmohesh me cianur, jo me striktinë, o trap.
Qeshën. Ishte një e qeshur e egër, e trishtuar.
— E shikon atë tipin që është te kabina telefonike? - Antonio de la Masa tregoi nga dritarja. - Kujt dreqi po i telefonon?
— Mbase gruas së vet ta pyesë në i ka shkuar mendja për seks.
Antonio de la Masa qeshi përsëri, këtë herë me të vërtetë, me një gaz të gjatë e të sinqertë.
— Ç'dreqin ke që qesh ashtu, budalla?
— Nuk të duket për të qeshur? - tha serioz Antonioja. - Ne të dy në këtë taksi. Ç'dreqin bëjmë këtu? Dhe nuk dimë as ku do të shkojmë.
E urdhëruan shoferin të kthehej në zonën koloniale. Antonioja i kishte shkuar në mendje diçka dhe, ndërkohë që ndodheshin në qendrën e vjetër, i thanë taksistit të futej në rrugën Espajat, nga Bilini. Atje jetonte avokati Heneroso Fernandes, të cilin e njihnin të dy. Antonioja i kujtohej se si e mallkonte ai Truhijon. Ndoshta ai mund t'u rregullonte ndonjë autoveturë. Avokati u afrua te porta, por nuk i la të hynin. Pasi e mblodhi veten - i shihte syshqyer nga tmerri - i indinjuar, i shkrepi në tru t'u kthehej me ulërimë:
— U çmendët? Ç'u thotë mendja, të më rrezikoni kështu? E dini kush hyri aty përballë para pak minutash? Konstitucionalisti Sarhosh! U menduat mirë para se ta bënit këtë gjë? Hajde, ikni! Kam familje. Ç'doni këtu? Mbathjani! Nuk ju njoh fare. Hajde, shporruni!
Ua përplasi derën në fytyrë. U kthyen në taksi. Taksisti i vjetër, i bindur vazhdonte të rrinte në timon pa i vështruar. Pas një hopi, u tha nëpër dhëmbë:
— Po tani, ku?
— Drejt parkut Indipendenca, - ia bëri Antonioja, sa për të thënë diçka.
Disa sekonda pasi u nisën - ishin ndezur dritat e rrugës dhe njerëzit kishin filluar të dilnin trotuarëve për t'u freskuar - shoferi i paralajmëroi:

– Po na ndjekin morat, janvë pas nesh. Më vjen keq vërtet, zotërinj.
Antonio de la Masa ndjeu një lloj lehtësimi. Kjo sorollatje që të përfundonin duke qëlluar me armë, sesa si dy budallenj endacakë. U kthye për të parë. Dy Volkswagen të gjelbër po i ndiqnin nja dhjetë metra larg.
– Nuk dua të vdes, zotërinj, - tha taksisti, duke u lutur. - Për Shën Virgjëreshën, zotërinj!
– Mirë, mirë. Merr për nga parku, nga të duash, dhe na lër te cepi i dyqanit të hekurishteve, - i tha Antonioja.
Kishte shumë trafik. Shoferi, duke manovruar mirë, arriti të çajë mes një autobusi i dendur me njerëz, të varur te portat e tij dhe një kamioni. Frenoi ashpër, pak metra nga fasada e madhe e kristaltë e dyqanit. Me t'u hedhur nga taksia, me revole në dorë, Antonioja pa të ndizeshin dritat e parkut, si për t'u dhënë mirëseardhjen. Kishte lustraxhinj, shitës ambulantë, lojtarë bixhozi, endacakë dhe lypësa të mbështetur mureve. Binte erë frutash e fërgesash. U kthye të ndihmonte Huan Tomasin, i cili nga shëndeti dhe lodhja, nuk e arrinte dot. Ndërkohë pas shpatullave të tyre shpërtheu një batare. Britma shurdhuese u dëgjuan përreth. Njerëzit ia dhanë vrapit përmes makinave. Karrot ngjiteshin në trotuare. Antonioja dëgjoi t'u bërtisnin me histeri: “Dorëzohuni, more derra! Jeni të rrethuar, s'keni ku veni.” Pa Huan Tomasin të mbaruar që u ndal. Qëndroi në krah të tij dhe filloi të qëllojë. Shtinte i kuturu, sepse kalecët dhe rojat fshiheshin pas Volkswagenëve, të vendosur si barrikadë në rrugë, duke e ndërprerë trafikun. Pa Huan Tomasin të binte në gjunjë, pastaj e pa të fuste tytën e pistoletës në gojë, po nuk arriti ta zbrazte, sepse një breshëri goditjesh e shtrinë përtokë. Edhe atij i kishin dhënë disa plumba, por ende nuk po vdiste. “Nuk jam i vdekur, dreqi e mori, ende jo”. E kishte zbrazur të gjithë karikatorin dhe i shtrirë përtokë mundohej të fuste dorën në xhep për të marrë striktinin. Po dora e mallkuar nuk i bindej. Nuk është më nevoja, Antonio. Pa yjet e ndritshëm të natës që sapo kishte filluar të shkëlqenin, pa fytyrën e qeshur të të vëllait, Tavitos, dhe u ndje edhe një herë i ri.

XX

Limuzina e Shefit iku dhe e la gjeneralin Hose Rene Romani atje te pellgacja e qelbur. Dridhej nga koka te këmbët, si ata ushtarët e mjerë që kishte parë të vdisnin nga malarja në garnizonin e Dahabonit, në kufirin haitiano-domenikan, në fillimet e karrierës ushtarake. Kishte shumë vite që Truhijo sillej ashpër me të, duke e bërë që në familje dhe para të tjerëve, të ndihej më pak i respektuar nga sa meritonte, duke e quajtur budalla pa kurrfarë shkaku. Po kurrë s'e kishte çuar përçmimi dhe fyerjet atje ku s'mban më, si këtë natë.
Priti ta linin të dridhurat para se të drejtohej në Bazën Ajrore të San Isidros. Oficeri i rojes u tremb kur e pa të mbijë aty, në mes të natës, në këmbë dhe tëpërbaltur, vetë shefin e Forcave të Armatosura. Gjenerali Virhilio Garsia Truhijo, komandant i San Isidros dhe kunati i Romanit – ishte vëllai binjak i Mirejës – nuk ishte. Ministri i Forcave të Armatosura mblodhi të gjithë oficerët dhe kunati i Romanit – ishte vëllai binjak i Mirejës Shkëlqesinë e Tij, duhej riparuar ipso facto, në të kundërt, do të kishte dënime të ashpra. Shefi do të vinte vetë për ta verifikuar dhe të gjithë ata e dinin sa i pamëshirshëm ishte për çështjet pastërtie. Mori një Xhip me një shofer për t'u kthyer në shtëpi. As u ndërrua, as u pastrua para se të nisej.
Hipi në Xhip dhe drejt e në Qytetin Truhijo, i tha vetes. Në të vërtetë, ato të dridhura nuk ishin për shkak të sulmit që i bëri Shefi, por nga tensioni që i kishte shkaktuar telefonata e tij. Aty mori vesh se Bamirësi ishte tepër i egërsuar. Gjatë tërë ditës, një mijë herë i kishte thënë vetes se ishte e pamundur, absolutisht e pamundur, të qe informuar prej kumbarit të vet, Luis Amiama, dhe mikut të tij, gjeneralit Huan Tomas Dias, për komplotin e guximshëm. Po të dinte gjë Truhijo, nuk do ta merrte në telefon, kurrësesi. Përkundrazi, do ta kishin arrestuar dhe tani do të ishte në Kuaranta ose El Nueve. Megjithatë krimbi i dyshimit nuk e kishte lënë të fuste ndonjë kafshatë gjatë të ngrënit. Në fund të fundit, me gjithë çastet e vështirëra

që kaloi, ishte një shpëtim që të sharat qenë për tubin e prishur dhe jo për komplotin. Vetëm ideja që Truhijo të ishte i informuar se qe njëri nga komplotistët, ia ngrinte gjakun.

Pupon mund ta akuzoje për gjithçka, por jo për paburri. Që nga koha kur ishte kadet, dhe më vonë, në tërë aktivitetin e tij ishte treguar i guximshëm dhe kishte vepruar pa iu dridhur qerpiku, duke marrë famën e mashkullit të fortë mes shokëve dhe vartësve. Gjithmonë kishte qenë më i miri në ndeshjet me grushte, me doreza dhe pa doreza. Nuk kishte lejuar kurrë të mos e respektonin. Nuk ka qenë si të tërë domenikanët, përpara Truhijos, trimëria e tij, kuptimi i nderit të tij, eklipsoheshin, paralizohej mendërisht e fizikisht, e pushtonte dobësia dhe përulja servile. Shpesh e pyeste veten: Përse vetëm prania e Shefit – zëri i tij i ëmbel si flautt dhe vështrimi i tij i ngulët – e asgjësonte moralisht.

Pikërisht për këtë pushtet që Truhijo ushtronte mbi karakterin e tij, gjenerali Romani iu përgjigj menjëherë Luis Amiamës, kur ky, para pesë muajsh, i foli për herë të parë për një përtim, që t'i jepnin fund këtij regjimi:

– Ta rrëmbejmë?! Është një marrëzi. Sa të jetë gjallë, asgjë nuk do të ndryshojë. Duhet vrarë.

Ndodheshin në fermën e bananeve që Amiama kishte në Guajabin, në Montekristi. Nga tarraca plot diell po këqyrnin ujërat e turbullta të lumit Jake. Kumbari i tregoi se ai dhe Huan Tomasi po e përgatisnin këtë operacion për të shmangur një revolucion tjetër komunist si ai i Kubës, si pasojë e rrënimit të të gjithë vendit prej këtij regjimi. Ishte një plan serioz që mbështetej në ndihmën e Shteteve të Bashkuara. Henri Dearborni, Xhon Banfieldi dhe Bob Oveni, të legatës, kishin dhënë mbështetjen e tyre zyrtare dhe i ngarkuari me përgjegjësi i CIA-s në Qytetin Truhijo, Lorenco D. Beri (“Pronari i super marketit ‘Wimy's'?” “Po, dora vetë.”), do t'i furnizonte me paratë, armët dhe eksploziv. Shtetet e Bashkuara qenë të shqetësuar nga veprimet e Truhijos, qysh me atentatin kundër Presidentit venezuelan Betankur dhe donin ta hiqnin qafe, po në të njëjtën kohë, donin të siguroheshin se nuk do të zëvendësohej nga një Fidel Kastro i dytë. Prandaj, do të mbështetej një grup serioz, qartësisht antikomunist, që do të formonte një Juntë qytetaro-ushtarake, e cila pas gjashtë muajsh, do të bënte zgjedhjet. Pupo Romani duhej ta drejtonte këtë Juntë.

Kush më mirë se ai do të siguronte përkrahjen e garnizoneve ushtarake dhe një tranzicion drejt demokracisë?

– Ta rrëmbesh dhe t'i kërkosh dorëheqjen?! – u skandalizua Romani. - S'e njihni as këtë vend, as atë vetë, miku im. Duket që s'e njihni. Kurrë s'do t'ju lërë ta kapni të gjallë. Dhe kurrë nuk do ta detyroni dot të japë dorëheqjen. Vetëm ta vrasësh.

Shoferi i Xhipit, një rreshter, e drejtonte me qetësi, ndërsa Romani thithte thellë Lucky Strike, cigaret e tij të preferuara. Po pse pranoi të bashkohej me komplotistët? Ndryshe nga Huan Tomasi, që e zuri e keqja dhe u largua nga Ushtria, Pupoja do t'i humbiste të gjitha. Kishte arritur në detyrën më të lartë që mund të aspironte një ushtarak dhe, edhe pse tregtia nuk i shkonte dhe aq mirë, pronat e veta i kishte gjithmonë në duart e veta. Rreziku për t'ia konfiskuar ishte zhdukur me pagesën e katërqind mijë pesove Bankës Bujqësore. Shefi nuk e shleu atë borxh për të shpëtuar atë, po nga ndjenja e tij arrogante që familja e vet, nuk duhet të jepte kurrë një përshtypje të keqe, që imazhi i Truhijeve dhe i rrethit të tyre të ishte gjithmonë i papërlyer. Nuk qe as etja për pushtet, as perspektiva ta shihte veten në fronin e Presidentit të përhkohshëm të Republikës Domenikane – dhe mundësia e madhe për të kaluar pastaj si President i zgjedhur – ajo që e bëri të miratojë komplotin. Ishte urrejtja, e akumuluar prej vyerjeve të pafundme, me të cilat Truhijo e kishte kthyer në viktimë që kur u martua me Mirejën, martesë që e kishte bërë anëtar të klanit të privilegjuar dhe të paprekshëm. Prandaj, Shefi e ngjiti lart, para të tjerëve, e emëroi në poste të rëndësishme dhe shpesh herë i kishte bërë dhurata me para në dorë apo në forma të tjera, që i lejonin një nivel të lartë jetese. Por ato favore dhe përfitime, i qe dashur t'i paguante me fyerje dhe keqtrajtime. “Dhe kjo është ajo që kushton më shtrenjtë”, mendoi.

Në këtë pesë muaj e gjysmë, sa herë që Shefi e poshtëronte, gjeneral Romani, sikurse atë çast, kur Xhipi po kapërcente Urën e Radamesit, i thoshte vetes se së shpejti do ta ndiente veten një burrë i plotë, me jetën e vet, dhe jo një gjysmëmak, siç ndihej me Truhijon. Edhe pse Luis Amiama dhe Huan Tomasi i besuan, ai do të merrte pjesë në atë përbetim për t'i treguar Truhijos se nuk ishte i padobishëm, siç besonte ai.

Kushtet e tij ishin mjaft konkrete. Nuk do të lëvizte as gishtin, nëse sytë e tij nuk do ta shikonin të ekzekutuar. Vetëm atëherë

do të vepronte për të mobilizuar trupat dhe për të kapur vëllezërit e Truhijos dhe ushtarakët e civilët më të kompromet uar me regjimin, duke filluar nga Xhoni Abes Garsia. As Luis Amiama, as gjeneral Diasi nuk duhet t'ia përmendnin emrin – as shefit të grupit të aksionit, Antonio de la Masës – se bën pjesë në komplot. Nuk do të shkëmbenin me të asnjë mesazh të shkruar, nuk do të bënin asnjë bisedë telefonike. Vetëm biseda të drejtpërdrejta. Ai do të punonte me kujdes, duke vendosur oficerë të besuar në detyrat kyçe, në mënyrë që, kur të vinte dita, garnizonet t'i bindeshin njëzëri.
Ashtu kishte bërë, kishte vendosur në Fortesën Santiago e Kavalierëve, e dyta në vend nga madhësia, gjeneralin Qezar A. Oliva, shoku i tij i shkollës dhe mik i ngushtë. Po ashtu, mundi të vërë në komandën e Brigadës së Katërt të vendosur në Dahabon, gjeneralin Garsia Urbaes, një aleat dhe besnik i tij. U lidh edhe me gjeneralin Guarioneks Estreja, komandant i Brigadës së Dytë, e vendosur në La Vega. Nuk kishte shumë miqësi me Guaron, një truhijist i tërbuar, por duke qenë vëllai i Turkut Estreja, i cili bënte pjesë në grupin e aksionit, ishte logjike ta mendoje se do të anonte nga i vëllai. Nuk ua kishte besuar sekretin e tij asnjërit prej këtyre gjeneralëve. Kishte shumë frikë se e kallëzonin. Por e parashikonte se, me të ndodhur vrasja, të gjithë do të jepeshin pa hezitim.
Kur do të ndodhte? Pa dyshim, shumë shpejt. Në ditëlindjen e tij, më 24 maj, nja gjashtë ditë të shkuara, Luis Amiama dhe Huan Tomasi, të ftuar prej tij në shtëpinë e vet në fshat, e siguruan se gjithçka qe gati. Huan Tomasi qe i prerë: "Në çdo çast, Pupo". I thanë se Presidenti, Hoakin Balageri, do të pranonte të bënte pjesë në Juntën qytetaro-ushtarake të drejtuar prej tij, Pupos. U kërkoi detaje, por ata nuk mundën t'i jepnin. Planin e kishte bërë doktori Rafael Batle Vinjas, i martuar me Indianën, kushërirën e Antonio de la Masës dhe mjeku familjar i Balagerit. E kishte hetuar vetë Presidentin kukull, duke e pyetur se në rast zhdukjeje të papritur të Truhijos, "a do të bashkëpunonte me patriotët?". Përgjigja e tij kishte qenë kriptike: "Sipas Kushtetutës, nëse do të zhdukej Truhijo, Pupo duhej të mbështeteshin tek unë". A qe lajm i mirë ky? Pupo Romanit, ky burrth i butë dhe i trembur, i frymëzonte gjithmonë dyshimin instinktiv që meritojnë burokratët dhe intelektualët. Ishte e pamundur të dije se ç'mendonte. Sjelljet e

tij të përzemërta dhe thjeshtësia e tij e spikatur, fshehin një enigmë. Por, në fund të fundit, ajo që thonin miqtë e tij, ishte e vërtetë: Pjesëmarrja e Balagerit do t'i qetësonte jankit. Ora ishte nëntë e gjysmë e natës kur mbërriti në shtëpinë e vet, në Gaske. E nisi Xhipin në San Isidro. Mireja dhe i biri, Alvaroja, togër i ri i Ushtrisë, i cili kishte ardhur me leje t'i vizitonte, u shqetësuan kur e panë në atë gjendje. I tha Mirejës të merrte në telefon të vëllanë, gjeneralin Virhilio Truhijo, të cilin e vuri në dijeni për zemërimin e Shefit:

– Më fal, kunat, por jam i detyruar të të paralajmëroj. Nesër eja në zyrën time. Pas orës dhjetë.

– Për njëfarë tubi të prishur?! – shpërtheu gazmor Virhilio. - Është e vështirë me natyrën e tij.

Bëri një dush dhe u sapunis mirë nga koka te këmbët. Sa doli nga banja, Mireja i solli një palë pizhihama dhe një rrobdëshambër prej mëndafshi. Ajo i rrinte pranë, ndërsa ai fshinte trupin, parfumohej e vishej. Ndryshe nga çfarë besonin të shumtët, duke nisur nga Shefi, nuk ishte martuar me Mirejën për interes. Ishte dashuruar me atë vajzë brune e të ndrojtur dhe rrezikoi jetën duke i ardhur rrotull një mbesë të Truhijos. Ishte një çift i lumtur, pa zënka e ndarje për njezët e ca vjet bashkë. Duke biseduar me Mirejën në tryezë (u kufizua të pinte një gotë rum, sepse nuk kishte oreks), mendoi se ç'qëndrim do të mbante tani e shoqja. Do të ishte me burrin apo me klanin? E brente dyshimi. Shpesh e kishte parë Mirejën të indinjuar nga sjelljet përçmuese të Udhëheqësit. Mbase për këtë, do t'i merrte anën e të shoqit. Veç kësaj, cilës domenikane nuk do t'i pëlqente të bëhej dama e parë e vendit?

Pasi mbaroi darka, Alvaroja doli të ktente ndonjë birrë me miqtë e tij, ndërsa Mireja dhe ai u ngjitën në dhomën e gjumit, në katin e dytë, dhe hapën televizorin te "Zëri domenikan". Jepej një program me muzikë vallëzimi, me këngëtarë dhe orkestër të kohës. Para sanksioneve, ky stacion bënte kontrata me artistët më të mirë latino-amerikanë, por, vitin e fundit, për shkak të krizës, pothuajse i gjithë prodhimi i televizionit të Petan Truhijos, bëhej me artistë vendas. Ndërsa dëgjonin merenga dhe dancet të orkestrës "Generalisimo", e drejtuar nga maestro Luis Alberti, Mireja u lut "do Zoti të mbarojë shpejt këto zënka me Kishën". Punët sikur nuk shkonin mirë. Mikeshat e saj të lojës me letra thonin se flitej për një revolucion,

flitej se Kenedi do të dërgonte marinsat, etj. Pupoja e qetësoi: Udhëheqësi do t'ia dilte mbanë dhe vendi do të qetësohej e do të ecte në rrugë të mbarë. Zëri i tij tingëllonte aq fals, sa pushoi, duke u hequr se e zuri kolla.

Pak më vonë, u dëgjua ulërima e frenave të një makine dhe një borie e çmendur. Gjenerali u hodh nga shtrati dhe doli në dritare. Dalloi siluetën e mprehtë të gjeneralit Arturo Espajat, Neshterit, duke dalë nga autovetura që sapo kishte ndaluar. Sapo i dalloi fytyrën, të ndriçuar prej fenerëve të makinës, zemra iu hodh përpjetë: më në fund, u bë.

- Ç'kemi, Arturo? - pyeti që nga dritarja.
- Diçka shumë e rëndë ka ndodhur, - tha gjeneral Espajati, duke u afruar. - Isha me time shoqe te Poni dhe kaloi Shevroleti i Udhëheqësit. Pak më vonë dëgjova të shtëna. Vajta të shoh e u gjenda përballë zjarrit të breshërive me me mes të rrugës.
- Ngadalë, ule zërin, - bërtiti Pupo Romani. Mireja po vishte rrobdëshambrin dhe doli në ballkon, duke bërë kryqin: “O Zot, i mjeri dajo! O Zot, ç'më gjeti! O Krisht i Shenjtë!”

Nga ai çast, dhe gjatë tërë minutave e orëve të mëpastajme, kohë kur po vendosej fati i tij, i familjes së tij, i bashkëkomplotistëve dhe, tekembramja, i Republikës Domenikane, gjeneral Hose Rene Romani do ta bënte gjithçka me një rrethanat me tërë përgjegjësi. Ndërsa zbriste shkallët, mendoi se në rrethanat që ndodhej, e vetmja gjë e mençur që duhej bërë, po të donte jetën dhe mosdështimin e komplotit, ishte që t'i hapte derën ish-shefit të SIM-it, ushtarakut më të kompromentuar në operacionet kriminale të regjimit, zbatuesit të sekuestrimeve, shantazheve, torturave dhe vrasjeve të pashembullta me urdhër të Truhijos dhe t'ia zbraste të gjithë karikatorin e revolvverit të tij. Neshteri nuk kishte mundësi tjetër, veç besnikërisë prej qeni ndaj Truhijos dhe regjimit, për të mos shkuar në burg apo për të mos u vrarë.

Edhe pse e dinte shumë mirë këtë, ç'bëri ai: i hapi derën gjeneral Espajatit dhe gruas së tij, Lihia Fernandes de Espajat, të cilën e puthi në faqe duke e qetësuar, sepse ajo e kishte humbur fare toruan dhe bëlbëzonte gjëra pa kuptim. Neshteri i dha sqarime: Ndërsa afrohej me autoveturën e vet, dëgjoheshin breshëri shurdhuese revolverësh, pushkësh dhe automatikësh.

Në shkrepëtimat e tyre njohu Shevroletin e Udhëheqësit dhe arriti të shihte në rrugë figurën e një njeriu që qëllonte. Ndoshta, mbi Truhijon. Nuk mundi t'i vinte dot në ndihmë. Ishte civil dhe nuk kishte armë me vete. I tmerruar se mund ta zinte ndonjë plumb Lihian, erdhi këtu. Kjo kishte ndodhur para pesëmbëdhjetë minutash, shumë-shumë, para njëzet minutash.

– Prit, sa të vishem, - Romani i ngjiti shkallët me të hedhura, i ndjekur nga Mireja, e cila i binte kokës me grushte si e çmendur.
– Duhet lajmëruar dajo Negroja, - bërtiti, ndërkohë që ai po vishte uniformën e ditës. E pa Mirejën të rrëmbente telefonin dhe të formonte numrin, pa i dhënë kohë atij të hapte gojën. Edhe pse e dinte se s'duhej ta bënte atë telefonatë, e bëri. Kapi receptorin e telefonit dhe, duke mbërthyer këmishën, lajmëroi gjeneral Hektor Bienvenido Truhjon:
– Sapo më informuan për një atentat të mundshëm ndaj Shkëlqesisë së Tij, në rrugën e San Kristobalit. Po nisem për atje. Do t'ju mbaj në dijeni.
U vesh dhe zbriti me një karabinë automatike M-1 në duar, që e mbante gjithmonë të mbushur. Në vend që ta shkrepte me vrundull dhe t'i mbaronte punë me Neshterin, e ruajti atë edhe kësaj here dhe dhi miratoi me kokë, kur Espajati, me ca sy të vegjël si të miut, e këshilloi t'i jepte alarmin Shtatmadhorisë dhe të urdhëronte bllokimin e rrugëve. Gjeneral Romani telefonoi në Fortesën “18 Dhjetori” dhe u komunikoi të gjithë garnizoneve të viheshin në gatishmëri të plotë, të mbylleshin daljet e kryeqytetit dhe njoftoi komandantët e provincave se do të vihej menjëherë në kontakt telefonik ose radiofonik me ta për një çështje tepër të rëndësishme. Po humbiste një kohë të pariparueshme, por nuk mund të vepronte ndryshe, për të mos zgjuar asnjë lloj dyshimi në mendjen e Neshterit.
– Shkojmë, - i tha Espajatit.
– Do të çoj Ligian në shtëpi, - u përgjigj ky. - Do të takohemi rrugës. Besoj në kilometrin e shtatë.
Rrugës, në timonin e makinës së tij private, mendoi se duhet të shkonte menjëherë në shtëpinë e gjeneralit Huan Tomas Dias, pak metra nga shtëpia e tij, për të verifikuar nëse ishte bërë vrasja (ishte i sigurt se qe kryer) dhe për të vënë në lëvizje grushtin e Shtetit. Tashmë s'kishte më shpëtim. Sido që të ishte, Truhijo i vdekur apo i plagosur, ai qe bashkëkomplotist.

Por, në vend që të shkonte te Huan Tomasi ose tek Amia-ma, e drejtoi makinën për nga bulevardi Xhorxh Uashington. Pranë Panairit Bujqësor dhe Blegtoral, pa një një makinë nga po jepnin shenja me drita, kolonelin Markos Antonio Horhe Moreno, shefi i truprojës personale të Truhijos, të shoqëruar nga gjenerali Pu.

– Jemi të shqetësuar, - klithi Moreno, duke nxjerrë kokën. - Shkëlqesia e Tij nuk ka mbërritur ende në San Kristobal.

– Ka ndodhur një atentat, - i informoi Romani. - Ndiqmëni!

Në kilometrin e shtatë, nën rrezet e dritës së projektorëve të Morenos dhe Pusë, njohu Shevroletin e zi të bërë shoshë nga plumbat. Pa xhamat e dritareve të bëra copë-copë dhe njollat e gjakut në asfalt, përzier me hedhurina e copëra gjithfarëshe. Atëherë e kuptoi se atentati kishte qenë i suksesshëm. Vetëm i vdekur mund të dlihej nga ajo mori breshërish. Prandaj atë çast, duhej nënshtruar, rekrutuar ose vrarë Morenoja dhe Puja, dy truhijistë të akuzuar e të provuar për feje, e para se të arrinte Espajati me ushtaraktë e tij të tjerë, të fluturonte në Fortesën "18 Dhjetori", ku do të ishte i sigurt. Po as këtë s'e bëri.

Përkundrazi, duke treguar të njëjtin tmerr, sikurse Morenoja e Puja, kontrolloi bashkë me ta rreth e rrotull dhe gjeti një revolver midis shkurreve. Pak më vonë, erdhi aty Neshteri, pastaj menjëherë ia behën patrulla e roja, të cilët i urdhëroi të vazhdonin kërkimet. Ai duhet të ishte në Shtatmadhori.

Me autoveturën e tij zyrtare, të drejtuar prej rreshterit të parë Morones, eci drejt Fortesës "18 Dhjetori", duke tymosur pa ndërprerje Lucky Strike. Luis Amiama dhe Huan Tomasi, me kufomën e Udhëheqësit në shpinë, sigurisht ishin duke e kërkuar ethshëm. Ishte detyra e tij t'u dërgonte ndonjë sinjal. Por, në vend që të vepronte kështu, me të mbërritur në Shtatmadhori, i kërkoi rojës që, për asnjë arsye, të mos linte askënd të hynte në godinë, kushdo që të ishte.

E gjeti të ngritur në këmbë Fortesën. Ishte një gjë jo normale ajo lëvizje në atë orë. Ndërsa ngjiti shkallët me nxitim drejt zyrës së tij dhe i përgjigjej përshëndetjeve të oficerëve, dëgjoi dikë ta pyeste: "Ndonjë tentativë zbarkimi përballë Panairit Bujqësor e Blegtoral, gjeneral?", por s'i ktheu përgjigje.

Hyri i turbulluar dhe ndjeu zemrën t'i rrihte fort. Duke i hedhur një vështrim të shkurtër rreth njëzet oficerëve të gradës së lartë të mbledhur në zyrën e tij, kuptoi se, edhe pse

me shanse të humbura, kishte ende edhe një mundësi për të vënë në jetë Planin. Ata oficerë, të cilët, me ta parë, përplasën takat dhe bënë nderimin ushtarak, ishin një grup i zgjedhur me kujdes në komandën e lartë, shumica miq të tij dhe që prisnin urdhëra prej tij. E kuptonin ose e merrnin me mend se qe krijuar një zbrazëti e tmerrshme dhe, të formuar në traditën e disiplinës së rreptë dhe të varësisë së plotë nga Udhëheqësi, prisnin që ai të merrte komandën, me qëllime të qarta. Në fytyrat e gjeneralëve Fernando Sançes, Radames Hungria, Fausto Kamanjo e Feliks Permba Hermida, në ato të kolonelëve Rivera Kuesta e Krusado Pinja dhe në ato të majorëve Vesin Vesini, Pagan Montas, Saldanja, Sançes Peres, Fernandes Dominges dhe Hernando Ramires, kishte frikë dhe shpresë. Ata donin që ai t'i nxirrte nga pasiguria ndaj së cilës nuk dinin si të mbroheshin. Një ligjëratë e shqiptuar me zë të lartë nga një komandant, i cili e ka guximin e duhur dhe e di se ç'bën, duke u shpjeguar se në rrethanat tepër të rënda, zhdukja apo vdekja e Truhijos, e ndodhur për arsye që do të duhet të gjykohen mirë, Republikës i hapej një mundësi hyjnore për ndryshime. Mbi të gjitha të shmangej kaosi, anarkia, revolucioni komunist dhe dhashoja e drejtpërdrejtë e tij, pushtimi amerikan. Ata, si patriotë me zemër dhe profesion, e kishin për detyrë të veronin. Vendi po merrte rrokullimën, i futur në karantinë nga shpërdorimet e një regjimi, i cili, megjithatë në të kaluarën kishte bërë shërbime të çmuara, pati degjeneruar në një tirani që kishte provokuar zamërimin e përgjithshëm. Ishte e nevojshme t'u prije ngjarjeve me vizionin e së ardhmes. Ai do t'u bënte thirrje ta ndiqnin dhe, së bashku, të mbyllnin hendekun që kishte filluar hapur. Si komandant i Forcave të Armatosura, do të drejtonte me njerëz të rëndësishëm Juntën qytetaro-ushtarake, e ngarkuar të siguronte një tranzicion drejt demokracisë. Kjo Juntë do të bënte të hiqeshin sanksionet e vendosura nga Shtetet e Bashkuara dhe do të bënte zgjedhjet nën kontrollin e OEA-s. Junta do të mbështetej nga Uashingtoni dhe ai priste prej tyre, shefave të institucioneve më prestigjioze të vendit, një bashkëpunim të vërtetë. E kishte të qartë se fjalët e tij do të priteshin me duartrokitje dhe, dhe kishte ndonjë kundërshtar, siguria e shumicës do të fitonte. Do të ishte e lehtë atëherë t'u jepte urdhëra oficerëve drejtues si Fausto Kamanjo dhe Feliks Hermida që të arrestonin vëllezërit Truhijo

dhe të mbërthenin Abes Garsian, kolonelin Figeroa Karrion, kapitenin Kandito Torres, Klodoveo Ortisin, Ameriko Dante Minervinon, Qezar Rodriges Vijetën dhe Alisinio Riverën. Kësisoj do të shkatërrohej makineria e SIM-it.

Por, edhe pse e kishte të qartë se këto gjëra duhej t'i thoshte e t'i bënte në ato çaste, nuk bëri dot asgjë. Pas disa hapa qetësie të lëkundur, me një gjuhë të ngathët, me ndërprerje e bëlbëzime, u kufizua të njoftonte oficerët se, në kushtet e atentatit kundër Gjeneralísimit, Forcat e Armatosura duhej të qëndronin si grusht, të gatshme për të vepruar. Mund ta vend që t'u ngjallte besimin, u ngjiti pasigurinë e vet. Ata nuk e prisnin këtë prej tij. Për të pakësuar pështjellimin që ndiente, filloi bisedat telefonike me repartet e provincave. Thirri në telefon gjeneralët Qezar A. Olivian në Santiago, Garsia Urbaes në Dahabon dhe Guarioneks Estrejan në La Vega. U përsëriti atyre, me të njëjtën mënyrë të paqartë (gjuha mezi i bindej, si të ishte i dehur) se për shkak të vrasjes së supozuar, duhej t'i mbanin në kazermë trupat dhe të mos bënin asnjë lëvizje pa autorizimin e tij.

Pas thirrjeve telefonike, mundi ta shqyente pak këmishën e fshehtë që e frenonte dhe e torturonte dhe mori një iniciativë për diçka të mbarë.

– Mos u largoni, - tha dhe u ngrit në këmbë. - Do t'ju thërras menjëherë në një mbledhje të një rëndësie të madhe.

Urdhëroi të thërrisnin Presidentin e Republikës, shefin e SIM-it dhe ish-Presidentin, gjeneral Hektor Bienvenido Truhijo. Sapo të vinin, do t'i arrestonte të tre. Në qoftë se Balageri bënte pjesë në komplot, do t'i jepte më pas dorën. Vuri re njëfarë pështjellimi tek oficerët: shkëmbime vështrimesh, pëshpëritje. I kaluan telefonin. Doktor Hoakin Balagerin sapo e kishin ngritur nga gjumi:

– Më falni që ju prisha gjumin, zoti President. Ka patur një atentat kundër Shkëlqesisë së Tij tek shkonte në San Kristobal. Si Sekretar i Forcave të Armatosura, jam duke thirrur një mbledhje urgjente në Fortesën “18 Dhjetori”. Ju lutem të vini pa humbur kohë.

Presidenti Balager ndenji pak çaste pa i kthyer përgjigje dhe Romani pandehu se u prerë komunikimi. A thua, e papritura ishte shkaku i kësaj heshtjeje? Apo dyshimi për atë telefonatë

në atë kohë? Në fund, dëgjoi përgjigjen, të shqiptuar pa më të voglin emocion:

– Nëse ka ndodhur një gjë kaq të rëndë, si President i Republikës nuk më takon të ndodhem në një repart ushtarak, po në Pallatin Kombëtar. Po shkoj atje. Ju sugjeroj që mbledhja të bëhet në zyrën time. Natën e mirë.

Pa i dhënë kohë për të replikuar, e mbylli telefonin.

Xhoni Abes Garsia e dëgjoi me vëmendje. Mirë, do të vinte në mbledhje, por pasi të dëgjonte dëshminë e kapitenit Zakarias de la Krus, i cili sapo kishte mbërritur i plagosur në Spitalin Marion. Vetëm Negro Truhijo u duk se pranoi thirrjen. "Po vij menjëherë". E pikasi se ai po çmendej nga lajmi për atë që kishte ndodhur. Por kaloi një gjysmë ore dhe ai nuk erdhi. Atëherë Hose Rene Romani e kuptoi se edhe plani i tij i minutave të fundit, kishte dështuar. Asnjëri nga ata të tre nuk ra në kurthin e tij. Dhe ai, nga mënyra se si kishte vepruar, filloi të thundosej në një rreth thithëse, prej së cilës zor se do të dilte më. Të paktën të merrte një avion ushtarak dhe t'ia mbathte në Haiti, Trinidad, Porto Riko, Antilet Franceze apo Venezuelë, ku do ta prisnin krahahapur.

Që nga ai çast filloi të zhytej gjithnjë e më shumë në një gjendje të përhënur. Pamja i errej, dhe në vend që të ecte përpara, vinte rrotull sërish me një çmeritje që e ligështonte dhe e tërbonte. Nuk do të dilte dot më nga ajo gjendje për katër muaj e gjysmë jetë që i kishin mbetur, nëse mund të quhej jetë dhe jo ferr ajo torturë. Deri më 12 tetor të vitit 1961 nuk mundi të kishte një kuptim të qartë të kohës, përkundrazi, pati ndjesinë e një amëshimi misterioz, që kurrë nuk i zgjoi interes. Herë-herë, hapa të befta kthjellimi i kujtonin se ishte gjallë, se nuk kishte mbaruar ende. Në ato çaste e shtypte e njëjta pyetje sfiliste: Pse nuk veprove si duhej, kur e dije se të priste kjo? Ato pyetje e mundonte më shumë se torturat, që i përballoi me trimëri të pashoqe. Po, ndoshta ishte trimëri t'i provonte vetes, se nuk ishte shkak burracakëria, ajo që e bëri aq të pavendosur atë natë të pafudme të 31 majit të vitit 1961.

I paaftë të shpjegonte veprimet e veta, i bëri ndesh vetvetes dhe gjërat i bëri shkel e shko. E urdhëroi të kunatin, gjeneralin Virhilio Garsia Truhijo, të dërgonte nga San Isidro, ku ndodheshin divizionet e blinduara, katër tanke dhe tri kompani këmbësorie për të përforcuar Fortesën "18 Dhjetori". Por

aty për aty vendosi ta braktisë Fortesën e të shkojë në Pallat. I kërkoi shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë, gjeneralit Tuntin Sançes që ta mbante në korrent lidhur me kërkimin e vrasësve. Para se të nisej, i telefonoi në Viktoria, Ameriko Dante Minervinos. Në mënyrë kategorike, e urdhëroi të likuidonte menjëherë dhe me kujdesin maksimal, të burgosurit major Segundo Imbert Barreras dhe Rafael Augusto Sançes, duke ia zhdukur edhe kufomat, ngaqë pati frikë se mos Antonio Imberti, i grupit të aksionit, mund të kishte vënë në dijeni të vëllanë, Segundon, për bashkëpunimin e tij në komplot. Ameriko Dante Minervinoja, i mësuar me këto lloj misionesh, s'e bëri fare dysh fjalën dhe tha: "Si urdhëron, gjeneral". E çuditshme gjeneralin Tuntin Sançes, duke i thënë që të udhëzonte patrullat e SIM-it, Ushtrisë dhe Aviacionit që ishin në kërkim, se personat "armiq" dhe "të pakënaqur" që kapeshin, duhet të vriteshin në vend për kundërshtimin më të vogël ndaj arrestit. ("Nuk duam të burgosur që shërbejnë për të ndezur fushata ndërkombëtare kundër vendit tonë.") Vartësi i tij nuk tha gjë tjetër, veçse: "Do t'i transmetoj një për një udhëzimet tuaja, gjeneral".

Kur doli nga Fortesa për t'u nisur drejt Pallatit, togeri i rojes e informoi se kishte ardhur një makinë me dy civilë, njëri prej të cilëve thoshte se ishte vëllai i tij, Ramoni (Bibini). Kishin ardhur te porta dhe donin ta takonin, por togeri, duke zbatuar urdhërat e tij, i kishte larguar. Tundi kokën, pa thënë asgjë. Pra, edhe i vëllai qenkej në komplot dhe për pasojë edhe ai, Bibini, do ta paguante për shkak të këtij sorollatje dhe hezitimeve të tij. I zhytur në këtë lloj hipnoze, mendoi se plogështia e tij ndoshta vinte ngaqë, edhe pse Udhëheqësi kishte vdekur, shpirti i tij, fryma e tij apo ç'tjetër, vazhdonte ta mbante akoma skllav.

Në Pallatin Kombëtar gjeti rrëmujë dhe dëshpërim. Pothuajse e gjithë familja Truhijo ishte aty. Petani, me çizme kalorësi dhe me automatik në krah, sapo kishte mbërritur nga çifligu i tij i Bonanos dhe vinte rrotull si një kalorës karikature. Hektori (Negroja), i fundosur në një sofë, fërkonte krahët si të kishte ftohtë. Mireja dhe vjehrra e tij, Marina, ngushëllonin donja Marien, gruan e Udhëheqësit, e cila ishte fare e zbehtë dhe nervoze. Përkundrazi, Anhelita e bukur qante dhe përplaste duart, me gjithë përpjekjet e të shoqit, kolonelit Hose Leon

Esteves (Peçitos), me uniformë dhe i mërzitur, për ta qetësuar. Ndjeu sytë e të gjithëve të mbërthyer mbi vete, si ta pyesnin: A ka ndonjë të re? I përqafoi një për një. U tha se e kishte kaluar në krehër gjithë qytetin, shtëpi për shtëpi, rrugë më rrugë dhe, së shpejti... Por befas zbuloi se ata dinin më shumë se shefi i Forcave të Armatosura. Kishin kapur njërin nga komplotistët, ish-ushtarakun Pedro Livio Sedenjo, të cilin po e hetonte Abes Garsia në Klinikën Ndërkombëtare. Dhe koloneli Hose Leon Esteves, tashmë kishte njoftuar Ramfisin dhe Radamesin, të cilët po bënin përpjekje për të marrë me qira një avion të Air France për t'i sjellë nga Parisi. Po ashtu, në ato çaste, kuptoi se pushteti që i jepte detyra e tij, të cilin orët e fundit e kishte shpërdoruar, kishte filluar ta humbiste. Vendimet tani nuk dilnin më nga zyra e tij, por nga ajo e shefave të SIM-it, Xhoni Abes dhe kolonelit Figeroa Karrion, apo nga të afërmit më miqtë e ngushtë të Truhijos, si Peçitoja ose kunati i tij Virhilio. Një forcë e padukshme po e largonte nga pushteti. Nuk u çudit që Negro Truhijo nuk denjoi t'i jepte asnjë shpjegim përse nuk kishte ardhur në mbledhjen ku ai e kishte ftuar.

U nda nga grupi, u fut në një kabinë dhe telefonoi Fortesën. Urdhëroi shefin e Shtabit të Përgjithshëm që të dërgonte trupa për të rrethuar Klinikën Ndërkombëtare, të vendoste nën mbikëqyrje ish-oficerin Pedro Livio Sedenjo e të ndalonte SIM-in për ta nxjerrë andej, duke përdorur edhe forcën po të qe nevoja. I ndaluari duhej të çohej në Fortesën "18 Dhjetori". Do ta shkonte ta merrrte ai në pyetje. Tuntin Sançesi, pas një intervali ogurzi, u mjaftua ta përshëndeste: "Natën e mirë, gjenerali". I këputur, mendoi se mbase ky ishte gabimi më i madh i asaj nate.

Në sallën ku ndodheshin Truhijot, kishte më shumë njerëz. Të gjithë po dëgjonin me një qetësi të trishtë Xhoni Abes Garsian, i cili fliste në këmbë tërë hidhërim:

– Proteza që u gjet në rrugë, është e Shkëlqesisë së Tij. E ka konfirmuar doktor Fernando Kamino. Mund të supozojmë se, nëse nuk ka vdekur, gjendja e tij është e rëndë.
– Ç'po ndodh me vrasësit? - e ndërpreu Romani sfidues. - Folët me subjektin? I denoncoi bashkëpunëtorët e tij të komplotit?

Fytyra e gjerë e shefit të SIM-it, u kthye drejt tij. Sytë prej zvarraniku, i hodhën një vështrim të lagët Romanit, i cili dukej qesharak me gjendjen tmerrësisht delikat ku ndodhej.

– Ka denoncuar tre, - shpjegoi Xhoni Abesi, duke e vështruar pa i lëvizur qerpiku. - Antonio Imbertin, Luis Amiamën dhe gjeneral Huan Tomas Diasin. Ky është koka, thotë.
– A janë kapur?
– Njerëzit e mi po i kërkojnë kudo në Qytetin Truhijo, - siguroi Xhoni Abes Garsia. - Edhe diçka. Shtetet e Bashkuara mund të jenë pas kësaj.

Pështpëriti disa fjalë përgëzuese në adresë të kolonelit Xhoni Abesit dhe vajti prapë në kabinë. I telefonoi përsëri gjeneralit Tuntin Sançes. Patrullat duhet të arrestonin menjëherë gjeneral Huan Tomasin, Luis Amiamën dhe Antonio Imbertin, po ashtu familjarët e tyre, "gjallë ose vdekur, nuk kishte rëndësi, mbase më mirë të vdekur, sepse CIA mund të tentonte t'i rrëmbente e t'i nxirrte nga vendi". Kur mbaroi së foluri, një gjë e pati të qartë: siç po zhvilloheshin ngjarjet, edhe arratisja ishte e pamundur. Duhet t'ia fuste vetes me një plumb.

Në sallon, Abes Garsia vazhdonte të fliste. Tani jo më për vrasësit, por për situatën në të cilën ndodhej vendi.

– Është e domosdoshme që në këto çaste një anëtar i familjes Truhijo të marrë drejtimin e Presidencës së Republikës, - tha prerë. - Doktor Balageri duhet të japë dorëheqjen dhe t'ia lerë detyrën gjeneralit Hektor Bienvenido ose gjeneralit Hose Arismendi. Kështu vendi do ta shohë se shpirti, filozofia dhe politika e Udhëheqësit, do të dëmtohen dhe do të vazhdojnë të drejtojnë jetën domenikane.

Pati një çast hutimi. Të pranishmit shkëmbyen vështrime. Zëri i qerrtë, vulgar dhe i dhunshëm i Petan Truhijos dominoi sallën:

– Xhoni ka të drejtë. Balageri duhet të japë dorëheqjen. Ta marrim Presidencën Negroja ose unë. Populli do të marrë vesh se Truhijo nuk ka vdekur.

Duke ndjekur vështrimet e të pranishmëve, gjeneral Romani vuri re se Presidenti kukull ishte aty. I vogël dhe i matur si gjithmonë, në një karrige në cep, duke dëgjuar t'i thuhej për të, përpjekej të ruante qetësinë. I veshur si duhet, si përherë, ishte tepër i qetë, si të bëhej fjalë për një formalitet të vogël. Me një gjysmë buzëqeshje të vizatuar në fytyrë, foli me një që qetësi që e zbuti atmosferën:

– Siç e dini, unë jam President i Republikës me vendim të Gjeneralisimit, i cili gjithmonë respektoi procedurat kushtetuese.

Kam ardhur në këtë detyrë për t'i lehtësuar gjërat, jo për t'i nderlikuar. Nëse dorëheqja ime do ta qetësojë situatën, ja ku e keni. Por më lejoni një sugjerim. Para se të marrim një vendim tepër të rëndësishëm, që godet ligjshmërinë, a s'është e arsyeshme të presim ardhjen e gjeneral Ramfis Truhijos? Djali i madh i Udhëheqësit është trashëgimtari shpirtëror, ushtarak e politik i tij. A nuk ia vlen të konsultohemi me të?
Hodhi një vështrim mbi gruan, mbi atë, të cilën protokolli i qartë truhijist i detyronte kronistët shoqërorë ta quanin gjithmonë Dama e Hijshme. Marie Martines de Truhijo reagoi me autoritet:

– Doktor Balageri ka të drejtë. Derisa të vijë Ramfisi, asnjë ndryshim nuk do të ketë, - faqja e saj e rrumbullaktë i kishte rifituar ngjyrat.

Duke parë Presidentin e Republikës të ule sytë ndrojtësisht, gjeneral Romani doli për pak sekonda nga humbja mendore xhelatinoze dhe kuptoi se, në ndryshim nga ai vetë, ky njeri i vogël, i qarmatosur, që shkruante vargje dhe që dukej një gjë aq e imët në këtë botë meshkujsh me pistoleta dhe mitroloza, dinte shumë mirë se ç'farë donte dhe ç'farë bënte, sepse nuk e humbiste asnjë çast qartësinë. Gjatë asaj nate, më e gjata e jetës së tij gjysmëshekullore, gjeneral Romani zbuloi se në mbarësinë dhe trazirën që shkaktoi ndodhja me Udhëheqësin, ajo qenie dytësore, të cilin të gjithë e kishin kujtuar një dorëshkrues, një figurë dekorative të regjimit, çuditërisht kishte filluar të fitonte autoritet. Në orët që erdhën më pas, si nëpër ëndërr, pa atë asamble të afërmish, krushqish e autoritetesh truhijistë, të bëhej, të zhbëhej në grupe e të ribëhej prapë, ndërkohë që hollësitë do të lidheshin si copa që mbushin zbrazëtitë e kashelasheve, derisa t'i jepnin formë një figure të plotë. Para mesnate njoftuan se pistoleta e gjetur në vendin e atentatit, i përkiste gjeneral Huan Tomas Diasit. Kur Romani urdhëroi që, përveç shtëpisë së këtij, të kontrolloheshin edhe ato të vëllezërve të tij, e informuan se tashmë kontrolli ishte bërë nga patrullat e SIM-it, të drejtuara nga kolonel Figeroa Karrioni. Po ashtu e informuan se vëllai i taksistit Mamuzit, Modesto Diasi, i ishte dorëzuar SIM-it prej mikut të tij, rritësit të gjelave, Çuço Malapunta, ku qe strehuar e i burgosur në Kuarenta. Pesëmbëdhjetë minuta më vonë, Pupo Romani i telefonoi të

birit, Alvatos. Kërkoi t'i sillte municion special për karabinën e vet automatike M-1 që e mbante gjithnjë në sup, i bindur se në çdo çast do t'i duhej të mbronte jetën e vet ose do t'i jepte fund asaj me dorën e tij. Pas një bisede në zyrën e tij me Abes Garsian dhe kolonelin Luis Hose Leon Esteves (Peçito), mbi peshkopin Reji, mori kurajën t'i thoshte se, nën përgjegjësinë e tij, ta nxirrte me forcë nga Kolegji Santo Domingo dhe ta mbështeti tezën e shefit të SIM-it për ta ekzekutuar, sepse nuk dyshonte fare në bashkëpunimin e Kishës në makinacionin kriminal. Burri i Anhelita Truhijos, duke prekur revolen, tha se do të ishte nder për të që ta zbatonte atë urdhër. U kthye pas një ore i inatosur. Operacioni ishte kryer pa më të voglin incident, përveç disa grushteve ndaj ca murgeshave dhe dy priftërinjve shëlbues, po ashtu gringo, të cilët tentuan të mbronin peshkopin. I vetmi i vdekur ishte një qen pastor gjerman që ruante kolegjin, i cili, para se të hante plumbin, kishte kafshuar një sigurims. Peshkopi ndodhej tani në qendrën e ndalimit të Forcave Ajrore, në kilometrin e nëntë të rrugës së San Isidros. Komandanti Rodrigues Mendes, shefi i qendrës, nuk pranoi kurrësesi të ekzekutohej peshkopi dhe as që e lejoi Peçito Estevesin ta bënte këtë pa urdhërin e Presidentit të Republikës.

I çuditur, Romani pyeti nëse ishte fjala për Balagerin. I shoqi i Anhelita Truhijos, jo më pak i inatosur, pohoi:

- Me sa duket, beson se ekziston. E pabesueshme nuk është se ky furacak fut hundët në këtë punë, po që u binden urdhërave të tij. Ramfisi duhet t'i tregojë vendin.
- Nuk është nevoja të presim Ramfisin. Do t'ia rregulloj unë qejfin dhe pikërisht tani, - shpërtheu Pupo Romani. U nis me nxitim për në zyrën e Presidentit, por në korridor pati një marramendje. Mundi të arrinte deri te një kolltuk i veçuar dhe u rrëzua mbi të. Aty dremiti menjëherë. Pas nja dy orësh u zgjua, duke u hedhur përpjetë nga një ëndërr e llahtarshme polare. Iu bë sikur ndodhej në një stepë me dëborë, duke u dridhur prej të ftohtit, ku iu vërsul një lukuni ujqish. U ngrit vrrinkthi nga vendi dhe gati vrapoi drejt zyrës së Presidentit Balager. E gjeti me dyert e hapura kanatë. Hyri i vendosur dhe ushtronte autoritetin e vet mbi atë pigmen që fuste hundët ku s'i takonte, por, o Zot, u gjend ballë për ballë me vetë peshkopin Reji. I shpërfytyruar, me veladonin gjysmë të shqyer,

me gjurmë keqtrajtimi në fytyrë, figura e gjatë e peshkopit tregonte, megjithatë, një dinjitet madhështor. Presidenti i Republikës ishte duke e përcjellë.

– Ah, Imzot, shiko kush është, Sekretari i Forcave të Armatosura, gjenerali Hose Rene Roman Fernandes, vjen t'ju lypë ndjesë si autoritet ushtarak për keqkuptimin fyes. Ju jap fjalën time, por edhe në emër të shefit të Ushtrisë – a nuk është kështu, gjeneral Romani? – se as ju, as ndonjë prelat tjetër, as motrat e Santo Domingos, kurrë nuk do të shqetësohen më. Unë vetë do t'ju jap shpjegime motrave Viliemine dhe Helen Klere. Jetojmë çaste shumë të vështira dhe ju, një njeri me përvojë, duhet ta kuptoni. Ka vartës që e humbasin kontrollin dhe i kalojnë caqet, sikurse këtë natë. Nuk do t'ju shoqëroj deri në kolegj. Ju lutem, që për më të voglin problem, të kontaktoni personalisht me mua.
Peshkop Reji, i cili shihte si të qe i rrethuar me marsianë, bëri një lëvizje të ngathët koke si përshëndetje largimi. Romani iu drejtua doktor Balagerit në mënyrë arrogante, duke prekur armën e vet:

– Duhet të më shpjegoni, zoti Balager, kush jeni ju që jepni kundërdrejt ndaj një urdhërese timen, duke thirrur në një qendër ushtarake një oficer epror, pa respektuar hierarkinë e personelit? Kush dreqin besoni se jeni?
Njeriu i vogël e vërejti pa ia vënë veshin. Pasi e këqyri një çast, lëshoi një buzëqeshje miqësore. Duke i treguar karrigen përballë tryezës së punës, e ftoi të ulej. Pupo Romani nuk lëvizi nga vendi. Gjaku i gufonte në vena, si një kaldajë gati për shpërthim.

– Përgjigjuni pyetjes time, dreqin! - shpërtheu.
Por as kësaj here, Balageri nuk u trazua. Po me atë butësi me që deklamonte apo lexonte fjalimet, e paralajmëroi atërisht:

– Keni të drejtë ta humbisni toruan, gjeneral. Po me atë butësi pak veten. Jetojmë mbase çastet më kritike të Republikës dhe ju më tepër se kushdo tjetër duhet të jepni shembull qetësie.
Balageri i rezistoi vështrimit të tij të inatosur (Pupoja kishte dëshirë ta godiste, por, në të njëjtën kohë, e frenonte kureshtja) dhe, pasi u vu në vendin e vet, po me atë zë, shtoi:

– Duhet të më falënderoni që kam penguar të bënit një gabim të rëndë, gjeneral. Duke vrarë peshkopin, nuk do të mbaronin

problemet tuaja. Do të përkeqësoheshin edhe më. Po, nëse ju intereson, duhet të dini se Presidenti, tek i cili keni ardhur të flisni kodra pas bregut, është i gatshëm t'ju ndihmojë. Megjithatë, trembem se nuk do të mundem të bëj shumë për ju.

- Romani nuk e kapi kuptimin e atyre fjalëve. A thua fshihej një kërcënim prapa tyre? Po të gjykoje nga mënyra dashamirëse e vështrimit të Balagerit, jo. Zemërimi iu davarit. Tani kishte frikë. E kishte zili qetësinë e këtij xhuxhi gojëmbëltë.
- Duhet të dini se kam urdhëruar ekzekutimin e Segundo Imbertit dhe të Papito Sançesit në Viktoria, - klithi fort pa menduar ç'po thoshte. - Se edhe ata kanë qenë në përbetime. Kështu do të bëj me të gjithë të përfshirët në vrasjen e Udhëheqësit.
- Doktor Balageri miratoi në heshtje, pa e ndryshuar fare pamjen e vet.
- Ilaçe të fortë për sëmundje të rënda, - mërmëriti në mënyrë kriptike. Dhe u ngrit e eci kah dera e zyrës, duke dalë pa e përshëndetur.
- Romani qëndroi ku ishte, pa ditur ç'të bënte. Pastaj vendosi të shkojë në zyrën e vet. Në dy e gjysmë të mëngjesit, e çoi Mirejën, e cilat kishte pirë qetësues, në shtëpi, në Gaskedë* atje gjeti të vëllanë, Bibin, duke pirë me shishe "Carta Dorada" që e tundte si t'u valviste një flamur ushtarëve të gardës. Bibini, dembeli, qejfliu, kokëkrisuri, hileqari, simpatiku Bibin, mezi qëndronte në këmbë. I desh ta ngjiste në krahë deri në banjën e katit të sipërm, me shkakun se do të villte dhe do t'i lante fytyrën. Sapo mbetën vetëm, Bibini ia dha të qarit. Kundronte të vëllanë me një trishtim të pafund në sytë e vet të mbushur me lot. Një jargë e hollë si fije merimange i varej në buzë. Me zë të ulët e të copëzuar, i tregoi se ai, Luis Amiama dhe Huan Tomas Dias, e kishin kërkuar tërë natën në gjithë qytetin, dhe të dëshpëruar, e kishin mallkuar. Ç'kishte ndodhur, Pupo? Pse nuk bëre asgjë? Pse u fshehe? A kishte një Plan? Grupi i aksionit e përmbushi misionin e vet. E sollën kufomën, siç ua kërkove.
- Pse nuk e bëre tënden, Pupo? - i dridhej gjoksi nga frymëmarrja e zorshme. - Çfarë do të na ndodhë tani?
- Pati të papritura, Bibin, më erdhi Neshteri Espajat, i cili kishte parë gjithçka. Nuk munda. Tani...
- Tani kemi marrë fund, - gërhiti, duke gëlltitur qurrat, Bibini. - Luis Amiama, Huan Tomas, Antonio de la Masa, Toni Imberti,

të gjithë. Po, mbi të gjithë, ti. Ti, dhe pas teje, unë, sepse jam vëllai yt. Nëse më do sado pak, më fut një plumb, tani, në vend, Pupo. Qëllomë me këtë pushkë, përfito që jam i dehur. Para se ta bëjnë ata... Nëse më do, Pupo.

- Në këto fjalë e sipër, trokiti në derën e banjës Alvaroja: Sapo e kishin gjetur kufomën e Gjeneralizimit në bagazhin e një autoveture në shtëpinë e gjeneralit Huan Tomas Dias.
- Nuk mbylli sy tërë atë natë, as natën tjetër, as në tjetrën dhe, pothuajse në katër muaj e gjysmë, nuk mundi të provonte më ç'ishte të fjeturit e vërtetë – të shplodhej, të harronte vetveten dhe të tjerët, të zhytej në mosqenie, nga e cila të dilte pastaj i shëruar – edhe pse vërtet e humbi shumë herë vetëdijen dhe kaloi netë të gjata, ditë dhe netë, në një topitje pa kuptim, pa imazhe, pa ide, me dëshirën fikse që t'i vinte vdekja e ta shpëtonte. I dukej sikur gjithçka përzihej e bëhej rrokopujë, sikur koha qenkej kthyer e qe bërë një rrëmujë, një katrahurë, ku as më parë, as tani dhe as më vonë, nuk kishte më çaste logjike, po gjithçka përsëritej e përsëritej. Kujtonte saktësisht spektaklin, kur në Pallatin Kombëtar mbërriti donja Maria Fernandes de Truhijo, duke klithur para kufomës së Udhëheqësit: "U derdhët deri në pikën e fundit gjaku i vrasësve!". I ngatërrohej ajo skenë me një tjetër që duhet të qe një ditë më pas: Ja tek shfaqej figura shtathedhur, me uniformë ushtarake, krëk, e një Ramfisi të zbehtë, sklerotik, duke u përkulur paksa mbi arkivolin e gdhendur, duke kundruar fytyrën e grimuar të Gjeneralizimit e duke folur npër dhëmbë: "Unë nuk do të jem aq zemërgjerë, sa ti me armiqtë, baba". I dukej se Ramfisi nuk i fliste të atit, por atij vetë. Romani e përqafoi fort Ramfisin dhe me ofshamë, i pëshpëriti te veshi: "Ç'humbje e pazëvendësueshme, Ramfis. Për fat të kemi ty".
- Befas i shfaqej vetvetja, me uniformën e paradës, duke mbajtur në dorë pushkën automatike M-1, që s'e ndante kurrë nga vetja, duke asistuar në nderimet funebre të Udhëheqësit në kishën e San Kristobalit. Disa paragrafë të fjalimit të një Presidenti Balager gjigant - "Ja zotërinj, i rrëzuar nga inati i një shkulmi tradhtar, lisi i fuqishëm, i cili për më se tridhjetë vjet i mposhti të gjitha rrufetë dhe doli fitimtar ndaj tërë furtunave" - e bënë t'i lagen sytë. E dëgjonte këtë së bashku me një Ramfis të ngurosur dhe të rrethuar nga një shpurë të tërë rojash të armatosur me automatikë. Në të njëjtën kohë

e shihte veten duke kundruar (një, dy apo tri ditë më parë? radhën e pafundme prej mijëra e mijëra domenikanësh, të të gjitha moshave, profesioneve, racave e klasave shoqërore, që prisnin orë të tëra, nën një diell mizor, për të ngjitur shkallët e Pallatit, dhe në mes të thirrjeve histerike, të dhimbjes, të të fiktit, të kujave, të mblatimeve sipas zakonit vudu, t'i bënin nderimet e fundit Udhëheqësit, Burrit, Bamirësit, Gjeneralizimit, Babait. Dhe në mes të gjithë kësaj, ai dëgjonte të dhënat e adjutantëve të tij: U kap inxhinieri Uaskar Teheda dhe Salvador Estreja Sadalai; u vranë Antonio de la Masa dhe gjenerali Huan Tomas Dias në parkun Indipendencia, te qoshi Bolivar, duke u mbrojtur me armë; pak më tej, u vra menjëherë togeri Amado Garsia, i cili kishte vrarë para se ta vrisnin; u rrënua dhe u bastis shtëpia e tezes së tij, e cila i strehoi. Po ashtu, i vinin ndërmend thashethemet për zhdukjen misterioze të kumbarit të tij, Amiama Tios dhe Antonio Imbertit - Ramfisi jepte gjysmë milioni peso për këdo që do të mundësonte kapjen e tyre - dhe arrestimin e nja dyqind domenikanëve, civilë e ushtarakë në Qytetin Truhijo, Santiago, La Vega, San Pedro de Makoris dhe në një gjysmë duzine vendesh të tjerë, të kompromet uar në vrasjen e Truhijos.

– Gjithçka i përzihej, por të paktën, ishte e kuptueshme. Po ashtu ishte edhe kujtimi i fundit, i atëkohshëm, që i kishte ngelur në mendje: Me të mbaruar mesha e Gjeneralizimit në kishën e San Kristobalit, Petan Truhijo i futi krahun: "Eja me mua në makinën time, Pupo". Në Kadillakun e Petanit arriti të kuptonte - ishte gjëja e fundit që e mendoi me qartësi të plotë - se kjo ishte mudësia e vetme dhe e fundit për t'i shpëtuar asaj që do të vinte: Vetëm duke shkruar armën e tij mbi vëllanë e Udhëheqësit dhe mbi vetveten, sepse ai udhëtim nuk do të përfundonte në shtëpinë e tij në Gaskedë. Petani, pa u përpjekur të shtirej, e gënjeu - "kemi një mbledhje familjare" - dhe e çoi në Bazën e San Isidros. Në hyrje të Bazës Ajrore, dy gjeneralë, i kunati Virhilio Garsia Truhijo dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Tuntin Sançes, i bënë me dije atij se arrestohej, i akuzuar për bashkëpunim me vrasësit e Bamirësit të Atdheut, Atit të Kombit, Babait të Atdheut të Ri. Tepër të zbehtë dhe pa e parë në sy, i kërkuan armën. Ua dorëzoi me bindje automatikun M-1, prej të cilit nuk ishte ndarë për katër ditë rresht.

E çuan në një dhomë ku kishte një tavolinë, një makinë shkrimi të vjetër, një tufë letrash të bardha dhe një karrige. I thanë të hiqte rripin dhe këpucët, që ia dorëzuan një rreshteti. Veproi në heshtje, pa thënë asgjë. E lanë vetëm dhe, pas disa minutash, hynë dy miqtë më të ngushtë të Ramfisit, koloneli Luis Hose Esteves (Peçito) dhe Pirulo Sançes Rubirosa, të cilët, pa e përshëndeturt, i thanë të shkruante gjithçka dinte mbi komplotin, duke dhënë emrat e mbiemrat e komplotistëve. Gjenerali Ramfis - Presidenti Balager e kishte emëruar kryekomandant të Forcave Ajrore, Detare dhe Tokësore të Republikës dhe me dekret suprem do të afirmohej atë natë nga Kongresi - kishte informacion të saktë për pritën, falë të arrestuarve, të cilët kishin kallëzuar gjithçka.

- U ul në makinën e shkrimit dhe gjatë dy orëve bëri atë që i kërkuan. Ishte një makinë shkrimi shumë e keqe, shkruante vetëm me dy gishta dhe bëri shumë gabime, që i korrigjoi shpejt. I tregoi të gjitha, qysh nga biseda e parë gjashtë muaj të shkuara me kumbarin e tij, Luis Amiama, tregoi emrat e njëzet njerëzve që i dinte si të implikuar, por jo Bibin. Shpjegoi se për të ishte vendimtare që Shtetet e Bashkuara e mbështetnin komplotin dhe që vetë ai pranoi të drejtonte Juntën qytetaro-ushtarake, kur u vu në dijeni nga Huan Tomas. Tregoi se si konsulli Henri Dearborn edhe konsulli Xhek Benet e shefi i CIA-s në Qytetin Truhijo, Lorenzo D. Berri (Wimpy), donin që ai të kryesonte Juntën. Shkroi vetëm një gënjeshtër. Se do të merrte pjesë me një kusht: Gjeneralizimi, kurrësesi, nuk duhej të vritej, por duhej të rrëmbehej dhe të detyrohej të jepte dorëheqjen. Bashkëpunëtorët e tjerë e tradhtuan dhe nuk e mbajtën premtimin. Rilexoi fletushkat dhe i firmosi.
- Mbeti vetëm për disa çaste të gjata, duke pritur me një qetësi shpirtërore të paprovuar qysh nga nata e 30 majit. Kur erdhën ta shihnin, po errej. Ishte një grup oficerësh që nuk i njihte. I vunë prangat dhe, ashtu të zbathur, e nxorën në oborrin e Bazës dhe e hipën në një kamioçinë me xhama të errët ku lexoi “Instituti Panamerikan i Edukimit”. Mendoi se do ta çonin në Kuarenta. E njihte shumë mirë atë godinë të zymtë në rrugën 40, pranë Fabrikës Domenikane të Çimentos. Kishte qenë vetë i pranishëm, kur, pas ndërhyrjes kastriste të 14 qershorit, një nga të arrestuarit, doktor Teheda Florentino, i ulur në Fronin qesharak - një sedile Xhipi, tubo, shkopinj, kërbaçe demi, çomange

me bisht kali për të mbytur viktimën, njëkohësisht shkarkonin mbi të rrymë elektrike - u vdiq në duar, ngaqë gabimisht, tekniku i SIM-it i lëshoi rrymë me voltazh të lartë. Por në vend të Kuarentës, e çuan në El Nueve, në rrugën Mella, një rezidencë e vjetër e Pirulo Sançes Rubirosës. Edhe aty kishte një Fron, më të vogël, por më modern.

– Nuk kishte frikë. Tani jo. Paniku, që qysh nga nata e vrasjes së Truhijos, e shoqëroi "kaluar", siç thoshin ata që mbeteshin bosh në vetvete dhe që pushtoheshin nga shpirtra të ceremonive vudu, u qe larguar plotësisht. Në El Nueve, e zhveshën dhe e ulën në një karrige të nxirë, në mes të një dhome pa dritare dhe gjysmë të errët. Era e fortë e fekaleve dhe e urinës i dhanë të përziera. Karrigia ishte e shtrembër dhe pa kuptim me ato aksesorët e saj. Ishte e betonuar në sheshin e qelisë dhe kishte rripa e unaza për të lidhur këmbët dhe duart për kyçesh, gjoksin e kokën. Krahët e saj qenë të veshur me pllaka bakri për të lehtësuar kalimin e rrymës elektrike. Një tufë kabllosh dilte nga Froni dhe shkonte te tavolina apo banaku, ku kontrollohej voltazhi. Në dritën e dobët, ndërsa po e lidhnin për karrige, njohu mes Peçito Leon Estevesit dhe Sançes Rubirosës, fytyrën prej meiti të Ramfisit. I kishte hequr mustaqet dhe nuk i kishte sytë e përhershme Ray Ban. E shihte me një vështrim të fjetur si atëherë kur drejtonte torturat dhe vrasjet e të mbijetuarve të Konstacës, Maimonit dhe Estero Hondos në qershor të vitit 1959. Vazhdonte ta shihte pa folur, ndërsa njëri e rruante, tjetri, i ulur në gjunjë, i mbërthente kyçet e këmbëve, kurse një i tretë hidhte parfum në dhomë. Gjeneral Romani u rezistoi atyre syve.

– Ti je më i poshtër nga të gjithë, Pupo, - dëgjoi t'i thotë zëri i ndryshuar nga dhimbja. - Gjithçka që ishe dhe çdo gjë që kishe, ia detyroje babait. Pse e bëre këtë?

– Për dashurinë ndaj Atdheut tim, - tha.

Heshtjen një hop. Ramfisi foli përsëri:

– A është i implikuar Balageri?

– Nuk e di. Luis Amiama më ka thënë se kishin bërë përpjekje nëpërmjet mjekut të tij. Nuk ishte i sigurt. Jam i prirur besoj se nuk ka qenë.

– Ramfisi bëri një lëvizje koke dhe Pupoja ndjeu të hidhej përpjetë me një forcë cikloni. Ishte një shkundje që e dërrmoi nga koka deri te këmbët. Rripat dhe hallkat po i prisnin muskujt.

Shikonte sfera zjarri dhe gjilpëra të mprehta që i shponin poret e lëkurës. Rezistoi, pa ulërirë. Vetëm rënkonte. Megjithëse në çdo shkarkim rryme - në intervalet e shkarkimeve i hidhnin ujë për ta sjellë në vete - humbiste vetëdijen dhe të parit, përmendej përsëri. Në të tilla raste ia mbushnin hundët me një parfum shërbëtorësh. Përpiqej ta mbante sandopak veten dhe të mos përulej duke kërkuar mëshirë. Në ato skena të pambarimta torture, që i dukeshin si ëndrra të llahtarshme, për dy gjëra ishte i sigurt: Midis torturuesve kurrë nuk u duk Xhoni Abes Garsia, dhe në një çast, dikush, që mund të ishte Peçito Leon Esteves apo gjenerali Tuntin Sançes, i kishte thënë se Bibini pati vepruar shumë më mirë se ai, se kishte arritur t'i fuste vetes një plumb në gojë, kur SIM-i i shkoi në shtëpi për ta kapur. Pupoja shpesh kishte pyetur veten nëse i biri, Alvaroja, dhe Hose Reneja, të cilëve kurrë nuk u foli për komplotin, kishin bërë vetëvrasje.

- Kur mbaronin seancën e karrikes elektrike, e zvarrisnin të zhveshur dhe e hidhnin në një qeli të lagësht, ku i zbraznin kova të tëra me ujë të qelbur për ta përmendur. Për të mos e lënë të flinte, ia mbërthenin qepallat për vetullash me leukoplast. Edhe pse i kishte sytë hapur, kur humbiste vetëdijen, i fusnin në gojë substanca të pangrënshme. Disa herë dalloi se qenë fekale dhe e mbyti të vjellët. Pastaj, në atë gjendje çnjerëzore ku ra aq shpejt, stomaku mundi të mbajë çfarëdo që i hidhnin. Në sesionet e para të karrikes elektrike, e pyeste Ramfisi. Përsëriste shumë herë të njëjtën pyetje, për të parë nëse ngatërrohej. ("A është i implikuar presidenti Balager?"). Përgjigjej duke bërë përpjekje mbinjerëzore që gjuha t'i bindej. Derisa dëgjoi të qeshura dhe pastaj zërin pa ngjyrë e gati femëror të Ramfisit: "Mjaft, Pupo. Nuk ke ç'më tregon më. Tashmë i di të gjitha. Je duke paguar tradhtinë tënde ndaj babait". Me ca tonalitete të çakorduara, ishte po ai zë i orgjive gjakatare, ku u zhyt pas 14 qershorit, kur humbi arsyen dhe Udhëheqësi u detyrua ta dërgonte në një klinikë psikiatrike në Belgjikë.
- Ai qe dialogu i fundit me Ramfisin dhe nuk mundi ta shohë më. Ia kishin shkulur leukoplastet bashkë me vetullat, kur një zë i dehur dhe i kënaqur e lajmëroi: "Tani do të jesh në errësirë, që të flesh i qetë". Ndjeu gjilpërën që i shpoi qepallat. Nuk lëvizi fare, ndërkohë që ea qepnin. I erdhi çudi që nga qepja e

syve me fill, kishte më pak vuajtje nga goditjet elektrike në Fron. Deri atëherë kishte dështuar në dy përpjekje për të vrarë veten. E para, duke përplasur kokën me tërë forcat e mbetura kundër murit të qelisë. Kishte humbur ndjenjat i mbytur në gjak. Herën e dytë për pak sa ishte arritur qëllimi. Kishte mundur të ngjitej në hekura - ia kishin hequr prangat, sepse do të fillonte seanca e re në Fron - dhe kishte thyer llambën që i ndriçonte qelinë. Këmbadorazi, kishte mbledhur dhe gëlltitur të gjitha copat e thyera të qelqit, duke pritur të vdiste nga hemoragjia e brendshme. Por SIM-i i mbante dy mjekë të gatshëm dhe një ndihmë të shpejtë me medikamentet më të domosdoshme për të shmangur vdekjen e të torturuarve nga vetëvrasja. E kishin çuar në infermieri, i kishin dhënë me zor të pinte një lëng që i kishte shkaktuar të vjella dhe i kishin futur një sondë për t'i pastruar zorrët. E kishin shpëtuar që Ramfisi dhe miqtë e tij ta vrisnin pak nga pak.

- Ndodhej afër vdekjes, kur e trodhën. Nuk ia prenë herdhet me thikë, por me gërshërë, të lidhur në Fron. Dëgjonte se si shkuleshin së qeshuri dhe bënin komente të turpshme ca subjekte që ishin vetëm zëra dhe erëra shpuese sqetullash e duhani mbeturinë. Nuk ua bëri qejfin të bërtiste. Ia futën herdhet e veta në gojë dhe i gëlltiti me shpresën e madhe që të mbytej e të vdiste, gjë që kurrë nuk e kishte dëshiruar aq shumë.
- Një çast njohu zërin e Modesto Diasit, vëllait të gjeneralit Huan Tomas, për të cilin thoshin se qe domenikan po aq i zgjuar sa Inteligjenti Kabral dhe Konstitucionalisti Sarhosh. E kishin futur në të njëjtën qeli? Po e torturonin si dhe atë? Zëri i Modestos ishte i hidhur dhe akuzator:

- Për fajin tënd jemi këtu, Pupo? Pse na tradhtove? Nuk e dije ç'do të pësoje? Pendohu që tradhtove miqtë e tu dhe vendin tënd.
- Nuk pati më fuqi të shqiptonte asnjë tingull, as për të hapur gojën. Ca kohë pas kësaj, mund të ishin orë, ditë, por edhe javë, dalloi një dialog midis mjekut të SIM-it dhe Ramfis Truhijos:
- E pamundur t'ia zgjatësh më jetën, gjeneral.
- Dhe sa i mbetet? - ishte Ramfisi, pa më të voglin dyshim.
- Disa orë, ndoshta një ditë, nëse i dyfishojmë serumin. Por, në gjendjen ku ndodhet, nuk do të durojej dot asnjë shkarkim elektrik. Është e pabesueshme që ka rezistuar katër muaj, gjeneral.

– Hapu pak, atëherë nuk do ta lë që të vdesë nga një vdekje natyrore. Rri pas meje, mos të zë ndonjë kapsollë.
– I lumtur, gjenerali Hose Rene Roman, ndjeu shkrepëtimën e fundit.

XXI

Pas dy ditësh, i mbyllur në baxonh mbytëse të shtëpisë së doktor Robert Reid Kabralit, kur doktor Marselino Veles Santana, i cili kishte dalë për të marrë informacion, u kthye dhe i tha, duke u vënë një dorë ngushëlluese në sup, se shtëpia e tij në Mahatma Gandhi qe sulmuar dhe kalecët ia kishin marrë gruan dhe djalin, Salvador Estreja Sadalai vendosi të dorëzohej. Ishte bërë ujë në djersë dhe mezi mbushej frymë. Ç'mund të bënte tjetër? T'i linte ata barbarë t'ia vrisnin gruan dhe djalin? Sigurisht po i torturonin. Ankthi nuk e linte as të lutej për familjen e vet. Ndaj foli me shokët e vet të strehës se çfarë duhej të bënte.

– E kupton se ç'do të thotë kjo, Kurko? - e qortoi Antonio de la Masa. - Do të të poshtërojnë dhe torturojnë egërsisht para se të të vrasin.
– Dhe do të torturojnë familjen tënde në sytë e tu që t'i spiunosh të gjithë, - ngriti këmbë gjenerali Huan Tomas Dias.
– Askush nuk më shtyn dot hap gojën, edhe sikur të më djegin të gjallë, - u betua me lot në sy. - Por faqeziun Pupo Romanin do të denoncoj.
– I kërkuan të rrinte edhe një natë, pastaj do të iknin të gjithë, dhe ai pranoi. Me mendjen te gruaja dhe fëmijët, Luisin katërmbëdhjetëvjeç dhe Karmen Elin, as katër vjeçe, të cilët ndodheshin në birrucat e SIM-it të rrethuar nga kriminelë të pamëshirshëm, nuk mbylli sy tërë natën, duke pshertirë e pa mundur as të lutet, as të mendonte dot në gjë tjetër. E brente ndërgjegja dhe i copëtohej zemra: Si munde ta vesh në rrezik familjen tënde? Pastaj mendja i shkonte te Pedro Livio Sedenjoja, ndaj të cilit qëlluar pa dashje, gjë që ia rriste dyfish ndërgjegjen. I shkreti Pedro! Ku ndodhet tani? Ç'gabim kishin bërë me të!
– Mbasditen e 4 qershorit, ai e la i pari shtëpinë e Reid Kabralit. Ndali një taksi te cep i rrugës dhe e adresoi për në rrugën Santiago, tek inxhinieri Felisiano Sosa Mieses, kushëriri i së shoqes,

me të cilin gjithmonë kishte shkuar mirë. Donte vetëm të dinte se ç'bëhej me të shoqen, fëmijët dhe pjesën tjetër të familjes së tij, por e kishte të pamundur. Ia hapi derën vetë Felisianoja, i cili, me ta parë, thirri me gjeste: "Zot i madh!", si t'i ishte shfaqur përballë djalli.

– Ç'do këtu, Turko? - klithi me furi. - E di që kam familje? Do që të na vrasin? Ik! Më lutje, të keqen, ik këtej!
– I mbylli derën me një shprehje frike dhe neverie, sa ngriu pa ditur ç'të bënte. U kthye te taksia me një ligështim që ia dobësoi edhe kockat. Edhe pse ishte vapë, po ngrinte së ftohti.
– A më njohe se kush jam? - pyeti shoferin më pas, i ulur në sedile.
– Shoferi, me një kapele të ngjeshur deri te vetullat, nuk u kthye ta shihte.
– Ju njoha që kur hipët, - tha fare i qetë. - Mos u shqetëso. Me mua jeni i sigurt. Edhe unë jam antitruhijist. Nëse duhet ikur, do të ikim bashkë. Ku do të shkosh?
– Në ndonjë kishë, - i tha Salvadori. - Nuk ka rëndësi se tila.
– Do t'ia linte në dorë Zotit dhe po të ishte e mundur, do të rrëfehej. Pasi të shprazte nga ndërgjegja, do t'i kërkonte priftit që të thërriste policinë. Por, pa mundur të ktheheshin drejt qendrës, nëpër ca rrugë ku muzgu ku vinte më shpejt, shoferi e paralajmëroi:
– Ai tipi ju ka spiunuar, zotëri. Ja ku i ke kalecët.
– Ndalu, - e urdhëroi Salvadori. - Të zbres, që të mos të të vrasin edhe ty.
– Bëri kryqin dhe zbriti nga taksia me duart lart, duke u nguar kështu njerëzve të Volksvagenit, me automatikë dhe pistoleta, se nuk kishte ndër mend të rezistonte. I vunë ca pranga që po ia prisnin duart dhe e ngjeshën në vendin e pasmë të një morri. Dy kalecë gjysmëular mbi të, qelbeshin nga era e djersës dhe e këmbëve. U nisën. Ngaqë morën rrugën e San Pedro Makorisit, e kuptoi se po e çonin në El Nueve. Bëri të lëvizte në qetësi, duke u përpjekur të bënte kryqin e të lutej, por nuk mundi dhe kjo i dhembi. Koka e tij ishte një vorbull e zjarrtë, kaotike ku asgjë nuk qe e qetë, asnjë mendim, asnjë imazh, i bëhej se do t'i plaste.
– Ja godina e famshme në kilometrin e nëntë, e rrethuar veçmas me një mur të lartë. Përshkuan një kopsht, ku pa një fermë të rregulluar mirë e me një vilë të vjetër rrethuar me pemë

dhe shtëpi fshati në të dyja anët. E zbritën me të shtyra nga morri. Kaloi nëpër një korridor gjysmë të errët ku kishte shumë qeli me grupe njerëzish të zhveshur, dhe e shtynë në një shkallinë të gjatë. Një erë e athët fekalesh, të vjellash e mishi të përzhitur, i shpoi hundët i erdhi të përzier. I shkoi mendja se ishte në ferr. Në fundin e shkallëve, në gjysmëterr, mezi mundi të shquante një radhë qelish me dyer hekuri dhe me ca hapësira të vogla të përforcuara me hekura, të ndriçuara me koka njerëzish që përpiqeshin ta shihnin. Poshtë në bodrum i hoqën me të shqyera pantallonat, këmishën, të mbathurat, këpucët dhe çorapet. Mbeti lakuriq, vetëm me pranga në duar. Këmbët e zbathura i shkelën diçka dhe në shputat e këmbëve ndjeu një lëndë ngjitëse me të cilën ishte lyer çimentoja e ashpër e dyshemesë. Gjithmonë me të shtyra, e futën në një qeli tjetër, pothuajse fare të errët. Atje e ulën dhe e mbërthyen në një karrige pa krahë, të veshur me pllaka hekuri - pati të rrëthuthura - me rripa e hallka metalike për duart e këmbët.

– Një hop nuk ndodhi asgjë. Mundohej të lutej. Njëri nga tipat që e kishin lidhur, ashtu, i veshur vetëm me të mbathura - sytë filluan t'i mësoheshin me errësirën - spërkati ajrin me një lloj parfumi të rëndomtë "Nice", që e kishte dëgjuar të reklamohej në radio. Ndjeu të ftohtin e pllakave të hekurta në muskuj, vithe, shpatulla dhe mezi merrte frymë, i mbytur nga atmosfera e rënduar. Tani i dallonte mirë ata që e rrethonin: Siluetat, aromat dhe tiparet e tyre. Njohu atë fytyrë të flashkët me gushë të dyfishtë, që ia shtonte shëmtinë atij trupi shtrembaluq me barkun e kërcyer përpara. Rrinte i ulur në një stol mes dy të tjerëve, jo shumë larg njëri-tjetrit.

– Sa turp, dreqi të mori! I biri i gjeneralit Piro Estrejas të përzihet në këtë punë të ndyrë, - tha Xhoni Abes. - Nuk ka fare mirënjohje në ndërgjegjen tënde, more pis?

– Donte t'i përgjigjej se familja e tij nuk kishte të bënte fare me atë që kishte bërë ai, se ai i ati, as vëllezërit, as e shoqja dhe aq më pak Luisitoja dhe e vogla Karmen Eli, nuk dinin asgjë për këtë punë, kur goditja elektrike e ngriti dhe e përplasi për rripash dhe unazash që e shtrëngonin. Ndjeu sëmbime gjilpërash në lëkurë, në kokë i shpërthyen mijëra xixa të zjarrta, i shpëtoi ujët e hollë dhe të trashë e volli zorrët. Një kovë me ujë e solli në vete. Aty për aty njohu një tjetër fytyrë, në të

djathtë të Abes Garsias: Ramfis Truhijo. Deshi ta shajë dhe në të njëjtën kohë t'i lutej t'i lëshonte gruan, Luisiton dhe Karmen Elin, por gryka e tij nxorri vetëm ca tinguj pa kuptim.

- Është e vërtetë që Pupo Romani merr pjesë në komplot? - pyeti Ramfisi.
- Tjetër kovë me ujë e bëri të flasë:
- Po, po, - shqiptoi, pa e njohur zërin e vet. - Ai burracak, ai tradhtar, po. Ai na gënjeu. Më vra, gjeneral Truhijo, po leri të lirë gruan dhe fëmijët e mi. Janë të pafajshëm.
- Nuk do të jetë aq e thjeshtë, mor qen, - iu përgjigj Ramfisi. - Para se të shkosh në ferr, ka për të kaluar përmes purgatorit, mor bir kurve!
- Një shkarkesë e dytë elektrike e vërviti nëpër lidhëset - ndjeu t'i dilnin kokërdhokët e syve nga vendi si ata të një bretkose - dhe humbi ndjenjat. Kur erdhi në vete, pa se ishte në çimenton e një qelie, në një pellg balte, i zhveshur dhe i prangosur. I dhimbnin eshtrat, muskujt dhe ndiente një zjarrmi të padurueshme në herdhe dhe anus, si t'ia kishin rrjepur. Por më e tmerrshme qe etja. Fyti, gjuha, qiellza i ngjanin si zmerile të ndezura flakë. Mbylli sytë dhe u lut. Mundi ta bënte në ndërkohët kur binte në jerm. Për pak sekonda përqendrohej në lutje. I lutej Virgjëreshës së Mersedeseve, duke i kujtuar pelegrinazhin plot devocion që kishte bërë kur ishte i ri, në Santo Serro, duke u gjunjëzuar mbi Santo Serro, duke u gjunjëzuar mbi Santo Serro. Përulësisht, i lypi asaj që t'i mbronte gruan, Luisiton dhe Karmen Elin prej mizorive të Shtazës. Midis terrorit u ndje mirënjohës. Mundi të lutej përsëri.
- Kur hapi sytë, njohu të vëllanë, Guarioneksin, të shtrirë pranë tij, me trupin e zhveshur e të gjakosur, plot plagë dhe hematoma. Si e kishin bërë! O Zot, i mjeri Guaro! Gjenerali i kishte sytë hapur dhe po e shikonte në dritën e mekur të një llambe të korridorit, që hynte nga katrori i vogël i hapur dhe i përforcuar me shufra hekuri i derës së qelisë.
- Jam Turku, vëlla, jam Salvadori, - i tha, duke u zvarritur drejt tij. - A më dëgjon? A më shikon, Guaro?
- Kaloi një kohë e pambarimtë, duke u munduar të komunikonte me të vëllanë, po nuk ia doli dot. Guaroja qe gjallë: Lëvizte, rënkonte, hapte e mbyllte sytë. Herë-herë shpërthente në histeri si t'i jepte urdhra ushtrisë të tij: "Largoma atë mushkë, reshter!". Ata ia patën fshehur Planin gjeneralit Guarioneks

Estreja Sadalait, sepse e konsideronin truhijist. Çe paritur për të ziun Guaro! I arrestuar, i torturuar dhe i hetuar për diçka që as e kishte idenë. Turku u mundua t'ia shpjegonte Ramfisit dhe Xhoni Abesit kur e çuan në sallën e torturave dhe e ulën në Fron. Ua përsëriti dhe u betua shumë herë para se t'i binte të fiktë prej goditjeve elektrike. Pastaj vazhduan ta rrihnin me lloj kamxhiku, përbishte demi, që i shqiste copa lëkure. Ata as që ishin të interesuar të dinin të vërtetën. U betohej për Zotin se as Guarioneksi, as ndonjë vëlla tjetër, as i ati nuk kishin marrë pjesë në komplot dhe u klithi se ajo që po i bënin gjeneral Estreja Sadalait, ishte një padrejtësi monstruoze dhe se për këtë do të jepnin llogari në jetën tjetër. Ata, më shumë të interesuar për ta torturuar, sesa për ta hetuar, as e dëgjuan fare. Vetëm pas një kohe të gjatë - kishin kaluar, orë, ditë apo javë nga çasti kur e kapën? - e kuptoi se i jepnin rregullisht supë me copa mandioce, një fetë bukë dhe ndonjë kupë ujë, ku zakonisht pështynin para se t'ia jepnin. Asgjë nuk i interesonte më tani. Vetëm donte të lutej. E bënte këtë në çdo çast, po të qe i lirë dhe i kthjellët, e ndonjëherë edhe i përgjumur apo i alivanosur. Por jo kur e torturonin. Në Fron, dhimbja dhe frika e paralizonin. Herë-herë, vinte ndonjë mjek i SIM-it t'i kontrolluar zemrën dhe për t'i bërë ndonjë injeksion që i kthente forcat.

- Një ditë, apo natë, sepse në birucë ishte e pamundur të dije orën, e nxorrën të zhveshur dhe të prangosur nga qelia dhe duke e ngjitur shkallëve me të zvarrisur, e hodhën në një dhomë me diell. Drita e diellit e verboi. Më në fund njohu fytyrën e zverdhur të Ramfis Truhijos dhe në krah të tij, me trup të drejtë, edhe pse i plakur, pa të atin, gjeneralin Piro Estrejan. Sa e pa, Salvadorit iu mbushën sytë me lot.
- Por, në vend që të ligështohej duke parë të birin në atë gjendje, gjenerali i bërtiti plot indinjatë:

- Nuk të njoh kush je! Nuk je im bir! Vrasës! Tradhtar! - jepte e merrte duke tundur duart, i bukosur prej zemërimit. - Nuk e di se çfarë i detyrohemi Truhijos unë, ti dhe të gjithë ne? Atë njeri ke vrarë? Pendohu, more i poshtër!
- Mezi u mbajt në një tavolinë, se iu morën këmbët. Ul sytë. A thua shtirej i ati? Mos përpiqej ta bënte për vete Ramfisin që pastaj t'i shpëtonte jetën të birit? Apo zelli truhijist i babait, qe mbi ndjenjën atërore? Ky dyshim po e gërryente

tërë kohën, përveç seancave të torturave. Ato seanca i përsëriteshin çdo ditë apo çdo dy ditë, të shoqëruara pa fund me pyetje të çmendura ku, për të njëmijtën herë, i përsëritnin të njëjtën gjë, i kërkonin të njëjtat hollësi dhe ngulnin këmbë që të denonconte bashkëpunëtorët e tjerë. Asnjëherë nuk i besuan se nuk njihte njeri, veç atyre që tashmë diheshin, se asnjëri nga familjarët e tij nuk kishte marrë pjesë, absolutisht, as Guarioneksi. Gjatë sesioneve të torturave, nuk dukeshin as Xhoni Abesi, as Ramfisi. Ato i drejtonin vartësit e tyre, të cilët mund të ishin edhe familjarë me ta: Togeri Klodeveo Ortiz, hetuesi Eladio Ramirez Suero, koloneli Rafael Truhijo Rejnoso, togeri i parë i Policisë Peres Merkado. Disa prej tyre dukeshin se argëtoheshin me shufrat elektrike që i kalonin në trup, apo duke e goditur në kokë dhe në shpinë me shkopinj gome dhe duke e djegur me cigare. Të tjerët dukej sikur e bënin atë gjë pa qejf dhe të mërzitur. Gjithmonë, me të filluar seanca, njëri nga xhelatët që përgjigjej për shkarkimet elektrike, gjysmë i zhveshur, spërkaste ambientin me "Nice", për të mbytur sado pak erën e rëndë të jashtëqitjeve dhe mishit të përcëlluar.

- Një ditë (ç'ditë duhet të ishte?) futën në qelinë e tij Fifi Pastoricën, Uaskar Tehedën, Modesto Diasin, Pedro Livio Sedenjon dhe Tunti Kaseres, ky i fundit nipi i Antonio de la Masës, i cili në planin e parë qe caktuar të drejtonte makinën, por që në fund u drejtua nga Antonio Imberti. Ishin të zhveshur dhe të prangosur, sikurse ai. Kishin qenë gjithmonë aty, në birucat e tjera të El Nueves dhe ishin trajtuar njëlloj me goditje elektrike, kërbaçe, djegie dhe gjilpëra në vesh e në thonj. U ishin nënshtruar hetimeve të pafundme.
- Prej tyre mori vesh se Imberti dhe Luis Amiama qenë zhdukur dhe se, në përpjekjet e dëshpëruara për t'i gjetur, Ramfisi i ofronte gjysmë milioni peso atij që do të mundësonte kapjen e tyre. Po ashtu mori vesh se qenë vrarë në ndeshje me armë, Antonio de la Masa, gjenerali Huan Tomas Dias dhe Amaditoja. Në vend të izolimit ku e kishin mbajtur atë, ata kishin mundur të bisedonin me rojat e burgut dhe të merrnin vesh se ç'ndodhte jashtë. Uaskar Teheda, nëpërmjet njërit prej torturuesve të vet, me të cilin qe afruar, kishte mësuar për dialogun midis Ramfisit dhe babait të Antonio de la Masës. I biri i Gjeneralizimit kishte ardhur t'i thoshte don Vicente de la Masës në qelinë e tij, se i biri ishte vrarë. Plaku, i pari i Mokas,

e kishte pyetur pa iu dridhur zëri. “A vdiq duke luftuar?”. Ramfisi kishte miratuar me kokë. Dhe don Vicente de la Masa, duke bërë kryqin kishte thënë: “Faleminderit, o Zot!”.

- Kur pa se Pedro Livio Sedenjoja qe shëruar prej plagëve që kishte marrë pa dashje prej tij, u ndje më mirë. Ndonëse ai i mbante mëri, se kishte shtënë mbi të prangosur, me një herë e sipër. “Ajo që mbetesha i gjallë? Që të ma punonin kështu? Në djall vaftë! Inati i të gjithëve kundër Pupo Romanit, ishte shumë i madh, po asnjëri nuk u gëzua kur Modesto Diasti tregoi se, nga qelia e vet, në katin e sipërm po të asaj godine, kishte parë Pupon, të zhveshur dhe të prangosur, me qepallat e djegura, të zvarrisur prej policëve drejt dhomës së torturave. Modesto Diashi nuk e kishte mësuar aspak atë hijen e politikanit elegant e inteligjent, siç qe gjatë jetës së tij. Kishte humbur shumë në peshë, trupin e kishte plot plagë dhe nga fytyra nuk i ndahej shprehja e pikëllimit të pafund. “Ashtu duhet të jem edhe unë”, mendoi Salvadori. Qysh kur e arrestuan, nuk e kishte parë veten në pasqyrë.
- Shpesh u kishte kërkuar hetuesve të tij t’i sillnin një prift për t’u rrëfyer. Më në fund, roja i burgut që i sillte ushqimin, pyeti se kush donte një prift. Të gjithë ngritën dorën. U dhanë pantallonat për t’i veshur dhe të prangosur, me ato këmishat të thikta, deri te dhoma ku Turku qu qe ngjitur në një palë shkallë parë diellin, me të ndier mbi lëkurë të ngrohtit e vakët, e mori veten. Më shumë se kurrë donte të rrëfehej e të kungohej, sepse nuk besonte se do të bënte dot kurrë më këtë gjë. Kur kapelani ushtarak, ad Rodriges Kanela, i ftoi ta shoqëronin në një lutje në kujtim të Truhijos, vetëm Salvadori u ul në gjunjë dhe u lut bashkë me të. Të tjerët qëndruan në këmbë të bezdisur.
- Nga ati, Rodriges Kanela, e mësoi se ç’datë ishte: 30 gusht 1961. Vetëm tre muaj! Kurse atij i duhej se ky tmerr kishte shekuj që zgjaste. Të ligështuar, të drobitur, të demoralizuar, flisnin nga pak me njëri-tjetrin. Besda vërtetaj gjithmonë mbi ato që kishin parë, dëgjuar e përjetuar në El Nueve. Nga të gjithë dëshmitë e shokëve të qelisë, Salvadorit i mbeti e ngulitur si një gjurmë e pashlyeshme, historia që Modesto Diashi tregoi mes ngashërimeve. Javët e para kishte qenë në një qeli bashkë me Migel Anhel Baes Diasin. Turku kujtoi lajmin e madh që u kishte sjellë atë natë të 30 majit në rrugën e San Kristobalit,

kur ky njeri që shfaqur papritur me Volksvagenin e tij dhe i kishte siguruar ata se Truhijo, me të cilin kishte shëtitur gjatë Bulevardit, do të vinte se s'bën. Aty kishte marrë vesh se ai zotëri i rëndë, lulja e truhijistëve, bënte pjesë në komplot. Abes Garsia dhe Ramfisi u tërbuan kur morën vesh për të, sepse ishte aq afër Truhijos. Ishin gjithmonë të pranishëm në seancat e torturave ndaj tij, me goditjet elektrike, rrahjet me kërbaç e djegiet që i shkakëtonin plagë dhe urdhëronin mjekët e SIM-it ta sillnin në vete sa herë humbiste ndjenjat, për të vazhduar torturat. Gjatë dy-tri javëve, në vend të pjatës së neveritshme me miell misri të zakonshëm, u sillnin për të ngrënë një kusi me copa mishi. Migel Anhel Baesi dhe Modestoja i gëlltitnin, duke i marrë me duar, derisa ngopeshin. Roja i qelisë hyri një ditë pas të ngrënit dhe iu drejtua Migel Anhelit: Gjenerali Ramfis Truhijo donte të dinte nëse nuk i vinte ndot që hante mishin e birit të vet. Nga vendi ku ishte, Migel Anheli e shau: "Thuaj nga ana ime atij bir kurve të ndyrë që të kafshojë gjuhën e të mbytet". Roja filloi të qeshte. Iku dhe u kthye sërish, duke u treguar nga dera një kokë djaloshi që e mbante për flokësh. Migel Anhel Baesi vdiq disa orë më vonë në krahët e Modestos, nga një atak në zemër.

- Imazhi i Migel Anhelit, duke parë kokën e Migelitos, djalit të tij të madh, s'iu hoq nga mendja Salvadorit. Shihte ëndrra tmerri: Luisiton dhe Karmen Elin e vet me koka të prera. Klithmat që lëshonte në gjumë i shqetësonin miqtë e tij.
- Ndryshe nga miqtë e vet, shumë e të cilëve patën tentuar t'i jepnin fund jetës së tyre, Salvadori vendosi të rezistonte deri në fund. Ishte pajtuar me Zotin. Vazhdonte të lutej ditë e natë. Kisha e ndalonte vetëvrasjen. Po edhe e lehtë nuk qe. Uaskar Teheda u përpoq ta bënte me kravatën që i vodhi njërit prej rojave, i cili e mbante në xhepin e prapmë. Deshi të varej, por dështoi. Për këtë u ndëshkua edhe më keq. Pedro Livio Sedenjoja dëshironte ta vrisnin, duke e provokuar Ramfisin në sallën e torturave: "Bir kurve", "bastard", "bir i shtatë farave", "jot ëmë, Epanjolita, ishte në bordelo para se ta njihte yt atë". Mundi edhe ta pështynte. Po Ramfisi nuk ia dha breshërinë me automatik që Pedroja e dëshironte aq shumë: "Jo, do të vazhdosh të pikëllohesh deri në fund. Ke ende për të paguar".
- Ishte hera e dytë që Salvadori mësoi datën. 9 tetor 1961. Atë ditë i dhanë një palë pantallona për t'i veshur dhe e ngjitën

në atë shkallinën e pjerrtë që të çonte tek ajo dhoma ku rrezet e diellit i plagosnin sytë dhe i gëzonin lëkurën. I zbehtë në fytyrë, krëk në uniformën e gjeneralit me katër yje, po e priste Ramfisi me gazetën "Karaibe" të asaj dite në dorë: 9 tetor 1961. Salvadori lexoi titullin me shkronja të mëdha: "Letra e gjeneral Pedro A. Estrejas gjeneralit Rafael Leonidas Truhijo Birit" - Lexoje këtë letër që më ka dërguar babai yt, - i zgjati gazetën. - Flet për ty.

- Salvadori, me kyçet e duarve të ënjtura nga prangat, mori gazetën "Karaibet". Edhe pse i merreshin mendtë dhe kishte një përzierje të pambarimtë neverie dhe trishtimi, dalloi në të rreshtit e fundit. Gjenerali Piro Estreja e quante Çapin "më i madhi i të gjithë domenikanëve", mburrej se kishte qenë miku, roja e mbrojtësi i tij dhe i referohej Salvadorit me epitetet më të ulëta. Flishte për "tradhtinë e një biri të shthurur" dhe për "pabesinë e birit tim, i cili tradhtoi mbrojtësin e vet dhe familjarët e tij. Më keq nga ngasjet qe paragrafi i fundit: I ati e falënderonte Ramfisin në një servilizëm të bujshëm, se i kishte dhuruar para për ta ndihmuar që të mbijetonte, pasi i kishte konfiskuar gjithë pasuritë e familjes për shkak të pjesëmarrjes së të birit në vrasje.
- U kthye në qelinë e vet i tranuar nga mërzia dhe turpi. Nuk e ngriti kokën më, edhe pse para shokëve përpiqej ta fshihte demoralizimin. "Nuk është Ramfisi, është im atë, ai që më ka vrarë", mendonte. Dhe ndiente zili për Antonio de la Masën. Çfarë fati të jesh biri i don Vicente!
- Kur pak ditë pas atij 9 tetori mizor, ai dhe pesë shokët e qelisë qenë transferuar në Viktoria - u hodhën ujë me tub për t'i larë dhe u dhanë rrobat e tyre - Turku ishte si një vdekur ambulant. Të enjteve u dhanë nja gjysmë ore mundësi për t'i vizituar familjarët. Por as këto takime, as përqafimet e puthjet me të shoqen dhe me Luisiton e Karmen Elin, nuk ia shkrinë dot akullin që i kishte hyrë në zemër që kur lexoi letrën publike të të atit dërguar Ramfijis.
- Në Viktoria nuk i torturuan dhe as i hetuan më. Flinin përtokë, veç tani, jo të zhveshur, po me rroba që ua dërgonin nga shtëpia. Edhe prangat ua kishin hequr. Familjet mund t'u dërgonin për të ngrënë, për të pirë diçka freskuese dhe ndonjë para, me të cilat mund të korruptonin rojat që t'u sillnin gazetat, t'u jepnin informacion për të burgosurit e tjerë dhe të

dërgonin ndonjë mesazh jashtë. Fjalimi i Presidentit Balager në Kombet e Bashkuara, që dënonte diktaturën e Truhijos dhe premtonte një demokratizim "brenda rendit", bëri të rilindnin shpresat edhe në burg. Dukej e pabesueshme, por po fillonte ta shfaqej një opozitë politike, me Bashkimin Qytetar dhe 14 Qershorin, që vepronin publikisht. Mbi të gjitha, miqtë të tij u dha zemër lajmi se në Shtetet e Bashkuara, në Venezuelë dhe në vende të tjera, qenë formuar komitete që kërkonin që gjykimi i tyre të bëhej nga një gjykatë civile dhe me praninë e vëzhguesve të huaj. Salvadori mundohej të përfshihej në entuziazmin e të tjerëve. Tani i lutej Zotit t'i kthente shpresat e humbura. E kishte vënë re mirë atë pamjen e pamëshirshme të Ramfisit. A thua do t'i linte të dilnin gjallë andej? Kurrë. Ai do të hakmerrej deri në fund.

- Pati një shpërthim hareje në Viktoria, kur u mor vesh se Petani dhe Negro Truhijo kishin braktisur vendin. Tani do të ikte edhe Ramfisi. Balageri do të mundej të bënte një amnisti. Po Modesto Dias, me logjikën e vet të fuqishme dhe vetëtinë e të analizuarit të gjërave, i bindi se tani, më shumë se kurrë, ishte koha kur familjarët dhe avokatët duhet të mobilizoheshin për t'i mbrojtur. Ramfisi nuk do të ikte pa i likujduar ekzekutuesit e babait. Ndërsa e dëgjonte, Salvadori vërente se si qe katandisur Modestoja: Si mos më keq. Vazhdonte të dobësohej dhe fytyra i qe bërë si e një plaku, plot rrudha. Po ai vetë, sa do të qe ligur? Pantallonat dhe këmisha që i kishte sjellë e shoqja, i vinin rrotull dhe çdo javë i hapte edhe një vrimë më tej rripit.
- Ishte gjithmonë i trishtuar. Nuk kishte folur me askënd për letrën publike të të atit, e cila i rrinte si thikë në shpatull. Megjithëse planet nuk dolën siç shpresuan dhe pati shumë vuajtje e viktima, vepra e tij kontribuoi për t'i ndryshuar gjërat. Lajmet që depërtonin deri në qelitë e Viktorias, flisnin për mitingje, për të rinj që prishnin kokat e statujave të Truhijos dhe shkyenin pllakat me emrin e tij e të familjes së tij, për kthimin e të arratisurve. A nuk ishte fillimi i fundit të Epokës së Truhijos? Asgjë nga këto nuk do të arrihej, nëse ata nuk do të kishin vrarë Shtazën.
- Kthimi i vëllezërve të Truhijos, qe si një dush i ftohtë për të mbyllurit në Viktoria. Pa e fshehur gëzimin e vet, drejtori i burgut, majori Ameriko Dante Minervino, më 17 nëntor u

komunikoi Salvadorit, Modesto Diasit, Uaskar Tehedës, Pedro Livios, Fifi Pastoricës dhe të riut Tunti Kaseres, se atë mbrëmje do t'i çonin në qelitë e Pallatit të Drejtësisë, sepse të nesërmen në mëngjes do të bëhej një rindërtim i atentatit te vendi ku ndodhi. Me paratë që u kishin mbetur, me ndihmën e rojeve, u dërguan mesazhe urgjente familjeve, duke u thënë se diçka e dyshimtë po ndodhte. Pa dyshim, rindërtimi i krimit, ishte një gënjeshtër. Ramfisi kishte vendosur t'i vriste.

- Në të ngrysur, ua vunë prangat dhe i morën të gjashtët me një kamionçinë të zezë, nga ato që kryeqytetasit i quanin "Kolibe qeni", me dritare të errëta, të shoqëruar nga tre roja të armatosur. Me sytë e mbyllur, Salvadori iu lut Zotit që të kujdesej për të shoqen dhe fëmijët. Ndryshe nga ajo, së cilës i trembëshin, nuk i çuan te shkëmbinjtë, vend i preferuar për ekzekutime sekrete nga regjimi. I çuan në qendër, në qelitë e Pallatit të Drejtësisë. E kaluan pjesën më të madhe të natës në këmbë, sepse qelia qe aq e ngushtë, sa nuk mund të uleshin dot njëherësh të gjithë. E bënë me turne, dy nga dy. Pedro Livioja dhe Fifi Pastorica qenë kurajozë. Përderisa i sollën këtu, ishte e vërtetë ajo puna e rindërtimit të atentatit. Optimizmi i tyre preku edhe Tunti Kaseres e Uaskar Tehedën. Po, po. Pse jo? I dorëzuan te Pushteti Gjyqësor që t'i gjykojnë gjyqtarët civilë. Salvadori dhe Modesto Diashi qëndronin të heshtur, duke fshehur mosbesimin e tyre.
- Me zë të ulët, Turku i pëshpëriti në vesh mikut të tij: "Ky është fundi. Apo jo, Modesto?". Avokati miratoi pa folur, duke i shtrënguar krahun.
- Para se të dilte dielli, i nxorrën nga biruca dhe i hipën përsëri në "Koliben e qenit". Kishte një mobilizim ushtarak të jashtëzakonshëm përreth Pallatit të Drejtësisë dhe Salvadori, në dritën e mugët, dalloi se të gjithë ushtarët kishin shenjën e Forcave Ajrore. Ishin të Bazës së San Isidros, prona të Ramfisit dhe Virhilio Garsia Truhijos. Për të mos i alarmuar shokët, nuk foli. Në furgonin e ngushtë u përpoq të fliste me Zotin, siç kishte bërë një kohë gjatë natës, duke i kërkuar që t'i ndihmonte të vdisnin me dinjitet, pa u çnderuar me shfaqje burracakërie, por, këtë herë s'mundi të përqendrohej. Ky dështim e angështoi.
- Pas një udhëtimi të shkurtër, kamionçina frenoi. Ishin në atentat-rrugën e San Kristobalit. Aty ishte, pa dyshim, vendi i atentatit.

- Dielli digjte qiellin, palmat e kokos gjatë rrugës, detin që rënkonte duke rrahur bregun shkëmbor. Rreth e qark kishte plot roja. Kishin bllokuar rrugën, duke e ndërprerë trafikun nga të dy drejtimet.
- Përse gjithë kjo farsë? Biri doli palaço si dhe babai, - dëgjoi të thotë Modesto Diasi.
- Po përse duhet të jetë një farsë? - protestoi Fifi Pastorica.
- Mos ji pesimist. Është një rindërtim. Kanë ardhur gjyqtarët. Nuk i sheh?
- Po ata pisllëqe që i pëlqenin edhe të atit, - këmbënguli Modestoja, duke lëvizur kokën me zemërim.
  Kinse apo jo, rindërtimi i ngjarjes zgjati shumë orë, derisa dielli u ngjit në zenit dhe po u digjte kokën. I çuan njërin pas tjetrit përballë një tryeze në fushë, në ajër të lirë, ku dy civilë u bënin të njëjtat pyetje që u kishin bërë në El Nueve e në Viktoria. Disa stenografë regjistronin përgjigjet e tyre. Vetëm oficerët vartës endeshin përreth. Asnjëri nga shefat – Ramfisi, Abes Garsia, Peçito Leon Esteves, Pirulo Sançes Rubirosa – nuk u pa atje gjatë ceremonisë së mërzitshme. Nuk u dhanë për të ngrënë, veç ca gota me pije freskuese aty nga mesdita. Kishte filluar pasditja, kur u duk drejtori i ngjunjur i Viktorias, majori Ameriko Dantes Minervino. Ndukte mustaqet me njëfarë nervozizmi dhe kishte një pamje më ogurzezë se zakonisht. Shoqërohej nga një zezak trupmadh, me një hundë të shtypur prej boksieri, me automatik në krah dhe pistoletë në brez. I hipën në "Koliben e qenit".
- Erdha vetë t'ju marr që të mos humbisni rrugën.
- Ku po shkojmë? - pyeti Pedro Livio majorin Minervino.
- Do të kthehemi në Viktoria - tha ky.
- Çfarë nderi! - komentoi Pedro Livio.
- Majori u ul te timoni dhe zezaku me fytyrë boksieri në krah të tij. Tre rojat që i shoqëronin ishin aq të rinj, sa dukeshin të saporekrutuar. Ishin të tensionuar e të shqetësuar për përgjegjësinë që të ruanin të burgosur aq të rëndësishëm. Veç prangave, u kishin vënë pengesa litari nëpër këmbë, kështu që mund të ecnin me hapa shumë të shkurtër.
- Ç'dreq janë këto pengesa?! - protestoi Tunti Kaseres.
- Njëri nga rojat i tregoi me kokë majorin duke vënë gishtin te buzët me gjestin: "Mbylle gojën".
- Nga udhëtimi i gjatë, Salvadori e kuptoi se nuk do të kthehesin

më në Viktoria. Edhe nga fytyrat e shokëve të vet dukej se ata diçka kuptonin. Qëndronin si vuvë, dikush me sytë e mbyllur e dikush me sytë tepër të hapur e të ndezur, si të donte të shponte llamarinën e trashë të furgonit për të parë se ku ndodheshin. Nuk provoi të lutej. Ligështimi qe aq i madh, sa do të ishte e kotë. Zoti do ta kuptonte.

- Kur kamioçina u ndal, dëgjuan detin që shfrente me uturimë në këmbët e një shkëmbi të lartë. Rozat hapën deriçkën e furgonit. Ndodheshin në një shkrep, një vend i shkretë, me dhe të kuqremtë dhe me ca pemë të rralla. Dielli vazhdonte të shkëlqente, por tani udha e tij qe në zbritje. Salvadori tha me vete se vdekja do të ishte një mënyrë të pushuari. Ndiente një lodhje të madhe.
- Dante Minervinoja dhe zezaku shulak me fytyrë boksieri, u thanë tre rojave adoleshentë të zbrisnin nga furgoni. Kur gjashtë të burgosurit bënë të dilnin pas rojave, majori dhe zezaku i ndalën: "Mos lëvizni". Pastaj befas filluan të shtinin me breshëri. Jo mbi të burgosurit, por mbi ushtarët. Të tre djelmoshat me rrëzuan përdhe, të bërë shoshë, pa patur kohë as të habiteshin, as të kuptonin gjë, as të bërtisnin.
- Ç'bëni? Ç'bëni, more vrasës! - ulëriti Salvadori. - Pse i vratë ata të mjerë, o kriminelë?!
- Nuk i vramë ne, po ju, - u përgjigj shumë serioz majori Dante Minervinoja, tek rimbushte automatikun, ndërsa zezaku me fytyrë plloçake ia dha të qeshurit me të madhe. - Tani po, zbrisni.
- Të trullosur, gati të marrosur nga e papritura, të gjashtë zbritën dhe duke u hedhur e penguar - pengeset në këmbë i detyronin të ecnin me ca të hedhura qesharake - nëpër trupat e të vrarëve, i çuan në një kamioçinë tjetër, njësoj si ajo që lanë, e parkuar pak metra më tej. Ay ishte vetëm një civil që e ruante. Pasi i mbyllën në atë furgon, të tre burrat u ngjeshën në vendet e para, ku Dante Minervinoja mori sërish timonin.
- Tani po, Salvadori mundi të lutej. Dëgjoi njërin nga shokët e vet të ngashërehej, po ai vaj nuk i bënte më përshtypje. Lutej pa vështirësi, si në kohët më të mira, për veten, për familjen e tij, për tre ushtarët e sapovrarë, për pesë shokët e furgonit, njëri prej të cilëve, në një atak nervor, përplaste kokën mbi pllakën e hekurt që i ndante nga kabina, duke sharë.
- Nuk e kuptoi sa zgjati rruga, sepse në asnjë çast nuk pushoi

së luturi. Ndiente paqe dhe një ëmbëlsi të pamatë, duke kujtuar të shoqen dhe fëmijët. Kur makina frenoi dhe deriçka u hap, pa dritën, muzgun, diellin që po zhytej në një horizont blu të ngjyer me gjak.

- I zbritën me të shtyra. Ndodheshin në oborrin e një shtëpie shumë të madhe, pranë një pishine. Kishte një tufë palmash të vjetra me kreshtën përpjetë dhe nja njëzet metra më tej, një tarracë ku dukeshin silueta njerëzish me gota në duar. Njohu Ramfisin, Peçito Leon Estevesin, vëllanë e tij Alfonso, Pirulo Sançes Rubirosën dhe dy a tre të panjohur. Alfonso Leon Estevesi erdhi me vrap drejt tyre, pa e lëshuar gotën e uiskit nga dora. Ndihmoi Ameriko Minervinon dhe zezakun boksier për t'i shtyrë drejt palmave.
- Një nga një, Peçito! - urdhëroi Ramfisi.
- "Është i dehur", mendoi Salvadori. Duhet të dehej për të gëzuar festën e fundit, i biri i Çjapit.
- Të parin vranë Pedro Livion, i cili u palos menjëherë në të shtënat e mbytura të revolverit dhe breshërive shurdhuese të automatikut që ranë mbi të. Pastaj zvarritën për te palmat Tunti Kaseresin, i cili, para se të binte, shau Ramfisin: "I degjeneruar, burracak, bythqirë!" Dhe më pas, Modesto Diasin, i cili bërtiti: "Rroftë Republika!" e u përpëlit në tokë, para se të mbaronte.
- Pastaj i erdhi radha atij. Nuk u desh ta shtynin, as ta hiqnin zvarrë. Me hapa të shkurtër, aq sa e lejonte pengesja, shkoi me këmbët e veta drejt palmave ku shtriheshin miqtë e tij, duke falënderuar Zotin që e kishte lejuar të ishte me Të ato çaste të fundit dhe, duke menduar plot melankoli se nuk do ta shihte kurrë Baskintan, atë fshat të vogël libanez prej nga ikën Sadalaitë, për të ruajtur fenë e tyre e për të kërkuar fatin në këto dhera Perëndie.

XXII

Kur, pa i dalë mirë gjumi, dëgjoi të bjerë telefoni, Presidenti Hoakin Balager parandjeu diçka të rëndë. Ngriti receptorin, ndërkohë që fërkonte sytë me dorën tjetër. Dëgjoi gjeneralin Hose Rene Roman që e ftonte në një mbledhje të nivelit të lartë në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë. "E kanë vrarë", mendoi. Komploti kishte pasur sukses. I doli gjumi plotësisht. Nuk duhej të humbiste kohë duke u mallëngjyer, as duke u zemëruar. Problemi i atij çasti ishte shefi i Forcave të Armatosura. Pastroi zërin e tha ngadalë: "Nëse ka ndodhur një gjë kaq e rëndë, si President i Republikës, nuk më takon të ndodhem në një repart ushtarak, por në Pallatin Kombëtar. Po shkoj atje. Ju sugjeroj që mbledhja të bëhet në zyrën time. Natën e mirë". E mbylli telefonin, duke mos i lënë kohë ministrit të Forcave të Armatosura t'i përgjigjej.

- U ngrit dhe u vesh pa bërë zhurmë, për të mos zgjuar të motrat. Kishin vrarë Truhijon, ishte i sigurt. Dhe ishte duke u bërë një grusht Shteti, i kryesuar nga Romani. Për çfarë mund ta thërriste në Fortesën "18 Dhjetori"? Ta detyronte të jepte dorëheqjen, ta arrestonte apo t'i kërkonte që të mbështeste kryengritjen. Dukej i mefshët. Plan i keq. Në vend të telefononte, duhej t'i dërgonte një patrullë. Romani, sado që ndodhej në krye të Forcave të Armatosura, nuk e kishte autoritetin t'u imponohej garnizoneve. Ndërmarrja e tij do të dështonte.
- Doli dhe i tha rojës të zgjonte shoferin e vet. Ndërsa po e çonte në Pallatin Kombëtar, përmes bulevardit Maksimo Gomes të zbrazët e të errët, parashikoi se ç'mund të ndodhte: Ndeshja mes garnizoneve rebele e atyre besnike dhe ndërhyrja e mundshme ushtarake amerikane. Uashingtoni do të kërkonte një pretekst kushtetues për atë veprim dhe në këto çaste, Presidenti i Republikës do të përfaqësonte ligjshmërinë. Dihej se detyra e tij ishte dekorative, por me vdekjen e Truhijos, ajo bëhej reale. Varej nga ai vetë që, me një mashtrim të thjeshtë, të bëhej Kryetar Shteti i vërtetë i Republikës Domenikane.

Ndoshta pa e ditur as vetë, që kur lindi më 1906, po priste këtë cast. Si asnjëherë tjetër, i mëshoi parimit të jetës së vet: Në asnjë çast, për asnjë arsye, mos e humb qetësinë.

- Vendimin e vet e përforcoi edhe më, kur hyri në Pallatin Kombëtar dhe vuri re rrëmujën që mbretëronte. Kishin dyfishuar rojat dhe nëpër korridore e shkallë qarkullonin ushtarët të armatosur, si të kërkonin se kë duhet të qëllonin. Disa oficerë, me ta parë të shkonte ngadalë drejt zyrës së tij, sikur u qetësuan: Ndoshta ai dinte se ç'duhej bërë. Pa mbërritur në zyrë, në sallonin e vizitave, pranë zyrës së Gjeneralísimit, pa familjen Truhijo: E shoqja, e bija, vëllezërit, nipërit dhe mbesat. Iu drejtua atyre me pamje të rëndë, siç e lypte ai çast. Angjelita ishte zbehur dhe sytë i kishte me lot. Por në fytyrën e ashpër e të ngritur të donja Maries, kishte egërsi, tërbim të pamatë.
- Çfarë do të ndodhë me ne, doktor Balageri? - belbëzoi Angjelita duke u mbajtur tek ai.
- Asgjë, nuk do të ndodhë asgjë, - i dha zemër ai. Përqafoi gjithashtu edhe Damën e Hijshme: - E rëndësishme është të mbani veten. Ta bëjmë zemrën gur. Zoti nuk do të lejojë që Shkëlqesia e Tij të vdesë.
- Një vështrim i thjeshtë i mjaftoi të kuptonte se ajo tribu djaish të mjerë, e kishte humbur udhën. Petani, me një automatik nëpër duar, vinte rreth vetes si një qen që përpiqet të kafshojë bishtin e vet. Ishte i mbytur në djersë e bërtiste duke lëshuar rrufe nëmash mbi pyjet, mbi malet e mbi Ushtrinë e vet, ndërkohë që Hektor Bienvenidoja (Negroja), ish-Presidenti, ngjante si i sëmurë nga idiotësia katatonike: Shihte në zbrazëti, me gojën plot pështymë, si të mundohej të kujtonte cili ishte dhe ku ndodhej. Deri edhe më gdhëja i vëllezërve të Udhëheqësit, Amable Romeo (Pipi), ndodhej aty, i veshur si lypës, i kruspullosur në një kolltuk, i tronditur. Në disa kolltukë ishin ulur motrat e Truhijos: Nieves Luisa, Marina, Hulieta, Ofelia Japonesa, tek fshinin sytë e shihin, duke u përgjëruar për ndihmë. Doktor Balageri u mërmëriti fjalë ngushëlluese të gjithëve. Ishte një zbrazëti që duhej mbushur sa më parë.
- Shkoi në zyrë dhe thirri gjeneralin Santos Melido Marten, inspektor i përgjithshëm i Forcave të Armatosura, oficer i hierarkisë së lartë ushtarake, me të cilën kishte marrëdhënie të vjetra. Ai nuk dinte asgjë dhe mbeti aq i shastisur nga lajmi sa për gjysmë minute, vetëm thoshte: "Zoti im, Zoti im!". I kërkoi

t’u telefononte komandantëve të përgjithshëm dhe shefave të garnizoneve të gjithë Republikës, t’i siguronte ata se vrasja e mundshme nuk do të ndryshonte rendin kushtetues dhe se të kishin përherë mbështetjen dhe besimin e Kryetarit të Shtetit, i cili rikonfirmonte detyrat e tyre. "Do të filloj menjëherë nga puna, zoti President", tha, duke nderuar gjenerali.

- E njoftuan se nuncioja apostolik, konsulli amerikan dhe i ngarkuari për tregti i Mbretërisë së Bashkuar, ndodheshin në hyrje të Pallatit, të ndaluar nga roja. U kërkoi t’i lejonin të hynin. Nuk vinin për atentatin, por për kapjen e dhunshme në hymzot Rejit nga njerëz të armatosur që kishin hyrë në Kolegjin Santo Domingo, duke shqyer dyert. Kishin qëlluar në ajër, kishin goditur murgeshat e priftërinjtë shëlbues të San Huan de la Maguana që shoqëronin peshkopin dhe kishin vrarë një qen roje. I kishin marrë prelatët me të shtëra.
- Zoti President, ju bëj përgjegjës për jetën e timzot Rejit, - iu kanos nuncioja.
- Qeveria ime nuk do ta tolerojë atentatin kundër jetës së tij, - e paralajmëroi diplomati i Shteteve të Bashkuara. - Nuk është nevoja t’ju kujtoj interesin e Uashingtonit për Rejin, i cili është një qytetar amerikan.
- Uluni, ju lutem, - u tregoi karriget rreth tryezës së tij.
- Ngriti telefonin dhe kërkoi të lidhnin me gjeneral Virhilio Garsia Truhijon, shef i Bazës Ajrore të San Isidros. U kthye nga diplomati:
- Më vjen keq më shumë se juve, besomni. Nuk do të kursej përpjekjet e mia për t’i dhënë fund kësaj mizorie.
- Pak më vonë dëgjoi zërin e nipit të Gjeneralísimit. Pa i hequr sytë nga treshja e vizitorëve, foli në telefon me një zë të shtruar:
- Ju flet Presidenti i Republikës, gjeneral. Po flas me shefin e San Isidros dhe gjithashtu me nipin e preferuar të Shkëlqesisë së Tij? Po jua kursej vërejtjet paraprake, duke pasur parasysh gjendjen e rëndë të situatës. Me ndodhet këtu një veprim tepër i papërgjegjshëm, ndonjë vartës, ndoshta koloneli Abes Garsia, ka arrestuar peshkopin Reji, duke e nxjerrë forcërisht prej Kolegjit Santo Domingo. Kam këtu përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara, të Britanisë së Madhe dhe të Vatikanit. Në qoftë se i ndodh ndonjë gjë timzot Rejit, i cili është qytetar i SHBA-së, mund të jetë një katastrofë për vendin. Përfshirë dhe një

zbarkim të fanterisë detare. Nuk është nevoja t'ju them se ç'do të thotë kjo për Atdheun tonë. Në emër të Gjeneralísimit, ungjit tuaj, ju bëj thirrje të shmangni një fatkeqësi historike.

- Priti reagimin e gjeneral Virhilio Garsia Truhijo. Një dihatje nervoze i thoshte pavendosmëri.
- Nuk qe ideja ime, doktor, - e dëgjoi të mërmëriste më në fund. - As që më lajmëruan për këtë çështje.
- E di shumë mirë, gjeneral Truhijo, - e ndihmoi Balageri. - Ju jeni një ushtarak i arsyeshëm dhe i përgjegjshëm. Kurrë s'do të bënit një marrëzi të tillë. A është imzot Reji në San Isidro? Apo e kanë çuar në Kuarenta?
- Heshtja e gjatë e tjetrit, e nervozoi. I trembej më së keqes.
- A është gjallë imzot Reji? - nguli këmbë Balageri.
- Ndodhet në një aneks të Bazës së San Isidros, nja dy kilometra prej këtej, doktor. Komandanti i qendrës, Rodrigues Mendes, nuk ka lejuar ta vrsinin. Sapo më informuan.
- Presidenti e zbuti zërin:
- Ju lutem, shkoni vetë personalisht si i dërguari im, për ta shpëtuar timzot Rejin. Dhe t'i lypni ndjesë në emër të qeverisë për gabimin e bërë. Pastaj ta shoqëroni peshkopin deri në zyrën time, shëndosh e mirë. Është një lutje miku, por gjithashtu një urdhër i Presidentit të Republikës. Kam besim të plotë te ju.
- Të tre vizitorët e shihnin të shqetësuar. U ngrit në këmbë dhe shoqëroi duart deri te dera dhe, duke u shtrënguar duart, mërmëriti:
- Nuk jam i sigurt nëse ju binda, zotërinj. Por, siç e shihni, jam duke bërë ç'është e mundur për t'u imponuar arsyen.
- Ç'do të ndodhë, zoti President? - pyeti konsulli. - Do ta pranojnë autoritetin tuaj truhijistët?
- Kjo varet shumë nga Shtetet e Bashkuara, miku im. Ndershmërisht, nuk e di. Tani, do të më falni, zotërinj.
- U kthye në sallën ku ishte familja Truhijo. Kishte edhe njerëz të tjerë. Koloneli Abes Garsia shpjegonte se një nga vrasësit, i kapur në Klinikën Ndërkombëtare, kishte kallëzuar tre bashkëpunëtorë: Gjeneralin në lirim Huan Tomas Dias, Antonio Imbertin dhe Luis Amiamën. Pa dyshim, kishte dhe shumë të tjerë. Midis atyre që dëgjonin të hutuar, dalloi gjeneral Romanin. E kishte këmishën të lagur, fytyrën ujë në djersë dhe një armë automatike të shtrënguar në duar. Në sy i vlonte

një çoroditje, si një kafshë që ndihet e humbur. Dukej qartë. Gjërat nuk i kishin dalë mirë. Me një zë të çakorduar, shefi trashanik i SIM-it siguroi se, sipas ish-ushtarakut Pedro Livio Sedenjo, komploti nuk kishte degëzime në Forcat e Armatosura. Ndërsa e dëgjonte, mendoi se kishte ardhur ora të përplasej me Abes Garsian, i cili e urrente. Ai vetë e përçmonte. Në çaste si ky, për fat të keq, nuk vlenin idetë, po armët. Ju lut Zotit, tek i cili besonte herë-herë, që të ishte në anën e tij.

- Koloneli Abes Garsia lëshoi sulmin e parë. Duke marrë parasysh zbrazëtinë e lënë nga atentati, Balageri duhej të jepte dorëheqjen që dikush nga familja të merrte Presidencën. Me trashësinë dhe intolerancën e vet, Petani e mbështeti në këtë japë dorëheqjen". Ai dëgjonte në heshtje, me duart e lidhura mbi bark, si një famulltar i qetë. Kur vështrimet ranë mbi të, miratoi me ndrojtje, si të shfajësohej që ndihej i detyruar të ndërhynte. Me modesti, kujtoi se ndodhej në atë post me vendim të Gjeneralísimit. Sigurisht, do të jepte menjëherë dorëheqjen, nëse kjo gjë do t'i shërbente kombit. Por, i lejohej të sugjeronte se, përpara se të prishej rendi kushtetues, le të prisnin të vinte gjenerali Ramfis. A mund të përjashtohej trashëgimtari i Udhëheqësit nga çështje kaq jetike? Dama e Hijshme e përkrahu i Radamesi po bënin përpjekje në Paris për të marrë me qira një avion të Air France. Çështja u shty.
- Ndërsa kthehej në zyrën e vet, i tha vetes se bëhej e vërtetë nuk do të ishte kundër vëllezërve Truhijo, një bandë arrogantësh idiotë, po kundër Abes Garsias, i cili, vërtet ishte një sadist i shkarë, po kishte një mendje demoniake. Sapo e kishte bërë një gabim, duke harruar Ramfisin. Marie Martinesi qe bërë aleatja e tij. Ai e dinte si përfundonte ajo aleancë: Kopracia e Damës së Hijshme do të ishte e dobishme në rrethanat aktuale. Por më urgjente ishte të pengohej një kryengritje. Gjatë kohës që ndodhej në zyrë, mbërriti thirrja e gjeneral Melido Martesi. Kishte folur me të gjithë garnizonet ushtarake dhe komandantët e kishin siguruar për besnikëri ndaj qeverisë ekzistuese. Megjithatë, gjeneralët Qezar A. Oliva i Santiago de los Kavajeros, Garsia Urbaes i Dahabonit dhe Guarioneks Estreja i La Vegas, ishin të shqetësuar për urdhërat kontradiktore të sekretarit të Forcave të Armatosura. Çfarë gjej zoti President?

- Asgjë konkrete, por e marr me mend, ashtu si dhe ju, miku im, - i tha Balageri gjeneral Melido Martes. - Do t'i marr në telefon ata komandantë për t'i qetësuar. Ramfis Truhijo është duke fluturuar tani drejt nesh, për të siguruar drejtimin ushtarak të vendit.
- Pa humbur kohë, u telefonoi të tre gjeneralëve dhe u përsëriti se gëzonin mbështetjen e tij. U kërkoi që, duke marrë gjithë fuqitë administrative dhe politike, duhej të garantonin rendin në rajonet e tyre dhe, derisa të mbërrinte gjeneral Ramfisi, do të lidheshin vetëm me atë. Kur po ndahej me gjeneral Guarioneks Estreja Sadalain, adjutantët e njoftuan se gjenerali i keqtrajtuar ndodhej në para dhomë, me peshkopin Reji. U tha të hynte vetëm i nipi i Truhijos.
- Ju keni shpëtuar Republikën, - i tha, duke e përqafuar, gjë që nuk e bënte kurrë. - Nëse do të zbatoheshin urdhërat e Abes Garsias dhe do të ndodhte diçka e pandreqshme, marinsat do të ishin duke zbarkuar në Qytetin Truhijo.
- Nuk qenë urdhëra vetëm të Abes Garsias, - iu përgjigj shefi i Bazës së San Isidros. E pa të turbulluar. - Ai që urdhëroi komandantin Rodrigues Mendes, të qendrës së ndalimit të Forcave Ajrore, për të pushkatuar peshkopin, ishte Peçito Leon Esteves. Tha se ishte vendim i konsultuar me mua. Ishte një mrekulli kuptoj. Askush nuk pranoi ta zbatonte pa folur me mua.
- Gjenerali Garsia Truhijo kujdesej për trupin dhe për veshjen e vet - mustaqe ala meksikane, flokët të shtrirë, uniformë të prerë mirë dhe të hekurosur si për paradë dhe syzet e përhershme Ray Ban në xhep - me të njëjtën sqimë si i kushëriri, Ramfisi, me të cilin kishte afëri. Por, tani ishte me këmishë gjysmë të hapur dhe i pakrehur. Në sytë e tij lexohej xhelozi dhe dyshim.
- Nuk e kuptoj pse Pupoja dhe Peçitoja morën një vendim të tillë, pa u konsultuar më parë me mua. Donin të kompromentonin Forcat Ajrore, doktor.
- Gjeneral Romani duhet të jetë tepër i rënduar nga çështja e Gjeneralísimit, sa nuk i kontrollon dot nervat, - shfajësoi Presidenti. - Për fat të mirë, Ramfisi është duke ardhur. Prania e tij është e domosdoshme. Atij, si gjeneral me katër yje dhe djalë i Udhëheqësit, i takon të sigurojë vazhdimësinë e politikës së Bamirësit.

- Po Ramfisi nuk është politikan, e urren politikën dhe ju e dini këtë, doktor Balageri.
- Ramfisi është një njeri shumë inteligjent dhe e adhuronte babanë e tij. Nuk mund të mos marrë përsipër rolin që Atdheu pret prej tij. Ne do ta bindim.
- Gjenerali Garsia Truhijo e pa me simpati.
- Mund të mbështeteni tek unë për gjithçka, zoti President.
- Domenikanët do ta mësojnë se këtë natë ju shpëtuat Republikën, - përsëriti Balageri, ndërsa e shoqëronte deri te dera.
- Ju, gjeneral, jeni me përgjegjësi të madhe. San Isidro është baza më e rëndësishme e vendit dhe, për pasojë, nga ju varet ruajtja e rendit. Për çdo gjë më thërrisni në telefon. Kam urdhëruar që t'ju jepet prioritet thirrjeve tuaja.
- Peshkop Reji duhet të kishte kaluar disa orë terrori në duart e kalecëve. Uniformën fetare e kishte të shqyer e të përbaltur dhe disa gërvishtje të thella i prishnin fytyrën e dëshpëruar e me një pamje tmerri të vulosur në të. Qëndronte drejt dhe i heshtur. Pranoi me dinjitet keqardhjen dhe shpjegimet e Presidentit të Republikës e, me një buzëqeshje të sforcuar, e falënderoi që kishte marrë masa për ta liruar: "Falni, zoti President, sepse nuk dinë ç'bëjnë". Në këto e sipër, u hap dera dhe, me automatik në duar, i mbytur në djersë, me shikim prej shtaze të trembur e të egërsuar, u fut vrullshëm gjeneral Romani. Mjaftoi vetëm një sekondë që Presidenti të kuptonte se, nëse nuk do të merrte iniciativën, ky primat do të fillonte të shtinte. "Ah, imzot, shih kush na erdhi". I përzemërt, falënderoi Ministrin e Forcave të Armatosura, i cili vinte t'i kërkonte falje në emër të institucionit ushtarak, zotit peshkop të San Huan de la Maguanas për keqkuptimin, viktimë e të cilit ai kishte qenë. Gjeneral Romani qëndroi si hu në mes të zyrës, duke shqyer sytë si i marrosur. Sytë i kishte me sklepa, sikur sapo qe ngritur nga gjumi. Pa thënë asgjë, pas disa sekondash hezitimi, zgjati dorën drejt peshkopit, i cili, për gjithë çfarë po ndodhte, ishte po aq i çorientuar sa edhe gjenerali. Presidenti e përcolli timzot Rejin deri te dera.
- Kur u kthye te tryeza e vet të punës, Pupo Romani filloi të bërtiste: "Ju duhet të më jepni shpjegime. Çfarë dreqi besoni se jeni, Balager", duke i tundur automatikun para fytyrës. Presidenti qëndronte i patundur, duke e parë në sy. Ndiente t'i binte një fytyrë pështymë e gjeneralit, si një zë i padukshëm.

Ky çmendarak nuk do të guxonte të shtinte mbi të. Pasi zbrazi të shara e palavra përmes ca frazave pa lidhje logjike, Romani pushoi. Qëndronte aty ku ishte, duke gulçuar. Me zë të butë e plot politesë, Presidenti e këshilloi të qetësohej dhe të kontrollonte veten. Në këto çaste shefi i Forcave të Armatosura duhet të ishte shembull i maturisë. Megjithë fytyrën dhe kërcënimet që i lëshoi, Balageri ishte i gatshëm ta ndihmonte, nëse kishte nevojë. Gjeneral Romani shpërtheu përsëri në një monolog gjysmëdelirant, ku, papritur e pakujtuar, i bëri të ditur se kishte dhënë urdhër për të ekzekutuar majorin Segundo Imbert dhe Papito Sanças, të burgosurit në Viktoria, si bashkëpunëtorë në vrasjen e Udhëheqësit. Balageri nuk donte të dëgjonte më tej atë që rrezikonte. Pa i thënë asgjë, doli nga zyra. Tani nuk kishte më dyshim: Romani ishte i përfshirë në vdekjen e Gjeneralísimit. Nuk kishte si ta shpjegonte ndryshe sjelljen e tij aq të çoroditur.

- U kthye në sallë. Kishin gjetur trupin e Truhijos në bagazhin e një autoveture, në garazhin e gjeneral Leit Huan Tomas Dias. Doktor Balageri, gjatë gjithë jetës së vet të gjatë, kurrë nuk do ta harronte rrënimin e atyre fytyrave, lotët e atyre syve, shprehjen prej jetimi, të shkretuar e të pikëlluar, të civilëve dhe ushtarakëve, kur kufoma e gjakosur, e grirë nga breshëritë, fytyra e prishur dhe mjekra e copëtuar nga plumbat, qëndronte mbi tavolinën e sallës së ngrënies të Pallatit, aty ku, para disa orësh, ishin dreguar mysafirët e nderuar Simon e Doroti Gitleman. Një ekip mjekësh e zhveshën, e lanë dhe e ekzaminuan, duke e bërë gati për në sallën e homazheve. Nga reagimi i gjithë të pranishmëve, ajo që i la mbresë më shumë, ishte vejusha. Donja Marie Martinesi e shikonte kufomën si e hipnotizuar, si e ngrirë, mbi këpucët me taka të larta, që e bënin më të gjatë. Sytë i kishte të ënjtur e të skuqur, po nuk qante. Papritur ulëriti, duke ngritur krahët: "Hakmarrje! Hakmarrje! Duhet vrarë të gjithë!" Doktor Balageri nxitoi t'i vinte dorën mbi supe, po ajo nuk u ngushëllua dot. E ndiente tek merrte frymë thellë, duke hequr në zemër. Dridhej e tëra. "Duhet ta paguajnë, duhet ta paguajnë", përsëriste. "Do të lëvizim qiell e tokë që të bëhet ashtu, donja Marie", i pëshpëriti në vesh. Dhe në çast, pati një parandjenjë: Tani duhej shfrytëzuar rasti me Damën e Hijshme, më vonë do të ishte e kotë.
- Duke i mëshuar dhembshurisht dorës mbi shpinën e saj, si

për ta larguar nga ajo pamje dhimbjendjellëse, e çoi donja Marie Martinesin drejt një salloni të vogël, ngjitur me sallën e ngrënies. Me të parë që ishin vetëm, mbylli derën.

- Donja Marie, ju jeni një grua tepër e fortë, - i tha me përzemërsi. - Prandaj guxoj, në këto çaste kaq të rënda të trazoj hidhërimin tuaj me një çështje që mund t'ju duket e papërshtatshme. Por nuk është ashtu. Veproj i udhëhequr nga admirimi dhe respekti. Uluni, ju lutem.
- Fytyra e rrumbullaktë e Damës së Hijshme, e shikonte me mosbesim. Ai buzëqeshi i trishtuar. Ishte, pa dyshim, i patundur, po që e bezdiste me këto sjellje, kur shpirti i saj ishte i dërrmuar nga një humbje aq mizore. Veç, po e ardhmja? A s'kishte donja Marie një jetë të gjatë përpara? Kush e dinte se ç'mund të ndodhte pas kësaj kataklizme? Ishte e domosdoshme të merrte disa masa, duke menduar të ardhmen. Mosmirënjohja e popujve qe provuar që nga tradhtia e Judës ndaj Krishtit. Vendi do ta qante tani Truhijon dhe do të hakmerrej kundër vrasësve të tij. Por, do të vazhdonte dhe nesër të ishte besnik ndaj kujtimit të Udhëheqësit? Po nëse shpërthente inati, ajo sëmundje kombëtare? S'donte t'i humbiste kohë. Do të futej në temë, pra. Donja Marie duhet të sigurohej që, për çdo eventualitet, të shpëtonte pasuritë e ligjshme të arritura falë përpjekjeve të familjes Truhijo, që i kishte sjellë aq të mira popullit domenikan. Dhe duhet ta bënte para se të ndodhnin ndryshime politike. Më vonë do të dilnin pengesa. Doktor Balageri sugjeronte që ta diskutonin me senatorin Henri Çirinos, i ngarkuar si mbikëqyrës i çështjeve tregtare të familjes dhe ta studionte se ç'pjesë pasurie mund të transferohej menjëherë jashtë. Presidenti i Republikës kishte fuqinë për të autorizuar veprime të kësaj natyre - për shembull, konvertimin e pesos domenikane në valutë nga Banka Qendrore - por s'i dihej nëse kjo gjë do të ishte e mundur më vonë. Gjeneralísimi gjithmonë pati nguruar ta bënte këtë gjë, për shkak të parimeve të larta të tij. Por, të mbaje një qëndrim të tillë në këtë situatë, do të ishte, më falni për shprehjen, një marrëzi. Kjo qe një këshillë miqësore, e frymëzuar nga përkushtimi dhe miqësia.
- Dama e Hijshme e dëgjoi në qetësi, duke e parë në sy. Më në fund, dha miratimin e pritur:
- E dija që ju jeni një mik besnik, doktor Balageri, - tha tepër e sigurt në vetvete.

- Shpresoj t’jua vërtetoj, donja Marie. Kam besim se nuk m’i keni marrë për keq këshillat e mia.
- Është një këshillë e mirë. Në këtë vend kurrë s’dihet se ç’mund të ndodhë, - u qa nëpër dhëmbë. - Do të flas me doktor Çirinosin qysh nesër. Çdo gjë të jetë në fshehtësi të plotë?
- Në nderin tim, donja Marie, - afirmó Presidenti, duke rrahur gjoksin.
- Por vuri re se një dyshim përpëlitej në fytyrën e vejushes së Gjeneralísimit. Dhe parashikoi atë që ajo do t’i kërkonte:
- Ju lutem për një gjë: As me bijtë e mi të mos flisni për këtë çështje, - tha me zë fare të ulët, si të trembej se mos e dëgjonin ata. - Për arsye që do të ishte e gjatë t’jua shpjegoja.
- Askujt. As atyre, donja Marie, - e qetësoi Presidenti. - Sigurisht. Më lejoni t’jua përsëris se e admiroj karakterin tuaj, donja Marie. Pa ju Bamirësi s’do të mundte kurrë ato që bëri.
- Kishte fituar një pikë tjetër në luftën për t’i shpëtuar tributë Xhoni Abes Garsias. E parashikonte përgjigjen e donja Marie Martinesit: Lakmia ishte tek ajo më e fortë se çdo pasion tjetër. Në të vërtetë, Dama e Hijshme i ngjante njëfarë respekti doktor Balagerit. Që të qëndronte aq vitë pranë Truhijos, në fillim si dashnore, pastaj si grua, Espanjolita duhet të kishte qenë e zhveshur nga çdo lloj sentimentalizmi, nga çdo ndjenjë - mbi të gjitha, mëshira - duke u strehuar vetëm në zemrën e llogarive, llogarive të ftohta, mbase edhe në atë të urrejtjes.
- Reagimi i Ramfisit, në të kundërt, atë e shqetësoi. Ai kishte mbërritur me Radamesin, me playboy-in Profirio Rubirosën dhe një grup miqsh me avionin e marrë me qira nga Air France, në Bazën e San Isidros. Balageri qe i pari që e përqafoi të fundit i shkallëve të avionit. Nja dy orë më vonë, i rruar e i veshur me uniformën e gjeneralit me katër yje, u paraqit në Pallatin Kombëtar për t’i bërë homazhe të atit. Nuk qau, nuk e hapi gojën. Ishte i zymtë dhe kishte një shprehje të huaj në fytyrën e tij të bukur e të pikëlluar, nga e papritura, nga çudia, nga mospranimi: si mundej dhe pse duhet të ishte atje ajo figurë e shtrirë, me atë veshje ceremoniale, me gjakosjen plot dekorata, e vendosur në atë arkë madhështore, e rrethuar me shandanë, në atë kënd gjithë kurora funebre? Të ndodhurit e asaj figure të shtrirë atje, duhej të qe një gabim në rregullsinë e Universit. Qëndroi çaste të tëra, duke parë kufomën dhe duke u shtrembëruar, pastajshmangështritë, në fytyrë. Dukej sikur muskujt e

tij facialë, mundoheshin të shqisnin një shtrat merimange të padukshëm, të ngjitur në lëkurën e fytyrës së tij. "Unë nuk do të jem aq zemërgjerë me armiqtë, sa ishte ai", e dëgjoi të thoshte, më në fund. Atëherë doktor Balageri, i cili ndodhej në krah të tij, me veshjen rigoroze të zisë, i foli në vesh: "Është e domosdoshme të bisedojmë pak minuta, gjeneral. E di se është një çast shumë i vështirë për ju. Por ka çështje që nuk presin dot kohë". Ramfisi, duke e mbledhur veten, pranoi. Shkuan në një zyrë të Presidentit. Gjatë rrugës, shikoni nga dritaret e mëdha turmën e pafund, së cilës i shtoheshin grupe burrash e grash të ardhur nga rrethinat e Qytetit Truhijo dhe fshatrat përreth. Bishti (ishin pesë ose gjashtë radhë me njerëz) i kolonës, ishte disa kilometra larg dhe rojat e armatosur mezi mundnin t'i përmbanin. Kishin shumë orë duke pritur. Midis atyre që kishin mbërritur te shkallët e Pallatit dhe ndodheshin pranë sallës funebre të Gjeneralísimit, kishte skena kujesh, vetëçjerrjesh dhe betimesh histerike.

- Doktor Hoakin Balageri e dinte se nga kjo bisedë varej ardhmja e tij dhe e Republikës Domenikane. Prandaj mori një vendim që do ta bënte vetëm në raste ekstreme, pra do të shkonte kështu, kundër natyrës së tij të përkujdesit: Të luante me të gjitha, për gjithçka, për çfarë të dilte. Priti që djali i madh i Truhijos të ulej përballë tij - nga dritaret lëvizte, si det me dallgë, turma e stërmadhe, duke pritur të arrinte deri te kufoma e Bamirësit - dhe, si gjithmonë, me natyrën e vet të qetë, pa dhënë as më të voglën shenjë shqetësimi, i tha atë që, me aq kujdes, e kishte përgatitur:
- Nga ju, dhe vetëm nga ju, varet nëse do të mbetet diçka, do të mbetet shumë apo asgjë nga vepra që krijoi Truhijo. Nëse vepra e tij do të zhduket, Republika Domenikane do të zhytet përsëri në barabari. Do të barazohemi me Haitin, si tridhjetë vjet më parë, duke u bërë kombi më i mjerë dhe më i dhunshëm i hemisferës perëndimore.
- Gjatë kohës që foli Presidenti, Ramfisi nuk e ndërpreu asnjëherë. E dëgjonte? As miratonte, as kundërshtonte. Sytë e tij, të fiksuar herë te folësi, herë në askund, e bënë doktor Balagerin të mendonte se, me vështirësi të tilla duhej t'i fillonin ato krizat e tjetërsimit dhe melankolisë së skajshme, për të cilat qe mbyllur në klinikat psikiatrike të Francës dhe Belgjikës. Por nëse e dëgjonte, Ramfisi do t'i peshonte arsyetimet e tij.

Edhe pse pijanec, i prapë, pa prirje politike, pa përkushtim qytetare, njeri, energjitë e të cilit harxhoheshin në sentimente që i ngjallnin femrat, kuajt, avionët dhe gotat, dhe që mund të ishte po aq mizor sa edhe i ati, bënte pjesë te njerëzit e zgjuar. Mund të ishte i vetmi në familjen e tij me një mendje të aftë për të parë atë që ndodhej përtej hundës së vet. Kishte një mendje të shpejtë, të mprehtë, që, sikur të ishte e kultivuar, do të mund t'i jepte fryte të shkëlqyera. Asaj inteligjence ia drejtoi Balageri ekspozenë e tij, me një çiltërsi të guximshme. Ishte i bindur se qe karta e fundit që i mbetej, nëse nuk donte të ishte i flakur si një letër pa vlerë nga zotërinjtë e koburëve.

- Kur pushoi së foluri Balageri, Ramfisi dukej edhe më i zbehtë se ç'ishte para kufomës së babait të vet.
- Ju mund ta humbisnit jetën për gjysmën e atyre që thatë, doktor Balager.
- E di, gjeneral. Po situata nuk më lë tjetër mundësi, veç t'ju flas me sinqeritët. Ju kam propozuar të vetmen politikë të mundshme, siç e besoj. Nëse ju shihni tjetër, ju përgëzoj. Dorëheqja ime është gati, këtu, në këtë sirtar. Doni t'ia paraqes Kongresit?
- Ramfisi bëri "jo" me kokë. Mori frymë dhe pas një hopi, me zërin e vet melodioz prej aktori radioteatri, u shpjegua:
- Nga rrugë të tjera, unë prej kohësh kam arritur në të njëjtin përfundim, - bëri një lëvizje me supe, në shenjë pajtimi. - Është e vërtetë, nuk ka tjetër politikë për të shpëtuar nga marinsat dhe komunistët, që OEA dhe Uashingtoni të na heqin sanksionet. E pranoj planin tuaj. Veç, për çdo hap, çdo masë, çdo marrëveshje, duhet të konsultoheni me mua dhe të prisni miratimin tim. Vetëm kështu. Drejtimi i ushtrisë e i rendit, janë punë të miat. Nuk pranoj ndërhyrje as nga ju, as nga funksionarët e civilë, as nga jankit. Askush prej atyre që lidhen drejtpërdrejtë apo jo me vrasjen e tim eti, nuk do t'i shpëtojë ndëshkimit.
- Doktor Balageri u ngrit në këmbë.
- E di që ju e adhuronit, - tha, solemnisht. - Kjo flet për ndjenjat tuaja të mira si biri, i cili do të marrë hak për atë krim të tmerrshëm. Askush, dhe unë më pak se kushdo, do ta pengonte detyrimin tuaj për të vendosur drejtësi. Kjo është edhe dëshira ime e zjarrtë.
- Sa u nda nga i biri i Truhijos, rrëkëlleu një gotë ujë. Zemra

e tij mezi po e rregullonte ritmin. Kishte luajtur me jetën, po kishte fituar. Tani, përpara, njeri, për të vënë në jetë marrëveshjen. Dhe e nisi me varrimin e Bamirësit në kishën e San Kristobalit. Fjalimi i tij funebret plot lavdërime prekëse për Gjeneralísimin, sidoqoftë, të kripura butë me nga aluzione kritike të dykuptimta, bëri të derdhnin lot disa kurizane injorantë, turbulloi disa të tjerë, habiti disa dhe la shumë konfuzion, por meritoi përgëzimet e trupit diplomatik. "Po fillojmë të ndryshojmë gjërat, zoti President", tha konsulli i ri i Shteteve të Bashkuara, i cili sapo kishte ardhur në ishull. Ditën tjetër doktor Balageri thirri me urgjencë kolonelin Abes Garsia. Me ta parë fytyrën e mufatur, të drejtur nga shqetësimi, duke fshirë djersën me shaminë e veçantë, flakë të kuqe, e kuptoi se shefi i SIM-it e dinte mirë se çfarë priste.

– Më kini thirrur të më bëni të ditur se jam i shkarkuar? - e pyeti pa e përshëndetur. Ishte me uniformë, me pantallonat të rëna dhe me kapelen të vënë shtrembër, aq sa të bënte për të qeshur. Veç pistoletës në brez, kishte edhe një automatik në krah. Balageri dalloi pas tij fytyrat kriminele të katër a pesë shoqëruesve, të cilët nuk hynë në zyrë.
– T'ju lutem të pranoni një emërim diplomatik, - foli butë Presidenti. Dora e tij e vogël shëndosh një karrige. - Një patriot me talent mund t'i shërbejë atdheut në fusha krejt të ndryshme.
– Ku është ekzili i artë? - Abes Garsia nuk e fshifte as dështimin, as zemërimin e tij.
– Në Japoni, - tha Presidenti. - Sapo u firmos emërimi juaj si konsull. Rroga dhe shpenzimet e përfaqësimit, do të jenë si të një ambasadori.
– Nuk mundet të më dërgojë më larg?
– Nuk ka se ku, - u shfajësua doktor Balageri pa ironi. - I vetmi vend më larg është Zelanda e Re, po nuk kemi marrëdhënie diplomatike me të.
– Personazhi lozonjar lëvizi në vend, duke shfryrë. Një dritë e verdhë pakënaqësie të pafund, i vetëtinte në sytë e kërkyer. Një çast e mbajti mbi buzë shaminë e kuqe, si të donte të pështynte në të.
– Ju besoni se keni fituar, doktor Balageri, - tha ashpër. - Gaboheni. Jeni i lidhur njësoj si unë me këtë regjim. Po aq i njollosur madje sa unë. Askush nuk do ta gëlltisë hilenë tuaj makiaveliste për të kryesuar tranzicionin për të demokracisë.

- Ka mundësi të dështoj, - pranoi Balageri, pa armiqësi. - Po, duhet ta provoj. Për këtë dikush duhet të sakrifikohet. Ndiej se jeni i pari, por nuk ka ilaç: Përfaqësoni fytyrën më të keqe të regjimit. Një fytyrë e nevojshme, heroike, tragjike, e di. I ulur në atë karrige, më kujtuat vetë Gjeneralísimin. Por as ai vetë nuk do t'ju shpëtonte dot tani. Ju jeni inteligjent, nuk është nevoja t'jua shpjegoj. Mos mendoni t'i sillni telashe qeverisë. Nisuni për në ShBA dhe duajeni të rritur. Duhet të largoheni dhe të mos dukeni, derisa t'ju harrojnë. Keni shumë armiq. Ka shumë vende që duan t'ju shtien në dorë. Shtetet e Bashkuara, Venezuela, Interpoli, FBI-ja, Meksika dhe gjithë Amerika Qendrore. Ju jeni më i informuar se unë. Japonia është vendi më i sigurt, dhe aq më shumë duke patur një status diplomatik. E di mirë që më shumë ju ka interesuar spiritualizmi. Doktrina rosacruz, apo jo? Përfitoni nga rasti për t'u thelluar në ato studime. Sidoqoftë, nëse doni të vendoseni në ndonjë vend tjetër, ju lutem, mos më thoni ku, ju do të vazhdoni të merrni rrogën kudo që të jetë. Kam firmosur për një detyrë speciale dhe për shpenzimet e rrugës e të vendosjes kudo qoftë. Keni dyqind mijë peso, që mund t'i tërhiqni nga thesar. Mbarësi!
- Nuk ia dha dorën, duke menduar se ish-ushtaraku (sapo kishte firmosur dekretin për ta hequr nga Ushtria) nuk do t'ia jepte të vetën. Abes Garsia qëndroi pak çaste pa lëvizur, me sytë e ngulur mbi të. Por Presidenti e dinte se, si njeri praktik, në vend që të reagonte me një trimëri idiote, do të pranonte të keqen më të vogël. E pa të ngrihej e të ikte, pa thënë lamtumirë. Ai vetë i diktoi një sekretari komunikatën për të njoftuar se ish-koloneli Abes Garsia, kishte dhënë dorëheqjen nga Shërbimi Sekret, për të kaluar me detyrë në një vend të huaj. Dy ditë më vonë, "Karaibet", në pesë kolona, mes lajmeve për të vdekurit dhe kapurit për vrasjen e Gjeneralísimit, publikonte një fotografi, ku doktor Balageri vuri re Abes Garsian, të mbështjellë me një pardesy me garniturë anëve dhe me një sombrero cilindër, si personazhet e Dikensit, duke ngjitur shkallinat e avionit.
- Deri atëherë, Presidenti kishte vendosur që kryeparlamentari i ri, i cili urtësisht do të bënte që Kongresi të kthehej drejt pozicioneve më të pranueshme ndaj Shteteve të Bashkuara dhe komunitetit perëndimor, të ishte, Jo Agustin Kabrali, por senatori Henri Çirinos. Ai do të kishte preferuar Inteligjentin,

kthjelltësia e sjelljeve të tij, ndërkohë që alkoolizimi i Kushtetucionalistit e sjelljeve të tij, ndërkohë që alkoolizimi i Kushtetucionalistit e sjelljeve të tij, ndërkohë që alkoolizimi i Kushtetucionalistit Sarhosh, e neveriste. Por zgjodhi të dytin, sepse të rehabilitonte papritur dikë që sa ishte goditur nga Shkëlqesia e Tij, mund të zemëronte ajkën truhijiste, së cilës ia kishte nevojën. Ishte ende herët për t'i provokuar aq shumë. Çirinosi ishte i pëgërë, por talenti i tij për intriga dhe mashtrime, ishte i madh. Askush nuk i njihte më mirë se ai makinacionet parlamentare. Nuk kishin qenë kurrë miq për shkak të alkoolit, po Balagerit i gallte krupën. Kur u thirr në Pallat dhe Presidenti i bëri të ditur se çfarë donte prej tij, senatori u ngazëllua njësoj si atëherë kur i kërkoi që të lehtësonte, në mënyrën më të shpejtë e më të padukshme, transferimin jashtë shtetit të fondeve të Damës së Hijshme. ("Gjest fisnik ai juaji, zoti President: të sigurosh të ardhmen e një zonje të madhe të rënë në të keq"). Me atë rast, senatori Çirinos, akoma i errët për situatën që zhvillohej, i rrëfeu se kishte patur nderin të informonte SIM-in për Antonio de la Masën dhe gjeneralin Huan Tomas Dias, të cilët endeshin në qytetin kolonial (i kishte parë në një autoveturë të ndalur përballë shtëpisë së një miku në rrugën Espajat) e i lypi shërbimin Presidentit për t'i kërkuar Ramfisit shpërblimin që ai ofronte ndaj çdo informacioni që bënte të mundur kapjen e vrasësve të babait të tij. Doktor Balageri e këshilloi të hiqte dorë nga ajo kënaqësi e të mos e publikonte atë kallëzim patriotik: Do të dëmtonte rëndësinë e tij si kryetar i ri, të cilit Truhijo, midis miqve të ngushtë, i kishte vënë nofkën Lyrashi, e kuptoi menjëherë:

- Më lejoni t'ju përgjigjem, zoti President, - thirri, duke bërë gjeste, si të ishte në tribunë. - Gjithmonë kam menduar se regjimi duhej të hapej kur t'i vinte koha. Pas vdekjes së Shefit, askush më mirë se ju nuk do të dinte të shmangte furtunën dhe ta drejtonte anijen domenikane drejt portit të demokracisë. Do të kesh mbështetjen time si bashkëpunëtorin tuaj më besnik dhe më të përkushtuar.
- Dhe ashtu bëri vërtet. Ai prezantoi në Kongres mocionin për t'i dhënë gjeneral Ramfis Tjullijos pushtetin suprem në hierarkinë ushtarake dhe autoritetin maksimal në çështjet ushtarake e politike të Republikës, dhe udhëzoi deputetët e senatorët mbi politikën e re të Presidentit, e orientuar, jo të mohonte të kaluarën, as të hidhte poshtë Epokën e Truhijos,

por ta kapërcente dialektikisht, duke ia përshtatur kohëve të reja. Kështu që Kiskeja, ndërkohë që do të përsoste demokracinë, pa bërë asnjë hap prapa, do të ftohej përsëri nga motrat amerikane në OEA-s, do t'i hiqeshin sanksionet dhe do të përfshihej në komunitetin ndërkombëtar. Në një nga mbledhjet e shumta të punës me Presidentin Balager, senatori Çirinos pyeti, pa njëfarë shqetësimi, se ç'plane kishte Shkëlqesia e Tij lidhur me ish-senatorin Agustin Kabral.

- Kam urdhëruar t'i zhbllokojnë llogaritë bankare dhe t'i rinjohin shërbimet kushtuar shtetit, me qëllim që të marrë një pension, - e informoi Balageri. - Për momentin kthimi i tij në politikë nuk duket me vend.
- Jam plotësisht me ju, - miratoi senatori. - Inteligjenti, me të cilin kam lidhje të vjetra, është i vështirë dhe ngjall armiqësi.
- Shteti mund ta përdorë talentin e tij, veç me kujdesin që të mos duket shumë, - shtoi kreu i shtetit. - I kam propozuar detyrën e këshilltarit ligjor në administratë.
- Një vendim i matur, - miratoi sërish Çirinosi. - Agustini ka patur gjithmonë një aftësi të lartë juridike.
- Kishin kaluar gati pesë javë nga vdekja e Gjeneralísimit dhe ndryshimet ishin të dukshme. Hoakin Balageri nuk mund të ankohej: Nga President kukull, një zotëri hiç, gjatë asaj kohe tepër të shkurtër, u bë Kryetar Shteti i vërtetë, detyrë që e njohën të gjithë kundërshtarët, por mbi të gjitha Shtetet e Bashkuara. Megjithatë rezervat në parime, kur ia konsulloi të ri, tani i merrnin më seriozisht premtimet e tij për ta çuar ngadalë vendin drejt një demokracie të plotë, brenda rendit, pa lejuar që të përfitojnë komunistët. Çdo dy-tri ditë bënte mbledhje me të dërguarin Xhon Kalvin Hill - një diplomat trupmadh si kauboj, që fliste pa u hedhur degë më degë - të cilin mundi ta bindte se, në këtë periudhë duhej ta kishte si aleat Ramfisin. Gjenerali kishte pranuar planin e hapjes graduale. Ramfisi kishte kontrollin ushtarak në dorë dhe, falë tij, ata shtatëzetë gangësterë, Petani dhe Hektori, si dhe ushtarakët e lidhur ngushtë me Truhijon, ishin nën fre. Ndryshe ata do ta kishin rrëzuar. Ndoshta Ramfisi besonte se, me lëshimet që i bënte Balagerit - kthimi i disa të arratisurve, shfaqja e një kritike të ndrojtur ndaj regjimit të Truhijos në radio dhe gazeta (më luftaracja ishte një gazetë e re, "Bashkimi qytetar", që doli në gusht), mitingjet publike të forcave

opozitare që filluan të pushtonin rrugët, të djathtët, Bashkimi Qytetar Kombëtar i Viriato Fiajos dhe Anhel Severo Kabralit, dhe të majtët, Lëvizja Revolucionare "14 Qershori" - ai mund të kishte një të ardhme politike. Si ishte e mundur që një njeri me mbiemrin Truhijo të vazhdonte të figuronte që një njetetën publike të këtij vendi? Ta hiqte atë kohë, do të ishte gabim. Ramfisi kontrollonte topat dhe kishte përkrahjen e ushtarakëve. Të shpërbëje Forcat e Armatosura derisa të shkulej truhijizmi, donte kohë. Marrëdhëniet e qeverisë me Kishën qenë përsëri të shkëlqyera. Balageri shpesh e pinte kafen me nuncion apostolik dhe kryepeshkopin Pitini.

- Çështja për të cilën nuk do të mund të pranohej zgjidhje ndaj opinionit ndërkombëtar, ishte "të drejtat e njeriut". Kishte protesta të përditshme për të burgosurit politikë, të torturuarit, të zhdukurit, të vrarët në Viktoria, El Nueve, Kuarenta dhe burgjet e kazermat e tërë vendit. Në zyrën e tij kishte një shi të vërtetë manifestesh, letrash, telegramesh, informatash, komunikatash diplomatike. Nuk mund të bëje shumë. Më mirë të thoshte asgjë, veç se të premtonte gjëra të paqarta dhe të shihte tjetër gjë. Vazhdonte ta linte Ramfisin me duar të lira. Ende nuk mundej të mos plotësonte zotimin e marrë. I biri i Gjeneralísimit kishte dërguar donja Marien dhe Angjelitën në Evropë dhe vahzdonte, i palodhshëm, duke kërkuar komplotistë, sikur konspiracioni për të vrarë Truhijon të ishte aq i madh. Një ditë gjenerali i ri i ra pyetit vrazhdë:
- E dini që Pedro Livio Sedenjoja deshi t'ju përfshijë në vrasjen e babait?
- Nuk më çudit, - buzëqeshi Presidenti, pa u shqetësuar. - Mbrojtja më e mirë e vrasësve, është të ngatërrojnë gjithë botën. Sidomos njerëzit e afërt të Bamirësit. Francezët e quajnë këtë intoksikacion.
- Sikur edhe një vrasës më shumë ta konfirmonte këtë, ju do të kishit patur fatin e Pupo Romanit, - Ramfisi dukej esëll, megjithatë duhmën që lëshonte. - Në këto çaste ai mallkon veten pse lindi.
- Nuk dua ta di, gjeneral, - e ndërpreu Balageri, duke zgjatur dorën. - Është e drejta juaj morale të hakmerreni ndaj krimit. Por mos më jepni hollësira, ju lutem. E kam më të lehtë të përballoj kritikat që më vijnë nga gjithë bota, po të mos i di veprimet që denoncojnë, janë të vërteta.

- Shumë mirë. Vetëm do t'ju njoftoj për kapjen e Antonio Imbertit dhe Luis Amiamës, nëse i kapim. - Balageri vuri re se fytyra e bukuroshit tkurrej, si gjithmonë, kur përmendte ata dy pjesëmarrës të komplotit, të cilët ende nuk ishin të burgosur, as të vrarë. - Besoni ju se janë ende këtu?
- Sipas meje, po, - siguroi Balageri. - Po të kishin dalë jashtë vendit, do të kishin dhënë konferenca shtypi, do të kishin marrë çmime, do të dukeshin në të gjithë televizionet. Do të ishin duke gëzuar pozitën e tyre prej heronjsh të hamendur. Pa dyshim, janë këtu të fshehur.
- Atëherë, shpejt apo vonë, do t'i kapim, - mërmëriti Ramfisi. - Kam mijëra njerëz që i kërkojnë, shtëpi në shtëpi, vrimë në vrimë. Po të jenë në Republikën Domenikane, do të bien. Dhe nëse jo, nuk ka vend në botë ku mund të shpëtojnë pa paguar vdekjen e babait. Nuk do të kursej as qindarkën e fundit.
- Dëshiroj që t'ia arrini qëllimit, gjeneral, - tha mirëkuptues Balageri. - Më lejoni një këshillë. Mundohuni të ruani pamjen e jashtme. Përpjekja delikate për t'i treguar botës se vendi ynë po shkon drejt demokracisë, do të dështonte nëse do të ndodhte ndonjë skandal. Një tjetër Çështje Galindes apo një tjetër Çështje Betankur.
  Vetëm në çështjen që lidhej me komplotistët i biri i Gjeneralissimusit nuk bënte lëshime. Balageri nuk humbiste kohën të ndërhynte për lirimin e tyre - fati i tyre ishte i ditur, po ashtu edhe ai i Imbertit dhe Amiamës, po t'i kapnin - gjë që për të tjerët mund të mos e favorizonte planin e tij. Në të vërtetë, kohët ndryshonin. Po ashtu edhe ndjenjat e turmës. Populli domenikan, truhijist deri në vdekje, do t'u kishte nxjerrë sytë dhe zemrën Huan Tomas Diasit, Antonio de la Masës, Estreja Sadalait, Luis Amiamës, Uaskar Tehedës, Pedro Livios, Fifi Pastoricit, Antonio Imbertit e shokëve të tyre, nëse këta do t'i kishin dalë përpara deri më 30 maj të vitit 1961. Por, lidhja miqësore me udhëheqësin, me të cilin domenikani kishte jetuar tridhjetë e një vjet, po errësohej. Mitingjet në rrugë të organizuara nga studentët, nga Bashkimi Qytetar, nga 14 Qershori, në fillim të mekura prej frikës, pas një muaji, dy muajsh, tre muajsh u shumëfishuan. Jo vetëm në Santo Domingo (Presidenti Balager e kishte gati mocionin për t'i kthyer emrin e tij Qytetit Truhijo dhe senatori Çirinos do të bënte të mundur miratimin në Kongres me brohoritje në çastin e duhur), ku

shpesh mbushnin parkun Indipendenca, por edhe në Santiago, La Romana, San Francisko de Makoris dhe qytete të tjera. Gjithnjë e më shumë po binte frika e po shtohej të mohuarit e Truhihos. Nuhatja e hollë historike, i thoshte doktor Balagerit se kjo ndjenjë e re do të rritej e do të ishte e parezistueshme. Dhe në një klimë popullore antitruhijiste, vrasësit e Truhihos do të ktheheshin në figura të lartësimi politike. Po kujt do t'i shërbente kjo? Kjo gjë e shtyti Ramfisin të bënte një përpjekje të ndrojtur si kryeparlamentar i lëvizjes së re balageriste. Erdhi të konsultohej me Presidentin, nëse ky besonte se një ligj i Kongresit për amnistinë e komplotistëve të 30 majit, do ta bënte OEA-n dhe Shtetet e Bashkuara që të hiqnin sanksionet.

– Qëllimi është i mirë, senator. Por, ç'pasoja do të ketë? Amnistia do të trazonte ndjenjat e Ramfisit, i cili do t'i vriste menjëherë gjithë të falurit. Përpjekjet do të na shkonin dëm.
– Forca e vlerësimit tuaj, gjithmonë më lë pa mend, - tha senatori Çirinos, gati të duartrokiste.
– Jashtë kësaj teme, Ramfis Truhiho, i cili ishte dorëzuar pijes së përditshme në Bazën e San Isidros dhe në shtëpinë e vet buzë detit, në Boka Çika, ku qe tërhequr, i shoqëruar nga e ëma dhe dashnorja e fundit, një balerinë e Lidio de Paris, dhe duke lënë në atë qytet shtatëzonë gruan e ligjshme, artisten e re Lita Milan, kishte bërë hapa edhe më tej nga ç'shpresonte Balageri. Kishte pranuar që t'i kthehej përsëri Santo Domingo Qytetit Truhiho. Po ashtu, t'u viheshin emrat e tyre të parë qyteteve, lokaliteteve, rrugëve, shesheve, urave, vendeve të ndryshme, të quajtur Gjeneralisim, Ramfis, Anhelita, Radames, Donja Hulia, apo Donja Maria, dhe s'ngulte më këmbë për të ndëshkuar dhe aq studentët, armiqtë dhe endacakët që shkatërronin statujat, pllakat, bustet, fotot, tabelat e Truhihos dhe familjes së tij në rrugë, bulevarde, parqe e rrugicë. Pa fjalë e pranoi sugjerimin e Balagerit që "me një akt bujarie patriotike", t'ia jepte Shtetit, pra vendit, tokat, fermat, ndërmarrjet bujqësore të Gjeneralisimit dhe bijve të tij. Ramfisi e bëri këtë me një letër publike. Kështu Shteti u bë zot i dyzet për qind të të gjithë tokave të punueshme, gjë që e bëri të dytë vendin e dytë në kontinent, pas shtetit kuban, për pronat shtetërore që zotëronte. Por gjeneral Ramfisi duhej të qetësonte shpirtrat e atyre trashanikeve, vëllezërve të Udhëheqësit, të cilët, zhdukja sistematike e shkëlqimit e simboleve truhijiste, i çorodiste.

Një natë Balageri, pasi kishte darkuar me të motrat menynë e thjeshtë të çdo dite, supë pule, pilaf, sallatë dhe ëmbëlsirë me qumësht, kur u ngrit për të shkuar të flinte, iu morën mend. Humbi vetëdijen për pak sekonda dhe doktor Feliks Goiko e paralajmëroi: Po të vazhdonte të punonte me atë ritëm, deri në fund të vitit zemra apo truri do t'i shpërthente si një granatë. Duhej të shplodhej ende - që nga vdekja e Truhihos flinte vetëm tri apo katër orë - të bënte ushtrime dhe, në fund të javës, të argëtohej. U detyrua të qëndrojë në shtrat pesë orë çdo natë dhe pas të ngrënit, shëtiste duke shmangur njerëzit e sherrit, larg bulevardit Xhorxh Uashington. Shkonte te parku i vjetër Ramfis, tani me emrin Eugenio Marie de Hostos. Të dielave, pas meshës, për të prehur shpirtin, lexonte nja dy orë poezi romantike dhe moderniste, apo klasikët e kastejanos të Shekullit të Artë. Nganjëherë, ndonjë idhnak e ndalonte në rrugë: "Balager, o kukull filmi!", - por shumicën e herëve e përshëndesnin: "Paq të mira, President!". I falenderonte me ceremoni, duke hequr kapelen, të cilën kishte zakon ta ngjiste deri te veshët për të mos ia marrë era.

- Më 2 tetor 1961, kur deklaroi në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në Nju Jork, se "në Republikën Dominikane po lind një demokraci e vërtetë dhe një rend i ri gjërash", bënte të ditur para qindra delegatësh, se diktatura e Truhihos kishte qenë anakronike, një shtypje e egër lirish dhe të drejtash. U kërkoi kombeve të çliruara të ndihmonin për t'u kthyer ligjin dhe lirinë dominikanëve.
- Pas pak ditësh, mori një letër të hidhur prej donja Marie Martinesit, nga Parisi. Dama e Hijshme ankohej se Presidenti "padrejtësisht" kishte dhënë një tablo të keqe të Epokës së Truhihos, "pa u kujtuar për gjërat e mira që bëri burri im, të cilave, ju vetë, u thurët aq lavde gjatë tridhjetë e një viteve". Por, nuk ishte Marie Martinesi ajo që e shqetësonte Presidentin. Ishin vëllezërit e Truhihos. Mori vesh se Petani dhe Negroja kishin takuar menjëherë Ramfisin, të cilit i kishin kërkuar: A do të lejonte që ai turiqkën të shkonte në OKB për t'u tallur me babanë e tij? Kishte ardhur ora për ta shporrur nga Pallati Kombëtar dhe për të vënë atje një të ri nga familja Truhiho, siç e kërkonte populli. Ramfisi gjykoi se, po të bënte një grusht Shteti, ndërhyrja e marinsave do të ishte i pashmangshëm: ia kishte bërë të qartë Xhon Klavin Hilli, personalisht. E vetmja

mundësi për të ruajtur diçka, ishte të shtrëngoje radhët pas kësaj qenieje të dobët, por të ligjshme, që quhej President. Balageri manovronte me zgjuarsi për të arritur që OKB-ja dhe Departamenti i Shtetit të hiqnin sanksionet. Prandaj i duhej të bënte diskutime si ai në OKB, kundër bindjeve të veta.

– Megjithatë, në mbledhjen që pati me kreun e shtetit, pasi ky u kthye nga Nju Jorku, i biri i Truhihos u tregua shumë më pak tolerant. Zemërimi i tij ishte i tillë, sa prishja dukej e pashmangshme.
– Do të vazhdosh ta sulmosh babanë, siç bëre në Asamblenë e Përgjithshme? - I ulur po në atë karrige ku ulur Shefi në takimin e fundit, disa orë para se ta vrisnin, Ramfisi fliste me vështrim nga deti.
– S'kam rrugë tjetër, gjeneral, - pranoi Presidenti, i zënë ngushtë. - Nëse dua t'i bind se çdo gjë ka ndryshuar, se vendi po shkon, vërtet, drejt demokracisë, duhet të jap prova autokritike për të kaluarën. Është e dhimbshme për ju, e di. Edhe për mua s'është më pak e tillë. Politika, shpesh, kërkon dhimbje.
– Gjatë një hopi, Ramfisi nuk u përgjigj. Mos ishte i dehur? Apo i droguar? A thua, po i afrohej një nga ato krizat shpirtërore që hapte portat e çmendurisë? Me rrathët e zmadhuar e mavi të syve, me sytë të ndezur e plot angështi, bënte ca ngërdheshje të çuditshme.
– Unë jua kam shpjeguar, - shtoi Balageri. - Po t'i nënshtrohem rreptësisht marrëveshjes sonë. Ju, vetë, e keni miratuar projektin tim. Por, pa dyshim, qëndron në këmbë ajo që ju kam thënë atëherë. Nëse preferoni të merrni frenat, s'është nevoja të nxirrni tanket nga San Isidro. Qysh tani jua dorëzoj.
– Të gjithë ma kërkojnë, - mërmëriti pa entuziazëm tjetri. - Ungjërit e mi, komandantët e rajoneve, ushtarakët, të afërmit, miqtë e babait. Po s'dua të ulem aty ku jeni ju. E kam bezdi, s'më pëlqen, doktor Balageri. Po, pse? Që ta paguaj si im atë?!
Heshti me një shkurajim të thellë.
– Atëherë, gjeneral, në s'doni pushtet, më ndihni ta ushtroj.
– Ende? - iu kthye tallës Ramfisi. - Po të mos isha unë, ungjërit e mi do të të kishin vrarë me kohë.
– Nuk mjafton, - replikoi Balageri. - Ju i shihni trazirat në rrugë. Mitingjet e Bashkimit Qytetar dhe 14 Qershorit çdo ditë bëhen më të dhunshme. Dhe do të shkojë edhe më keq nëse nuk e fitojmë lojën me ta.

Te birit të Gjeneralisimit i erdhi fytyra në vend. Priste, me kokën përpara, si ta pyeste, nëse Presidenti do të guxonte të kërkonte atë që ai dyshonte.

- Ungjërit duhet të ikin nga ky vend, - tha qetësisht doktor Balageri. - Derisa të jenë këtu, as komuniteti ndërkombëtar, as opinioni publik, nuk do të besojnë te ndryshimet. Vetëm ju mund t'i bindni.
- Mos do të kërkoni t'ia mbath dhe unë nga ky vend, të cilin e bëri im atë, në mënyrë që njerëzit të gëlltisin marrëzitë e kohëve të reja?
- Balageri priti pak sekonda.
- Po, - pështpëriti me frikë të madhe. - Edhe ju. Por pasi të keni nisur xhaxhallarët. Për të më ndihmuar të forcoj qeverinë, për t'ua bërë të qartë Forcave të Armatosura se Truhijo nuk është më. Kjo nuk është gjë e re për ju, gjeneral. Gjithmonë e keni ditur se më e mira për ju, familjen dhe miqtë tuaj, është që ky projekt të ecë përpara. Me Bashkimin Qytetar apo 14 Qershorin në pushtet, do të ishte më keq.
- As nxorri revolverin, as e pështyti: U zbeh përsëri dhe sërish i nisën ato ngërdheshjet e të sëmurit mendor. Ndezi një cigare dhe nxorri shtëllunga tymi, duke i parë se si shpërbëheshin e largoheshin.
- Do të kisha ikur me kohë nga ky vend qelbësirash e bukëshkelësh, - nëpërdhëmbi. - Po të kisha gjetur Amiamën dhe Imbertin, s'do të isha këtu. Janë të vetmit që mungojnë. Me të mbajtur premtimin që i kam bërë babait, do të ikë.
- Presidenti e informoi se kishte autorizuar kthimin nga mërgimi të Huan Bosch dhe të shokëve të tij të Partisë Revolucionare Domenikane. Iu duk se gjenerali nuk i dëgjoi shpjegimet e tij që Boschi dhe PRD po i përkushtoheshin një lufte të pamëshirshme, si dhe Bashkimi Qytetar e 14 Qershori, për t'u venë në krye të antitruhijizmit. Kështu që do t'i bënin një shërbim të mirë qeverisë. Se, në të vërtetë, më të rrezikshmit ishin zotërinjtë e Bashkimit Qytetar Kombëtar, ku bënin pjesë njerëz të fuqishëm ekonomikisht e konservatorë me ndikim në Shtetet e Bashkuara, si Severo Kabrali. Dhe këtë e dinte mirë Huan Boschi, i cili do të bënte ç'ishte e mundur dhe, mbase edhe të pamundurën, për të shmangur kundërshtarë aq të fuqishëm.
- Në Viktoria qëndronin nja dyqind pjesëmarrës të komplotit,

të vërtetë apo të dyshuar, të cilët sa të iknin Truhijot, do të liroheshin. Po Balageri e dinte se i biri i Truhihos kurrë nuk do t'i linte të dënuarit të gjallë andej ekzekutuesit. Nuk do t'u ndahej atyre, si dhe gjeneral Romanit, të cilin e torturoi katër muaj rresht dhe pastaj tha se kishte vrarë veten, ngaqë e brente ndërgjegjja për tradhtinë që kishte bërë. Kufoma kurrë nuk iu gjet. Nuk do t'i ndahej as Modesto Diasit, i cili, sa të ishte gjallë, do ta torturonin ende. Problemi ishte se këta të burgosur - opozita i quante ekzekutorët - e shëmtonin fytyrën e re që ai donte t'i jepte regjimit. Çdo ditë vinin misione, delegacione, politikanë dhe gazetarë të huaj që interesoheshin për të burgosurit dhe Presidenti duhej të bënte dredha për t'u shpjeguar pse nuk po gjykoheshin ende, të betohej se jeta e tyre do të respektohej dhe se në gjyqin tepër të pastër ndaj tyre, do të asistonin vëzhgues të huaj ndërkombëtarë. Pse nuk kishte mbaruar ende punë me ta Ramfisi, siç bëri pothuajse me gjithë vëllezërit e Antonio de la Masës - Marion, Bolivarin, Erneston, Pirolon e shumë kushërinj, nipër e ungjër, të vrarë me plumba apo me dhunë qysh ditën e arrestimit - në vend që t'i mbante ashtu, si tharm të gatshëm për opozitën? Balageri e dinte se gjaku i ekzekutorëve do ta spërkaste: Do t'i shkonte dëm përpjekja që i duhej të përleshej me të.

- Pak ditë pas asaj bisede, një telefonatë e Ramfisit i solli një lajm të shkëlqyer: I kishte bindur ungjërit. Petani dhe Negroja do të niseshin jashtë për pushime të gjata. Më 25 tetor, Hektor Bienvenido fluturoi drejt Xhamajkës, me të shoqen amerikane. Ndërsa Petani u nis me fregatën "Presidenti Truhiho" që do të hipte në një kryeqëzor që shkonte në Karaibe. Konsulli Xhon Kalvin Hill i tha Balagerit se tani po besonte në mundësinë e heqjes së sanksioneve.
- Të mos vonohen shumë, zoti konsull, - iu lut Presidenti. - Çdo ditë Republika po asfiksohet gjithnjë e më shumë.

  Ndërmarrjet industriale ishin pothuajse të paralizuara nga paqartësia politike e kufizimet për të importuar lëndë të parë. Dyqanet ishin të zbrazura nga rënia e të ardhurave. Ramfisi po i shihte me humbje firmat e regjistruara jo në emër të Truhijove, me të cilat Banka Qendrore duhej të transferonte ato shuma të kthyera në valutë me një vlerë këmbimi joreale, një pesë një dollar, bankave të Kanadasë dhe Evropës. Familja nuk kishte nxjerrë aq para jashtë, sa

ia kishte frikën Presidenti: Donja Maria dymbëdhjetë milionë dollarë, Anhelita trembëdhjetë, Radamesi shtatëmbëdhjetë dhe, deri tani, Ramfisi rreth njëzet e dy. Gjithsej bëheshin gjashtëdhjetë e katër milionë dollarë. Mund të kishte qenë edhe më keq. Pra, rezervat do të ishin shfarosur shpejt dhe, tani nuk do të mundej të paguheshin ushtarakët, mësuesit dhe nëpunësit e shtetit.

- Më 15 nëntor, Ministri i Brendshëm e njoftoi me telefon tepër i frikësuar: Gjeneralët Petan dhe Hektor Truhiho ishin kthyer papritur. Ju lut që të kërkonte azil politik, sepse në çdo çast do të shpërthente grushti ushtarak. I mbështeste shumica e Ushtrisë. Balageri thirri me urgjencë konsullin Kalvin Hill. I shpjegoi situatën. Veçse po t'i ndalonte Ramfisi, ndryshe shumë garnizone do të mbështesnin Petanin dhe Negron në përpjekjen e tyre për kryengritje. Do të kishte një luftë civile, fundi i së cilës nuk dihej, dhe ndonjë një kasaphanë të madhe ndaj antitruhijistëve. Konsulli i dinte të gjitha. Në të njëjtën kohë, e informoi se Presidenti Kenedi, personalisht, sapo kishte urdhëruar dërgimin e një flote luftarake. Të nisur nga Porto Rikoja, ajo po udhëtonte drejt brigjeve domenikane: aeroplanmbajtësja "Valley Forge", kryqëzori "Little Rock" (anije e famshme e Flotës së Dytë) dhe torpedinerët gjuajtës "Hyman", "Bristol" e "Beatty". Nja dy mijë marinsa do të zbarkonin, nëse do të kishte puç ushtarak.
- Në një telefonatë të shkurtër me Ramfisin - ishte përpjekur edhe katër herë të tjera të lidhej më përpara me të - ky i dha lajmin më ogurzi. Kishte pasur një bisedë të ashpër me xhaxhallarët e tij. Nuk donin të iknin. Ramfisi u kishte thënë se, atëherë, po iki unë.
- Ç'do të ndodhë tani, gjeneral?
- Se, duke nisur nga ky çast, ju do të ngeleni vetëm në kafazin me bishat, zoti President, - qeshi Ramfisi. - Ju priftë e mbara!
- Doktor Balageri mbylli sytë. Orët dhe ditët që vinin do të ishin vendimtare. Ç'mendonhte të bënte i biri i Truhihos? Të nisej? T'ia hiqte vetes? Do të nisej për në Paris, të bashkohej me gruan, nënën dhe motrën e vet, të ngushëllohej me festa, lojëra polo dhe femra në shtëpitë e bukura që kishte blerë në Neuilly. Tashmë i kishte nxjerrë të gjitha paratë që kishte mundur. Kishte lënë disa prona të paluajtshme, të cilat, shpejt apo vonë, do të konfiskoheshin. Por, në fund të fundit, nuk ishte

ky shqetësimi për Balagerit. Problemi ishin shtazët e paarsyeshme. Vëllezërit e Gjeneralisimit do të fillonin së shpejti të qëllonin me armë, të vetmen gjë që dinin të bënin. Në tërë listat e armiqve për likujdim që kishte bërë Petani, sipas fjalëve të njerëzve, Balageri ishte në krye. Siç thoshte një fjalë e urtë, që Balagerit i pëlqente ta citonte, duhej "ta kapërcente këtë lumë me kujdes dhe gur më gur". Nuk kishte frikë, vetëm keqardhje, ngaqë ndërtesa e bukur të cilën po e vinte në rrugë të mbarë, do të shkatërrohej nga dhuna e një të jete të poshtri.

- Të nesërmen, qysh pa gdhirë, e zgjoi Ministri i Brendshëm dhe e informoi se një grup ushtarakësh kishin nxjerrë kufomën e Truhihos nga varrezat e kishës së San Kristobalit. E kishin çuar në Boka Çika, ku, përballë skelës private të gjeneral Ramfisit, ishte ankoruar jahti "Anhelita".
- Nuk kam dëgjuar asgjë, zoti ministër, - i mbylli telefonin Balageri. - As ju nuk më keni thënë gjë. Ju kështilloj të shplodheni disa orë. Kemi ditë plot.
- Ndryshe nga ç'e këshilloi ministrin, vetë ai nuk ndenji të priste kohën. Ramfisi nuk do të nisej pa likujduar vrasësit e të atit. E kjo vrasje mund të hidhte përtokë të gjitha përpjekjet e tij të mëdha të muajve të fundit për të bindur botën se me atë në Presidencë, Republika po ecte drejt demokracisë, pa luftë civile, pa kaos, nga e cila trembeshin Shtetet e Bashkuara dhe klasa drejtuese domenikane. Po ç'mund të bënte? Çdo urdhër i tij në lidhje me të burgosurit, binte ndesh me atë të Ramfisit, i tij pasuesi dhe i spikaste mungesën absolute të autoritetit të tij në Forcat e Armatosura.
- Por mistershëm, veç përhapjes së zhurmës mbi kryengritjen e shpejtë të armatosur dhe masakrën civile, as më 16, as më 17 nëntor, nuk ndodhi gjë. Ai vazhdoi të merrej me çështjet e përditshme, sikur vendi të ishte në qetësi të plotë. Në mbrëmjen e 17 nëntorit, u informua se Ramfisi kishte zbrazur shtëpinë e vet në plazh. Pak më vonë, e kishin parë të idhur duke hipur në një automobil, duke sharë e duke hedhur një granatë mbi fasadën e Hotel Ambasadorit, e cila nuk kishte plasur. Prej atëherë, nuk e pa më vendin e vet. Mëngjesin tjetër, një komision i Bashkimit Qytetar Kombëtar, i kryesuar nga Anhel Severo Kabrali, kërkoi një takim urgjent me Presidentin: Çështja ishte për jetë a vdekje. E priti komisionin. Severo Kabrali ishte si i tërbuar. Tundte në dorë një fletë të shkruar. Ishte letra e

Uaskar Tehedës dërguar së shoqes, Lindinës, fshehtësish, prej Viktorias, ku i tregonte se gjashtë të akuzuarit për vrasjen e Truhihos (përfshirë Modesto Diasin dhe Tunti Kaseresin), i kishin ndarë nga të burgosurit e tjerë politikë për t'i çuar në një burg tjetër. "Do të na vrasin, e dashur", - përfundonte pusulla. Drejtuesi i Bashkimit Qytetar kërkoi që të burgosurit të viheshin në dispozicion të Pushtetit Gjyqësor ose të liroheshin me dekret presidencial. Gratë e të burgosurve, bashkë me avokatët e tyre, po manifestonin te dyert e Pallatit. Shtypi ndërkombëtar ishte i alarmuar, si dhe Departamenti i Shtetit e ambasadat perëndimore.

- Doktor Balageri, me gjak të prishur, i siguroi se do të merrej personalisht me këtë çështje. Nuk do të lejonte një krim të tillë. Sipas informatave që kishte, transferimi i gjashtë komplotistëve, kishte për qëllim që të përshpejtohej më shumë ecuria. Bëhej fjalë për një procedurë të thjeshtë të rindërtimit të krimit, pas së cilës do të fillonte pa vonesë gjykimi. Dhe sigurisht, me vëzhgues të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, të cilët do t'i ftonte ai vetë.
- Me të ikur drejtuesit e Bashkimit, thirri prokurorin e përgjithshëm të Republikës, doktor Hose Manuel Maçado. A e dinte ai se shefi i Policisë Kombëtare, doktor Hose Morenos, kishte urdhëruar transferimin e Estreja Sadalait, Uaskar Tehedës, Fifi Pastoricës, Pedro Livio Sedenjos, Tunti Kaseresit dhe Modesto Diasit në qelitë e Pallatit të Drejtësisë? Prokurori i përgjithshëm i Republikës nuk dinte gjë. Reagoi i indinjuar: Dikush, padrejtësisht, përdorte emrin e Pushtetit Gjyqësor. Asnjë gjyqtar nuk kishte urdhëruar një rindërtim të ri të atentatit. Tepër i shqetësuar, Presidenti e siguroi se kjo qe e patolerueshme. Do të urdhëronte menjëherë Ministrin e Drejtësisë të hetonte thellësisht për të përcaktuar përgjegjësinë dhe për të fajësuar autorët. Për të lënë prova të shkruara për çka do të bënte, i diktoi sekretarit të vet një notë dhe e urdhëroi ta çonte menjëherë në Ministrinë e Drejtësisë. Pastaj mori në telefon Ministrin, i cili bënte si i luajtur mendsh:
- Nuk di ç'të bëj, zoti President. Të dera kam gratë e të burgosurve. Kam presione nga të gjitha anët për t'i informuar, po unë nuk di asgjë. Dini gjë ju, se i kanë transferuar në qelitë e Pallatit të Drejtësisë? Askush nuk është në gjendje të më shpjegojë. Tani i kanë çuar në rrugë për një rindërtim të ri të

krimit, për të cilin askush nuk ka urdhëruar. Është e pamundur të afrohesh atje, sepse ushtarët e Bazës së San Isidros kanë bllokuar tërë zonën. Ç'duhet të bëj?

- Shko vetë atje kërko shpjegime, - e këshilloi Presidenti. - Është e domosdoshme të ketë dëshmitarë, që qeveria ka bërë gjithçka për shkeljen e ligjit. Kërko të të shoqërojnë përfaqësues të Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë së Madhe.
- Doktor Balageri i telefonoi personalisht Xhon Kalvin Hillit dhe iu lut ta mbështeste veprimin e ministrit të Drejtësisë. Në të njëjtën kohë e informoi se mundej që, nëse gjeneral Ramfisi, i detyruar, do të braktiste vendin, vëllezërit e Truhihos do të hidheshin në aksion.
- Vazhdoi punën, i shqetësuar nga situata kritike e financave. Nuk lëvizi nga zyra as në orën e të ngrënit. Duke punuar me sekretarin e Shtetit të Financave dhe guvernatorin e Bankës Qendrore, nuk pranoi të bënte as biseda telefonike, as takime. Në mbrëmje, sekretari i dha një njoftim të Ministrit të Drejtësisë, ku thuhej se ai dhe konsulli i Shteteve të Bashkuara ishin penguar nga ushtarët e armatosur të Aviacionit për t'u afruar te zona e rindërtimit të krimit. I konfirmonte, gjithashtu, se askush nuk kishte kërkuar procedurë gjyqësore po gjykatë, madje, as ishte vënë në dijeni, për atë procedurë. Ishte një vendim plotësisht ushtarak. Sa mbërriti në shtëpi, në tetë e gjysmë të darkës, pati një telefonatë prej shefi i Policisë, koloneli Markos A. Horhe Moreno. Kamionçina me tre rojat e armatosura, që pas plotësimit të procedurës gjyqësore po kthente të burgosurit në Viktoria, qe zhdukur në rrugë.
- Mos kurse përpjekjet për ta gjetur, kolonel. Mobilizo tërë forcat që ke, - e urdhëroi Presidenti. - Më njofto në çdo orë.
- Motrave e veta, të shqetësuara nga fjalët që qarkullonin se Truhijot i kishin vrarë atë mbasdite ekzekutuesit e Gjeneralisimit, u tha se nuk dinte gjë. Me sa duket, qenë sajime të ekstremistëve për të ashpërsuar klimën e shqetësimit dhe pasigurisë. Ndërsa qetësonte ato me gënjeshtra, hamendësoi: Ramfisi do të ikte sonte, nëse nuk ishte nisur ende. Atëherë ballafaqimi me vëllezërit Truhiho do të ndodhte në mëngjes. Do të vinin ta kapnin? Do ta vrisnin? Truri i tij i vogël, ishte i aftë të besonte se duke e vrarë, do ta shpëtonin atë makineritë historike, për t'i fshirë sa më shpejt nga politika dominikane. Nuk kishte kurrfarë shqetësimi, por vetëm kureshtje.

Kur po vishte pizhamat, telefonoi përsëri koloneli Moreno. Ishte gjetur kamioçina: Të gjashtë të burgosurit qenë zhdukur, pasi kishin vrarë rojat.

– Mos le gjë pa bërë, derisa t'i gjesh, - i tha me ton recituesi. - Do të përgjigjeni për jetën e atyre të burgosurve, kolonel. Ata duhet të dalin para një trupi gjykues, që të gjykohen sipas ligjit për këtë krim të ri.
– Para se të flinte, e pushtoi befas një ndjenjë keqardhjeje. Jo për të burgosurit e vrarë atë mbasdite, pa dyshim nga Ramfisi, përpara se të ushtarët, të cilët, po ashtu i kishte vrarë i biri i ushtarët e mjerë, të vërtetuar kinse arratisjen e të burgosurve. Tre besueshëm një marrëzi që kurrë s'do ta besonte njeri! Ç'krim i panevojshëm!
– Të nesërmen shkoi në Pallat, lexoi në faqet e brendshme të "Karaibeve" për ikjen e vrasësve të Truhihos, pasi kishin vrarë, pabesisht, të tre ushtarët, të cilët po i kthenin në Viktoria. Megjithatë, skandali i cilit i trembej, s'ndodhi, e lanë mënjanë ngjarjet e tjera. Nga orën dhjetë të mëngjesit, një shkelje e hapi dhunshëm derën e zyrës së tij. Me automatik në dorë e me granata e revolverë në brez, hyri me vrull gjenerali Petan Truhiho, pas tij i vëllai, Hektori, po ashtu me uniformë gjenerali. Me vete kishin njëzet e gjashtë burra të armatosur, garda e tyre personale, me pamje rrufjanësh të alkoolizuar. Bezdia që i shkaktoi turma e harbutëve, qe më e fortë se frika.
– Nuk mund t'ju ftoj të uleni, se nuk kam aq karrige, më falni, - u shfaqësua i vogli President, duke u ngritur përgjysmë nga vendi. Dukej i qetë dhe fytyrën e tij e rrumbullaktë buzëqeshte me njerëzi.
– Ka mbërritur ora e së vërtetës, Balager, - hungëriti shtazërisht Petani, duke pështyrë. Vringëllinte automatikun kërcënueshëm, përpara fytyrës së Presidentit, i cili nuk lëvizi nga vendi. - Mjaft me dëngla hipokrite! Ashtu siç mbaroi punë dje me ata bij kurvash Ramfisi, do të mbarojmë edhe ne me ca zabërhanë. Do ta fillojmë nga judët, mor tradhtar xhuxh.
– Dukej hapur se ishte ca i dehur ai hiç vulgar. Balageri e fshihte zemërimin dhe shqetësimin e tij, duke e vështruar vetëm plotësisht. Me qetësi u tregoi dritaren:
– Ju lutem, më shoqëroni, gjeneral Petani, - iu drejtua atij, pastaj Hektorit. - Edhe ju, ju lutem.

Shkoi te dritarja dhe tregoi me gisht nga deti. Ishte një mëngjes rrezatues. Përballë brigjeve dalloheshin shumë qartë duke rrëzëllitur, siluetat e tri anijeve luftarake amerikane. Emrat nuk mund t'ua lexoje dot, por mund të dalloje grykat e gjata të topave të të dyja jahteve të para, si pajisur me raketa dhe të aeroplanmbajtëseve "Valley Forge" e "Franklin D. Roosevelt", të drejtuar nga qyteti.

– Presin që ju të merrni pushtetin, për të nisur goditjen me topa, - tha Presidenti fare ngadalë. - Presin t'ju jepni pretekstin, për të na pushtuar përsëri. Doni të futeni në histori si domenikanë që lejuan një pushtim të dytë janki të Republikës? Nëse e doni këtë, qëlloni dhe më bëni një hero. Pasardhësi im nuk do të rrijë dot asnjë orë në këtë karrige.
– Pasi e kishin lënë të shqiptonte tërë atë frazë, menduan se ishte e pavend ta vrisnin. Petani dhe Negroja diç pëshpëritën, duke folur njëkohësisht të dy e pa u marrë vesh me njëri-tjetrin. Mujsharët dhe rojat e tyre shikonin shoshoqin të hutuar. Më në fund, Petani urdhëroi njerëzit e vet të dilnin. Kur e pa veten vetëm me dy vëllezërit Truhiho në zyrë, e kuptoi se e kishte fituar betejën. Erdhën dhe u ulën përballë tij. Hëm, bijtë e djallit! Sa të shqetësuar ishin tani! Nuk dinin nga t'ia fillonin. Duhej t'ua lehtësonte punën.
– Vendi pret një gjest të mirë prej jush, - u tha me simpati. - Duhet të veproni me zemërgjerësi dhe patriotizëm e gjeneral Ramfisit. Nipi juaj ka braktisur vendin për të ndihmuar paqen.
– Petani e ndërpreu i revoltuar dhe i tha drejtpërdrejt:
– Është shumë e lehtë të jesh patriot kur ikën jashtë me disa milionë dhe pasuri si Ramfisi. Por as Negroja, as unë nuk kemi atje as shtëpi, aksione, as llogari rrjedhëse. Tërë pasuria jonë është këtu, në këtë vend. Në qoftë se vetmit idiotë që iu bindëm Shefit për të mos nxjerrë para jashtë. Është e drejtë kjo? Nuk jemi idiotë, zoti Balager. Gjithë tokat dhe pasuritë që kemi këtu, do të na i konfiskojnë.
– Balageri u ndje i lehtësuar.
– Kjo ka ilaç, zotërinj, - i qetësoi. - Mjafton gjesti bujar që do të bëni dhe Atdheu do t'jua shpërblejë.

Qysh nga ai çast, gjithçka kaloi në një tregti të mërzitshme fitimi, që ia shtoi edhe më Presidentit përçmimin për njerëzit e etur për para. Ishte diçka që ai kurrë nuk e kishte lakmuar.

Së fundi, u morën vesh për një shumë që Balagerit iu duk e arsyeshme, duke pasur parasysh paqen dhe sigurinë që fitonte Republika. I dha urdhër Bankës Qendrore që t'i jepte dy milionë dollarë secilit prej vëllezërve dhe t'ua kthente në valutë njëmbëdhjetë milionë pesë që kishin, pjesërisht në arkat e kursimit dhe mbetjen në bankat e kryeqytetit. Për të qenë të sigurt se marrëveshja do të respektohej, Petani dhe Hektori kërkuan që ta nënshkruante edhe konsulli amerikan. Kalvin Hilli erdhi menjëherë, i kënaqur që gjërat po rregulloheshin me vullnet të mirë, pa gjakderdhje. Uroi Presidentin, duke i thurur lavde: "Në kriza rajoni, doktor Balageri mendoi se me ikjen e Truhijove, do të kishte një shpërthim të tillë gëzimi dhe hareje - po ashtu edhe kaos - sa pak njerëz do të kujtoheshin për vrasjen e gjashtë të burgosurve, kufomat e të cilëve, pa përrallë dyshimi, kurrë s'do të gjendeshin. Kjo gjë s'do ta dëmtonte shumë.

– Në Këshillin e Ministrave, kërkoi miratimin e plotë kërkesat për një amnisti politike të përgjithshme, që të zbrazeshin burgjet dhe të anuloheshin të gjitha proceset gjyqësore për veprimtari armiqësore dhe urdhëroi në këmbë, e duartrokitën. Demokratë. Ministrat, të ngritur në këmbë, e duartrokitën. Atëherë, me faqet pak të skuqura, doktor Tabare Alvares Perejra, Ministër i Shëndetësisë, bëri të ditur se qysh prej gjashtë muajsh e mbante të fshehur në një dollap muri të ngushtë, midis bluzave dhe pizhamave - të kërkuarin Luis Amiama Tio. Doktor Balageri e lavdëroi shpirtin e tij human dhe i tha që ta shoqëronte ai vetë në Pallatin Kombëtar doktor Amiamën, sepse ky, sikurse edhe Antonio Imberti, i cili pa dyshim, nga çasti në çast do të bëhej i gjallë, do të priteshin nga vetë Presidenti i Republikës me respektin e mirënjohjen që meritonin për shërbimet e larta kushtuar Atdheut.

XXIII

Pas ikjes së Amaditos, Antonio Imberti qëndroi akoma edhe ca kohë te shtëpia e kushëririt të tij, doktorit Manuel Duran Barreras. Nuk kishte shpresë se Huan Tomas Diasi dhe Antonio de la Maza, do ta gjenin gjeneral Romanin. Ndoshta Plani politiko-ushtarak ishte zbuluar dhe Pupoja ishte i vdekur ose i burgosur. Ndoshta ishte trembur dhe ishte tërhequr. Nuk kishte rrugë tjetër, veç të fshihej. Me të kushëririn, Manuelin, shqyrtuan mundësitë, para se të vendoste për shkuar te doktoresha Gladis de los Santos, një kushërira e largët, kunata e Duranit. Ajo jetonte afër kësaj shtëpie.

- Ishin orët e para të mëngjesit, po ishte ende errësirë, kur Manuel Durani dhe Imberti i përshkuan me hapa të shpejta ata gjashtë blloqe, pa ndeshur në makina dhe njerëz. Doktoresha u vonua për të hapur derën. Ishte me rrobëdëshambër dhe fërkonte sytë fort, ndërsa ata ia shpjegonin. Nuk u tremb shumë. Reagoi me një qetësi të çuditshme. Ishte një grua e mbyllur, por e shkathët, midis të dyzetave dhe të pesëdhjetave, që tregonte siguri dhe e shikonte botën me shpërfillje.
- Eja, rregullohu një herë sim-i. Më kanë hapur dosje.
  Për të mos e parë shërbëtorja, e rregulloi pranë garazhit, në një depo të vogël me dritare, ku shtroi një dyshek portativ. Ishte një hapësirë e kufizuar, pa ajrim dhe Antonioja nuk mbylli sy tërë natën. E vuri Colt 45 pranë tij, në një sergjen mbushur me kuti konservash. Rrinte i tendosur, me veshët pipëz ndaj çdo zhurme të dyshimtë. Herë-herë mendonte për të vëllanë, Segundon, dhe i ngjethej mishi: Ishin duke e torturuar apo e kishin vrarë atje në Viktoria.
- E zonja e shtëpisë, e cila e kishte mbyllur depon me çelës, erdhi për ta nxjerrë andej në orën nëntë të mëngjesit.
- I dhashë leje shërbyeses që të shkonte në Harabakoa, për të parë familjen e vet, - i dha kurajë. - Mund të hysh në shtëpi. Por që të mos ju shohin fqinjët, natën do ta kaloni në atë guvë.

Ndërsa hanin mëngjes në kuzhinë, me mangu, djathë të skuqur dhe kafe, po dëgjonin edhe lajmet. Asnjë nga informacionet e radios nuk tha gjë për atentatin. Doktoresha Santos u nis pak më vonë për në punë. Imberti bëri një dush, zbriti në sallonin e vogël dhe u shtri në një kolltuk, ku e zuri gjumi me Colt 45 pranë. U hodh përpjetë, duke psherëtirë ngaqë dikush e tundi fort.

– Agentët e morën Manuelin sot në mëngjes, pak më vonë se ç'dole ti andej, - i tha Gladisi, e shumtë e shqetësuar. - Vonë apo shpejt, do të vijnë edhe këtu. Duhet të ikësh nga shtëpia e Imbertëve.
– Po. Po, ku? Gladisi kishte kaluar me kalecët. Pa dyshim, ia kishin ndaluar gruan dhe fëmijët. Ju duk sikur ca duar të padukshme filluan t'ia shtrëngonin fytin. E përmbajti alarmin e vet, për të mos ia shtuar frikën e zonjës së shtëpisë, e cila dukej si e transformuar: Shqetësimi i madh e bënte të hapte e të mbyllte sytë tërë kohën.
– Ka morra me kalecë dhe kamioçina me roja gjithandej, - i tha. - Kontrollojnë makinat, u kërkojnë dokumenta të gjithëve, futen nëpër shtëpi.
– Ende nuk thuhej asgjë në televizion, në radio dhe gazeta, po fjalët s'kishin të mbaruar. Njoftimi se vranë Truhijon po përhapej gojë më gojë në të gjithë qytetin. Njerëzit ishin të paqartë dhe të trembur për çfarë mund të ndodhte. Kishin një orë që po e vrisnin mendjen: Ku të fshihej? Për tani, duhej të dilte këtej. E falënderoi doktoreshën De los Santos për ndihmën dhe doli në rrugë, me dorën e djathtë në xhep, ku mbante pistoletën gati. U end ca, pa ditur ku ndodhej, derisa iu kujtua doktori Kamilo Suero, që jetonte nga Spitali Ushtarak. Kamiloja dhe e shoqja, Alfonsina, e futën brenda. Nuk kishin mundësi për ta fshehur, por së bashku e menduan mirë se cili do të ishte strehimi i mundshëm. Dhe në këto vramendje, i erdhi papritur në kujtesë figura e Françisko Rainierit, një mik i vjetër, djali i një italiani dhe ambasador i Urdhërit të Maltës. Gruaja e Antonio Imbertit, Guarina, dhe ajo e Francisco Rainierit, Venecia, zakonisht pinin çaj dhe luanin letra bashkë. Ndoshta diplomati do të mund t'i lehtësonte azilin në ndonjë legatë. Me kujdes të madh, telefonoi në rezidencën e Rainierëve dhe ia kaloi receptorin Alfonsinës, e cila tha se po flisnin me Guarina Tesonin (mbiemri i vajzërisë

i gruas së Imbertit) dhe donte të fliste me Kekon. Ky e mori menjëherë aparatit dhe la të habitur Alfonsinën me përshëndetjen e përzemërt:

– Si je, e dashur Guarina? Ç'kënaqësi të të përshëndes. Ah, more për takimin e kësaj nate, apo jo? Mos u shqetëso. Do të dërgoj makinën të të marrë. Në shtatë fiks. Mirë? Më thuaj ku je, të lutem.
– Ose është një shenjt, ose është i luajtur mendsh, ose nuk di çfarë, - tha e zonja e shtëpisë, pasi la receptorin.
– Po tani, ç'do të bëjmë deri në shtatë, Alfonsina?
– Lutju Zonjës Sonë të Altagrasias, - bëri kryqin ajo. - Në qoftë se se vijnë kalecët më përpara, do të përdorësh pistoletën, s'ka rrugë tjetër.
– Në shtatë fiks qëndroi te porta një Buick blu i ndritshëm me targë diplomatike. E drejtonte vetë Francisko Rainieri. U nis sakaq kur Imberti qe ulur në krah të tij.
– E mora me mend se ishe ti këtu, sepse Guarina dhe vajza janë janisë në shtëpinë time, - i tha menjëherë Rainieri, në vend të përshëndetjes. - Nuk ka dy Guarina Teson në Qytetin Truhijo, kështu që duhet të ishe ti.
– Ishte shumë i qetë, deri i gëzuar, i veshur me një setër të sapohekurosur e të parfumosur. E çoi Imbertin në një rezidencë të largët nëpër ca rrugë të veçuara, duke bërë një xhiro të madhe, sepse në rrugët kryesore kishte prita kontrolli. Kishte të paktën një orë që qe shpallur zyrtarisht vrasja e Truhijos. Kudo përreth dyshimi, sikur e gjithë bota të priste një shpërthim. Elegant, si gjithmonë, ambasadori nuk bëri asnjë pyetje mbi vrasjen e Truhijos, as për shokët e komplotit. Shumë natyrshëm, si të fliste për kampionatin e ardhshëm të tenisit në "Country Club", komentoi:
– Siç po venë punët, është jashtë mundësive që ndonjë ambasadë të të japë azil. As për çështje të mëdha. Qeveria, nëse ka qeveri, nuk do të respektonte asgjë. Do të të nxirrnin me forcë, kudo që të ishe. E vetmja gjë që të mbetet, është të fshihesh. Në konsullatën e Italisë, ku kam miq, ka shumë vajtje-ardhje punonjësish dhe vizita. Por kam gjetur personin me siguri të plotë. E kam bërë edhe herë këtë punë, me Jujo d'Alessandro, kur ishte i përndjekur. Ka vetëm një kusht. Askush nuk duhet ta dijë, as Guarina. Mbi të gjitha, për sigurinë e saj.
– Sigurisht, - mërmëriti Toni Imberti, i habitur se si me inisiativën e vet,

ky njeri, me të cilin e lidhte një miqësi jo e fortë, rrezikonte aq shumë për t'i shpëtuar jetën. Ishte aq i hutuara nga shpirtmadhësia e jashtëzakonshme e Kekos, sa harroi ta falënderonte.

- Te shtëpia e Rainierit mundi të përqafojë gruan dhe të bijën. Edhe në ato rrethana, ato ruanin qetësi të madhe. Veçse, kur po e shtrëngonte në gjoks Leslin, ndjeu trupin e saj të vogël të dridhej. Ndenji me ato dhe me Rainierit rreth dy orë. E shoqja i kishte sjellë një çantë dore, me rroba të pastra dhe me veglat e rrojës. Nuk e zunë në gojë Truhijon. Guarina i tregoi qëte kishin marrë vesh nga fqinjët. Shtëpia e tyre qe pushtuar që në mëngjes nga policë me uniformë dhe civilë. E kishin bastisur. Gjerat që nuk mundën t'i merrnin dot në dy kamionët që patën me vete, i bënë pluhur e hi.
- Kur erdhi koha, diplomati bëri një gjest të vogël, duke treguar orën. E përqafoi dhe e puthi Guarinen dhe Leslin dhe shkoi pas Francisko Rainierit, nga porta e shërbimit në rrugë. Pak sekonda më vonë, një autoveturë e vogël me drita të venitura, frenoi përpara tyre.
- Lamtumirë dhe paç fat! - e përshëndeti Rainieri, duke i dhënë dorën. - Mos ki merak fare për familjen. Asgjë nuk do t'u mungojë.
- Imberti hyri në autoveturë dhe u ul pranë shoferit. Ky qe një i ri, me këmishë dhe gravatë, por pa xhaketë. Me një spanjishte të përsosur, por me tone muzikore italiane, u prezantua:
- Quhem Cavalieri dhe jam funksionar i ambasadës italiane. Ime shoqe dhe unë do të bëjmë ç'është e mundur që qëndrimi juaj në apartamentin tonë të jetë sa më i këndshëm. Mos u shqetësoni fare, në shtëpinë time nuk do të ketë dëshmitarë të padëshiruar. Ne jetojmë vetëm. Nuk kemi as kuzhiniere, as shërbëtorë. Gruas sime i pëlqejnë punët e shtëpisë. Dhe të dyve na pëlqen të gatuajmë.
- Qeshi dhe Antonio Imberti mendoi se për mirësjellje duhej t'i përgjigjej me një buzëqeshje. Çifti jetonte në katin e fundit të një pallati të ri, jo larg nga rruga Mahatma Gandhi dhe shtëpia e Salvador Estreja Sadalait. Zonja Cavalieri ishte edhe më e re se i shoqi, një vajzë e hollë, me sy bajame dhe flokë të zinj. E priti me një përzemërsi të çiltër dhe tërë gëzim, si një mik të familjes që vjen për të kaluar fundin e javës. Nuk tregoi kurrfarë bezdie për të strehuar një të panjohur

në shtëpinë e vet, vrasësit e zotit të këtij vendi, të cilin mijëra roja dhe policë e kërkonin me lakmi dhe urrejtje. Për gjashtë muaj e tri ditë që jetoi me ta, kurrë, as dhe një herë të vetme, asnjërin nga të zotët e shtëpisë, prania e tij - në atë situatë të volitshme më parë fantazma, ai ishte tepër i ndjeshëm - s'e bëri të ndjehej, sadopak i bezdisur. E dinte ai çift se luhej me jetën? Pa dyshim. Dëgjuan dhe panë në televizion, rrëfime me plot hollësira për panikun që u provokonin ata vrasës të ndyrë domenikanëve, shumë prej të cilëve, jo vetëm që nuk i strehuan, po edhe i kallëzuan. Panë të binte para inxhinieri Uaskar Teheda, i dëbuar pabesisht nga famulltari i tmerruar i kishës së Santo Kura de Ars, i cili e hodhi në krahët e SIM-it. Vazhduan të tregonin me detaje odisenë e gjeneral Huan Tomas Diasit dhe Antonio de la Masës, duke bredhur me një taksi rrugëve të Qytetit Truhijo dhe të spiunuar nga njerëz, të cilëve ata iu drejtuan për ndihmë. Panë se si e morën kalecët plakun e mjerë që strehoi Amadito Garsia Gerreron, pasi e vranë këtë, dhe se si turmat rrëzonin dhe zhbënin shtëpinë e saj. Por ato skena dhe tregime nuk i frikësuan fare Cavalierët, as e ftohën ngrohtësinë me të cilën e trajtonin.

- Me kthimin e Ramfisit, Imberti dhe të zotët e shtëpisë kuptuan se fshehja e tij do të zgjaste. Përqafimet publike mes të birit të Truhihos dhe gjeneral Hose Rene Romanit, ishin kuptimplote: Ky kishte tradhtuar dhe nuk do të kishte kryengritje ushtarake. Nga universi i tij i vogël, televizori "Penthouse" i Cavalierëve, pa turmat në radhë, orë e orë të tëra, duke bërë homazhe Truhijos. Pa në atë ekran portretin e tij, pranë atij të Amiamës, të cilin ende nuk e njihte, nën lajmin që i ofronte njëqind mijë, pastaj dyqindmijë dhe, së fundi, gjysmë milionë peso, atij që do të kallëzonte vendndodhjen e tyre.
- Eh, me rënien e vlerës së pesos domenikane, nuk është ndonjë fitim kushedi, - tha me humor Cavalieri.
- Shumë shpejt jeta e tij u pajtua me një rutinë rigoroze. Kishte një dhomëz më vete, me një shtrat dhe një abazhur koke. Ngrihej shpejt dhe rreth një orë bënte fizkulturë: pompa, vrap në vend, ushtrime barku. Mëngjesin e hante me të zotët e shtëpisë. Me këmbënguljen e tij, e lejuan që t'i ndihmonte në pastrimin e shtëpisë. Fshirja, pastrimi i aspiratorit, marrja e pluhurave mbi objekte dhe mobilie, iu kthyen në stërvitje dhe detyrë, diçka që e bënte me qejf, me përqendrim të plotë

dhe me njëfarë gezimi. Veçse zonja Cavalieri kurrë nuk e la të fuste duart në kuzhinë. Ajo gatuante shumë mirë, sidomos makaronat, të cilat i shërbente dy herë në ditë. Tonit, makaronat i kishin pëlqyer qysh fëmijë. Mirëpo, pas atyre gjashtë muajve izolimi, kurrë nuk do të hante më pastiço, taliatele, ravioli dhe as ndonjë lloj tjetër makaronash, që ishte ushqimi kryesor italian.

- Pasi mbaronte detyrat shtëpiake, lexonte orë të tëra. Nuk kishte qenë ndonjë lexues i mirë, po ato gjashtë muaj zbuloi kënaqësinë e të lexuarit. Librat dhe revistat ishin mbrojtja më e mirë kundër shkurajimit që i shkaktonin izolimi, rutina dhe pasiguria.
- Vetëm kur televizori njoftoi se një komision i OEA-s kishte ardhur të takohej me të burgosurit politikë, mori vesh se Guarina kishte disa javë e burgosur, si dhe gratë e gjithë miqve të tij të përbetimeve. Të zotët e shtëpisë nuk i kishin thënë deri atëherë se Guarina ndodhej në burg. Vetëm nja dy javë më pas, të gëzuar, i dhanë lajmin e mirë se ajo tani ishte e lirë.
- Asnjëherë, as kur fshinte, pastronte apo i hiqte pluhurin aspiratorit, nuk e ndau nga vetja Colt 45 e tij, gjithmonë të mbushur. Vendimi i tij ishte i formës së prerë. Do të bënte atë mënyrë më e denjë për të vdekur. Ndryshe do t'i nënshtrohej poshtërimeve dhe torturave të shpikura nga mendjet e mbrapshta të Ramfisit dhe kompanisë së tij.
- Pasditeve dhe pasdarkave lexonte gazetat që sillnin të zotët e shtëpisë dhe shikonte me lajmet në televizion. Pa besuar shumë, ndoqi atë dualitet të paqartë me të cilin po gatuhej regjimi: Një qeveri civile e kryesuar nga Balageri, i cili bënte gjeste e deklarata, duke siguruar se vendi po demokratizohej, dhe një pushtet ushtarak e policor i drejtuar nga Ramfisi, që vazhdonte të vriste, të torturonte dhe të zhdukte njerëz me të njëjtat mënyra antiligjore si në kohën e Udhëheqësit. Sidoqoftë, nuk mund të ndjehej më shpresëhumbur, me kthimin e të arratisurve politikë, shfaqjen e publikimeve të para të opozitës - organet e Bashkimit Qytetar dhe të 14 Qershorit - dhe mitingjet studentore kundër qeverisë. Për këto mitingje informonin edhe mediat zyrtare, edhe pse i akuzonin si manifestime komuniste.

Fjala e Hoakin Balagerit në Kombet e Bashkuara, tek kritikohte diktaturën e Truhihos dhe angazhohej të demokratizonte vendin, e çuditi. A nuk ishte ky burrec që për tridhjetë e një vjet rresht, kishte qenë shërbëtori më besnik dhe më i palëkundshëm i Babait të Atdheut të Ri? Në bisedat e gjata pas darkës, kur Cavalieri i linte në furrën e sobës pastiçon e përditshme - ata ia plotësonin të dhënat me fjalët që zienin në këtë qytet të sapoqiatur me emrin e vjetër të tij Santo Domingo de Gusman. Edhe pse të gjithë trembëshshin prej një grushti shteti të vëllezërve Truhijo që donin të restauronin diktaturën e ashpër dhe të egër, dukej sheshit se, pak nga pak, njerëzit po e mposhtnin frikën, ose më mirë, po prishej magjia, falë së cilës sa e sa dominikanë ia kishin dorëzuar trupin dhe shpirtin Truhihos. Çdo ditë dilnin më shumë zëra, deklarata dhe veprime antitruhijiste dhe i jepej më shumë mbështetje Bashkimit Qytetar, 14 Qershorit apo PRD-së, drejtuesit e së cilës sapo qenë kthyer në atdhe dhe ishin vendosur në një godinë në qendër të qytetit.

- Dita më e trishtuar e odisesë së tij, ishte gjithashtu edhe më e lumtura. Më 18 nëntor, në të njëjtën kohë që u dha lajmi për ikjen e Ramfisit nga vendi, televizioni bëri të ditur se gjashtë vrasësit e Udhëheqësit (katër ekzekutorët dhe dy bashkëpunëtorë) kishin ikur, pasi kishin vrarë tre ushtarët, të cilët po i kthenin në burgun e Viktorias, pas një rekonstruksioni të krimit. Përballë ekranit të televizionit, s'e përmbajti dot veten dhe shpërtheu në ngashërime. Ishte e qartë se miqtë e tij - Turku, miku i tij i ngushtë - i kishin vrarë, bashkë me tre ushtarët e mjerë, si kinse alibi. Sigurisht, kurrë s'do të gjendeshin trupat e tyre. Zoti Cavalieri i zgjati një gotë me konjak:
- Ngushëllime, zoti Imbert. Mendoni se së shpejti do të shikoni gruan dhe vajzën tuaj. E keqja mbaroi.
- Pak më vonë, do të njoftohej ikja e vëllezërve Truhijo me familjet e tyre nga atdheu. Tani, po. I erdhi fundi fshehjes së tij. Të paktën deri tani i kishte shpëtuar gjuetisë, ku praktikisht, me përjashtim të Luis Amiamas - së shpejti do të mësonte se ai kishte kaluar gjashtë muaj i fshehur në një dollap rrobash orë të tëra të ditës - të gjithë të përbetuarit kryesorë, përveç qindra të tjerëve të pafajshëm, midis tyre edhe i vëllai, Segundoja, qenë torturuar, qenë vrarë apo vazhdonin nëpër burgje.

Një ditë pas ikjes së Truhijove nga vendi, u bë një amnisti politike. Filluan të hapeshin burgjet. Balageri krijoi një komision për të zbuluar të vërtetën më atë që ndodhi me "ekzekutorët e tiranit". Radiot, gazetat dhe televizionit, qysh nga ajo ditë, nuk i quanin më "vrasës", por "ekzekutorë", pastaj do t'i quanin heronj dhe shumë më vonë rrugët, sheshet e bulevardet e gjithë vendit, do të fillonin të quheshin me emrat e tyre.
Ditën e tretë doli nga streha. Të zotët e shtëpisë ia kursyen kohën e falënderimeve për nderin që i kishin bërë dhe i kërkuan vetëm një gjë: Askush të mos e dinte ku qe strehuar, ndryshe komrometohej pozita e një diplomati. Ishte mbrëmje kur u shfaq, i vetëm, në familjen e vet. U përqafua gjatë me Guarinën dhe Leslin, pa mundur të thoshnin dot gjë. Duke vërejtur njëri-tjetrin, vërejtën se Guarina dhe Lesli qenë dobësuar, kurse Toni kishte shtuar pesë kile. U shpjegoi se në shtëpinë ku qe strehuar – nuk mund t'ua thoshte se ku – hani shumë makarona. Nuk mund të flisnin shumë. Vatra e shpartalluar e Imbertëve filloi të mbushej me buqeta me lule nga të afërmit, miqtë dhe të panjohurit që vinin t'i përshëndesnin, t'i përqafonin e t'i uronin – shpesh duke u dridhur prej emocioneve, me sytë e mbushur me lot – t'i quanin heronj dhe t'u jepnin falënderime për ato që kishin bërë. Midis vizitorëve u duk edhe një përshëndetjeve të duhura, majori Teofronio Kaseda i tha se atë dhe don Luis Amiamën – i cili, gjithashtu, sapo kishte dalë streha e fshehtë, shtëpia e Ministrit të Shëndetësisë – Kryetari i Shtetit donte t'i priste në Pallatin Kombëtar të nesërmen në mesditë. Po ashtu, me një buzëqeshje bashkëkontribuesi, e informoi se senatori Henri Çirinos, sapo kishte paraqitur në Kongres ("i njëjti Kongres i Truhijos!") një ligj, sipas të cilit Antonio Imberti dhe Luis Amiama emëroheshin gjeneralë me tre yje të Ushtrisë Domenikane, për shërbime të jashtëzakonshme ndaj kombit.
Mëngjesin tjetër, i shoqëruar nga Guarina dhe Lesli – të tre me rrobat më të mira, Antonion të tijat e shtrëngonin – shkuan për takimin në Pallat. I priti një tufë fotografësh dhe një trupë ushtarake me uniformë parade, qëndroi për nder armë për ta. Në sallën e pritjes njohu Luis Amiamën, një burrë shumë elegant dhe solemn, fjalëpak, të cilin prej atij çasti do ta kishte

mik të pandashëm. Shtrënguan duart e shoshoqit, për t'u parë pas takimit me Presidentin, për të vizituar së bashku gratë (të vejat) e gjithë të përbetuarve të vdekur apo të zhdukur dhe për të treguar secili aventurën e vet. Në këto e sipër, u hap zyra e Kryetarit të Shtetit. I buzëqeshur dhe me shprehje të thellë gëzimi, doktor Hoakin Balageri, me krahë të hapur, eci drejt tyre nën blicet e fotografëve.

XXIV

Manuel Alfonsoja, shumë i përpiktë, erdhi të më merrte, - thotë Urania me vështrimin e përqendruar në askund. - Qyqe e orës së sallonit këndoi tetë herë, kur ai trokiti në portë. Hallë Adelina, të kushërirat Lusinda e Manolita dhe e mbesa Marianita, nuk po shohin me njëra-tjetrën, për të mos shtuar tensionin. Shikojnë vetëm Uraninë, kureshtare dhe me një lloj ankthi. Samsoni, i fjetur, e ka varrosur midis pendëve të gjelbra sqepin e vet kërrut.

– Babai u fut me nxitim në dhomën e vet, me pretekstin për të shkuar në banjë, - vazhdon Urania, tani e ftohtë, gati materiale. - "Bye-bye, bija ime, ia kalofsh mirë." Nuk guxoi të më shikonte në sy, kur më përshëndeti.
– Të kujtohen këto hollësi?! - hallë Adelina lëviz grushtin e saj të vogël e të rrudhosur, tashmë pa energji dhe pa autoritet.
– Kam harruar plot gjëra, - përgjigjet Urania me gjallëri. - Por, nga ajo natë, më kujtohet gjithçka. Vërtet.
I kujtohet për shembull që Manuel Alfonsoja ishte veshur sportiv. Në një festë të Gjeneralizimit me veshje sportive? Me një këmishë të kaltër dhe xhaketë të lehtë ngjyrë kremi, këpucë këkure mokasini dhe një shall të vogël mëndafshi për të mbuluar shenjat e operacionit. Me zërin e tij të zorshëm i tha se, veshja e saj prej cohe të hollë të trëndafiltë, ishte shumë e bukur dhe se këpucët me taka të holla, e bënin të dukej më e rritur. E puthi në faqe, duke i thënë: "Ikim, se na u bë vonë, bukuroshe". I hapi derën e autoveturës, e la të hipte, u ul pranë saj dhe shoferi, me uniformë e i parfumuar - i kujtohet edhe emri i tij: Luis Rodriges - u nis.
– Në vend që të zbrisnim në bulevardin Xhorxh Uashington, autovetura bëri disa kthesa pa kuptim. U ngjit tek Indipendenca dhe bëri drejt qytetit kolonial, duke ecur më ngadalë. Gjoja ishte vonë. Kishte kohë për të shkuar në San Kristobal.
Kureshtare, Manolita we duart para trupit të saj të mbushur.

– Por kur t’u duk e habitshme, nuk i the gjë Manuel Alfonsos? Asgjë fare?
Në fillim, jo. Asgjë fare. Ishte, vërtet, shumë e çuditshme që po bridhnim kot nëpër qytetin kolonial dhe që Manuel Alfonsoja po shkonte në festë të Gjeneralizimit me një veshje të tillë, si të shkonte në Hipodrom apo në "Country Club", megjithatë Urania nuk e pyeti fare ambasadorin. Filloi të dyshonte se Agustin Kabrali dhe ai i kishin treguar përralla? Qëndronte e heshtur, duke dëgjuar përgjysmë zërin e prishur e mizor të Manuel Alfonsos, i cili tregonte për ca festa të dikurshme të kurorëzimit të Mbretëreshës Isabela II, në Londër, ku ai dhe Angjelita Truhijo (“Atëherë një vogëlushe aq e bukur, si ti tani”), përfaqësonin Bamirësin e Atdheut. Po më shumë që përqendruar te shtëpitë e qëmotshme, të hapura kanatë, duke treguar gjithë intimitetin e vet; te familjet që kishin dalë në rrugë - pleq, plaka, të rinj, fëmijë, qen, mace deri edhe papagaj e kanarina - për të gëzuar freskun e natës, pas një dite përvëluese, duke fjalosur që nga lëkundëset, karriget e stolat e tyre, apo të ulur në pragjet e dyerve ose buzë trotuarëve të lartë. Rrugët e vjetra kryeqytetase qenë bërë kështu si vende mbledhjesh, shoqatash e festash të pambarimta popullore. Aty kishte grupe me dy apo katër vetë - gjithmonë burra, përherë të moshuar - lojtarë dominosh që qëndronin tepër indiferentë, të mbërthyer në tavolinat e tyre të ndriçuara nga llambushka a fenerë. Ishte një pamje si e atyre e mejhaneve plot gjallëri, me banakë dhe rafte druri me bojë të bardhë, dingas me kuti, shishe me carta Dorade e Jacas, pije Bermudez, arka ngjyra-ngjyra, ku gjithmonë kishte blerës me shumicë. Urania do ta ruante të gjallë në kujtesën e saj një pamje të tillë që në Santo Domingo e sotëm, ndoshta, është zhdukur fare, ose mund të ekzistojë në ca lagje të vjetra, ku shekuj të shkuar, një grup aventurierësh të ardhur nga Evropa themeluan qytetin e parë kristian të botës së re, me emrin tingëllues Santo Domingo de Gusman. Ishte nata e fundit që po e shihte atë spektakël, Urani.
– Kishim hyrë në rrugën për San Kristobal dhe kur makina po kalonte te vendi ku dy javë më pas vranë Truhijon, Manuel Alfonsoja filloi... - një shqetësim i beftë i mbyt zërin dhe Urania e ndërpret rrëfimin.
– Ç’doje të thoje? - pyet Lusinda me hezitim. - Filloi... Çfarë?

– Të më përgatiste, - e mori veten Urania. - Të më zbuste, të më frikësonte dhe të më kënaqte. Si nuset e zgjedhura për Molokun, të cilat i përkëdhelnin dhe i vishnin si princesha para se t'i hidhnin në flakadanin e gojës së monstrës.
– Pra, nuk e ke njohur Truhijon, kurrë nuk ke folur me të, - thërret tërë kënaqësi Manuel Alfonsoja. - Kjo do të jetë përvoja e madhe e jetës tënde, moj vajzë.
Ashtu do të ishte. Autovetura ecte drejt San Kristobalit, nën një qiell të yjëzuar, midis palmave pranë bregut të detit të Karaibeve, i cili rrihte shkëmbinjtë, duke rënkuar.
– E, çfarë thoshte më? - e nxit Manolita, se Urania po hesht.
I tregonte se ç'kavalier i mrekullueshëm ishte Gjeneralisimi në sjelljen e tij me damat. Ai vërtet ishte i ashpër në çështje ushtarake dhe qeverisëse, po e kishte moton e vet proverbbin: "Femrën mos e godit as me patale trëndafili". Ashtu i trajtonte përherë vajzat e bukura.
– Ç'fat që ke, moj vashë, - përpiqej t'i përcillte entuziazmin e tij, eksitimin e tij emocional, që ia bënte edhe më të padurueshëm të folurën. - Truhijo të fton personalisht në vilën e vet, në Shtëpinë me Mogan. Ç'privilegj! Numërohen me gishtat e dorës ato që meritojnë diçka të tillë. Besomë mua, moj çupkë.
Dhe atëherë Urania i bëri pyetjen e parë dhe të fundit të asaj nate:
– Kush është ftuar tjetër në atë festë? - Dhe Urania shikon nga halla, Lusinda e Manolita: - Isha kureshtare se si do të përgjigjej, se tashmë e kisha kuptuar se nuk po shkonim në festë.
Fytyra e hijshme mashkullore u kthye drejt saj dhe Urania dalloi vagëllimthi një përshkënditje në sytë e ambasadorit.
– Askush tjetër. Është një festë për ty. Vetëm për ty! E përfytyron dot? E merr vesh? A nuk të thashë se është diçka e pashembullt? Truhijo të ofron një festë. Kjo është si të të bjerë një llotari, Uranita.
– Po ti? Po ti? - thërret me atë zërin e hollë, e mbesa, Marianita. - Çfarë mendove, teze?
– Mendova shoferin e autoveturës, Luis Rodriges. Asgjë tjetër. Vetëm te shoferi e kisha mendjen.
Sa turp ndieja nga ai shofer me kapele, dëshmitar i asaj bisede mashtruese të ambasadorit. Shoferi kishte ndezur radion e makinës, ku u dhanë dy këngë italiane të modës - "Volare" dhe "Ciao, ciao, bambina" - por ishte e sigurt se atij nuk i

shpëtonte asnjë fjalë nga marifetet me të cilat Manuel Alfonsoja përpiqej ta kandiste, që të ndihej e lumtur dhe fatlume. Një festë e Truhijos vetëm për atë!

– Çfarë mendove për babanë tënd? - nuk iu durua Manolitës. - Se dajo Agustini të dërgonte, që ai...?

Dhe Manolita hesht, pa ditur si të vazhdojë. Hallë Adelina i bën një shenjë qortimi me sy. Plaka prishet në fytyrë, duke shprehur një ligështim të thellë.

– Ishte Manuel Alfonsoja ai që mendonte për babanë tim, - thotë Urania. - A isha unë një bijë e mirë? A doja unë ta ndihmoja senatorin Agustin Kabral?

E bënte me atë mprehtësinë e fituar gjatë viteve të veta në detyrën diplomatike të misioneve të vështira. Veç kësaj, nuk ishte ky një rast i mirë që Urania të ndihmonte mikun e tij, inteligjentin, për të dalë nga gracka që i kishin ngritur ziliqarët e përhershëm? Gjeneralisimi mund të ishte një njeri i rreptë, i pamëshirshëm për sa i përket interesave të vendit. Por në thellësi, ishte një romantik. Ashpërsia e tij zbehej përpara një vajze joshëse, si një copë akulli e lënë në diell. Nëse donte që Gjeneralisimi t'i jepte dorën Agustinit, t'i kthente pozitën, pushtetin, detyrat e tij, ajo, me zgjuarsinë që kishte, mund t'ia arrinte. Mjafton t'ia fitonte zemrën Truhijos, një zemër që nuk dinte t'i kthente mbrapsht lutjet e bukurisë.

– Më dha gjithashtu dhe ca këshilla, - thotë Urania. - Çfarë gjëra nuk duhej të bëja, sepse e mërzisnin Udhëheqësin. Atij i pëlqente që vajzat të ishin të dashura, po jo ta tepronin me admirimin e tyre, me dashurinë e tyre. Unë pyesja veten: "Deri këtu arrin?! Të më thotë gjëra të tilla?!"

Kishin hyrë në San Kristobal, qytet i famshëm, sepse aty kishte lindur Udhëheqësi, në një shtëpizë të thjeshtë pranë kishës, të cilën e ndërtoi ai vetë. Senatori Kabral e kishte çuar Uraninë për ta vizituar atë kishë, dhe i kishte shpjeguar afresket biblike, të pikturuar në muret e saj nga Vela Zaneti, një artist spanjoll i arratisur, të cilit Udhëheqësi shpirtmadh i kishte hapur dyert e Republikës Domenikane. Në atë shëtitje, në San Kristobal, senatori Kabral i kishte treguar gjithashtu fabrikën e shisheve dhe atë të armëve, e kishte bredhur në tërë luginën e ujitur nga lumi Nigua. Dhe tani, babai i saj e dërgonte në San Kristobal t'i lutej Udhëheqësit që ta falte, t'i zhbllokonte llogaritë dhe ta rivendoste në Presidencën e Senatit.

- Prej Shtëpisë me Mogan shihet një pamje e mrekullueshme mbi luginë. Duket lumi Nigua, kuajt dhe kopetë e fermës Fundasion, - hyri në hollësira Manuel Alfonsoja. Autovetura, pasi kaloi postbllokun e parë, po ngjitej në një bregore, në majën e së cilës qe ndërtuar me dru të çmuar mogani (dru që kishte filluar të shfarosej në ishull) shtëpia ku Gjeneralisimi mbyllej dy ditë në javë, për të gëzuar në takime sekrete, për të bërë punë të pista apo tregti të guximshme, në fshehtësi të plotë.
- Nga Shtëpia me Mogan do të mbaj mend, për shumë kohë, vetëm qilimin. Mbulonte tërë sheshin e ambjentit dhe kishte të qëndisur një emblemë kombëtare gjigante, me tri ngjyrat e saj. Në dhomën e gjumit një vitrinë kristali ishte e mbushur me uniforma të të gjithë stileve e mbi to një varg kapelesh civile e ushtarake. Edhe një kapele dycepëshe napoleoniane.
  Nuk qesh. Duket serioze, me diçka prej humbëtire në sy dhe në zë. Edhe hallë Adelina, Lusinda e Marianita, e cila sa qe kthyer nga banja, - vazhdon Urania, tani e ftohtë, - ishte ulur në dhomën e gjumit një vitrinë kristali ishte e mbushur me uniforma të të gjithë stileve e mbi to një varg kapelesh civile e ushtarake. Edhe një kapele dycepëshe napoleoniane.
  Nuk qesh. Duket serioze, me diçka prej humbëtire në sy dhe në zë. Edhe hallë Adelina, Lusinda e Marianita, e cila sa qe kthyer nga banja, ku kishte shkuar për të vjellë (kishte pasur të përziera), nuk qeshën. Papagalli vazhdonte të flinte. Qetësia kishte pllakosur mbi tërë qytetin Santo Domingo: asnjë bori, asnjë motorr, asnjë radio, asnjë e qeshur prej të tjerëve, do të lehtura qensh.
- Quhem Benita Sepulveda, urdhëroni, ju lutem, - i tha zonja që e priti në fond të shkallëve të drunjta. E moshuar, shpërfillëse e, megjithatë, me diçka prej nëne në gjestet dhe sjelljen e saj, mbante uniformë dhe një shami në kokë. - Ejani këtej.
- Ishte kujdestarja, - thotë Urania. - Ishte ngarkuar të vendoste çdo ditë lule në të gjitha dhomat. Me padurim, ajo po fliste me oficerin e hyrjes. Dhe nuk e pashë më kurrë. Benita Sepulveda, me një dorë të vogël topolake, duke i shenjuar errësirën tej dritareve të mbrojtura me rrjeta metalike, i shpjegoi se ajo që nxinte tuteje ishte një tufë lisash, se në kopsht kishte shumë mango e kedra, por më të bukurat qenë bajamet e moganët që rrethonin shtëpinë, degët me aromë të të cilave do t'i shihje gjithandej. Ndjehet aroma? A ndjehet? Po, qysh të nesërmen në mëngjes herët, sa të dilte dielli, do të kishte rast të kundronte peizazhin: lumi, lugina, centrali, stallat e fermës Fundasion. Do të hante mëngjes domenikan, me banane të shtypura, vezë të fërguara, sallam ose pastërma e lëng frutash? Apo do të pinte vetëm kafe, si Gjeneralisimi?

- Nga Benita Sepulveda mora vesh se do ta kaloja natën atje, se do të flija me Shkëlqesinë e Tij. Ç'guxim i madh!
  Kujdestarja, me vetëbesimin e madh që i jepte një praktikë e gjatë, e ndali në kryeshkallën e parë dhe e futi në një mjedis gjysmë të ndriçuar. Ishte një bar. Kishte ndenjëse prej druri kudo përreth, me mbështetëset ngjitur për muri, duke lënë një hapësirë vallëzimi në qendër. Një monedhë bakri, shumë e madhe dhe një banak me rafte plot me shishe, gota dhe kupa kristali. Por Uranisë i mbetën sytë te qilimi i madh gri, me emblemën domenikane, i shtruar cep më cep në atë hapësirë të gjerë. Pak vëmendje u kushtoi portreteve dhe kuadrove të Gjeneralisimit - në këmbë dhe në kalë, ushtarak dhe civil, i ulur në një tryezë pune apo i ngrehosur në një tribunë, mbërthyer me shiritin presidencial - që vareshin në mure, po ashtu medaljeve prej argjendi dhe diplomave të fituara për lopët qumështore dhe për kuajt e racës së fermës Fundasion, të përziera këto me taketuke plastike dhe stoli të lira me vulën e dyqaneve njujorkeze "Macy's", që zbukuronin tavolinat, vitrinat dhe sergjenet e atij monumenti kitsch, ku Benita Sepulveda e la vetëm, pasi u sigurua se vërtet nuk donte një gotë liker.
- Fjala kitsch nuk ekziston më, besoj, - sikur halla apo kushërirat të kishin bërë ndonjë vërejtje. - Vite më pas, kur dëgjova apo lexova dhe e kuptova se ç'shprehte kjo fjalë e keqe shprehëse, m'u kujtua Shtëpia me Mogan. Vërtet, një monument kitsch.
  Edhe ajo ishte pjesë e këtij kitschi, veç gjërave të tjera, atë natë të nxehtë maji, me veshjen e saj prej cohe të hollë të trëndafiltë për festa dhe djalë në shoqëri, gjerdanin prej argjendi me një smerald të vogël dhe vathët e larë në flori, të cilat kishin qenë të mamasë dhe që, posaçërisht, babai e lejoi t'i vinte për festën e Truhijos. Nuk donte të besonte çka po ndodhte. I dukej se nuk ishte ajo vetë, ajo vashëz e ndalur mbi një ushtë të emblemës së atdheut, në atë ambjent ekstravagant. A thua senatori Agustin Kabral po ia dërgonte burran të gjallë Bamirësit dhe Babait të Atdheut të Ri? Po. Nuk kishte kurrfarë dyshimi: babai i saj e kishte përgatitur këtë gjë së bashku me Manuel Alfonson. E, megjithatë, prapë nuk donte ta besonte.
- Diku jashtë barit, vunë një disk të Luço Gatikës. "Besame, besame mucho, como si fuera esta noche la ultima vez."
- Më kujtohet, - Manolita, e turpëruar për ndërhyrjen, shfaqësohet

me një shtrembërim fytyre. - Atëherë tërë ditën në radio dhe në festa jepej "Besame mucho".

Në këmbë, pranë dritares, prej nga vinte një fllad i ngrohtë dhe një aromë e fortë fushe, bari dhe pemësh, dëgjoi zëra. Zëri i çjerrë i Manuel Alfonsos. Tjetri, i ashpër, me ulëngritje, mund të ishte i Truhijos. Ndjeu gudulisje në qafë dhe në kyçet e duarve, ku mjeku i maste pulsin, një cëmbisje bezdisëse, që i vinte gjithnjë në orët e provimeve, po edhe më vonë në Nju Jork, para vendimeve të rëndësishme.

- Mendova t'i hidhesha nga dritarja. Mendova t'i bija në gjunjë, t'i lutesha, të qaja. Mendova se duhej ta lija të bënte atë që donte, duke shtrënguar dhëmbët, që të mund të jetoja dhe një ditë të hakmerresha ndaj babait. Mendova një mijë gjëra, ndërsa ata bisedonin, atje poshtë.

  Në karrigen e vet lëkundëse, hallë Adelina, bën një të hedhur nga vendi dhe hap gojën. Por, nuk thotë asgjë. Është e bardhë si letër, me sytë e thellë, të ënjtur nga lotët. Zërat u prenë. Pati një qetësi të përkohshme. Pastaj hapa që ngjisin shkallët. Mos i ndali zemra? Në dritën e mekur të barit, u duk silueta e Truhijos, me uniformën ngjyrë ulliri të blertë, pa xhaketë ushtarake, pa gravatë. Në dorë mbante një gotë me konjak. Ecte drejt saj, duke buzëqeshur.
- Mirëmbrëma, bukuroshe, - mërmëriti, duke u përkulur. I zgjati dorën e lirë, dhe kur Urania, me një lëvizje automatike, i dha të sajën, Truhijo, në vend që t'ia shtrëngonte, e çoi te buzët dhe ia puthi. - Mirë se erdhe në Shtëpinë me Mogan, bukuroshe!
- Kisha dëgjuar për sytë dhe vështrimin e Truhijos. Nga im atë dhe miqtë e tij. Por atëherë e mësova se ç'ishte në të vërtetë ai vështrim. Një vështrim që të shponte, që depërtonte thellë. Edhe pse buzëqeshte me shumë elegancë, ai vështrim më zbrazi, më la vetëm lëkurën. Nuk isha më unë.
- Nuk të ofroi asgjë Benita? - Pa ia lëshuar dorën, Truhijo e shpuri drejt pjesës më të ndriçuar të barit. I ofroi vend në një sofa për dy vetë. E hulumtoi, duke i kaluar vështrimin ngadalë nga lart poshtë, nga koka te këmbët, duke e ngjitur e zbritur atë shikim, pa shtirje, siç bënte kur ekzaminonte lopët dhe pelat e blera për fermën Fundasion. Në sytë e ngulur, të fiksuar, hetues, nuk vuri re lakmi, as epsh, veç një kontroll mbi trupin e saj.

– Pati një zhgënjim. Tani, e kam të qartë pse. Atë natë, nuk e dija. Unë isha trupderdhur, tepër hollake, ndërsa atij i pëlqenin të mbushurat, me gjoks e vithe të bëshme. Gra të bëshme. Një shije tipike tropikale. Mbase mendoi ta niste përsëri në Qytetin Truhijo atë skelet timin. E dini pse nuk e bëri? Sepse ideja për të prishur virgjërinë e një vajze, i eksiton burrat.
Hallë Adelina lëshoi një ofshamë. Me grushtin e vogël e të rrudhosur, të ngritur pak, me gojën gjysmë të hapur, me shprehje frike e qortimi, duke u shtrembëruar në fytyrë, deshi t'i përgjërohej për diçka. Por nuk arrin të shqiptojë ndonjë fjalë.
– Më fal për çiltërsinë, hallë. Këtë gjë e tha ai vetë, më vonë. Të betohem. Tha tekstulisht: "Të çajnë pidhin e një vajze të virgjër, kjo gjithmonë i eksiton burrat. Petani, shtaza Petan, eksitohet edhe më shumë kur i zhvirgjeron me gishtrinj."
Këtë do t'ia thoshte më vonë, kur nga pazotësia për të arritur atë që donte, goja i villte gjëra pa kuptim, gulçime, fjalë të palara, mbeturina afshi, me të cilat shfrente inat e hidhërim. Por deri atëherë sillej me korrektësinë e vet të studiuar. Nuk i ofroi çfarë pinte vetë. Një vajzë të re, "Karlos I" ia përvëlonte shkotat. Do t'i jepte një gotë verë herë të ëmbël. I shërbeu vetë, pastaj uroi, duke i çokur gotën. Edhe pse sa ia lagu buzët, Urania ndjeu diçka të zjarrtë në fyt. Të mundohej të buzëqeshte? Apo të qëndronte serioze, duke treguar panikun e saj?
– Nuk e di, - thotë, duke mbledhur supet. - Ndodhesha atje, në atë sofa, bashkë me atë. Më dridhej gota me herë në dorë.
– Unë nuk ha çupkat, - buzëqeshi Truhijo, duke ia marrë gotën asaj dhe duke e vendosur në një tavolinë. - Gjithmonë je kështu, e heshtur, apo vetëm tani, bukuroshe?
– Më thoshte "bukuroshe", njësoj si Manuel Alfonsoja. Nuk më fliste Urani, as Uranitka apo vashëz. Isha njëlloj lodërze për të dy.
– Të pëlqen të vallëzosh? Sigurisht, se të gjitha vajzave të moshës tënde, - tha Truhijo. - Mua më pëlqen shumë. Jam një valltar shumë i mirë, edhe pse kam kohë që nuk vallëzoj. Eja të vallëzojmë.
U ngrit në këmbë. Urania bëri si ai. Ndjeu trupin e tij të fortë, barkun e tij ta çë zmadhuar duke i prekur stomakun, ndjeu erën e konjakut dhe dorën e ngrohtë që i përfshiu mesin. Mendoi se do t'i binte të fikët. Luço Gatika, tashmë, nuk këndonte më "Besame mucho", por "Alma mia".

- Vallëzonte shumë mirë. Kishte vesh muzikë dhe lëvizte si djalë i ri. Isha unë ajo që ngatërroja hapin. Vallëzuam dy bolero dhe një guaraca të Tonja la Negras. Po ashtu merenga. Tha se merenga kërcehej në klube dhe në shtëpitë e sërës së lartë, falë atij. Se më përpara kishte paragjykime: Të pasurit thonin se ishte muzikë zezakësh e indigjenësh. S'di se kush i ndërronte disqet. Kur mbaroi merenga e fundit, më puthi në qafë. Një puthje e butë, por që më rrëqethi.
  Duke e mbajtur për dore, me gishtat të kryëzuar, e ktheu te sofaja dhe u ul pranë saj. E vërente gazmor, ndërsa pinte konjak, duke marrë frymë shpesh nga lodhja. Dukej i qetë dhe i kënaqur.
- Gjithmonë kështu je, si një sfinks? Jo, jo. Ndoshta ngaqë ke shumë respekt, - buzëqeshi Truhijo. - Më pëlqejnë të bukurat e matura, të cilat nuk admirojnë. Perëndeshat shpërfillëse. Do të të recitoj një varg të shkruar enkas për ty.
- Më recitoi vargje nga një poemë e Pablo Nerudës. Pranë veshit, duke më prekur veshin e flokët me buzët dhe mustaqet e tij:

  Më pëlqen kur hesht,
  dukesh e largët si një yll.
  Vallë, ç'je duke menduar?
  Një puthje gojën ta mbyll.

  Kur mbaroi fjalën e fundit, dora e tij ma ktheu kokën dhe më puthi në buzë. Atë natë bëra shumë gjëra për herë të parë: Vura stolitë e mamasë, piva herë, vallëzova me një shtatëdhjetëvjeçar, mora puthjen e parë në buzë...
  Kishte qenë në festa me meshkuj dhe kishte vallëzuar. Po vetëm njëherë e kishte puthur një djalë në faqe, në një ditëlindje, në shtëpinë e madhe të familjes Visini, ku kryqëzohet Maksimo Gomes me bulevardin Xhorxh Uashington. Quhej Kasimiro Saens dhe ishte djali i një diplomati. E kishte marrë në vallëzim dhe në fund kishte ndeshur buzët e tij në faqe. Qe skuqur deri te flokët dhe në rrëfimin e së premtes, përpara kapelanit të kolegjit, sa përmendi atë mëkat, turpi ia këputi zërin. Por ajo puthje nuk i ngjante aspak kësaj. Mustaqet e vogla të Shkëlqesisë së Tij i kruanin hundën, gjuha e tij, një gjë me majuckë viskoze dhe e ngrohtë, përpiqej t'i hapte buzët

e dhëmbët. Një nepërkë e lagët, e zjarrtë, hyri me tërbim brenda gojës së saj, duke lëvizur makutërisht. Pastaj ndjeu që u ndal.

– Nuk di të puthësh, bukuroshe, - i buzëqeshi Truhijo, përzemërsisht i habitur, duke i puthur përsëri, dorën. - Vërtet, je virgjëreshë?
– Ishte i eksituar, - thotë Urania, duke parë në zbrazëtirë. - Duket se pati një ereksion. Manolita lëshon një të qeshur të shkurtër, por as e ëma, as të tjerat, nuk e pasojnë dhe ajo ul sytë e turpëruar.
– Më falni që flas për ereksion, - thotë Urania. - Por kur mashkulli eksitohet, seksi i tij forcohet e zmadhohet. Ashtu ndodhi me Shkëlqesinë e Tij, kur më futi gjuhën në gojë.
– Shkojmë lart, bukuroshe, - tha, me një zë lehtësisht të ngrohtë. - Atje, do të jemi më të lirshëm. Do të zbulosh diçka të mrekullueshme. Dashurinë. Kënaqësinë e vërtetë. Do të kënaqesh. Unë do të të mësoj. Mos ki frikë. Nuk jam shtazë si Petani. Unë nuk di t'i trajtoj vajzat me ashpërsi. Mua më pëlqen që edhe ato të kënaqen. Do të të bëj të lumtur, bukuroshe.
– Ai ishte shtatëdhjetëvjeç, ndërsa unë katërmbëdhjetë, - saktëson Urania, për të pestën apo të dhjetën herë. - Ishim tejet të pabarabartë, e prapë ishim një çift që po ngjiste ato shkallë me parmak metalik, të veshur me dru. Dorë për dore, si të fejuar. Gjyshi dhe mbesa drejt shtratit të nusërisë.
Abazhuri mbi komodinë ishte i ndezur dhe Urania pa shtratin katror prej hekuri të gdhendur, me kunupieren e ngritur, dhe ndjeu krahët e ventilatorit duke xhiruar ngadalë në tavan. Një jorgan i bardhë, i qëndisur, mbulonte shtratin dhe një sërë jastëkësh, të vegjël e të mëdhenj, mbushnin kreun e tij. Ndjehej fort era e luleve të freskëta.
– Mos u zhvish, bukuroshe, - tha me zë të ulët Truhijo. - Do të të ndihmoj unë. Prit, tani kthehem.
– Të kujtohet, Manolita, se me ç'nerva flisnim për humbjen e virgjërisë? - kthehet nga e kushërira Urania. - Kurrë nuk më kishte shkuar në mendje se do ta humbisja atë në Shtëpinë me Mogan, me Gjeneralisimin. Ato çaste mendova: "Po të hidhem nga ballkoni, tani do ta trasë ndërgjegjja tmerrësisht".
U kthye pas pak, i zhveshur, i mbështjellë me një rrobëdëshambër mëndafshi të kaltër me pika të bardha dhe me shapka sateni ngjyrë shege. Ktheu një gllënjkë konjak, e

la gotën mbi një bufe, midis fotografive, ku kishte dalë ai i rrethuar nga nipërit e vet. I u afrua Uranisë dhe, duke e mbërthyer për mesi, e uli në anë të shtratit. Ndodheshin në pjesën e hapur të tylit të kunupieres, anët e së cilës ngjanin me dy krahë gjigantë fluture të lidhur, mbi kokat e tyre. Filloi ta zhvishte, ngadalë. I zbërtheu fustanin nga shpina, pullë më pullë, pastaj i hoqi rripin e fustanit. Para se t'ia hiqte fustanin, u ul në gjunjë dhe, duke u përkulur me pak vështirësi, i hoqi këpucët. Me kujdes, sikur veshja të thërrmohej nga ndonjë lëvizje e ashpër e gishtave të tij, i hoqi çorapet nailon, duke i përkëdhelur, në të njëjtën kohë, këmbët.

– I ke këmbët të ftohta, bukuroshe, - mërmëriti me dashuri. - Ke ftohtë? Afrohu, më ler të t'i ngroh.
Gjithmonë në gjunjë, ia fërkonte këmbët me të dyja duart. Herë pas here, i afronte te goja dhe ia puthte, duke filluar nga qafa e këmbës deri te gishtat e te thembrat. Me një të qeshur dinake, si të ishte ai që ndiente një gacmim të gëzueshëm, e pyeste nëse kishte gudulisje.
– Qëndroi ashtu një kohë të gjatë, duke më ngrohur këmbët. Po nëse doni ta dini, për asnjë sekondë, nuk ndjeva turbullimin më të vogël.
– Kushëri ç'frikë duhet kesh pasur, moj kushërirë, - tha me kureshtje Lusinda.
– Në ato çaste, akoma jo. Më pas, po, u tmerrova fare. Mundimshëm, Shkëlqesia e tij u ngrit dhe u ul përsëri në anë të krevatit. I hoqi fustanin, gjimbajtëset rozë që i shtrëngonin gjokset e vegjël gjysmë të dalë dhe të mbathurat në formë trekëndëshi. Ajo, si një kufomë, e linte t'i bënte këto veprime, pa asnjë lloj rezistence. Kur po i hiqte mbathjet, rreshqanthi nëpër këmbët e saj, ndjeu se gishtat e Shkëlqesisë së Tij dridheshin dhe të djersitur ia digjnin lëkurën aty ku preknin. E shtriu. U ngrit, hoqi rrobëdëshambrin dhe ra në krah të saj, lakuriq. Me kujdes, futi gishtat nëpër qimet e rralla të pubis të vajzës.
– Vazhdonte të ishte tepër i eksituar, kur filloi të më prekte e të më përkëdhelte. Më puthte, duke ma hapur me zor gojën me gojën e vet. Më puthte gjinjtë, qafën, supet, këmbët. S'rezistoi fare. E linte ta prekte, ta përkëdhelte, ta puthte, dhe trupi i saj u bind lëvizjeve e pozicioneve që duart e Shkëlqesisë së Tij kërkonin. As që u përgjigjej përkëdheljeve

të tij dhe sytë i mbante herë mbyllur e herë te krahët e ventilatorit. Atëherë dëgjoi Gjeneralisimin të fliste me vete: "Të çajnë pidhin e një vashe të virgjër, kjo gjithmonë i eksiton burrat".

– E para fjalë e ndyrë, i pari vulgaritet i asaj nate, - saktëson Urania. - Pastaj do të fliste edhe më keq. Atëherë, mora vesh se diçka nuk po shkonte për të. Kishte filluar të tërbohej. Po, pse? Pse unë rrija e qetë, e vdekur, pse nuk e puthja?
Jo nuk ishte ai shkaku, tani e kuptonte. Që ajo të merrte pjesë apo jo në zhvirgërimin e saj, nuk kishte rëndësi për Shkëlqesinë e Tij. Për ta ndier kënaqësinë të plotë, i mjaftonte që ajo ta kishte të mbyllur dhe ai t'ia hapte me seksin e tij të fortë e i lumtur që do të llokoçitej atje brenda, i shtrënguar në flegrat e atij intimiteti të sapogjetur, duke e bërë që ajo të rënkonte, të bërtiste, të ulërinte nga dhimbja. Nuk ishte dashuri, as kënaqësi, ajo që priste nga Urania. Kishte pranuar që bija e senatorit Agustin Kabral të vinte në Shtëpinë me Mogan, vetëm për të provuar që Rafael Leonidas Truhijo Molina, edhe pse shtatëdhjetë vjeç, edhe pse me probleme prostati, edhe pse me dhimbjet e kokës që ia shkaktonin priftërinjtë, jankit, venezuelesit, konspiratorët, ishte ende një hamshor, një cjap me një pallosh të aftë t'i ngrinte ej t'i shponte pidhin e virgjër që kishte përpara.
– Megjithë mungesën e përvojës, e mora vesh, - halla, kushërirat dhe mbesa afruan edhe më shumë kokat për të dëgjuar dëshminë e saj. - Diçka po ndodhte, atje poshtë, dua të them, te qendra ime. Ai nuk po bënte dot gjë. Dhe pikërisht për këtë, do të bëhej i egër, do t'i harronte sjelljet e tij mira.
– Mua do të më hiqesh si e pandjeshme, moj bukuroshe?! Hajde, lëri dënglat! - e dëgjoi të urdhëronte i shpërfytyruar. - Në gjunjë! Në mes të këmbëve të mia! Ashtu! Kapma me duart e tua e fute në gojë. Dhe thithe, si ta thithje unë pidhin. Derisa të ngrihet. E zeza ti, nëse s'më ngrihet. Dëgjon, bukuroshe?
– Provova e provova. Megjithë tmerrin, krupën. I bëra të gjitha. U ula galiç dhe e futa në gojë, e putha, e lëpiva, e thitha, derisa më erdhi për të vjellë. Po prapë, i butë. I butë. I lutesha Zotit të më thoshte: "Mjaft!".
– Mjaft, Urani, mjaft! - thotë hallë Adelina, pa lot. E shikon e trembur, pa keqardhje. I kishte të dala kockat e vetullave dhe kapakët e syve si të bymyer. Është e hutuaj dhe përpëlitet. - Po, ç'tregon, moj bijë? Për Zotin, mjaft!

– Dhe e lashë, nuk munda më, - këmbëngul Urania. - Ai, i shtrirë, vuri krahun mbi sy, pa thënë asgjë. E pashë që më kishte marrë inat.
Sytë i kishte të skuqur dhe në bebëza i shkëlqente një dritë e verdhë, e ethshme nga zemërimi me turpi. Tani e shikonte vajzën pa kurrfarë respekti, me një armiqësi lufte, sikur ajo t'i kishte shkaktuar një dëm të pariparueshëm.
– Gabohesh nëse beson se mund të dalësh këtej e virgjër, për t'u tallur me mua, pastaj bashkë me tët atë, - i shqiptonte një nga një fjalët, me një inat të verbër, duke u krekosur si gjel.
Pastaj e mbërtheu për krahu dhe e rrëzoi pranë vetes. Duke lëvizur këmbët dhe mesin, i hypi përsipër. Ajo e ndjeu madhe mishi, e shtypte dhe e fundoste më dyshek. Era e konjakut dhe tërbimi i tij, e trullosën vajzën. Ndiente sikur po i këputeshin e i dërrmoheshin muskujt dhe kockat. As mungesa e frymëmarrjes, nuk e ndaloi të ndiente ashpërsinë e asaj dore, të atyre gishtave që eksploronin, gërmonin dhe hynin brenda saj dhunshëm. Ndjeu se po e çanin dhe po e thernin. Një si vetëtimë e përshkoi nga truri te këmbët. Mendoi se po vdiste dhe ia dha një klithme.
– Bërtit sa të duash moj buçe e vogël. Tani do të ta tregoj unë ty! - volli zëri i plagosur dhe i fyer i Shkëlqesisë së Tij. - Hajde, hapi këmbët! Pa të shoh nëse je e çarë vërtet e nuk bërtite për të ma hedhur.
– Ishte e vërtetë. Kofshët i kisha tërë gjak. Edhe ai ishte bërë me njolla gjaku. Edhe dysheku e krevati.
– Mjaft, mjaft! Ç'tregon akoma, moj bijë, - i bërtet halla. - Eja këtu, të bëjmë kryqin, të lutemi. Pash Zotin, bija ime! A beson te Zoti? Te Zonja Jonë e Altagrasias, pajtorja e domenikanëve? Jot ëmë ishte aq e devotshme për të, Uranita. Më kujtohet si përgatitej çdo 21 janar për pelegrinazhin te Bazilika e Higeit. Je mbushur inat e urrejtje. Nuk është mirë ashtu. Tashmë ka ikur ajo që ka ndodhur. Eja të lutemi, o bijë!
– Dhe atëherë, - thotë Urania, pa ia vënë veshin. - Shkëlqesia e Tij u shtri praptas dhe mbylli sytë. Qëndroi i qetë, i qetë fare. Nuk flinte. Befas, lëshoi një ngashërimë. Dhe filloi të qante.
– Të qante?! - këlthet Lusinda.
Një potere e papritur i përgjigjet. Të pesta kthejnë kokat: Samsoni është zgjuar dhe lajmëron, duke llomotitur.
– Jo për mua, - thotë me siguri Urania. - Qante për prostatën e

tij të ënjtur, për seksin e tij të vdekur, për atë se tani i duhej t'i pallonte me gishta vashëzat, si Petani.

– Të lutem, moj bijë, për Zotin, a çfarë ke më të shtrenjtë! - i lutet hallë Adelina, duke bërë kryqin. - Mjaft më, tani!
Urania përkëdhel grushtthin e rrudhosur e gjithë pikla të plakës.
– E di që janë të tmerrshme, gjëra që nuk duhej t'i thosha, moj hallë, - e zbut zërin. - Nuk do ta bëj më, kurrë, të betohem. E more vesh tani pse i thashë këto gjëra për babanë? Dhe pse që kur vajta në Adrian, nuk doja të dija më për familjen time? Ja tani besoj se e di pse.
Herë pas here dëneste dhe frymëmarrjet e thella i ngrinin gjoksin. Midis sisëve të tij dhe kërthizës së errët, zbardhnin ca qime të rralla. Sytë i mbante gjithnjë të fshehur poshtë krahut. A thua e ka harruar vajzën? Vallë hidhërimi dhe vuajtja që e kishin pushtuar të tërin, ia fshinë nga mendja atë? Kurse ajo është më e trembur se më përpara, kur ai e përkëdhelte dhe e përdhunonte. Harron dhimbjen e zjarrtë, plagën midis kofshëve, frikën që i japin njollat e gjakut në këmbët e saj e në çarçaf. S'lëviz. Bëhet e padukshme, e paqenshme. Në qoftë se ai burrë që qante, me ato këmbë pa qime, do ta kujtonte që është është aty, nuk do ta falte. Do të derdhte mbi të inatin e paaftësisë së vet mashkullore, e turpit të të qarit të tij, dhe do ta zhdukte.
– Thoshte se nuk ka drejtësi në këtë botë. Se pse t'i ndodhte kjo gjë, kur ai kishte luftuar aq shumë për këtë vend mosmirënjohës, për këtë njerëzi pa nder. I drejtohej Zotit. Shenjtorëve. Zonjës Tonë. Mbase, vetëm djallit. Ulërinte e lutej. Pse e vinin në tërë ato prova? Tortura e bijve të tij, komplotet për ta vrarë, për të shkatërruar veprën e gjithë jetës së tij. Por nuk qahej për këtë. Ai donte t'u kushtohej armiqve me mish e me shpirt. Kështu kishte bërë që kur ishte i ri. Nuk mund të toleronte goditje të palejueshme, të cilat nuk e linin të mbrohej. Dukej gjysmë i çmendur nga dëshpërimi. Tani e kuptoj pse. Sepse seksi i tij, që kishte zhvirgëruar kushedi sa femra, tani nuk i ngrihej më. Kjo e bënte të qante kolosin e fuqishëm që, tani, nuk ishte më. A nuk është për të qeshur?
Por Urania nuk qeshte. Dëgjonte e palëvizur, mezi guxonte të merrte frymë, që ai të mos kujtohej se ajo ndodhej aty. Monologu nuk qe i rrjedhshëm, po i copëtuar, pa lidhje logjike, i

ndërprerë nga heshtje të gjata. Ngrinte zërin dhe bërtiste, ose e shuante atë deri në padëgjim, në një mërmërimë lënduese. Uranisë i kishin ngelur sytë mbi atë gjoks që ulej e ngrihej. Mundohej të mos e shikonte trupin e tij, por nganjëherë sytë e saj, pa dashje, shëtisnin barkun e flashkët, mbiveten, seksin e vdekur dhe këmbet qose.
Ky ishte Gjeneralisimi, Bamirësi i Atdheut, Babai i Atdheut të Ri, Restauruesi i Pavarësisë Ekonomike. Ky ishte Udhëheqësi, të cilit babai i kishte shërbyer tridhjetë vjet me devocion e besnikëri, të cilit i kishte bërë dhuratën më delikate: të bijën e tij katërmbëdhjetëvjeçe. Por gjërat nuk shkuan siç shpresonte senatori. Ai - zemra e Uranisë u gëzua - nuk do të rehabilitohej. Ndoshta, do ta fusnin në burg, ndoshta do ta vrisnin.

– Papritur, ngriti krahun dhe më pa me sytë e skuqur e të ënjtur. Jam dyzet e nëntë vjeçe dhe prapë dridhem kur e kujtoj atë çast. Kështu jam dridhur tridhjetë e pesë vjet rresht, qysh atëherë.
E shikonte me habi dhe urrejtje. Ngjante si një lugat. Të kuq, të zjarrtë, shpues, sytë e tij e ngrinin akull. Ajo s'guxonte të lëvizte. Vështrimi i Truhijos brodhi, duke u ulur deri te këmbët e saj, kaloi mbi çarçafin me njolla gjaku dhe u kthye prapë tek ajo për ta përvëluar. I mbytur prej neverisë, e urdhëroi:
– Hajde, çohu! Nuk shikon si e ke bërë shtratin? Shporru këtej!
– Ishte një mrekulli që më linte të ikja, - thotë Urania. - Pasi e kisha parë të dëshpëruar, të mallëngjyer, duke u ankuar, duke qarë, ishte, vërtet, një mrekulli shenjtorësh, moj hallë. U ngrit, zbriti nga shtrati, mori rrobat e shpërndara përtokë dhe, duke u përplasur te një mobilje, u fut në banjë. Kishte një vaskë banje prej porcelani të bardhë, ku kishte plot sfungjerë e sapunë dhe një parfum të fortë që i shkakëtoi marramendje. Me duart që mezi i bindeshin, pastroi hemorragjinë dhe u vesh. Ishte e pamundur të kopsiste fustanin, të mbërthente rripin. Nuk i veshi çorapet, vetëm këpucët dhe, në një pasqyrë, pa fytyrën e vet të latyrisur me të kuq buzësh dhe rimel. Nuk kishte kohë për t'u pastruar, ai mund të ndërronte mendje. Duhej vrapuar për të dalë nga Shtëpia me Mogan, për të shpëtuar. Kur u kthye në dhomë, Truhijo nuk ishte më lakuriq. Kishte veshur

rrobëdëshambrin e vet të kaltër dhe në dorë mbante gotën me konjak. I tregoi shkallët:

- Hajde, mbathja, ik! - pengohej në të folur. - Thuaj Benitës të sjellë çarçafë të pastër dhe një jorgan e t'i heqë këto ndyrësi.
- Te shkallët e para u pengova dhe m'u thye taka e një këpuce. Gati u rrokullisa gjatë tre kateve. Më vonë m'u ënjt shuma kyc i këmbës më vonë. Benita Sepulveda ishte në katin e parë. Shumë e qetë, duke më buzëqeshur. Desha t'i them ç'më kishte urdhëruar ai. Po nuk më doli asnjë fjalë. Vetëm munda t'i bëj me shenjë për lart. Më kapi për krahu dhe më çoi te rojat, në hyrje. Më tregoi një si kabinë ku kishte një karrige e më thë: "Këtu i lustrojnë çizmet Udhëheqësit". As Manuel Alfonsoja, as makina e tij nuk ishin atje. Shoferi ishte një ushtarak. Më solli në Qytetin Truhijo. Kur më pyeti "Ku është shtëpia jote?", iu përgjigja: "Do të shkoj në Kolegjin Santo Domingo. Më ço atje". Ishte akoma errësirë. Ora tre, ose katër. As që e dija. U vonuan të më hapnin portën e hekurt. Akoma nuk flisja dot, edhe kur erdhi roja. Munda të flas me motër Marien, murgesha që më donte aq shumë. Më çoi në mencë, më dha ujë, më lagu ballin.
  Samsoni, i heshtur për shumë çaste, po shfaq prapë kënaqësinë apo pakënaqësinë e vet, duke fryrë puplat e duke u çjerrë. Të gjithë heshtin. Urania merr gotën e saj, por është bosh. Marianita ia mbush. Nga nervozizmi i derdhet ibriku. Urania pi disa gllënjka ujë të freskët.
- Besoj se më bëri mirë që ju tregova këtë histori mizore. Tani, harrojeni. Mbaroi. Ndodhi dhe nuk ka më shërim. Mbase, duhej ta kisha kapërcyer. Por, as kam dashur, as kam mundur.
- Uranita, moj kushërirë, çfarë po thua, - proteston Manolita. - Pse jo? Shiko ku ke arritur tani. Cila je. Ke një jetë që ta kanë zili gjithë domenikanët.
  Ngrihet dhe shkon drejt Uranisë. E përqafon, e puth në faqe.
- Më ke plagosur, Uranita, - e qorton me dashuri Lusinda. - Por, nuk duhet të qahesh, moj vajzë. Nuk ke të drejtë. Në rastin tënd ia vlen të thuash se s'ka të mirë që nuk vjen nëpërmjet së keqes. Studjove në universitetin më të mirë, ke pasur sukses në karrierën tënde. Ke një burrë që të bën të lumtur dhe nuk të pengon në punën tënde...

Urania e godit lehtë në krah dhe mohon me kokë. Papagalli hesht dhe dëgjon

– Të gënjeva, nuk kam asnjë të dashur, moj kushërirë, - qesh përgjysmë dhe zërin e ka ende të prishur. - Nuk kam pasur kurrë, as nuk do të kem. Do t'i dish të gjitha, Lusinda? Qysh atëherë, kurrë nuk më ka prekur me dorë asnjë burrë. Vetëm Truhijo qe ai që më ka prekur. Siç e dëgjuat. Sa herë që më afrohet e më shikon si femër, më kall krupën. Tmerrin. Dëshirën që të vdes apo ta vras. E kam vështirë ta shpjegoj. Kam studjuar, punoj dhe bëj jetën të mirë. Por jam bosh dhe tërë frikë, akoma. Si ata pleqtë në askund. Të punosh, të punosh, derisa të biesh e dërrmuar. Nuk është për të më pasur zili, të siguroj. Më saktë, unë ju kam zili ju. Po. Po. E di se keni probleme, hallë, qënzime. Por ama keni një familje, jeni një çift, keni fëmijë, keni një vend. Këto gjëra ta mbushin jetën. Kurse mua, im atë dhe Shkëlqesia e Tij më shkretuan përjetë.
Samsoni ka filluar nervoz shëtitjen midis telave të kafazit. Ecën duke u tundur, ndalon dhe mpreh sqepin te këmbët e veta.
– Ishin të tjera kohëra, e dashur Urani, - belbëzon hallë Adelina, duke gëlltitur lotët. - Duhet ta falësh. Ai ka vuajtur dhe vuan. Qe e tmerrshme, moj bijë. Po ashtu ishte koha. Agustini ka qenë i dëshpëruar. Mund ta fusnin në burg, mund ta vrisnin. Nuk ka dashur ta bënte dëm. Ndoshta mendoi se ishte e vetmja mënyrë për të të shpëtuar. Kështu gjoja ndodhnin, atëherë, megjithëse tani nuk kuptohen. Ashtu ishte jeta, këtu. Agustini të ka dashur më shumë se asnjë tjetër në këtë botë, Urani.
Plaka, e robëruar prej shqetësimit, ngatërron duart dhe lëviz në karrigen lëkundëse, ja gjetur prehje. Lusinda i afrohet, i lëmon flokët dhe i jep disa pika valerianë: "Qetësohu, mami, mos bëj ashtu".
Nga dritarja e kopshtit, shkëlqejnë yjet në natën e qetë domenikane. Ishin kohë të tjera? Një frymë e ngrohtë flladi hyn në dhomën e ngrënies herë pas here dhe tund perdet e lulet e një saksie, midis statujave të vogla të shenjtorëve dhe fotografive të familjes. "Ishin dhe nuk ishin", mendon Urania. "Ende diçka prej atyre kohërave pluskon deri këtu"

– Qe e tmerrshme, po atëherë vetëm shpirtmadhësia, delikatesa, humanizmi i motër Maries më shpëtuan, - thotë, duke marrë frymë thellë. - Pa atë, unë do të isha e çmendur ose e vdekur.
Motër Maria gjeti zgjidhje për gjithçka, duke qenë një shembull maturie. Që nga ndihma e parë, në infermierinë e kolegjit, për t'i prerë hemorragjinë e për t'i lehtësuar dhimbjen, deri te nxitja dhe bindja e eprores së Nunciave Domenikane që, në më pak se tri ditë, t'i jepnin bursën, një nxënëse shembullore jeta e së cilës ishte në rrezik, bursën për të vazhduar studimet në "Siena Heights University", në Adrian, Miçigan. Motër Maria foli me senatorin Agustin Kabral (për ta qetësuar apo për ta frikësuar?), në zyrën e drejtoreshës, vetëm ata të tre, dhe i kërkoi të lejonte udhëtimin urgjent të së bijës për në Shtetet e Bashkuara. Po ashtu e bindi që kurrësesi nuk duhej ta shikonte të bijën, për tronditjen e madhe që ajo kishte pësuar, pas asaj që i kishte ndodhur në San Kristobal. Ç'pamje mori Agustin Kabrali para motrës? Urania e kishte pyetur vetëm shumë herë: Të habisë hipokrite? Të shqetësimit? T'i hutimit? Të brerjes së ndërgjegjes? Të turpit? Por as ajo nuk e pyeti, as motër Maria nuk i tha gjë. Murgeshat shkuan në konsullatën amerikane për të siguruar vizën dhe i kërkuan një takim Presidentit Balager të lejonte autorizimin që kërkonin dominikanët për të dalë jashtë, një procedurë që mund të vonohej me javë të tëra. Kolegji i pagoi biletën asaj, duke pasur parasysh se senatori Kabral nuk kishte mundësi ekonomike. Motër Maria dhe motër Helenë Kleri, e shoqëruan në aeroport. Kur u ngrit avioni, ajo për të cilën i falënderoi më shumë Urania, qe e mbajtën premtimin për të mos e lënë të atin ta shihte, as nga larg. Tani i falënderonte gjithashtu, edhe që e kishin internuar diku në ishull ose do t'ua kishte hedhur për ushqim peshkaqenëve.
– U bë vonë, - thotë, duke parë orën e saj. - Pothuaj, është dy e mëngjesit. Duhet të bëj gati valixhen, avioni niset shumë shpejt.
– Do të kthehesh që nesër në Nju Jork? - trishtohet Lusinda. - Shpresoja se do të qëndroje disa ditë.
– Duhet të punoj, - thotë Urania. - Në studio më pret një mal me letra, që do të më bëjnë të luaj mendsh.

- Tani nuk do të vazhdojmë si më parë, apo jo, Urani? - e përqafon Manolita. - Do të shkruajmë dhe do të na kthesh përgjigjie. Ndonjëherë do të vish për pushime e do ta vizitosh familjen tënde. Vërtet, vajzë?
- Patjetër, - pranon Urania, duke e përqafuar. Por, nuk është e sigurt. Ndoshta, me të dalë nga kjo shtëpi, nga ky vend, do të preferonte ta harronte përsëri, këtë familje, këta njerëz dhe të kaluarën e saj. Ndoshta do të pendohej që kishte ardhur dhe kishte folur aq shumë, si këtë natë. Apo ndoshta, jo? Apo, mbase donte të rindërtonte, në njëfarë mënyre, lidhjen me çfarë i kishte mbetur nga familja? - A mundet të thërras një taksi në këtë orë?
- Do të të çojmë ne, - dhe Lusinda ngrihet nga vendi.
  Kur Urania përkulet për të përqafuar hallë Adelinën, plaka kapet pas saj duke i ngulur gishtat e saj të holluar e të kthyer si grepa. U duk sikur ishte qetësuar, po tani prapë i dallohet turbullimi dhe një shqetësim i qartë në sytë e futur thellë, si gropa të rrethuara me rrudha.
- Mbase, Agustini nuk ka ditur gjë, - belbëzon me vështirësi, si t'i kishte dalë nga vendi proteza. - Manuel Alfonsoja mund ta ketë gënjyer tim vëlla, i cili, në thelb, ishte shumë i çiltër. Mos i mbaj aq mëri, bijëza ime. Ka jetuar i vetmuar, ka vuajtur shumë. Zoti na mëson të falim. Për shpirt të nënës tënde që ishte aq katolike, moj bijëz.
  Urania mundohet ta qetësojë: "Po, po, halla, është si thua ti, mos u mërzit, të lutem". Dy vajzat e saj, e rrethojnë plakën, duke u përpjekur ta qetësojnë. Ajo, së fundi, ulet dhe mbetet e mbledhur në karrige, me fytyrë të shtrembëruar.
- Më fal që të tregova këto gjëra, - Urania e puth në ballë. - Qe një budallallëk. Por kishte shumë vjet që më digjte përbrenda.
- Tani do të qetësohet, - thotë Manolita. - Do të rri unë me të. Bëre mirë që na i tregove. Të lutem, na shkruaj, na telefono ndonjëherë. Të mos e humbasim më lidhjen, kushërirë e dashur.
- Të premtoj, - thotë Urania.
  E shoqëron deri te porta dhe e përshëndet, pranë autoveturës së vjetër të Lusindës, një Toyota e dorës së dytë e parkuar në hyrje. Manolita e përqafon për herë të dytë me sytë mbushur me lot.

Në makinë drejt Hotel Haraguas, ndërsa përshkojnë rrugët e shkreta të Gaskes, Urania angështohet. Pse e bëre këtë? A do të ndjehesh ndryshe, e çliruar nga ata demonë që të kanë tharë shpirtin? Pa dyshim që jo. Ishte një dobësi, një rënie në atë sentimentalizëm, në atë vetëmëshirë, gjë për të cilën gjithmonë, i kishte pasur inat të tjerët. Prisje se do t'u dhimbseshe, se do të mallëngjeheshin për ty? Atë dëmshpërblim doje?

– Dhe atëherë – shpesh është një ilaç për rëniet shpirtërore të saj – kujton fundin e Xhoni Abes Garsias. Ju kujtua, Esperansita Burrikod, një shoqe e Bankës Botërore, vite të shkuara, e cila qe caktuar në Puerto Prncipe, ku ish-shefit të SIM-it i kishin zënë këmbët dhe, pas një xhiroje në Kanada, Francë e Zvicër – kurrë nuk shkeli në Japoni – një strehim i artë, ku e vendosi Balageri. Esperansita dhe familja e Abes Garsias ishin fqinjë. Ai ndodhej në Haiti si këshilltar i Presidentit Dyvalie. Por, pas një kohe, filloi të komplotojë kundër shefit të ri, duke mbështetur planet armiqësore të një dhëndri të diktatorit haitjan, koloneli Domenik. Paba Doku e zgjidhi problemin për dhjetë minuta. Esperansita pa në mes të paradites të zbrisnin nga kamionçina nja njëzet Tontons Macoutes dhe të pushtonin shtëpinë e fqinjit të saj, duke shtrirë me armë. Dhjetë minuta, jo më shumë. Vranë Xhoni Abesin, vranë gruan e tij, vranë dy bijtë e vegjël të Xhoni Abesit, dy shërbëtorët, vranë pulat, lepujt dhe qentë e tij. Pastaj i vunë zjarrin shtëpisë dhe ikën. Esperansitës iu desh të bënte trajtim psikiatrik me t'u kthyer në Uashington. Këtë fund do të kishe dashur edhe për babanë? Të tha mirë hallë Adelina, je e mbushur plot inat e urrejtje. Përsëri ndjehet bosh.
– Më vjen keq shumë për atë skenë, atë melodramë, Lusindita, - i thotë te dera e Haraguas. I duhet të flasë fort, sepse muzika që gjëmonte në kazinonë e katit të parë e mbyste zërin e saj.
– E kam hidhëruar hallë Adelinën, sonte.
– Ke të drejtë, motër. Tani që mora vesh se ç'ka ndodhur me ty, e kuptoj tërë atë heshtje që na shkaktonte aq dhimbje. Të lutem, Urani, kthehu të na shohësh. Ne jemi familja jote dhe ky është vendi yt.
– Kur Urania përshëndetet me Marianitën, kjo e përqafon si donte të ngjitej me të, të futej brenda saj. Trupthi fare i hollë i vogëlushes, dridhej si gjethe.
– Unë do të të dua shumë, teze Urani, - i pëshpërit në vesh

dhe Urania ndien se e mbyt trishtimi. - Do të të shkruaj muaj për muaj. Nuk ka rëndësi nëse nuk më përgjigjesh.

- E puth dhe e puth në faqe disa herë me buzët e holla, si ta çukiste një zog. Para se të hyjë në hotel, Urania pret derisa automobili i vjetër i së kushërirës humbet në Malekonin Xhorxh Uashington, sfondi i të cilit që një radhë valësh të bardha, të zhurmshme. Hyn në Haragua. Në anën e majtë, kazinoja dhe diskoja pranë saj, janë shqetësuese: Ritme, zëra, automatë dhe thirrje lojtarësh në ruletë.
- Sa drejtohet për në ashensor, një figurë mashkulli e ndal. Është një turist ca i dehur, rreth të dyzetave, flokëkuq, me këmishë me kuadrate, pantallona kauboj dhe këpucë mokazini:

- *May I buy you a drink, dear lady?* - thotë dhe bën një përkulje oborrtari.
- *Get out of my way, you dirty drunk* - i përgjigjet Urania, pa u ndalur dhe arrin të shohë shprehjen e hutuar e të trembur të mendjelehtit.
- Hyn në dhomë dhe fillon të përgatisë valixhen, por pas një çasti e lë dhe shkon e ulet pranë dritares, për të parë yjet e ndritshëm dhe shkumën e valëve. E di se nuk do të ketë gjumë, kështu që ka kohë sa të duash për të mbaruar valixhen.
- Dhe vendos: "Nëse Marianita më shkruan, do t'i përgjigjem çdo letre të saj".

FJALOR

***Malekon* (Malecon)** - Mur që ngrihet buzë detit ose në porte për t'u mbrojtur nga dallgët. Ndërsa në Santo Domingo, El Malecon, është zona më e rëndësishme urbane, e ngritur dhe e rregulluar buzë detit. (Të gjitha shënimet janë të përkthyesit.)
***Kreole* (creole ose criolla)** - gjuha e zezakëve të Haitit, me bazë frëngjishten, por e përzier me disa gjuhë të Afrikës perëndimore. Nga viti 1961 është ligjëruar si gjuhë zyrtare, së bashku me frëngjishten.
Kamara de Kuentas (*Cámara de Cuentas*) - Në Republikën Domenikane, organizëm shtetëror i ngarkuar të kujdeset për përdorimin e mirë të burimeve të vendit.
***Fron* (El Trono)** - Spanjisht, një tip froni i sajuar enkas për të torturuar kundërshtarët në hetuesi.
RLTM - *Rectitud* (Drejtësi), Libertad (Liri), *Trabajo* (Punë), *Moralidad* (Moral), që përfaqësojnë katër germat e para të emrit të Truhijos, Rafael Leonidas Trujillo Molina.
Vudu - Fe pagane afrikane që e praktikojnë disa popuj të Amerikës Qendrore me origjinë afrikane.
Santeria - Fe e popujve zezakë të kontinentit amerikan, një përzierje e sinkretizmit pagan afrikan me katolicizmin.
***Perejil* (sp. perehil)** - majdanoz.
***Pobres negritos dominicanos* (sp. povres negritos domenikanos)** - Të mjerët zezakë domenikanë.
***Çapeton* (sp. chapeton)** - në Amerikën e Jugut kështu quhen emigrantët evropianë të sapombritur.
Besame, besame mucho, como si fuera esta noche la ultima vez (sp.) - Puthmë, puthmë fort, si të ishte hera e fundit këtë natë
***Tontons Macoutes* (tòntòn mäkut)**: - malok i ndyrë, është një term në gjuhën indigjene kreole që përdorej për të treguar njerëzit e afërm në shërbim të diktatorit të Haitit, Fransua Dyvalie, të organizuar në formë grupesh paraushtarake, ose Milicia e Sigurimit Kombëtar.
May I buy you a drink, dear lady? (ang.): - A pranoni një pije prej meje, e dashur zonjushë?
Get out of my way, you dirty drunk. (ang.): - M'u hiq sysh, pijanec i ndyrë.

Uruguaj, 1959. Një djalë i ri, i etur për aventurë dhe i zhgënjyer nga jeta provinciale, mbërrin në Santo Domingo për të gjetur të atin, të cilin nuk e ka njohur kurrë. Atje zbulohet një botë e magjepsur dhe e dhunshme nën hijen e diktatorit Rafael Trujillo. Vite më vonë, i rritur dhe i përfshirë në rrethet e pushtetit, ai bëhet dëshmitar – dhe pjesë – e ngjarjes që do t'i japë fund regjimit: atentatit ndaj Trujillos. Përmes kujtimeve të tij, romani ndërthur historinë personale me atë kombëtare, duke eksploruar natyrën e pushtetit, frikës, lirisë dhe fatit.

Mario Vargas Llosa (1936–2025) ishte shkrimtar, eseist dhe gazetar peruan, fitues i Çmimit Nobel për Letërsi më 2010. Vepra e tij shquhet për shqyrtimin e thellë të strukturave të pushtetit dhe lirisë individuale në shoqëritë latinoamerikane.